



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

**Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-
Asociimit (PKZMSA) 2021-2025**

Tetor 2021
Prishtinë

Faqe e zbrahtë

Përmbajtja

<i>Vendimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës për miratimin e PKZMSA 2021-2025</i>	5
<i>Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për miratimin e PKZMSA 2021-2025</i>	6
Lista e shkurtesave	7
HYRJE	9
Marrëdhëniet ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian.....	11
1. BLOKU 1: KRITERET POLITIKE	12
1.1. Demokracia dhe sundimi i ligjit	12
1.1.1. Kushtetuta, parlamenti dhe sistemi zgjedhor	12
1.1.2. Administrata publike	18
1.1.3. Avokati i Popullit	24
1.1.4. Mbikëqyrja civile e forcave të sigurisë	26
1.2. Bashkëpunimi rajonal dhe obligimet ndërkombëtare	28
2. BLOKU 2: KRITERET EKONOMIKE	37
2.1. Ekzistenca e ekonomisë funksionale të tregut.....	38
2.2. Kapaciteti për t'u përballur me presionin e konkurrencës dhe forcat e tregut brenda Unionit	52
3. BLOKU 3: STANDARDET EVROPIANE – PËRAFRIMI I LEGJISLACIONIT TË KOSOVËS ME ACQUIS-NË E BE-SË	66
3.0. Korniza ligjore për përafrimin e legjislacionit të Kosovës me acquis-në e BE-së	66
3.1. Kapitulli 1 i acquis-së: Lëvizja e lirë e mallrave	68
3.2. Kapitulli 2 i acquis-së: Liria e lëvizjes së punonjësve	76
3.3. Kapitulli 3 i acquis-së: E drejta e themelimit të kompanive dhe liria e ofrimit të shërbimeve	77
3.4. Kapitulli 4 i acquis-së: Lëvizja e lirë e kapitalit	82
3.5. Kapitulli 5 i acquis-së: Prokurimi publik	85
3.6. Kapitulli 6 i acquis-së: E drejta e kompanive.....	91
3.7. Kapitulli 7 i acquis-së: E drejta e pronësisë intelektuale	94
3.8. Kapitulli 8 i acquis-së: Politikat e konkurrencës	99
3.9. Kapitulli 9 i acquis-së: Shërbimet financiare.....	104
3.10. Kapitulli 10 i acquis-së: Shoqëria e informacionit dhe mediat.....	113
3.11. Kapitulli 11 i acquis-së: Bujqësia dhe zhvillimi rural.....	119
3.12. Kapitulli 12 i acquis-së: Politikat e sigurisë së ushqimit, veterinarisë dhe ato të fitosanitarisë	125
3.13. Kapitulli 13 i acquis-së: Peshkataria	129
3.14. Kapitulli 14 i acquis-së: Politikat e transportit	130
3.15. Kapitulli 15 i acquis-së: Energjia	135
3.16. Kapitulli 16 i acquis-së: Tatimet	145
3.17. Kapitulli 17 i acquis-së: Politikat ekonomike dhe monetare.....	150
3.18. Kapitulli 18 i acquis-së: Statistikat	153
3.19. Kapitulli 19 i acquis-së: Politikat sociale dhe punësimi	162
3.20. Kapitulli 20 i acquis-së: Politikat e ndërmarrjeve dhe ato të industrisë	166
3.21. Kapitulli 21 i acquis-së: Rrjetet trans-evropiane	168
3.22. Kapitulli 22 i acquis-së: Politikat rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore.....	174
3.23. Kapitulli 23 i acquis-së: Gjyqësori dhe të drejtat themelore.....	176
3.24. Kapitulli 24 i acquis-së: Drejtësia, liria dhe siguria	190
3.25. Kapitulli 25 i acquis-së: Shkenca dhe kërkimet shkencore	204
3.26. Kapitulli 26 i acquis-së: Arsimi dhe kultura.....	206
3.27. Kapitulli 27 i acquis-së: Mjedisi	210
3.28. Kapitulli 28 i acquis-së: Mbrojtja e konsumatorit dhe e shëndetit	219
3.29. Kapitulli 29 i acquis-së: Unioni Doganor	225
3.30. Kapitulli 30 i acquis-së: Marrëdhëniet me jashtë	231

3.31. Kapitulli 31 i acquis-së: Politika e jashtme, e sigurisë dhe ajo e mbrojtjes	234
3.32. Kapitulli 32 i acquis-së: Kontrolli financiar	237
3.33. Kapitulli 33 i acquis-së: Dispozitat financiare dhe buxhetore	244
3.34. Kapitulli 34 i acquis-së: Institucionet	245
3.35. Kapitulli 35 i acquis-së: Çështjet e tjera	245
MATRICA E MASAVE AFATSHKURTA	246

Vendimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës për miratimin e PKZMSA 2021-2025



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA ZYRA E KRYEMINISTRIT - UREDI PREMIERERA - OFFICE OF THE PRIME MINISTER SEKTORI I ARKIVËS - SEKTOR ARRIVE - ARCHIVE SECTOR			
Niveli Org. Charakteri Org. Unit	02.1.a	Nr. Proc. No. Proc. Proc. No.	1681/7
Nr. Fjalëve No. Words No. Pages	-2-	Data: Datum: Date:	06 / 10 / 20 21
Prishtinë/a			

Legjislatura VIII
Sesioni vjeshtor

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në Seancën plenare të mbajtur më 4 tetor 2021, pasi e shqyrtoi Programin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) 2021 – 2025, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) 2021 – 2025.

Nr. 08-V-079

Prishtinë, 04.10.2021

Glauk KONJUFCA

Kryetar i Kuvendit

Vendimi u dërgohet:

- Qeverisë së Republikës së Kosovës,
- Komisioneve parlamentare dhe
- Arkivit të Kuvendit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/19
Datë: 14.07.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4, dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 korrik 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) 2021-2025.
2. Buxheti për zbatimin e këtij Programi mbetet brenda ndarjeve buxhetore të organizatave buxhetore për vitin 2021 dhe në pajtim me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Zyra e Kryeministrit dhe institucionet e tjera përgjegjëse, sipas Programit.
4. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që të përcjellë këtë Program për miratim në Kuvendin e Republikës së Kosovës.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

Lista e shkurtesave

AAC	Autoriteti i Aviacionit Civil
AD	Akademia e Drejtësisë
AIP	Agjencia e Informimit dhe Privatësisë
AKI	Agjencia e Kosovës për Inteligjencë
AKK	Autoriteti Kosovar i Konkurrencës
AKKK	Agjencia Kosovare Kundër Korrupsionit
AKKVP	Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës
AKMRrSB	Agjencia e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore
APK	Agjencia e Kosovës për Privatizim
ARKEP	Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
ARrH	Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
AUV	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
BEI (EIB)	Banka Evropiane e Investimeve
BERZh (EBRD)	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BPV	Bruto Prodhimi Vendor
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CEFTA	Marrëveshja për Tregti të Lirë në Evropën Qendrore
DIE	Departamentet përgjegjëse për integrim evropian
DIEKP	Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave
DK	Dogana e Kosovës
DL	Departamenti Ligjor
DNSh	Departamenti për Ndihmë Shtetërore
EJL	Evropa Juglindore
ERA	Agjenda për Reforma Evropiane
FKPK	Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GVRAP	Grupi i Veçantë i Stabilizim-Asociimit për Reformën e Administratës Publike
GZ	Gazeta Zyrtare
IAP	Institucioni i Avokatit të Popullit
IHD	Investimet e Huaja Direkte
IKAP	Instituti i Kosovës për Administratë Publike
IPA	Instrumenti i Asistencës së Paraanëtarësimit
KASh	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
KBR (RCC)	Këshilli për Bashkëpunim Rajonal
KE	Komisioni Evropian
KfW	Banka Gjermane për Zhvillim
KGjK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KiE	Këshilli i Evropës
KIESA	Agjencia Kosovare për Investime dhe Mbështetjen e Ndërmarrjeve
KOSTT	Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
KPM	Komisioni i Pavarur i Mediave
KPSA	Komisioni Parlamentar i Stabilizim-Asociimit
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KRPP	Komisioni Rregullator i Prokurimit Publik
KSA	Këshilli i Stabilizim-Asociimit

MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MD	Ministria e Drejtësisë
ME	Ministria e Ekonomisë
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
MIK	Menaxhimi i integruar i kufirit
MINT	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
MKK	Ministria për Komunitete dhe Kthim
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MM	Ministria e Mbrojtjes
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPJD	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës
MSA	Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit
MSh	Ministria e Shëndetësisë
MZHR	Ministria e Zhvillimit Rajonal
NP	Ndërmarrje Publike
NVM	Ndërmarrje e vogël dhe e mesme
NjIF	Njësia e Inteligjencës Financiare
OBT	Organizata Botërore e Tregtisë
OShC	Organizatë e shoqërisë civile
OShP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
SDGs (OZhQ)	Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm
PKZMSA	Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit
PL	Programi Legjislativ i Qeverisë
PK	Policia e Kosovës
PQ	Programi i Qeverisë
PRE	Programi për Reforma në Ekonomi
PSA	Procesi i Stabilizim-Asociimit
PSO	Plan Strategjik Operacional
PSRK	Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës
PV	Plan veprimi
PZAP	Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
RAP	Reforma e administratës publike
ReSPA	Shkolla Rajonale për Administratë Publike
PBEJL (SEECp)	Procesi i Bashkëpunimit për Evropën Juglindore
SIDA	Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar
SIGMA/OECD	<i>Përkrahje për Përmirësimin e Qeverisjes dhe Menaxhimit (Instrument i Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik)</i>
SKZh	Strategjia Kombëtare për Zhvillim
ShBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
TI	Teknologji informative
TKE	Traktati i Komunitetit të Energjisë
UA	Udhëzim Administrativ
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
WBIF	Instrumenti Investues për Ballkan Perëndimor
ZBE	Zyra e Bashkimit Evropian
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit
ZKM	Zyra e Kryeministrit
ZRrE	Zyra e Rregullatorit të Energjisë
ZRrUK	Zyra e Rregullatorit për Ujë dhe Kanalizim

HYRJE

Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) 2021-2025 është programi i gjashtë me radhë për zbatimin e MSA-së ndërmjet Bashkimit Evropian (BE) dhe Republikës së Kosovës.¹ Ai është dokumenti kryesor kombëtar i politikave dhe planifikues për zbatimin e reformave për adoptimin e tërë acquis-së së BE-së në legjislacionin kombëtar. Ai zbatohet krahas fazës së dytë të Agjendës për Reforma Evropiane (ERA II), e cila përcakton prioritetet politike dhe reformat për përmbushjen e tyre, dhe është e ndërlidhur me të. ERA II do të zbatohet brenda dy vitesh nga miratimi i saj, përmes një plani veprimi (PV ERA II), të miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Rishikimi i rregullt vjetor i PKZMSA-së ka filluar në tetor 2020 dhe dokumenti ishte finalizuar në mesin e dhjetorit 2020, ndërsa në janar 2021 janë mbajtur konsultimet publike. Më pas, për shkak të formimit të Qeverisë së re të dalë nga zgjedhjet e 14 shkurtit, dokumenti u desh të modifikohej për t'u harmonizuar me Programin e Qeverisë 2021-2025 dhe Planet Strategjike Operacionale (PSO) të ZKM-së dhe ministrive, si dhe me PV ERA II. PKZMSA 2021-2025 është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës më 14 korrik 2021 dhe nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 4 tetor 2021.

Bazuar në Vendimin e Qeverisë nr. 06/22², ky proces është udhëhequr nga departamentet për integrim evropian në kuadër të Zyrës së Kryeministrit (ZKM/DIE), si institucioni kryesor koordinues, në bashkëpunim me ministrinë dhe institucionet e tjera përgjegjëse për secilin kapitull. Puna në nivel të institucioneve të linjës është koordinuar nga Departamentet për Koordinim të Politikave dhe Integrim Evropian (DIEKP-të) dhe strukturat ekuivalente. Në këtë proces në nivel të institucioneve të linjës gjithashtu janë përfshirë Departamentet Ligjore (DL) dhe strukturat e tjera të linjës brenda tyre të mandatuara për zhvillimin dhe zbatimin e politikave në fushat përkatëse. ZKM/DIE gjithashtu kanë qenë pjesë aktive e punës gjatë tërë procesit të rishikimit.

Sa i përket ndarjes së përgjegjësisë, ZKM/DIE kanë propozuar masat afatshkurtra, bazuar në reformat e dakorduara në mbledhjet e organeve të stabilizim-asociimit BE-Kosovë të mbajtura gjatë vitit 2020 dhe të gjeturat e Raportit të KE-së për Kosovën – 2020. Pas kësaj, masat e propozuara, në bashkëpunim me institucionet e linjës, janë zhvilluar më tej, në raport me zbatueshmërinë e tyre (bazuar në kapacitetet në dispozicion, kohën e nevojshme, etj.), janë ndërlidhur me dokumente sektoriale të politikave, si dhe janë kostuar (bazuar në metodologjinë e hollësishme për këtë qëllim) e konfirmuar nga institucionet e linjës.

Sa i përket përmbytjes, PKZMSA 2021-2025 është gjithëpërfshirës për kah fushëveprimi. Ai përmban reforma afatshkurtra për vitin 2021 dhe objektiva prioritare afatmesme (për periudhën deri në fund të vitit 2025) për përmbushjen e detyrimeve të MSA-së, përmes përfarimit të legjislacionit kombëtar me acquis të BE-së dhe zbatimit të legjislacionit të përafuar. Bazuar në strukturën e Kriteve të Kopenhagës, ai është i ndarë në tri blloqe: *Kriteret politike*, *Kriteret ekonomike*, dhe *Standardet evropiane – përafrimi i legjislacionit të Kosovës me acquis-në e BE-së*.

Blloku 1: Kriteret politike mbulon fushat e ligjvënies, kushtetutës, reformës së sistemit zgjedhor, administratës publike, bashkëpunimit rajonal. Ky bllok ndërlidhet me kapitujt 23 dhe 24 të acquis-së (të bllokut të tretë), dhe përmban pesë kapituj: *Kushtetuta*, *Parlamenti dhe sistemi zgjedhor*; *Administrata publike*; *Avokati i Popullit*; *Mbikëqyrja civile e forcave të sigurisë*; dhe *Bashkëpunimi rajonal dhe obligimet ndërkombëtare*.

Blloku 2: Kriteret ekonomike është i harmonizuar me Programin për Reforma Ekonomike (PRE). Ai gjithashtu reflekton prioritetet dhe aktivitetet të dalë nga mekanizma të tjerë të dialogut me BE-në, si prioritetet vjetore, konkluzionet e strukturave të MSA-së, ose nga mekanizmat multilateralë, si

¹ Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, në dispozicion në [https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:22016A0316\(01\)&from=EN](https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:22016A0316(01)&from=EN); Ligji nr. 05/L-069 për ratifikimin e MSA-së, në dispozicion në <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=11239>.

² Vendimi i Qeverisë nr. 06/22, në dispozicion në http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_mbledhjes_se_22_te_Qeverise_2015_.pdf, fq. 6.

marrëveshjet me FMN, etj. Ky bllok përmban dy kapituj: *Ekzistenca e ekonomisë funksionale të tregut, dhe Kapaciteti për t'u përballur me presionin e konkurrencës dhe forcat e tregut brenda Unionit.*

Blloku 3: Standardet evropiane - përafrimi i legjislacionit të Kosovës me acquis-në e BE-së përfshin të gjitha fushat e acquis-së e BE-së dhe kërkon reformimin e tërë qeverisjes përmes adoptimit të acquis-së në legjislacionin kombëtar dhe zbatimit të tij, gjë që kërkon edhe kapacitete administrative. Ky bllok përmban 33 kapituj të acquis-së dhe një kapitull mbi kornizën ligjore për përafrimin e legjislacionit vendor me acquis.

Secili kapitull është i ndarë në dy pjesë: pjesa narrative dhe matrica e masave afatshkurtra. Pjesa narrative përmbledh detyrimet e MSA-së dhe detyrimet nga mekanizmat e të tjerë të aderimit në BE, gjenden aktuale (kornizën legislative, përfshirë nivelin e përafrimit të legjislacionit vendor me acquis, kornizën e politikave dhe atë institucionale, dhe asistencën e jashtme), dhe objektivat prioritare afatmesme. Matrica e masave afatshkurtra përmban masat konkrete për zbatimin e reformave, përkatësisht masat legislative (të ndara më tej në masa të legjislacionit kornizë dhe akteve nënligjore e akteve të tjera rregullative) dhe masat zbatuese (të ndara më tej në masa të kornizës së politikave, reformave institucionale e të ngritjes së kapaciteteve institucionale, dhe ato për zbatim në praktikë).

Përgjegjëse për zbatimin e Programit dhe monitorimin e zbatimit të tij do të jenë organet përkatëse të administratës shtetërore, brenda fushëveprimit të kompetencave të tyre. Si mekanizmi qendror qeverisës në vend për përmbushjen e detyrimeve të MSA-së, përgjegjëse për këto në nivelin më të lartë është Qeveria, secili anëtar i saj dhe krerët e institucioneve të tjera të administratës shtetërore. Rol kyç në këtë do të luajnë edhe strukturat formale të stabilizim-asociimit. Koordinimin e përgjithshëm do ta bëjnë ZKM/DIE, në bashkëpunim me institucionet përkatëse të linjës, përfshirë përmes monitorimit të rregullt të zbatimit e raportimit të rregullt mbi zbatimin e tij. Masat që parashohin miratimin e projektligjeve konsiderohen të zbatuara me miratimin e projektligjeve përkatëse nga Qeveria.

Kuvendi do të jetë një nga shtyllat kryesore institucionale në zbatimin e këtij programi, në veçanti miratimin e legjislacionit, përfshirë përmes Komisionit për Integrim Evropian dhe Komitetit Parlamentar të Stabilizim-Asociimit (KPIE).

Në emër të BE-së, rol të rëndësishëm në përmbushjen e detyrimeve të MSA-së, dhe rrjedhimisht në zbatimin e PKZMSA-së, do të luajë edhe Komisioni Evropian (KE), përfshirë përmes Delegacionit të BE-së (ZBE) në Kosovë.

Rolin e tyre në zbatimin e Programit e kanë edhe shoqëria civile dhe palët e tjera të interesuara. ZKM/DIE, si institucione përgjegjës të Qeverisë për integrim evropian, do të bashkëpunojnë me aktorë jashtë institucioneve publike në zbatimin e këtij programi, përfshirë përmes mekanizmit konsultues me OShC dhe akterë të tjerë në kuadër të organeve të përbashkëta të stabilizim-asociimit BE-Kosovë.

Marrëdhëniet ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian

Më 1999 BE kishte iniciuar *Procesin e Stabilizim-Asociimit* (PSA) si kornizë për anëtarësimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në të, dhe e kishte lansuar atë në nëntor 2000, në Samitin e Zagrebit. Bazuar në Kriteret e Kopenhagës, PSA përcakton se perspektiva evropiane e këtyre vendeve varet nga përparimet në vendosjen e demokracisë së qëndrueshme, shtetit ligjor, ekonomisë së tregut dhe bashkëpunimit rajonal. Kjo perspektivë ishte rikonfirmuar në Këshillin Evropian të Selanikut, në qershor 2003.

Sa i përket Kosovës, në prill 2005 KE kishte nxjerrë komunikatën *E ardhmja evropiane për Kosovën*, kurse më 2006 Këshilli kishte miratuar Partneritetin e parë Evropian për Kosovën, e të dytin më 2008. Si përgjigje ndaj Partneritetit Evropian, gjatë periudhës 2008-2012 Kosova ka zbatuar Planin e Veprimit të Partneritetit Evropian (PVPE), e më pas, gjatë periudhës 2013-2015, Planin e Veprimit për MSA (PVMSA) dhe Planin e Veprimit për adresimin e rekomandimeve të Raportit të Progresit (PVRP).

Më 17 shkurt 2008, Kuvendi i Kosovës shpalli Kosovën shtet të pavarur dhe sovran. Republika e Kosovës deri më tani është njohur nga njëqindeshtatëmbëdhjetë (117) shtete³, përfshirë 22 shtete anëtare të BE-së.

Deri në fund të vitit 2009 dialogu i reformave ndërmjet Kosovës dhe BE-së është zhvilluar përmes Mekanizmit Përcjellës të procesit të Stabilizim-Asociimit (MPSA). Më pas, bazuar në komunikatën e KE-së *Kosova – përmbushja e perspektivës së saj evropiane*, të tetorit 2009, dialogu i reformave ishte avancuar në kornizën e Dialogut të Procesit të Stabilizim-Asociimit (DPSA), ndërsa gjithashtu ishte iniciuar procesi i pjesëmarrjes së Kosovës në Programet e BE-së.

Procesi drejt MSA-së ka nisur në tetor 2011, me rekomandimin e KE-së për iniciimin e *Studimit të Fizibilitetit për MSA*, i cili, në tetor 2012, kishte konstatuar se Kosova ishte e gatshme të negocionte MSA-në. Negociatat janë zhvilluar nga tetor i 2013 deri në korrik 2014. Më pas, MSA është miratuar nga Qeveritë e Shteteve Anëtare, ishte nënshkruar më 27 tetor 2015, si dhe është miratuar nga Qeveria e Kosovës (më 30 tetor 2015) dhe ratifikuar nga Kuvendi (më 2 nëntor 2015). Përfundimisht, MSA ka hyrë në fuqi më 1 prill 2016. Gjatë vitit 2016 gjithashtu janë funksionalizuar organet e përbashkëta Kosovë-BE të krijuara me MSA për mbikëqyrjen e zbatimit të saj: Këshilli i Stabilizim-Asociimit, Komiteti, nënkomitetet dhe grupet e veçanta, si dhe Komiteti Parlamentar i Stabilizim-Asociimit. Gjatë vitit 2020 këto organe janë mbledhur në raundin e pestë.

Zhvillim tjetër me rëndësi përbën lansimi i fazës së dytë të prioritetëve politike për zbatimin e MSA-së – Agjendës për Reforma Evropiane (ERA II), përkatësisht 15 prioritetëve. ERA II do të zbatohet gjatë periudhës së ardhshme dyvjeçare. Ajo shërben për përmbushjen e detyrimeve të MSA-së duke u fokusuar në reformat kyçe ekonomike, fuqizimin e sundimit të ligjit dhe konsolidimit të qeverisjes së mirë.

Pas shuarjes së Ministrinë e Integritimit Evropian, në mesin e nëntorit 2020 ka përfunduar transferimi i strukturave të saj në Zyrën e Kryeministrit (ZKM).

Sa i përket procesit të *liberalizimit të vizave*, më 18 korrik 2018 KE ka nxjerrë rekomandimin për heqjen e regjimit të vizave me Kosovën. Pas kësaj, më 30 gusht, Komiteti i Parlamentit Evropian për të Drejtat Civile, Drejtësi dhe Punë të Brendshme (LIBE) ka miratuar këtë rekomandim. Ky rekomandim ka mbetur të miratohet përfundimisht nga shtetet anëtare në Këshillin e BE-së.

Sa i përket pjesëmarrjes në *Programet e BE-së*, Kosova aktualisht përfiton nga gjashtë (6) prej tyre: *Evropa për Qytetarët*, *Evropa Kreative*, *COSME* dhe *ERASMUS+*, *Customs 2020* dhe *Fiscalis*.

³ MPJD, *Njohjet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës*, <https://www.mfa-ks.net/al/politika/483/njohjet-ndrkombtare-t-republiks-s-kosovs/483>.

1. BLOKU 1: KRITERET POLITIKE
1.1. Demokracia dhe sundimi i ligjit
1.1.1. Kushtetuta, parlamenti dhe sistemi zgjedhor

Kushtetuta

Kushtetuta e Republikës së Kosovës është miratuar nga Kuvendi më 9 prill 2008 dhe ka hyrë në fuqi më 15 qershor 2008. Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, sundimit të ligjit, mos-diskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes së mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit dhe ekonomisë së tregut. Këto parime demokratike janë të parapara edhe në nenin 3 të MSA-së.

Meqë këto parime përbëjnë elementet thelbësore të funksionimit shtetëror dhe të MSA-së, institucionet e Kosovës kanë ndërmarrë veprime konkrete për të filluar të përmbushin kriteret e MSA-së përmes ndryshimeve të nevojshme kushtetuese. Konkretisht, për të përmbushur kërkesat e MSA dhe gjetjet e raporteve kryesore për vendin nga KE.

Republika e Kosovës mbetet e përkushtuar për të përmbushur obligimet e tjera që dalin nga MSA. Në këtë drejtim, Kosova do të zbatojë reformat, përfshirë ato në fushën e administratës, drejtësisë dhe fushat e tjera varësisht nga nevojat që shfaqen gjatë periudhës zbatuese në vitet në vijim.

Parlamenti

Ky kapitull mbulon fushëveprimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës si organ ligjvënës, që miraton ligje e rezoluta dhe marrëveshje ndërkombëtare. Ai mbulon edhe funksionin mbikëqyrës të Kuvendit, përkatësisht për mbikëqyrjen e punës së Qeverisë dhe institucioneve të tjera publike të cilat sipas Kushtetutës dhe ligjeve i raportojnë Kuvendit, si dhe rolin e tij në procesin e integritit evropian. Pika të tjera që mbulon ky kapitull përfshijnë si në vijim: reformat kyçe kushtetuese që kërkon aderimi në BE; përbërjen dhe strukturën, përfshirë imunitetin e deputetëve; funksionet e përgjithshme të Kuvendit; funksionimin e strukturave të Kuvendit (bazuar edhe në Rregulloren e punës), me fokus në çështjet relevante për kërkesat e integritit evropian, përfshirë ato të MSA-së; funksionin legjislativ të Kuvendit; funksioni mbikëqyrës të Kuvendit; funksionin zgjedhor të Kuvendit (cilat organe/autoritete të administratës shtetërore i zgjedh/emëron dhe shkarkon, dhe procedurat e përgjithshme); rolin e Kuvendit në procesin e harmonizimit të legjislacionit kombëtar me acquis-në e BE-së dhe strukturat përgjegjëse; dhe zgjedhjet (legjislacionin, sistemin zgjedhor, funksionimin dhe ecurinë e proceseve zgjedhore).

Kërkesat e MSA-së

Neni 132 i MSA-së ka themeluar Komisionin Parlamentar të Stabilizim-Asociimit (KPSA) si forum të përbashkët të deputetëve të Parlamentit Evropian dhe atyre të Kuvendit të Republikës së Kosovës për të shkëmbyer mendimet rreth zbatimit të MSA-së. Kuvendi i Kosovës, në zbatim të nenit 132 të MSA-së më 18 mars, 2016 ka themeluar KPSA. Kuvendi në legjislaturën e V, më 16-17 maj 2016 ka mbajtur takimin e parë të Komisionit Parlamentar të Stabilizim-Asociimit BE-Kosovë ku është miratuar Rregullorja e Punës e këtij Komisioni. Gjatë legjislaturës së VI janë mbajtur takimet e përbashkëta të të dyja delegacioneve të cilat shënojnë ngritjen e bashkëpunimit të Kuvendit të Kosovës me Parlamentin Evropian në nivel më të lartë. KPSA mblidhet dy herë në vit, në intervale kohore për të cilat dakordohen.

Kërkesat nga mekanizmat e tjerë të aderimit në BE

Në kuadër të nënkomiteteve të stabilizim-asociimit nga Kuvendi kërkohet të sigurojë emërimin e anëtarëve të bordeve të institucioneve të pavarura të cilat janë kompetencë e Kuvendit. Kjo duhet të kryhet duke u bazuar në parim të meritokracisë dhe profesionalizmit duke shmangur politizimin për këto emërimë. Kuvendi, bazuar në Memorandumin e bashkëpunimit me Mbretërinë e Bashkuar, do të angazhohet që të sigurojë emërimin e anëtarëve të bordeve të institucioneve të pavarura të cilat janë në kompetencë të Kuvendit përmes një procesi transparent dhe meritator. Ky prioritet vazhdon të mbetet ndër më të rëndësishmit për Qeverinë e Kosovës, prandaj reflektohet në të gjitha dokumentet kryesore planifikuese të Qeverisë, duke përfshirë planin e veprimit për ERA 2021-2023 si dhe PKZMSA 2021 ndër të tjera.

Me qëllim të adresimit të kërkesave nga Raporti i Vendit për vitin 2020, Kuvendi i Republikës së Kosovës do të vazhdojë të fuqizojë ushtrimin e funksionit mbikëqyrës ndaj ekzekutivit dhe komisionet parlamentare do të vazhdojnë të ushtrojnë rolin mbikëqyrës parlamentar dhe të rrisin bashkëpunimin ndërmjet vete. Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, që përgatit rekomandimet të cilat i miraton Kuvendi do të mbajë më shumë dëgjime të ministrave. Roli i mbikëqyrjes parlamentare të Forcave të Sigurisë së Kosovës dhe Agjencisë së Inteligjencës së Kosovës duhet të rritet. Për më tepër, administrata e Kuvendit do të krijojë ekspertizë të specializuar për t'i dhënë mbështetje më efektive deputetëve dhe komisioneve të Kuvendit.

Gjithashtu, si kërkesë e dalë edhe nga *Raporti i KE-së për Kosovën – 2020*, Kuvendi dhe Qeveria duhet të zbatojnë rekomandimet e vlerësimit të agjencive të pavarura në mënyrë që të racionalizojnë numrin e agjencive që i raportojnë Kuvendit.

Sa i përket kërkesës që administrata e Kuvendit të krijojë ekspertizë të specializuar për t'i dhënë mbështetje më efektive deputetëve dhe komisioneve të Kuvendit, tashmë Drejtoria për Çështje Ligjore dhe Procedurale ka rekrutuar stafin në pajtim me Rregulloren për Përgjegjësitë dhe Organizimin e Administratës së Kuvendit. Në këtë drejtim, Kuvendi do të forcojë procedurën legislative në mënyrë që të sigurojë ekspertizë ndër-sektoriale dhe përputhshmëri me *acquis*.

Si kërkesë është theksuar edhe nevoja për të siguruar një shumicë stabile në Kuvend në mënyrë që të evitohen vonesat në vendimmarrje.

Gjendja aktuale

Korniza legislative

Sistemi politik i Kosovës është i bazuar në parimet e demokracisë parlamentare. Kuvendi i Kosovës është institucion ligjvënës dhe zgjedhjet drejtpërdrejt nga populli për një mandat katër vjeçar. Kuvendi i Kosovës është organi ligjvënës dhe fushë-veprimtarinë e vet e ushtron në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Rregullores së Kuvendit të Kosovës.

Përbërja dhe struktura e Kuvendit përcaktohet me kapitullin e IV të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Neni 64 i Kushtetutës përcakton strukturën e Kuvendit, ndërsa paragrafi 1 i nenit 64 përcakton, si vijon; *“Kuvendi ka njëqind e njëzet (120) deputetë të zgjedhur me votim të fshehtë bazuar në listat e hapura. Vendet në Kuvend ndahen midis të gjitha partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, në përpjesëtim me numrin e votave të vlefshme, të fituara prej tyre, në zgjedhjet për Kuvendin.”*

Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës përcakton organizimin dhe funksionimin e Kuvendit, organeve të trupave të punës së tij, si dhe të drejtat dhe detyrat e deputetëve.

Komisionet parlamentare pasqyrojnë përbërjen politike në Kuvend. Komisionet kanë kryetarin dhe dy zëvendëskryetarë që i përkasin grupeve të ndryshme parlamentare, ku së paku një zëvendëskryetar është nga radhët e komunitetit tjetër nga ai i kryetarit.

Një nga rolet kyçe të Kuvendit, përveç përafrimit të legjislacionit vendor me *acquis*, është shqyrtimi dhe verifikimi i këtij përafrimi. Struktura përgjegjëse për harmonizimin e legjislacionit me *acquis* përbëhet nga Drejtoria për Shërbime Juridike dhe Përafrim të Legjislacionit dhe Komisioni për Integrim Evropian, i cili shqyrton harmonizimin me *acquis* të çdo ligji që miraton Kuvendi. Drejtoria dhe Komisioni shqyrtojnë jo vetëm tekstin e projektligjeve, por edhe amendamentet e bëra nga komisionet funksionale, apo nga deputetët, duke siguruar pajtueshmërinë e tyre me aktet juridike të BE-së.

Kosova ka adoptuar vullnetarisht Rezolutën nr. 06-R-001, për Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm (SDG) dhe gjithashtu për krijimin e Këshillit për Zhvillim të Qëndrueshëm. Agjenda 2030 e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 ofrojnë kornizën kryesore për aktivitetet e Këshillit. Këshilli synon të bashkojë parlamentarët dhe përfaqësuesit e të tjerë institucionalë, organizatat ndërkombëtare dhe organizatat e shoqërisë civile, për t'u koordinuar për një veprim të përbashkët në

zbatimin dhe monitorimin e SDG, dhe përbehet nga deputetë, administrata e Kuvendit, organizata të shoqërisë civile, ZKM, ASK dhe organizata ndërkombëtare.

Në kuadër të administratës, Drejtoria për Standardizim, Përafrim dhe Harmonizim ligjor bën verifikimin e opinioneve të ZKM-së për përafrimin e projektligjeve me acquis të BE-së, si dhe mbikëqyrjen e përafrimit të legjislacionit me të dhe me standardet ndërkombëtare të aplikueshme në Kosovë për gjitha projektligjet që i propozohen Kuvendit për shqyrtim. Më tej, Drejtoria për Protokoll dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare, konkretisht Njësia për Marrëdhënie Ndërkombëtare, është e angazhuar në mbledhjet e Komisionit Parlamentar të Stabilizim-Asociimit BE – Kosovë, konkretisht në përpilimin e temave të diskutimit, si dhe në rezolutat e nxjerra nga takimet e përbashkëta si dhe mbarëvajtjen e aktivitetit.

Me qëllim të përmirësimit të mbikëqyrjes parlamentare ndaj ekzekutivit sa u përket çështjeve buxhetore dhe financiare, në korrik 2019 është funksionalizuar Njësia për Analiza Buxhetore dhe Financiare në kuadër të Drejtorisë për Hulumtime, Bibliotekë dhe Arkiv. Kjo njësi përgatitë raporte dhe analiza për: KASH-in, projekt-buxhetin e shtetit, raportet periodike dhe vjetore të shpenzimit të buxhetit, analizon raportet e Përgjithshëm të Auditimit dhe njofton komisionet parlamentare për fushat që mbulojnë, si dhe përgatitë analiza krahasimtare në mes vitit aktual dhe viteve të kaluara buxhetore për institucionet dhe agjencitë, bazuar në të dhënat kryesore.

Njësia për Marrëdhënie Ndërkombëtare gjithashtu ka asistuar dhe në konceptimin e tezave të diskutimit për deputetët si dhe është përkujdesur edhe për detaje tjera për mbarëvajtjen e takimit.

Korniza e politikave

Kuvendi aktivitetin e vet si organ legjislativ dhe mbikëqyrës e ushtron bazuar në këto dokumente:

- Programin Legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës;
- Planet e Punës së Komisioneve Parlamentare;
- Programin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së.

Dinamika e programit të punës realizohet në dy (2) pjesë: Sesioni pranveror dhe Sesioni vjeshtor, që përfshin punën e Kryesisë së Kuvendit, të komisioneve parlamentare dhe të seancës plenare. Kuvendi i Republikës së Kosovës, me qëllim të ngritjes së kapaciteteve profesionale të administratës së saj, rregullisht mban trajnime të vazhdueshme, varësisht prej nevoja të administratës.

Korniza institucionale

Për funksionimin e tij Kuvendi zgjedh nga radhët e veta Kryesinë (Kryetarin dhe Nënkryetarët), dhe emëron Komisionet parlamentare të përhershme dhe funksionale, si dhe Komisionet parlamentare *ad hoc*. Funksionimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës përcaktohet me nenin 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Ndër funksionet kryesore të Kuvendit është funksioni ligjvënës, ndërsa krahas këtij funksioni, Kuvendi ushtron edhe funksionin mbikëqyrës. Me qëllim të mbajtjes në përgjegjësi, Kuvendi mbikëqyr punën e institucioneve dhe organeve të cilat zgjedhën nga Kuvendi. Përveç kësaj, Kuvendi, kryesisht përmes komisioneve parlamentare, mbikëqyr edhe zbatimin e ligjeve duke rekomanduar marrjen e masave në rast të mos zbatimit apo zbatimit jo adekuat të ligjeve të mbikëqyrura.

Kuvendi i Republikës së Kosovës ka gjithsej 120 deputetë, përfshirë vendet e garantuara për komunitetet jo-shumicë në Republikën e Kosovës. Në kuadër të përgjegjësisë kushtetuese që ka Kuvendi, janë edhe zgjedhja e Qeverisë, Presidentit, dhe Institucioneve të Pavarura. Institucionet e pavarura të cilat zgjedhën nga Kuvendi i Republikës së Kosovës si dhe ato të propozuara nga Qeveria dhe të zgjedhura nga Kuvendi, raportojnë ashtu siç është e paraparë me legjislacionin përkatës në fuqi.

Sa i përket koordinimit të administratës së Kuvendit me Qeverinë, komunikimi bëhet në nivel drejtorësh. Njësia për Propozime dhe Parashtresa koordinohet me zyrtarin ndërlidhës të Qeverisë për procedimin e projektligjeve, raporteve, propozimeve për emërimet anëtarësh të bordeve dhe çështje të tjera. Përmes kësaj njësie Kuvendi gjithashtu i procedon Qeverisë dhe institucioneve të tjera vendime, shkresa, pyetje parlamentare, kërkesa për interpelanca, etj. Ajo gjithashtu ia dërgon Zyrës së Presidentit ligjet e miratuara nga Kuvendi për dekretim dhe Zyrës së Gazetës Zyrtare për publikim në Gazetën Zyrtare. Qeveria e

Republikës së Kosovës ka krijuar një mekanizëm dhe sistem të konsoliduar të koordinimit të punës me Kuvendin e Kosovës.

Kuvendi në mënyrë të rregullt shqyrton raportet e komisioneve parlamentare mbi zbatimin e ligjeve dhe miraton rekomandimet për përmirësimin e zbatimit të ligjeve të monitoruara.

Në çdo fillim legjislature, Kuvendi i përcjellë ftesën për regjistrim dhe akreditim përmes bazës së të dhënave të shoqërisë civile të gjitha OJQ-ve.

Kuvendi ka institucionalizuar partneritetin me shoqërinë civile përmes përgjegjësive të përbashkëta në çdo hap të procesit politik dhe vendimmarrës në hartimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve dhe politikave duke përfillur Deklaratën për Partneritet mes Kuvendit dhe Shoqërisë Civile. Megjithatë, sipas OShC-ve që merren me kornizën e bashkëpunimit të institucionalizuar ndërmjet Kuvendit dhe shoqërisë civile, ky bashkëpunim mbetet i kufizuar, pasi që shumë OShC kanë deklaruar se kanë kontakte shumë të kufizuara me Kuvendin. Prandaj kërkohet përkushtim më i madh për bashkëpunim formal, të strukturuar, dhe të bazuar në kritere obligative në mes të Kuvendit dhe shoqërisë civile; si dhe që t'i mundësohet shoqërisë civile komunikim transparent dhe pjesëmarrje të mirëfilltë e përmbajtësore, përtej aspekteve protokollare.

Bazuar në parimet e Strategjisë së Kuvendit për informim dhe marrëdhënie me publikun, Kryesia e tij, me vendim, ka themeluar Forumin për Transparencën Parlamentare, i përberë nga deputetë, përfaqësues të administratës dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Ai është i thirrur që të avancojë dhe sigurojë angazhimin më të madh qytetar duke promovuar kulturën parlamentare përmes informatave, qasjes në informata dhe në punën e Parlamentit si dhe duke fuqizuar qytetarët në procesin legjislativ dhe rritjen e llogaridhënies.

Kryesia e Kuvendit ka miratuar Strategjinë për Informim dhe Komunikim, me theks të veçantë në komunikimin e procesit të integritit evropian. Në këtë strategji, miratuar më 2019, Kuvendi ka shtuar edhe një kapitull të ri që i kushtohet procesit të komunikimit për integritet evropian. Gjithashtu, grupi punues ka finalizuar Vizionin e Kuvendit për Teknologji Informative, Rregulloren për shërbimet e IT-së, Doracakun për deputetët dhe të punësuarit për shërbimet e teknologjisë sipas standardeve dhe Strategjinë për teknologji informative sipas standardeve të IPU-së 2020-2025.

Administrata e Kuvendit, nën autoritetin e Sekretarit të Përgjithshëm, ofron shërbime profesionale, teknike, administrative si dhe shërbime të tjera mbështetëse të nevojshme për Kuvendin dhe organet e tij.

Objektivat prioritarë afatmesme:

- Miratimi i Rregullores së re të Kuvendit;
- Ngritja e kapaciteteve ligjvënëse të Kuvendit, sidomos të Drejtorisë për Çështje Ligjore dhe Procedurale;
- Përmirësimi i mbikëqyrjes së ekzekutivit, përfshirë sektorin e sigurisë, përmes shqyrtimit të legjislacionit dhe monitorimit të zbatimit të politikave dhe ligjeve;
- Organet përgjegjëse të Kuvendit do të sigurojnë mbikëqyrje të fortë të shpenzimeve buxhetore të parlamentit gjatë vitit financiar, përfshirë analizën, zbatimin dhe monitorimin e buxhetimit të përgjeshëm gjinor;
- Theks i veçantë do t'i kushtohet Komisionit Parlamentar për Integritet Evropian dhe Drejtorisë për Protokoll dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare, marrë parasysh rolin e tyre në procesin e integritit evropian.

Kuvendi do të zhvillojë kapacitetet profesionale të administratës së saj përmes bashkëpunimit me parlamentet e vendeve tjera, përmes prioritetëve të dala nga Strategjia për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Marrëdhënie ndër-parlamentare.

Reforma e sistemit zgjedhor

Ndër prioritetet kryesore të Kuvendit të Republikës së Kosovës mbetet dhe ndryshimi i legjislacionit përkatës që mundëson reformën e mirëfilltë zgjedhore, përkitazi me standardet e pranuar evropiane. Kjo do të sigurojë adresimin efektiv të dobësive të identifikuara ndër vite të cilat vazhdojnë të kenë impakt negativ gjatë gjithë ciklit zgjedhor. Shumë nga rekomandimet e bëra pas misionëve vëzhgues të zgjedhjeve

të BE-së më 2014, 2017 dhe 2019 ende nuk janë adresuar. E në anën tjetër, KQZ pas pranimit të secilit raport të misioneve vëzhguese të zgjedhjeve të BE-së harton planin e vet të veprimit për adresim të rekomandimeve që nuk kërkojnë ndryshime të ligjeve.

Korniza e rishikuar ligjore për financimin e partive politike dhe fushatave duhet të jetë në përputhje me rekomandimet e Komisionit të Venecias. Gjithashtu, KQZ dhe veçanërisht Zyra për Regjistrim dhe Certifikim të Partive Politike do të rrisë kapacitetet në mënyrë që të sigurojë zbatimin efektiv të rregullave për financimi të partive dhe fushatave politike. Kjo synohet të arrihet në një periudhë afatmesme përmes adresimit të rekomandimeve të Komisionit të Venedikut dhe të konkretizohet përmes arritjes së konsensusit të partive politike që përbëjnë Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Komisioni përkatës parlamentar që do të angazhohet për reformë zgjedhore pritet të adresojë aspektet kyçe të procesit zgjedhor në mënyrë që këto elemente të detajohen në ligje dhe të shërbejnë si mënyrë e ngritjes së sigurisë ligjore, si dhe ngritjes së besimit në proceset zgjedhore përkitazi me standardet dhe praktikat më demokratike evropiane. Përveç rritjes së kontrollit financiar të subjekteve politike, aspektet në vazhdim duhet të adresohen nga reforma zgjedhore: a) zgjatja e afateve (afatet për: organizim të zgjedhjeve të parakohshme, afatet për paraqitje të ankesave, konfirmimi dhe sfidimi i listës së votuesve, aplikimi për votim jashtë Kosovës), b) adresimi i mangësive të votimit me postë, dhe c) barazia gjinore në listat zgjedhore, duke respektuar përfaqësimin e grave deri në 50%, sipas Ligjit për Barazi Gjinore. Udhëheqësit e grupeve parlamentare të Kuvendit të Kosovës në prill 2019 kanë ndërmarrë një nismë të përbashkët për të përmirësuar dhe forcuar procesin zgjedhor duke krijuar një komision parlamentar *ad hoc*, ku kanë përfshirë ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë si dhe palë të interesuara. Ky komision nuk ka arritur të përfundojë punën e nisur për amendamentimin e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Në kuadër të reformës zgjedhore dhe me qëllim të përmbushjes së obligimeve të cilat dalin nga raportet e BE-së për Kosovën, Kosova duhet të adresojë rekomandimet e Misionit Vëzhgues të BE-së të vitit 2014, 2017 dhe 2019. Ajo gjithashtu duhet të plotësojë-ndryshojë Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Ligjin për Financimin e Partive Politike, duke siguruar konsistencë të përmbajtjes ndërmjet tyre. Konkretisht, Kuvendi i Republikës së Kosovës do të angazhohet që të themelojë Komisionin *ad hoc* për Reformë Zgjedhore, të cilit do t'i sigurojë buxhet për të përmbushur obligimet të cilat dalin nga ky proces. Ndërsa, më qëllim të zbatimit të Ligjit për Financimin e Partive Politike, Kuvendi do të angazhohet që rishpërndarja e funksioneve të kontrollit financiar të subjekteve politike të përcillet me: a) fuqizimin e Zyrës për Regjistrim dhe Certifikim të Partive Politike, e cila zyrë do të gëzojë një shkallë më të lartë të pavarësisë se Zyra e tanishme⁴; apo b) krijimin e një autoriteti të ri të pavarur në kuadër të ndonjë institucioni tjetër të pavarur.

Gjendja aktuale

Korniza legjislativë

Reforma zgjedhore në Republikë e Kosovës është e rregulluar sipas këtyre ligjeve:

- Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme;
- Ligjit për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës i plotësuar dhe ndryshuar në nëntor 2010;
- Ligjit nr. 03/L-174 mbi Financimin e Subjekteve Politike.

Kushtetuta dhe Ligji nr. 03/L-256 për plotësim-ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës rregullojnë sistemin zgjedhor në Kosovë. Sipas Kushtetutës dhe Ligjit, Kosova konsiderohet një zonë zgjedhore me shumë kandidatë. Duke ushtruar të drejtën e tij/saj të votës, votuesi voton për një (1) subjekt politik të certifikuar dhe mund të votojë për deri në pesë (5) kandidatë nga lista e kandidatëve të këtij subjekti politik, ndërsa nëse voton për më tepër se pesë (5) kandidatë, atëherë numërohet vetëm vota e hedhur për subjektin politik. Kuvendi i Republikës së Kosovës ka njëqind e njëzet (120) deputetë të zgjedhur me votim të fshehtë bazuar në listat e hapura. Vendet në Kuvend ndahen midis të gjitha partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, në

⁴ Perifrazim i opinionit në Komisionit të Venedikut, pika 26, faqe 9, [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2018\)016-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2018)016-e).

për pjesëtim me numrin e votave të vlefshme të fituara prej tyre në zgjedhjet për Kuvendin. Në kuadër të kësaj ndarjeje, njëzet (20) prej njëqind e njëzet (120) vendeve janë të garantuara për përfaqësimin e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë. Legjislacioni zgjedhor në Kosovë gjithashtu garanton barazinë gjinore në sistemin zgjedhor, në bazë të nenit 7.2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe neneve 6, 2 dhe 4.4. të Ligjit për Barazi Gjinore.

Ky legjislacion ofron bazë të mjaftueshme për zgjedhje demokratike në pajtim me instrumentet ndërkombëtare për të cilat Kosova është zotuar në Kushtetutën e saj. Korniza ligjore që ka rregulluar zgjedhjet e kaluara parlamentare dhe lokale edhe përkundër të metave, megjithatë ka siguruar një funksionim dhe ecuri normale të rrjedhjes së procesit të gjithmbarshëm zgjedhor në zgjedhjet parlamentare dhe ato lokale të 2017 si dhe zgjedhjet parlamentare të 2019. Zgjedhjet në përgjithësi kanë kaluar në atmosferë të qetë dhe pa ndonjë incident të madh. Megjithatë, zgjedhjet në veri të vendit janë karakterizuar me presion ndaj kandidatëve jashtë Listës Serbe. Sfidë ka qenë edhe procesi i numërimit të votave dhe menaxhimi i ankesave.

Në kuadër të reformës zgjedhore dhe me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dala nga raportet e BE-së për Kosovën sa i përket financimit të partive politike dhe fushatave, Qeveria ka miratuar projektligjin e plotësuar-ndryshuar për financimin e subjekteve politike. Më 30 shtator 2020 ky ligj është miratuar në parim nga Kuvendi, derisa pritet që të marr edhe miratimin formal në ndërkohë. Ky projektligj ka për qëllim amendamentimin e Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-058 dhe Ligjin nr. 04/L-122⁵, si dhe Ligjin për Zgjedhje të Përgjithshme, me fokus te veçantë kontrollin financiar, publikimin e raportit vjetor financiar të vitit paraprak dhe raportin e deklarimit financiar të fushatës së zgjedhjeve paraprake, dispozitat ndëshkuese, si dhe dispozita te tjera qe ndërliiden me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Përkundër përpjekjeve për të reformuar sistemin zgjedhor në Kosovë para zgjedhjeve lokale të vitit 2017, para zgjedhjeve parlamentare të 11 qershorit 2017 dhe atyre të 6 tetorit 2019, apo me iniciativën e Kuvendit të Kosovës, në prill 2019, reforma nuk ka ndodhur. Një varg të metash kanë përcjellë këto procese zgjedhore të cilat janë identifikuar edhe nga Raporti i KE-së për Kosovën – 2020, si dhe Raporti Final i Misionit të BE-së për Vëzhgimin e Zgjedhjeve. Megjithatë, brengë serioze paraqesin një sërë frikësimesh në radhët e komunitetit serb, me ç'rast shënjestroheshin posaçërisht kandidatët që nuk i përkasin partisë Lista Serbe. Një numër dobësish afatgjatë, sidomos financimi i partive politike, mungesa e raportimit për financimin e kandidatëve të ndara sipas gjinisë për fushata elektorale, pjesëmarrja e barabartë e grave në listat zgjedhore, mekanizmat e kontesteve zgjedhore, listat e pasakta të votuesve, si dhe sistemi në masë të madhe i mangët i votimit për qytetarët e Kosovës jashtë vendit, mbeten për t'u adresuar. Këto sfida duhen trajtuar si çështje prioritare, të udhëzuara nga rekomandimet e misioneve evropiane të vëzhgimit të zgjedhjeve.

Reforma e sistemit zgjedhor duhet të shqyrtojë edhe mospërputhjen e Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Ligjit nr. 03/L072 për Zgjedhje Lokale me Ligjin nr. 05/L-020 mbi Barazinë Gjinore. Aktualisht ligjet për zgjedhje parashohin një kuotë gjinore prej së paku 30% përfaqësim në lista të partive politike, ndërsa Ligji mbi Barazinë Gjinore parasheh si në vijim: "Përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore dhe institucionet e tjera publike arrihet kur sigurohet përfaqësim minimal prej pesëdhjetë për qind (50%) për secilën gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse." Partitë politike obligohen që përmes akteve të tyre të brendshme të zbatojnë masat për promovimin e pjesëmarrjes së barabartë të grave dhe burrave në organet dhe trupat e partive, në pajtim me dispozitat e nenit 6 të këtij ligji. Edhe këto mospërputhje do të duhej të adresoheshin përmes reformës së pritur zgjedhore.

Objektivat prioritare afatmesme:

- Zbatimi i rekomandimeve të Misionit të BE-së për Vëzhgimin e Zgjedhjeve;
- Miratimi dhe zbatimi i legjislacionit të ri rreth financimit të subjekteve politike, në përputhje me opinionin e Komisionit të Venedikut;

⁵ https://eeas.europa.eu/headquarters/headquarters-homepage/64291/statement-head-eu-officeceusr-and-heads-eu-missions-kosovo-draft-law-financing-political_en.

- Miratimi i Ligjit për Zgjedhje;
- Themelimi i Komitetit ad-hoc dhe Grupit Këshillues në kuadër të Reformës Zgjedhore;
- Ndërlidhja e sistemit të adresave me sistemin e regjistrimit qendror të gjendjes civile në kuadër të saktësimit të listës së votuesve.

1.1.2. Administrata publike

Administrata publike është një ndërlidhje në mes të qeverisë, shoqërisë civile, sektorit privat dhe qytetarëve, që zbaton politikat publike të ndërmarra nga qeveria duke rritur kështu kohezionin social dhe besimin midis shtetit dhe qytetarëve. Pra, administratën publike e përbejnë njësitë institucionale qeveritare që rregullojnë funksionimin e shoqërisë. Administrata publike efektive është vendimtare për zhvillimin e vendit duke zbatuar procedurat administrative transparente, të qarta dhe të thjeshta dhe ofron shërbime të fokusuara tek qytetarët. Administrata publike gjithashtu ndihmon bizneset gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, duke u lehtësuar procedurat, dhe heqjen e barrierave burokratike.

Kërkesat e MSA-së

Në kuadër të kriterëve për fushën e administratës publike që duhet plotësuar nga qeveria dhe institucionet relevante të Republikës së Kosovës në pajtim me nenin 120 të MSA-së, mbetet konsolidimi i plotë i kornizës ligjore (miratimi i legjislacionit sekondar pas miratimit të pakos ligjore për RAP nga Kuvendi) si dhe zbatimi i politikave dhe legjislacionit në tërësi.

Pjesë e obligimeve të MSA-së, sipas preambulës (pikës 4), zhvillimi i shoqërisë civile dhe demokratizimi janë elemente mbi të cilat palët angazhohen për të kontribuar në stabilizimin politik, ekonomik dhe institucional të Kosovës. Në këtë kontekst, ndër parimet e përgjithshme të MSA-së (neni 3) në fushën e administratës publike është respekti për parimet demokratike si bazë për formësimin e politikave. Kjo kërkon bashkëpunimin ndër-sektorial ndërmjet Qeverisë dhe shoqërisë civile, ku edhe bëhet mundësi i gjithëpërfshirjes në procesin e hartimit të politikave nëpërmjet procesit të konsultimit publik.

Kërkesat nga mekanizmat e tjerë të aderimit në BE

Në mbledhjen e katërt të Komitetit të Stabilizim-Asociimit, të tetorit 2020, KE theksoi se zbatimi i reformës së administratës publike duhet të jetë një përpjekje e tërë Qeverisë, dhe theksoi shqetësimet për emërimet politike në administratën publike. Prandaj, Kosova do të sigurojë që të gjitha rekrutimet, veçanërisht për postet e larta të menaxhmentit, të respektojnë parimet e meritës, transparencës dhe përfaqësimit të drejtë e të barabartë. KE ka bërë thirrje që të revitalizohet procesi në përgjithësi i reformave, si në fushën e sundimit të ligjit ashtu edhe në reformë ekonomike e në administratë publike.

Përgjegjësitë menaxheriale do të zbatohen në të gjithë Qeverinë, në mënyrë të koordinuar nga ish-Ministria e Administratës Publike (tash MPB), Ministria e Financave Zyra e Kryeministrit. KE gjithashtu i bëri thirrje Kosovës që të zbatojë Planin e Veprimit të Racionalizimit dhe Vendosjes së Vijave të Qarta të Llogaridhënies për Agjencitë të cilat funksionojnë në Kuvendin e Kosovës në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe transparente. Kjo është planifikuar të ndodhë në një periudhë afatmesme, duke nisur nga viti 2021 me valën e parë të racionalizimit.

Sa u përket gjetjeve të *Raportit të KE-së për Kosovën – 2020*, ndër sfidat kryesore që janë identifikuar janë: ndikimi i politik në rekrutimin e pozitave të larta drejtuese në shërbimin civil dhe rekrutimet jo të bazuara në merita; vonesat në miratimin e ligjeve të veçanta në përputhje me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA); vlerësimi jo i drejtë i performancës, i cili vazhdon të ketë pak ndikim në zhvillimin e karrierës për nëpunësit civilë.

Sa u përket rekomandimeve, duhet të konsolidohet korniza ligjore si dhe të miratohen aktet nënligjore të pakos ligjore (përfshirë ndryshimin e Ligjit për Zyrtarët Publikë në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese) dhe të fillohet sa më parë zbatimi i tyre; duhet rritur llogaridhënien në institucione, në veçanti tek niveli menaxherial; duhet harmonizuar legjislacioni me LPPA; duhet të respektohen parimet gjatë rekrutimit dhe heqja e ndikimit të politikës në administratë; duhet krijuar njësi të reja për menaxhimin e

burimeve njerëzore sipas pakos ligjore dhe duhet ofruar shërbime më të mira për qytetarët përmes digjitalizimit të shërbimeve (Portali e-Kosova). Gjithashtu duhet rritur kapacitetin për të mbledhur, kontrolluar dhe ruajtur të dhënat. Në këtë drejtim është paraparë që të krijohet platforma online për monitorim të Strategjisë së Re për RAP, gjë që reflektohet edhe në dokumentet dhe planet e punës së Qeverisë, si një ndër prioritetet kyçe, si: PKZMSA 2021-2025, PPQ dhe ERA II, që do të ndikonte në forcimin dhe përgatitjen edhe më të mirë të pikave të kontaktit, profesionalizmin e tyre, dhe rritjen e cilësisë. Gjithashtu është me rëndësi që prioritetet strategjike dhe buxhetimi qeveritar të ndërliken më mirë në mënyrë që të përmirësohet zbatimi dhe monitorimi i kornizës strategjike për RAP. Për më tepër, duhet të përmirësohet sistemi për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe të sigurohet interoperabilitet me sistemin e pagës.

Sipas *Konkluzioneve të takimit të GVRAP të vitit 2020*, planifikimi në fushën e administratës publike duhet të jetë më strategjik dhe i ndërlidhur me prioritetet e Qeverisë, strategjitë sektoriale, kornizën afatmesme të shpenzimeve dhe buxhetin në dispozicion. Kriteri i rëndësishëm është përfundimi i procesit të klasifikimit të vendeve të punës. Për të përfunduar këtë proces me sukses, Kuvendi i Kosovës duhet të miratojë Ligjin e ri për Paga, në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Kështu, gjatë vitit 2021 është planifikuar që Ligji i ri për Paga të rishkruhet në bashkëpunim me Komisionin Evropian, SIGMA-n dhe donatorët tjerë relevant. Në këtë mënyrë do të mundësohej konsolidimi eventual i kornizës ligjore për RAP.

Në mars 2017 Kuvendi dhe Qeveria kanë nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi për racionalizimin e agjencive shtetërore dhe grupi punues i krijuar nga MAP (tash MPB, sipas nenit 19 (6.2) të Rregullores së Punës së Qeverisë nr. 09/2011 (GZ, nr. 15/2011, dt. 12 shtator 2011) dhe Rregullores (QRK) nr. 07/2020 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive) ka përfunduar Koncept Dokumentin për Valën e Parë të Racionalizimit dhe Vendosjes së Vijave të Qarta të Llogaridhënës për Agjencitë të cilat funksionojnë në Kuvendin e Kosovës, i cili është miratuar nga Qeveria më 9 tetor 2018. Projektligji për valën e parë të racionalizimit është planifikuar të nënshkruhet gjatë pjesës së parë të vitit 2021, edhe pse duke gjykuar situatën aktuale të pandemisë Covid-19, koha e zbatimit të masave të parapara në PKZMSA duhet të konsiderohet sërish.

Sa u përket shërbimeve publike dhe menaxhimit të burimeve njerëzore, autoritetet janë zotuar për bërjen e ndryshimeve të nevojshme legislative në Ligjin për Zyrtarët Publikë, në harmoni me vendimin e Gjykatës Kushtetuese, finalizimin dhe miratimin e legjislacionit të mbetur sekondar dhe fillimin e zbatimit të ligjit. Autoritetet do ta finalizojnë krijimin e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë dhe do t'i dërgojnë Komisionit Evropian planin e plotësimit me staf dhe një përmbledhje të organizimit të brendshëm të Departamentit. Do të ndërmerren masa për të përmirësuar më tej procesin e emërimeve dhe shkarkimeve të zyrtarëve të lartë publikë, siç kërkohet me legjislacionin përkatës dhe në harmoni me parimet e meritës dhe transparencës. Gjithashtu do të monitorohet nga afër shkallëzimi i kontratave të përkohshme të lidhura më parë dhe zbatimin e dispozitave të Ligjit për Zyrtarët Publikë në këtë drejtim. Për më shumë, autoritetet do të marrin masa për të përmirësuar më tej mekanizmat për mbledhjen e të dhënave në lidhje me menaxhimin e burimeve njerëzore.

Disa nga obligimet e tjera të dala nga takimi i GV RAP 2020 lidhen me miratimin dhe zbatimin e programit për zvogëlimin e barrës administrative, të koordinuar nga Zyra e Kryeministrit, me fokus në masa konkrete për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve në planin afatshkurtër dhe afatgjatë, në veçanti nëpërmjet rritjes së digjitalizimit dhe thjeshtësimit, bashkimit e heqjes së licencave e lejeve. Nëpërmjet këtij ushtrimi, autoritetet do t'i kushtojnë vëmendje të veçantë masave të nevojshme për shpejtimin e harmonizimit të ligjeve të veçanta kontradiktore me Ligjin për Procedura të Përgjithshme Administrative. Përgjegjësia për harmonizimin e ligjeve, akteve nënligjore dhe udhëzimeve administrative me Ligjin për Procedura të Përgjithshme Administrative i përket ministrisë përkatëse të linjës. Qeveria do të emërojë koordinatoren qendror për procesin e harmonizimit dhe do të përcaktojë një afat detyrues për procesin për të gjitha ministrinë.

Kosova në kuadër të RAP do të zhvillojë një dokument gjithëpërfshirës të politikës së kontrollit financiar publik, me fokus në përcaktimin dhe zbatimin e përgjegjesisë menaxheriale dhe kontrollin e brendshëm financiar publik në sektorin publik. Qeveria duhet të sigurojë ndërlidhje më të mirë ndërmjet KASH 2021-2023 dhe ekzekutimit të buxhetit dhe si rrjedhojë të ketë planifikim më real të projekteve investuese. Në këtë drejtim, autoritetet gjithashtu janë zotuar për të siguruar harmonizimin e ngushtë me Strategjinë e re Kombëtare për Zhvillim me reformat e BE-së.

Sipas konkluzioneve të takimit të GVRAP të vitit 2021, institucionet e Qeverisë së Kosovës do të fokusohen në kompletimin e kornizës ligjore në këtë fushë duke miratuar Ligjin për Zyrtarët Publik dhe duke hartuar Ligjin e ri për Paga në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese (GJK). Po ashtu, aktet nënligjore për zbatim të 3 ligjeve bazë për RAP do të miratohen duke marrë për bazë të gjeturat e vendimit të GJK. Prioritet i veçantë në këtë fushë po ashtu i është dhënë kompletimit të kornizës ligjore për racionalizimit të agjencive dhe institucioneve të pavarura. Vetëm gjatë vitit 2021 planifikohet të miratohen 2 ligje për 2 valët respektive për racionalizim të agjencive. Derisa Ligjet për valën 3 dhe 4 të këtij procesi janë paraparë të kryhen gjatë vitit 2022-3. Korniza strategjike në RAP do të avancohet duke bashkuar në këtë mënyrë 3 strategji të kësaj fushe në një Strategji sektoriale për Reformë të Administratës Publike e cila do të miratohet në fund të vitit 2021 dhe do të shërbej si udhërrëfyes për 5 vitet e ardhshme.

E gjetur tjetër në kuadër të konkluzioneve është reduktimi i barrës administrative, me ç'rast vetëm gjatë vitit 2021 pritet të harmonizohen me LPPA të paktën 20% të projektligjeve ekzistuese, draft ligjeve, akteve nënligjore dhe udhëzimeve administrative që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe janë pjesë e programit legjislativ, derisa të paktën 8% e lejeve dhe licencave për operatorë ekonomik do të bashkohen apo shfuqizohen. Për fund, autoritetet qeveritare kanë vendosur si prioritet të lartë sistemin për menaxhimin e burimeve njerëzore, me ç'rast avancimi në sistem përmes krijimit të moduleve të reja dhe integritimit të tyre në sistem është duke u bërë duke pasur si objektiv më të gjerë përmirësimin dhe rritjen e efikasitetit në procedurat e rekrutimit në shërbim civil, në të gjitha nivelet dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Si obligime të tjera që kanë dalë në takimit e majit të GVRAP, dhe në mënyrë që të sigurohet zbatim sa më efektiv i reformës së administratës publike dhe të sigurohet që burimet e nevojshme financiare dhe njerëzore të alokohen për këtë rol, do të përmirësohet ndjeshëm zhvillimi profesional i nëpunësve civilë si dhe do të përmirësohet cilësia dhe numri i trajnimeve të siguruara nga IKAP.

Gjendja aktuale

Korniza legjislative

Korniza ligjore në fushën e administratës publike është vendosur, megjithatë ende nuk është kompletuar. Legjislacioni primar i Shërbimit Civil është në përputhje me parimet e BE-së, por mangësitë shfaqen sidomos në rregullimin e procedurave administrative, përgjegjësinë publike, me parimet e barazisë gjinore, procedurat gjyqësore administrative; si dhe llogaridhënien e institucioneve publike.

Ligjet bazike mbi bazën e të cilave funksionon Administrata Publike janë:

- Ligji nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura;
- Ligji nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik. Ky ligj është shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese me aktgjykim të datës 30 qershor 2020. Si rrjedhojë, kthehet në funksion Ligji 03/L-147 i Pagave të Nëpunësve Civilë derisa të hartohet Ligji i ri për Paga në Sektorin Publik;
- Ligji nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik.
- Ligji nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative;
- Ligji nr. 04/L-145 për Organet Qeveritare të Shoqërisë së Informacionit.

Korniza e politikave

Korniza strategjike për reformën e administratës publike është përcaktuar nga Këshillimi Ministror për Reformën e Administratës Publike, duke dhënë udhëzimet e nevojshme për rolet dhe përgjegjësitë e

institucioneve përgjegjëse. Në këtë mënyrë, qasja për reformën e administratës publike është përcaktuar përmes Kornizës Strategjike të Reformës së Administratës publike e përbërë nga tri dokumente të ndara, të përgatitura dhe menaxhuara nga portofolat kryesorë, më një nivel të koordinimit qendror. Në formësimin e qasjes së re të reformës, janë marrë parasysh çështjet kyçe të përcaktuara në strategjinë e zgjerimit të Komisionit Evropian dhe të paraqitura në hollësi nga OECD/SIGMA përmes Parimeve të Administratës Publike. Konkretisht, administrata publike në Republikën e Kosovës është duke u angazhuar që të funksionojë mbi bazën e parimeve dhe fushave kryesore të OECD/SIGMA, siç janë:

- Korniza strategjike e reformës së administratës publike;
- Zhvillimi dhe koordinimi i politikave;
- Shërbimi publik dhe menaxhimi i burimeve njerëzore;
- Llogaridhënia;
- Ofrimi i shërbimeve;
- Menaxhimi i financave publike.

Në përputhshmëri me këto parime, fushat përkatëse janë grupuar në tri "Shtylla të RAP-it", në kuadër të të cilave portofolave kryesore i është dhënë përgjegjësia për zhvillimin e një ose më shumë dokumenteve strategjike. Tri shtyllat e kornizës strategjike për reformën në administratë publike janë:

- Shtylla e parë: Zhvillimi dhe koordinimi i politikave – përgjegjësi e Zyrës së Kryeministrit;
- Shtylla e dytë: Shërbimi civil, burimet njerëzore, llogaridhënia dhe ofrimi i shërbimeve – përgjegjësi e Ministrisë së Punëve të Brendshme; dhe
- Shtylla e tretë: Menaxhimi i financave publike – përgjegjësi e Ministrisë së Financave.

Shtylla e dytë duhet të përfshijë kriterin e ofrimit të shërbimeve sipas parimit të trajtimit të barabartë për gra dhe burra.

Korniza e politikave për shtyllën e parë të reformës së administratës publike përbëhet nga këto dokumente kryesore:

- Korniza Kombëtare për Planifikim dhe Menaxhim Strategjik; dhe
- Strategjia për Planifikim dhe Koordinim të Politikave dhe Rregullim më të Mirë 2021-2026.

Korniza e politikave për shtyllën e dytë të reformës së administratës publike përbëhet nga këto dokumente kryesore:

- Strategjia për Modernizimin e Administratës Publike 2021-2026;
- Strategjia e Qeverisjes Elektronike

Korniza e politikave për shtyllën e tretë të reformës së administratës publike përbëhet nga këto dokumente kryesore:

- Strategjia e Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike;
- Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike.

Përveç këtyre, Qeveria gjithashtu ka miratuar *Strategjinë e re Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023*, me synim përmirësimin e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në hartim dhe zbatim të politikave dhe legjislacionit; ndërtimin e një sistemi të ofrimit të shërbimeve publike nëpërmjet OShC-ve; ndërtimin e një sistemi të bazuar mbi kriteret të përcaktuara për përkrahje financiare për OShC-të; dhe nxitjen e një qasjeje të integruar për zhvillimin e vullnetarizmit.

Korniza institucionale

Në kuadër të ish-Ministrisë për Administratën Publike, tash Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), fusha e administratës publike në aspektin e kornizës institucionale në nivel vendi përbëhet nga Agjencia e Shoqërisë së Informacionit (ASHI) dhe Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP).

Ish-MAP, tash MPB, ka të ndërtuar tani një infrastrukturë të avancuar për të mundësuar ofrimin e shërbimeve elektronike përmes Rrjetit Shtetëror i cili mbulon të gjitha zyrat e administratës qendrore dhe lokale. Kjo infrastrukturë u shërben të gjitha institucioneve të nivelit qendror edhe atij lokal. Arkitektura aktuale e kësaj infrastrukture është një bazë e fuqishme për dhënien e shërbimeve elektronike për qytetarë

si dhe për modernizimin e administratës publike. Modernizimi i mëtejshëm i administratës publike kërkon mirëmbajtje dhe investime të vazhdueshme konform rritjes së shërbimeve elektronike, trendëve të zhvillimeve tekniko-teknologjike dhe rritjen e sigurisë.

Rregullorja nr. 05/2016 mbi *Standardet Minimale për konsultimet Publike* është miratuar në prill 2016 dhe ka filluar së zbatuari nga janar i 2017. Sipas saj, Zyra për Qeverisje të Mirë (ZQM/ZKM) është organi përgjegjës për koordinimin e konsultimeve, të cilat kryhen përmes *Platformës Online për Konsultime me Publikun*. Rregullorja gjithashtu formë e teknika të tjera të konsultimit publik, për të siguruar përfshirjen e grupeve të interesit në politikë-bërje. Ato duhet të jenë të përshtatshme dhe të qasshme për qytetarët dhe qytetarët e Kosovës varësisht prej temës që trajtohet dhe specifikave e ndjeshmërisë. Përveç këtij mekanizmi, nga viti 2018 funksionon edhe mekanizmi konsultues ndërmjet Qeverisë dhe OShC-ve e palëve të tjera të interesuara në kuadër të strukturave të përbashkëta institucionale BE-Kosovë të themeluara me MSA. I rregulluar sipas udhëzuesit përkatës të miratuar nga Ministria e Integritimit Evropian më 2018, ky mekanizëm është forum i përshtatshëm që kontribuon në formësimin e politikë-bërjes dhe zbatimin e MSA-së, dhe si i tillë duhet të shfrytëzohet me mirë nga Qeveria dhe shoqëria civile.

Nga viti 2017, me miratimin e Rregullores MF-nr. 04/2017, Kosova ka ndërtuar një sistem me rregulla të unifikuara për financimin publik të OJQ-ve. Ato përcaktojnë kriteret minimale të ndërlidhura me financimin publik. Për më shumë, Qeveria, më 2 prill 2019, me vendimin nr. 05/96, ka themeluar mekanizmat për bashkëpunim të Qeverisë me shoqërinë civile, konkretisht Këshillin për Bashkëpunim të Qeverisë me Shoqërinë Civile. Ai është mekanizmi kryesor dhe i përhershëm këshillues që koordinon dhe përmirëson të gjithë procesin e bashkëpunimit qeveritar me shoqërinë civile, ku ZQM shërben si Sekretariat. Këshilli bashkë-kryesohet nga Sekretari i Përgjithshëm i ZKM-së dhe Drejtori Ekzekutiv i Platformës CiviKos. Ky këshill përbëhet nga 29 anëtarë: 15 nga OShC dhe 14 nga institucionet.

Mbështetja e donatorëve

Sa i përket donatorëve në fushën e administratës publike, aktualisht ka përkrahje me projekte të cilat janë të fokusuara në ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore në administratë, ofrimin e shërbimeve më të mira për qytetarët, dhe rishikimin funksional të administratës, me theks të veçanët agjencive të pavarura dhe ekzekutive. Këto projekte janë si në vijim:

- *Forcimi i mëtejshëm i aftësive trajnuese të Institutit të Kosovës për Administratë Publike (IKAP), me periudhë zbatimi 2019-2020, përkrahur nga Qeveria Gjermane; IKAP është duke zhvilluar diskutime për zgjatjen e këtij projektit edhe për një vit pasi disa aktivitete janë shtyrë si rezultat i Covid-19;*
- *Mbështetje për Zyrën e Planifikimit Strategjik të Zyrës së Kryeministrit, përkrahur nga BE (IPA); me periudhë përfundimi në maj 2021;*
- *Skema e Profesionistëve të Rinj, për ngritje të kapaciteteve në shërbim civil, përkrahur nga BE (IPA) në bazë vjetore;*
- *Përkrahja për reformë sektoriale në fushën e administratës publike (IPA), me periudhë katërvjeçare zbatimi;*
- *Mbështetja për Zbatimin e Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile. Ky projekt është i financuar në kuadër të IPA II, për Zyrën për Qeverisje të Mirë/Zyrën e Kryeministrit.*

Objektivat prioritarë afatmesme:

- *Krijimi i një shërbim civil apolitik, profesional, meritohet dhe të menaxhuar mire përmes riorganizimit të ministrive dhe organeve vartëse të tyre, finalizimit të procesit të klasifikimit të vendeve të punës, zbatimi të sistemit të ri të pagave dhe gradimeve;*
- *Zbatimi i planit për racionalizimin e agjencive dhe institucioneve të pavarura duke filluar me miratimin e Valës së parë dhe hartimin e Ligjit për Valën e Dytë të Racionalizimit gjatë vitit 2021 dhe duke vazhduar me dy valët e fundit gjatë vitit 2022 dhe 2023.*
- *Reduktimi i barrës administrative përmes harmonizimit me LPPA të ligjeve të veçanta, akteve nënligjore dhe udhëzimeve administrative që përmbajnë procedura të veçanta administrative'*

- Përmirësimi i sistemin për menaxhim të burimeve njerëzore përmes ndërlikohjes së tij me sistemin e pagave, pasi që të finalizohet procesi i klasifikimit të vendeve të punës sipas legjislacionit të ri;
- Ngritja e kapaciteteve të nëpunësve civilë në administratë me grupet jo-shumicë, duke u bazuar në legjislacionin në fuqi, me 10% në nivel qendror (nga 8.75% sa është tani) dhe në proporcion të drejtë me popullsinë në kuadër të komunës relevante të nivelit lokal;
- Përforcimi edhe më tej i administratës përmes zhvillimit të kapaciteteve për planifikim, analizim, zhvillim dhe zbatim të politikave në mënyrë që të krijojë politika substanciale, ekonomikisht efikase dhe financiarit të përbalueshme;
- Kompletimi i kornizës ligjore dhe operative të RAP-it dhe finalizimi i reformave të kostimit do të formojnë bazën për përcaktimin e fushëveprimit e përgjithshëm dhe financiar të përkrahje buxhetore sektoriale;
- Përmirësimi i mëtejshëm i cilësisë së konsultimeve publike, në përputhje me Rregulloren për Standardet Minimale për këtë proces;
- Sigurimi i fondeve të mjaftueshme për Zbatimin e pakos ligjore për RAP;
- Avancimin i qeverisjes elektronike me qëllim të rritjes së efektivitetit të shërbimeve dhe transparencës ndaj publikut. ASH/ish-MAP (tash MPB) ka për qëllim modernizimin dhe ngritjen e cilësisë për ofrimin e shërbimeve elektronike e cila do të ndikojë në ngritjen e transparencës;
- Zhvillimi i portalit shtetëror të shërbimeve elektronike, funksionalizimi i tij dhe fillimi i ofrimit të shërbimeve elektronike për qytetarë, biznese dhe nëpunës publikë nëpërmjet kësaj dritareje të vetme, si dhe integrimi i sa më shumë shërbimeve që ofrojnë institucionet në kuadër të portalit.
- Zgjerimi i Platformës elektronike të Interoperabilitetit (ndërveprimit) dhe përfshirja a sa më shumë sistemeve në kuadër të kësaj platforme.
- Ngritja e transparencës ndaj publikut përmes avancimit të Portalit për hapjen e të dhënave, ku do të publikohen të dhënat nga institucionet e nivelit qendror dhe lokal.

Vetëqeverisja lokale

Baza kushtetuese e vetëqeverisje lokale jepet nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Kapitulli X përcakton se “Njësia themelore e vetëqeverisjes lokale në Kosovë është komuna. Komunat gëzojnë shkallë të lartë të vetëqeverisjes lokale dhe inkurajojnë e sigurojnë pjesëmarrje aktive të të gjithë qytetarëve gra dhe burra në procesin e vendimmarrjes së organeve komunale”.

E drejta e vetëqeverisjes lokale garantohet me kushtetutë dhe rregullohet me ligj. Vetëqeverisja lokale ushtrohet nga organe përfaqësuese të zgjedhura në zgjedhje lokale të përgjithshme, të barabarta, të lira e të drejtpërdrejta, dhe me votim të fshehtë. Republika e Kosovës merr parasysh dhe zbaton Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale, në masën e kërkuar nga vendi nënshkrues. Vetëqeverisja lokale bazohet në parimet e qeverisjes së mirë, barazisë gjinore, transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit në ofrimin e shërbimeve publike, me kujdes të veçantë për nevojat e brengat specifike, përfshirë ato të personave me aftësi të kufizuara si dhe të komuniteteve që nuk janë shumicë dhe pjesëtarëve të tyre.

Sa i përket barazisë gjinore, ndonëse respektimi i parimit të barazisë gjinore në kuadër të vetëqeverisjes lokale është detyrim ligjor, zyrtarët për barazi gjinore në Komuna përballen me vullnetin e pamjaftueshëm politik për t’i përfshirë ata në proceset e politikave, gjë që kontribuon në mungesën e pikëpamjes gjinore në legjislacionin dhe politikat në nivelin lokal. Për më tepër, disa zyrtarë të tillë kanë kapacitete të dobëta të analizës gjinore dhe për procese të tjera të politikave, gjë që i pengon të kryejnë përgjegjësitë e tyre, ndërsa mungesa e kompetencave ekzekutive, fondet e pamjaftueshme dhe agjendat e partive politike gjithashtu minojnë punën e tyre. Këto dhe obligime të tjera janë kërkesa që dalin edhe nga Plani i Veprimit Gjinor i BE-së.

Raporti i KE-së për Kosovën – 2020 thekson se niveli i përfaqësimit të grave në pozita drejtuese në nivelin lokal mbetet çështje që duhet adresuar me prioritet më të lartë, edhe pse ka pasur progres në këtë drejtim. Gjithashtu duhet rritur cilësinë e konsultimeve publike në nivelin lokal. Duhet rritur kapaciteti i burimeve njerëzore dhe financiare që të mundësohet rritja e cilësisë së shërbimeve komunale. Gjithashtu theksohet nevoja për depolitizuar më tej administratën lokale dhe përmirësuar mbikëqyrjen e Kuvendeve Komunale

si dhe mbikëqyrjen e administratës në nivel lokal. Duhet gjithashtu të ulet influenca politike mbi administratën lokale, që veçse konsiderohet e tepruar dhe e dobëson atë.

1.1.3. Avokati i Popullit⁶

Ky kapitull mbulon fushëveprimin e Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP), si institucion i pavarur kushtetues që monitoron, mbron dhe promovon të drejtat dhe liritë e njeriut. Në të përfshihen kriteret e dala në kuadër të procesit integruar të Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian, gjendjen aktuale të përmbushjes së mandatit, sfidave me të cilat përballët IAP dhe planet e prioritetet për të ardhmen.

Kërkesat e MSA-së

Meqë BE u kushton rëndësi të veçantë të drejtave të njeriut, në mënyrë që të garantohet respektimi i tyre ka imponuar disa parakushte, përfshirë kriteret politike të Kopenhagës, të cilat kërkojnë stabilitet të institucioneve, ku hyn edhe IAP, që garantojnë demokracinë, sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut dhe respektimin dhe mbrojtjen e pakicave kombëtare.

Në këtë kuadër, dispozitat e MSA-së që ndërlidhen me IAP dhe mandatin e tij janë si në vijim:

- Neni 3: *“Respekti për parimet demokratike dhe të drejtat e njeriut siç janë shpallur në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut të vitit 1948 dhe siç janë përkufizuar në Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut të vitit 1950, në aktin final të Helsinkit dhe në Kartën e Parisit për një Evropë të re, respekti për parimet e së drejtës ndërkombëtare, përfshirë bashkëpunimin e plotë me Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNj) dhe mekanizmit të saj të mbetur, Tribunali Penal Ndërkombëtar, dhe respekti i shtetit të së drejtës dhe parimet e ekonomisë së tregut siç pasqyrohen në Dokumentin e Konferencës së Bonit për Bashkëpunim Ekonomik të Konferencës për Bashkëpunim për Siguri në Evropë formojnë bazën e politikave të BE-së dhe të Kosovës dhe përbëjnë elementët thelbësorë të kësaj Marrëveshje;*
- Neni 4: *“Kosova angazhohet të respektojë të drejtën dhe instrumentet ndërkombëtare, por jo vetëm ato që ndërlidhen me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të drejtave themelore, e deri tek mbrojtja e personave që u përkasin minoriteteve dhe pa diskriminim mbi çfarëdo baze.”*
- Neni 7: *“Zhvillimi i bashkëpunimit rajonal dhe marrëdhënieve të mira fqinjësore, si dhe respektimi i të drejtave të njeriut, përfshirë të drejtat e personave që u përkasin minoriteteve, janë të rëndësishme për PSA. Arritja dhe zbatimi i kësaj marrëveshjeje bëhet në kuadër të PSA-së dhe bazohet në vet meritat e Kosovës.”*

Ndërsa në nenin 120 të MSA-së përveç që kërkohet administratë publike profesionale, efiçente dhe llogaridhënëse, aty shprehimisht thuhet *“Bashkëpunimi do të përfshij gjithashtu përmirësimin e efikasitetit dhe kapacitetit të organeve të pavarura që shërbejnë për funksionimin e administratës publike dhe për një sistem efikas të kontrolleve dhe balancave.”*

Kërkesat nga mekanizmat e tjerë të aderimit në BE

Në konkluzionet takimit më të fundit të Nënkomitetit për Drejtësi, Liri dhe Siguri, ashtu si edhe në Raportin e KE-së për Kosovën – 2020 theksohet kërkesa që të sigurohet përcjellja e duhur e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit. Për më tepër, sipas treguesve 7.3.1 dhe 7.3.2 të Kontratës Buxhetore Sektoriale për Reformë të Administratës Publike në mes të Qeverisë së Kosovës dhe KE-së, deri më 2021 shkalla e zbatimit të rekomandimeve të IAP për autoritetet publike duhet të jetë të paktën 70%.

Në përgjithësi, Republika e Kosovës duhet të përmirësojë kushtet për funksionimin e IAP-it, në aspektin e zbatimit të kornizës ligjore, garantimin e qëndrueshëm të pavarësisë financiare, organizative dhe funksionale ashtu edhe dhe adresimin dhe përcjelljen adekuate të zbatimit të rekomandimeve që IAP lëshon.

Gjendja aktuale

Korniza legjislative

Në vijim është listuar korniza kryesore ligjore e cila rregullon fushë-veprimtarinë e IAP:

⁶ Ky kapitull lidhet me Kapitullin 23 i *acquis-së*: Gjyqësori dhe të drejtat themelore.

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës;
- Ligji për Avokatin e Popullit;
- Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi;
- Ligji për Barazi Gjinore;
- Ligji për Qasjen në Dokumente Publike.

Me pakon ligjore për të drejtat e njeriut, e cila është përbërë nga Ligji për Avokatin e Popullit, Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Ligji për Barazi Gjinore, e miratuar në korrik 2015, IAP-it i janë bartur edhe disa përgjegjësi të reja.

Në mënyrë që IAP të funksionojë në harmoni të plotë me Parimet e Parisit për Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut, që janë kriteret minimale ndërkombëtare që duhet të plotësojë çdo institucion kombëtar për të drejtat e njeriut në një vend në mënyrë që të mund të konsiderohet kredibil dhe i denjë që të kryej mandatin e tij, Ligji i ri për Avokatin e Popullit ka fuqizuar rolin e IAP përmes dispozitave që garantojnë pavarësi organizative, administrative dhe financiare. Për me tepër, ky ligj ka vendosur imunitet funksional jo vetëm për Avokatin e Popullit dhe zëvendësit, por për të gjithë stafin, ndërsa Qeveria dhe Komunitat obligohen të sigurojnë hapësira të përshtatshme për punë në pronësi publike në mënyrë që të mundësohet kryerja efektive e funksioneve dhe përgjegjësi të IAP, e gjithashtu është garantuar edhe pavarësia financiare. Neni 35 i këtij ligji përcakton si në vijim:

- *“Pavarësisht nga dispozitat e ligjeve të tjera, Institucioni i Avokatit të Popullit përgatit propozimin e buxhetit të tij vjetor dhe ia dërgon atë për miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës, cili nuk mund të jetë më i vogël se buxheti i miratuar për vitin e mëparshëm. Buxheti mund të shkurtohet vetëm me miratimin e Avokatit të Popullit.”*
- *“Në rast të shtimit të obligimeve dhe kompetencave të Institucionit të Avokatit të Popullit me këtë ligj dhe ligje të tjera, kjo përcillet edhe me burime shtesë përkatëse dhe adekuate financiare dhe njerëzore.*
- *Institucioni i Avokatit të Popullit menaxhon në mënyrë të pavarur me buxhetin e tij.”*

Pakoja ligjore për të drejtat e njeriut, ndër të tjera, ka përcaktuar afate më të shpejta për shqyrtim të rasteve, themelimin e Mekanizimit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT), mbulimin të sektorit publik dhe atij privat, përkritazi me rastet e diskriminimit, masa ndëshkimore për mosbashkëpunim me Avokatin e Popullit, inicimin e procedurave gjyqësore nga Avokati i Popullit, paraqitjen e Avokatit të Popullit në cilësinë e Mikut të Gjykatës (*amicus curiae*) në proceset gjyqësore që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, çështjet e barazisë, përfshirë ato të barazisë gjinore dhe mbrojtjes nga diskriminimi, etj.

Në kapacitetin e MKPT, Avokati i Popullit obligohet t'i vizitojë rregullisht, pa paralajmërim, të gjitha vendet ku mbahen persona të privuar nga liria (përfshirë ndalimin policor, paraburgimin, qëndrimin në institucionet shëndetësore, ndalimin doganor, ndalimin e emigrimit dhe çdo vend tjetër kur dyshohet se ka shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut); si dhe të krijojë mekanizëm të veçantë që do të kryej të gjitha funksionet e MKPT-së. Avokati i Popullit duhet të bashkëpunojë me mekanizmat ndërkombëtar dhe vendor në fushën e parandalimit të torturës si dhe formave të tjera të trajtimit apo ndëshkimit mizor, jonjerëzor dhe poshtëruës. Gjithashtu, Avokati i Popullit mund të japë sugjerime dhe rekomandime për personat dhe institucionet përgjegjëse ku mbahen personat e privuar nga liria pa marrë parasysh llojin apo objektin dhe rrethanat e mbajtjes së tyre, për përmirësimin e trajtimit dhe kushteve të tyre.

Sa i përket transpozimit të *acquis*-së në legjislacionin kombëtar në këtë fushë, deri më tani është arritur transpozim i konsiderueshëm (i pjesshëm), më konkretisht Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe Ligjin për Barazi Gjinore.

IAP ka vazhduar të punojë në përmbushjen e misionit kushtetues që të jetë mbrojtës i të drejtave të qytetarëve të Kosovës vis-à-vis veprimeve të autoriteteve publike. Aktualisht, IAP veprimtarinë e tij e zhvillon në Zyrën Qendrore në Prishtinë dhe në zyrat rajonale në: Prizren, Pejë, Gjiilan, Ferizaj, Gjakovë, Graçanicë, Mitrovicë dhe në Mitrovicën e Veriut.

Sipas raportit vjetor të Avokatit të Popullit, është evidentuar rritje progresive nga viti në vit i numrit të rekomandimeve të dërguara institucioneve përgjegjëse dhe trend pozitiv i zbatimit të tyre. Kjo ka ndikuar

në ngritjen e besimit të qytetarëve në institucion dhe rritje të përgjegjshmërisë nga ana e autoriteteve publike, sa i përket përmbushjes së obligimeve të tyre kushtetuese dhe ligjore, në shërbim të qytetarit.

Mbështetja e donatorëve

IAP, si institucion kombëtar për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, vazhdimisht është mbështetur nga akterë të ndryshëm ndërkombëtarë. Projektet nga të cilat ka përfituar ky institucion janë fokusuar në ngritjen e kapaciteteve të stafit në kryerjen efektive dhe efikase të detyrave e përgjegjësi sipas mandatit kushtetues dhe ligjor, dhe në promovimin e punës e ngritjen e vetëdijes së qytetarëve për rolin e institucionit dhe të drejtat e tyre. Projektet aktuale janë:

- *Fuqizimi i Institucioneve të Kosovës në Luftën Kundër Torturës, Keqtrajtimit dhe Trajtimt Çnjerëzor: me periudhë zbatimi korrik 2020-dhjetor 2021, përkrahur nga Mbretëria e Norvegjisë dhe Këshilli i Evropës;*
- *Mbështetje për Institucionin e Avokatit të Popullit të Kosovës: me periudhë zbatimi mars 2019-shtator 2020, përkrahur nga BE (IPA);*
- *Projekti i Asistencës Teknike për Integrim Evropian të Kosovës: me periudhë zbatimi maj 2018-prill 2022 përkrahur nga Qeveria e Luksemburgut dhe Mbretëria e Norvegjisë;*
- *Promovimi i Barazisë dhe Diversitetit në Kosovë: me periudhë zbatimi maj 2019-maj 2022, përkrahur nga BE dhe Këshilli i Evropës;*
- *Fuqizimi i Mekanizmit Kombëtar për Parandalim në Kosovë: me periudhë zbatimi maj 2017- prill 2019, përkrahur nga Këshilli i Evropës, Mbretëria e Norvegjisë dhe Qeveria e Zvicrës;*
- *Mbështetje për Zbatimin e Standardeve Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Kosovë dhe Reformimi i Institucionit të Avokatit të Popullit: me periudhë zbatimi mars 2015-shkurt 2017, përkrahur nga Këshilli i Evropës, Qeveria e Zvicrës dhe Mbretëria e Norvegjisë;*
- *Avancimi i Qasjes në Drejtësi dhe Sundimit të Ligjit në Kosovë: me periudhë zbatimi tetor 2014-dhjetor 2020, përkrahur nga UNDP dhe Qeveria e Norvegjisë;*
- *Avancimi i Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut në Kosovë: me periudhë zbatimi shkurt 2012-shkurt 2014, përkrahur nga BE dhe Këshilli i Evropës.*

Objektivat prioritarë afatmesme

Bazuar në mandatin dhe misionin e IAP, synimi dhe objektivi themelor i punës është hetimi i rasteve, sipas parastresave të qytetarëve burra dhe gra, me qëllim që mbrojtja dhe promovimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të realizohet me përgjegjësi, shpejtësinë e duhur dhe profesionalizëm.

Konkretisht, objektivat prioritarë afatmesme në këtë kapitull janë si në vijim:

- Ngritja e besueshmërisë së qytetarëve në IAP dhe promovimi i të drejtave të njeriut;
- Ngritja e numrit të trajtimit të rasteve ex officio;
- Ngritja e vazhdueshme e zbatimit të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga institucionet përgjegjëse;
- Mbrojtja e të drejtave dhe lirive të njeriut, me fokus të veçantë në çështjet sistematike të cilat janë më të rëndësishme për interesin dhe shqetësimet e qytetarëve;
- Ngritja e kapaciteteve të departamenteve të reja për realizimin e mandatit të tyre në pajtueshmëri me ligjin, me fokus në Departamentin për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe Departamentin për të Drejtat e Fëmijëve;
- Avancimi i bashkëpunimit si me autoritetet publike, shoqëri civile dhe media, por gjithashtu edhe me rrjete të ndryshme ndërkombëtare.

1.1.4. Mbikëqyrja civile e forcave të sigurisë

Ky kapitull mbulon mbikëqyrjen demokratike civile ndaj institucioneve të sigurisë, i cili i referohet ushtrimit të kontrollit civil përmes Kuvendit të Republikës së Kosovës, përkatësisht përmes Komisioneve përkatëse parlamentare (Komisioni për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes, Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë), Presidentit, Kryeministrit dhe Ministrit të Mbrojtjes.

MSA nuk përmban ndonjë dispozitë specifike lidhur me këtë fushë, por Kosova zbaton kërkesa të ndërlydhura të dala nga mekanizmat e të tjerë të aderimit në BE.

Kërkesat nga mekanizmat e tjerë të aderimit në BE

Çështja e verifikimit të anëtarëve të Komisionit parlamentar për mbikëqyrje të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë (AKI), e konstatuar nga Raporti i Vendit si verifikim joprofesional dhe partizan të sigurisë dhe se Kuvendi duhet të rrisë kapacitetin e saj dhe përmirësoj ekspertizën e saj për të mbikëqyrur këtë zone. Mbetet obligim i Kosovës që përmes plotësimit dhe ndryshimit të Ligjit për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimit të Sigurisë të themelojë Agjencinë për sigurinë e Informacionit të Klasifikuar, si autoritet i sigurisë Kombëtare, si dhe në bashkëpunim të ngushtë me mekanizmat e të tjerë të Republikës së Kosovës, të përfshijë në procesin e vendimmarrjes së verifikimit të sigurisë dhe njëkohësisht me arritjen e standardeve minimale të sigurisë për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara që janë në administrim të institucioneve përkatëse të Republikës së Kosovës.

Komisioni përkatës parlamentar për Sigurinë do të jetë mekanizëm mbikëqyrës si kësaj agjencie dhe të njëjtit nuk do t'i nënshtrohen verifikimit të sigurisë. *Raporti i KE-së për Kosovën - 2020* thekson sërish se mbikëqyrja parlamentare e Forcave të Sigurisë së Kosovës si dhe Agjencisë Kosovare për Inteligjencë vazhdon të jetë e pamjaftueshme. Raporti i Vendit 2020 gjithashtu thekson për këtë fushë nevojën që të adresohen të gjeturat e raportit të miratuar në qershor të vitit 2019 të Komisionit Hetimor Parlamentar për rastin e deportimit të 6 (gjashtë) shtetasve nga Turqia.

Gjendja aktuale

Korniza legjislative

Fusha e mbikëqyrjes demokratike civile në Republikën e Kosovës rregullohet nga:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës - neni 65, paragrafi 12;
- Ligji për Ministrinë e Mbrojtjes;
- Ligji për Forcën e Sigurisë së Kosovës;
- Ligji për Klasifikimin e Informacioneve dhe verifikimin e Sigurisë;
- Ligji për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë.

Më tej, marrë parasysh plotësimin dhe ndryshimin e Planit Legjislativ të Qeverisë për vitin 2018, më 13 shtator 2018 është ri-proceduar në Qeveri projektligji për Forcën e Sigurisë së Kosovës, projektligji për Ministrinë e Mbrojtjes si dhe projektligji për Shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës. Në mbledhjen e 13 shtatorit 2018, Qeveria e Republikës së Kosovës, me Vendimet përkatëse (nr. 04/65; nr. 05/65 dhe nr. 06/65) ka miratuar dhe procedura në Kuvend të Kosovës të tri (3) ligjet e lartpërmendura. Kuvendi i Republikës së Kosovës i ka miratuar këto projektligje më 14 dhjetor 2018 dhe ato kanë hyrë në fuqi në janar 2019. Korniza e re ligjore përcakton më hollësisht kompetencat e autoriteteve të kontrollit civil demokratik të FSK-së.

Korniza e politikave

Analiza e Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë (RSSS), e miratuar më 2014, ka përcaktuar objektivat strategjike të Sektorit të Sigurisë së Republikës së Kosovës, si në vijim: Pavarësia, sovraniteti dhe integriteti territorial; rendi kushtetues; zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik; jeta, mirëqenia, prona dhe siguria e qytetarëve të Kosovës; dhe stabiliteti rajonal dhe anëtarësimi në organizata ndërkombëtare.

Interesat dhe Objektivat e Sigurisë Kombëtare përcaktojnë bazat për misionin dhe detyrat aktuale dhe të ardhshme të institucioneve në përgjithësi, dhe institucioneve të sigurisë në veçanti. Në kuadër të interesave dhe sigurisë kombëtare nga Analiza e RSSS-së, fushëveprimi e kësaj strategjie ndërlidhet me integrimin në BE dhe NATO, pra stabilitetin rajonal dhe anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare. Njëkohësisht, mbikëqyrja civile e forcave të sigurisë duhet të bëhet në përputhje të plotë me Rezolutën e Kombeve të Bashkuara 1325 mbi Gratë, Paqen dhe Sigurinë, si dhe strategjitë e deritanishme qeveritare.

Korniza institucionale

Bazuar në legjislacionin relevant, zinxhiri i kontrollit demokratik civil fillon nga Kuvendi (përmes komisioneve relevante parlamentare), Presidenti i Kosovës, si Komandant Suprem i FSK-së, Kryeministri dhe Ministri i Mbrojtjes, kompetencat e të cilëve ushtrohen në thirrjen për raportim, emërimin, gradimin dhe mbikëqyrjen e financave.

Korniza institucionale për fushën e mbikëqyrjes demokratike civile të forcave të sigurisë përbëhet nga këto institucione:

- Presidenti i Republikës së Kosovës;
- Kuvendi i Republikës së Kosovës;
- Komisioni për Mbikëqyrje;
- Qeveria;
- Kryeministri;
- Ministri i Mbrojtjes.

1.2. Bashkëpunimi rajonal dhe obligimet ndërkombëtare⁷

Qeveria e Republikës së Kosovës promovon fqinjësi të mirë dhe konstruktive me të gjitha shtetet e rajonit. Në përbushje të politikës rajonale, Kosova mbetet e angazhuar në mënyrë konstruktive dhe pragmatike për të rritur bashkëpunimin rajonal efektiv. Qëllim kryesor mbetet forcimi i marrëdhënieve me fqinjët e parë, ngritja e nivelit aktual të shkëmbimeve të gjithanshme, avancimin e bashkëpunimit në të gjitha fushat me interes të përbashkët.

Kosova vazhdon të mbështes dialogun e të gjitha niveleve, sigurinë rajonale, bashkëpunimin ekonomik, thellimin e shkëmbimeve tregtare, mbrojtjes dhe promovimit të drejtave dhe lirive të njeriut. Kosova mbetet e përkushtuar për normalizimin e plotë të marrëdhënieve ndërshtetërore me Serbinë dhe vazhdimin e dialogut, ku synohet të finalizohet me njohje reciproke, gjë që do të mundësonte ndërtimin e paqes së qëndrueshme në mes të dyja vendeve dhe vendosjen e marrëdhënieve diplomatike dhe të mira fqinjësore në frymën evropiane, përfshirë pjesëmarrjen e grave dhe burrave në proceset e dialogut në përputhje me Rezolutën e Kombeve të Bashkuara 1325 mbi Gratë, Paqen dhe Sigurinë si dhe strategjitë e deritanishme qeveritare.

Anëtarësimi i Republikës së Kosovës në organizata ndërkombëtare mbetet një ndër prioritetet parësore të Qeverisë së Kosovës, si dhe vazhdojnë përpjekjet për t'u bërë anëtare e plotë e OKB-së, agjencive të saja të specializuara dhe të rrisë pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e saj në mekanizmat multilateralë. Diplomacia multilaterale e Kosovës vazhdon të jetë në shërbim të avancimit të interesave shtetërore të Kosovës, zhvillimit demokratik dhe ekonomik të vendit, si dhe marrjes së përgjegjësive ndërkombëtare.

Republika e Kosovës si anëtare me të drejta të plota në organizatën rajonale në Evropën Juglindore Këshilli për Bashkëpunim Rajonal (KBR) merr pjesë në takimet vjetore, takimet e bordit, të Koordinatorëve Nacionalë dhe në takimet sektoriale të tij. Institucionet e Kosovës, në përputhje me kërkesat e Ligjit për Barazi Gjinore, duhet të sigurojnë përfaqësim të barabartë të burrave dhe grave në të gjitha takimet, mbledhjet, seminarët dhe konferencat.

Sipas kërkesave që dalin nga MSA, nënkomitetet dhe mekanizmat e tjerë të këtij procesi në fushën e bashkëpunimit rajonal dhe obligimeve ndërkombëtare, Kosova vazhdon të zhvillojë bashkëpunim rajonal në respektimin e drejtave të njeriut, veçanërisht të minoriteteve, në nxitjen e bashkëpunimit rajonal lidhur me lëvizjen e personave, mallrave dhe shërbimeve, si dhe kapitalit. Rrjedhimisht, Kosova zhvillon dialog politik me qëllim të konsolidimit të përafrimit ndërmjet BE-së dhe Kosovës në avancimin e formave të reja të bashkëpunimit, në kuadër të procesit të normalizimit të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë, si dhe promovon në mënyrë aktive bashkëpunimin rajonal.

Është thelbësore që Kosova vazhdon zbatimin në mirëbesim të të gjitha marrëveshjeve të arritura deri më tani në mes të Kosovës dhe Serbisë, dhe angazhohet në mënyrë konstruktive në gamën e plotë të çështjeve

⁷ Ky kapitull lidhet me *Kapitullin 31 të acquis-së: Politika e jashtme, e mbrojtjes dhe e sigurisë*.

me lehtësimin e BE-së, përfshirë Traktatin e Komunitetit të Transportit, bashkëpunimin gjyqësor, dhe marrëveshjet për punësim dhe politikat sociale në kuadër të EJL, punësimin dhe Rrjetin e Politikave Sociale dhe Rrjetit shëndetësor të EJL. Andaj gjithashtu duhet të sigurohet pjesëmarrja e plotë e Kosovës në Dekadën Rome.

Sipas Konkluzioneve të Këshillit, prill 1997, bashkëpunimi rajonal është një nga kushtet kryesore për të lidhur marrëdhënie kontraktuale me BE-në. Qeveria e Republikës së Kosovës vazhdon të jetë konstruktive sa i përket dialogut me Republikën e Serbisë dhe në të njëjtën kohë ka intensifikuar përpjekjet për thellimin e raporteve të mira me vendet fqinje. Gjithashtu mbetet prioritet anëtarësimi dhe pjesëmarrja proaktive në organizatat rajonale e ndërkombëtare.

Sipas *Raportit të KE-së për Kosovën – 2020*, duhet të rritet bashkëpunimi ndërinstitucional në fushën e personave të zhdukur dhe të unifikohen pozicionet në mes të Komisionit të Kosovës për Persona të Zhdukur, Mbajtësit të Dosjes në ZKM si dhe përfaqësuesit të Kosovës në Grupin Punues Prishtinë-Beograd. Gjithashtu, duhet të vendoset dhe funksionalizohet sistemi për menaxhimin e rasteve për Persona të Zhdukur dhe do të forcojë bashkëpunim ndër-institucional. Prioritet i lartë do të jepet miratimit të legjislacionit dytësor në mënyrë që të përkrahet edhe zbatimi i Ligjit për Persona të Zhdukur. Gjithashtu, do të rriten kapacitetet për të kryer praktika të qëndrueshme forenzike, përfshirë antropologjinë dhe arkeologjinë forenzike.

Gjendja aktuale

Baza ligjore për rregullimin e fushës për marrëveshjet ndërkombëtare përbëhet nga:

- Ligji nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare;
- Ligji nr. 04/L-199 për ratifikimin e Marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë;
- Protokollet zbatuese të Marrëveshjes bazë për normalizimin e marrëdhënieve.

Baza ligjore për rregullimin e fushës për personat e zhdukur të marrëveshjeve ndërkombëtare bëhet me Ligjin nr. 04/1-023 për Persona të Zhdukur.

Korniza institucionale dhe marrëveshjet

Korniza institucionale për fushën e bashkëpunimit rajonal dhe obligimet ndërkombëtare përbëhet nga institucionet në vijim:

- Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, përkatësisht Departamenti për Marrëdhënie Rajonale; dhe
- Zyra e Kryeministrit (përgjegjëse për dialogun për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë).

Dialogu ka për qëllim zgjidhjen e çështjeve praktike ndërmjet dy shteteve të pavarura dhe sovrane. Dialogu ndërmjetësohet nga BE dhe mbështetet nga ShBA-të. Dialogu ka dalë si obligim ndërkombëtar nga Rezoluta e OKB-së e shtatorit 2010 për të cilën Qeveria e Republikës së Kosovës, në harmoni me Kushtetutën e vendit dhe Rezolutën e Kuvendit ka treguar gatishmërinë për përmbushjen e këtij obligimi, si dhe të objektivave për përmirësimin e jetës së qytetarëve dhe afrimin e Kosovës me Bashkimin Evropian.

Zyra e Këshillit për Bashkëpunim Rajonal (ZKBR) vepron në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, nën udhëheqjen e Koordinatorit Nacional në Këshillin për Bashkëpunim Rajonal të emëruar nga Kryeministri, i cili përfaqëson Republikën e Kosovës si dhe koordinon të gjitha aktivitetet për bashkëpunim rajonal në kuadër të KBR-së direkt me Sekretariatit në Sarajevë.

Koordinatori Nacional përfaqëson Kosovën në takimet e Bordit dhe takimet vjetore të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal në Sarajevë. Zyra e Këshillit për Bashkëpunim Rajonal është e angazhuar për bashkëpunim ndërministror me synim plotësimin e angazhimeve në kuadër të agjendës së KBR-së.

Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur që funksionon në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, është organ qeveritar i cili udhëheq, mbikëqyrë, bashkërendon dhe koordinon aktivitetet me institucionet vendore, bashkëpunon me institucionet dhe organizatat ndërkombëtare dhe akterët të tjerë, në lidhje me

zbardhjen e fatit të personave të zhdukur si pasojë e luftës së viteve 1998-1999, pavarësisht përkatësisë etnike, religjionit apo statusit ushtarak apo civil.

Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur ka mandat dhe ka për qëllim të mbrojtë të drejtat dhe interesat e personave të zhdukur dhe familjarëve të tyre, në veçanti të drejtën e familjarëve për të ditur fatin e personave të zhdukur, të cilët u zhdukën gjatë periudhës 1 janar 1998-31 dhjetor 2000, si pasojë e luftës në Kosovë në vitet 1998-1999.

Sa u përket marrëdhënieve me bashkësinë ndërkombëtare, Kosova është anëtare e Fondit Monetar Ndërkombëtar, Bankës Botërore, e Bankës Evropiane për Zhvillim dhe Rindërtim. Kosova gjithashtu merr pjesë në takimet e rregullta të CEFTA-s, mirëpo vazhdon të ballafaqohet me pengesat e krijuara nga Serbia ku nga Sekretariati i CEFTA-s kërkohet që në emër të Kosovës të nënshkruajë UNMIK-u, gjë që përbën shkelje të Marrëveshjes së Bashkëpunimit Rajonal të arritur në Bruksel më 24 shkurt 2012 (për më tepër, shihni kapitullin 31).

Republika e Kosovës është anëtare e këtyre nismave politike rajonale dhe ndërkombëtare:

- Procesi i Bashkëpunimit për Evropën Juglindore (SEECP);
- Iniciativa Rajonale për Migrim, Azil dhe Refugjatë (MARRI);
- Këshilli për Bashkëpunim Rajonal (RCC);
- Komisioni i Venedikut;
- Qendrën për Bashkëpunim për Siguri (RACVIAC);
- Organizatën Ndërkombëtare të Frankofonisë;
- Marrëveshja e Evropës Qendrore për Tregti të Lirë (CEFTA);
- Forumi Ekonomik i Vjenës (VEF);
- Procesi i Bërdos (BP);
- Instrumenti Investues për Ballkan Perëndimor (WBIF);
- Komuniteti Energjisë (EnC);
- Komisioni për Investime i Evropës Juglindore (SEEIC);
- Grupi Punues për Zhvillimin Rural të Rajonit (SWG);
- Forumi i Bashkësisë Tregtare të Evropës Juglindore (SEETUF);
- Iniciativa elektronike e Evropës Juglindore (eSEE);
- EETO - Observatori i Transportit i Evropës Juglindore;
- Rrjeti i Asociacioneve të Autoriteteve Lokale të Evropës Juglindore (NALAS);
- Rrjeti i Partneritetit Publiko Privat të Evropës Juglindore (SEPPPPN);
- SHBA - Karta e Adriatikut (A-5);
- Nisma e Reformës Arsimore për Evropën Juglindore (ERI SEE);
- Qendra Rajonale e Mjedisit (REC);
- Shkolla Rajonale për Administratë Publike (ReSPA);
- Rrjeti rajonal mjedisor për anëtarësim (RENA);
- Qendra Rajonale e të Mësuarit për Sipërmarrje në Evropën Juglindore (SEECEL);
- Task Forca për Avancimin dhe Ngritjen e Kapitalit Njerëzor (TF FBHC);
- Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrëse se Pensioneve (IOPS);
- Unioni Ndërkombëtar i Rrugës në Gjeneve (IRU);
- Banka Botërore (WB);
- Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD);
- Fondi Monetar Ndërkombëtar (IMF);
- Shoqata Ndërkombëtare e Avokatëve (IBA);
- Shoqata Ndërkombëtare e Sigurimeve Sociale (ISSA);
- Grupi Punues i Përhershëm i Zhvillimit Rural i Evropës Juglindore (RRDWG);
- Grupi i Vishegradit (VG);
- Human Dynamics (HD);
- Zbatimi i Qiellit të vetëm Evropian në Programin e Evropës Juglindore (ISIS ECAA);

- Kompakti i Investimeve për Ejl (ICSEE);
- Promovimi i Filmit Evropian (EFP);
- Rrjeti Evropian i Krerëve të Agjencive për Mbrojtjen e Mjedisit (EPA);
- Banka Evropiane e Investimeve (EIB);
- Banka e Këshillit të Evropës për Zhvillim (CEB);
- Grupi i Rregullatorëve të Pavarur – Hekurudhor (IRG – Rail);
- Asamble Parlamentare e NATO-s (NATO PA);
- Anketa e Euro Gjeologjisë (EGS);
- Organizata Ndërkombëtare e Frankofonisë (OIF);
- Unioni Ndërkombëtar i Radiove Fillestare (IARU);
- Qendra e Kërkimit dhe Inovacionit në Ballkanin Perëndimor (WISE);
- Fondi i Ballkanit Perëndimor (WBF);
- Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit (MCC);
- Byroja Ndërkombëtare e Ekspozitave (BIE);
- Zyra Rajonale e Bashkëpunimit Rinor (RYCO);
- Instituti Evropian i Standardeve të Telekomunikacionit (ETSI);
- Gjykata e Përhershme e Arbitrazhit (PCA);
- Konventa e Apostille (AC);
- Federata Botërore e Dentare (WDF);
- Federata Ndërkombëtare e Shoqatave dhe Institucioneve Bibliotekare (IFLA);
- Këshilli Ndërkombëtar i Muzeve (ICOM);
- Grupi Egmont i Njësitë të Inteligjencës Financiare (EGFIU);
- Traktati i Komunitetit të Transportit (TCT);
- Federata Ndërkombëtare e Këshillit të Arteve dhe Agjencive të Kulturës (IFACCA);
- Organizata Botërore e Doganave (WCO);
- Këshilli Ndërkombëtar për Monumentet dhe Vendet (ICOMOS);
- Rrjeti i Kinemasë në Evropën Juglindore (SEE Cinema Network);
- Akademia Evropiane e Filmit (EFA);
- Këshilli Rajonal i Evropës Juglindore – Këshilli Ndërkombëtar për Sisteme të Mëdha Elektrike (SEERC CIGRE);
- Këshilli Botëror i Ujit (WWC);
- Asambleja Parlamentare e Bronkofonisë (APF);
- Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN)
- Organizatat Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI);
- Réseau international francophone de formation policière (FRANCOPOL);
- Komiteti Ndërkombëtar për Regjistrimin e Kafshëve (ICAR).

Kosova gjithashtu është anëtarësuar në këto organizata sportive:

- Federatën Ndërkombëtare të Basketbollit;
- Federatën Ndërkombëtare të Notit;
- Komitetin Olimpik Ndërkombëtar;
- Federatën Ndërkombëtare të Hendbollit;
- Federatën Botërore të Taekwondos;
- Federatën Ndërkombëtare të Mundjes;
- Federatën Ndërkombëtare të Ping Pongut (ITTF);
- Federatën Ndërkombëtare të Stileve të Asociuara të Mundjes (FILA);
- Federatën Ndërkombëtare të Shigjetave (FITA);
- Federatën Ndërkombëtare të Peshëngritjes (IWF);
- Federatën Ndërkombëtare të topit të butë (ISF);
- Federatën Ndërkombëtare të Xhudos (IJF);

- Federatën Evropiane të Sporteve Minigolf (EMF);
- Federatën Ndërkombëtare të Lundrimit (ISAF);
- Federatën Botërore për Curling (WFC);
- Unionit Ndërkombëtar Modern të Pentathlonit (UIPM);
- Federatën Ndërkombëtare të Gjymnastikës (FIG);
- Komitetin Olimpik Evropian (ËB);
- Shoqatën Ndërkombëtare të Boksit Amator (AIBA);
- Federatën Ndërkombëtare të Kikboksit (IKF);
- Federatën Ndërkombëtare të Echecs (Federatën Botërore të Shahut) (FIDE);
- Federatën Ndërkombëtare të Sporteve të Qitjes (ISSF);
- Federatën Ndërkombëtare të Volejbollit (FIVB);
- Federatën Ndërkombëtare të Federatave të Atletikës (IAAF);
- Unionin Ndërkombëtar të Çiklistëve (UCI);
- Federatën Ndërkombëtare të Aeronautikës (FAI);
- Federatën Ndërkombëtare të Tenisit (ITF);
- Shoqatën Evropiane të Atletikës (EAA);
- Federatën Ndërkombëtare të Skive (FIS);
- Federatën Ndërkombëtare të Automobilave (FIA);
- Unionin e Shoqatave Evropiane të Futbollit (UEFA);
- Federatën Ndërkombëtare të Shoqatave të Futbollit (FIFA);
- Unionin Botëror të Mundjes (UWW);
- Federatën Botërore të Karatesë (WKF).

Sa i përket bashkëpunimit rajonal Kosova vazhdon të ketë bashkëpunim të kënaqshëm me vendet fqinje.

Me Shqipërinë: në kuadër të forcimit të bashkëpunimit strategjik me Republikën e Shqipërisë në fushën ekonomike, politike, kulturore, sportive dhe fusha e tjera, gjithsej janë mbajtur pesë mbledhje të përbashkëta ndërqeveritare në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë.

Gjatë mbledhjeve të viteve të fundit në mes Kosovës dhe Shqipërisë janë nënshkruar një numër i konsiderueshëm i marrëveshjeve, si në vijim:

- Marrëveshja për heqjen e çmimeve të shërbimeve Roaming për rrjetet publike të komunikimeve të lëvizshme ndërmjet ministrive përgjegjëse për fushën e komunikimeve elektronike të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës, më 26.11.2018;
- Protokollin për Kryerjen e veprimtarive të përbashkëta të kontrollit doganor në pikën e përbashkët të kalimit kufitar Morinë-Vërmicë” në mes të Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të Republikës së Shqipërisë, më 26.11.2018;
- Marrëveshja e bashkëpunimit në fushën e borxhit publik, financimeve të huaja dhe marrëdhëniet me institucionet Financiare Ndërkombëtare, më 26.11.2018;
- Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Agjencisë për pronësinë industriale të RKS dhe Drejtorisë së përgjithshme të pronësisë industriale të Republikës së Shqipërisë, më 26.11.2018;
- Protokollin ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të Republikës së Kosovës, për njohjen e bilaterale dhe unifikimin e modeleve të certifikatave shëndetësore, veterinare dhe fito sanitare që do të shoqërojnë ngarkesat e kafshëve të gjalla, produkteve me origjinë shtazore dhe produktet bimore gjatë importit, eksportit dhe tranzitit midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës, më 26.11.2018;
- Marrëveshja e Bashkëpunimit në fushën e Rinisë, më 26.11.2018;
- Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për bashkëpunimin, nxitjen e biznesit dhe të informimit të diasporës, më 26.11.2018;

- Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për njohjen reciproke të patentë shoferëve, më 26.11.2018;
- Marrëveshja e Bashkëpunimit në fushën e shëndetësisë ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë së Republikës së Kosovës, më 26.11.2018;

Më tej, Sekretariati i Përbashkët Kosovë – Shqipëri, i cili ka zhvilluar një sërë takimesh, ka një aktiv sa i përket mbikëqyrjes së marrëveshjeve të arriturave në mes të dy vendeve. Sekretariati në takimin themelues të mbajtur në Prishtinë është dakorduar për mbajtje të takimeve çdo dy muaj.

Me Malin e Zi së fundi, më 26 gusht 2015, Republika e Kosovës kishte nënshkruar marrëveshjen për Kufirin Shtetëror, të ratifikuar nga Kuvendi më 21 mars 2018. Gjatë tre viteve të fundit janë nënshkruar disa marrëveshje të rëndësishme:

- Marrëveshja “Transporti rrugor i udhëtarëve dhe mallrave” në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Malit të Zi u nënshkrua me datën 01 gusht 2018. Kjo marrëveshje ka hyrë në fuqi me datën 10 janar 2020.
- Marrëveshja për bashkëpunim në fushën e kulturës është nënshkruar më 28 prill 2017 dhe datë e hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje është data 21 nëntor 2017.
- Marrëveshja dypalëshe për programin e bashkëpunimit ndërkuftar ndërmjet Malit të Zi dhe Kosovës sipas IPA II (2014-2020) e nënshkruar më 20 shkurtit 2017 e ratifikuar me dekret të Presidentit dhe publikuar në Gazetën Zyrtare më 24 prill 2017.
- Me datën 5 prill 2018 është nënshkruar “Marrëveshja financiare trepalëshe mes BE-së, Kosovës dhe Malit të Zi për Programin e bashkëpunimit ndërkuftar IPA II” ndërmjet Kosovës përfaqësuar nga Ministria e Integritimit Evropian dhe Malit të Zi. Është publikuar më 26 dhjetor 2018.
- Pas shkëmbimit të notifikimeve, ratifikohet dhe hyn në fuqi nga data 31 dhjetor 2019 Marrëveshja IPA II për vitet 2018-2020 për “Bashkëpunim ndërkuftar” në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Malit të Zi.

Me Maqedoninë e Veriut, që nga nënshkrimi i marrëveshjes së demarkacionit, janë vendosur marrëdhëniet diplomatike mes dy vendeve (17 tetor 2009), kështu duke vazhduar me marrëdhënie të një niveli mjaft të mirë deri në ditët e sotme. Republika e Maqedonisë së Veriut ndanë objektivin e ngjashëm me politikën e jashtme të Kosovës, duke aspiruar anëtarësimin e plotë në BE dhe NATO. Themelore e marrëdhënieve dypalëshe të të dyja shteteve ka qenë dhe mbetet prej kohësh, respektimi reciprok i dokumenteve, Plani i Ahtisaar-it dhe Marrëveshja e Ohrit.

Në kuadër të bashkëpunimit strategjik dhe fqinjësor, në dy vitet e fundit janë nënshkruar një sërë marrëveshjesh e memorandumesh, dhe gjithashtu ka nisma që pritet të nënshkruhen së shpejti:

- Më 01.12.2017 është lëshuar Autorizim për nënshkrimin e “Marrëveshjes për Ripanimin e personave që qëndrojnë pa autorizim dhe Protokollin e tij zbatues”, në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Marrëveshja në mes të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Kosovës për “Luftën kundër trafikimit me qenie njerëzore” nënshkruar me 16 mars 2018. Pas shkëmbimit të notifikimeve, marrëveshja ratifikohet dhe hyn në fuqi nga data 20 janar 2020.
- Më 20.10.2017 është lëshuar Autorizim për nënshkrimin e “Marrëveshjes financiare trelaterale për vitin 2016 për programin e Bashkëpunimit Ndërkuftar IPA II (2014-2020) në mes të Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut” në mes të Kosovës përfaqësuar nga MIE, BE, përfaqësuar nga KE, dhe Maqedonisë së Veriut, përfaqësuar nga Kryeministria;
- Marrëveshja për “Njohjen reciproke të patentë shoferëve” në mes të Republikës së Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut, e nënshkruar më 01.08.2018. Data e hyrjes në fuqi është 9 janar 2020;
- Ligji nr. 05/l-149 për ratifikimin e marrëveshjes për themelimin e zyrës rajonale për bashkëpunim rinor në mes Kosovës, Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë (Publikuar më: 21.04.2017);

- Më 12.07.2018 është lëshuar Autorizim për nënshkrimin e “Marrëveshjes financiare trepalëshe ndërmjet BE-së, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut për vitin 2017, për programin e bashkëpunimit ndërkufitar IPA II ndërmjet Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut” në mes të Kosovës përfaqësuar nga Ministria e Integrimit Evropian, Bashkimin Evropian përfaqësuar nga KE dhe Maqedonisë së Veriut, përfaqësuar nga Kryeministria;
- Më 16 gusht 2017 në Prishtinë është nënshkruar një protokoll në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për mënyrën e përgatitjes së planifikimit urban dhe dokumentacionit adekuat-teknik të projektit final, ndarjen e kostos së përgjithshme dhe të mirëmbajtjes për objektet e përbashkëta dhe për mënyrën e kryerjes së kontrolleve kufitare tek Pikat e Përbashkëta të Kalimit Kufitar për Komunikacionin Rrugor ndërkombëtar në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut “Stanqiç-Bellanoc”.

Me Serbinë marrëdhëniet bilaterale zhvillohen kryesisht në kuadër të procesit të normalizimit, të ndërmjetësuar nga BE. Në kuadër të këtij procesi ekzistojnë disa marrëveshje, të përshkruara në vijim.

Energjia: Pavarësisht që marrëveshja e energjisë është negociuar për më shumë se gjashtë vjet ajo ende nuk mund të zbatohet pasi që është duke u bllokuar në mos lejinim që kompania e re të regjistrohet në Kosovë në pajtim me Ligjet e Kosovës ashtu siç parashihet me marrëveshjen e energjisë të arritur më 2013. Në terma konkretë, kompania e re, si një degë e një kompanie serbe, po refuzon të përmendë në Kosovën si shtetin ku do të operoj, në statutin saj, pavarësisht faktit se marrëveshja kërkon respektimin e Ligjeve të Kosovës. Moszbatimi i kësaj marrëveshjeje ka ndikim negativ në vendosjen e sistemit unik të këtij sektori në Kosovë, ndikim në përmbushjen e obligimeve ndaj qytetarëve të Kosovës dhe sigurinë energjetike në vend, dhe gjithashtu edhe në agjendën 6+ të procesit të Berlinit për agjendën e konektivitetit.

Diplomat: Edhe në fushën e arsimit Serbia nuk ka treguar gatishmëri për të ndihmuar studentët, përmes zbatimit të marrëveshjes për pranimin reciprok të diplomave midis dy shteteve, Kosovës dhe Serbisë. Që nga viti 2011, kur u arrit kjo marrëveshje dhe më vonë u zgjerua në janar 2016, ajo kurrë nuk është zbatuar nga Serbia. Motivet për bllokadë duket të jenë të natyrës politike, të orientuara kundër shqiptarëve të Luginës së Preshevës, të cilët veçanërisht kanë nevojë për pranimin e diplomave të tyre, duke qenë se studiojnë në Kosovë, në mungesë të Universitetit në gjuhën shqipe në Luginën e Preshevës në Serbi dhe të cilët kërkojnë të kthehen dhe të shërbejnë në sektorin e arsimit ose të punësohen në sektorë të tjerë publikë në Luginën e Preshevës.

Kadastr: Marrëveshja për kadastrën, e arritur më 2011, ende nuk ka filluar zbatimin. Megjithëse është miratuar Ligji për agjencinë teknike, në qershor 2016, për krahasimin dhe verifikimin e dokumenteve kadastrale që do të kthehen në Kosovë, Serbia ende nuk ka filluar zbatimin për t’i kthyer në Kosovë dokumentet e skanuara dhe verifikuara të kadastrave të Kosovës.

Edhe pse **rivitalizimi i plotë të Urës së Mitrovicës** dhe rivitalizimi i rrugës kryesore në Mitrovicën veriore ka përfunduar, për arsye të natyrës politike, pala serbe është duke e penguar hapjen e saj për qarkullim të lirë të këmbësorëve dhe automjeteve.

Zgjedhjet: Kosova i ka bërë të gjitha përgatitjet për zhvillimin e rregullt të procesit zgjedhor lidhur me zgjedhjet lokale në vend. Që nga zgjedhjet e kaluara lokale, të vitit 2013, është shënuar një përmirësim i dukshëm i qeverisjes në komunat në pjesën në veri të Ibrit, në përputhje me ligjet e Kosovës, përkundër faktit se Serbia ende nuk i ka shuar në tërësi strukturat paralele në Kosovë.

Integrimi i ish-pjesëtarëve të strukturave paralele: Integrimi i ish-policëve në Policinë e Kosovës në komunat në veri të Ibrit është përmbjllur me sukses. Sa i përket integrimit të individëve të ish, të ashtuquajturës “Mbrotjtje Civile”, Qeveria e Kosovës i ka përmbushur obligimet që burojnë nga marrëveshja. Në këtë kontekst sfidë e veçantë mbetet hapja e zyrave për këta punonjës në komunat në veri të Ibrit.

Lidhur me **Menaxhimin e integruar të kufirit (MIK)**, pala e Kosovës është duke e zbatuar në tërësi këtë marrëveshje, përfshirë ndërtesat e përhershme të IBM-it: në Merdarë ka përfunduar ndërtimi i pikë-kalimit kufitar, ndërtimi i të cilës kishte filluar më 16 shkurt 2017, ndërsa pala kosovare ka përfunduar të gjitha procedurat sa i përket ndërtimit të pikë-kalimit kufitar Mutivodë Pala serbe po përdor ndërtimet e përfunduara vetëm pjesërisht (pasi ata janë duke përdorur kabinat e kontrollit vetëm në njërin anë të objekteve). Ndërsa, në PKK-në Mutivodë pala serbe nuk po i përdorë aspak objektet. Për më tepër, Serbia ende nuk ka bërë ndonjë përparim në ndërtimin e 3 pikave të tjera të kalimit, përkatësisht: Jarinjë, Muqibabë dhe Dheu i Bardhë.

Sa i përket **telekomunikacionit**, në përgjithësi kjo marrëveshje është duke u zbatuar, dhe Qeveria e Kosovës është e gatshme të ndërmarrë të gjitha veprimet me qëllim të zbatimit të plotë të saj, duke siguruar edhe progresin për çështjet që po ngecin si: koordinimi i frekuencave ndërkufitare, interkoneksioni dhe roamingu mes operatorëve.

Lidhur me Marrëveshjen për avancimin e lirisë së lëvizjes, përkatësisht **Reciprocitetit për targat e regjistrimit të automjeteve**, marrëveshje që është arrit në shtator 2016 dhe ishte planifikuar të fillonte zbatimin më 15 nëntor 2016, për shkak të vonesave në miratimin e vendimeve të nevojshme lidhur me zbatimin e saj dhe zhvillimet e fundit politike duke rezultuar me zgjedhjet nacionale dhe krijimin e institucioneve të reja në vend, Kosova ka vonuar zbatimin e saj.

Në dhjetor 2015 Gjykata Kushtetuese ka nxjerrë një aktgjykim lidhur me Marrëveshjen për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. Qeveria e Kosovës gjithnjë do të veprojë në përputhje të plotë me Kushtetutën e Kosovës dhe vendimin e Gjykatës Kushtetuese.

Republika e Kosovës me datën 31 mars 2020 me vendimin nr. 01/20 ka hequr tarifën doganore 100% ndaj produkteve me origjinë nga Republika e Serbisë dhe Bosnje e Hercegovinës, tarifë e cila ishte vendosur nga Qeveria e shkuar si reagim ndaj qasjes ekonomike dhe politike të Serbisë dhe fushatës së vazhdueshme të saj për tërheqje të njohjeve të parandalim të anëtarësimit të Kosovës në organizata ndërkombëtare. Duhet theksuar që në vendimin e lartcekur theksohet fakti që pavarësisht hyrjes në fuqi të CEFTA-s, Serbia megjithatë ka vendosur një sërë barrierash tregtare jotarifore ndaj Republikës së Kosovës, duke përfshirë barrierat transit, barrierat teknike dhe barrierat politike, duke shkaktuar në këtë mënyrë deficit të lartë tregtar për Republikën e Kosovës.

Bosnja dhe Hercegovina akoma nuk ka ndryshuar qëndrimin e saj për njohjen e pavarësisë dhe sovranitetit të Kosovës. Përkundër faktit se shtetasit kosovarë duhet të pajiseshin me vizë për hyrje në Bosnje dhe Hercegovinë, autoritetet kosovare edhe pas pavarësisimit dhe krijimit të regjimit të vizave, nuk kishin aplikuar detyrimin për pajisje me viza të qytetarëve boshnjak për hyrje në Kosovë. Edhe pas vullnetit të mirë të Kosovës, autoritetet boshnjake nuk kishin reaguar pozitivisht, ku edhe më tej, vizat për qëndrim të shkurtër për shtetasit e Kosovës lëshohen vetëm me ftesë nga misionet e huaja diplomatike dhe të organizatave ndërkombëtare të akredituara në Bosnjë dhe Hercegovinë. Kështu, përmes një vendimi qeveritar të Republikës së Kosovës, në janar 2014, listës së shteteve, qytetarët të cilave kishin nevojë të pajisen me vizë për hyrje në territorin e Kosovës iu shtua edhe Bosnje e Hercegovina, ku aktualisht qytetarët boshnjak duhet të paraqiten tek ambasada e Kosovës në Tiranë për tu pajisur me vizë, ndërsa qytetarët e Kosovës pajisen me viza në ambasadën Bosnje e Hercegovinës në Shkup.

Pas vendosjes së masave reciproke, ka pasur përpjekje të vazhdueshme për të realizuar takime në nivel teknik për zgjidhje të problemit të vizave, por pa sukses për shkak të zhvillimeve dhe rrethanave politike në të dy vendet, e gjithashtu edhe për shkak të refuzimit nga zyrtarët e lartë të Bosnje e Hercegovinës. Megjithatë, institucionet e Kosovës vazhdojnë të jenë maksimalisht të përkushtuara dhe insistuese për zgjidhjen e kësaj çështjeje.

Përkundër arritjeve në rrafshin e marrëdhënieve ndërkombëtare, ende mbetin sfida të cilat vështirësojnë pozitën e Kosovës në rrafshin ndërkombëtar. Mosnjohja nga 5 vendet anëtare të BE-së paraqesin sfidë në rrugën e Kosovës drejt procesit të integritimit evropian. Gjithashtu mungesa e njohjeve të mjaftueshme pengon anëtarësimin e Kosovës në mekanizmat të tjerë ndërkombëtarë si në OKB, OSBE apo Këshill të

Evropës, si rrjedhojë Kosova nuk është në gjendje të përfitojë plotësisht nga mekanizmat e vlerësimit të konventave përkatëse.

Në kuadër të Procesit të Berlinit, në korrik 2018 në Samitin e Londrës u nënshkruan Deklaratat e Përbashkëta për Bashkëpunimin Rajonal dhe Marrëdhëniet e Fqinjësisë së Mirë dhe për Krimet e Luftës dhe Personat e Zhdukur, ku përmes kësaj Republika e Kosovës ka demonstruar gatishmërinë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të ndërsjella rajonale.

Në Samitin e Poznanit, mbajtur në korrik 2019, është shqyrtuar progresi në këto fusha të bashkëpunimit rajonal: ekonomia, inter-konektiviteti, marrëdhëniet e mira fqinjësore, pajtimi dhe çështje të hapura bilaterale dhe siguria. Është mirëpritur iniciativa e Kosovës dhe BeH për të qenë nikoqire të takimeve përgatitore në kuadër të procesit të Berlinit gjatë vitit 2020. Gjatë Samitit, në veçanti është darkoduar pakoja e ardhshme investuese për përmirësimin e konektivitetit në mes të shteteve të Ballkanit Perëndimor dhe atyre të BE-së. Nga 8 projektet e miratuara, Kosova përfiton nga projekti i destinuar për zhvillim të linjës hekurudhore 10, pra Korridori Orient/East-Med. Duhet theksuar që BE do të investoj me grant 180 milionë euro, nga 728.2 milionë euro sa planifikohet të jetë investimi i 8 projekteve për avancim të transportit rrugor, hekurudhor dhe sistemit energjetik. Pjesa tjetër e investimit do të mbulohet nga buxheti i vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe kreditë nga Banka Evropiane për Investime (EIB), Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD) dhe Banka Gjermane Zhvillimore (KfW).

Zbatimi i programeve të bashkëpunimit ndërkuftar: lidhur me këto programe shihni kapitullin 22 të acquis-së.

Objektivat prioritare afatmesme:

- Shtirja më tutje e rrjetit diplomatik në shtetet me fuqi rajonale dhe globale me qëllim të konsolidimit të subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës dhe anëtarësimit në organizata ndërkombëtare;
- Zgjidhja e fatit të personave të zhdukur, me theks në identifikimin e mbetjeve mortore dhe respektimin e kërkesave dhe të drejtave të familjeve të personave të zhdukur;
- Konsolidimi i bazës ligjore, përfshirë miratimin e legjislacionit dytësor si dhe plotësim ndryshimin dhe zbatimin e Ligjit për Persona të Zhdukur;
- Rregullimi i fushës së Mjekësisë Ligjore duke konsoliduar kornizën ligjore dhe duke krijuar regjistër qendror dhe për mbyllje të rasteve;
- Ngritja e kapaciteteve të qëndrueshme forenzike.

2. BLOKU 2: KRITERET EKONOMIKE

Plotësimi i kriterëve ekonomike për anëtarësim është i bazuar në kërkesat e dala në konkluzionet e Këshillit Evropian të vitit 1993 të quajtura si Kriteret e Kopenhagës. Ekonomia e tregut funksional është kriteri i parë ekonomik i Kopenhagës, i cili përfshin:

- Ekzistimin e një konsensusi të gjerë për politikën esenciale ekonomike;
- Arritjen e stabilitetit makroekonomik, përfshirë stabilitetin adekuat të çmimeve e qëndrueshmërinë e financave publike dhe bilancit të jashtëm të pagesave;
- Ndërveprimin e lirë të forcave të tregut të bazuar në mekanizmat e ofertës dhe kërkesës, përfshirë vendosjen e çmimeve dhe liberalizimin e tregtisë;
- Eliminimin e barrierave të qenësishme ndaj hyrjes dhe daljes nga tregu (në aspektin e krijimit të shoqërive të reja ose falimentimit të atyre ekzistuese);
- Ekzistencën e sistemit ligjor, përfshirë rregullimin e të drejtave të pronësisë dhe imponimin e zbatimit të ligjeve dhe kontratave;
- Konsensusin e gjerë për çështje kyçe të politikave ekonomike;
- Sektorin financiar të zhvilluar mjaftueshëm për të kanalizuar kursimet në investime produktive.

Kriteret e Mastrohitit, të njohura si kriteret ekonomike të konvergjencës, kanë të bëjnë me integrimin monetar në kuadër të Eurozonës, kurse shtetet që synojnë adoptimin e Euros duhet të përmbushin disa indikatorë makroekonomikë që matin:

- Stabilitetin e çmimeve përmes CPI;
- Qëndrueshmërinë dhe adekuatshmërinë e financave publike përmes limitimit të nivelit të deficitit buxhetor (në 3% të BPV) dhe nivelit të borxhit qeveritar në raport me BPV;
- Stabilitetin e normës afatgjatë të interesit; dhe
- Stabilitetin e normës së këmbimit.

Bazuar në konkluzionet e Këshillit për Çështje të Përgjithshme, KE në tre vitet e fundit ka nisur një qasje të re për të promovuar zhvillimin ekonomik dhe politik të Kosovës, të ngjashme me instrumentet dhe mekanizmat e vendeve anëtare. Në këtë kontekst, Strategjia e Zgjerimit për Kosovën (dhe Ballkanin në përgjithësi) bazohet në tri shtylla bazë, përfshirë qeverisjen ekonomike. Një nga instrumentet kryesore për të forcuar qeverisjen ekonomike është dialogu me BE përfshirë edhe përgatitjen e Programit për Reforma në Ekonomi. Andaj edhe vlerësimi i progresit në përmbushjen e kriterëve ekonomike do të jetë i ndërlidhur ngushtë me përmirësimin e qeverisjes ekonomike dhe programin e reformave ekonomike.

Si rezultat, objektivat dhe masat prioritare në kuadër të kriterëve ekonomike synojnë të reflektojnë substancën e reformave strukturore në Programin për Reforma në Ekonomi. Natyrisht, ato lidhen ngushtë me dokumentet strategjike si Programi i Qeverisë, strategjitë sektoriale dhe Strategjia Kombëtare për Zhvillim. Dokumenti inkorporon disa nga masat e rekomanduara në Raportin e KE-së për Kosovën dhe Nënkomitetin për Ekonomi, Çështje Financiare dhe Statistika.

Sa i përket përparimit në plotësimin e kriterëve ekonomike për anëtarësim, Kosova duhet të vazhdojë përpjekjet për krijimin e një ekonomie funksionale të tregut të aftë për t'u përballur me konkurrencën duke drejtuar buxhetin drejt investimeve që gjenerojnë rritje, dhe duke forcuar konkurrueshmërinë që do të kishte efekte pozitive në zvogëlimin e disbalancit të jashtëm. Duhet të vazhdojë privatizimi, dhe të punohet për rritjen e mbledhjes së tatimeve të brendshme. Qartësimi i procedurave të falimentimit do të kontribuonte pozitivisht në ekonomi. Ngjashëm, duhet të zhvillohet kapitali njerëzor për të reduktuar normën e lartë të papunësisë së burrave dhe grave, të luftohet ekonomia joformale dhe të adresohen faktorët bazë ligjorë dhe institucionalë që pengojnë qasjen e bizneseve në financa, si dhe avancimi i stabilitetit fiskal dhe përmirësimit të efikasitetit të shpenzimeve publike. Sipas gjetjeve të OSHC-ve që merren me çështje të barazisë gjinore, mungojë të dhënat statistikore sa i përket implikimeve gjinore të joformalitetit në ekonomi. Gjithashtu, në Anketën e Fuqisë Punëtore të ASK, mungojnë të dhënat sa i përket hendekut gjinor të pagave dhe ekonomisë joformale, të ndara sipas gjinisë, etnisë dhe sektorit përkatës. Në funksion të rritjes së kapacitetit për të qenë më konkurrues, ende ka nevojë për reforma të konsiderueshme përfshirë ndër të tjera edhe sektorin e energjisë dhe zhvillimin e sistemit të arsimit.

Kërkesat nga mekanizmat e tjerë të aderimit në BE

Sipas Raportit të KE-së për Kosovën – 2020, Kosova ka bërë progres të kufizuar dhe është në një fazë të hershme të zhvillimit të një ekonomie funksionale të tregut. Rritja ekonomike vazhdoi në vitin 2019, por situata e vështirë e tregut të punës dhe mungesa e diversifikimit ekonomik mbeten një sfidë. Përderisa qeveria ka respektuar rregullin fiskal në 2019, përbërja e shpenzimeve publike është përkeqësuar edhe më tej. Ulja e shpenzimeve kapitale, rritja e presioneve në lidhje me përfitimet shoqërore të synuara jo nga varfëria dhe rritja e pagave publike paraqesin rreziqe për financat publike dhe pengojnë zhvillimin e sektorit privat. Mjedisi i biznesit pati përmirësime të kufizuara. Zhvillimi i sektorit privat mbetet i kufizuar nga ekonomia e lartë joformale, gjyqësori i ngadaltë dhe joefikas, përhapja e lartë e korrupsionit dhe sundimi i përgjithshëm i dobët i ligjit. Perspektiva ekonomike e Kosovës filloi të përkeqësohej me shpejtësi në pranverën e vitit 2020, pasi kriza COVID-19 prishi rrjedhat financiare me diasporën.

Sipas Raportit, për të përmirësuar funksionimin e ekonomisë së tregut, Kosova në veçanti duhet të:

- Sigurojë hapësirë fiskale për të mbështetur rimëkëmbjen pas krizës, duke iu përmbajtur rregullit të pagave dhe duke respektuar kufirin e shpenzimeve të veteranëve të luftës;
- Përmirësojë mbikëqyrjen financiare dhe llogaridhënien e ndërmarrjeve shtetërore;
- Zbatojë masat përkatëse të mjedisit të biznesit, në veçanti thjeshtimin, bashkimin dhe heqjen e licencave dhe lejeve;
- Zbatojë masat aktive të tregut të punës për të mbështetur punësimin, për të rritur pjesëmarrjen në fuqinë punëtore dhe rritur formalitetin.

Konkluzionet e dala nga nënkomiteti i vitit 2020 kërkojnë të sigurohet stabilitet makroekonomik duke respektuar kufirin e shpenzimeve dhe deficitin nga rregullat fiskale si dhe duke zbatuar Konkluzionet e Përbashkëta të Miratuara së fundmi mbi Programin e Reformës Ekonomike 2020 të cilat synojnë sfidat strukturore të përkeqësuar nga pandemia COVID-19 dhe synojnë stimulimin e rimëkëmbjes ekonomike në terma afatshkurtër dhe afatmesëm dhe zbatimin e MSA-së. Sipas KE, të gjitha shpenzimet publike, përfshirë prokurimin, disbursimet për programin e rimëkëmbjes ose ndihmën shtetërore, duhet të bëhen në përputhje me parimet e transparencës dhe mbikëqyrjes së shpenzimeve publike.

2.1. Ekzistenca e ekonomisë funksionale të tregut

Qeverisja ekonomike

Qeveria ka program të veçantë për rimëkëmbje ekonomike, pasi, përveç ndikimit në shëndetin publik dhe në jetën e qytetarëve, COVID-19 do të shkaktojë një shok ekonomik, duke ndikuar negativisht në prodhim, punësim, të ardhura dhe eksporte. Për këtë arsye Qeveria e Kosovës do të ndërmarrë masa për rimëkëmbje ekonomike të cilat do të bazohen në një analizë të përgjithshme të ndikimit ekonomik të COVID-19. Këto masa do të përmbliidhen në kuadër të "Programit për Rimëkëmbjen Ekonomike pas Pandemisë COVID-19". Masat programore pritet të rezultojnë në rritje të aktivitetit ekonomik, sidomos në industrinë prodhuese, përpunuese dhe atë të shërbimeve, duke mbështetur zgjerimin e eksporteve, zvogëlimin e importeve dhe rrjedhimisht përmirësimin e bilancit tregtar të vendit. Paralelisht, Qeveria do të fokusojë resurset e veta në zbatimin e projekteve të mëdha zhvillimore, të cilat do të financohen përmes modaliteteve të ndryshme publiko-private. Zbatimi i këtyre projekteve përveç stimulimit afatmesëm, do të ndikojë në transformimin afatgjatë të strukturës ekonomike dhe në uljen e papunësisë.

Përgjatë mandatit, caqet programore të zhvillimit do të përkthehen në caqe vjetore të rritjes përmes Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve, planit vjetor të punës së Qeverisë, dhe Buxheteve vjetore.

Sa i përket kornizës së politikave, Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 është një nga dokumentet bazë të politikave në planin afatmesëm. Financimi i këtyre politikave dhe objektivave prioritare pastaj konkretizohet në ndarje indikative të mjeteve për sektorët përkatës në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve. Programi fokusohet në pesë shtylla kryesore prioritare: i) sundimi i ligjit, ii) zhvillimi ekonomik dhe punësim, iii) politika e jashtme dhe integrimet euro-atlantike (politika e jashtme, dialogu

me Serbinë, Integrimi në BE, kontributi për siguri), dhe iv) zhvillimi sektorial (Arsimi, Shëndetësia, Infrastruktura, Mirëqenia Sociale, Kultura, Rinia dhe Sporti, dhe Mjedisi dhe Planifikimi Hapësinor).

Pjesë integrale e bashkëpunimit të përforcuar institucional në mes të Kosovës dhe BE-së është edhe pjesëmarrja në dialogun e strukturuar për qeverisjen ekonomike që zhvillohet midis vendeve kandidatë nga njëra anë, dhe institucionet e BE-së, veçanërisht Këshilli dhe Komisioni, nga ana tjetër. Në kuadër të këtij dialogu, Republika e Kosovës ka përgatitur edhe Programin e radhës për Reforma në Ekonomi (PRE) 2020-2022. PRE është mjet i cili ka për qëllim të përmirësojë qeverisjen ekonomike duke ofruar një kornizë të qartë në zbatimin e reformave. Dokumenti përbëhen nga një analizë makroekonomike dhe fiskale, si dhe kornizën e përgjithshme të reformave prioritare strukturore për sektorë të caktuar. Ky dokument është në ndërlidhje të drejtpërdrejtë me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim, dokumentet e tjera strategjike rreth reformave strukturore dhe menaxhimit të financave publike në planin afatmesëm.

Stabiliteti makroekonomik

Në vitet e fundit, Kosova shënoi norma mesatare të rritjes së BPV-së ndër më të lartat në rajon. Sipas të dhënave nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), aktiviteti ekonomik i matur përmes BPV-së gjatë vitit 2019 ka pasur një rritje reale prej 4.2% dhe 5.3% rritje nominale krahasuar me vitin paraprak. Ndërsa, për gjashtë muajt e parë të vitit 2020 të dhënat nga ASK tregojnë rënie të BPV-së prej 4.1% (1.3% në TM1 dhe -9.3% në TM2) krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019.

Në vitet e fundit, Kosova shënoi norma mesatare të rritjes së BPV-së ndër më të lartat në rajon. Sipas të dhënave nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), BPV në TM4 2020 shënoi rritje reale për 0.72%, krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak (TM4 2019). Aktivitetet ekonomike që kishin rritje në këtë tremujor ishin: industria nxjerrëse, përpunuese, energjia elektrike, dhe furnizimi me ujë (8.37%); informacioni dhe komunikimi (9.01%); aktivitetet e pasurive të paluajtshme (1.60%); artet, argëtimi dhe çlodhjet, dhe aktivitetet e tjera shërbimi (4.89%); administrimi publik, arsimi dhe shëndetësia (7.75%); aktivitetet profesionale dhe administrative (6.17%); tregtia, transporti, akomodimi dhe shërbimet ushqimore (1.92%); aktivitetet financiare dhe të sigurimit (25.26%). Ndërkaq, aktivitetet ekonomike që shënuan rënie në këtë tremujor ishin: ndërtimi (-16.05%); dhe bujqësia, pyjet dhe peshkimi (-0.31%). Komponentët e BPV-së sipas metodës së shpenzimeve që kishin rënie ishin: formimi i bruto kapitalit (-10.94%); eksporti i shërbimeve (-2.79%); dhe importi i shërbimeve (-3.58%). Ndërkaq, rritje në këtë tremujor kishin: eksporti i mallrave (49.44%); importi i mallrave (5.11%); shpenzimet e konsumit final të ekonomive shtëpiake dhe IJPSHESH (3.80%); dhe shpenzimet e konsumit final të Qeverisë (3.12%).

Tabela 2.1 Bruto Produkti Vendor Tremujor (milionë EUR)

	2019				2020			
	I	II	III	IV	I	II	III	IV
BPV Nominale	1,421	1,824	1,967	1,877	1,438	1,636	1,828	1,902
BPV Reale	1,404	1,790	1,952	1,860	1,440	1,655	1,825	1,890
Rritja reale e BPV %	4.24	4.13	4.38	3.94	1.31	(9.28)	(7.25)	0.72

Burimi: ASK

Rritja ekonomike në Kosovë drejtohet kryesisht nga konsumi privat. Kontributi i lartë i konsumit privat në PBB është si rezultat i të ardhurave të disponueshme, të tilla si rritja e kompensimit të brendshëm, kompensimi i punonjësve jashtë vendit, dërgesat e parave dhe kushtet e favorshme të kredive konsumatore që ndikojnë në rritjen e kredisë konsumatore, duke e bërë konsumin privat një të rëndësishëm faktori i rritjes ekonomike. Investimet publike dhe private gjithashtu luajnë një rol të theksuar në rritjen e BPV. Rritja e investimeve gjatë viteve është si rezultat i përmirësimit të vazhdueshëm të kushteve të huasë, gjithashtu për shkak të rikuperimit të investimeve të huaja direkte dhe rritjes së kapitalit të Fondit të Garantimit të Kredisë së Kosovës i cili lehtësoi qasjen në financa për NVM-të. Rritja e investimeve publike lidhet me rritjen e investimeve të financuara nga të ardhurat e likuidimit si dhe shkallën e lartë të ekzekutimit të projekteve nga këto fonde. Bilanci negativ tregtar i mallrave vazhdon të mbetet sfidë për ekonominë e Kosovës. Duke pasur parasysh që metalet zënë rreth 35% të të gjitha eksporteve të mallrave, rëndësia e diversifikimit më të lartë të mallrave eksportuese të Kosovës është rritur. Eksporti neto i

shërbimeve, në cilën kategori eksportet e shërbimeve të udhëtimit zënë rreth 80% të totalit. Kjo linjë kryesisht mat shpenzimet e diasporës së Kosovës gjatë qëndrimit të tyre në Kosovë (duke zbritur shpenzimet e banorëve kosovarë jashtë vendit për pushime dhe qëllime të tjera), shpenzimet e turistëve të huaj, si dhe eksportin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit, shërbimeve financiare si dhe transportit shërbimet e ofruara nga kompanitë e Kosovës.

Investimet gjatë vitit 2020 kanë rënë për shkak të ngërçit politik në fillim të vitit dhe pasigurisë në rritje në vend pas masave kufizuese për të parandaluar përhapjen e COVID-19. Ngadalësimi i investimeve publike në krahasim me vitet e fundit si rezultat i situatës së krijuar nga COVID-19, e cila krijoi nevojën për të bërë hapësirë fiskale në mënyrë që të përballojë kostot e nevojshme dhe thelbësore. Nga ana tjetër, konsumi kontribuoi pozitivisht, me kontribut më të lartë të konsumit privat, kryesisht për shkak të remitancave më të larta, tërheqjes së kursimeve të pensionit (10%), stimulit fiskal dhe rritjes së eksportit të mallrave. Eksportet e mallrave kanë shënuar performancë pozitive gjatë pandemisë, ndërsa importi i mallrave shënoi një rënie. Eksportet dhe importi i shërbimeve shënoi një rënie të ndjeshme, e nxitur kryesisht nga rënia e ndjeshme e eksporteve të shërbimeve të udhëtimit dhe transportit si rezultat i masave për kufizimet e udhëtimit.

Norma mesatare vjetore e inflacionit në vitin 2020 ishte 0.2%. Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit në vend në vitin 2020 ishte më i lartë në një mesatare prej 0.2%, krahasuar me vitin 2019. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit të nëngrupet e COICOP-it: bukë dhe drithëra (2.3%); mish (1.8%), ku secili nga këto nëngrupe ndikoi me 0.2 për qind në IHÇK; qumësht, djathë dhe vezë (1.8%); pemë (5.0%); kafe, çaj dhe kakao (5.4%); ujë, pije joalkoolike, lëngje nga pemët dhe perimet (1.7%); produkte mjekësore, aparaturë dhe pajisje (4.4%); shërbime telefonike dhe të telefaksit (2.2%); shërbime hoteliere (2.3%); sigurime (15.7%), që secili nëngrup ndikoi me 0.1 për qind në IHÇK; sheqer dhe ëmbëlsira (3.4%); duhan (1.3%); pajisje shtëpiake (1.0%); shërbimet ambulatorie (5.8%); kujdes personal (1.3%); gjërat personale (3.2%), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 0.2 për qind në IHÇK. Ndërsa, rënie e çmimeve vërehet te nëngrupet e COICOP-it: përdorim i pajisjeve për transportin personal (-12.0%) - "rënie e çmimeve të naftës dhe benzinës", me një ndikim prej (-0.9%) në IHÇK; perime (-5.6%), me një ndikim prej (-0.2%) në IHÇK; veshje (-1.2%); pajisje audio-vizuale, fotografike për përpunimin e informatave (-1.8%), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej (-0.1%) në IHÇK.

Sa i përket të dhënave për vitin 2021, indeksi i tërësishëm i çmimeve të prodhimit në Kosovë u ngrit për 1.5%, duke krahasuar TM1 2021 me TM4 2020. Ngritje më të mëdha sipas degëve të veprimtarive ekonomike vërehen te: nxjerrja e xehes së metalit (23.3%); prodhimi i metaleve (5.8%); energjia elektrike, gaz, avull dhe furnizimi me ajër të kondicionuar (2.9%); prodhimi i produkteve të fabrikuar metalike, përveç makinerisë dhe pajisjeve (2.4%); prodhimi i pajisjeve elektrike (1.9%); prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës (1.2%); prodhimi i letrës dhe produkteve prej saj (0.6%); produkteve minerale jo-metalike (0.5%); dhe prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t (0.4%). Ngritja u neutralizua me rënien e çmimeve te: prodhimi i mobilieve (-4.6%); prodhimi i produkteve kimike (-2.3%); prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej saj (-0.5%); përpunimi i produkteve ushqimore (-0.3%); grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë (-0.1%); dhe xeheroret dhe guroret e tjera (-0.1%). Çmimet e Prodimit në Kosovë u ngritën në një mesatare prej 2.0%, ndërmjet TM1 2021 dhe TM1 2020.

Bilanci i llogarisë rrjedhëse gjatë 5 viteve të fundit vazhdon të jetë negativ dhe vlerësohet të jetë rreth 7% e BPV-së në fund të vitit 2020. Ndërsa deficiti tregtar i mallrave dhe shërbimeve në vitet e fundit ka qenë rreth 27% të BPV-së deri në vitin 2020 ku ajo u rrit në 32% të BPV-së.

Një nga arsyt kryesore që kemi një deficit kaq të lartë të llogarisë rrjedhëse në pesë vitet e fundit është sepse vlera e importeve të mallrave është shumë e lartë dhe ka vazhduar të rritet me kalimin e viteve. Megjithatë në vitin 2020 kishte një rënie të importeve për shkak të pandemisë që shënoi një rënie prej 9% krahasuar me vitin e kaluar. Vlera e importeve në fund të vitit 2019 arriti në 40% të BPV-së ndërsa në vitin 2020 kishte një rënie në 38% të BPV-së. Ndërsa eksportet e mallrave të cilat kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në uljen e deficitit tregtar dhe rrjedhimisht deficiti i llogarisë korente ka pasur një trend rritës sidomos gjatë vitit 2020 ku ato arritën vlerën prej 475.1 milion euro, e cila është më e lartë gjatë këtyre viteve ose

përkatësisht 7% e BPV . Gjithashtu eksporti i shërbimeve ka treguar një trend pozitiv në rritje në vitet e fundit, i cili është rritur gjatë pesë viteve të fundit, me përjashtim të vitit 2020 ku pësoi një rënie të lartë. Vlera e eksporteve të shërbimeve në fund të vitit 2020 arriti rreth 15% të BPV-së, ndërsa në vitin 2019 vlera e eksporteve të shërbimeve ishte rreth 24% e BPV-së. Konkretisht, rënia e eksporteve të shërbimeve i atribuohet rënies së shërbimeve të udhëtimit për shkak të mbylljes së kufijve. Kjo pasi shërbimet e udhëtimit zënë pjesën më të madhe të eksporteve të shërbimeve në Kosovë.

Një tjetër komponent që është i rëndësishëm në sektorin e jashtëm dhe që ndikon në uljen e deficitit të llogarisë korente janë remitancat që kanë pasur një trend rritës gjatë 5 viteve të fundit. Në vitin 2020 remitancat u rritën lehtë dhe ishin rreth 14% të BPV-së.

Sa i përket **borxhit publik**, korniza parësore ligjore për menaxhimin e borxhit shtetëror është Ligji për Borxhin Publik nr. 03/L-175 i miratuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës me 29 dhjetor 2009. Ky Ligj i krijon të drejtën Republikës së Kosovës “për të marrë hua, për të dhënë garanci për hua, për të paguar shpenzimet për marrjen e borxhit dhe për të paguar kryegjënë dhe interesin e Borxheve të saja Shtetërore”. Për më shumë, sipas Ligjit, shumta e papaguar e borxhit të përgjithshëm në asnjë rast nuk duhet të tejkalojë 40% të Bruto Produktit Vendor (BPV). Si rrjedhojë e pandemisë COVID-19, Qeveria vendosi të ndryshojë rregullat fiskale: deficitin fiskal si përqindje e BPV-së është ndryshuar nga 2% në 6.5% dhe bilanci bankar si përqindje e BPV-së është ndryshuar nga 4.5% në 3%.

Portofoli Aktual i Borxhit Shtetëror: Portofoli i përgjithshëm i borxhit aktualisht përbëhet nga borxhi shtetëror i Republikës së Kosovës, i cili më tej përbëhet nga borxhi i brendshëm dhe borxhi ndërkombëtar. Sipas tabelës së mëposhtme, borxhi i shtetit deri më 30 shtator 2020 është 1, 341.71 milionë euro, që përfaqëson 19.87% të BPV-së (përfshirë garancitë e qeverisë). Nga shumta e përgjithshme e borxhit total shtetëror, 429.61 milionë euro janë borxh ndërkombëtar.

Tabela 2.2. Gjithsej borxhi i Qeverisë (në milionë euro dhe si përqindje e BPV-së)


	2016	2017	2018	2019	2020	2021 (TM1)
Borxhi ndërkombëtar	373.77	422.15	416.43	409.10	525.80	516.75
Borxhi i brendshëm	478.97	574.27	676.62	791.94	961.90	1,011.72
Borxhi total	852.74	996.42	1,093.05	1,201.05	1,487.69	1,528.48
Borxhi total (% e BPV)	14.38%	16.22%	16.90%	17.51%	21.83%	21.78%

*Përfshin edhe shumën e garancive shtetërore

Në fund të vitit 2020 Borxhi i Përgjithshëm arriti vlerën 1,487.69 miliardë euro që krahasuar me vitin paraprak shënoi një rritje prej rreth 23.87%. Rritja e lartë është si rrjedhojë e disbursimeve prej 215.33 milion Euro gjatë vitit 2020 (prej të cilave 177.41 milionë Euro për menaxhimin e pandemisë Covid-19) si dhe emetimet e reja të Letrave me Vlerë në kuadër të Borxhit të Brendshëm prej 169.95 milion Euro. Vlen të theksohet që gjatë dy viteve të fundit treguesi Borxh/BPV ka pas rritje, në fund të vitit 2019 ishte 17.51% ndërsa në fund të vitit 2020 ishte 21.83%. Në anën tjetër shërbimi i borxhit ishte 88.71 milion Euro.

Gjatë vitit 2020 Borxhi Ndërkombëtar ka shënuar rritje për 28.52% krahasuar me vitin paraprak, kjo për arsye se shumta e shlyerjes/shërbimit të borxhit ndërkombëtar gjatë vitit 2020 ishte 88.71 milion Euro ndërsa shumta tërheqjeve ishte 215.33 milion Euro. Përgjatë vitit 2020 tërheqjet në shumat më të larta janë realizuar nga kreditori ANZh, FMN, BE, dhe pjesë më të vogla nga BZhKE, UniCredit dhe BIZh, siç edhe mund të shihen në Shtojcën 3. Borxhi Ndërkombëtar në fund të vitit 2020 shënoi shumën 525.80 milion Euro, që paraqet rreth 35% të total Borxhit Shtetëror apo 7.55% e BPV-së. Pjesa më e madhe apo rreth 70% e portofolit të Borxhit Ndërkombëtar është ndaj ANZh-së, BNRZh-së dhe FMN-së.

Diagrami 1. Trendi i Borxhit të Përgjithshëm 2016 – TM1 2021



Sa u përket **politikave fiskale**, shuma totale e të ardhurave të Qeverisë së Përgjithshme në TM4 2020 ishte 703.2 milion Euro. Shumica e të ardhurave janë taksa për produktet që përfaqësojnë 52.2% të të ardhurave totale, ndërsa pjesa tjetër i atribuohet kategorive të tjera të të ardhurave.

Shuma e shpenzimeve të Qeverisë së Përgjithshme në TM4 2020 ishte 817.1 milion Euro. Pjesa më e madhe e shpenzimeve përbëhet nga kontributet dhe përfitimet shoqërore (21.3%); kompensimi i punonjësve (20.9%); formimi i kapitalit bruto (16.6%); dhe konsumi i ndërmjetëm (10.8%). Ndërsa pjesa tjetër e shpenzimeve janë shpërndarë në kategoritë të tjera të shpenzimeve.

Është aprovuar vendimi i qeverisë për tejkalimin e përkohshëm të tavanit të deficitit buxhetor në -6.5% të PBB-së dhe uljen e tavanit të përdorshëm të bilancit bankar në 3% të BPV-së, për shkak të përkeqësimit të parametrevave makro-fiskalë të shkaktuar nga situata globale e pandemisë COVID-19. Bilanci bankar ishte në 234.4 milion EUR deri në fund të vitit 2020, ndërsa deficitin fiskal ishte 5.2%.

Ndikimi i pandemisë COVID-19 në ekonominë e Kosovës

Në një periudhë relativisht të shkurtër, situata dhe perspektiva ekonomike në Kosovë ka ndryshuar në mënyrë dramatike si pasojë e ndikimit të pandemisë në të gjitha sferat e ekonomisë, në disa më shumë e në disa më pak. Masat apo vendimet e ndërmarra nga qeveria pas paraqitjes së rasteve të para (kufizimi i lëvizjes dhe udhëtimit të njerëzve, ndalimi i veprimtarisë për një sërë aktiviteteve biznesore, mbyllja e shkollave, etj.) me qëllim parandalimin e përhapjes së mëtejshme të COVID-19, kanë pasur ndikim të ndjeshëm negativ në indikatorët kryesorë ekonomikë.

Më 30 mars 2020, Qeveria e Republikës së Kosovës miratoi Vendimin për Pakon Emergjente Fiskale, e cila kishte për qëllim të adresojë problemet ekonomike-sociale të shkaktuara nga pandemia COVID-19. Kjo pako konsistonte me gjithsej 15 masa, të cilat kishin si qëllim ndihmesën e menjëhershme të qytetarëve apo të atyre bizneseve që janë dëmtuar më së shumti nga kufizimet e vendosura nga qeveria në lidhje me kufizimin e ushtrimit të aktivitetit ekonomik për disa sektorë dhe të lëvizjes së qytetarëve. Synimi i këtyre masave nuk ishte kompensimi i të gjitha efekteve negative por orientohet drejt minimizimit të dëmeve të shkaktuara nga kjo situatë emergjente e shëndetit publik. Kjo pako kishte vlerë 180 milionë Euro.

Paketa u zgjerua më vonë si pjesë e Programit të Reformës Ekonomike dhe deri në fund të Tetorit, rreth 210 milionë Euro në total janë disbursuar në lidhje me zbatimin e masave të pandemisë. Faktor tjetër që ka kontribuar në të ardhura shtesë për buxhetin për shkak të COVID, është një grant shtesë nga Bashkimi

Evropian. Sidoqoftë, kriza ka sjellë nevojën për financim shtesë. Qeveria ka marrë financim shtesë në vlerë prej 207 milionë Euro në vitin 2020, dhe kjo ka kontribuar në një rritje të borxhit publik si shihet edhe në grafikonin më lartë. Edhe pse në muajin qershor 2020 janë liruar masat kufizuese, vlerësimi i ndikimit të pandemisë në ekonominë e Kosovës vazhdon të jetë sfidues pasi që ekzistojnë një sërë pasigurish të mëdha në lidhje me zhvillimet në ekonominë e jashtme dhe veçanërisht në vendet fqinje, stimujve fiskalë që ndërmerren nga autoritetet përkatëse (siç është rasti i Pakos Emergjente Fiskale dhe Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike) etj.

Duke marrë parasysh të gjitha rrethanat, aktiviteti ekonomik real për vitin 2020 është vlerësuar të jetë në negativ, rreth 6.7%, me goditjen më të madhe të reflektuar në tremujorin e dytë dhe të tretë. Rënia me 6.7% e BPV-së reale gjatë vitit 2020 i atribuohet kryesisht rënies së investimeve private (me një kontribut negativ prej rreth 4.1 p.p) dhe rënies së eksporteve të mallrave dhe shërbimeve (me një kontribut negativ prej rreth 4.9 p.p. Një prej kanaleve kryesore të transmetimit të krizës është rënia e madhe e eksporteve të shërbimeve, veçanërisht të eksportit të udhëtimeve. Konsumi privat gjithashtu vlerësohet të ketë një kontribut negativ në rritjen reale ekonomike, me rreth 0.3 p.p, si rezultat i të ardhurave më të ulëta në dispozicion, kursime paraprake për shkak të rritjes së pasigurisë së konsumatorit për të ardhmen dhe natyrën e masave kufizuese për të parandaluar përhapjen e COVID-19. Kontributi i konsumit publik pritet të jetë lehtësisht më pozitiv (me rreth 0.18 p.p). Investimet publike pritet të ngadalësohen krahasuar me vitin e kaluar (me një kontribut negativ në rritjen ekonomike prej rreth 1.7 p.p), si rezultat i situatës së krijuar nga COVID-19 dhe si rezultat i vitit të mëparshëm i karakterizuar me ngërçe politike, gjë që çoi në vonesa të miratimit të Ligjit të Buxhetit për vitin 2020.

Pavarësisht rritjes në numrin e infeksioneve dhe rivendosjes së masave kufizuese në tremujorin e fundit të vitit, treguesit e tërthortë për konsumin privat (remitancat, kreditë e reja konsumuese, mbledhja e TVSH-së) tregojnë për një përmirësim të dukshëm në TM4. Një pritje e tillë mbështetet gjithashtu nga tërheqja e konsiderueshme (10%) e kursimeve të pensionit në dhjetor, e cila u bë e mundur me miratimin e Ligjit të Rimëkëmbjes Ekonomike.

Indeksi i Çmimeve të Konsumit pritet të luhatet rreth nivelit 0.2% gjatë vitit 2020, duke qëndruar ndjeshëm më poshtë se niveli i shënuar në vitin 2019 (2.7%). Presionet inflacioniste në kategorinë e “ushqimeve dhe pijeve alkoolike” që mund të vijnë nga shtrembërimet në zinxhirin ushqimor pritet të dominohen nga presionet disinflacioniste që mund të vijnë nga heqja e tarifës 100% ndaj produkteve të Serbisë dhe të Bosnjës & Hercegovinës dhe nga rënia drastike e çmimeve të mallrave bazike (nafta, metale bazë, etj.) në tregjet ndërkombëtare.

Parashikimet makroekonomike për periudhën 2021-2023

Gjatë vitit 2021, ekonomia e Kosovës pritet të rritet me një normë reale mbi trendin e vet historik, me rreth 5.4%, ndërsa, në vitet 2022-2023 rritja ekonomike do të luhatet rreth nivelit prej 4.1%. Remitancat priten të vazhdojnë me një ecuri rënëse edhe në vitin 2021, duke pasur parasysh reagimin me vonesë kohore të remitencave ndaj zhvillimeve ekonomike; si dhe efektin bazë të vitit 2020, ndërkohë që në 2022 ecuria e tyre pritet të stabilizohet.

Kontributi kryesor në rritjen ekonomike në 2021 vjen kryesisht nga eksporti, veçanërisht ai i shërbimeve (me rritje prej 20%), investimet private (me rritje 10.4%), dhe nga konsumi privat (me rritje prej 1.4%). Gjatë vitit 2021, gjithashtu pritet një dinamikë më e shpejtë e ekzekutimit të investimeve publike, me rritje rreth 33.7%. Megjithatë, sa më shumë të zgjasë periudha e distancimit social apo izolimit, aq më të vogla janë gjasat për një rimëkëmbje të ekonomisë.

Gjatë vitit 2021 inflacioni pritet të jetë rreth 1.8%, ndërsa në periudhën 2022- 2023, inflacioni pritet të luhatet rreth nivelit 1%.

Funksionimi i tregut të produkteve

Mjedisi afarist

Ligji nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare ka për qëllim përcaktimin e llojeve të shoqërive tregtare përmes së cilave mund të zhvillohen veprimtaritë ekonomike në Kosovë; subjekteve të tjera që kërkohet të regjistrohen në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës; organizimit, kompetencave dhe funksioneve të Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës; kërkesave, kushteve dhe procedurave të regjistrimit dhe çregjistrimit, për secilin lloj të shoqërive tregtare; organizimit të shoqërive tregtare; dhe të drejtave dhe detyrimeve të aksionarëve, përfaqësuesve të autorizuar, pronarëve, drejtorëve, menaxherëve, dhe palëve të treta në lidhje me Shoqëritë Tregtare.

Sa i përket **kornizës institucionale**, institucioni bartës për këtë është Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK) në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë. ARBK kryen regjistrimin e të gjitha organizatave të biznesit vendore dhe të huaja në përputhje me Ligjin nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare. Agjencia siguron informacion dhe bashkëpunon me Zyrën e Statistikave, Administratën Tatimore, Doganat, Shërbimin Policor dhe agjencive të tjera. Më tej, ajo regjistron të gjitha bizneset e reja, modifikimet e të dhënave të biznesit, mbylljes së bizneseve, lëshimin e certifikatës së regjistrimit me numër fiskal, certifikatën e tatimit mbi vlerën e shtuar, certifikatën e import-eksportit, si dhe ofron informata dhe formularët falas.

Lidhur me **kapacitetet administrative** të ARBK-së, agjencia përbëhet nga drejtoria për çështje administrative dhe regjistrimit të biznesit dhe 3 sektorë (aprovuesit, përpunimi i të dhënave dhe kolaterali). Përveç kësaj, ajo ka hapur 29 qendra komunale afariste one stop shop.

Sa u përket politikave dhe reformave, Kosova ka bërë përparim në lehtësimin e fillimit të një biznesi dhe lehtësimin e ofrimit të shërbimeve përmes konceptit one stop shop. Procedurat për hapjen e biznesit janë thjeshtësuar dhe shkurtuar dhe kjo mund të bëhet në cilëndo qendër komunale të ARBK-së varësisht nga lokacioni i shtrimit të aktivitetit të entitetit aplikues. Për bizneset individuale dhe ortakëritë, regjistrimi bëhet brenda 1 (një) dite. Ndërsa për shoqëritë aksionare dhe ato me përgjegjësi të kufizuar regjistrimi bëhet brenda 2-3 ditëve. Kjo evidentohet edhe në Raportin e fundit të 'Të Bërit Biznes 2020' të Bankës Botërore ku Kosova ka pasur përparim sa i përket nisjes së biznesit duke u ranguar në pozitën e 12.

Në vlerësimin e përgjithshëm të 'Të Bërit Biznes 2019', Kosova ka pasur një përmirësim në rangim duke shënuar 71 pikë në vitin 2019, ndërsa pritet të shënojë 73.2 pikë në vitin 2020. Sa i përket pagesës së taksave Kosova është në vendin e 48, ndërsa për tregti ndërkuftare në vendin e 31. Sidoqoftë, vështirësitë kryesore për bizneset mbetet qasja në financa, në veçanti për bizneset e udhëhequra nga gratë, zgjidhjet efektive të kontesteve në sistemin gjyqësor, furnizimi me energji elektrike dhe zbatimi i kontratave. Një nga çështjet që pengon zhvillimin e biznesit është edhe shkalla e joformalitetit në ekonomi.

Mjedisi afarist, sistemi gjyqësor dhe kapacitetet administrative

Sistemi gjyqësor është faktor shumë i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të vendit dhe luan rol kyç në lehtësimin e investimeve, mbrojtjen adekuate të të drejtave kontraktuale të bizneseve dhe rritjen e sektorit privat. Ky sistem është i rregulluar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjin për gjykatat, Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës. Ligji për gjykatat ka përcaktuar 7 gjykata Themelore të shkallës së parë në territorin e Republikës së Kosovës. Gjykata Themelore janë të ndara në rajone dhe atë si vijon: Gjykata Themelore e Prishtinës, Gjykata Themelore e Gjilanit, Gjykata Themelore e Prizrenit, Gjykata Themelore në Gjakovë, Gjykata Themelore e Pejës, Gjykata Themelore e Ferizajt, dhe Gjykata Themelore e Mitrovicës.

Organizimin e Brendshëm të Gjykatës Themelore ligji për gjykatat ka përcaktuar si në vijim:

- Departamenti për Çështjet Ekonomike që vepron në Gjykatën Themelore në Prishtinës, për gjithë territorin e Republikës së Kosovës;
- Departamenti për Çështjet Administrative që vepron në Gjykatën Themelore në Prishtinës, për gjithë territorin e Republikës së Kosovës;
- Departamenti për Krimet e Rënda që vepron në selinë e secilës Gjykatë Themelore;
- Departamenti i Përgjithshëm që vepron në selinë e secilës Gjykatë Themelore, si dhe në secilën degë të Gjykatës Themelore;
- Departamenti për të Mitur, që vepron në kuadër të gjykatave themelore.

Ligji për gjykata ka përcaktuar Gjykatën e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, me juridiksion territorial në gjithë Republikën e Kosovës e cila ka në strukturën e saj organizative edhe Departamentin për Çështje Ekonomike. Gjykata Supreme e Kosovës është instanca më e lartë gjyqësore në Kosovë. Gjykata Supreme përfshin kolegjin e apelit të Agjencisë Kosovare të Pronës si dhe Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme. Sa i përket të drejtës së pronës, neni 119, pika 1 e Kushtetutës së Republikës së Kosovës siguron një mjedis të favorshëm ligjor për ekonominë e tregut, lirinë e aktiviteteve ekonomike dhe sigurinë e pronës publike dhe private. Me këtë, forma e pronës publike dhe pronës private njihet si kategori kushtetuese. Me Kushtetutë garantohet e drejta e pronësisë, dhe ofrohen garanci të cilat përjashtojnë mundësinë e privimit në mënyrë arbitrare nga prona. Pasi që llojet e pronës janë përcaktuar me Kushtetutë, rregullimi i përmbajtjes së tyre i delegohet legjislativit. Legjislativi ka nxjerrë Ligjin nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat e tjera Sendore, i cili rregullon krijimin, përmbajtjen, bartjen, mbrojtjen dhe shuarjen e të drejtave sendore si dhe rregullon pronësinë dhe të drejtat sendore të kufizuara si posedimin, të drejtat sendore të sigurimit si dhe të drejtat sendore të shfrytëzimit, ndërsa ende nuk ka një ligj që rregullon pronën publike në përgjithësi. Hulumtime të ndryshme tregojnë që gratë dhe vajzat kanë qasje më të kufizuara në pronë.

Më 2018 është miratuar ligji për trashëgiminë dhe noterinë. Gjithashtu, në nëntor të vitit 2019 është miratuar UA nr. 10/19 për matjet kadastrale për regjistrim në kadastrë, UA nr. 09/19 për ndarjen e zonave kadastrale. Me qëllim të thjeshtësimit të procedurave të regjistrimit dhe uljes së kostos përkatëse, më 2019 është miratuar UA nr. 08/2019 për tarifën e produkteve dhe shërbimeve të agjencisë kadastrale të Kosovës.

Krijimi i një sistemi efektiv dhe të barabartë të përcaktimit të të drejtave pronësore krijon siguri ligjore për investitorët dhe rrjedhimisht rrit mundësitë për investime, ndërsa kjo u krijon shtetasve më shumë mundësi për të përdorur pronën si kolateral dhe për këtë arsye përmirëson qasjen në financa, dhe kontribuon në pavarësimin financiar të grave në Kosovë. Në përgjithësi, ndikimi përfshin gjithashtu përmirësimin e indikatorëve të Bankës Botërore për mjedisin afarist, sikurse: ulja e kostos së regjistrimit të pronës, ulja e numrit të përgjithshëm të procedurave me ligj për regjistrimin e pronës, numrin e ditëve që nevojitet për regjistrimin e pronës, përmirësimin e indeksit të administrimit të tokës (besueshmëria e infrastrukturës, transparenca e informatave, mbulimi gjeografik dhe zgjidhja e kontesteve mbi tokën).

Në kuadër të **reformës së sistemit të drejtësisë**, për të ngritur efikasitetin e gjyqësorit, në Programin Kombëtar për Reforma në Ekonomi 2021-2023 dhe Programin Legjislativ për vitin 2021 është planifikuar themelimi dhe funksionalizimi i Gjykatës Komerciale, ku qëllimi kryesor është rritja e efikasitetit në zgjedhjen e kontesteve komerciale, si adresë e vetme për zgjidhjen e të gjitha kontesteve komerciale të bizneseve dhe investitorëve të huaj.

Korniza ligjore **për fushën e ndërmjetësimit** rregullohet me Ligjin nr. 06/L-009 për ndërmjetësim. Praktika e deritanishme e zbatimit të formave alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ka rezultuar shumë i mirë. Mirëpo, nga analizat dhe rekomandimet e sugjeruara në praktikë është konkluduar se duhet të ketë një koordinim më të mirë në mes të qendrës së ndërmjetësimit si dhe Gjykatës apo Prokurorisë dhe të sqarohet më tepër roli dhe rëndësia e qendrës së ndërmjetësimit, tarifën e administrimit të rastit të ndërmjetësuar në një qendër të ndërmjetësimit, dhe mbulimi i kostos financiare nga buxheti i Republikës së Kosovës.

Një ndër inovacionet e **procedurës përmbartimore**, dhe e cila ndikon në zbatueshmërinë e vendimeve, është arritur me anë të ligjit nr. 05/L-118 për amendamentimin e ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, i cili zhvendosi përmbartimin prej gjykatave tek përmbartuesit privatë, të cilët emërohen nga Ministria e Drejtësisë (MD) për kryerjen e autorizimeve publike të besuara, në përjashtim të kompetencës për të vendosur në procedurën e përmbartimit dhe të zbatojnë përmbartimin në të gjitha çështjet nga e drejta familjare dhe kthimin e punëtorëve dhe shërbyesve civilë në punë dhe kompensimet e tjera.

Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës (AKKVP) është themeluar me miratimin nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 9 qershor 2016, të Ligjit 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, i cili ka hyrë në fuqi në nëntor të vitit 2016. AKKVP është agjenci e pavarur e themeluar sipas nenit 142 të Kushtetutës, me mandat të pranojë, krahasojë dhe përmes Komisionit për Verifikim dhe Vendosje për Prona (KVVP) të zgjidhë dallimet dhe papajtueshmëritë në mes

të dokumenteve kadastrale origjinale të para qershorit 1999, të cilat janë marrë nga Kosova nga autoritetet serbe dhe të dokumenteve kadastrale aktuale në Republikën e Kosovës, për pronën private, pronën private komerciale dhe pronën private të bashkësive fetare.

Me themelimin e AKKVP, Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP) ka pushuar së ekzistuari. Sipas Ligjit për AKKVP, përveç mandatit të ri të dhënë, Agjencisë do t'i barten të gjitha kompetencat e AKP përfshirë buxhetin, obligimet kontraktuale si dhe asetet fizike. Sipas ligjit 05/L-010, AKKVP do të trashëgojë edhe mandatin e AKP. Rrjedhimisht, AKKVP do të ketë për mandat që përmes Komisionit për Kërkesa Pronësore (KKP) të zgjidh kërkesat e pronësisë dhe kërkesat lidhur me të drejtat mbi shfrytëzimin (me të drejtë ankese në Gjykatën Supreme të Kosovës) lidhur me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale (kërkesa këto të lidhura me luftën në Kosovë, përfshirë rrethanat që drejtpërsëdrejti janë të ndërlidhura me të ose janë pasojë e saj në periudhën ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999), e të cilat më herët janë dorëzuar në AKP. Mandati i trashëguar nga AKP përfshin edhe autoritetin ekzekutiv të zbatimit të vendimeve të AKP-së dhe në këtë pikëpamje, përveç vendosjes, AKKVP do të ketë në mandatin e saj edhe autoritetin ekzekutiv të zbatimit të vendimeve të AKP dhe Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore.

Sfidat kryesore të sistemit gjyqësor në Kosovë bazuar edhe në raportet ndërkombëtare përfshirë Raportin për Vendin konsistojnë në zbatimin efektiv të kornizës gjyqësore, forcimin e kapaciteteve për funksionim efektiv dhe zgjidhjen e numrit të madh të lëndëve të grumbulluara. Kjo do të kontribuonte në përmirësimin e ambientit për të bërë biznes.

Sa i përket **të drejtës së regjistrimit të pronës përmes sistemit kadastral**, regjistri i të drejtave të pronës së paluajtshme rregullohet me legjislacionin e mëposhtëm:

- Ligji mbi Hipotekat nr. 2002/4;
- Ligji mbi Themelimin e Regjistrimit të të Drejtave mbi Pronën e Paluajtshme nr. 2002/5;
- Ligji për Kadastrën nr. 04/L-013;
- Ligji nr. 04/L-009 për amendamentimin e Ligjit 2002/5 për themelimin e regjistrimit të të drejtave të pronës së paluajtshme;
- Ligji nr. 04/L-071 për sistemin e adresave;
- Ligji mbi Plotësimet dhe ndryshimet e Ligjit të RDPP 2003/13.

Sipas Ligjit për Barazi Gjinore, kjo rregullativë duhet të sigurojë që të gjitha të dhënat e sistemit kadastral duhet të jenë të ndara sipas gjinisë.

Ndërsa legjislacioni zbatues përbëhet nga rreth 15 udhëzime administrative. Të drejtat pronësore regjistrohen duke u mbështetur në dispozitat e Ligjit nr. 04/L-009 për Regjistrin e të drejtave të pronës së paluajtshme, sipas të cilit regjistrohen në bazë të:

- Vendimit të plotfuqishëm të gjykatës;
- Vendimit të organit administrativ shtetëror;
- Kontratës për bartjen e së drejtës së pronës së paluajtshme të vërtetuar nga organi kompetentë;
- Vendimit apo kontratës për privatizim të lëshuara nga Agjencia kosovare e privatizimit;
- Vendimit të Komisionit për rindërtimin e kadastrës;
- Vendimit të Komisionit për rregullimin e tokave; dhe
- Dokumentit tjetër që me ligje të veçanta parashihet regjistrimi i të drejtave pronësore.

Regjistri i kadastrave mbahet në formë elektronike në nivel vendi, ndërsa i gjithë dokumentacioni kadastral mbahet në nivel të komunave si dhe shërbimet qytetarëve iu ofron në afërsi me vendbanimin d.m.th. në secilën komunë.

Të drejtat e pronave të paluajtshme përfshijnë pronësinë, hipotekat, servitutet, të drejtat e shfrytëzimit të pronave komunale, publike, shoqërore dhe pronave shtetërore; dhe barrët dhe ngarkesat pronësore.

Agjencia Kadastrale Kosovës (AKK) është institucion publik për regjistrimin, mbajtjen dhe përditësimin e të drejtave të pronarëve mbi pronën e paluajtshme. Agjencia është autoriteti qendror për mirëmbajtjen e

bazës së të dhënave kadastrale, për mirëmbajtjen e regjistrave pronësorë, për hartografi dhe për GIS. Gjithashtu është autoriteti qendror për infrastrukturën e të dhënave gjeohapësinore. Ajo është përgjegjëse për certifikimin e personave në Zyrat Komunale Kadastrale dhe licencimin e kompanive e gjeodetëve për kryerjen e matjeve kadastrale. Organizimi është në nivel vendi dhe disa të drejta e detyrime janë të deleguara, sipas ligjit për kadastrë, në nivel lokal, përkatësisht në Zyrat Komunale Kadastrale. Aktivitetet e tyre janë të lidhura dhe pasqyrohen në bazën qendrore të të dhënave të Agjencisë.

Me ndihmën e qeverisë Norvegjeze është ndërtuar gjeoportali – një ueb-portal i cili paraqet informata gjeografike nga burime të ndryshme në mënyrë të unifikuar. Qëllimi kryesor i tij është ofrimi i shërbimeve online duke mundësuar qasje në të dhëna hapësinore për të interesuarit. Këto zhvillime të sistemit kadastral kontribuojnë në lehtësimin e ambientit afarist duke ofruar shërbime më të mira për regjistrimin dhe menaxhimin e pronës, planifikimin hapësinor, ndihmë në sistemin tatimor dhe në dizajnimin e politikave publike në shumë fusha. Gjithashtu kjo do t'i mundësojë sistemit gjyqësor zbatim më efikas të parimit të ligshmërisë dhe të drejtave pronësore.

Regjistrimi i të drejtave pronësore bëhet në Zyrat Komunale Kadastrale (ZKK) e cila evidencë monitorohet në bazë ditore, ndërsa publikohet çdo ditë ueb faqe te AKK-së.⁸ Afati ligjor për aplikim tek zyrat e kadastrave për transaksionet e shitblerjes, trashëgimisë, pengut është 30 ditë. Por bazuar në të dhënat e fundit të zyrave kadastrave ky proces kryhet mesatarisht për 10 ditë.

Kosova renditet në vendin e 37-të për regjistrimin e pronës në Raportin e Bankës Botërore “Të Bërit Biznes” 2020⁹. Koha që kërkohet për regjistrim të pronës së paluajtshme është 32 ditë (sipas Raportit Të Bërit Biznes 2020 të Bankës Botërore). Ndërsa kërkohen vetëm 6 procedura për regjistrim të pronës, dallim relativisht jo i madh në krahasim me numrin e procedurave në gjithë rajonin e Evropës dhe Azisë Qendrore.

Liberalizimi i çmimeve

Ligji nr. 05/L-184 për Rregullatorin e **Energjisë** përcakton kompetencat, detyrat dhe funksionet e Zyrës së Rregullatorit për Energji, përfshirë kushtet për dhënien e licencave për kryerjen e aktiviteteve në fushën e energjisë, certifikimin e aktiviteteve të operatorëve të transmetimit në sektorin e energjisë procedurat për dhënien e autorizimeve për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese, krijimin dhe funksionimin efikas të tregjeve konkurruese të energjisë, mbrojtjen e konsumatorit, si dhe kriteret për rregullimin e tarifave dhe kushtet për furnizim me energji. Bazuar në këtë ligj, rregullatori ka autoritetin dhe përgjegjësinë të miratojë metodologjitë tarifore të përgatitura nga Operatori i Sistemit të Transmisionit, Operatori i Tregut dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes për tarifën e vendosura për shërbimet e tyre të rregulluara të energjisë dhe të sigurojë se ato janë proporcionale dhe që zbatohen në mënyrë jodiskriminuese. Tarifat për konsumatorin fundor do të reflektojnë plotësisht koston nga ndërmarrja e energjisë.

Sa u përket **tarifave të shërbimeve publike të ujit dhe kanalizimit**, bazuar në Ligjin 05/L-042, tarifën vendosen nga rregullatori i ujit dhe mbeturinave bazuar në kërkesën dhe fizibilitetin e ofrimit të shërbimeve të ujit dhe mbeturinave si dhe duke marrë parasysh qëndrueshmërinë e çmimeve nga perspektiva e konsumatorëve. Ligji nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit është hartuar për këtë fushë dhe është miratuar nga Kuvendi i Kosovës, i publikuar më 14 janar 2016. Metodologjia për caktimin e tarifave është e rregulluar me Rregullën për Caktimin e Tarifave për Shërbimet e Ujësjetës dhe Kanalizimit dhe Furnizimit me shumicë (R-02/U&K).

ZRRUK aplikon tarifa tri-vjeçare të cilat mund të rikonfigurohen nëse e nevojshme. Rregullatori monitoron eficiencën operacionale dhe financiare për të siguruar që tarifën përmbushin standardet relevante të ofrimit të këtyre shërbimeve. Rregullatori ka hartuar Kartën e Konsumatorëve që parasheh zhvillimin e marrëdhënieve kontraktuale ligjore midis ofruesve të shërbimeve dhe konsumatorëve gra dhe burra. Pra, Karta vendos obligimet dhe të drejtat ligjore të pjesëmarrësve. Për të siguruar cilësinë e ujit, rregullativa obligon secilin ofrues të shërbimeve që të jetë i pajisur me laborator testues për kontrollin e kualitetit të ujit.

⁸ Të dhënat e përditësuara gjenden në <http://akk-statistics.rks-gov.net/>.

⁹ <https://www.doingbusiness.org/en/data/exploretopics/registering-property>.

Në bazë të Ligjit nr. 04/L-109 për **Komunikime Elektronike (LKE)**, ARKEP ka të drejtë që t'u imponojë ndërmarrjeve me fuqi të ndjeshme në treg detyrimin për kontrollimin e çmimeve dhe llogaritjen e kostos sipas dispozitave të nenit 35 të ligjit. Sipas nenit 40, rregullatori mund t'u imponojë ndërmarrjeve me fuqi të ndjeshme në treg (FNT) detyrimin për mbulimin e kostove dhe kontrollimin e çmimeve, përfshirë detyrimet për çmimet e bazuara në kosto dhe detyrimet lidhur me sistemet e llogaritjes së kostos, për ofrimin e llojeve specifike të interkonjeksionit dhe/ose qasjes, në situatë kur një analizë e tregut tregon mungesë të konkurrencës efektive që do të thotë që operatori përkatës mban çmimet në një nivel tepër të lartë, ose mund të zbatojë një ngjeshje të çmimeve, në dëm të shfrytëzuesve fundor. Në rast të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në mes të operatorëve lidhur me interkonjeksion, gjatë zgjidhjes së mosmarrëveshjes rregullatori vendos edhe për çmimet e interkonjeksionit.

Sipas Ligjit nr. 06/L-038 për **Shërbimet Postare**, të miratuar në janar 2019, ai rregullon kushtet dhe termat e përgjithshëm të ofrimit të shërbimit universal postar si dhe rregullon edhe tarifën e shërbimit universal postar dhe shërbimeve të tjera specifike, të përcaktuara me këtë ligj.

Sipas Ligjit nr. 04/L-063, NP Trainkos Sh.A. ka opsionin e **caktimit të tarifave për hekurudhat e Kosovës**.

Në **fushën e arsimit**, tarifën e institucioneve private të arsimit caktohen lirshëm nga ato institucione të ofrimit të shërbimeve të edukimit. Ndërsa sipas Ligjit për Arsimin e Lartë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASHTI) përmes legjislacionit sekondar cakton tarifën maksimale që duhet paguar për studentët në institucionet publike. Niveli i pagesës caktohet varësisht nga statusi rezidencial i studentit (Kosovë apo jashtë Kosovës), natyra dhe kostoja e programit të studimeve. Tarifën e arsimit të lartë përfshijnë tarifën e pranimit, pagesën vjetore, tarifën e ri-hyrjes në provime dhe pagesën për kartën studentore. Këto tarifa aprovohen nga institucionet përkatëse të arsimit dhe konfirmohen nga MASHTI.

Çmimet për **shërbimet shëndetësore** në sektorin privat caktohen dhe rregullohen me UA nr. 02/2019 - Rregullimi i Çmimit të Produkteve dhe Pajisjeve Medicinale, ndërsa çmimet e shërbimeve shëndetësore të ofruara nga sektori publik janë uniforme për të gjithë Kosovën. Ato caktohen nga Ministria e Shëndetësisë (MSh) bazuar në analizën e kostos materiale dhe kostos së punës. Rregullimi i çmimit të produkteve medicinale dhe caktimi i marzhave për produkte medicinale dhe pajisje medicinale bëhet nga Agjencia për Produkte dhe Pajisje Medicinale dhe Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me institucionet e tjera të qeverisë bazuar në Ligjin nr. 2013/04-L-190 për Produktet dhe Pajisjet Medicinale.

Ndikimi i shtetit në tregun e produkteve

Ministria e Ekonomisë ka iniciuar ndryshimin e bazës ligjore për Ndërmarrje Publike në vitin 2017. Mirëpo për shkaqe objektive, Projektligji për Ndërmarrje Publike i proceduar në Qeveri për miratim në vitin 2018, është kthyer në rishikim.

Aktualisht Ministria e Ekonomisë ka krijuar grupin punues me datë 26 gusht 2020, dhe në asistencë me EBRD dhe Deloitte është në fazën e rishikimit të Projektligjit për Ndërmarrje Publike, i cili është paraparë në Programin Legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2020. Për shkak të rrethanave të krijuara në vend nga pandemia globale Covid-19, projektligji parashihet të shtyhet për realizim gjatë gjysmës së parë të vitit 2021.

Përmes këtij Projektligji për Ndërmarrje Publike parashihet: të vendoset një standard i ri i formës së strukturës mbikëqyrëse të Aksionarit karshi Ndërmarrjeve Publike Qendrore, njëkohësisht Ndërmarrjeve Publike Lokale; standardizimi i llogaridhënies së Ndërmarrjeve Publike; hartimi i një strategjie të qartë gjithëpërfshirëse për Ndërmarrjet Publike; përcaktimi i detyrave dhe përgjegjësisë të Bordit të Drejtorëve dhe Zyrtarëve të lartë; përcaktimi i sanksioneve ndaj anëtarëve të Bordit të Drejtorëve dhe Zyrtarëve të lartë; rishikimi i procedurave të përzgjedhjes së Bordit të Drejtorëve dhe Zyrtarëve të lartë; formë e re e raportimit financiar dhe operativ, me theks të veçantë në menaxhimin e riskut; ristrukturimi, si një proces obligativ në periudhë të caktuar kohor; kompensimi dhe bonuset e BD dhe Zyrtarëve të lartë.

Me miratimin e Projektligjit të ri për Ndërmarrje Publike nga ana e Qeverisë, pasojnë procedurat e tjera për hyrje në fuqi nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, i cili do të pritët të ndodhë gjatë vitit 2021. Me Ligjin e

ri për Ndërmarrje Publike, parashihet edhe hartimi i akteve nënligjore, të cilat të rregullojnë dhe do të sjellin një çasje tjetër të Ndërmarrjeve Publike në raport me Aksionarin dhe publikun.

Në Kosovë funksionojnë 17 Ndërmarrje Publike në pronësi shtetërore, në të cilat aksionar është Qeveria e Republikës së Kosovës. Ndërmarrja e Re Energjetike e Kosovës Sh.A. (NKEC) është themeluar me 24.05.2018 dhe është regjistruar si Ndërmarrje Publike Qendrore, mirëpo kjo ndërmarrje nuk ka afarizëm operativ dhe financiar.

Ndërsa ndërmarrja Trepça, me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 05/L-120 për Trepçën është shndërruar në "Trepça Sh.A.", ku Qeveria e Republikës së Kosovës ka në pronësi 80% të aksioneve dhe 20% të aksioneve janë në pronësi të punëtorëve.

Në vitin 2020, ndërmarrjet publike të cilat kanë përfituar nga ndarja buxhetore për subvencione dhe investime kapitale janë:

- Sektori i transportit (Trainkos dhe Infrakos) në vlerë 996,779.24 EUR;
- Sektori i ujit dhe mbeturinave në vlerë 800,000 EUR.

Sa i përket ndihmës shtetërore, Ligji i ri nr. 05/L-100 për Ndhimën Shtetërore, miratuar më 2016, vendos bazën për zhvillimin e sistemit të ndihmës shtetërore, principet dhe procedurat për dhënien e saj. Ai vendos definicionet bazë, përfshirë atë të ndihmës shtetërore, mekanizmin e kornizën për kontrollin e ndihmës shtetërore, dhe bazën për themelimin e inventarit gjithëpërfshirës dhe sistemit të raportimit. Rregullat e acquis të kësaj fushe transpozohen përmes legjislacionit dytësor. Për më shumë rreth masave në këtë fushë, shihni Kapitullin 8 Politikat e Konkurrencës.

Privatizimi dhe ristrukturimi

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) është themeluar si një organ i pavarur publik i cili i ushtron funksionet dhe përgjegjësitë e saj me autonomi të plotë në bazë të Kuvendit të Kosovës sipas Ligjit nr. 04/L-034 për AKP-në, i cili është ndryshuar dhe plotësuar në maj të vitit 2018 me Ligjin nr. 06/L-023 mbi AKP-në me qëllim të lejimit të investimit të mjeteve të privatizimit në letrat me vlerë, me qëllim të rregullimit të trajtimit të "fondeve të mbetura", trajtimit të "fondeve të përkohshme" si të hyra në Fondin e Konsoliduar të Republikës së Kosovës dhe rregullimit të proceseve operative të Agjencisë.

Mandati i AKP-së është administrimi, shitja, transferimi dhe/ose ekzekutimi i likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore dhe asetëve të tyre. Për të përmbushur këtë mision, AKP mban dhe administron çdo ndërmarrje (sipas mandatit të saj), në mirëbesim dhe për të mirën e pronarëve dhe kreditorëve të tyre, dhe i shet ose likuidon ndërmarrjet dhe asetet në përputhje me ligjin. AKP është themeluar si trashëgimtare e Agjencisë së Mirëbesimit të Kosovës (AKM) dhe të gjitha asetet dhe detyrimet e kësaj të fundit janë transferuar si asete dhe detyrime të AKP-së.

Në përputhje me Ligjin nr. 04/L-034, privatizimi bëhet përmes dy metodave kryesore: Metodës së Spin Off-it dhe metodës së Likuidimit që ne e quajmë Shitje të Aseteve. Në përputhje me kërkesën e Qeverisë së Republikës së Kosovës si dhe situatën pandemike Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) që në muajin mars 2020 ka pezulluar të gjitha shitjet.

Në përgjigje të situatës së rënduar ekonomike si rezultat i pandemisë dhe duke iu bashkëngjitur vendimeve të institucioneve qendrore dhe lokale për mbështetjen e bizneseve, AKP ka lëshuar një vendim për lirimin nga detyrimet e qirasë për operatorët ekonomikë, mbajtësit e qirasë së ndërmarrjeve shoqërore. Përfundimisht 100% nga pagesat për qiramarrësit me ndalim veprimi në përputhje me vendimet e qeverisë, ndërsa 70% përfundimisht nga pagesa për qiramarrësit me mundësi të kufizuara për të vepruar.

Tabela 2.3. Përmbledhje e rezultateve financiare të fondeve në mirëbesim deri më 31 tetor 2020

Përshkrimi	Shuma
Të hyrat nga shitjet	772,453,198
Të hyrat nga qiraja dhe komercializimi	48,961,713
Tarifa dhe konfiskimet për pjesëmarrjen në tenderët e shitjes	8,879,064
Interesi i fituar	34,844,700
Të hyrat e tjera	7,464,334
Kapitali themelor i Agjencisë	1,013,200
Gjithsej Pranimet	873,616,208
20% i punëtorëve transferuar në BSPK	151,372,509
Ofruesi i Shërbimeve Profesionale (Autoriteti i Likuidimit)	16,701,407
Mallra dhe shërbime	20,636,176
Shërbime publike	2,879,633
Tatimet	8,026,352
Vendimet e gjykatave/përmblyesve (depozita dhe taksa)	3,020,911
Transferimi i mjeteve 5% për mbulimin e aktiviteteve të AKP-së	45,777,947
Shpenzime të tjera	854,389
Pagesat ndaj kreditorëve të NSh-së	35,706,841
Fondet transferuar Buxhetit të Kosovës	398, 195, 186
Gjithsej Pagesat/Shpërndarjet	683,171,351
Gjendja bankare	190,444,857.05

Procesi i likuidimit

Deri në fund të tetorit 2020 procesi i likuidimit ka filluar për 567 Ndërmarrje Shoqërore/Asete. Deri më tani Bordi i Agjencisë ka miratuar 191 Raporte të shpërndarjes së parakohshme/përfundimtare për 191 ndërmarrje shoqërore në likuidim. Shuma e fondeve të miratuara nga Bordi Agjencisë deri me tani për shpërndarje te kreditorët e ligjshëm që nga fillimi i procesit të likuidimit ka arritur vlerën prej 33,527,435 eurosh. Nga këto shpërndarje kanë përfituar rreth 16,000 kreditorë të ndryshëm. Nga 91,349 kërkesa kreditore të ndryshme të dorëzuara në Agjenci deri më tani Autoritetet e likuidimit kanë lëshuar 91,100 vendime për pretendues të ndryshëm. Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës ka lëshuar aktvendime për lejimin e përmbylljes së procesit të likuidimit për 32 ndërmarrje shoqërore.

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) është organ përgjegjës për procesin e privatizimit, përfshirë këtu edhe shpërndarjen e 20% për ish punëtorët e ndërmarrjeve shoqërore. Nga fondet e 20% deri në tetor 2020 Agjencia ka shpërndarë 151,372,509 milionë euro.

Sa i përket privatizimit dhe ristrukturimit, bazuar në konkluzionet e dala nga nënkomiteti i vitit 2020, Kosova duhet të miratojë ligjin e ri për ndërmarrjet publike si dhe të rrisë mbikëqyrjen e tyre. Kosova gjithashtu duhet të ndërmarrë konsultime me palët e interesuara përkatëse në një mënyrë transparente para se të merret ndonjë vendim strategjik mbi pronësinë e ardhshme të Telekomit të Kosovës.

Funksionimi i tregut financiar

Kjo pjesë do të fokusohet kryesisht në stabilitetin dhe zhvillimin e sektorit financiar nga perspektiva e strukturës, madhësisë dhe efikasitetit të ndërmjetësimit financiar. Aspektet e natyrës legislative dhe kërkesat që dalin nga MSA do të elaborohen më gjerësisht në kapitujt të tjerë relevantë si kapitulli për lëvizjen e lirë të kapitalit dhe ai për shërbimet financiare.

Autoriteti i vetëm mbikëqyrës e rregullativ i institucioneve financiare është Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) e themeluar me Ligjin nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Objektivi parësor i BQK-së është nxitja dhe ruajtja e një sistemi të qëndrueshëm financiar, përfshirë një sistem të sigurt dhe efikas të pagesave. Që nga themelimi i saj ka zhvilluar dhe zbatuar politika dhe praktika mbikëqyrëse të bazuara në standardet më të mira ndërkombëtare për rregullimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare në funksion të stabilitetit financiar në Kosovë, kryesisht të bazuara në Direktiva

të BE-së dhe standardet e nxjerra nga mekanizmat ndërkombëtarë të njohur për përgatitjen dhe harmonizimin e standardeve në fushën e mbikëqyrjes së bankave, sigurimeve dhe pensione, siç janë BCBS, IAIS dhe IOPS.

Sistemi financiar përbëhet nga sektori bankar me 10 banka komerciale të cilat përbëjnë 65% të aseteve totale të sektorit financiar (8 me pronësi të huaj), sektori i sigurimeve me 13 kompani sigurimesh (7 me pronësi të huaj), fondet pensionale (2 фонде), ndihmësit financiarë (51), sektori mikro-financiar me 20 IMF (12 me pronësi të huaj) dhe tregu i letrave me vlerë. Sistemi financiar ka vazhduar të zgjerohet në mënyrë të vazhdueshme gjatë vitit 2019 duke arritur shkallën e ndërmjetësimit financiar në 102.5% të BPV-së. Bankat janë ndërmjetësuesit kryesorë të sektorit financiar pasuar nga fondet pensionale dhe sektori i sigurimeve.

Në BQK, si përgjegjës ekskluziv për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare, janë themeluar departamentet dhe divizionet përkatëse për mbikëqyrjen e institucioneve financiare, si në vijim: Departamenti për Mbikëqyrjen e Bankave, Departamenti për Mbikëqyrjen e Sigurimeve, Departamenti për Licencim dhe Standardizim, Divizioni për Mbikëqyrjen e Fondeve Pensionale dhe Tregut të Letrave me Vlerë dhe Divizioni për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Parandalimin e Financimit të Terrorizmit, të cilët janë të vendosura në pjesën e Mbikëqyrjes Financiare.

Zhvillimet në tregun financiar

Sistemi financiar i Kosovës në vitin 2020 ishte i shëndoshë dhe i qëndrueshëm përkundër përballjes me një rrezik të paparë dhe të papritur që ishte rezultat i Covid-19. Edhe pse treguesit e rrezikut në përgjithësi treguan një trend në rritje krahasuar me vitet e mëparshme; bankat dhe institucionet financiare arritën të jenë fitimprurëse, likuide dhe të kapitalizuara mirë. Për më tepër, aktiviteti i huasë në sektorin bankar vazhdoi të rritet, pavarësisht me ritëm më të ngadaltë se trendi i viteve të mëparshme dhe burimeve të qëndrueshme të financimit, të tilla si depozitat, të cilat gjithashtu u rritën gjatë vitit 2020, pavarësisht bllokimit në mars-maj 2020 dhe kufizimeve të tjera në muajt e ardhshëm.

Sektori bankar pavarësisht pandemive Covid-19, ka një nivel të lartë të likuiditetit. Raporti i aseteve likuide (të gjëra) ndaj detyrimeve afatshkurtra në dhjetor 2020 u rrit me 2.3 pikë përqindje krahasuar me vitin e kaluar, në 39.8%, që është dukshëm mbi nivelin minimal të rekomanduar (25.0%). Rritja e likuiditetit të sektorit bankar u nxit gjithashtu nga tërheqja e kursimit prej 10% nga Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës, duke rritur kështu depozitat e familjeve dhe në anën tjetër një rritje të parave të gatshme për sektorin bankar.

Sektori bankar regjistroi një fitim neto prej 79.9 milion euro (dukshëm më i lartë se mesatarja historike), krahasuar me periudhën e mëparshme, sektori regjistroi një rënie të fitimit me 7.4% (ulje me 6.4 milion euro). Kjo rënie ishte për shkak të rritjes më të lartë të shpenzimeve (12.7%) krahasuar me rritjen më të ngadaltë të të ardhurave (prej 6.1%). Ngadalësimi i rritjes së të ardhurave ishte për shkak të ngadalësimit të të ardhurave nga interesi, veçanërisht të ardhurat nga interesi për huatë. Ndërsa, rritja e shpenzimeve, u ndikua kryesisht nga rritja e shpenzimeve jo me interes, në veçanti e shpenzimeve për humbjet e kredisë. Si rezultat i fitimit më të ulët të gjeneruar në vitin 2020, ai ndikoi gjithashtu në treguesit e fitimit si ROA dhe ROE, të cilat qëndronin në 1.6% (2.2% në 2019) dhe ROE që qëndronin në 14.0% në 2020 (18.9% në 2019).

Sektori bankar vazhdon të jetë i kapitalizuar mirë, duke qëndruar dukshëm mbi nivelin e kërkuar rregullator minimal prej 12%, në 16.5% në vitin 2020 (15.8% në 2019). Kështu, niveli i kapitalizimit është më i lartë me 0.7 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë. Krahasuar me periudhën e mëparshme, niveli i kapitalit ka shënuar një rritje vjetore prej 7.2%, ndërsa niveli i aktiveve të ponderuara me rrezik me 2.6%. Rritja e nivelit të kapitalizimit është rezultat i fitimit të realizuar gjatë vitit 2020 si dhe mos shpërndarjes së dividendëve që nga fillimi i pandemisë, ndërsa rritja më e ngadaltë e aktiveve me rrezik, si rezultat i rritjes së ngadaltë të aktivitetit të huadhënies krahasuar me vitet e mëparshme.

Kreditë me probleme ndaj gjithsej kredive vazhdojnë të jenë në nivel më të ulët krahasuar me nivelin e NPL-ve në rajon. Që nga dhjetori 2020, sektori bankar kishte një nivel NPL prej 2.7% (2.0% në 2019). Rritja ishte rezultat i rritjes së vlerës së NPL me 39.8%, për herë të parë në gjashtë vjet; ndërsa aktiviteti i

huadhënies u rrit me 7.1% në periudhën përkatëse, i cili është me ritme më të ulta krahasuar me trendin e dy viteve të fundit. Kreditë me probleme vazhdojnë të jenë të mirë-provizionuara, duke qëndruar në 141.4% deri në dhjetor 2020. Si rezultat i një rritjeje në nivelin e NPL-ve, shpenzimet e provizioneve të humbjeve të kredive u rritën, duke ndikuar në fitimin e bankave (ulje me 7.4%). Nëse situata me pandeminë COVID-19 nuk përmirësohet në 2021 ne mund të përballemi me kufizime të mëtejshme në ekonomi, të cilat do të dëmtonin bizneset dhe familjet. Kështu, ne mund të presim një rritje të mëtejshme të nivelit të NPL-ve, duke ndikuar në të ardhurat neto për shkak të rritjes së mundshme të provizioneve për humbjet e kredisë dhe rënies së të ardhurave nga interesi.

Lidhur me sektorin tjetër të sistemit financiar, sektori i pensioneve në vitin 2020 shënoi një rritje më të ngadaltë të aktivitetit si rezultat i ndikimit negativ të pandemisë në ekonomi; si dhe tërheqjen e 10% të fondeve të besimit nga kontribuuesit. Sektori u rrit me vetëm 1.2% në 2020 pavarësisht të gjitha zhvillimeve në sektor si rezultat i kthimit të investimit prej 72.3 milion euro dhe të ardhurave të qëndrueshme nga kontributet.

Sektori i sigurimeve në vitin 2020 u karakterizua nga një zgjerim i aseteve, duke ruajtur nivelin e primeve të mbledhura nga viti i kaluar, si dhe duke ulur nivelin e dëmeve të paguara. Përhapja e pandemisë COVID-19 ndikoi më shumë në nivelin e kërkesave të paguara (ulur si rezultat i kufizimit në lëvizje dhe aktivitetin e biznesit), kështu që sektori operoi me fitim në vitin 2020.

Sektori i mikrofinancave shënoi një ngadalësim të ndjeshëm të rritjes së aktivitetit krahasuar me vitet e mëparshme, gjë që u reflektua në aktivitetin e huadhënies dhe dhënies me qira. Por sektori vazhdon të ketë një nivel relativisht të ulët të NPL-ve, të cilat sigurohen mirë.

Objektivat prioritarë afatmesme

Në planin afatmesëm prioritetet kryesore që parashikohet të realizohen janë:

- Ruajtja e pjesëmarrjes së shpenzimeve kapitale në buxhet;
- Vazhdimi me reformat që janë të rëndësishme në kontekst të stabilitetit makroekonomik dhe sektorit financiar përfshirë këtu edhe zbatimin e rregullës fiskale për deficitin buxhetor;
- Miratimi dhe implementimi i Ligjit të ri për Ndërmarrjet Publike dhe akteve nënligjore;
- Implementimi i Ligjit të ri për Ndërmarrjet Publike;
- Privatizimi dhe likuidimi i ndërmarrjeve shoqërore;
- Sigurimi i të drejtave pronësore duke adresuar joformalitetin në sektorin e pronës së paluajtshme;
- Rritja e efikasitetit gjyqësor për të arritur cakun 0% të lëndëve të vjetra deri më 2022;
- Përmirësimi i qasjes në financa për NVM-të përmes rritjes së Fondit Kosovar për Garanci Kreditore;
- Avancimi i vazhdueshëm i kornizës rregullative për sistemin bankar në harmoni me standardet ndërkombëtare dhe legjislacionin e BE-së
- Përafrimi i mëtejshëm i rregulloreve të sigurimeve në Kosovë me direktivat përkatëse evropiane. Në varësi të ndryshimeve të kërkesave juridike të BE-së dhe standardeve ndërkombëtare, rregulloret ekzistuese do të amendamentohen për t'u harmonizuar plotësisht me këto kërkesa.

2.2. Kapaciteti për t'u përballur me presionin e konkurrencës dhe forcat e tregut brenda Unionit

Ky kapitull adreson pikën e dytë të kriterëve ekonomike të Kopenhagës për anëtarësim, që ka të bëjë me kapacitetin e vendit për të përballuar dhe qenë konkurrues në tregun e BE-së. Faktorët kyçë për të arritur këtë qëllim dhe në bazë të të cilëve KE monitoron dhe vlerëson progresin drejt anëtarësimit përbëhet nga:

- Zhvillimi i kapitalit njerëzor dhe fizik në nivel të kënaqshëm ku vlerësohen aspekte të zhvillimit të arsimit, hulumtimeve dhe infrastrukturës,
- Struktura adekuate sektoriale dhe e ndërmarrjeve, përfshirë kompozicionin sektorial, zhvillimin e NVM-ve dhe çështjet e ristrukturimit të ndërmarrjeve,
- Shkalla e limituar e ndikimit të shtetit në konkurrueshmëri ku ndër të tjera shqyrtohet ndikimi i politikave dhe segmenteve të caktuara në ekonomi përfshirë këtu ndihmën shtetërore dhe mbështetja për NVM-të, dhe

- Integrimi i mjaftueshëm tregtar i ekonomisë me vendet e BE-së.

Prioritetet e Qeverisë mbeten të orientuara në zhvillimin e kapitalit fizik përmes zhvillimit të infrastrukturës, zhvillimin e kapitalit njerëzor përmes reformave në arsim dhe masave për mbështetje të sektorit privat. Korniza strategjike që përcakton masat dhe objektivat prioritare përbëhet nga Programi i Qeverisë 2020-2023 dhe dokumente strategjike sektoriale, përfshirë strategjinë për zhvillimin e sektorit privat dhe Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë 2017-2021. Zhvillimi i sektorëve me rëndësi ekonomike si energjisë, infrastrukturës, bujqësisë, telekomunikacionit dhe shoqërisë informative dhe turizmit janë objektiva prioritare.

Në kuadër të kornizës së bashkëpunimit rajonal dhe procesit të integritit evropian, Republika e Kosovës është e angazhuar edhe në arritjen e objektivave të Strategjisë së Evropës Juglindore 2020 dhe agjendës së ndërlikshme infrastrukturale, përfshirë edhe atë që tani quhet si 'Procesi i Berlinit'. Përmirësimi i konkurrueshmërisë, tregut të punës dhe politikave industriale, facilitimi i tregtisë midis vendeve të rajonit, përmirësimi i rrjetit të infrastrukturës rrugore dhe tregu i energjisë janë disa nga objektivat kryesore në nivel rajonal. Republika e Kosovës ka integruar realizimin e tyre në kornizën e objektivave strategjike dhe planet përkatëse të veprimit.

Sipas *Raportit të KE-së për Kosovën – 2020*, Kosova ka bërë progres të kufizuar dhe është në një fazë të hershme sa i përket kapacitetit për t'u përballuar me presionin konkurrues dhe forcat e tregut në BE. Cilësia e arsimit mbetet një shqetësim. Kosova bëri një progres në përmirësimin e infrastrukturës rrugore, por ka boshllëqe të mëdha në infrastrukturën hekurudhore dhe energjetike. Megjithatë investimet në burimet e rinovueshme po rriten gradualisht, Kosova mbetet e mbështetur në një sistem të prodhimit të energjisë kryesisht të bazuar në qymyr, të vjetruar dhe jo të besueshëm. Kosova bëri një progres sa i përket digjitalizimit të ekonomisë. Struktura sektoriale e ekonomisë po zhvendoset drejt aktiviteteve të përtregueshme të cilat peshojnë në konkurrencën dhe rritjen e eksporteve të mallrave.

Në mënyrë që të mbështesë rimëkëmbjen ekonomike, të përmirësojë konkurrencën dhe të mbështesë rritjen afatgjatë, Kosova në veçanti duhet të përmirësojë cilësinë e aftësisë dhe arsimit profesional në të gjitha nivelet dhe të harmonizojë programet mësimore me nevojat e tregut të punës; të rrisë stimujt e eficiencës së energjisë në sektorin e banimit dhe atë privat; të rritë burimet e ripërtëritshme në prodhimin e energjisë në një mënyrë më efikase; si dhe të avancojë mbështetjen financiare dhe jo-financiare për NVM-të për të përballur krizën, për të përmirësuar aftësinë konkurruese dhe eksportin e tyre.

Konkluzionet e dala nga nënkomiteti i vitit 2020 kërkojnë që Kosova të miratojë riorganizimin strukturor të Agjencisë Kosovare të Investimeve dhe Mbështetjes së Ndërmarrjeve (KIESA) si dhe të emërojë drejtorin e saj bazuar në kriteret profesionale siç parashikohet nga ligji. Gjithashtu kërkohet të zbatohet Strategjia dhe Plani i Veprimit për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimet Financiare. Kosova duhet të përmirësojë mjedisin afarist duke rritur digjitalizimin, thjeshtësimin dhe heqjen e licencave dhe lejeve.

Në vazhdim jepet një pasqyrë e zhvillimeve të secilit nga këta faktorë kyç të kriterit të dytë ekonomik.

Arsimi dhe inovacioni

Kapitali njerëzor

Duke marrë parasysh se Kosova është një vend me më pak se dy milionë banorë, zhvillimi i kapitalit njerëzor është faktor i rëndësishëm për zhvillimin e përgjithshëm të vendit dhe një shoqërie të dijes. Zhvillimi dhe transformimi i sistemit arsimor është orientuar në mënyrë që t'i shërbejë nevojave dhe kërkesave të shoqërisë në procesin e tranzicionit dhe zhvillimit ekonomik, të ofrojë mundësi të barabarta dhe të zhvillohet në harmoni me standardet evropiane. Reforma e arsimit bazohet në parimet e paanësisë, barazisë gjinore, cilësisë, të mësuarit gjatë gjithë jetës, efektshmërisë dhe eficiencës, autonomisë institucionale dhe sistemit të decentralizuar, dhe përgjegjshmërisë publike.

Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021 është dokumenti bazë sektorial për zhvillimin e sektorit të arsimit. Ai fokusohet në arritjen e 7 objektivave strategjike: pjesëmarrja dhe gjithëpërfshirja në arsim,

menaxhimi cilësor dhe efikas i sistemit arsimor, zhvillimi i sistemit të cilësisë në harmoni me standardet ndërkombëtare, rritja e cilësisë së mësimdhënies, zhvillimi i mëtejshëm i arsimit profesional për të adresuar kërkesat e tregut, dhe rritja e cilësisë së arsimit të lartë. Bashkë me Planin Strategjik është zhvilluar dhe miratuar edhe Plani i Veprimit, i cili identifikon aktivitetet, institucionet, afatet kohore dhe mjetet e nevojshme buxhetore për realizimin e këtyre objektivave të strategjisë.

Ndërsa **Programi i Qeverisë së Kosovës 2021- 2025**, thekson se Qeveria do të angazhohet për arsim cilësor, gjithëpërfshirës dhe të digjitalizuar, harmonizim të arsimit profesional me kërkesat e tregut, menaxhim efektiv të sistemit arsimor në të gjitha nivelet, dhe përmirësim të mjedisit për kërkime dhe inovacion.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka kërkuar që tekstet shkollore të kenë funksion edukativ, të nxisin raport pozitiv ndaj shkencës/diturisë, zhvillimit të identitetit qytetar, kulturor dhe barazisë gjinore. Të respektohet barazia gjinore, të eliminohen stereotipat gjinore në tekste shkollore dhe përdorimi i gjuhës diskriminuese në to.

Sipas të dhënave të MASHTI-it, numri i institucioneve edukativo-arsimore publike në Kosovë në vitin 2019/20 të cilat raportojnë në sistemin SMIA është si në tabelën më poshtë.

Tabela 2.4. Studentët në arsimin publik dhe privat sipas niveleve, viti shkollor 2020/21

Niveli	Publik			Privat			Totali		
	M	F	Total	M	F	Total	M	F	Total
Edukimi i hershëm i fëmijërisë (mosha 0- <5)	2,196	1,987	4,183	2,546	2,309	4,855	4,742	4,296	9,038
Arsimi para-fillor (mosha 5 <6)	10,396	9,617	20,013	1,084	1,044	2,128	11,480	10,661	22,141
Shkolla fillore / e mesme e ulët	115,377	108,531	223,908	3,194	2,602	5,796	118,571	111,133	229,704
Shkolla e Mesme e Lartë	35,992	34,750	70,742	1,858	1,787	3,645	37,850	36,537	74,387
Total	163,961	154,885	318,846	8,682	7,742	16,424	172,643	162,627	335,270

Tabela 2.5. Studentët në arsimin publik dhe privat sipas niveleve, 2015-2020

	2015/2016	2016/2017	2017/2018	2018/2019	2019/2020
Edukimi i hershëm i fëmijërisë (mosha 3, 4, 5)	30.9%	33.9%	36.0%	37.5%	38.10%
Para-fillor (mosha-5)	81.3%	87.6%	92.4%	92.5%	93.10%
Fillor	94.7%	96.2%	98.4%	100.3%	100.9%
Shkolla e mesme e ulët	96.0%	93.3%	91.2%	90.5%	90.4%
Shkolla e mesme e lartë	84.9%	88.1%	90.2%	86.8%	82.5%

Në **arsimin profesional**, përveç shkollave profesionale janë ngritur 4 qendra të Kompetencës. Për të avancuar menaxhimin e cilësisë në **arsimin parauniversitar**, përpjekjet janë fokusuar në ngritjen e cilësisë së brendshme, zbatimin e mekanizmave për vlerësim të cilësisë së jashtme dhe ngritjen e kapaciteteve të Inspektoratit të Arsimit.

Arsimi i lartë ofron mundësi studimi për të gjithë personat brenda apo jashtë territorit të Kosovës, pa asnjë lloj diskriminimi (nacional, racor, fetar, gjinor). Tanimë funksionojnë 6 universitete publike brenda territorit të Republikës së Kosovës, si dhe 22 kolegje private. Nuk ka kufizim moshe për t'u regjistruar apo për të fituar kualifikim të arsimit të lartë në Kosovë.

Tabela 2.6. Numri i fëmijëve, nxënësve dhe studentëve në të gjitha nivelet e arsimit në sektorin publik dhe privat 2019/2020

Niveli	Privat	Publik	Gjithsej
Universitar (5+6)	35, 989	68, 590	104, 579
Arsimi special (1+2+3)	0	349	349
I mesëm i lartë (3)	3, 480	74, 427	77, 907
Fillor/mesëm i ultë (1+2)	5, 252	229, 338	234, 590
Parashkollor (0)	5, 229	4, 164	9, 393

Burimi: Statistikat e Arsimit në Kosovë 2019/2020, SMIA/MASH T ASK

Brenda Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë funksionon edhe qendra NARIC, e cila bën barasvlerën e diplomave të arsimit të lartë të fituara jashtë Kosovës. Kosova zyrtarisht nuk i është bashkuar procesit të Bolonjës por aplikimi për pranim formal është dorëzuar më 2014. Baza ligjore harmonizon praktikat aktuale arsimore me prioritetet e deklaratave të Grupit të Bolonjës, sidomos në lidhje me harmonizimin e dispozitave të caktuara të ligjit me Ligjin dhe Kornizën Kombëtare për Kualifikime (nr. 03/L-060) dhe lehtësimin të njohjes së mësimin paraprak dhe kualifikimeve të fituara në vendet e tjera përmes qendrës NARIC.

Agjencia e Akreditimit të Kosovës (AAK) bën vlerësimin e jashtëm të institucioneve të arsimit të lartë në nivel institucional dhe të programeve të studimit. Me zbatimin e plotë të Udhëzimit Administrativ për akreditim (kërkesën për 1 PhD për çdo 60 ECTS, të fushës përkatëse për program të studimit) ka pasur një zbritje domethënëse të programeve të akredituara të studimit për shkak se disa institucione kanë dështuar që të plotësojnë këto kritere. Për më tepër, numri i institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit ka rënë dukshëm.

Shkarkimi i anëtarëve të KSHC-së rezultoi në përjashtimin e AKA-së nga EQAR (Regjistri Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë) në fillim të vitit 2018, ndërsa Rrjeti Evropian i Agjencive të Sigurimit të Cilësisë për Arsim të Lartë (ENQA) ka vendosur AKA-në në statusin e anëtarit "nën rishikim". Ekipi i ekspertëve nga ENQA arriti në përfundim se niveli i përgjithshëm i plotësimit të standardeve dhe udhëzuesve Evropianë (ESG) nuk është i mjaftueshëm për përtëritjen e anëtarësimin të AKA-së në ENQA. Me këtë rast bordi i ENQA-s njofton se AKA ka të drejtë riaplikimi dy vite pas marrjes së këtij vendimit. Gjatë këtyre dy viteve, AKA do t'i nënshtrohet edhe një vlerësimi nga ekspertët e ENQA-s i cili ka për qëllim të ndihmojë dhe këshillojë AKA-në para aplikimit formal për rivlerësim.

Fusha e hulumtimeve shkencore ende mbetet e limituar. Mbështetja për hulumtime konsiston në përkrahjen financiare përmes skemës së mobilitetit, dhe botimeve dhe publikimeve shkencore.

Sa u përket zhvillimeve në **tregun e punës**, për shkak të pandemisë COVID-19 e cila ka kapluar Republikën e Kosovës, rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore për tremujorin e tretë të 2020 nuk u publikuan sipas datës së planifikuar në kalendarin statistikor të botimeve për vitin 2020, pasi ASK ka ndaluar mbledhjen e të dhënave në terren më 16 mars 2020. Prandaj, mbledhja e të dhënave në terren për tremujorin e tretë 2020 u bë pas lehtësimin të disa masave nga Qeveria e Kosovës, së bashku me mbledhjen e të dhënave për tremujorin e dytë 2020 dhe shumica e të dhënave përfaqësuese do të jenë në dispozicion në raportin përfundimtar për vitin 2020 i cili do të publikohet më vonë.

Pothuajse dy të tretat e popullsisë së Kosovës janë në moshë pune (mosha 15-64). Pritet që popullsia në moshë pune të rritet me shpejtësi gjatë dekadës së ardhshme pasi Kosova është ndër vendet me popullsinë më të re në Evropë. Nga popullsia në moshë pune, 60.0% nuk janë ekonomikisht aktivë, që do të thotë se ata nuk janë të punësuar dhe nuk kanë qenë aktivë në kërkim të punësimit gjatë katër javëve të fundit dhe / ose nuk janë të gatshëm të fillojnë të punojnë brenda dy javësh. Nga 40.0% (488,424 persona) të popullsisë që është ekonomikisht aktive, 24.6% (120,348 persona) janë të papunë. Raporti i punësimit ndaj popullsisë (shkalla e punësimit), 30.1% (368,076 persona) janë të punësuar. 60.0% e popullsisë në moshë pune është joaktive.

Ka dallime të konsiderueshme gjinore në të gjithë tregun e punës. Një në pesë (21.5%) femra në moshë pune janë aktive në tregun e punës, krahasuar me rreth tre të pestat (58.9%) të meshkujve në moshë pune. Midis personave në fuqinë punëtore, papunësia është më e lartë për femrat sesa për meshkujt (33.1% kundrejt 21.5%).

Shkalla e punësimit në mesin e femrave në moshë pune është vetëm 14.1%, krahasuar me 46.2% për meshkujt. Kjo shkallë shumë e ulët e papunësisë midis grave buron nga kombinimi i pjesëmarrjes shumë të ulët në fuqinë punëtore dhe papunësisë së lartë. Femrat ishin kryesisht të punësuara në sektorët e arsimit, tregtisë dhe shëndetësisë (49.7% e femrave të punësuara). Meshkujt ishin kryesisht të punësuar në sektorët e tregtisë, ndërtimit dhe prodhimit (duke punësuar 46.5% të meshkujve të punësuar).

Papunësia e të rinjve është shumë e lartë në Kosovë. Në tremujorin e tretë të vitit 2020, të rinjtë në Kosovë kishin dy herë më shumë gjasa të ishin të papunë sesa të rriturit. Midis personave të moshës 15-24 në fuqinë punëtore, 4619 ishin të papunë. Papunësia është më e lartë tek femrat e reja (61.0%) sesa meshkujt e rinj (40.8%). Gati një e treta (37.7%) e atyre të moshës 15 deri 24 vjeç në Kosovë nuk ishin në arsim, punësim ose trajnim (NEET). Kjo shifër është 38.1% për femrat e reja krahasuar me 37.4% për meshkujt e rinj. Shumica e atyre punonjësve raportojnë se punojnë me kohë të plotë. 92.5% e të anketuarve raportuan se punojnë me kohë të plotë në punën e tyre kryesore.

Arsyet për të punuar me kohë të pjesshme ndryshojnë midis gjinive, pasi femrat, duke marrë rolin e kujdesit brenda familjes, zvogëlojnë orët në dispozicion për punësim. Arsyeja numër një për meshkujt që nuk punojnë me kohë të plotë, ishte mungesa e një pune me kohë të plotë. 17.5% e të punësuarve i përkisnin kategorisë së punësimit të paqëndrueshëm. Kjo do të thotë që ata janë ose të punësuar në biznesin e tyre (punëtorë për llogari të vet), ose kontribuojnë në një biznes familjar (të paguar ose të papaguar). Vetëm 42.1% e personave të punësuar kishin një kontratë të përhershme në punën e tyre kryesore, me 2.9% më të larta për femrat sesa meshkujt (44.2% në 41.3%), ndërsa 57.9% kishin një kontratë të përkohshme, me 2.9% më të lartë tek meshkujt sesa tek femrat. Personat që kishin kontrata të përkohshme u pyetën pse kishin këtë lloj kontrate dhe 91.3% e të anketuarve raportuan se nuk kishte ndonjë kontratë tjetër në dispozicion. Pagat neto të shumicës së të punësuarve ishin ndërmjet 400 dhe 500 € në muaj. Dallimet gjinore janë vërejtur me 0,1% më të larta për meshkujt sesa për femrat.

Kapitali fizik dhe cilësia e infrastrukturës

Sipas parashikimeve, pjesa e investimeve publike e private pritet të rritet në 2021. Ky nivel i investimeve parashikohet të mbahet gjatë këtij viti dhe vitit 2021, pjesërisht për shkak të projekteve aktuale në zhvillim dhe projekteve të mëdha hyrëse të infrastrukturës, si termocentrali. Në periudhën e ardhshme theks të veçantë do t'i kushtohet klauzolës së investimeve përmes së cilës Qeveria e Republikës së Kosovës synon të investojë në projektet e mëdha infrastrukturore për të tejkaluar sfidat strukturore që kanë penguar shfrytëzimin maksimal të potencialit zhvillimor të vendit. Për të mundur rritje ekonomike gjithëpërfshirëse, Qeveria ka rritur hapësirën për shpenzime kapitale në nivel të komunave.

Infrastruktura rrugore

Objektivat kryesore në këtë sektor përfshijnë: i) integrimin e Kosovës në rrjetin rajonal rrugor përmes zhvillimit të rrugëve 6 dhe 7 përgjatë korridoreve pan-evropiane, ii) zvogëlimin e shpenzimeve të transportit, dhe uljen e ngarkesës në trafik përmes rrugëve të reja përfshirë rrugët transit rreth qendrave urbane, iii) rritjen e sigurisë përmes përmirësimit të sinjalizimit horizontal dhe vertikal, përmirësimit të kualitetit të infrastrukturës rrugore dhe fushatave për sigurinë në rrugë, dhe iv) mirëmbajtjen dhe përmirësimin e rrugëve ekzistuese që mundësojnë shërbime të mira të transportit privat dhe publik.

Qeveria e Republikës së Kosovës mbetet e përkushtuar në përmirësimin e mëtejshëm të infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore, duke u fokusuar në përfundimin e akteve rrugore kryesore ndërkombëtare dhe rajonale, si dhe linjën ndërkombëtare hekurudhore për të mundur lëvizje më të shpejtë dhe më të lirë të qytetarëve dhe mallrave, duke zvogëluar kostot dhe distancën e transportit të njerëzve dhe mallrave në dhe nga Kosova. Kjo do t'u lehtësojë bizneseve të plasojnë mallra në tregjet vendore dhe ndërkombëtare,

kurse modernizimi i rrjetit hekurudhor ndërkombëtar do të ndihmojë sektorin e eksportit të mallrave minerare dhe bujqësore.

Puna për ndërtimin e autostradës R6 ka përfunduar në segmentin Prishtinë - Hani i Elezit (me gjatësi 65.6 km) dhe është hapur zyrtarisht në maj 2019. Kjo autostradë e re ka 13 ura, përfshirë edhe më të gjatat në rajon, e gjatë 5.7 kilometra.

Ka përfunduar pjesa e autostradës Prishtinë-Vërmicë që është pjesë e autostradës kombëtare Vërmicë-Merdarë (R7) që lidhet me korridoret ndërkombëtare 8 dhe 10. Edhe segmenti Prishtinë-Milloshëvë i autostradës M2 është përfunduar. Gjithashtu, projekti për ndërtimin e Autostradës Prishtinë - Hani i Elezit ka përfunduar dhe rruga është lëshuar në qarkullim.

Pas lëshimit në qarkullim të segmenteve të Autostradës R7, Morinë-Gjurgjicë (Lidhja me N9) Bresje -Besë, Ministria e Infrastrukturës në bashkëpunim me WBIF-in dhe EIB ka përfunduar Plotësimin e Studimit të Fizibilitetit dhe Ndikimit mjedisor për segmentin Besë - Merdarë (Kufiri me Serbinë). Ky projekt do të zgjasë 14 muaj dhe financohet nga WBIF (Western Balkan Investment Framework).

Në bashkëpunim me Kornizën për Investime në Ballkanin Perëndimor (WBIF) dhe BERZH-in ka përfunduar studimi i fizibilitetit dhe ndikimit mjedisor për segmentin Kijevë-Zahaq (32 Km) dhe është duke vazhduar hartimi i projektit zbatues i cili pritet të zgjatë 12 muaj, dhe pas përfundimit të projektit zbatues do të vazhdohet me definimin e hapave të mëtejme të financimit të këtij projekti.

Transporti hekurudhor

Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës Sh.A. (INFRAKOS) menaxhon me infrastrukturën hekurudhore në pronësi të shtetit. Kjo është një Ndërmarrje Publike me 100% të aksioneve të zotëruara nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Rrjeti hekurudhor i Kosovës përbëhet nga 335, 079 km të linjave hekurudhore. Katër linjat hekurudhore kanë nevojë për nivele të ndryshme të rehabilitimit për t'i sjellë hekurudhat në standardet moderne të shpejtësisë dhe sigurisë. Gjatë vitit të kaluar, si transporti i pasagjerëve ashtu edhe ai i mallrave kishin një rritje të konsideruar. Rrjeti hekurudhor ka një mirëmbajtje e cila garanton sigurinë e nevojshme të qarkullimit të trenave.

Më konkretisht infrastruktura hekurudhore është si më poshtë:

- Linja hekurudhore 10-të (kufiri me Serbinë - Leshak - Mitrovicë - Fushë Kosovë - Hani i Elezit - Kufiri me Maqedoninë e Veriut), me gjatësi prej 149.110 km, njëbinarëshe, e pa elektrifikuar, me gjerësi 1435 mm, Kategoria D3, masë boshtore 22.5 ton dhe masë longitudinale 7.2 ton/m;
- Linja hekurudhore lindore (kufi me Serbinë - Podujevë - Prishtinë - Fushë Kosovë), me gjatësi prej 45.198 km, vetëm një palë binarë, e pa elektrifikuar, me gjerësi të binarëve 1435 mm, kategoria D3, masa e boshtit 22.5 ton dhe 16 ton, dhe masa longitudinale 7.2 ton/m dhe 5 ton/m.
- Linja hekurudhore perëndimore (Fushë Kosovë-Pejë) me gjatësi 81.940 km, vetëm një palë binarë, jo e elektrifikuar, me gjerësi 1435 mm, Kategoria C2, masa e boshtit 20 ton dhe masa longitudinale 6.4 ton/ m; dhe
- Linja hekurudhore jug-perëndimore (Klinë-Xërxë-Prizren) me gjatësi 58.831 km, me vetëm një palë binarë, jo e elektrizuar, me gjatësi 1.435 mm, Kategoria D3 dhe B1, masa e boshtit 22.5 tonë dhe 18 tonë, dhe masa longitudinale 7.2 ton/m dhe 5 ton/m.

Ligji nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës themelon Autoritetin Rregullativ të Hekurudhave i cili përbëhet nga organe të pavarura, përveç organit të hetimit që është nën zyrën e kryeministrit për të monitoruar dhe për të rregulluar sektorin hekurudhor.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ka zhvilluar Strategjinë Sektoriale të Transportit Multimodal 2015-2025 e cila përfshinë edhe sektorin hekurudhor. Strategjia ka marrë parasysh edhe interoperabilitetin e sistemit hekurudhor, sigurinë dhe standardet e sistemit hekurudhor evropian, dhe strategjitë e zhvilluara sipas Traktatit mbi Themelimin e Komunitetit të Transportit për vendet e Ballkanit Perëndimor.

Pasi që linja hekurudhore 10, që lidh Kosovën me Serbinë dhe Maqedoninë e Veriut është pjesë e zgjerimit të korridoreve Trans Evropiane të Transportit (TEN-T), atëherë është linjë prioritare për të cilën janë siguruar fondet e nevojshme nga BERZH, BEI dhe Grantet e WBIF për modernizimin e saj.

Në gusht 2019 ka filluar Rehabilitimi Gjeneral dhe Modernizimi i fazës së parë të kësaj linje hekurudhore (Fushë Kosovë-Hani i Elezit-Kufiri me Maqedoninë e Veriut). Pas realizimit të projektit të modernizimit Linja e 10-të Hekurudhore do t'i plotësojë Specifikacionet Teknike të Interoperabilitetit dhe Kriteret e Sistemit Evropian të Menaxhimit të Trafikut Hekurudhor (ERTMS).

Transporti ajror

Kosova ka Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari" që operon me shërbime të kombinuara civile dhe ushtarake. Në prill 2010 ka hyrë në fuqi Kontrata e partneritetit publiko-privat në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Konsorciumit Turko-Francez Limak- Aeroport de Lyon për dhënie të Koncesion të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës, dhe ky është një nga shembujt e suksesshëm të projekteve të Koncesionimit në Evropën Juglindore.

Terminali i ri, i cili është përruar më 23 tetor 2013 është një investim prej rreth 100 milionë euro dhe ofron më shumë komoditet për udhëtarët, shërbime të nivelit të parë si dhe hapësirë të mjaftueshme dhe një mjedis social e relaksues për pasagjerët gra dhe burra. Terminali i ri ka 44,000 m² dhe kapacitet që mundëson pritjen e rreth 4 milionë pasagjerëve në vit. Si pjesë e rrjetit themelor rajonal dhe ndërkombëtar, mbetet si synim zgjerimi dhe ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve të këtij aeroporti.

Energjia

Siguria e furnizimit me energji, është kusht për zhvillim ekonomik dhe rritje të mirëqenies. Siguria e furnizimit me energji si synim kryesor përveç tjerash varet nga gjendja e kapaciteteve prodhuese, transmetuese dhe shpërndarëse të energjisë.

Sistemi energjetik në Republikën e Kosovës është i përbërë nga gjenerimi i energjisë elektrike, transmetimi i energjisë elektrike, shpërndarja e energjisë elektrike, konsumatorët e parregulluar, si dhe konsumatorët me të drejtën e shërbimit universal. Pjesëmarrësit në tregun e energjisë elektrike janë edhe furnizuesit dhe tregtarët me shumicë.

Gjenerimi - është kryesisht i bazuar në termocentralet me linjit (TC Kosova A dhe TC Kosova B) dhe HC Ujmani në pronësi të Qeverisë së Republikës së Kosovës, si dhe HC dhe BRE tjera në pronësi private.

KOSTT - është operator i vetëm i transmetimit dhe tregut dhe është 100% pronësi e Republikës Kosovës ndërsa të drejtat e aksionarit i ushtron Kuvendi i Republikës së Kosovës. Operon me dy licenca të ndara, licencë për operim të sistemit të transmetimit dhe licencë për operim të tregut. Operatori i tregut ka përgjegjësi organizimin dhe zhvillimin e tregut të energjisë elektrike, ndërsa Operatori i Sistemit të Transmetimit ka përgjegjësi transmetimin e energjisë elektrike, operimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të transmetimit, si dhe balancimin e sistemit.

KEDS - është operator i vetëm i sistemit të shpërndarjes dhe është në pronësi private. Ky operator është përgjegjës për operimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të shpërndarjes dhe menaxhimin e gjeneratorëve të kyçur në sistemin e shpërndarjes.

KESCO - është furnizues që ka licencë për furnizim me energji elektrike, duke përfshirë Obligimin e Shërbimit Publik të përcaktuar nga Rregullatori për të furnizuar konsumatorët me të drejtën e shërbimit universal. Përveç kësaj, Rregullatori i ka caktuar edhe obligimin e furnizuesit të mundësisë së fundit.

Furnizues tjerë - deri më tani janë të licencuar 7 furnizues të energjisë elektrike, të cilët janë në pronësi private por ende nuk kanë filluar me operim komercial.

Aktualisht, barra e gjenerimit të energjisë elektrike bie mbi termocentralet me bazë thëngjillin/linjtin që mbulojnë rreth 96% të gjithë prodhimit të energjisë elektrike, ndërsa pjesa tjetër sigurohet nga centralet me

energji nga BRE-të (ne masën më të madhe nga hidrocentralet, kryesisht të vogla) dhe nga importi. Varësia nga importi i energjisë elektrike sillet ndërmjet 10% dhe 15%.

Prodhimi i energjisë elektrike në vend bëhet kryesisht nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK sh.a) në kuadër të së cilës bëjnë pjesë dy termocentrale (Kosova A dhe Kosova B) dhe minierat e qymyrit. Meqenëse TC Kosova A është mjaft e vjetruar (mbi 40 vjet në operim), e gjithashtu edhe TC Kosova B ka një periudhë 36-vjeçare të operimit, për të siguruar qëndrueshmërinë e furnizimit me energji elektrike nevojiten investime të reja)

Sipas Raportit vjetor 2019 të ZRRE-së, prodhimi i gjithmbarshëm i energjisë elektrike në vitin 2019 ka qenë 5,718 GWh, ndërsa në vitin 2018 ka qenë 5,311 GWh, që do të thotë se ka pasur një rritje prej 7.7%. Ndërsa, krahasuar me bilancin e energjisë elektrike për vitin 2019 prodhimi është realizuar rreth 100.4%. Sipas Bilancit Vjetor të energjisë elektrike dhe termike të ZRRE për vitin 2020, prodhimi i tërë nacional, duke përfshirë edhe HC të kyçura në Shpërndarje dhe gjeneratorët me erë dhe me panele diellore, planifikohet të jetë 6,210.8 GWh. Në përgjithësi humbjet e energjisë elektrike janë zvogëluar nga 27.9% sa ishin në vitin 2018 në 25.9% ndaj kërkesës në rrjetin e shpërndarjes.

Kosova si palë nënshkruese e Komunitetit të Energjisë ka transpozuar Rregulloren e BE-së nr. 347 të adoptuar nga Komunitetit i Energjisë së BE-së për Investimet e përbashkëta rajonale përmes U.A 01/2017 për promovimin e investimeve të përbashkëta rajonale në sektorin e energjisë. Në funksion të këtij U.A. është hartuar doracak i procedurave për dhënien e lejeve për projektet me interes për Komunitetin e Energjisë. Në mars 2019, ZRRE ka amendamentuar Udhëzimin për liberalizimin e tregut të energjisë elektrike në Kosovë në mënyrë që të zgjasë rregullimin e çmimeve të furnizimit për klientët e furnizuar në një tension prej 35 kV për konsumatorët 10 kV.

Gjatë vitit 2020, kanë hyrë në operim, katër hidrocentrale me një kapacitet prej 11.06 MW. Strategjia për Energjinë 2017-2026, parashihet kapacitetin prej 1436 MW më 2025, 438 MW prej të cilit rrjedhin nga burimet ripërtëritëse. Me këtë kapacitet prodhues parashihet të prodhohet rreth 7703 KWh për një vit, ku 934 KWh apo 12.1% të tyre gjenerohen nga burimet ripërtëritëse. Aktualisht, gjithsej 21 gjenerator nga BRE janë tanimë në operim, me një kapacitet total instalues prej 104.83 MW: 13 HC (61.1 MW); 6 PV-Solare (10MW) dhe dy (2) nga gjeneratorët prej erës (33.73 MW).

Ngrohja e hapësirave në Kosovë realizohet në masën dërmuese nga biomasa (kryesisht dru zjarri). Sektori i ngrohjes së përqendruar në Kosovë përbëhet nga 4 ngrohore (Prishtinë, Gjakovë, Mitrovicë dhe Zveçan). Në fund të vitit 2014 Ngrohitorja e Prishtinës, Termokos është kyçur në sistemin e kogjenerimit në TC Kosova B. Kjo ka ndikuar ndjeshëm në rritjen e kualitetit të furnizimit të qytetarëve të Prishtinës me ngrohje në njërin anë dhe reduktimin e ndotjes mjedisore në anën tjetër. Një studim fizibiliteti për zhvillimin e sistemeve të ngrohjes në disa qytete të mëdha të Kosovës është planifikuar që të zhvillohet nëpërmjet platformës WBIF.

Ndonëse në Kosovë nuk ekziston infrastrukturë funksionale dhe treg i gazit natyror, me qëllim të hapjes së perspektivës së zhvillimit të gazit natyror në dhjetor 2018, përmes platformës WBIF, është realizuar studimi i përbashkët i parafizibilitetit për gazsjellësin Shqipëri-Kosovë (Projekti ALKOGAP). Ky studim ka synuar vlerësimin fillestar të fizibilitetit për ndërtimin e gazsjellësit ALKOGAP – si një linjë furnizimi të gazit natyror nga rajoni i kaspikut përmes gazsjellësve rajonal TAP/IAP, që në fazën e parë do të lidhë Shqipërinë me Kosovën dhe potencialisht në të ardhmen të vazhdojë drejt vendeve tjera të rajonit. Studimi i parafizibilitetit ka dhënë rekomandimet pasuese për fazat tjera, se pari përgatitjen e master planit të gazit për pjesën e Kosovës, dhe pastaj inicimin e përbashkët me palën shqiptare në realizimin e studimit të fizibilitetit për gazsjellësin Shqipëri-Kosovë. Mbi bazën e rekomandimeve të dala nga studimi i parafizibilitetit, ish MZHE tani Ministria e Ekonomisë në bashkëpunim me institucionet përkatëse në fillim të vitit 2019 përmes platformës WBIF ka aplikuar për mbështetje financiare në formë granti për përgatitjen e Master planit për shpërndarjen e Gazit Natyror në Kosovë. Komitetit Drejtues i Kornizës Investuese të Ballkanit Perëndimor (WBIF), në qershor 2019 në Berlin, sipas njoftimeve nga NIPAC Kosova, është dakorduar një grant në vlerën prej euro 1.5 mil Euro për përgatitjen e Master Planit për shpërndarjen e

gazit natyror në Kosovë, e i cili do të përgatitet përmes asistencës teknike e angazhuar nga platforma WBIF/BERZH ne periudhën 2021-2022.

Më tej, në kuadër të bashkëpunimit rajonal, ish Ministria e Zhvillimit Ekonomik tani Ministria e Ekonomisë e Republikës së Kosovës dhe Ministri për Ekonomi i Maqedonisë së Veriut, në shkurt 2019, nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi me qëllim të intensifikimit të bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve duke përcaktuar fushat prioritare për bashkëpunim në lidhje me sektorin e energjisë. Në funksion të zbatimit të këtij memorandum bashkëpunimi, në pjesën e parë të vitit 2019 përmes platformës WBIF është bërë një aplikim i përbashkët me palën Maqedonisë së Veriut, kjo e fundit në rolin e promotorit të projektit, për mbështetje financiare në formë granti për të realizuar një studim të fizibilitetit për gazsjellësin Maqedoni e Veriut - Kosovë. Sipas njoftimeve, Komiteti Drejtues i WBIF ka miratuar grantin në vlerën 0.650 mil. euro. Ky studim do të realizohet përmes asistencës teknike e angazhuar nga platforma WBIF/BERZH i cili planifikohet të realizohet në periudhën 2020-2021.

Më tej, me iniciativën e Korporatës së Sfidave të Mijëvjeçarit (MCC), në fillim të pjesës së parë të vitit 2020 është realizuar një studim i parafizibilitetit për gazifikimin e Kosovës nga konsulentët e angazhuar nga MCC. Sipas njoftimeve nga MCC, rezultatet e dala përveç inicimeve të zhvillimeve tjera, do të shërbejnë si mbështetje për përgaditjen e Master planit për shpërndarjen e gazit natyror për Kosovën dhe Studimin e fizibilitetit për interkoneksionin Maqedoni e Veriut - Kosovë

Institucionet kryesore që udhëheqin me sektorin e energjisë janë:

- Ministria e Ekonomisë (ME);
- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRÉ), që vepron si agjenci e pavarur rregullatorë që ka përgjegjësi për rregullimin e tregut të energjisë (energjisë elektrike, gazit natyror dhe energjisë së ngrohjes);
- Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM)- që vepron si agjenci e pavarur rregullatorë për rregullimin e aktivitetëve minerare ku bënë pjesë edhe thëngjilli;
- Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës (KOSTT sh.a.) e cila është ndërmarrje publike që menaxhon me rrjetin e transmisionit dhe ka rolin e Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Operatorit të Tregut të energjisë elektrike.

Institucionet e tjera qeveritare, siç janë Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), si dhe Komisioni Kosovar i Konkurrencës, kanë rol të rëndësishëm në mbikëqyrjen e përgjegjësive sociale, ekonomike dhe mjedisore të sektorit të energjisë

Tregu i komunikimeve elektronike

Në Kosovë sektori i komunikimeve elektronike dhe teknologjia informative ka rëndësi të madhe ekonomike. Në vitet e fundit, pjesëmarrja e këtij sektori në Bruto Produktin Vendor sillet rreth shifrës prej 2.2%. Sa u përket zhvillimeve në treg, telefonia fikse historikisht ka një zhvillim të ulët në vendin tonë. Në total deri tani kemi katër operatorë aktivë për ofrimin e shërbimeve telekomunikuese fikse:

- Telekom i Kosovës Sh.A. (ish PTK -), e licencuar më; 30/07/2004,
- IPKO Telecommunications LLC, e licencuar më; 08/09/2006,
- Kujtesa.Net, e licencuar më 07/01/2014 dhe
- Fiberlink (Vendimin nr. 607 (nr. prot. 013/B/15), ka caktuar bllokun numerik nga seria e numeracionit Gjeografik për përdorim nga "FiberLink" Sh.P.K.).
- Mts d.o.o posedon autorizim të përgjithshëm bazuar në marrëveshjen e telekomunikacionit në mes Republikës së Kosovës dhe Serbisë, nën lehtësimin e BE-së.

Sikurse në TM3 edhe në periudhën TM4 2020, ka vazhduar trendi rënës i parapaguesve të telefonisë fikse. Të dhënat për normën e penetrimit të telefonisë fikse në Kosovë në këtë tremujor janë 4.21%. Norma e penetrimit të telefonisë fikse në Kosovë vazhdon të jetë shumë e ulët krahasuar me vendet e rajonit, e sidomos me shtetet e BE-së.

Pjesëmarrjen më të lartë në treg e ka kompania publike Telekom i Kosovës, e ndjekur nga kompania IPKO dhe pastaj MTS D.O.O dhe Kujtesa Net. Sidoqoftë, të gjithë indikatorët e telefonisë fikse tregojnë për një zhvillim shumë të ngadalshëm dhe në rënie.

Sa u përket shërbimeve postare, Ligji nr. 06/L-038 për Shërbimet Postare është miratuar më 21 dhjetor 2018 dhe ka hyrë në fuqi me 2 shkurt 2019, me qëllim vendosjen e rregullave për sigurimin e ofrimit të shërbimit postar dhe shërbimit universal postar në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës, përcaktimi i kushteve për qasje në rrjetin postar, nxitja e konkurrencës së lirë, përcaktimi i parimeve për tarifën, sigurimi i transparencës së llogarive të ofrimit të shërbimit universal postar, përcaktimi i standardeve për shërbimin universal postar dhe vendosja e një sistemi për të siguruar pajtueshmërinë me këto standarde. Ky ligj është pjesërisht në përputhshmëri me Direktivën 97/67/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit. Sipas të dhënave nga ARKEP, kemi një rënie të theksuar të numrit të përgjithshëm të dërgesave postare. NPQ 'Posta Kosovës SHA', me 86.90%, mbulon tregun e përgjithshëm të shërbimeve postare kurse operatorët privatë janë të përfaqësuar në vlerën; 13.10% të tregut të përgjithshëm.

Tregu i telefonisë mobile ka shtrirjen më të gjerë në gjithë komunikimet elektronike. Shërbimet e telefonisë mobile në Kosovë ofrohen nga tre operatorë të rrjetave të telefonisë mobile në brezin frekuencor 900/1800 MHz përfshirë operatorin me autorizim të përkohshëm dhe të kufizuar në infrastrukturë mts D.O.O.:

- Telekom i Kosovës Sh.a/Vala e licencuar më datë; 30/07/2004 (ART nr. Prot. 111/04) me periudhë vlefshmërie prej 15 vite. Me Vendimin nr. 1419 dt. 30/07/ 2019 (Ref nr. Prot. 083/B/19) ARKEP ka bërë 'Ripërtrirjen e së drejtës së shfrytëzimit të resurseve Frekuencore për ndërmarrjen Telekom i Kosoves Sh.a. për 20 vjet.;
- IPKO Telecommunications LLC e licencuar më datë; 06/03/2007 (ART nr. Prot. 77/07) me periudhë vlefshmërie prej 15 vite; me Vendimin nr. 1420 dt. 30/07/2019 (Ref. nr. Prot. 084/B/19) ARKEP ka bërë 'Ripërtrirjen e së drejtës së shfrytëzimit të resurseve Frekuencore për ndërmarrjen IPKO Telecommunicatgions LLC për 20 vjet.
- Mts D.O.O. posedon Autorizim të përkohshëm bazuar në marrëveshjen e telekomunikacionit në mes Republikës së Kosovës dhe Serbisë, nën lehtësimin e BE-së. Kjo ndërmarrje shërbimet i ofron, përmes infrastrukturës së kufizuar vetëm në lokacione të caktuara dhe nuk ka të drejtën e shtrirjes.

Krahas tre operatorëve të autorizuar të rrjetave MNO (Mobile Network Operator) të përmendur më lartë, aktualisht në Republikën e Kosovës ekziston edhe një operator mobil virtual (MVNO):

- Dukagjini Telecommunications sh.a. (D3 mobile) e licencuar më datë; 24/06/2008 (ART nr. Prot. 124/08) i cili ofron kryesisht shërbime M2M.

Numri total i përdoruesve të telefonisë mobile në fund të tremujorit të katërt (TM4-2020) ka arritur në 1,988,721 përkatësisht për 4.1 % më i lartë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (TM4-2019) . Ndërsa, krahasuar me tremujorin paraprak TM3-2020 numri i përdoruesve është 2.37% më i ulët.

Numri i linjave të internetit me qasje fikse brez gjerë deri në TM4 2020 i raportuar nga operatorët është dhënë në figurën e mëposhtme dhe shënon shifrën 383,763 parapagues të internetit. Nga kjo vërehet rritje e konsiderueshme prej 21,664 parapagues apo 6 % në krahasim me TM3 2020, respektivisht një rritje prej 7.6 % në krahasim me periudhën TM4 2019. Ndërsa, penetrimi i internetit përmes qasjes fikse brezgjere në internet për ekonomi familjare është 129.2%, përkatësisht penetrimi i internetit sipas banorëve (për 100 banorë) rezulton të jetë 21.14%.

Numri i përdoruesve të shërbimeve të internetit mobil (Mobile Broadband) apo qasja në internet përmes rrjetit mobil 3G dhe 4G në periudhën TM4 2020 ka arritur në 1,275,309 përdoruesish e që shënon një rënie të lehtë prej -0.68% krahasuar me TM1 2020 përkatësisht rritje prej rreth 8% krahasuar me periudhën e njëjtë të viti 2019.

Sa i përket ndarjes së tregut të shërbimeve të internetit sipas përdoruesve për operator, në fund të 2020, Telekom i Kosovës kishte 8.75%, IPKO 27.11%, Kujtesa 16.38%, Artmotion 23.69% dhe të tjerët pjesën e mbetur. Sa i përket ndarjes së tregut të shërbimeve të internetit sipas të hyrave për operator, në fund të vitit

2020, Telekom i Kosovës kishte 7.27%, IPKO 26.71%, Kujtesa 24.74%, Artmotion 20.73% dhe të tjerët pjesën e mbetur.

Sa i përket **kornizës rregullative dhe të politikave**, Ligji për Komunikimet Elektronike dhe legjislacioni tjetër zbatues vendosin një kornizë gjithëpërfshirëse ligjore në harmoni me Direktivat e BE-së (Pakoja e Direktivave të vitit 2009, si plotësim-ndryshim i Pakos së Direktivave të vitit 2002 për sektorin e Komunikimeve Elektronike).

Ligji për Komunikimet Elektronike ndër të tjera ka krijuar bazën ligjore për kalimin nga regjimi i licencave në regjimin e autorizimeve të përgjithshme (ang. General Authorization) për ofrimin e shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike. Kjo nënkupton rritje të mundësive dhe përmirësim cilësor të ambientit për investime të reja dhe konkurrencë të drejtë e fer, çka edhe është një nga synimet (prioritetet) kryesore të Qeverisë.

Vizioni dhe qëllimet strategjike të Qeverisë së Kosovës për sektorin e teknologjisë informative, rrjedhimisht edhe për sektorin e Komunikimeve Elektronike janë të shprehura në dokumentin "Politikat e Sektorit të Komunikimeve Elektronike – Agjenda Digjitale për Kosovën 2013-2020". Dokumenti i Politikave është në përputhje edhe me objektivat e përcaktuara në Komunikatën e Komisionit Evropian të, 19 majit 2010, për Parlamentin Evropian, Këshillin e Evropës, Komitetin Evropian Ekonomik dhe Social dhe Komitetin e Rajoneve "Agjenda Digjitale për Evropën" (COM (2010) 245 final). Prioritetet Afatmesme bazuar në dokumentin e politikave për komunikimet Elektronike janë: zhvillimi i infrastrukturës së TIK, zhvillimi i shërbimeve dhe përmbajtjeve elektronike dhe promovimi i shfrytëzimit të tyre, avancimi i aftësive të banorëve gra dhe burra të Kosovës në përdorimin e TIK.

Në këtë dokument janë të transpozuar idetë dhe objektivat strategjike të parapara në Agjendën Digjitale për Evropën, duke marrë parasysh dhe iu përshtatur realitetit dhe gjendjes së sektorit të TIK në vend.

Struktura sektoriale dhe e ndërmarrjeve

Numri i përgjithshëm i bizneseve të regjistruara në ARBK në vitin 2020 ishte 9,805. Në krahasim me vitin 2019 (10,054), ka afërsisht 2% më pak biznese të regjistruara për shkak të situatës me COVID-19. Është pothuajse e njëjta situatë me kategoritë e tjera. Numri i bizneseve të mbyllura në vitin 2020 ishte 1,356 që është rreth 30% më pak se në vitin e kaluar (1,766). Numri i ndërmarrjeve në pronësi të huaj në vitin 2020 ishte 582 ndërsa në vitin 2019 ishte 696. Numri i kompanive të regjistruara në pronësi të grave në vitin 2020 ishte 1,764, më pak se në vitin 2019 (3,016).

Tabela 2.7. Numri i bizneseve të regjistruara, 2014 - 2020 Tetor

Përshkrimi	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Të regjistruara	9,404	9,833	10,553	9,335	9,966	10,054	9,805
Të shuara	1,671	2,205	2,378	1,589	1,892	1,766	1,356
Me pronare gra	1,529	2,020	2,332	2,096	2,443	3,016	1,764

Burimi: Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë

BPV-ja në TM4 2020 shënon rritje reale për 0.72%, krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraparak (TM4 2019). Aktivitetet ekonomike që kishin rritje në këtë tremujor ishin: industria nxjerrëse, përpunuese, energjia elektrike, dhe furnizimi me ujë (8.37%); informacioni dhe komunikimi (9.01%); aktivitetet e pasurive të paluajtshme (1.60%); artet, argëtimi dhe çlodhjet, dhe aktivitetet e tjera shërbimi (4.89%); administrimi publik, arsimit dhe shëndetësia (7.75%); aktivitetet profesionale dhe administrative (6.17%); tregtia, transporti, akomodimi dhe shërbimet ushqimore (1.92%); aktivitetet financiare dhe të sigurimit (25.26%). Ndërkaq, aktivitetet ekonomike që shënuan rënie në këtë tremujor ishin: ndërtimi (-16.05%); dhe bujqësia, pyjet dhe peshkimi (-0.31%). Komponentët e BPV-së sipas metodës së shpenzimeve që kishin rënie ishin: formimi i bruto kapitalit (-10.94%); eksporti i shërbimeve (-2.79%); dhe importi i shërbimeve (-3.58%). Ndërkaq, rritje në këtë tremujor kishin: eksporti i mallrave (49.44%); importi i mallrave (5.11%); shpenzimet e konsumit final të ekonomive shtëpiake dhe IJPSHESH (3.80%); dhe shpenzimet e konsumit final të Qeverisë (3.12%).

Sa i përket madhësisë së sektorit privat, pjesëmarrja e investimeve të sektorit privat në BPV lëviz midis 84 dhe 86 pikë të përqindjes në periudhën 2016-2022 siç shihet në tabelën më poshtë. Investimet private pritet të kenë të njëjtin trend edhe në 2020, 2021 dhe 2022. Konsumi privat bazuar në projeksionet për vitin 2020 pritet të ketë trend të njëjtë sikurse në vitet paraprake.

Tabela 2.8. Pjesëmarrja e sektorit privat në BPV reale, në%

Përshkrimi	2016	2017	2018	2019	2020	2021 (proj.)	2022 (proj.)	2023 (proj.)
Konsumi privat	86%	84%	85%	85%	90%	87%	86%	84%
Investimet private	20%	21%	22%	22%	20%	21%	21%	22%

Burimi: Projekligji i Buxhetit 2021, MFPT

Integrimi ekonomik me BE-në dhe konkurrueshmëria e çmimeve

Tregtia e mallrave në vitin 2020 kishte në vlerë prej 2.8 miliardë Eurosh, që tregon për një deficit tregtar më të ulët për (-9.4%), krahasuar me vitin 2019. Do të thotë se edhe në këtë vit është një bilanc negativ. Totali i eksporteve në këtë vit ishte 474.8 milionë Euro, ndërsa importi 3.2 miliardë Euro. Eksporti mbulon importin për vetëm 14.4%.

Duke krahasuar të dhënat e eksporteve për mallrat kosovare gjatë viti 2020 me atë të vitit 2019, shifrat tregojnë se është një rritje vjetore për 23.8%. Rritje, e cila ka edhe më tutje bilancin negativ tregtar të Kosovës.

Eksportet sipas sektorëve në këtë vit kishin rritje në këto grupe: artikuj të ndryshëm të prodhuar në vlerë rreth 49.7 milionë Euro (krahasuar me 20.0 milionë Euro, ose 10.5% e eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 148.9%); produkte të industrisë kimike në vlerë rreth 18.7 milionë Euro (krahasuar me 8.1 milionë Euro, ose 4.0% e eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 130.2%); produktet bimore në vlerë rreth 31.7 milionë Euro (krahasuar me 22.9 milionë Euro, ose 6.7% e eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 38.3%); tekstil dhe artikuj tekstili, në vlerë rreth 15.2 milionë Euro (krahasuar me 11.5 milionë Euro, ose 3.2% e eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 32.3%); metale bazë dhe artikuj prej tyre, në vlerë rreth 173.9 milionë Euro (krahasuar me 134.3 milionë Euro, ose 36.6% e eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 29.4%); mjetet e transportit në vlerë rreth 5.1 milionë Euro (krahasuar me 3.9 milionë Euro, ose 1.1% e eksporteve të përgjithshme me një rritje prej 29.3%); artikuj prej guri, allçie, prodhim qeramike dhe qelqi, në vlerë rreth 10.4 milionë Euro (krahasuar me 8.5 milionë Euro, ose 2.2% e eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 23.0%); makineri, pajisje mekanike dhe elektrike, në vlerë rreth 20.3 milionë Euro (krahasuar me 16.8 milionë Euro, ose 4.3% e eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 20.7%); plastikë, gomë dhe artikuj prej tyre, në vlerë rreth 57.1 milionë Euro (krahasuar me 50.8 milionë Euro, ose 12.0% e eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 12.5%); ushqime të përgatitura, pije, pije alkoolike dhe duhan, në vlerë rreth 43.5 milionë Euro (krahasuar me 39.8 milionë Euro, ose 9.2% e eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 9.4%); letër dhe artikuj prej letre, në vlerë rreth 4.5 milionë Euro (krahasuar me 4.3 milionë Euro, ose 1.0% të eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 3.6%).

Gjatët kësaj periudhe, kishte rënie të eksporteve në këto grupe: lëkurë dhe artikuj prej saj, në vlerë rreth 4.1 milionë Euro (krahasuar me 6.5 milionë Euro, ose 0.9% e eksporteve të përgjithshme, me një rënie prej 36.9%); produktet minerale, në vlerë rreth 26.0 milionë Euro (krahasuar me 40.0 milionë Euro, ose 5.5% e eksporteve të përgjithshme, me një rënie prej 34.8%); druri dhe artikuj druri, në vlerë rreth 5.4 milionë Euro (krahasuar me 5.7 milionë Euro, ose 1.1% e eksporteve të përgjithshme, me një rënie prej 5.6%).

Trend pozitiv të rritjes së eksporteve nga 2010-2020, kanë pasur këto grupe të sektorëve: plastika, goma dhe artikujt prej tyre, nga 8.1 milionë Euro në 57.1 milionë Euro; artikujt e ndryshëm të prodhuar, nga 1.9 milionë Euro në 49.7 milionë Euro; ushqimet e përgatitura, pijet, pijet alkoolike dhe duhani, nga 11.5 milionë Euro në 43.5 milionë Euro; produktet bimore nga 12.2 milionë Euro në 31.7 milionë Euro.

Të dhënat e tregtisë së mallrave për importin e Kosovës në vitin 2020 kanë shënuar një rënie vjetore rreth (-5.7%), duke krahasuar me vitin paraprak, 2019.

Rritje te importet sipas sektorëve janë vërejtur në këto grupe: produktet e industrisë kimike, në vlerë rreth 283.9 milionë Euro (krahasuar me 246.9 milionë Euro, ose 8.6% e importeve të përgjithshme, me një rritje

prej 15.0%); yndyrat, në vlerë rreth 32.1 milionë Euro (krahasuar me 30.0 milionë Euro, ose 1.0% e importeve të përgjithshme, me një rritje prej 6.9%); instrumentet optike, mjekësore, fotografike, muzikore etj., në vlerë rreth 45.1 milionë Euro (krahasuar me 43.0 milionë Euro, ose 1.4% e importeve të përgjithshme, me një rritje prej 4.8%); produktet bimore, në vlerë rreth 163.9 milionë Euro (krahasuar me 160.5 milionë Euro, ose 5.0% e importeve të përgjithshme, me një rritje prej 2.1%); plastika, goma dhe artikujt prej tyre, në vlerë rreth 224.5 milionë Euro (krahasuar me 220.8 milionë Euro, ose 6.8% e importeve të përgjithshme, me një rritje prej 1.7%); makineria, pajisjet mekanike dhe elektrike, në vlerë rreth 434.9 milionë Euro (krahasuar me 431.7 milionë Euro, ose 13.2% e importeve të përgjithshme, me një rritje prej 0.8%); ushqimet e përgatitura, pijet, pijet alkoolike dhe duhani, në vlerë rreth 422.2 milionë Euro (krahasuar me 420.4 milionë Euro, ose 12.8% e importeve të përgjithshme, me një rritje prej 0.4%).

Ndërkaq, rënie të importeve kishte te këto grupe: produktet minerale (lëndët djegëse), në vlerë rreth 353.8 milionë Euro (krahasuar me 517.6 milionë Euro, ose 10.7% e importeve të përgjithshme, me një rënie prej 31.7%); lëkura dhe artikujt prej saj, në vlerë rreth 7.2 milionë Euro (krahasuar me 10.4 milionë Euro, ose 0.2% e importeve të përgjithshme, me një rënie prej 30.9%); veshmbathjet (këpucët dhe pjesët e artikujve të tillë), në vlerë rreth 35.0 milionë Euro (krahasuar me 43.5 milionë Euro, ose 1.1% e importeve të përgjithshme, me një rënie prej 19.5%); artikujt e ndryshëm të prodhuar, në vlerë rreth 87.6 milionë Euro (krahasuar me 99.9 milionë Euro, ose 2.7% e importeve të përgjithshme, me një rënie prej 12.4%); letër dhe artikuj prej letre në vlerë rreth 47.1 milionë Euro (krahasuar me 52.5 milionë Euro ose 1.4% e importeve të përgjithshme me rënie prej 10.2%), mjetet e transportit të ndryshëm në vlerë rreth 288,8 milionë Euro (krahasuar me 314,7 milionë Euro ose 8.8% e importeve të përgjithshme me rënie prej 8.2%), metale bazë dhe artikuj prej tyre, në vlerë rreth 351.1 milionë Euro (krahasuar me 371.4 milionë Euro, ose 10.7% e importeve të përgjithshme, me një rënie prej 5.5%); tekstili dhe artikujt prej tij, në vlerë rreth 163.1 milionë Euro (krahasuar me 173.2 milionë Euro, ose 4.9% e importeve të përgjithshme, me një rënie prej 5.9%); druri dhe artikuj nga druri, në vlerë rreth 80.6 milionë Euro (krahasuar me 83.4 milionë Euro, ose 2.4% e importeve të përgjithshme, me një rënie prej 3.3%); artikujt prej guri, allçie, prodhim qeramike dhe qelqi, në vlerë rreth 112.5 milionë Euro (krahasuar me 115.6 milionë Euro, ose 3.4% e eksporteve të përgjithshme, me një rënie prej 2.7%); kafshët e gjalla, produktet me origjinë kafshe, në vlerë rreth 147.2 milionë Euro (krahasuar me 148.7 milionë Euro, ose 4.5% e importeve të përgjithshme, me një rënie prej 1.1%).

Eksportet e Kosovës në vendet e BE-së arritën në 163.4 milionë Euro, ose rreth 34.4% e eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 28.5%. Partnerët kryesorë për eksportin e mallrave në BE janë: Gjermani (9.3%), Italia (6.0%), Holanda (4.6%), etj. Sipas kapitujve, pjesëmarrje më të lartë nga vendet e BE-së kanë këto grupe të eksporteve: hekur dhe çelik, 35.6 milionë Euro, ose rreth 21.8%; plastika dhe artikujt prej saj, 28.3 milionë Euro, ose rreth 17.3%; mobilieritë: krevatet, dyshekët, mbajtëset e dyshekëve dhe shtresa të ngjashme të mbushura, llambat dhe pajisjet e ndriçimit (jo të përfshira diku tjetër), 10.0 milionë Euro, ose rreth 6.1% etj.

Importet e Kosovës nga vendet e BE-së ishin rreth 1.5 miliardë Euro, ose 45.8% e importeve të përgjithshme, me një rënie prej (-12.0%). Importet me pjesëmarrje më të lartë ishin nga: Gjermania (13.0%), Italia (5.6%), Greqia (4.2%), Sllovenia (3.2%) dhe Polonia (3.1%), etj. Vendet e BE-së mbulojnë pjesën më të madhe të importeve të përgjithshme të Kosovës. Importet me pjesëmarrje më të lartë ishin te kapitujt: mjetet e transportit të ndryshëm, 238.2 milionë Euro, ose rreth 15.8%; lëndët djegëse minerale dhe vajrat minerale, produktet e destinimit të tyre, 172.4 milionë Euro, ose rreth 11.4% etj.

Gjatë vitit 2020, eksportet e Kosovës me vendet e CEFTA-s arritën në 210.7 milionë Euro, ose 44.4% të eksporteve të përgjithshme, ku kishte rritje prej 27.8%. Partnerë kryesorë për eksport në vendet e CEFTA-s ishin: Shqipëria (23.2%), Maqedonia e Veriut (9.3%), Serbia (6.4%) dhe Mali i Zi (3.9%). Sipas kapitujve, pjesëmarrje më të lartë nga vendet e CEFTA-s kishin këto grupe të eksporteve: hekuri dhe çeliku, 55.8 milionë Euro, ose rreth 26.5%; artikujt prej hekuri dhe çeliku, 30.6 milionë Euro, ose rreth 14.6%; pijet, pijet alkoolike dhe uthulla, 20.7 milionë Euro, ose rreth 9.8% etj.

Ndërsa, importet nga vendet e CEFTA-s, në vitin 2020 arritën në 615.3 milionë Euro, ose 18.7% të importeve të përgjithshme, me një rritje prej 22.4%. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import ishin: Shqipëria (5.8%), Maqedonia e Veriut (5.7%), Serbia (5.3%). Importet me pjesëmarrje më të lartë ishin te kapitujt: hekuri dhe çeliku, 120.3 milionë Euro, ose rreth 19.6%; kripërat, sulfuret, oksidet, gurët, materialet suvatuese, gëlqerja dhe çimentoja, 55.8 milionë Euro, ose rreth 9.1% etj.

Eksportet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 100.6 milionë Euro, ose 21.2%. Si partnerë më të rëndësishëm nga këto vende për eksport ishin: Zvicra (8.2%), SHBA (5.0%).

Ndërsa, importet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 1.1 miliardë Euro, ose 35.5%. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import në këtë grup ishin: Turqia (12.4%) dhe Kina (9.8%).

Objektivat prioritarë afatmesme:

- Ulja e konsumit të energjisë nëpërmjet masave të efijencës së energjisë duke zbatuar masa në ndërtesa publike, amvisëri, sektorin privat dhe ndërtesa shumë-banesore më 2021 dhe 2022;
- Zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve prodhuese të energjisë, përfshirë kapacitetet prodhuese me bazë thëngjillin për plotësimin e kërkesave në rritje për energji elektrike;
- Përmirësimi i mjedisit për Inovacion dhe Ndërmarrësi, përfshirë rritjen e mbështetjes financiare dhe infrastrukurore të inovacionit dhe ndërmarrësisë dhe ngritjen e kapaciteteve njerëzore;
- Shtrirja e infrastrukturës së rrjetave të TIK-ut për zhvillim socio-ekonomik veçanërisht shtrirja e infrastrukturës brezgjere në vise të pambuluara si dhe digjitalizimi i bizneseve;
- Rritja e efikasitetit për kosto të transaksioneve ndërkombëtare tregtare nëpërmjet thjeshtimit dhe standardizimit të të gjitha formaliteteve dhe procedurave në kufi, me synim harmonizimin e praktikave në përputhje me marrëveshjet shumëpalëshe;
- Harmonizimi i ofertës dhe kërkesës përmes hartimit të standardeve të profesionit dhe rishikimit të kurrikulave;
- Ngitja e cilësisë në arsimin dhe aftësimin profesional bazuar në kërkesat e tregut të punës;
- Rritja e qasjes së të rinjve dhe grave në tregun e punës përmes ofrimit të shërbimeve cilësore të punësimit, masave aktive të punësimit dhe ndërmarrësisë;
- Përmirësimi i shërbimeve sociale e shëndetësore përmes funksionalizimit të fondit të sigurimeve shëndetësore.

3. BLOKU 3: STANDARDET EVROPIANE – PËRAFRIMI I LEGJISLACIONIT TË KOSOVËS ME ACQUIS-NË E BE-SË

3.0. Korniza ligjore për përafrimin e legjislacionit të Kosovës me acquis-në e BE-së

Përafrimi dhe zbatimi i legjislacionit të Kosovës me acquis të BE-së është parakusht kryesor për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian. Përafrimi nënkupton pajtueshmërinë e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Kosovës me acquis të BE-së dhe përmban dy komponentë: marrjen përsipër të detyrimeve që rrjedhin nga acquis e BE-së dhe zbatimin e saj në praktikë.

Në kuadër të komponentit të parë, marrja përsipër e detyrimeve që rrjedhin nga acquis e BE-së është e specifikuar në nenin 74 të MSA-së. Ky nen përcakton përafrimin gradual të legjislacionit të Republikës së Kosovës me atë të BE-së dhe zbatimin efektiv në praktikë. Ai kërkon që fillimisht përafrimi të përqendrohet në elementet themelore të acquis së BE-së në fushën e tregut të brendshëm, në fushën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë, si dhe në fusha e tjera të lidhura me tregtinë. Ai gjithashtu përcakton s procesi i përafrimit të legjislacionit të bëhet sipas një programi të akorduar ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Komisionit Evropian.

Në mënyrë specifike, ky nen kërkon që Republika e Kosovës dhe KE të përcaktojnë modalitetet për monitorimin e zbatimit të përafrimit të legjislacionit. Detyrimet që rrjedhin për Kosovën janë të kombinuara në disa akte ligjore, ndërsa prioritetet dhe reformat konkrete për përafrim të legjislacionit dhe modalitetet për monitorimin e zbatimit janë të përcaktuara në PKZMSA. Rrjedhimisht, monitorimi i progresit në përafrimin e legjislacionit është tejet i rëndësishëm për arsye të përditësimit të ecurisë së në çfarë shkalle qëndron procesi i përafrimit të legjislacionit të Kosovës me acquis-në e BE-së.

Programi i përafrimit të legjislacionit dhe modalitetet për monitorimin e zbatimit të legjislacionit janë mekanizma esencial që dokumentojnë se si detyrimet ligjore të acquis së BE-së të përcaktuara sipas neneve përkatëse që mbulojnë sektorë të ndryshme të MSA-së, reflektojnë shkallën, nivelin, cilësinë dhe përmbajtjen substanciale ligjore brenda legjislacionit të Republikës së Kosovës.

Në kuadër të komponentit të dytë, zbatimi i detyrimeve që kërkohet sipas nenit 74 të MSA-së kërkon kapacitet administrative dhe mekanizma ligjor me përmbajtje teknike dhe udhëzues për përafrimin e legjislacionit të Republikës së Kosovës me acquis të BE-së. Aktualisht, procesi i përafrimit të legjislacionit të Republikës së Kosovës me acquis të BE-së bazohet në akte ligjore dhe udhëzues/manualë ndihmëse për përafrimin e legjislacionit me acquis të BE-së të miratuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Aktet ligjore në fuqi të cilat ndërlidhen me procesin e përafrimit të legjislacionit të miratuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës janë:

- Rregullorja e punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës;
- Rregullorja për shërbimin ligjor qeveritar;
- UA për standardet e hartimit të akteve normative.

Udhëzimet/manualët për përafrimin e legjislacionit të Republikës së Kosovës me acquis të BE-së janë:

- Udhëzuesi Praktik i vitit 2014 për përafrimin e legjislacionit të Republikës së Kosovës me legjislacionin e BE-së;
- Manuali Praktik i vitit 2015 për plotësimin e tabelave dhe deklaratës së përputhshmërisë me acquis të BE-së.

Udhëzimet/manuali për përafrim të legjislacionit janë instrumente me përmbajtje teknike-ligjore që udhëzojnë dhe shërbejnë për zyrtarët përgjegjës gjatë procesit të hartimit dhe përafrimit të legjislacionit të Republikës së Kosovës me acquis së BE-së. Përgjithësisht, aktet ligjore dhe udhëzimet/manuali për procesin e përafrimit të legjislacionit të Republikës së Kosovës me acquis të BE-së i referohen procesit të përafrimit të legjislacionit në mënyrë të përgjithësuar.

Në aspektin procedural, procesi i vlerësimit të përafrimit të legjislacionit të Republikës së Kosovës me acquis të BE-së përbëhet prej disa hapave. Hapi fillestar nis nga institucionet përgjegjës që harton projekt-aktin normativ; në këtë fazë ai, përmes përpilimit të Deklaratës së Përputhshmërisë (DeP) dhe Tabelave të

Përputhshmërisë (TeP) me acquis të BE-së paraprakisht vlerëson nivelin e përafrimit. Hapi vijues është vlerësimi i përafrimit me acquis të BE-së. Kjo bëhet përmes opinionit ligjor të pajtueshmërisë me acquis të BE-së, i cili përmbledh dy lloje gjetjesh: mbi substancën e projekt-aktit normativ dhe mbi pajtueshmërinë e Deklaratës së Përputhshmërisë (DeP) dhe Tabelave të Përputhshmërisë (TeP) me acquis të BE-së. Hapi tjetër ndërlidhet me përcjelljen e opinionit ligjor të përputhshmërisë me acquis të BE-së tek institucioni përgjegjës që ka hartuar projekt aktin normativ. Pastaj, institucioni përgjegjës që ka hartuar projekt-aktin normativ ia përcjell Zyrës së Kryeministrit për pëlqim në aspektin procedural e kushtetues, dhe përcillet për miratim në Qeveri. Pas miratimit nga Qeveria, projektligjet dorëzohen në Kuvend për miratim. Kryesisht, pakoja e projektligjit me të gjitha dokumentet relevante i dërgohet Komisionit për Legjislacion, Komisionit për Integrim Evropian dhe, sipas fushëveprimit të projektligjit, mund t'u dërgohet edhe komisioneve të tjera, të cilët bëjnë rishikimin, analizën, si dhe sipas nevojës plotësim-ndryshimin e projektligjit përkatës dhe më pas dërgohet për miratim.

I tërë procesi i përafrimit i legjislacionit ndërlidhet me përkthimin e acquis së BE-së në gjuhët zyrtare të Kosovës, përkatësisht në gjuhën shqipe dhe gjuhën serbe. Përkthimi i acquis së BE-së është pjesë integrale e procesit të përafrimit të legjislacionit vendor me acquis të BE-së. Procesi i përkthimit të legjislacionit të BE-së është i rregulluar me *Rregulloren nr. 02/2015 për Procesin e Përkthimit të Legjislacionit të BE-së në Gjuhët Zyrtare të Republikës së Kosovës*, e cila përcakton procedurat e përkthimit, koordinimin e procesit të përkthimit, si dhe unifikimin e terminologjisë të acquis së BE-së në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës. Në kuadër të bashkëpunimit rajonal, në mes të Kosovës dhe Shqipërisë është nënshkruar Marrëveshje Bashkëpunimi për krijimin e Komisionit Teknik për Përkthimin e Legjislacionit të BE-së në gjuhën shqipe, si dhe bashkëpunimit në sferën e përafrimit të legjislacionit (2015), për koordinimin e agjendës së përbashkët të përkthimit të akteve të BE-së bazuar në aktet relevante për përafrim të përcaktuara në MSA, si dhe shkëmbimin e akteve ligjore të përkthyer të BE-së nga të dy vendet. Vlen të theksohet që Komisioni Teknik ka krijuar platformën elektronike 'albterm.net' në të cilën azhurnohen aktet e acquis të përkthyer në gjuhën shqipe në bazë të kalendarit të përkthimit të acquis së BE-së. Gjithashtu, në 2015 është nënshkruar edhe Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" në fushën e përkthimit të legjislacionit të BE-së.

Objektivat prioritarë afatmesme

Objektivat prioritarë afatmesme në fushën e përafrimit dhe përkthimit në Republikën e Kosovës janë koordinimi, bashkërendimi dhe raportimi i vazhdueshëm i procesit të përafrimit. Në mënyrë specifike fuqizimi dhe koordinimi i kapaciteteve brenda shërbimit ligjor qeveritar do të mundësojë përmbushjen e detyrimeve legjislative që rrjedhin nga neni 74 i MSA-së.

Objektivat e prioritarë afatmesme në fushën e përafrimit:

- Rishikimi i legjislacionit për shërbimin ligjor qeveritar dhe udhëzimeve/manualëve praktike për përafrim të legjislacionit me qëllim përmirësimin e fushëveprimit të procesit të përafrimit të legjislacionit të Kosovës me acquis të BE-së;
- Funkcionalizimi i plotë i platformës elektronike për hartimin e akteve normative dhe përafrim të legjislacionit;
- Azhurnimi i listës së acquis së BE-së dhe përcjellja tek departamentet ligjore të institucioneve të linjës për përafrim të legjislacionit që përfshijë projekt aktet normative bazuar në konkluzionet e takimeve të vitit 2021 të MSA-së, Raportin e KE-së 2021, ERA II;
- Rritja e numrin të trajnimeve të avancuara profesionale që kanë për qëllim përafrimin substancial të legjislacionit të Kosovës me acquis të BE-së në fushat primare të përafrimit për tetë kapitujt: Liria e Lëvizjes së Mallrave, e Drejta e Themelimit dhe Liria e Ofrimit të Shërbimeve, Prokurimi Publik, e Drejta e Kompanive, e Drejta e Pronësisë Intelektuale, e Drejta e Konkurrencës, Gjyqësori dhe të Drejtat e Njeriut, Drejtësia, Liria dhe Siguria.

Objektivat e prioritarë afatmesme në fushën e përkthimit:

- Rritja e numrit të përkthimeve të akteve të acquis së BE-së në gjuhët zyrtare të Kosovës dhe themelimin e Komisioneve për Certifikimin e akteve të përkthyer të akteve të acquis së BE-së në gjuhët zyrtare të Kosovës;
- Rritja e bashkëpunimit në mes të palëve të interesit (ministrive të linjës) në Kosovë lidhur me përkthimet e akteve të acquis së BE-së, dhe rritjen e bashkëpunimit dhe bashkërendimit ndërmjet palëve të interesit (njësive koordinuese në ministrinë e linjës) në vendet e rajonit për përkthimin e akteve të acquis së BE-së në gjuhët zyrtare të Kosovës;
- Hartimi i udhëzuesit për certifikimin e acquis së BE-së në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës;
- Azhurnimi i vazhdueshëm të platformës elektronike ‘albtterm.net’ për publikimin e akteve të BE-së të përkthyer në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.

3.1. Kapitulli 1 i acquis-së: Lëvizja e lirë e mallrave

Ky kapitull mbulon kërkesat që dalin nga acquis legjislativi i BE-së me qëllim që të sigurohet qarkullimi plotësisht i lirë i produkteve në tregun e brendshëm dhe respektimit të zbatimit të këtij parimi të përgjithshëm nga secili shtet anëtar. Për të siguruar respektimin dhe zbatimin e këtij parimi themelor të funksionit të tregut të brendshëm, me qëllim që produktet të përmbushin standardet dhe kërkesat për t'u tregtuar në tregun e brendshëm të BE-së, zbatimi i këtij kapitulli nga ana e shteteve aderuese u kërkon atyre që të vendosin tërë kornizën ligjore e rregullative, në harmoni me atë të BE-së, për ‘qasjen e vjetër’ (që përcakton kërkesat specifike për produkte) dhe ‘qasjen e re’ (që përcakton specifikimet esenciale për produkte). Harmonizimi i legjislativit vendor arrihet përmes transpozimit të plotë të acquis-it të BE-së në kuadër të fushëveprimit të këtij kapitulli deri në anëtarësimin e plotë. Përveç kësaj, shteteve aderuese gjithashtu u kërkohet të zhvillojnë dhe zbatojnë politika nacionale për të siguruar zbatimin e legjislativit të harmonizuar me atë të BE-së, si dhe të vendosin dhe funksionalizojnë plotësisht tërë sistemin institucional dhe kapacitetet institucionale që nevojiten për të zbatuar këtë legjislacione e politika, si dhe për të zbatuar masat horizontale e procedurale në fushat specifike të standardizimit, vlerësimit të konformitetit, akreditimit, metrologjisë dhe mbikëqyrjes së tregut.

Lëvizja e lirë e mallrave është një element kyç në krijimin dhe zhvillimin e tregut të brendshëm. nenet 34, 35 dhe 36 të Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFBE), parandalojnë Shtetet Anëtare që të miratojnë dhe vendosin kufizime të pajustificuara ndaj tregut të lirë të mallrave brenda tregut të brendshëm, përveç tregtisë brenda BE-së. Dispozitat e TFBE-së nuk përjashtojnë ndalesat e justifikuara, dhe zbatohen proporcionalisht, mbi bazën e moralit publik, politikave publike ose sigurisë publike, mbrojtjes së shëndetit dhe jetës së njerëzve, kafshëve ose bimëve, apo mbrojtjes së pronësisë industriale e komerciale, si dhe të kërkesave të tjera të detyrueshme të njohura nga Gjykata e Drejtësisë (p.sh. mbrojtja e mjedisit). Masat që kanë efekt të barasvlershëm me kufizim sasiar, përveç disa përjashtimeve, gjithashtu janë të ndaluara. Kjo sidomos nënkupton eliminimin e barrierave teknike në tregti dhe respektimin e parimit të njohjes së ndërsjellë, përfshirë procedurat e shkëmbimit të informatave.

Legjislativi i qasjes së re dhe globale mbulon pajisjet e tensionit të ulët (LVD), kontabilitetin elektromagnetik (EMC), lodrat, makinerinë, ashensorët, emetimet e zhurmës nga pajisjet për përdorim jashtë objekteve, emetimet e ndotësve nga motorët e makinerive të lëvizshme jo rrugore, pajisjet personale mbrojtëse (PPM), pajisjet dhe sistemet mbrojtëse të destinuara për përdorim në atmosfera shpërthyes (ATEX), pajisjet mjekësore, pajisjet e gazit, veglat nën presion, instalimet e teleferikut, produktet e ndërtimit, artizanate rekreative, kërkesat e eko-projektimit për produktet e lidhura me energjinë (ErP), dhe pajisjet terminale të radio dhe telekomunikacionit (R&TTE). Legjislativi i qasjes së vjetër mbulon fushat e automjeteve motorike dhe kimikateve.¹⁰

Kërkesat e MSA-së

Marrë parasysh angazhimin e palëve ndaj tregtisë së lirë, në përputhje me parimet përkatëse të Organizatës Botërore të Tregtisë, të cilat duhet të zbatohen në mënyrë transparente dhe jo-diskriminuese, MSA, në Titullin IV “Lëvizja e lirë e mallrave”, përmban disa dispozita thelbësore relevante për këtë kapitull.

¹⁰ Farmaceutikët dhe kozmetikët janë të mbuluara në Kapitullin 28.

Në nenin 20 thuhet se BE dhe Kosova gradualisht do të krijojnë një zonë të tregtisë së lirë gjatë një periudhe maksimale prej 10 vjetësh, duke filluar nga hyrja e MSA-së në fuqi. Në nenin 22 ("koncesionet e BE-së për produktet industriale") thuhet se kufizimet sasiore mbi importet në BE dhe masat me efekt të njëjtë, për produktet me origjinë në Kosovë, do të shfuqizohen në datën e hyrjes së MSA-së në fuqi. Kosova ka marrë përsipër të njëjtin koncesion për produktet industriale me origjinë në BE (neni 23). Në nenin 24 ("Detyrimet dhe kufizimet mbi eksportin") të dy palët shpallin se me hyrjen e MSA-së në fuqi do të heqin të gjitha kufizimet sasiore mbi eksportet dhe masat ekuivalente.

Neni 35 i MSA-së e definojnë çështjen e indikatorëve gjeografikë, mirëpo ajo shtjellohet në kapitullin 7, mbi DPI. Neni 42 i jep të drejta palëve që të marrin masa mbrojtëse në rast të gjetjes së veprimeve të dumpingut, këto veprime duhet të jenë në pajtim me rregullat e OBT-së, pjesa që zbaton nenin 6 të GATT-it 1994.

Lidhur me mbrojtjen e tregut, MSA kërkon të zbatohet neni XIX i GATT 1994 dhe rregullat e OBT-së për mbrojtje të tregut. Neni 43 kërkon që masat e mbrojtjes së tregut të merren vetëm për qëllimin e adresimit të problemit, dhe cek se këto masa nuk guxojnë të merren në një periudhë më të gjatë se dy vite.

Kërkesat nga mekanizmat e tjerë të aderimit në BE

Raporti i KE-së për Kosovën – 2020 vlerëson Kosova duhet të implementojë legjislacionin për kërkesat teknike të produktve dhe vlerësimin të konformitetit, të forcojë kapacitetet në fushën e infrastrukturës së cilësisë, si dhe të amendamentohet Rregullorja për regjistrimin, vlerësimin, autorizimin dhe kufizimin e kimikateve (REACH).

Konkluzionet e Nënkomitetit për Tregti, Industri, Dogana dhe Tatime të vitit 2020, theksojnë nevojën e plotësimit të legjislacionit primar me atë sekondar në kuadër të të gjitha fushave të Infrastrukturës së Cilësisë, si dhe ngritjen e kapaciteteve zbatuese.

Gjendja aktuale

Korniza legjislativ dhe ajo e politikave

Çështjet horizontale

Korniza legjislativ në fushën e Standardizimit përbëhet nga këto akte kryesore normative:

- Ligjin nr. 06/L-019 për Standardizim nr. 06/L-019;
- UA nr. 08/2018 për Këshillin Profesional të Standardizimit;
- UA nr. 10/2018 për Logon e Agjencisë Kosovare të Standardizimit;
- UA nr. 16/2018 mbi Komitetet Teknike të Standardizimit.

Këto akte normative kanë transpozuar pjesërisht Rregulloren (BE) 1025/2012, e cila përcakton kërkesat për Standardizim – pjesërisht.

Korniza legjislativ në fushën e Akreditimit përbëhet nga këto akte kryesore normative:

- Ligjin nr. 05/L-117 për Akreditim;
- Rregullorja nr. 02/2018 e Këshillit Profesional. Këshilli Profesional është organ këshillëdhënës i Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit të Kosovës (DAK);
- UA nr. 03/2018 për Caktimin e Tarifave për Akreditim.
- UA nr. 04/2019 për caktimin e formës, përmbajtjes dhe përdorimit të logos të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit të Kosovës dhe simbolit të akreditimit dhe referimi i tekstit në akreditim.

Këto akte normative kanë transpozuar pjesërisht Rregulloren (KE) nr. 765/2008, e cila përcakton kërkesat për akreditim dhe mbikëqyrje të tregut që kanë të bëjnë me vënien e produkteve në treg.

Korniza legjislativ në fushën e Vlerësimit të Konformitetit përbëhet nga:

- Ligji nr. 06/L -041 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit, i cili ka transpozuar pjesërisht Vendimin nr. 768/2008/KE të Parlamentit Evropian për një kornizë të përbashkët për marketingun e produkteve;

- UA nr. 12/2018 për mënyrën e Emërimit të Trupave për Vlerësim të Konformitetit.
- Rregullore nr. 25/2018 për Përbajtjen dhe Mënyrën e Menaxhimit të Regjistrit të Rregullave Teknike
- Rregullore nr. 28/2018 për Mënyrën e Notifikimit dhe Ofrimit të Informacioneve mbi Rregulloret Teknike, Procedurat për Vlerësimin e Konformitetit dhe Standardet.
- UA nr. 03/2020 për formën dhe përbajtjen e shenjës së Konformitetit dhe mënyrën e njohjes së dokumenteve të huaja të Konformitetit
- Rregullorja nr. 24/2020 për Grupet e Produkteve të cilat janë subjekt i Mbikëqyrjes Inspektuese

Korniza legislative në fushën e Metrologjisë përbëhet nga këto akte kryesore normative:

- Ligjin nr. 06/L -037 për Metrologjinë;
- Rregullorja nr. 04/2018 për Peshoret Jo-automatike;
- Rregullorja nr. 03/2018 për Parapaketimet;
- UA nr. 04/2018 për Shishet si Enë Matëse;
- UA nr. 05/2018 për Lartësinë dhe Procedurën e Pagesës për Shërbimet në Metrologji;
- UA nr. 14/2018 për Kërkesat Teknike dhe Metrologjike për Transformatorët Matës të Grupeve Matëse për Matjen e Energjisë Elektrike.
- UA nr. 02/2020 për Caktimin e Formës, Përbajtjes dhe Përdorimin e Logos së Agjencisë së Metrologjisë së Kosovës
- UA nr. 03/2020 për Lartësinë dhe Procedurën e Pagesës për Shërbimet në Metrologji.
- Rregullorja nr. 02/2020 për Etalonet Shtetëror të Matjes dhe Materialet Referente
- Rregullorja nr. 03/2020 për Këshillin e Metrologjisë;
- UA nr. 04/2020 për Mbikëqyrjen Metrologjike.

Këto akte normative kanë transpozuar këto akte të acquis-së:

- Direktivën e BE-së 2014/32 për harmonizimin e ligjeve të shteteve anëtare përkitazi me vënien në dispozicion të tregut të mjeteve matëse - pjesërisht;
- Dokumentin D1: 2012 të OIML-së -pjesërisht;
- Direktivën 2014/31/BE, miratuar më 11 qershor 2018 - pjesërisht;
- Direktivën 76/211/KEE, miratuar më 28 maj 2018 - pjesërisht;
- Direktivën 75/107/KEE, miratuar më 28 maj 2018 - pjesërisht.

Korniza legislative në fushën e Mbikëqyrjes së Tregut përbëhet nga këto akte kryesore normative:

- Ligji nr. 06/L-041 mbi Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit;
- Ligji nr. 04/L-078 mbi Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve;
- Ligji nr. 03/L-181 mbi Inspektoratin e Tregut dhe Mbikëqyrjen Inspektuese.

Qasja e re dhe ajo globale

Korniza legislative në fushën e Pajisjeve të tensionit të ulët (LVD) përbëhet nga Ligji nr. 06/L-041 mbi Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit i cili paraqet bazën për Rregulloren teknike nr. 06/2018 për Pajisjet Elektrike të Dizajnuara për Përdorim Brenda Kufijve të Caktuar të Tensionit, e cila ka transpozuar pjesërisht Direktivën 2014/35/BE.

Korniza legislative në fushën e Përputhshmërisë elektromagnetike (EMC) përbëhet nga Ligji nr. 04/L-039 mbi Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit paraqet bazën për Rregulloren nr. 01/2017 për Pajtueshmërinë Elektromagnetike, e cila ka transpozuar pjesërisht Direktivën 2014/30/BE dhe amendamentet e saj. Kjo rregullore do të vazhdojë të zbatohet deri në harmonizimin e saj me Ligjin e ri nr. 06/L-041 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit.

Korniza legislative në fushën e Sigurisë së lodrave përbëhet nga Ligji nr. 04/L-039 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit i cili paraqet bazën për Rregulloren nr. 02/2017 për Sigurinë e Lodrave, e cila transponon pjesërisht Direktivën 2009/48/KE dhe amendamentet e saj. Kjo rregullore do të

vazhdoj të zbatohet deri në harmonizimin e saj me Ligjin e ri nr. 06/L-041 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit.

Korniza legjislative në fushën e makinerive përbëhet nga Ligji nr. 04/L-039 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit, i cili paraqet bazën për Rregulloren nr. 02/2020 mbi Sigurinë e Makinerive, e cila transponon pjesërisht Direktiven 2006/42/KE të datës 17 maj 2006 për Sigurinë e Makinerive.

Korniza legjislative në fushën e emetimeve të zhurmës nga pajisjet që përdoren jashtë objekteve përbëhet nga UA nr. 08/2009 mbi Vlerat e Lejuara të Emisioneve të zhurmës nga burimet e ndotjes i cili transponon pjesërisht Direktivën 2000/14/KE.

Korniza legjislative në fushën e ashensorëve përbëhet nga Ligji nr. 04/L-039 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit i cili paraqet bazën për Rregulloren nr. 03/2017 për Sigurinë e Ashensorëve e cila transponon Direktivën 2014/33/BE. Kjo rregullore do të vazhdojë të zbatohet deri në harmonizimin e saj me Ligjin për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit.

Korniza legjislative në fushën e Pajisjeve personale mbrojtëse (PPE) përbëhet nga Ligji nr. 04/L-039 mbi Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit, i cili paraqet bazën për Rregulloren nr. 08/2012 mbi Pajisjet Personale Mbrojtëse, e cila transponon pjesërisht Direktivën 89/686/KEE. Kjo rregullore do të vazhdoj të zbatohet deri në harmonizimin e saj me Ligjin nr. 06/L-041 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit. Në pajtim me këtë të fundit, gjatë vitit 2020 do të transpozohet Rregullorja 2016/425/BE për Pajisjet Mbrojtëse Personale në rregulloret teknike.

Korniza legjislative në fushën e Pajisjeve dhe sistemeve mbrojtëse të destinuara për përdorim në atmosfera potencialisht shpërthyes (ATEX) përbëhet nga Ligji nr. 04/L-039 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit, i cili paraqet bazën për Rregulloren nr. 04/2012 mbi Pajisjet dhe Sistemet Mbrojtëse të Destinuar për Përdorim në Atmosfera Potencialisht Shpërthyes, e cila transponon pjesërisht Direktivën 94/9/KE. Kjo rregullore do të vazhdoj të zbatohet deri në harmonizimin e saj me Ligjin nr. 06/L-041 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit.

Korniza legjislative në fushën e Pajisjeve të gazit dhe bojlerët me ujë të nxehtë përbëhet nga Ligji nr. 04/L-039 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit, përmes Rregullores nr. 06/2016 për Pajisjet që Djejin Karburantet e Gazta, e cila transponon pjesërisht Direktivën 90/396/KEE. Kjo rregullore do të vazhdoj të zbatohet deri në harmonizimin e saj me Ligjin nr. 06/L-041 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit.

Korniza legjislative në fushën e Pajisjeve nën presion përbëhet nga Ligji nr. 06/L-031 për Pajisjet nën Presion, i cili transponon pjesërisht këto akte të acquis-së:

- Direktivën 2014/68/B;
- Direktivën 2014/29/BE;
- Direktivën 2010/35/BE;
- Direktivën 2008/47/KE.

Korniza legjislative në fushën e Pajisjeve të thjeshta nën presion (SPVD) përbëhet nga Ligjin nr. 06/L-031 për Pajisje nën Presion. UA mbi Enët e Thjeshta nën Presion, që derivon nga ligji i vjetër nr. 02-L-103, transponon pjesërisht Direktivën 2009/105/KE, dhe do të mbetet në fuqi deri në momentin e nxjerrjes së Rregullores për Pajisjet e Thjeshta nën Presion, i cili do të transpozohet pjesërisht rregulloren 2014/29/BE.

Korniza legjislative në fushën e Aerosolëve dispensivë përbëhet nga Ligji nr. 04/L-039 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit, i cili paraqet bazën për miratimin e Rregullores nr. 13/2014 mbi Aerosolët Dispensiv, e cila transponon pjesërisht Direktivën 75/324/KEE.

Korniza legjislative në fushën e Teleferikëve përbëhet nga Ligji nr. 04/L-039 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit, i cili paraqet bazën për miratimin e Rregullores nr. 05/2012 mbi Teleferikët për Transport Njerëzish, e cila transponon pjesërisht Direktivën 2000/9/KE.

Korniza legislative në fushën e Produkteve ndërtimore përbëhet nga Ligji nr. 06/L-033 për Produktet Ndërtimore, i cili transponon pjesërisht Rregullon e BE 305/2011 për Produktet e Ndërtimit.

Korniza legislative në fushën e Barkave rekreative përbëhet nga Ligji nr. 06/L-041 mbi Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit. Megjithatë, Kosova ende nuk ka miratuar legjislacionin detyrësorë i cili do të duhet të transpozohet Direktivën 94/25/KE.

Në fushën e Kërkesave të eko-dizajnit për produktet e ndërlidhura me energjinë (ErP) dhe etiketimit energjetik i produkteve ende nuk është transpozuar në legjislacionin vendor Direktiva horizontale 2009/125/KE për eko-dizajn dhe as aktet përkatëse vertikale ligjore.

Korniza legislative për radio-pajisjet dhe pajisjet terminale telekomunikuese (R&TTE) Rregulloren teknike për radio-pajisjet përbëhet nga Ligji nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike, që transponon pjesërisht Rregulloren 136/2009/KE. Lidhur me konformitetin e radio-pajisjeve dhe pajisjeve telekomunikuese, Rregullorja teknike për Radio Pajisjet nr. 032/B/17 transponon pjesërisht Direktivën 2014/53/KE.

Korniza legislative në fushën e Eksplozive për përdorime civile dhe artikujve piroteknikë përbëhet nga Ligji nr. 2011/04-L-022 për Përdorimin Civil të Eksplozivëve, i cili transponon pjesërisht Direktivën 93/15/KE për eksplozivë dhe Direktivën 2013/29/KE për Piroteknikë.

Korniza legislative në fushën e Produkteve dhe pajisjeve mjekësore përbëhet nga këto akte kryesore normative:

- Ligjin nr. 04-L-190 për Produkte dhe Pajisje Mjekësore;
- UA nr. 01/2015 për Autorizim Marketing për Produkte Mjekësore;
- UA nr. 07/2015 për Përcaktimin e Kushteve për Praktikën e mirë të Prodhimit, Lëshimin e Autorizimit të Prodhimit dhe Certifikatën e Praktikës së Mirë Prodhuese për Praktikë Mjekësore;
- UA nr. 09/2017 për Farmakovigjilencën e Produkteve Medicinale për Përdorim Njerëzor në Republikën e Kosovës.

Këto akte normative kanë transpozuar këto akte të acquis-së:

- Direktivën 2001/83;
- Direktivën 2002/98;
- Direktivën 2003/63;
- Direktivën 2004/24;
- Direktivën 2004/27;
- Direktivën 2008/29, ;
- Direktivën 2009/53;
- Direktivën 2009/120;
- Rregulloren 726/2004;
- Rregulloren 1394/2007 – pjesërisht;
- Direktivën 2001/83;
- Direktivën 2011/62;
- Direktivën 2001/20; dhe
- Direktivën 2003/94 – pjesërisht.

Qasja e vjetër

Sa i përket Qasjes së vjetër, përveç prodhuesve të produkteve përkatëse, shteti është gjithashtu përgjegjës për sigurinë e produkteve dhe për këtë arsye duhet krijuar dhe fuqizuar autoritetet përkatës shtetërore për kryerjen e detyrave të vlerësimit të konformitetit (p.sh. regjistrimi, vlerësimi dhe miratimi).

Korniza legislative në fushën e Automjeteve Motorike përbëhet nga Ligjit nr. 05/L-132 për Automjete, nga i cili rrjedhë UA nr. 2/2018 për Përcaktimin e Kushteve dhe Procedurave të Homologimit të Mjeteve Rrugore.

Sa i përket *Emetimeve te ndotësve nga motorët e makinerive të lëvizshme jo-rrugore*, në Kosovë, nuk ka prodhues të produkteve (automjeteve) që mbulohen nga Direktiva 97/68 mbi makineritë e lëvizshme jo-rrugore. Detyrimet për operatorët ekonomik do të zbatohen nga importuesit dhe shpërndarësit.

Korniza legjislative në fushën e *Kimikateve (Regjistrimi, Vlerësimi, Autorizimi dhe Kufizimi i Kimikateve, RVAK)* përbëhet nga Ligji nr. 04/L-197 për Kimikate, i cili transponon pjesërisht Rregulloren (KE) 1907/2006.

Korniza legjislative në fushën e *Kimikateve (Klasifikimi, Etiketimi dhe Paketimi (KEP) Automjeteve Motorike* përbëhet nga Ligji nr. 04/L-197 për Kimikate dhe UA nr. 17/2014 për Klasifikimin, Etiketimin dhe Paketimin e Kimikateve të Rrezikshme, që transponojnë pjesërisht Rregulloren (KE) 1272/2008 për Klasifikimin, Etiketimin dhe Paketimin e Substancave dhe Përzierjeve.

Në kuadër të *Praktikave të mira laboratorike (GLP)*, Direktiva 2004/9/KE përcakton detyrimin e Shteteve Anëtare të përcaktojnë autoritetet përgjegjëse për inspektimet GLP në territorin e tyre. Ajo gjithashtu përfshin kërkesat e raportimit dhe tregut të brendshëm (pranimi i ndërsjellë i të dhënave). Direktiva kërkon që Udhëzimet e Rishikuara OECD për Procedurat e Monitorimit të Pajtueshmërisë për GLP dhe Udhëzimi OECD për Ushtrimin e Inspektimit të Stabilimentit Testues dhe Auditimet e Studimit duhet të ndiqen gjatë inspektimeve laboratorike dhe auditimeve të studimit.

Direktiva 2004/10/KE kërkon nga Shtetet Anëtare të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që laboratorët që kryejnë studimet e sigurisë në produktet kimike të jenë në përputhje me Parimet e OECD-së të Praktikave të mira laboratorike.

Korniza legjislative në fushën e *Detergjentëve*, konkretisht për përcaktimin e kërkesave teknike dhe procedurave të vlerësimit të konformitetit përbëhet nga Ligji për Kimikate nr. 04/L-197 dhe Rregullorja nr. 02/2015 për Detergjentet që transponojnë pjesërisht Rregulloren (KE) 648/2004.

Korniza legjislative në fushën e *Plehrave* përbëhet nga këto akte kryesore normative:

- Ligji nr. 2003/10 mbi Plehra Artificiale;
- UA nr. 10/2006 për Cilësinë e Plehrave Artificiale;
- UA nr. 17/2007 për Formimin dhe Funkcionimin e Shërbimit Rregullues dhe Bordit Këshillues për Plehrat Artificiale;
- UA nr. 04/2009 mbi Vendosjen e Taksës për Licencimin e Subjekteve që merren me Importin dhe Tregtinë e Plehrave Artificiale.

Këto akte normative kanë transponuar pjesërisht Rregulloren (KE) 2003/2003.

Korniza legjislative në fushën e *Prekursorëve dhe barërave* përbëhet nga Ligji nr. 02/L-128 për Barna Narkotike, Psikotropet dhe Prekursorët, i cili transponon pjesërisht Rregulloren (KE) 273/2004. Ndërsa UA nr. 02/2019, i vitit 2019 rregullon çmimet e produkteve medicinale për shitje me shumicë dhe pakicë në sektorin privat nga subjektet e licencuara, produkteve medicinale nga lista e barnave esenciale dhe produkteve medicinale nga lista e barnave të ri-mbursueshme nga Fondi i Sigurimit Shëndetësor.

Masat procedurale

Sa i përket *transparencës në lidhje me çmimet dhe riimbursimin e produkteve mjekësore* Kosova ende nuk e ka përafuar legjislacionin e saj me acquis të BE-së në këtë fushë.

Korniza legjislative në fushën e *Qelqi i kristaltë* përbëhet nga Rregullorja nr. 04/2012 mbi Produktet e Qelqit të Kristaltë, e cila transponon pjesërisht Direktivën 69/493/KE.

Korniza legjislative në fushën e *Tekstilit* përbëhet nga këto akte kryesore normative:

- Rregullorja nr. 01/2018 për Etiketimin dhe Shënjimimin e Produkteve të Tekstilit;
- Rregullorja nr. 11/2012 mbi Përmbajtjen e Lëndës së parë dhe Etiketimin e Tekstilit;
- Rregullorja nr. 1/2012 mbi Metodën për Analizën Sasiore të Përzierjes së Trefishtë të Fibrave të Tekstilit;
- Rregullorja nr. 12/ 2012 mbi Metodën për Analizën Sasiore të Përzierjes së Dyfishtë të Fibrave të Tekstilit.

Këto akte normative kanë transponuar këto akte të acquis-së:

- Direktivën 73/44/KEE;
- Direktivën 96/73/KE;
- Direktivën 2008/121/KE;
- Rregulloren (BE) 1007/2011 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 27 shtator 2011, mbi emrat e fibrave të tekstitit dhe etiketimin dhe shënjinin e përbërjes së fibrave të produkteve të tekstitit.

Korniza legjislative në sektorin e Këpucëve përbëhet nga Ligji nr. 04/L-039 mbi Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit, i cili paraqet bazën për Rregulloren nr. 03/2016 për Etiketimin e Mbathjeve, e cila transponon plotësisht Direktivën 94/11/KE. Kjo rregullore do të vazhdojë të zbatohet deri në harmonizimin e saj me Ligjin nr. 06/L-041 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit.

Aktualisht në Kosovë ka disa prodhues të këpucëve dhe/ose komponentëve të tyre në nivelin mikro që mbulohen nga Direktiva 94/11/KE. Detyrimet për operatorët ekonomik kryesisht do të zbatohen nga importuesit dhe shpërndarësit.

Korniza institucionale

Cështjet horizontale

Korniza institucionale sa i përket infrastrukturës së cilësisë përbëhet nga këto institucione:

- Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, përkatësisht Divizioni i Infrastrukturës së Cilësisë pranë Departamentit të Industrisë;
- Drejtoria e Akreditimit të Kosovës (DAK) në kuadër të MINT-së;
- Inspektorati i Tregut në kuadër të MINT-së;
- Agjencia Kosovare për Standardizim (AKS);
- Agjencia për Metrologjinë e Kosovës (AMK).

Qasja e re dhe ajo globale

Korniza institucionale në këtë kategori përbëhet nga këto institucione:

- Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë,
- Ministria e Ekonomisë, përgjegjëse për Barkat Rekreative dhe vëzhgimin e përdorimit të produkteve të ndërtimit;
- Ministria e Punëve të Brendshme, përgjegjëse për eksplozivët për përdorim civil dhe produktet piroteknike;
- Ministria e Shëndetësisë, përgjegjëse për produktet dhe pajisjet mjekësore;
- Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Mjekësore (AKPPM), përgjegjëse për produktet dhe pajisjet mjekësore;
- Autoriteti Rregullativ për Komunikimet Elektronike dhe Postare (ARKEP) (përgjegjës për përafrimin ligjor ashtu edhe për mbikëqyrjen e tregut në fushën e Radio Pajisjeve dhe Pajisjeve terminale telekomunikuese (R&TTE).

Qasja e vjetër

Korniza institucionale në kuadër të kësaj kategorie përbëhet nga këto institucione:

- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, përkatësisht Departamenti i Automjeteve. Kompetencat e "autoritetit aprovues" kryhen nga Ministria e Infrastrukturës, ndërsa kompetencat e "shërbimeve teknike" kryhen nga trupat privat të autorizuar nga Ministria e Infrastrukturës. Departamenti i Automjeteve brenda MI është autoritetet përgjegjëse për të kryer mbikëqyrjen e tregut të automjeteve motorike (vetura, autobusë, kamionë, traktorë) në territorin e Kosovës. Ndërsa strukturat për Ambient janë përgjegjëse për Kimikatet dhe Detergjentet, kompetent për transpozimin e Rregullores (KE) 1907/2006.

- Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë përgjegjëse për transpozimin e legjislacionit të BE-së në legjislacionin kombëtar sa u përket rmetimeve të ndotësve nga motorët e makinerive të lëvizshme jo-rrugore;
- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, kompetente për nxjerrje të legjislacionit në lidhje me Plehrat, ndërsa mbikëqyrja e tregut zbatohet nga Inspektorati fito-sanitar;
- Ministria e Shëndetësisë, autoriteti kompetent për legjislacion në fushën e Prekursorëve të barërave, ndërsa zbatimi ekzekutohet nga Agjencia Kosovare për Produkte dhe Pajisje Mjekësore (AKPPM). Mbikëqyrja e tregut kryhet nga AKPPM-ja dhe Inspektorati Shëndetësor.

Masat procedurale

Korniza institucionale në kuadër të kësaj kategorie përbëhet nga këto institucione:

- Agjencia Kosovare për Produkte dhe Pajisje Mjekësore (AKPPM), përgjegjëse për transparencën në lidhje me çmimet dhe riimbursimin e produkteve mjekësore;
- Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë kompetente për transpozimin dhe zbatimin në fushën e Qelqit të kristaltë, Tekstilët dhe Këpucët.

Mbështetja e donatorëve

Institucionet e Kosovës mbështeten nga KE (përmes IPA-s) dhe nga donatorë të tjerë bilateralë me projektet e përmbledhur në vijim.

Mbështetje institucionale të Kosovës në procesin integruar, është programi i Qeverisë së Luksemburgut i cili ka si synim ngritjen e kapaciteteve institucionale të Republikës së Kosovës në zbatimin e prioritetëve që dalin nga MSA. Ky projekt ka filluar më 2019 dhe do ofrojë mbështetje për institucionet kosovare të infrastrukturës së cilësisë.

Ky kapitull gjithashtu mbështetet në mënyrë indirekte nga donatorët e Gjermanisë përmes GIZ.

Objektivat prioritarë afatmesme

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA dhe dokumentet e mekanizmat të tjerë të aderimit në BE në kuadër të fushëveprimit të kapitullit 1, fokusi gjatë periudhës 2021-2024 do të jetë në këto objektiva prioritarë afatmesme:

Masat horizontale:

- Miratimi i legjislacionit sekondar për zbatimin e ligjit për inspektime të përgjithshme, konkretisht pjesa e mbikëqyrjes së tregut;
- Anëtarësimi i plotë i DAK-së në EA, nënshkrimi i MLA me EA-në;
- Anëtarësimi i plotë i Agjencisë së Metrologjisë në BIPM, OIML dhe Euramet;
- Funksionalizimi i laboratorit të kohës dhe frekuencës, dhe fuqizimi i laboratorëve ekzistues të metrologjisë;
- Organizimi i aktiviteteve vetëdijesuese për biznese në lidhje me rolin e infrastrukturës së cilësisë;
- Realizimi i një studimi për vlerësimin e nivelit të informimit të bizneseve për infrastrukturë të cilësisë, përfshirë MSA-në;
- Ngritja e kapaciteteve të stafit përgjegjës për infrastrukturën e cilësisë.

Qasja e re dhe ajo globale:

- Transpozimi i acquis të BE-së mbi qasjen e re të produkteve dhe mbikëqyrjen e tregut - me fokus në Rregulloren mbi Sigurinë e Produkteve të Konsumit dhe Rregulloren për Mbikëqyrjen e Tregut të produkteve;
- Miratimi i legjislacionit sekondar për zbatimin e ligjit për produktet e ndërtimit
- Ngritja e kapaciteteve të stafit.

3.2. Kapitulli 2 i acquis-së: Liria e lëvizjes së punonjësve

Acquis në këtë kapitull parasheh që qytetarët e një shteti anëtar BE-së të kenë të drejtën për të punuar në një Shtet tjetër Anëtar. Punëtorët migrantë BE-së duhet të trajtohen në të njëjtën mënyrë si punëtorët vendas në lidhje me kushtet e punës, kushtet sociale dhe avantazhet e taksave. Acquis gjithashtu përfshinë një mekanizëm për të koordinuar dispozitat e sigurimeve shoqërore kombëtare për personat e siguruar dhe anëtarët e familjeve të tyre që lëvizin në një Shtet tjetër Anëtar. Struktura e kapitullit është ndarë në katër pjesë të cilat prezantohen shkurtimisht në vazhdim.

Acquis për **qasjen në tregun e punës** ofron të drejta për qytetarët e një shteti anëtar për të punuar në shtetet e tjera anëtare, të banojnë në atë shtet me familjet e tyre për këtë qëllim dhe të trajtohen në mënyrën e njëjtë me shtetasit e atij vendi sa i përket kushteve të punës, përparësive sociale dhe të tatimit. Këtu përfshihen edhe të drejtat për pension suplementar për të punësuarit, përfshirë të vet-punësuarit brenda BE-së.

Rrjeti EURES (Shërbimet Evropiane të Punësimit) synon të promovojë lirinë e lëvizjes së punëtorëve brenda BE-së përmes bashkëpunimit të shërbimeve nacionale të punësimit dhe shkëmbimit të informacionit për mundësitë për punësim.

E drejta e lëvizjes së punëtorëve komplementohet nga një **sistem i koordinimit të sigurimeve shoqërore** ku hyjnë të drejtat e punëtorëve migrantë dhe familjarëve të tyre të fitojnë në mënyrë kumulative dhe të transferojnë benefitet e sigurimeve sociale përfshirë edhe pagesën e atyre benefiteve. Kjo është e bazuar në rregulloret të BE-së që nuk harmonizojnë por koordinojnë sistemet e sigurimeve sociale të vendeve anëtare duke kërkuar bashkëpunim mes tyre.

Karta Evropiane e Sigurimit Shëndetësor jepet për të gjithë shtetasit për të riimbursuar shpenzimet mjekësore për trajtimin e nevojshëm të punëtorëve të sëmurë ose aksidentuar gjatë qëndrimit të përkohshëm në vendin tjetër anëtar, për shembull si turistë.

Kërkesat e MSA-së

Sipas MSA-së, neni 55 parasheh që një kompani e BE-së e themeluar në Kosovë apo një kompani Kosovare e themeluar në BE, në përputhje me legjislacionin në fuqi në vendin e themelimit, ka të drejtë të punësojë në një degë të saj punëtorë të cilët janë shtetas të BE-së apo Kosovës përkatësisht, nëse ky personel është personel kyç – i specifikuar me paragrafin 2 të këtij neni.

Gjithashtu neni 79, paragrafi 9, sa i përket punësimit dhe lëvizjes së punëtorëve lidhur me përmbushjen e kontratave publike, acquis i BE-së në lidhje me shtetasit e vendeve të treta do të zbatohet Sa u përket qytetarëve të Kosovës në BE. Në lidhje me shtetasit e BE-së në Kosovë, Kosova do tu japë të drejta reciproke punonjësve të cilët janë shtetas të një Shteti Anëtar ngjashëm me ato të qytetarëve të Kosovës në BE sa i përket punësimit dhe lëvizjes së punëtorëve lidhur me përmbushjen e kontratave publike.

Gjendja aktuale

Korniza legjislative

Korniza legjislative në këtë fushë përbëhet nga këto akte kryesore normative:

- Ligji nr. 04/L219 për të Huaj;
- Ligji nr. 03/L-212 i Punës;
- Ligji nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti;
- Ligji nr. 04/L-220 për Investimet e Huaja.

Këto akte normative kanë transpozuar këto akte të acquis-së:

- Direktivën 96/71/KE në lidhje me dërgimin e punëtorëve në kuadër të ofrimit të shërbimeve dhe ndryshimit të Rregullores (BE) nr. 1024/2012 për bashkëpunimin administrativ nëpërmjet Sistemit Informativ të Tregut të Brendshëm ('Rregullorja IMI').
- Direktivën 96/71 më 2014 e cila direktive rregullon më hollësisht çështjen e inspektimit të punëtorëve të huaj dhe procesin e bashkëpunimit ndërkombëtar nga organet kompetente në

fushën e sigurimit social të vendeve nga janë dërguar punëtorët e huaj, përkatësisht punëdhënësi i huaj i vendosur në Kosovë për një kohë të caktuar.

- Direktivën e cila rregullon çështjen e inspektimit të punëtorëve të huaj është Direktiva 2014/67/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit datë 15 maj 2014 për zbatimin e Direktivës 96/71/KE në lidhje me ricaktimin e të punësuarve në kuadër të ofrimit të shërbimeve dhe ndryshimit të Rregullores (BE) nr. 1024/2012 për bashkëpunimin administrativ nëpërmjet Sistemit informativ të tregut të brendshëm ('Rregullorja IMI') (Tekst, kuptimi i të cilit lidhet me ZEE-në).
- Rregullorja 883/2004 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit Evropian, 29 prillit 2004, për bashkërendimin e sistemeve të sigurimeve shoqërore,
- Rregullorja 987/2009 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit Evropian, e 16 shtatorit 2009, që përcakton procedurën për zbatimin e Rregullores 883/2004 për bashkërendimin e sistemeve të sigurimeve shoqërore.

Korniza institucionale:

- Ministria e Ekonomisë;
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve;
- Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
- Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Ministria e Punëve të Brendshme;
- Kuvendi i Kosovës.

Objektivat prioritarë afatmesme

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA dhe dokumentet e mekanizmat të tjerë të aderimit në BE në kuadër të fushëveprimit të kapitullit 2, fokusi gjatë periudhës 2021-2024 do të jetë në këto objektivat prioritarë afatmesme:

- Negocimin dhe arritjen e marrëveshjeve lidhur me sigurimet shoqërore për qytetarët e saj që jetojnë dhe punojnë jashtë Kosovës si edhe për punëtorët e shteteve anëtare të BE-së të punësuar në Kosovë, në zbatim të rekomandimeve të Komisionit Evropian.
- Rishikimin e kornizës ligjore për rregullimin dhe menaxhimin e pensioneve dhe beneficioneve përfshirë administrimin më të mirë të pensioneve të financuara nga shteti përmes një organi të vetëm në MFPT;
- Përafrimi i legjislacionit me *acquis*, duke transpozuar:
 - Direktivën 79/7/KEE për trajtimin e barabartë sa i përket aspekteve sociale në harmoni me mundësitë dhe kapacitetet e vendit;
 - Direktivën 2014/67/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit datë 15 maj 2014 për zbatimin e Direktivës 96/71/KE në lidhje me ricaktimin e të punësuarve në kuadër të ofrimit të shërbimeve dhe ndryshimit të Rregullores (BE) nr. 1024/2012 për bashkëpunimin administrativ nëpërmjet Sistemit informativ të tregut të brendshëm ('Rregullorja IMI') (Tekst, kuptimi i të cilit lidhet me ZEE-në)
- Rishikimi i kornizës ligjore për shërbime sociale dhe familjare dhe formulës së financimit të shërbimeve sociale dhe familjare.

3.3. Kapitulli 3 i *acquis*-së: E drejta e themelimit të kompanive dhe liria e ofrimit të shërbimeve

Legjislacioni i BE-së për të drejtën e themelimit dhe lirinë e ofrimi të shërbimeve kërkon nga shtetet anëtare të sigurojnë të drejtën e themelimit e shtetasve të BE-së dhe personave juridikë në çdo Shtet Anëtar, dhe që liria për të ofruar shërbime ndër-kufitare, e definuar në nenin 49 dhe 56 të TFBE, të mos pengohet nga legjislacioni kombëtar, përveç rasteve të përjashtimeve të vendosura në traktatin e BE-së. Legjislacioni bazë për këtë fushë është Direktiva 2006/123 KE për shërbimet në tregun e brendshëm (Direktiva e Shërbimeve). Edhe praktikat gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian, pjesë e *acquis*, duhet të respektohen.

Në lidhje me **të drejtën e themelimit dhe lirinë për të ofruar shërbime**, Direktiva e Shërbimeve synon të lehtësojë themelimin dhe ofrimin e shërbimeve në vendet e tjera anëtare dhe të ofrojë shërbime ndërkufitare mes vendeve anëtare. Meqenëse Direktiva është instrument horizontal që mbulon një fushë të gjerë të shërbimeve, zbatimi i saj kërkon kombinim të masave legislative, organizative dhe praktike. Dispozitat e direktivës në një masë të konsiderueshme bazohen në praktikat gjyqësore të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në fushat e lirisë së themelimit dhe ofrimit të shërbimeve dhe plotësojnë instrumentet ekzistuese të BE. Direktiva obligon vendet anëtare të krijojnë një 'Pikë të vetme kontakti' dhe të marrin pjesë në një sistem elektronik të informacionit¹¹ për shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunim në mbikëqyrjen e shërbimeve midis vendeve anëtare.

Sa i përket **njohjes reciproke të kualifikimeve profesionale**, Direktiva 2005/36/KE e amendamentuar nga Direktiva 2013/55/BE vendos rregullat rreth njohjes së diplomave dhe kualifikimeve tjera ndërmjet vendeve anëtare. Kjo lehtëson ushtrimin e profesionit të qytetarëve të BE-së nga një vend në një tjetër për profesionet e rregulluara. Direktiva gjithashtu rregullon ofrimin e përkohshëm të shërbimeve nga profesionistët (Titulli II i Direktivës) dhe një kurrikulë të përbashkët të trajnimeve minimale për disa profesione të rregulluara (Kapitulli III i Titullit III të Direktivës). Gjithashtu, ekziston legjislacioni që rregullon ushtrimin e profesionit për gjyqtarët, agjentët komercial dhe njohja e kualifikimeve profesionale që lidhet me përdorimin, tregtimin dhe distribuimin e produkteve toksike. Në lidhje me kapacitetin administrativ, kërkohet që të ketë një kontakt nacional për pranimin e kërkesave për njohje të kualifikimeve profesionale dhe për bashkëpunim administrativ me autoritetet e vendeve anëtare.

Në fushën e **shërbimeve postare**, legjislacioni bazë përbëhet nga Direktiva e parë Postare 97/67/KE (Direktiva kornizë) e amendamentuar nga Direktiva e dytë Postare dhe Direktiva e tretë Postare 2008/6/KE që synojnë krijimin e tregut të brendshëm të shërbimeve postare duke hapur këtë treg ndaj konkurrencës në mënyrë graduale, dhe ofrimin e një shërbimi universal postar të kualitetit të lartë për shfrytëzuesit. Sa i përket kapacitetit administrativ, kërkohet krijimi i një autoriteti të pavarur kombëtar rregullator për të siguruar zbatimin adekuat të legjislacionit të BE.

Kërkesat e MSA-së

Dispozitat kryesore të MSA që rregullojnë këtë fushë janë të përfshira në nenet 51, 56, 57, 58, 59 dhe 74. Sipas nenit 51, Kosova obligohet që me hyrjen në fuqi të MSA-së të sigurojë trajtim të barabartë kompanive të BE-së me ato vendore sa u përket kushteve të punës, pagesave dhe trajtimit të punëtorëve dhe subjekteve juridike të cilët themelohen juridikisht në territorin e Kosovës. Neni 57 i MSA-së definon që pas 6 viteve nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshje, Këshilli i Stabilizim Asociimit (KSA) duhet të krijoj modalitetet për të zgjeruar dispozitat e kapitullit mbi ofrimin e shërbimeve për shtetasit e BE-së dhe qytetarëve të Kosovës. Neni 58 i MSA-së obligon Kosovën që pesë vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, KSA-ja të marrë masat e nevojshme për të zbatuar në mënyrë progresive lejimin e ofrimit të shërbimeve nga kompanitë e BE-së, nga kompanitë Kosovare ose nga shtetasit e BE-së dhe qytetarët e Kosovës të cilat janë të vendosur në territorin e njëjës Pale, për persona të tjerë përveç atyre për të cilët dedikohen shërbimet.

Sipas Nenit 74 të MSA-së, Kosova detyrohet që të përafroj **legjislacionin** e saj ekzistues dhe të ardhshme me *acquis-in* e BE-së, si dhe të siguroj hyrjen në fuqi dhe zbatimin në mënyrë të duhur. Në një fazë të hershme, përafrimi do të përqendrohet në elementet thelbësorë të *acquis-it* të BE në fushën e Tregut të Brendshëm si dhe në fushat e lidhura me tregti.

Sa u përket profesioneve të rregulluara, sipas Nenit 56 të MSA-së, Këshilli të Stabilizim-Asociimit (KSA) obligohet që brenda dy viteve nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes, do të shqyrtojë se cilët hapa janë të nevojshëm për njohjen reciproke të kualifikimeve, me qëllim që të lehtësohet ky proces për shtetasit e BE-së dhe qytetarët e Kosovës që të fillojnë dhe ndjekin veprimtaritë e rregulluara profesionale përkatësisht në Kosovë dhe në BE.

Kërkesat nga mekanizmat e tjerë të aderimit në BE

¹¹ Sistemi Informativ i Tregut të Brendshëm.

Sa i përket *Lirisë për të ofruar Shërbime, Raporti i KE-së për Kosovën 2020*, thekson se Kosova duhet të largojë të gjitha barrierat e identifikuar për të garantuar lirinë për të ofruar shërbime, duke zbatuar planin e veprimit për zbatimin e plotë të Ligjit për Shërbime.

Sa u përket *shërbimeve postare, Raporti i KE-së për Kosovën – 2020* kërkon vazhdimin e transpozimit të *acquis* në legjislacionin vendor dhe hapjen e mëtejshme të tregut postar në Kosovë.

Në fushën e *njohjes reciproke të kualifikimeve profesionale, Raporti i KE-së për Kosovën 2020*, theksohet se Kosova duhet të transpozojë legjislacionin vendor me *acquis* në fushën e njohjes reciproke të kualifikimeve profesionale. Raporti nënvizon se legjislacioni sekondar duhet të miratohet dhe se duhet të vazhdohen përpjekjet për zhvillimin e strukturave institucionale për njohjen reciproke të kualifikimeve.

Në konkluzionet nga takimi i Nënkomitetit për Treg të Brendshëm, Konkurrencë dhe Mbrojtje të Konsumatorit dhe Shëndetit të mbajtur në vitin 2021 theksohet nevoja që Kosova të përafrojë legjislacionin e saj me atë të BE-së, të themelojë Pikën e Vetme të Kontaktit dhe të zhvillojë kapacitetet e institucioneve që merren me shërbimet.

Gjendja aktuale

Korniza legjislative dhe ajo e politikave

Korniza legjislative dhe ajo e politikave në fushën e të drejtës së themelimit dhe lirisë për të ofruar shërbime

Korniza legjislative në këtë fushë përbëhet nga këto akte kryesore normative:

- Ligji nr. 05/L-130 për Shërbime;
- UA për Mënyrën e Funkcionimit të Pikës së Vetme të Kontaktit;
- UA për Procedurën e Njoftimit dhe Vlerësimin e Përputhshmërisë së Projekt-akteve Normative.

Këto akte normative kanë transpozuar Direktivën 2006/123/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 12 dhjetorit 2006 për Shërbimet në Tregun e Brendshëm.

Ligje të tjera që rregullojnë aspekte të caktuara të fushës në fjalë përfshijnë:

- Ligjin nr. 06/L-016 për Shoqëri Tregtare (E drejta e themelimit të shoqërive tregtare në Kosovë);
- Ligjin nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave. Ky ligj rregullon lejet dhe licencat për ofrimin e shërbimeve ndërkufitare i cili aktualisht aplikohet në të gjithë sektorët ku nevojitet licencim profesional.
- Me qëllim të zbatimit të këtij Ligji, është miratuar Rregullorja nr. 06/2015 për Regjistrin Qendror të Llojeve të Lejeve dhe Licencave. Kjo Rregullore ka për qëllim të përcaktoj procedurat për themelimin, administrimin dhe funksionimin e regjistrit qendror të lejeve dhe licencave në nivelin qendror të Republikës së Kosovës.
- Ligjin nr. 04/L-219 për të huajt është plotësuar dhe ndryshuar nga Ligjit nr. 06/L-036 për të Huajt. Ky ligj rregullon kushtet e hyrjes, qëndrimit, punësimit, të drejtat dhe detyrimet e të huajve në territorin e Republikës së Kosovës. Për zbatim të këtij të fundit është nxjerrë UA nr. 01/2014 për Procedurën e Lëshimit të Lejes së Qëndrimit për të Huajt dhe Vërtetimit për Lajmërimin e Punës, i cili rregullon aspektet procedurale që ndjek organi administrativ (Departamenti për Shtetësi Azil dhe Migrim së bashku me Departamentin për Punë dhe Punësim në MFPT) me rastin e lëshimit të leje qëndrimeve (sidomos atyre për qëllim pune në Republikën e Kosovës);
- Ligjin për Avokatinë - (Ofrimi i shërbimeve juridike);
- Ligjin për Noterinë (Ofrimi i shërbimeve juridike);
- Ligjin për Procedurën Përmbarimore (Ofrimi i shërbimeve juridike);
- Ligjin nr. 04/L-176 për Turizmin, i cili rregullon veprimtarinë turistike dhe hoteliere.

Korniza legjislative dhe ajo e politikave në fushën e Shërbimeve postare

Korniza legjislative në këtë fushë përbëhet nga këto akte kryesore normative:

- Ligji nr. 06/L-038 për Shërbimet Postare
- Rregullorja nr. 41, për dhënien e Autorizimit të Përgjithshëm për ofrim të shërbimeve postare,

- Rregullorja nr. 44, për ofrimin e shërbimeve universal postare,
- Rregullorja nr. 23, për standardet e kualitetit të realizimit të shërbimit universal postar,
- Rregullorja Nr. 11, për të dhënat periodike statistikore për shërbimet telekomunikuese dhe postare.

Këto akte normative kanë transponuar këto akte të acquis-së:

- Direktivën 97/67/KE – pjesërisht;
- Direktivën 2002/39/KE – pjesërisht;
- Direktivën 2008/06/KE për Kufizimet sa i Përket Zonës së Rezervuar – pjesërisht.

Korniza legjislativë dhe ajo e politikave në fushën e Njohjes reciproke të kualifikimeve profesionale

Korniza legjislativë në këtë fushë përbëhet nga këto akte kryesore normative:

- Ligji nr. 05/L-066 për Profesionet e Rregulluara;
- UA për kriteret e parapara për fitimin e të drejtës në ushtrimin e profesionit të rregulluar, i miratuar në vitin 2020; dhe
- UA për rregullat për funksionimin e komisionit të provimit shtetëror, kompensimin e anëtarëve të saj, procedurat dhe mënyra e zhvillimit të provimit shtetëror, i miratuar në vitin 2020.

Ky akt normativ ka transponuar këto akte të acquis-së:

- Direktivën 2005/36/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropian, e 7 shtatorit 2005. mbi Njohjen e Kualifikimeve Profesionale;
- Direktivën 2013/55/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian, të 20 nëntorit 2013.

Lidhur me njohjen e ndërsjellë të kualifikimeve profesionale, aktualisht vetëm katër profesione (kontabilist, arkitekt, inxhinier dhe jurist) janë të rregulluar me bazë ligjore në Kosovë. Kualifikimet e huaja profesionale janë të njohura përderisa janë të certifikuara nga një autoritet i akredituar në vendin e origjinës.

Korniza institucionale

E drejta e themelimit dhe liria për të ofruar shërbime

Korniza institucionale në këtë fushë përbëhet nga këto institucione:

- Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (Agjencia për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve në Kosovë-KIESA dhe Departamenti i Tregtisë);
- Banka Qendrore e Kosovës (Shërbimet financiare);
- Ministria e Drejtësisë (Shërbimet juridike);
- Ministria e Shëndetësisë (Shërbimet shëndetësore);
- Ministria e Punëve të Brendshme (lejeqëndrimi për personat e jashtëm);
- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (Shërbimet financiare);
- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (Shërbimet e reasturimit);
- Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit (Shërbimet e Telekomunikacionit);
- Oda e Përmbauesve Privat;
- Oda e Noterëve të Republikës së Kosovës;
- Odat e profesionistëve shëndetësorë.

Shërbimet postare

Korniza institucionale në këtë fushë përbëhet nga këto institucione:

- Ministria e Ekonomisë;
- Autoritetit Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP).

Njohja reciproke e kualifikimeve profesionale

Korniza institucionale në këtë fushë përbëhet nga këto institucione:

- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, përkatësisht Divizioni për Ekzaminimin e Profesioneve të Rregulluara;
- Autoriteti Kombëtar për Kualifikime.

Mbështetja e donatorëve

Institucionet e Kosovës mbështeten nga KE (përmes IPA-s) dhe nga donatorë të tjerë bilateralë me projektet e përmbledhur në vijim.

Në kuadër të marrëveshjes financiare IPA 2016 të sektorit “Konkurrueshmëri dhe Inovacion” është paraparë projekti “Mbështetja e zbatimit të Direktivës së Shërbimeve të BE-së” i cili pritet të fillojë zbatimin në gjysmën e dytë të vitit 2020. Ky projekt ka karakter të binjakëzimit.

Mbështetje institucioneve të Kosovës në procesin integruar, është programi i qeverisë së Luksemburgut, me synim ngritjen e kapaciteteve institucionale të Republikës së Kosovës në zbatimin e prioritetëve që dalin nga MSA. Ky projekt ka filluar më 2019 dhe do ofrojë mbështetje edhe për Departamentin e Tregtisë.

Gjithashtu Departamenti i Tregtisë përkrahet edhe nga projekti i GIZ “Mbështetja e Procesit të Integritimit Evropian në Kosovë.” Projekti GIZ synon të mbështesë Ministrinë për Integrimin Evropian dhe Ministrinë e Linjës në aftësimin e tyre për të drejtuar procesin e integritimit evropian, zbatimin e MSA-së. Projekti synon të forcojë në mënyrë sistematike strukturat ekzistuese dhe proceset e institucioneve partnere dhe mbështet marrëdhëniet bashkëpunuese midis këtyre institucioneve në nivelin qendror dhe lokal.

Objektivat prioritarë afatmesme

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA dhe dokumentet e mekanizma të tjerë të aderimit në BE në kuadër të fushëveprimit të kapitullit 3, fokusi gjatë periudhës 2021-2024 do të jetë në këto objektiva prioritarë afatmesme:

E drejta e themelimit dhe liria për të ofruar shërbime:

- Zbatimi i Planit të Veprimit për Transpozimin i Direktivës së Shërbimeve në Tregun e Brendshëm (2006/123/KE) për Periudhën 2017-2022;
- Zbatimi i UA nr. 04/2018 për Mënyrën e Funkcionimit të Pikës së Vetme të Kontaktit ;
- Zbatimi i Planit të Veprimit për themelimin e Pikës së Vetme të Kontaktit (PVK);
- Zbatimi i UA nr. 05/2018 për Procedurën e Njoftimit dhe Vlerësimin e Përputhshmërisë së Projekt Akteve Normative me Ligjin për Shërbime;
- Hartimi i analizës mbi diagnostifikimin e sektorëve të rëndësishëm të tregtisë së shërbimeve si bazë për formulimin e politikave të përshtatshme;
- Do të vazhdohet me përgatitjet për Krijimin e Pikës së Vetme të Kontaktit, duke përfshirë burimet njerëzore dhe të IT's;
- Do të vazhdohet me procesin e përafrimit të legjislacionit kombëtar me Direktivën e Shërbimeve
- Do të punohet në rritjen e aftësive profesionale të stafit të Departamentit Ligjor dhe atij të Tregtisë për vlerësimin e harmonizimit të draft akteve normative me Ligjin për Shërbime.
- Do të punohet në rritjen e ndërgjegjësimit të bizneseve, shoqatave profesionale dhe komunave për thjeshtimin e procedurave administrative që lidhen me zbatimin e Planit të Veprimit pesë-vjeçar.
- Do të bëhet zbatimi i Ligjit për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besuara në Transaksionet Elektronike;

Shërbimet Postare

- Do të vazhdojë harmonizimi me *acquis* për shërbimet postare, përfshirë rregulloren për Shërbimet e Dorëzimit të Parcelave Ndërkufitare
- Hartimi i Strategjisë Kombëtare për zhvillim të sektorit postar në Republikën e Kosovës viti 2022 – 2026;
- Do të punohet tutje në zhvillimin e kapaciteteve të institucioneve që merren me shërbime postare për të siguruar një proces të suksesshëm të shqyrtimit dhe përafrimit

Njohja reciproke e kualifikimeve profesionale:

- Hartimi dhe publikimi i listës së profesioneve të rregulluara;
- Kompletimi i legjislacionit sekondar për zbatimin e Ligjit për Profesionet e Rregulluara;
- Ngritja e kapaciteteve të stafit në fushën e profesioneve të rregulluara.

3.4. Kapitulli 4 i acquis-së: Lëvizja e lirë e kapitalit

Shtetet anëtare duhet të heqin të gjitha kufizimet ndaj lëvizjes së kapitalit dhe pagesave, me disa përjashtime, si brenda BE-së, ashtu edhe mes Shteteve Anëtare dhe vendeve të treta. Acquis i këtij kapitulli është i bazuar në Traktatin për Funksonimin e BE-së, në veçanti nenet 63-66. Definicioni i llojeve të ndryshme të kapitalit bëhet në Aneksin I të Direktivës 88/361/KEE. Praktikrat gjyqësore të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë dhe Komunikatat e Komisionit ofrojnë interpretime shtesë të neneve të mësipërme.

Legjislacioni i BE-së përfshinë edhe rregullat për pagesa ndërkuftare dhe ekzekutimin e urdhrave të transferimit në lidhje me letrat me vlerë. Direktiva për luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, kërkon që entitetet që janë subjekt i kësaj direktive të identifikojnë klientët dhe të raportojnë transaksionet e dyshimta, sidomos kur bëhet fjalë për objekte me vlerë të lartë dhe për transaksione me para në dorë me vlera të mëdha. Kjo direktivë gjithashtu kërkon që entitetet të ndërmarrin hapa shtesë si mbajtja e evidencës, trajnimet dhe krijimi i procedurave të brendshme të entiteteve të kësaj fushe. Një kërkesë kyçe në luftën kundër krimit financiar është krijimi i kapaciteteve efektive administrative dhe zbatuese, përfshirë edhe bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve që merren me mbikëqyrjen, zbatimin dhe ndjekjen penale. Direktiva e re është harmonizuar por shkon përtej rekomandimeve për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit të Task Forcës për Veprim Financiar (FATF).

Acquis e kësaj fushe gjithashtu përbëhet nga Konventat nr. 141 dhe nr. 198¹² të Këshillit Evropian dhe legjislacioni i BE-së për bashkëpunim në fushën e drejtësisë dhe policisë (përfshirë Veprimin e Përbashkët 98/699/JHA, Vendimin Kornizë të Këshillit 2001/500/JHA dhe Protokollin e vitit 2000 që zgjeron kompetencat e Europolit në fushën e pastrimit të parave). Ngjashëm, Vendimi i Këshillit 2000/642/JHA i vitit 2000 vendos kornizën e bashkëpunimit midis Njësisë të Inteligjencës Financiare të vendeve të BE-së.

Kërkesat e MSA-së

Detyrimet e Kosovës në MSA në lidhje me lëvizjen e lirë të kapitalit dalin nga nenet 51, 63, 64, 65 dhe 89. Neni 51 i MSA-së, obligon Kosovën të ofroj mundësinë që filialet dhe degët e shoqërive të BE-së, brenda pesë viteve nga hyrja në fuqi e MSA-së, të gëzojnë të drejtën e përvetësimit dhe gëzimit të drejtave të pronësisë mbi pasuritë e patundshme sikurse kompanitë Kosovare.

Neni 64 i MSA-së parasheh detyrimet që rrjedhin në lidhje me çdo pagesë apo transfer në llogarinë rrjedhëse të bilancit të pagesave ndërmjet BE-së dhe Kosovës në përputhje me nenin VIII të Neneve të Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar. Në lidhje me transaksionet në llogarinë kapitale dhe financiare të bilancit të pagesave, që nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes, palët sigurojnë lëvizjen e lirë të kapitalit lidhur me transaksionet tregtare ose me sigurimin e shërbimeve, përfshirë huat financiare dhe kreditë, ku merr pjesë një rezident i njërës prej Palëve.

Neni 65 i MSA-së obligon Kosovën brenda pesë vjetëve nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshje, t'i ofroj trajtim kombëtar shtetasve të BE-së që blejnë pasuri të patundshme në territorin e saj.

Neni 89 i MSA-së parasheh bashkëpunimin e palëve në lidhje me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

Kërkesat nga mekanizmat e tjerë të aderimit në BE

Sipas Raportit të KE-së për Kosovën – 2020, lëvizja e kapitalit mbetet kryesisht e lirë në Kosovë, pa kufizime në pronësinë e huaj ose në investimet në sektorin financiar. Disa kufizime mbeten për shtetasit e BE-së që blejnë pasuri të paluajtshme në Kosovë. Gjatë periudhës raportuese, ka pasur progres veçanërisht në fushën e shërbimeve të pagesave, me hyrjen në fuqi të Rregullores për licencimin dhe mbikëqyrjen e operatorëve të sistemit të pagesave. Kuadri legjislativ për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit ende duhet të harmonizohet me acquis të BE-së. Theksohet se duhet të zbatohet bashkëpunimi ndërinstitucional për të siguruar hetimet e duhura dhe ndjekjen e veprave penale. Megjithëse u morën hapat fillestarë, rekomandimet e raportit të mëparshëm mbeten të vlefshme.

¹² Kjo e zgjeron konventën 141 dhe është ratifikuar edhe nga BE.

Rekomandohet që Kosova duhet të ndryshojë Ligjin për të drejtat e pronës për t'u dhënë trajtim kombëtar shtetasve të BE-së që marrin pasuri të patundshme në Kosovë, në përputhje me MSA-në; si dhe të rritë përpjekjet për të luftuar krimin ekonomik dhe financiar dhe të harmonizojë Ligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit me acquis të BE-së.

Në konkluzionet e takimit të Nënkomitetit për Treg të Brendshëm, Konkurrencë dhe Mbrojtje të Konsumatorit kërkohet të shtohen përpjekjet për luftimin e krimit ekonomik e financiar dhe harmonizimin e Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit me acquis.

Në raport dhe konkluzione gjithashtu nënvizohet se Kosova duhet të shqiptojë sanksione shtesë kundër financimin e terrorizmit; si dhe për identifikimin e pronarit përfitues dhe zbatimin e mekanizmave të sanksioneve financiare të synuara; dhe identifikimin e mbrojtjen e infrastrukturës së rëndësishme. Poashtu, autoritetet duhet të azhurnojnë vlerësimet sektoriale të rrezikut me një metodologji më të rreptë dhe të shtrijnë ato në sektorët e identifikuar në Vlerësimin Kombëtar të Rrezikut dhe vlerësimin e kërcënimit të krimit të organizuar të Policisë së Kosovës.

Gjendja aktuale

Korniza legislative dhe ajo e politikave

Liberalizimi i lëvizjes së kapitalit

Korniza legislative në këtë fushë përbëhet nga Ligji nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat e tjera Sendore.

Sa u përket akteve të acquis-së të transpozuar në këtë ligj, ai nuk e specifikon mundësinë e fitimit të drejtës për paluajtshmëritë nga personat fizikë apo juridikë. Në anën tjetër, acquis e BE-së përmban mundësinë, për persona fizik dhe juridik të fitojnë të drejtën në paluajtshmëri në çfarëdo shteti anëtar të BE-së.

Korniza e politikave në këtë fushë përbëhet nga Strategjia Kombëtare për të Drejtat Pronësore 2017-2021.

Sistemi i pagesave

Korniza legislative në këtë fushë përbëhet nga këto akte kryesore normative:

- Ligji nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Ligji nr. 05/L-150 për amendamentimin e ligjit nr. 03/L-209;
- Ligji nr. 04/L-155 për Sistemin e Pagesave;
- Rregullorja për instrumente elektronike;
- Rregullorja për raportim të Instrumenteve të Sistemit të Pagesave;
- Rregullorja për licencimin dhe rregullimin e operatorëve të sistemeve të pagesave.

Këto akte normative kanë transpozuar në pjesë të madhe aktet të acquis-së në vijim:

- Direktivën 2007/64/KE mbi sistemin e pagesave në tregun e brendshëm;
- Rregulloren nr. 1409/2013 të BQE-së për statistikën e pagesave (BQE/2013/43);
- Rregulloren nr. 260/2012 mbi vendosjen e kriterëve teknike dhe afariste për transfere krediti dhe Debitimin
- Direktivën 2007/64/KE mbi Shërbimet e Pagesave në Tregjet e Brendshme, Rregulloren nr. 1409/2013 të Bankës Qendrore Evropiane për statistikën e Pagesave (ECB/2013/43) dhe Rregulloren nr. 260/2012 mbi Vendosjen e Kriterëve Teknike dhe Afariste për Transfere Krediti dhe Debitim Direkt.

Korniza e politikave në këtë fushë përbëhet nga këto dokumente:

- Plani Strategjik i BQK-së në kuadër të së cilit planifikohet:
 - Rishikimi dhe plotësimi i rregullativës që ka të bëjë me mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave në pajtim me standardet dhe praktikën më të mira ndërkombëtare;
 - Mbështetja dhe modernizimi i mëtejshëm i shërbimeve të pagesave dhe promovimi i bashkëpunimit mes akterëve të sistemit kombëtar të pagesave;

- Avancimi i rolit të BQK-së si katalizator për progres në lëmin e pagesave në Republikën e Kosovës.
- Avancimi i Standardeve për mbikëqyrjen e Sistemeve të Pagesave të harmonizuara sipas Parimeve të CPSS-IOSCO;

Parandalimi dhe luftimi i shpëlarjes së parasë

Korniza legislative në këtë fushë përbëhet nga këto akte kryesore normative:

- Ligji nr. 05/L-O96 për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit
- UA për Personat e Ekspozuar Politikisht;
- Rregullorja e BQK-së për Parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e terrorizmit;
- UA nr. 01/2018 për mbajtjen e statistikave për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimit të terrorizmit;
- UA MF- nr. 04/2018 për Vlerësimin e Rrezikut Kombëtar për Pastrimin e Parave dhe Financimin e Terrorizmit;
- UA MF (NJIF-K) nr. 02/2017 Trajnimet për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit;
- Rregullore MF (NJIF-K) nr. 01/2017 për Funkcionin e Pajtushmërisë dhe Kriteret për i Përshtatshëm dhe i Duhur për Zyrtarin e Pajtushmërisë;
- UA nr. 01/2017 për Përjashtimin e Transaksioneve të Caktuara nga Raportimi;
- Udhëzues për Listën e Juridiksioneve me Rrezikshmëri të Lartë;
- UA MF (NJIF-K) nr. 01/2020 për Parandalimin dhe Zbulimin e Pastrimit të Parave, Veprave të Ndërlidhura Penale dhe Financimit të Terrorizmit në Mjedise Online.

Këto akte normative kanë transpozuar Direktivën 2015/849 për Parandalimin e Përdorimit të Sistemit Financiar për qëllime të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (pjesërisht), si dhe është bazuar në rekomandimet e Task Forcës së Veprimit Financiar.

Korniza e politikave në këtë fushë përbëhet Strategjia dhe Plani i Veprimit për luftimin dhe parandalimin e ekonomisë jo-formale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare 2021-2024.

Korniza institucionale

Korniza institucionale në fushën e liberalizimit të lëvizjes së lirë të kapitalit përbëhet nga Ministria e Drejtësisë, në fushën e sistemit të pagesave nga Banka Qendrore e Kosovës, dhe në atë të parandalimit të pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit nga Njësia për Inteligjencë Financiare në kuadër të Ministrisë së Financave.

Mbështetja e donatorëve

Projektet aktuale dhe të planifikuara të donatorëve bilateralë

Mbështetje në hartimin e Kodit Civil dhe trajtimin e çështjeve pronësore: ka për qëllim finalizimin e Kodit Civil dhe trajtimin e çështjeve pronësore. Projekti është i ndarë në tri faza: 1. Faza fillestare (tre muaj); 2. Faza e zbatimit (36 muaj); dhe 3. Faza e largimit (6 muaj). Kohëzgjatja e projektit: 2017-2020.

Mbështetje institucionale të Kosovës nga Ambasada Norvegjeze në procesin e integrimit evropian: ka si qëllim ngritjen e kapaciteteve institucionale për administratën publike të Kosovës në përmbushjen e obligimeve që dalin nga MSA. Në mesin e kapitujve prioritarë që do finanohen nga ky projekt është edhe kapitulli 4 dhe të tri komponentët e këtij kapitulli. Përkatësisht, Banka Qendrore e Kosovës, Njësia e Inteligjencës Financiare, Ministria e Drejtësisë dhe ish-Ministria e Integrimit Evropian kanë nevojë për trajnime për të kuptuar thellësisht kërkesat kryesore të acquis-së për lëvizjen e lirë të kapitalit. Përpos aktiviteteve të tjera, këto trajnime do të jenë të dobishme për stafin profesional, përgjegjës për transpozimin e acquis dhe zbatimin e politikave që kontribuojnë drejtpërdrejt në reformat e BE-së.

Objektivat prioritarë afatmesme

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA dhe dokumentet e mekanizmat e tjerë të aderimit në BE në kuadër të fushëveprimit të kapitullit 4, fokusi gjatë periudhës 2021-2025 do të jetë në këto objektiva prioritare afatmesme:

Liberalizimi i lëvizjes së kapitalit

- Forcimi i sistemit të të drejtave pronësore;
- Miratimi dhe zbatimi i legjislacionit në fushën e të drejtave pronësore të shtetasve të huaj, në veçanti të shtetasve të BE-së në harmoni me MSA.

Sistemi i pagesave

- Miratimi i legjislacionit sekondar për Sistemin e Pagesave me qëllim harmonizimin me Direktivën për Shërbimet e Pagesave në Tregun e Brendshëm nr. 2015/2366;
- Hartimi i Strategjisë për Zhvillimin e Sistemeve të Pagesave në Republikën e Kosovës.

Parandalimi i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit

- Transpozimi i Direktivës 2015/849 dhe Direktivës 2018/843 për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit, përmes plotësimit ndryshimit të Ligjit 05/L-O96 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit;
- Ngritja e kualitetit të informatave që NJIF pranon nga ana e subjekteve raportuese;
- Vlerësimi III i Rrezikut Kombëtar të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit;
- Anëtarësimi i Kosovës në Moneyval;
- Rritja e numrit të stafit të NJIF;
- Ofrimi i udhëzimeve specifike për subjektet raportuese se si të përgatisin dhe zhvillojnë vlerësime të rrezikut;
- Fuqizimi i strukturës së përgjithshme të kornizës mbikëqyrëse dhe zhvillimi i mbikëqyrjes së bazuar në rrezik dhe sektorët më të cenueshëm;
- Fuqizimi i aftësive për identifikimin e pronësisë përfituese dhe për të kufizuar keqpërdorimin e personave juridikë dhe marrëveshjeve juridike për qëllime të PP/FT;
- Rishikimi i Metodologjisë së vlerësimit të rrezikut të PP/FT dhe fuqizimi i vlerësimit të rrezikut, menaxhimit të rrezikut dhe kornizës strategjike;
- Hetimi dhe ndjekja penale e financimit të terrorizmit;
- Fuqizimi i aftësive për masat parandaluese për financim të terrorizmit dhe sanksionet financiare.
- Zbatimi i rekomandimeve të Raportit të Vlerësimit të përputhshmërisë së Kosovës me standardet ndërkombëtare në parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit (gjithsej 87 masa nën 11 Rezultate të Menjëhershme).

3.5. Kapitulli 5 i acquis-së: Prokurimi publik

Ky kapitull bazohet në parimet e përgjithshme të transparencës, trajtimit të barabartë, konkurrencës së lirë dhe mos-diskriminimit që dalin nga Traktati për Funkcionimin e BE-së, pjesa III, titulli IV dhe titulli VII si dhe nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë. Këto parime të përgjithshme janë të zbatueshme për të gjitha procedurat e prokurimit përfshirë edhe procedurat që janë jashtë fushëveprimit të Direktiva të BE-së për prokurimin, siç janë për shembull procedurat e prokurimit nën vlerën minimale të BE-së.

Dhënia e kontratave publike për punë, furnizime dhe ofrim të shërbimeve koordinohet nga dy Direktivat specifike: Direktiva 2004/18/KE e zëvendësuar nga Direktiva 2014/24/BE për prokurimin publik, dhe Direktiva 2004/17/KE e zëvendësuar nga Direktiva 2014/25/BE për koordinimin e procedurave të prokurimit të entiteteve që operojnë në sektorët e ujit, energjisë, transportit dhe shërbimeve postare. Ndërsa koncesionet rregullohen nga Direktiva 2014/23/BE për dhënien e kontratave koncesionare.

Këto direktiva ofrojnë edhe kornizën për aplikimin e prokurimit elektronik. Direktiva 2009/81/KE rregullon dhënien e disa kontratave në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Për zbatim të këtyre Direktivave kërkohen kapacitete administrative adekuate për të siguruar që të gjitha fushat që lidhen me prokurimin publik funksionojnë në mënyrë eficiente përfshirë aspektet kyçe të hartimit të politikave, legjislacionit, monitorimin, kontrollin, aspektet operacionale dhe statistikat adekuate.

Legjislacioni i BE-së gjithashtu përbëhet nga direktiva për shqyrtimin e ankesave dhe disponueshmërisë së mjeteve juridike Direktiva e Parlamentit Evropian 2007/66/KE mbi Mjetet Juridike, e 11 dhjetorit 2007. Ajo vendos dispozitat për vendosjen e procedurave të pavarura dhe efektive të shqyrtimit mbi vlerat e caktuara kundrejt vendimeve të marra nga autoritetet kontraktuese. Institucionet për shqyrtim duhet të jenë të pavarura dhe të kenë kapacitetet adekuate për të garantuar efektivitetin dhe efikasitetin e sistemit të prokurimit. Në harmoni me principin e mbrojtjes juridike që del nga rendi ligjor i BE-së, mekanizmat për shqyrtim kërkohet të veprojnë edhe jashtë fushëveprimit të zbatimit të direktivës përkatëse.

Kërkesat e MSA-së

Kapitullin I, Titullin VI përkatësisht nga neni 79 i MSA-së, në mënyrë eksplicite vendos një sërë obligimesh për Kosovën.

Sipas MSA-së nga hyrja në fuqi kompanitë pavarësisht se a janë të themeluara në BE apo jo, u lejohe qasje në aplikimin për kontratat publike sipas rregullave të prokurimit të BE-së me trajtim të barabartë me kompanitë e vendeve të BE-së. Qasja e njëjtë iu ofrohet kompanive të BE-së të themeluara në Kosovë nën Kapitullin I, Titullin e V-të të kësaj marrëveshje. Ndërsa për kompanitë e themeluara në BE, qasja e tyre në kontratat publike në Kosovë vlen me përjashtimet e parapara në paragrafin 5 të nenit 79.

Hapja e dhënies së kontratave publike konsiderohet si objektiv i dëshirueshëm mbi bazën e mos-diskriminimit dhe reciprocitetit duke ndjekur veçanërisht rregullat e OBT-së. Këto rregulla bazohen në Marrëveshjen për Prokurimin Qeveritar (MPQ) të nënshkruar edhe nga BE dhe të cilat negociohen gjatë negociatave për anëtarësim në OBT. Sipas nenit V të Marrëveshjes, vendet në zhvillim mund të negociojnë trajtim preferencial për prokurimin publik brenda një periudhe tranzitore.

Paragrafi 9 i nenit 79 definojnë se prokurimi publik për fushën e shërbimeve ndërmjet Kosovës dhe BE-së do të jetë në harmoni me nenet 56-60 të MSA-së, e cila përmban dispozita për trajtim reciprok në mënyrë progresive për shërbimet, profesionet e rregulluara, vetë-punësimin, transportit. Modalitetet dhe periudhat tranzicionale për këto fusha do të jenë në harmoni me konventat përkatëse (p. sh në fushën e transportit) dhe do të rishikohen nga Këshilli i MSA-së. Ndërsa paragrafi 5 definojnë periudhën tranzicionale për heqjen e çfarëdo preference ekzistuese për kompanitë kosovare apo kompanitë e BE-së të themeluara në Kosovë dhe për kontratat e dhëna nën kriteret e tenderit ekonomikisht më të favorshëm dhe çmimit më të ulët, me një preferencë të çmimeve. Periudha tranzitore është 5 vite dhe reduktimi i preferencës në çmim duhet të fillojë gradualisht që nga hyrja në fuqi e marrëveshjes.

Kërkesat nga mekanizmat e tjerë të aderimit në BE

Në fushën e prokurimit publik, *Raporti i KE-së për Kosovën – 2020* dhe të dalat e Nënkomitetit për Tregun e Brendshëm, Politikën e Konkurrencës dhe Mbrojtjen e Konsumatorit theksojnë se Kosova duhet të përfshijë më tej legjislacionin e vet me *acquis* për prokurimin publik, përfshirë partneritetet publiko-private dhe koncesionet, dhe të sigurojë zbatimin e duhur të Ligjit për prokurim publik. Gjithashtu, Kosova duhet të sigurojë që bordi i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) është plotësisht funksional, dhe që të adresohen kufizimet e kapaciteteve të stafit. Raporti I KE-së dhe konkluzionet e Nënkomitetit gjithashtu rekomandojnë që Kosova të rrisë kapacitetin e të gjitha institucioneve të prokurimit publik dhe bashkëpunimin ndërmjet tyre për të siguruar zbatimin e vazhdueshëm të kornizës rregullative të prokurimit publik.

Për më shumë, të dalat nga Nënkomiteti theksojnë se projektligji për Partneritetin Publiko-Privat që do të harmonizohet me Direktivën 2014/23/BE, duhet të konsultohet me SIGMA dhe Komisionin Evropian para se të miratohet, duke përfshirë përjashtimet e bazuara në marrëveshjet ndërkombëtare.

Megjithëse Kosova ka një nivel përgatitjeje për prokurimin publik, pak progres është arritur me shtrirjen e mëtejshme të platformës elektronike të prokurimit.

Kosova ende duhet të adresojë kapacitetin e dobët të institucioneve të prokurimit publik për administrimin e prokurimit publik, monitorimin dhe ekzekutimin e pamjaftueshëm të kontratave, si dhe sistemet e dobëta të mjeteve juridike, ku të gjitha janë të cenueshme ndaj korrupsionit.

Korniza ligjore e Kosovës për prokurim publik është e përafruar në masë të madhe me Direktivat e BE-të vitit 2004 për prokurimin klasik dhe shërbimeve komunale edhe për koncesionet dhe partneritetet publiko-private. Ende nevojitet përafrimi i mëtejshëm me Direktivat e BE-së të vitit 2014, përfshirë partneritetet publiko-private dhe koncesionet. Të gjitha instrumentet ligjore dhe financiare të përdorura në fushën e prokurimit publik dhe koncesioneve, përfshirë marrëveshjet ndërqeveritare të lidhura me vendet e treta, duhet të pasqyrojnë parimet e transparencës, konkurrencës, trajtimit të barabartë dhe mos-diskriminimit.

Prokurimi i centralizuar është i detyrueshëm për 14 kategori të mallrave dhe shërbimeve të listuara nga Ministria e Financave dhe vlen për të gjitha Autoritetet Kontraktuese si të nivelit qendror ashtu edhe të atij lokal. Gjithashtu Agjencia e Prokurimit Publik kryen aktivitete të prokurimit edhe për agjencitë me më pak se 50 punonjës që i raportojnë Kuvendit. Sidoqoftë, vetëm 16 (nga 165) autoritete kontraktuese kryejnë prokurime përmes Agjencisë Qendrore të Prokurimit. Në vitin 2019, ata kryen 31 procedura të centralizuara të prokurimit. Poashtu, stafi dhe burimet e tjera të Agjencisë Qendrore të Prokurimit nuk janë të mjaftueshme për të përmbushur kërkesat. Mangësitë rrjedhin nga planifikimi i dobët dhe dështimi nga autoritetet kontraktuese që të kryejnë hulumtime të tregut. Analiza e pamjaftueshme dhe mbledhja e të dhënave i kontribuon ekzekutimit të dobët të kontratave. Përdorimi i vetëm i kriterit të “çmimit më të ulët” gjatë prodhimit të furnizimeve mund të shpie në kosto më të larta të ciklit të jetëgjatësisë dhe blerje të cilësisë së dobët. Monitorimi i menaxhimit dhe zbatimit të kontratave është i mangët.

Gjendja aktuale

Korniza legjislative dhe ajo e politikave

Korniza ligjore është e harmonizuar pjesërisht me standardet e BE-së, dhe nuk është diskriminuese. Me plotësim-ndryshim të LPP-së është bërë eliminimi i trajtimit preferencial për ofertuesit vendorë.

Korniza legjislative në fushën e prokurimit publik përbëhet nga Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237, ligjin nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092.

Sa i përket legjislacionit dytësor dhe politikave për prokurim publik. Dokumentet kryesore janë:

- Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik, si dhe dokumentet standarde për përdorimin e tyre për zhvillimin e aktiviteteve të prokurimi publik;
- Strategjia Kombëtare për Prokurim Publik (2017-2021)

Aktet normative kanë transpozuar këto akte të acquis-së:

- Direktivën 2014/24/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 26 shkurtit 2014, për prokurimet publike mbi koordinimin e procedurave për caktimin e fituesit në kontratat publike të punës, shërbimit dhe furnizimit, që shfuqizon Direktivën 2004/18/KE, të cilat Shtetet Anëtare duhet të përputhet me të brenda 24 muajve nga data e hyrjes në fuqi.
- Direktivën e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit 2014/25/KE, e 26 shkurtit 2014, në prokurimin nga subjektet që operojnë në sektorin e ujit, energjisë, transportit dhe shërbimeve postare dhe që shfuqizon Direktivën 2004/17/KE.
- Direktivën e Parlamentit Evropian 2007/66/KE mbi Mjetet Juridike, e 11 dhjetorit 2007.

KRPP, në baze të vlerësimeve të bëra dhe nevojave të paraqitura, ka filluar me inicimin e ndryshimit të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP). Përmes këtij ndryshimi do të inkorporohen dispozitat e Direktivave të reja të Prokurimit të BE-së, të kompletohet baza ligjore për funksionimin e mirëfilltë të platformës së prokurimit elektronik, të definohen mundësitë për NVM-të për pjesëmarrje në aktivitetet e prokurimit, si dhe të eliminohen të gjitha vështirësitë që janë hasur gjatë zbatimit të Ligjit për prokurim publik në praktikë. Koncept Dokumenti për trajtimin e legjislacionit në fushën e prokurimit publik është miratuar me datë 9.09.2020, ndërsa sipas Vendimit të dt. 06.10.2020, është themeluar Ekipi përgjegjës për hartimin e Ligjit të ri për prokurim publik. Objektivat janë që në tremujorin e parë të vitit 2021, të hartohet ligji i ri për prokurim publik. Nxjerrja e akteve të reja nënligjore për implementim të Ligjit të ri për prokurim publik do të behet brenda një periudhe 6 mujore pas miratimit të ligjit.

Rregullorja e koncesioneve u largua nga ligji për të parandaluar konfuzionin dhe mospërputhjen me ligjin specifik mbi procedurën e koncesionit që ishte miratuar më 2005.

Një numër i rëndësishëm i legjislacionit sekondar që mundësonte zbatimin e Ligjit është përgatitur, përfshirë format standarde për secilin lloj të njoftimit, kodin e etikës, një formular për raportimin e kontratave të nënshkruara, format standarde të dosjeve së tenderëve, një formular për parashtrim të ankesave për Organin Shqyrtues të Prokurimit dhe udhëzime për procedurat me vlerë minimale.

Me qëllim të funksionimit më të mirë të platformës së e-prokurimit, ngritjes së transparencës në fushën e prokurimit publik dhe të një zbatimi sa më korrekt, janë bërë tri (3) plotësim-ndryshime të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, dy plotësim-ndryshime të formularit standard B58 si dhe UA nr. 1/2019 për veprimet e KRPP dhe Autoriteteve Kontraktuese në procedurat e prokurimit publik në rast të pengesave në funksionimin e platformës elektronike për prokurimin elektronik.

Plotësim-ndryshimi i parë, A01 Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, ka hyrë në fuqi më 16 prill 2018 si dhe Formulari Standard “B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues” ka hyrë në fuqi më 16 prill 2018.

Plotësimi-ndryshimi i dytë i rregullores A01 Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, është bërë më 3 shtator 2018, për funksionimin më të mirë të platformës së e-prokurimit, me qëllim të rritjes së transparencës ku është bërë obligative për autoritetet kontraktuese edhe publikimi i kontratave në platformën e e-prokurimit. Edhe plotësimi-ndryshim i dytë i Formularit Standard “B58: Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues” ka hyrë në fuqi më 03.09.2018 dhe përmes këtij ndryshimi dhe RRUOPP dhe publikimi i të gjitha letrave njoftuese për ofertuesit e tenderëve janë bërë të detyrueshme.

Plotësim-ndryshimi i tretë i rregullores, A01 Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, ka hyrë në fuqi më 10.04.2019. Me anë të këtij ndryshimi nga Autoritetet Kontraktuese, gjatë zbatimit të aktiviteteve të prokurimit kërkohet që të publikohen në sistemin e e-prokurimit edhe procesverbalet e hapjes së ofertave, Formulari Standard B12 si dhe kontratat e nënshkruara.

UA nr. 1/2019 për veprimet e KRPP dhe Autoriteteve Kontraktuese në procedurat e prokurimit publik në rast të pengesave në funksionimin e platformës elektronike për prokurimin elektronik është miratuar më dt. 13.09.2019. Udhëzimi synon të ndihmojë AK- se si të veprojnë në rast të paraqitjes së pengesave në platformën elektronike gjatë implementimit të aktiviteteve të prokurimit.

Korniza institucionale

Korniza institucionale në fushën e prokurimit publik përbëhet nga këto institucione:

- Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik (KRPP).
- Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP);
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT)/Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP).

KRPP është agjenci e pavarur rregullative përgjegjëse për zhvillimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e sistemit të Prokurimit Publik. Në bazë të Ligjit të Prokurimit Publik, Komisioni është përgjegjës për hartimin dhe shpërndarjen në legjislacionin sekondar, përfshirë edhe rregullat e prokurimit, doracakët, udhëzimet, formularët standard, kontratat model dhe për të përgatitur rekomandimet për përmirësim të LPP-së dhe sistemit të përgjithshëm të prokurimit publik për Qeverinë dhe Kuvendin.

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) është përgjegjës për kryerjen e funksioneve të dhëna me Ligjin e Prokurimit Publik dhe Ligjit për Procedurën për dhënien për koncesioneve, lidhur me trajtimin e ankesave në relacion me këto ligje. Ky organ është një trup kuazi-gjyqësor, kompetent për shqyrtimin e vendimeve administrative të lëshuara nga institucionet qendrore të prokurimit për kryerjen e procedurave të prokurimit dhe për të rishikuar ankesat nga tenderuesit nën procedurën e shqyrtimit.

Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP) funksionon si një agjenci në kuadër të Ministrisë së Financave me përgjegjësi të gjerë në lidhje me procedurat e prokurimit të nivelit qendror. AQP zbaton dhe kryen

funksiione dhe përgjegjësi të specifikuar në Ligjin e prokurimit Publik përderisa funksioni kryesor i Agjencisë është prokurimet qendrore.

Reformat në prokurimin publik

Në mbështetje të vendimit të Qeverisë të Republikës së Kosovës të vitit 2016, nga 1 janar i 2017 të gjitha Organizatat buxhetore kanë filluar aplikimin e sistemit të e-prokurimit. Ndërsa nga 1 janar 2018, sistemi i prokurimit elektronik është bërë obligativ për përdorim nga të gjitha autoritetet kontraktuese dhe për të gjitha procedurat e prokurimit me vlerë mbi 1000 euro, apo rreth 98% e procedurave të prokurimit zhvillohen në tërësi në sistem të prokurimit elektronik deri në nënshkrim të kontratës.

KRPP në funksion të rritjes së përdorimit të sistemit të prokurimit elektronik edhe nga ana e Operatorëve ekonomik, nga gjysma e vitit 2018 ka nxjerr një vendim nëpërmjet të cilit nga data 5 korrik 2018, për të gjitha prokurimet e centralizuara që zhvillohen nga AQP – dorëzimi i ofertës lejohet vetëm në formë elektronike, ndërsa nga janar i 2019, për të gjitha prokurimet me vlerë të madhe të publikuara nga të gjitha Autoritetet Kontraktuese – dorëzimi i ofertës bëhet vetëm në formë elektronike. Me këtë, 98% e të gjitha aktiviteteve të prokurimit, përfshirë dorëzimin e ofertave, zbatohen përmes platformës së prokurimit elektronik (duke përjashtuar kontratat me vlerë minimale nën 1,000 euro).

Me qëllim të përmirësimit të menaxhimit gjatë zbatimit të kontratave të nënshkruara dhe ngritjes së transparencës në këtë fushë, KRPP me mbështetjen e projektit USAID -DAI “Komuna Transparente dhe Llogaridhënëse – Komponenti e Transparencën, dhe Komuna Llogaridhënëse”, është duke punuar në modifikimin e sistemit të prokurimit elektronik për të mbështetur veglat elektronike të menaxhimit të kontratave dhe vlerësimin e performancës së kontraktuesit. Ky proces është pauzuar gjatë vitit 2020 për shkak të pandemisë Covid-19.

Këto vegla do të jenë gati për tu futur në përdorim në fillim të vitit 2021. Me aplikimin e veglave elektronike (modulit) për zbatimin e menaxhimit elektronik të kontratave të nënshkruara, deri në fund të vitit 2021 do të bëhet zbatimi i menaxhimit të deri në 100% të kontratave të nënshkruara përmes sistemit të e-prokurimit.

KRPP, me qëllim lehtësimi dhe të përkrahjes së autoriteteve kontraktuese në të gjitha nivelet ka iniciuar një proces të vazhdueshëm trajnimi në fushën e prokurimit publik, i cili do të jetë i vazhdueshëm për aq sa do të konsiderohet i nevojshëm dhe/ose i kërkuar nga ana e Autoriteteve Kontraktuese dhe Operatorëve Ekonomikë.

Objektivat dhe planifikimet janë që më 2021 dhe në vijim, të vazhdohet me trajnimin e zyrtareve të prokurimit dhe grupeve të tjera të interesit në fushën e prokurimit publik, me fokus në lidhje me ndryshimet ligjore të bëra si dhe përdorimin e kriterit, “Tenderi ekonomikisht më i favorshëm”, për të inkurajuar Autoritetet Kontraktuese në përdorimin e këtij kriteri për dhënie të kontratave publike, në mënyrë që të arrihet prokurim i qëndrueshëm.

Mbështetja e donatorëve

Institucionet e Kosovës mbështeten nga KE (përmes IPA-s) dhe nga donatorë të tjerë bilateralë me projektet e përmbledhur në vijim.

Projektet aktuale dhe të planifikuara IPA

- Reforma e sistemit të prokurimit publik në Kosovë është mbështetur kryesisht nga projektet përkatëse të financuara nga BE dhe Banka Botërore.
- DAI USAID “Komuna Transparente dhe Llogaridhënëse – Komponenti e Transparencën, dhe Komuna Llogaridhënëse”, i cili ka për qëllim përmirësimin e kapaciteteve administrative në fushën e prokurimit publik në Kosovë dhe parashihet që të përfundoj deri në fund të qershorit 2022.
- Organit Shqyrtues së Prokurimi, Ambasada e Britanisë së Madhe ka filluar të mbështesë OSHP-në me ekspertë që do të punojnë që vendimet të kenë arsyetim më racional dhe vendimet e OSHP-së të zbatohen tërësisht.
- Që nga fillimi i 2020 ka nisur zbatimin e projektit: Asistenca Teknike për të mbështetur zbatimin e Reformave në Menaxhimin e Financave Publike, financiar nga fondet e BE.

- Projekti i menaxhuar nga Agjencia e ardhshme për Integrim Evropian në ZKM (ish-MIE) dhe financuar nga Qeveria e Luksemburgut, që ka për qëllim ngritjen e kapaciteteve institucionale për administratën publike të Kosovës në përmbushjen e obligimeve që dalin nga MSA.

Reforma e sistemit të prokurimit publik në Kosovë është mbështetur kryesisht nga projektet përkatëse të financuara nga BE dhe Banka Botërore.

Që nga dhjetor i 2017 prokurimi publik në Kosovë është duke u mbështetur nga projekti i DAI USAID "Komuna Transparente dhe Llogaridhënese – Komponenti e Transparencën, dhe Komuna Llogaridhënese" i cili ka për qëllim përmirësimin e kapaciteteve administrative në fushën e prokurimit publik në Kosovë dhe parashihet që të përfundoj deri në fund të qershorit 2022.

Për më tepër ky projekt ka vazhduar të ndihmojë KRPP-në edhe në ofrimin e trajnimeve, objektivi i përgjithshëm i të cilit është të sigurojë administrimin e duhur të fondeve publike, transparencë dhe efektshmëri në shpenzimet publike përmes përmirësimit të sistemit të menaxhimit të financave publike dhe krijimit të një kuadri efektiv të qeverisjes publike në Kosovë dhe ndërtimin e besimit lidhur me shpenzimet publike duke rritur llogaridhënien publike. Projekti synon të ngrit Transparencën, Efikasitetin dhe Llogaridhënien në të gjitha komunat e Kosovës. Fillimisht si pilot projekt është iniciuar në pesë (5) komuna ndërsa më vonë pritet të përfshij të gjitha komunat e vendit.

Nga janari 2020 ka filluar zbatimi i projektit të financuar nga BE: Asistenca Teknike për të mbështetur zbatimin e Reformave në Menaxhimin e Financave Publike. Qëllimi i projektit të komponentit për prokurim publik është që të mbështesë Organet Qendrore të Prokurimit Publik në rolin e tyre rregullues, këshillues, monitorues, mbikëqyrës, zbatues dhe shqyrtues për të rritur efektivitetin e prokurimit publik përmes zbatimit të parimit të 'vlerës për para'. Gjithashtu projekti do të mbështesë KRPP në hartimin e kornizës së re ligjore të prokurimit publik në Kosovë që është më e përafuar me kërkesat e legjislativës të BE-së, përfshirë aktet nënligjore. Projekti parashihet të zgjasë 3 vite.

Projekti i Luksemburgut që mbështet aktivitetet e kapitullit 5, ka për qëllim zhvillimin e kapaciteteve institucionale në administratën publike të Kosovës në përmbushjen e obligimeve që dalin nga MSA. Ndër të tjera, parashihet zhvillimi i kapaciteteve të KRPP-së në administrimin e sistemit elektronik të prokurimit, monitorimin efikas të aktiviteteve të tilla si dhe ofrimin e trajnimeve në prokurimin publik. Për fillimin e vitit 2020, ndër të tjera, janë planifikuar trajnime të avancuara për aplikimin e ndryshimeve ligjore - veçanërisht transpozimin e Direktivave të BE-së, trajnime në fushën e IT-së për sigurinë e sistemit, si dhe trajnime në lidhje me dhënien e kontratave të koncesionit në kuadër të Partneritetit Publiko-Privat.

Gjatë vitit 2020, KRPP ne mbështetje të Projektit të Luksemburgut ka mbajtur trajnimin "Trajnimi për Trajner për Menaxhimin e Prokurimit Publik sipas sistemit të BE-së. Për shkak të situatës së krijuar me pandeminë Covid-19, trajnimi u mbajt në formatin Online. Pjesëmarrës ishin 10 zyrtarë nga 2 Institucionet Qendrore të Prokurimit Publik (KRPP & AQP) dhe kishte për qëllim zhvillimin e kapaciteteve të institucioneve qendrore të prokurimit publik në lidhje me zbatimin e Direktivave të BE-së për prokurim publik dhe praktikave më të mira, me fokus në: Ligji i prokurimit të BE-së; Parimet dhe çështjet ligjore; Procedurat e prokurimit dhe marrëveshjet kornizë; Prokurimi në shtëpinë dhe Prokurimi direkt; Kualifikimi & Përrjashtimi; Vetë- pastrimi; ESPD ose Dokumenti unik i prokurimit; eCertis; 'TEMF i bazuar në konceptin e' raportit më të mirë çmim- cilësi '; Menaxhimi i kontratave si dhe Teknikat dhe metodologjia e trajnimeve. Trajnimi është zbatuar nga njeri nga Institutet e njohura ndërkombëtare në fushën e trajnimeve në prokurimin publik ITC-ILO (International Training Center-International Labor Organization).

Gjithashtu gjatë vitit 2020, KRPP ne mbështetje të po të njëjtit projekt ka mbajtur trajnimin "Trajnimi CEH (Certified Ethical Hacker). Për shkak të situatës së krijuar me pandeminë Covid-19, trajnimi u mbajt në formatin Online. Trajnimi kishte për qëllim ngritjen e kapaciteteve në fushën e sigurisë së informacionit dhe mbrojtjes së dhënave, të stafit të e-prokurimit në kuadër të KRPP. Pjesëmarrës ishin 2 zyrtarë të TI nga Departamenti i e-prokurimit të KRPP. Trajnimi është mbajtur nga AUK (American University of Kosova).

Objektivat prioritarë afatmesme

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA dhe dokumentet e mekanizma të tjerë të aderimit në BE në kuadër të fushëveprimit të kapitullit 5, fokusi gjatë periudhës 2021-2025 do të jetë në këto objektiva prioritare afatmesme:

- Përafrimi i mëtejshëm i kornizës legjislative të vendit me kornizën ligjore të BE-së bazuar në kërkesat e MSA-së, dhe duke shfrytëzuar përvojën dhe praktikën më të mira të shteteve anëtare të BE-së në fushën e prokurimit publik.
- Rritja e efikasitetit në sistemin e Prokurimit Publik përfshirë edhe sistemin elektronik, vendosja e rregullave dhe monitorimi sipas parimit të transparencës dhe qasjes në informata në të gjitha fazat e aktivitetëve të prokurimit gjatë përdorimit të fondeve publike.
- Përmirësimi i përgjegjësisë, integritetit, llogaridhënies, kontrollit për zbatimin e politikave dhe legjislacionit në prokurim publik, duke bërë edhe ndryshimet e nevojshme ligjore të LPP-së.
- Trajnimi dhe rritja e cilësisë së trajnimeve për Prokurim Publik me qëllim të zhvillimit të kuadrove profesionale në fushën e prokurimit publik, për tu përballuar me një treg në rritje dhe rolin e tij të pritur në zhvillimin ekonomik kombëtar.
- Përmirësimi i mëtejshëm i koordinimit, përfshirë krijimin e mekanizmit të bashkëpunimit ndërinstitucional ndërmjet aktorëve të prokurimit publik si p.sh. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, Bordi për Shqyrtimin e Prokurimit, Agjencia Qendrore e Prokurimit por edhe Autoriteti i Konkurrencës i Kosovës, Auditori i Përgjithshëm, gjyqësori dhe institucionet e zbatimit të ligjit.
- Miratimi i rregulloreve dhe udhëzimeve për hulumtimin e tregut si pjesë e vlerësimit para-dhënies së vendimeve të prokurimit publik të centralizuar.
- Komunikimi dhe ngritja e vetëdijes për prokurimin publik në Kosovë.

3.6. Kapitulli 6 i acquis-së: E drejta e kompanive

Legjislacioni për Kompani përmban rregulla mbi formimin, regjistrimin, bashkimin dhe ndarjen e kompanive dhe kërkesat për raportim financiar që synojnë të përkrahin të drejtën e themelimit.

Në fushën e **të drejtës së kompanive**, Direktiva 2009/101/KE për koordinimin e masave mbrojtëse që kërkohen nga kompanitë për mbrojtje të interesave të anëtarëve dhe palëve të treta (e njohur më parë si Direktiva e Parë e të Drejtës së Kompanive) përmban kërkesa për shpалosjet obligative. Direktiva e Dytë e së drejtës së Kompanive 2012/30/BE konsiston në rregulla për themelimin e ndërmarrjeve publike me përgjegjësi të kufizuar dhe kapitalin e tyre. Direktiva 22e Njëmbëdhjetë e së Drejtës së Kompanive (89/666/KEE) rregullon kërkesat për shpалosje për degët e hapura në një vend anëtar dhe të qeverisura nga një vend tjetër. Direktiva e Dymbëdhjetë e së Drejtës së Kompanive (2009/102/KE) kërkon që vendet anëtare të njohin në ligjet e tyre kompanitë me përgjegjësi të kufizuar me një anëtar. Direktiva 2004/109/KE (Direktiva e Transparencës) kërkon harmonizimin e kërkesave për transparencë për kompanitë e listuara. Së fundmi është miratuar Direktiva 2017/1132 e cila kodifikon dhe zëvendëson 6 Direktiva: 82/891/KEE, 89/666/KEE, 2005/56/KE, 2009/101/KE, 2011/35/BE, 2012/30/BE.

Direktiva e Tretë (78/855/KEE) dhe e Gjashtë (82/891/KEE) e së Drejtës së Kompanive harmonizojnë rregullat kombëtare për mbrojtjen e aksionarëve dhe kreditorëve në kontekstin e bashkimeve dhe ndarjeve të kompanive me përgjegjësi të limituar publike vendore. Në këtë fushë acquis përmban edhe disa Direktiva të tjera që rregullojnë aspektet ndër-kufitare të funksionimit të kompanive.

Legjislacioni i BE-së gjithashtu përmban disa rregullore që rregullojnë forma legale Evropiane të caktuara siç janë për shembull Grupimi i Interesave Ekonomike Evropiane dhe Kompania Evropiane – *Societas Europaea* duke lënë në kompetencë të vendeve anëtare të rregullojnë operacionet dhe strukturën e brendshme. Katër Rekomandime të Komisionit (2004/913/KE, 2005/162/KE, 2009/385/KE, dhe 2009/384/KE) adresojnë principet e qeverisjes korporative për pagesën e drejtorëve dhe pagesën në institucionet financiare, pavarësinë e komiteteve të bordit dhe drejtorëve jo-ekzekutiv.

Në fushën e **raportimit financiar dhe auditimit**, rregullat e acquis kërkojnë paraqitjen e llogarive vjetore dhe të konsoliduara të ndërmarrjeve publike dhe private me përgjegjësi të kufizuar (Direktiva VII e së

Drejtës së Kompanive), pasqyrës së të hyrave dhe profitit (Direktiva IV e së Drejtës së Kompanive), përfshirë edhe rregullat e thjeshtuara për NVM. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit është i detyrueshëm për disa entitete me interes publik. Këto direktiva gjithashtu caktojnë kërkesat për auditim, dhe obligimet për shpalesje dhe publikim të të dhënave. Përveç kësaj, *acquis* përcakton rregullat për miratimin, integritetin profesional dhe pavarësinë e auditimeve ligjore.

Ekzistojnë edhe rregullore që i detyrojnë kompanitë të cilat janë të listuara në një treg të rregulluar, në mënyrë që llogaritë e tyre të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare të adoptuara nga KE. Së fundi, Direktiva e Tetë e së Drejtës së Kompanive (2006/43/KE) për Auditimin Ligjor harmonizon rregullat, përfshirë mes tjerash, miratimin dhe regjistrimin e auditorëve ligjor, sigurimin e jashtëm, mbikëqyrjen publike, pavarësinë e auditorit dhe zbatimin e mundshëm të standardeve ndërkombëtare të auditimit.

Kërkesat e MSA-së

Obligimet që dalin nga MSA për transpozimin gradual të legjislacionit të BE dhe zbatimin efektiv burojnë nga neni 74 i marrëveshjes. Këto obligime përfshijnë edhe fushën e të drejtës së kompanive dhe paragrafi 3 i nenit 74 i jep përparësi transpozimit të legjislacionit të tregut të brendshëm dhe atij tregtar në fazën e parë të periudhës tranzitore.

Sipas nenit 51, Kosova obligohet që me hyrjen në fuqi të MSA-se të sigurojë trajtim të barabartë kompanive të BE-së me ato vendore sa u përket kushteve të punës, pagesave dhe trajtimit të punëtorëve dhe subjekteve juridike të cilët themelohen juridikisht në territorin e Kosovës.

Kërkesat nga mekanizmat e tjerë të aderimit në BE

Raporti i KE-së për Kosovën – 2020 thekson se Kosova ka marrë hapa konkret për implementimin e Ligjit për Shoqëritë Tregtare. Në raport nënvizohet fakti se institucionet përgjegjëse kanë miratuar dy akte nënligjore, atë për numrin unik identifikues si dhe atë të tarifave. Megjithatë, theksohet nevoja për harmonizimin e mëtejshëm të së drejtës së kompanive me *acquis* të BE-së, sidomos dispozitave që kanë të bëjnë me kërkesat minimale të kapitalit, bashkimeve ndërkufitare, si dhe publikimit të informacioneve të degëve të huaja në Kosovë.

Në takimet e Nënkomitetit për Tregun e Brendshëm, Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Konkurrencë, u theksua nevoja që nismat e ardhshme legjislative të harmonizohen me dispozitat e Direktivës BE/2017/1132 dhe të bëhet përafrimi i më tejshëm i legjislacionit me atë të BE-së në fushat ku ka mangësi ose përafrim të pjesshëm në Ligjin për shoqëritë tregtare, përfshirë kërkesat minimale të kapitalit, aspektet e publikimit të informacionit për kompanitë dhe degët e tyre, bashkimet ndërkufitare, kompanitë anëtare të vetme, mbrojtjen e aksionarëve dhe ofertat për blerje. Poashtu, u theksua nevoja e hartimit dhe miratimit të Kodit të parë të Qeverisjes Korporative, sipas praktikave më të mira të BE-së.

Lidhur me raportimin financiar dhe auditimin, *Raporti KE-së për Kosovën – 2020* thekson se tashmë Ligji i ri për Raportim Financiar, Kontabilitet dhe Auditim ka hyrë në fuqi, si dhe janë miratuar aktet nënligjore sa i përket licensimit të auditorëve si dhe kompanive audituese. Raporti nënvizon nevojën që nismat e ardhshme për plotësim-ndryshimin e Ligjit duhet të kenë parasysh transpozimin e *acquis* që ka të bëjë me raportimin e komponentëve jo-financiar të kompanive. Raporti gjithashtu thekson se megjithëse Bordi i Mbikëqyerjes Publike është themeluar, ende nuk është gjete një zgjidhje e qëndrueshme financiare e cila do të mundësonte operimin normal të strukturave mbikëqyrëse.

Konkluzionet e Nënkomitetit për Treg të Brendshëm, Konkurrencë dhe Mbrojtje të Konsumatorit nënvizojnë nevojën për sigurimin e resurseve adekuate për strukturat mbikëqyerjes, si dhe për të mundësuar zhvillimin e aktiviteteve inspektuese.

Gjendja aktuale

Korniza legjislative dhe ajo e politikave

Korniza legjislative dhe ajo e politikave në fushën e së drejtës së kompanive përbëhet nga këto akte kryesore normative:

- Ligji nr. 06/L-O16 për Shoqëritë Tregtare;
- UA nr. 11/2018 për përcaktimin e taksave për shërbimet e ofruara nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve;
- UA që përcakton kërkesat, kushtet dhe procedurat për krijimin e Numrit Unik Identifikues.
- UA nr. 02/2020 për procedurën e regjistrimit të emrit zyrtar dhe emrit tregtar të shoqërive tregtare.
- UA Nr. 03/2020 për mënyrën dhe procedurën e regjistrimit dhe ndryshimit të dhënave të shoqërive tregtare në ARBK.

Aktet normative kanë transponuar këto akte të acquis-së:

- Direktivën 2009/101/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, për bashkërendimin e masave mbrojtëse të cilat kërkohen, për mbrojtjen e interesave të anëtarëve dhe palëve të treta, nga shtetet anëtare të kompanive në kuadër të kuptimit të paragrafit të dytë të nenit 48 të Traktatit, me pikëpamjen që këto masa mbrojtëse të bëhen të barasvlershme;
- Direktivën të Këshillit 89/666/KEE, lidhur me kërkesat për zbulim sa u përket degëve të hapura në një Shtet Anëtar nga lloje të caktuara kompanish të rregulluara me ligj të një Shteti tjetër;
- Direktivën 2011/35/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të 5 prillit 2011, në lidhje me bashkimet e shoqërive publike me përgjegjësi të kufizuar;
- Direktivën e gjashtë të Këshillit 82/891/KEE, bazuar në nenin 54 (3) (g) të Traktatit, sa i përket ndarjes së shoqërive tregtare publike me përgjegjësi të kufizuar, këtu e tutje direktiva 82/891/KEE;
- Direktivën 2005/56/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, për bashkimet ndërkufitare të shoqërive tregtare me përgjegjësi të kufizuar; Direktivën 2012/17/BE të Parlamentit dhe të Këshillit, të 13 qershorit 2012, për amendamentimin e Direktivës së Këshillit 89/666/KEE dhe Direktivave 2005/56/KE dhe 2009/101/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit sa i përket ndërlidhjes së regjistrave qendror, komercial dhe të shoqërive tregtare;
- Pjesërisht në përputhje me Direktivën 2012/30/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 25 tetor 2012, për bashkërendimin e masave mbrojtëse të cilat kërkohen, për mbrojtjen e interesave të anëtarëve dhe të tjerëve, nga Shtetet Anëtare të kompanive në kuadër të kuptimit të paragrafit të dytë të nenit 54 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian, sa i përket formimit të shoqërive tregtare me përgjegjësi të kufizuar dhe mirëmbajtjen dhe ndryshimin e kapitalit të tyre, me pikëpamjen që këto masa mbrojtëse të bëhen të barasvlershme.
- Direktivën 77/91/KEE për koordinimin e masave mbrojtëse, Direktiva 78/855/KEE e 9 tetorit 1978 në bazë të nenit 54 (3) (g) të Traktatit lidhur me bashkimet e ndërmarrjeve publike me përgjegjësi të kufizuar (shoqëri aksionare);
- Direktivën 82/891/KEE të 17 dhjetorit 1982 në bazë të nenit 54 (3) (g) të Traktatit, lidhur me ndarjen e shoqërive publike me përgjegjësi të kufizuar (shoqëri aksionare) Direktivën 89/667/KEE mbi kompanitë private me përgjegjësi të kufizuar një -anëtarësh (Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar)
- Direktivën 2005/56/KEE të Parlamentit dhe Këshilli Evropian, e 26 tetorit 2005, mbi shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar për bashkimin ndërkufitar;
- Direktivën 89/666/KEE në lidhje me kërkesat për dhënie informata shpjeguese në lidhje me degët e hapur në një Shtet Anëtar nga lloje të caktuara të shoqërisë të qeverisura nga ligji i një shteti tjetër.

Korniza e politikave në këtë fushë përbëhet nga këto dokumente:

- Programin e Qeverisë 2017-2021, i cili për këtë fushë përmban:
- Strategjinë për Zhvillimin e Sektorit Privat 2018-2021;
- Dokumente tjera strategjike nacionale dhe rajonale.

Raportimi financiar dhe auditimi

Korniza legislative në këtë fushë përbëhet nga Ligji nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

Ai ka transponuar këto akte të acquis-së:

- Direktivën 2006/43/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, për auditimet ligjore të pasqyrave vjetore financiare individuale dhe pasqyrave financiare të konsoliduara;

- Direktivën 2008/30/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, për ndryshimin e Direktivës 2006/43/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, për auditimet ligjore të pasqyrave vjetore financiare individuale dhe pasqyrave financiare të konsoliduara;
- Direktivën 2013/34/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, për pasqyrat vjetore financiare individuale, pasqyrat financiare të konsoliduara dhe raportet përkatëse të llojeve të caktuara të ndërmarrjeve, dhe për ndryshimin e Direktivës 2006/43/KE; dhe
- Direktivën 2014/56/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, për ndryshimin e Direktivës 2006/43/KE për auditimet ligjore të pasqyrave vjetore financiare individuale dhe pasqyrave financiare të konsoliduara.

Korniza institucionale

E drejta e kompanive

- Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, përkatësisht Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës.

Raportimi financiar dhe auditimi

- Këshilli Kosovar për Raportim Financiar dhe Auditim;
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Mbështetja e donatorëve

Projektet aktuale dhe të planifikuara të donatorëve bilateralë

Mbështetje institucionale të Kosovës në procesin integruar, është program i qeverisë së Luksemburgut i cili ka si synim ngritjen e kapaciteteve institucionale të Republikës së Kosovës në zbatimin e prioritetëve që dalin nga MSA. Ky projekt është duke ofruar mbështetje për ARBK-në dhe KKRF-në si bartëse kryesore të këtij kapitulli.

Objektivat prioritarë afatmesme

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA dhe dokumentet e mekanizmat e të tjerë të aderimit në BE në kuadër të fushëveprimit të kapitullit 6, fokusi gjatë periudhës 2021-2024 do të jetë në këto objektiva prioritarë afatmesme:

E drejta e kompanive:

- Kompletimi i legjislacionit sekondar për zbatimin e Ligjit për Shoqëritë Tregtare;
- Të bëhet përafrimi i legjislacionit vendor me aquis, gjegjësisht: Directive 2017/828, Directive 2019/1151 si dhe Directive 2019/2121;
- Përafrimi i legjislacionit përfshirë edhe sistemin e interkonjeksionit të BRIS;
- Zbatimi i qeverisjes korporative;
- Përmirësimi i kapaciteteve njerëzore dhe teknike të qendrave *One Stop Shop*, përmirësimi i shërbimeve të biznesit dhe ndërmarrja emasave afirmative për të inkurajuar gjininë e nën-përfaqësuar, në përputhje me Ligjin për Barazi Gjinore
- Trajnimi si stafit për përdorimin e softuerit dhe platformës së re elektronike.

Raportimi financiar dhe auditimi:

- Nxjerrja e akteve nënligjore të harmonizuara me Plotësim-ndryshim e Ligjit për Kontabilitet, Raportim financiar dhe Auditim;
- Zhvillimi dhe zbatimi i standardeve të auditimit dhe raportimit financiar, rregullave për Arsimin profesional dhe Zhvillimin e vazhdueshëm profesional në fushën e Kontabilitetit dhe Auditimit;
- Zhvillimi dhe zbatimi i metodologjisë së inspektimit të kualitetit të auditimeve në harmoni me rregulloren e auditimit;

3.7. Kapitulli 7 i aquis-së: E drejta e pronësisë intelektuale

Legjislacioni i BE-së në këtë fushë definon rregullat e harmonizuara për mbrojtjen e pronësisë industriale, të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta.

Në fushën e të drejtave të pronësisë industriale, *acquis* vendos rregullat për mbrojtje ligjore të markave tregtare, dizajnit industrial, patentave, tregusit gjeografike dhe emërtimet e origjinës si dhe mbrojtjen e topografisë që qarqeve të integruara. Për sistemin e patentave në BE është me rëndësi anëtarësimi në Konventën Evropiane të Patentave dhe Organizatën Evropiane të Patentave.

Direktiva 2015/2436/EU për Marka Tregtare dhe Direktiva 2015/2436/EU për Sekretin Tregtar duhet të transpozohen në legjislacionin nacional të Kosovës.

Acquis gjithashtu përfshin Rregulloret e BE, të cilat rregullojnë dizajnin industrial dhe markat tregtare në BE. Pjesëmarrja në Protokollin e Madridit dhe Marrëveshja e Hagës janë të rëndësishme për sistemin e markave tregtare dhe dizajnit në BE dhe për regjistrimin ndërkombëtar të dizajnit industrial dhe markave tregtare. Gjithashtu ekzistojnë edhe dispozita në kundërt të rregulloreve të BE për certifikatat e mbrojtjes suplementare që u ofrojnë pronarëve të shpikjeve mbrojtje shtesë në rastet kur patenta mbulohet nga një autorizim administrativ marketingu që nuk lejon përfitime të plota nga shfrytëzimi i patentës (*sidomos* në fushën e farmaceutikës, produkteve të bimëve etj.).

Në fushën e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta, objektivi kryesor është harmonizimi i disa aspekteve të shoqërisë informative në linjë me zhvillimet teknologjike. Këtu bën pjesë edhe legjislacioni i BE që rrjedh nga obligimet ndërkombëtare të traktateve për të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta të miratuara në kornizën e Organizatës Botërore për Pronësinë Intelektuale (WIPO). Direktiva 2006/115/KE rregullon të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta të mbajtësit. Kjo direktivë rregullon disa të drejta të përafërta përfshirë të drejtën e riprodhimit, transmetimit, dhe distribuimit. Direktiva 2006/116/KE e amandamentuar nga Direktiva 2011/77/BE vendos periudhën e mbrojtjes për lloje të ndryshme të punëve dhe çështje tjera të ndërlidhura për vendet anëtare të BE. Ekzistojnë edhe disa Direktiva e tjera që rregullojnë transmetimet audio-vizuale ndërkufitare (satelitore), të drejtën e rishitjes së përfitimeve të autorit, mbrojtjen e programeve kompjuterike, baza e të dhënave, digjitalizimin, dhe ekspozimin online për punët që autorët ose nuk dihen ose nuk mund të lokalizohen (kontaktohen).

Sa i përket zbatimit të të drejtave të pronësisë intelektuale dhe industriale, legjislacioni i BE-së kërkon që vendet anëtare të aplikojnë masa dhe ndëshkime efektive dhe proporcionale për falsifikimin dhe piraterinë e mallrave. Kjo synon të krijojë trajtim të barabartë për mbajtësit e të drejtave në gjithë BE-në. Rregullorja (KE) nr. 1383/2003 u jep rol të rëndësishëm administratave doganore në parandalimin dhe ndalimin nga qarkullimi të produkteve që shkelin të drejtën industriale ose të drejtën e autorit. Zbatimi i *acquis* në këtë fushë kërkon kapacitete dhe struktura adekuate e efektive. Duhet të ekzistojë një institucion që pranon aplikacionet për mbrojtje në të gjitha fushat e pronësisë intelektuale. BE është anëtare e Organizatës Botërore të Tregtisë e cila administron Marrëveshjen për Aspektet Tregtare të të Drejtave të Pronësisë Industriale.

Kërkesat e MSA-së

Dispozitat e MSA-së kërkojnë që institucionet kosovare përgjegjëse për pronësinë intelektuale të ofrojnë fillimisht kornizën ligjore të harmonizuar me Direktivat dhe rregulloren e BE-së, si dhe të ofrojnë mbrojtje të njëjtë të këtyre të drejtave në Kosovë në nivel të njëjtë me ato të vendeve të BE-së. Neni 77 dhe 78 i MSA-së e obligon Kosovën që të marrë të gjitha masat e nevojshme për garantim të mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale, përfshirë mjetet e efektshme për realizimin e këtyre të drejtave.

Më konkretisht, bazuar në nenet e MSA, Kosova duhet që:

- Të krijojë një sistem të pronësisë intelektuale në Kosovë konform standardeve ndërkombëtare në fushën e pronësisë intelektuale;
- T'i kushtohet vëmendje bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtarë, duke qenë se Kosova nuk është nënshkruese e ndonjë marrëveshje ndërkombëtare apo rajonale, ashtu sikurse nuk është anëtare e asnjë organizate ndërkombëtare dhe rajonale në fushën e pronësisë intelektuale;
- Kosova obligohet që të hartojë legjislacionin dhe politikat në atë mënyrë që të jenë konform parimit të trajtimit kombëtar (*National Treatment Principle*) përmes së cilit Kosova dhe BE do t'u ofrojnë

kompanive të njëra-tjetrës trajtim jo më pak të favorshëm se atë që ata i japin nga ana e tyre ndonjë vendi të tretë nën Marrëveshjet dypalëshe;

- Kosova kërkohet që konform nenit 109 të MSA-së të ketë bashkëpunim në fushën audio-vizuale për nxitjen e industrisë audio-vizuale në Evropë, si dhe për të përkrahë bashkë-prodhimin në fushat e kinemasë dhe mediave audio-vizuale, ku sipas këtij neni bashkëpunimi mund të përfshijë, programet dhe lehtësirat për trajnimin e gazetarëve dhe profesionistëve në industrinë e mediave audio-vizuale, ashtu si edhe asistencën teknike për mediat publike dhe private të Kosovës, me qëllim të përforsimit të pavarësisë së tyre, profesionalizmin dhe lidhjeve me median evropian;
- Të bëjë përafrimin e politikave të saj për rregullimin e aspekteve të përmbajtjes së transmetimeve ndërkufitare me ato të BE-së;
- Të harmonizojë legjislacionin e saj me acquis të BE-së në sferën e përvetësimit të së drejtës së pronësisë intelektuale për programet dhe transmetimin si dhe të siguroj dhe fuqizoj pavarësinë e autoriteteve rregullatore përkatëse;
- Të angazhohet në mbrojtjen e Treguesve Gjeografikë dhe Emërtimeve të Origjinës konform Neneve 2, 6, 7, 8 të Marrëveshjes për Njohjen, Mbrojtjen dhe Kontrollin Reciprok të Emrave të Verërave, Pijeve Alkoolike dhe Verërave të Aromatizuara të MSA-së;
- Të inkurajojë bashkëpunimin në kërkimet civile shkencore dhe zhvillimin teknologjik konform Nenit 118 të MSA-së, mbi bazën e përfitimit të ndërsjellë dhe duke marrë parasysh burimet e disponueshme, qasjen e duhur në programet e tyre përkatëse, të kushtëzuara nga nivelet e përshatshme të mbrojtjes efikase të të drejtave të pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare.

Kërkesat nga mekanizmat e tjerë të aderimit në BE

Në fushën e së drejtës së autorit, *Raporti i KE-së për Kosovën – 2020* veçon faktin që Kosova ka miratuar Strategjinë Kombëtare për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta, dhe se Ministria ka caktuar anëtarët e Task Forcës kundër piraterisë dhe falsifikimit. Raporti poashtu thekson se është themeluar Komisioni për caktimin e tarifave për shfrytëzimin e materialeve të mbrojtura me të drejtën e autorit, si dhe miratimi i këtyre tarifave pritet të ndodhë këtë vit.

Nga konkluzionet e Nënkomitetit për Treg të Brendshëm, Mbrojtje të Konsumatorit dhe Konkurrencë kërkohet nga Zyra për të Drejtat e Autorit që të harmonizojë legjislacionin me Direktivat relevante të BE-së, konkretisht Direktivën e Menaxhimit të të Drejtave Kolektive, si dhe të ndërmarrë hapat e nevojshëm për garantimin e rimbursimit të mbajtësve të së drejtës.

Në anën tjetër, sa i përket pronësisë industriale, *Raporti i KE-së për Kosovën – 2020* thekson se është shënuar progres në amendamentimin e legjislacionit të patentave, dhe se ende ka nevojë të përafrohet korniza ligjore me acquis të BE-së. Raporti njeh progresin e Agjencisë për Pronësi Industriale në reduktimin e aplikacioneve të vjetra (backlog), dhe në shtimin e resurseve të reja humane. Në raport nënvizohet nevoja e miratimit të Strategjisë kombëtare për Pronësi Industriale dhe forcimit të bashkëpunimit ndër-institucional.

Nga konkluzionet e Nënkomitetit për Treg të Brendshëm, Mbrojtje të Konsumatorit dhe Konkurrencë kërkohet që Agjencia për Pronësi Industriale duhet të vazhdoj harmonizimin e legjislacionit vendor me atë të BE-së sidomos në fushën e sekreteve tregtare, markave tregtare, dizajnëve industriale, patentave, dhe topografive. Bazuar në këto të fundit, kërkohet plotësim-ndryshimi i Ligjit për Patentat, Ligjit për Topografitë e Qarqeve të Integruara dhe Ligjit për Dizajnin Industrial si dhe të hartohet dhe miratohet Ligji për Markat Tregtare dhe Ligji për Sekretet Tregtare. Gjithashtu, theksohet nevoja për miratim të Strategjisë për Pronësi Industriale, dhe organizimit të aktiviteteve vetëdijësuese me publikun për rëndësinë e Pronësisë Industriale.

Në aspektin horizontal të zbatimit të të drejtave intelektuale, *Raporti i KE-së për Kosovën – 2020* konstaton se ka nevojë të forcohet bashkëpunimi mes policisë, doganave, dhe inspektoratit të tregut. Në këtë aspekt, përmendet nevoja për të marrë leje nga policia nga inspektorët e tregut para se të ndërmarrin ndonjë aktivitet investigativ.

Gjendja aktuale

Korniza legislative dhe ajo e politikave

Korniza legislative në fushën e së drejtës së autorit përbëhet nga këto akte kryesore normative:

- Ligji për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta nr. 04/L-065 dhe ai nr. 05/L-047 për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta;
- Plotësim-ndryshimi i Rregullores nr. 21/2018 për Ndërmjetësim në fushën e së drejtës së autorit dhe të Drejtave të Përafërta;
- Rregullorja nr. 20/2018 për të drejtën e kompensimit të veçantë dhe reprografik;
- Rregullorja nr. 01/2018 për procedurat e dhënies, përkatësisht marrjes së lejes shoqatave për administrim kolektiv të të Drejtave të Autorit dhe të Drejtave të Përafërta.
- Rregullore e Punës për Komisionin e Ekspertëve për Produktet Bujqësore dhe Artikujt Ushqimorë, i miratuar

Këto akte normative kanë transponuar këto akte të acquis-së:

- Direktivën 93/83/KE mbi koordinimin e rregullave të caktuara në lidhje me të drejtën e autorit dhe të drejtave të lidhura me të drejtën e autorit të aplikueshme në transmetimet satelitore dhe ritransmetimet kabllorë;
- Direktivën 2001/29/KE mbi harmonizimin e disa aspekteve të të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura në shoqërinë e informacionit;
- Direktivën 2001/84/KE mbi të drejtën e rishitjes në dobi të autorit në një vepër origjinale arti;
- Direktivën 96/9/KE e 11 marsit 1996 mbi mbrojtjen ligjore të bazave të të dhënave (OJ L 077, 27/03/1996);
- Direktivën 2006/115/KE mbi të drejtën e qirasë dhe të drejtën kreditimit dhe në disa të drejta që lidhen me të drejtën e autorit në fushën e pronësisë intelektuale;
- Direktivën 2009/24/BE-së mbi mbrojtjen ligjore të programeve kompjuterike;
- Direktivën 2011/77/BE, harmonizimin e afatit të mbrojtjes së të drejtës së autorit dhe disa të drejtave të lidhura (OJ L 265, 11/10/2011) që ndryshon Direktivën 2006/116/KE të 12 dhjetorit 2006;
- Direktivën 2012/28/BE (OJ L 299, 27/10/2012) mbi përdorimet e lejuara të caktuara të veprave jetimë;
- Direktivën 2014/26/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e (OJ L 84, 26/022014), për menaxhim kolektiv të të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura dhe licencimi multiterritoriale të drejtave në veprave muzikore për përdorim në internet në të brendshme tregut;
- Direktivën 2004/48/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit mbi zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale.

Korniza legislative në fushën e pronësisë industriale përbëhet nga këto akte kryesore normative:

- Ligji nr. 04/L-029 për Patenta;
- Ligji nr. 04/L-026 për Marka Tregtare;
- Ligji nr. 05/L-058 për Dizajnin Industrial;
- Ligji nr. 05/L-051 për Treguesit Gjeografikë dhe për Emërtimet e Origjinës;
- Ligji nr. 06/L-015 për Masat Doganore dhe Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale;
- Ligji për Inspektoratin e Tregut;
- Ligji nr. 03 L-165 për Përcaktimin e të Drejtave dhe Mbrojtjen e Topografisë së Qarqeve të Integruara
- UA nr. 09-2018 për Përcaktimin e Simboleve për Treguesit Gjeografikë, Emërtimit të Originës dhe Specialitetit Tradicional të Garantuar
- UA nr. 06-2018 për Përfaqësues të Autorizuar në Fushën e Pronësisë Industriale
- UA nr. 02-2017 për Kompetencat, Mandatin dhe Punën e Komisionit të Ankesave në Agjencinë e Pronësisë Industriale
- UA nr. 14-2016 për Regjistrimin e Markës Tregtare

- UA nr. 13-2016 për Procedurat e Regjistrimit të Patentave
- UA nr. 12-2016 për Regjistrimin e Dizajnit Industrial
- UA nr. 11-2016 për Treguesit Gjeografikë dhe Emërtimet e Originës
- UA nr. 10-2016 për Tarifat Administrative për Objektet e Pronësisë Industriale;
- Rregullorja nr. 01/2020 e Punës për Komisionin e Ekspertëve për Produktet Bujqësore dhe Artikujt Ushqimorë.

Këto akte normative kanë transponuar këto akte të acquis-së:

- Rregulloren (KE) nr. 1610/96 të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, mbi krijim e certifikatës së mbrojtjes shtesë për produktet mbi mbrojtjen e bimëve,
- Rregulloren e KE-së nr. 816/2006 mbi licencimin e detyrueshëm të patentave që lidhen me prodhimin e farmaceutikëve për eksport në vendet me probleme të shëndetit publik.
- Direktivën 98/44/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, mbi mbrojtjen ligjore të shpikjeve bioteknologjike;
- Rregulloren e KE-së nr. 469/2009 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit në lidhje me certifikatën e mbrojtjes shtesë për produkte mjekësore;
- Direktivën 2008/95 EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, për të përafuar ligjet e Shteteve Anëtare në lidhje me markat tregtare;
- Direktivën 2004/48/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, mbi zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale.
- Direktivën 98/71/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, mbi mbrojtjen e dizajnit industrial.
- Rregulloren e BE-së nr. 1151/2012 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 21 nëntorit 2012, mbi skemat e cilësisë për produkte bujqësore dhe ushqimore;
- Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 510/2006, e 20 marsit 2006, mbi Mbrojtjen e Treguesve Gjeografikë dhe Emërtimet e Originës së Produkteve Bujqësore dhe Produkteve Ushqimore;
- Rregulloren e BE-së nr. 608/2013.

Korniza institucionale

E drejta e autorit

- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Zyra për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta;

Pronësia industriale

- Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë / Agjencia për Pronësi Industriale

Zbatimi horizontal i së drejtës intelektuale

- Dogana e Kosovës;
- Inspektorati i Tregut;
- Policia e Kosovës: Njësia për Krime Ekonomike dhe Njësia për Krime Kibernetike.

Mbështetja e donatorëve

Institucionet e Kosovës mbështeten nga KE (përmes IPA-s) dhe nga donatorë të tjerë bilateralë me projektet e përmbledhur në vijim.

Projektet aktuale dhe të planifikuara IPA

Mbështetje për zhvillimin e tregtisë në Kosovë: Në kuadër të projektit të IPA II për Konkurrueshmërinë i cili ka filluar më 2018 është paraparë edhe mbështetja e Agjencisë për Pronësi Industriale, në veçanti në fuqizimin e zbatimit të së drejtës së pronësisë industriale, përfshirë treguesit gjeografik, sekretet tregtare, ngritjen e kapaciteteve të Agjencisë për pronësi industriale dhe vetëdijesimin e bizneseve dhe qytetarëve për përdorimin e sistemit IPR. Projekti financohet dhe menaxhohet nga Zyra e BE-së në Kosovë.

Mbështetja e BE-së për të drejtat e pronësisë intelektuale në Kosovë: Ky projekt, i nisur gjatë vitit 2019, synon mbështetjen e Agjencisë për Pronësi Industriale në hartimin e legjislacionit dhe të politikave, ngritjen e

kapaciteteve administrative dhe strukturore të institucioneve përgjegjëse për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale në Kosovë dhe në ngritjen e ndërgjegjësimit tek sektori privat.

Mbështetje institucioneve të Kosovës në procesin integruar, është program i qeverisë së Luksemburgut i cili ka si synim ngritjen e kapaciteteve institucionale të Republikës së Kosovës në zbatimin e prioriteteve që dalin nga MSA. Ky projekt që ka filluar më 2019, është duke ofruar mbështetje për Zyrën për të Drejtat e Autorit dhe Agjencinë për Pronësi Industriale.

Objektivat prioritare afatmesme

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA dhe dokumentet e mekanizma të tjerë të aderimit në BE në kuadër të fushëveprimit të kapitullit 7, fokusi gjatë periudhës 2021-2025 do të jetë në këto objektiva prioritare afatmesme:

Të drejtat e autorit dhe të drejtat e përfaqësuara:

- Ngritja e kapaciteteve të stafit në institucionet e pronësisë intelektuale dhe institucioneve zbatuese të drejtave pronësore intelektuale;
- Vetëdijësi i mbajtësve të të drejtave lidhur me rëndësinë e themelimit të Shoqatave të reja të Menaxhimit Kolektiv të të drejtave të autorit;
- Ngritja e vetëdijës së mbajtësve të të drejtave të autorit mbi rëndësinë dhe benefitet e menaxhimit kolektiv të të drejtave (me theks të veçantë aktivitete vetëdijësuese për botuesit);
- Nxjerrja e akteve nënligjore nga Ligji i ri për të Drejtat e Autorit;
- Promovimi tek autorët mbi rëndësinë e menaxhimit kolektiv të së drejtave;
- Përmirësimi i Legjislacionit në fushën e krimeve kibernetike;
- Ndërmarrja e masave për tu përafuar më tej me legjislacionin më të fundit të BE-së për të drejtat e autorit, siç është Direktiva e Menaxhimit të të Drejtave Kolektive
- Do të vazhdojnë përpjekjet për të garantuar zbatimin e marrëveshjeve të duhura kolektive të licencimit në mënyrë që të garantohet ri-imbursimi i mbajtësve të së drejtës.

Pronësia industriale:

- Do të vazhdohet tutje përafrimi me *acquis*, veçanërisht në lidhje me markat tregtare, sekretet tregtare, patentat dhe dizajnin industrial
- Do të punohet në zbatimin e Direktivës për Zbatimin e të Drejtave të Pronësisë Industriale
- Ngritja e resurseve humane pranë Agjencisë për Pronësi Industriale, krijimi i Divizionit të Promovimit dhe atij Juridik
- Ngritja e kapaciteteve profesionale të stafit të Agjencisë së Pronësisë Industriale
- Do të ndërmerren hapa konkretë për të rritur kapacitetin dhe koordinimin e institucioneve politikëbërëse dhe agjencive të zbatimit të ligjit - në veçanti efektivitetin e Task Forcës dhe Këshillit Shtetëror të IP - për të zbatuar të drejtat e pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare dhe për të luftuar mallrat e falsifikuara dhe piraterinë. Si rezultat, do të përgatiten raporte të përbashkëta të zbatimit të aktiviteteve.
- Intensifikimi i bashkëpunimit ndër-institucional me institucionet zbatuese dhe me institucionet politikëbërëse në fushën e pronësisë industriale
- Ngritja e vetëdijës të NVM-ve mbi rëndësinë e mbrojtjes së Pronësisë Industriale;
- Krahas ngjarjeve publike dhe takimeve me biznese, promovimi i DPI duhet të bëhet edhe përmes mjeteve të informimit ose mekanizmave të tjerë, ku audienca e synuar do të ishin edhe qytetarët. Synim i fushatave të tilla do të ishte ndërgjegjësimi i konsumatorëve që të mos përdorin mallra të falsifikuara, që mes e tjerash, përbëjnë edhe rrezik për shëndet.
- Anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare dhe evropiane (WIPO dhe EPO).

3.8. Kapitulli 8 i *acquis*-së: Politikat e konkurrencës

Politikat e konkurrencës përfshijnë politikat e anti-trustit dhe politikat e kontrollit të ndihmës shtetërore. Kapitulli përmban legjislacion, rregulla dhe procedura për sjelljen jo-konkurrese të ndërmarrjeve siç janë marrëveshjet e ndaluara ndërmjet ndërmarrjeve dhe abuzimi me pozitën dominuese në treg. Këtu

gjithashtu hyjnë analiza e bashkimit të ndërmarrjeve, dhe funksioni parandalues i qeverisë në dhënien e ndihmës shtetërore që çrregullon konkurrencën në treg. Legjislacioni i BE-së në fushën e konkurrencës buron nga Traktati për Funkcionimin e BE-së (TFBE), më konkretisht, neni 37 i cili rregullon monopolet shtetërore të karakterit komercial, nenet 101-105 që kanë të bëjnë me rregullat e zbatueshme për ndërmarrjet, neni 106 me ndërmarrjet publike dhe ndërmarrjet me të drejta të veçanta ose ekskluzive si dhe nenet 107-109 të Traktatit që kanë të bëjnë me rregullat e zbatueshme për ndihmën shtetërore.

Kërkesat e MSA-së

MSA, në anën tjetër, në mënyrë eksplicite vendosë një sërë obligimesh për Kosovën, të përfshira në Titullin VI, përkatësisht nga nenet 74-75 të MSA-së.

Sipas MSA-së, në fushën e politikave të konkurrencës, Kosova duhet të zbatojë rregullat e konkurrencës dhe gradualisht të përafrojë legjislacionin e saj me legjislacionin e BE-së duke filluar nga hyrja në fuqi e marrëveshjes (nenet 74, 75 të MSA-së). Për më tepër, Neni 75 “Konkurrenca dhe dispozitat e tjera” definon përgjegjësitë e Autoritetit të Konkurrencës dhe ofron kornizën për funksionimin e marrëveshjes në lidhje me tregtinë në mes të BE-së dhe Kosovës në të gjitha marrëveshjet midis ndërmarrjeve, vendimet nga grupe ndërmarrjesh dhe praktikat e bashkërenduara midis ndërmarrjeve që parandalojnë, kufizojnë ose çrregullojnë konkurrencën.

Marrëveshja ndikon në përafrimin gradual të legjislacionit të Kosovës me Acquis, zbatimin efektiv si dhe sigurimin e mekanizmave të monitorimit dhe transparencës kompatibil me rregullat e BE. Në esencë, kjo ka të bëjë me:

- Kartelet dhe Marrëveshjet mes Ndërmarrjeve;
- Abuzimin me Pozitën Dominuese; dhe
- Bashkimet, blerjet (e një kompanie nga një tjetër) në tregun relevant të Kosovës.

Ndërsa dispozitat e MSA për Ndihmën Shtetërore (nenet 75.1-75.7), kërkojnë që Kosova të mos jap ndihma shtetërore që çrregullojnë ose kërcënojnë të çrregullojnë konkurrencën duke favorizuar ndërmarrje ose produkte të caktuara për aq sa kjo afekton tregtinë midis BE-së dhe Kosovës. Kosova duhet gradualisht të përafrojë legjislacionin e saj me atë të BE-së dhe të themelojë një autoritet funksionalisht të pavarur i cili do të ketë fuqinë ligjore të kontrollojë ndihmën shtetërore.

Më konkretisht, bazuar në nenet e MSA-së Kosova duhet që:

- Të adoptojë legjislacionin për ndihmën shtetërore dhe të sigurojë që një autoriteti funksionalisht të pavarur i janë dhënë të drejtat e nevojshme për dhënien dhe kthimin e ndihmave;
- Të aplikojë rregullat e BE-së për ndihmën shtetërore, përfshirë Përfshirjet në Bllok, ndihmën *De minimis*, Shërbimet e Interesit të Përgjithshëm Ekonomik, dhe Rregullat e Transparencës për ndërmarrjet publike;
- Të krijojë një inventar të skemave të ndihmës shtetërore që ekzistojnë para hyrjes në fuqi të ligjit (skemat ekzistuese të ndihmës) brenda një periudhe tre-vjeçare nga hyrja në fuqi e marrëveshjes;
- Të sigurojë harmonizimin e skemave të ndihmës shtetërore brenda tri viteve nga hyrja në fuqi e marrëveshjes;
- Të bëjë një “hartë rajonale të ndihmës shtetërore” që ka të bëjë me të dhënat për BPV për kokë banori të harmonizuara me nivelin NUTS II brenda një periudhe 4-vjeçare nga hyrja në fuqi e marrëveshjes dhe ta diskutojë me Komisionin Evropian për nevoja të harmonizimit me rregullat e BE-së për ndihmën shtetërore rajonale. Ndërkohë, i gjithë territori i Kosovës do të trajtohet si rajonet më pak të zhvilluara për qëllime të aplikimit të limiteve të ndihmës rajonale; dhe
- Të raportojë në baza vjetore tek KE për ndihmat shtetërore në Kosovë përmes një raporti vjetor pas hyrjes në fuqi të MSA-së.
- Dispozitat e MSA për ndihmën shtetërore theksojnë rëndësinë e zhvillimit të legjislacionin kompatibil me rregullat e BE-së dhe vendosjes së mekanizmave monitorues dhe të transparencës.

Kërkesat nga mekanizmat e tjerë të aderimit në BE

Në fushën e konkurrencës, Raporti i KE-së për Kosovën – 2020 thekson se legjislacioni vendor është pjesërisht në linjë me acquis të BE-së. Në lidhje me këtë, theksohet nevoja që Kosova duhet të miratojë legjislacionin e nevojshëm për mbrojtje të konkurrencës për të adresuar zbrastësirat të cilat pengojnë implementimin e duhur të rregullave të konkurrencës. Raporti përmend Memorandumet e Mirëkuptimit të nënshkruara nga Autoriteti i Konkurrencës me Zyrën e Rregullatorit të Energjisë, Hekurudhat e Kosovës, Rregullatorin e Shërbimeve të Ujit, si dhe Bankës Qëndore. Raporti më tej kërkon nga institucionet përgjegjëse që të forcojnë bashkëpunimin ndër-institucional.

Sa i përket *Ndihmës Shtetërore*, njihet progresi në harmonizimin e legjislacionit vendor me atë të BE-së. Raporti nënvizon se përtej progresit të shënuar në emërimin e anëtarëve të Komisionit për Ndihmë Shtetërore, kapacitetet e tij mbesin të limituara.

- Miratimi i legjislacionit sekondar, rregullores së ndihmës rajonale si dhe rregullores për ndihmën horizontale, shërbime me interes të përgjithshëm ekonomik;
- Të vazhdohet edhe me tutje me ndjekjes e rasteve dhe me zbatimin e kontrollit të ndihmës shtetërorë;
- Të azhdohet me ngritjen e kapaciteteve dhe buxhetin e Departamentit të Ndihmës Shtetërore, në përputhje me kërkesat e ligjit për ndihmën e shtetit;
- Të mbahen trajnime profesionale për stafin e ndihmës shtetërore, stafin e institucioneve që marrin grante si dhe prokurove dhe gjyqtarëve;
- Krijimi i një platforme efektive për bashkëpunim midis Komisionit të Ndihmës Shtetërore dhe Departamentit të Ndihmës Shtetërore si dhe dhënësve të ndihmave, me qëllim të përmbushjes së detyrimeve të MSA-së për ndihmën shtetërore.

Në fushën e Konkurrencës kërkohet që të:

- Kompletohet procesi i harmonizimit me acquis të BE-së, duke i marre parasysh rekomandimet e Komisionit Evropian;
- Përforcohet kapaciteti administrativ i Autoritetit të Konkurrencës në Kosovë për të kryer hetime;
- Ndërmerren hapa për të siguruar që parimet e përcaktuara në TFEU, që zbatohen për ndërmarrjet publike dhe ndërmarrjet për të cilat janë dhënë të drejta të veçanta dhe ekskluzive, para 1 Prillit 2019, sipas parashikimeve të Art 76 të MSA-së;
- Legjislacioni për homologimin e automjeteve (Udhëzimi Administrativ nr. 2/2018, ligji për automjetet në nëntor 2020) duhet të rishikohet, në mënyrë që të harmonizohet me opinionin profesional të Autoritetit të Konkurrencës të Kosovës, praktikat më të mira të BE-së dhe për të eliminuar pengesat jo-tarifore.

Gjendja aktuale

Korniza legjislative dhe ajo e politikave

Konkurrenca

Kjo fushë rregullohet nga Ligji nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, i vitit 2010, i plotësuar ndryshuar nga Ligji nr. 04/L-226, i vitit 2014. Ky ligj definon rregullat dhe masat për mbrojtjen konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, kompetencat, organizimin e Autoritetit për Mbrojtjen e Konkurrencës si dhe procedurat për zbatimin e këtij ligji.

Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës është aktualisht në procedurë ndryshimi/plotësimi. Ndër arsyet kryesore për ndryshim të ligjit është përafrimi i mëtejshëm me legjislacionin evropian, ndërsa gjithashtu është vërejtur kolizion brenda vet ligjit si dhe është paraqitë nevoja për ndryshimin e përqindjes së pozitës dominuese.

Gjatë vitit 2019 drafti i koncept dokumentit për ligjin për mbrojtjen e konkurrencës ka përfunduar nëpërmjet të gjitha procedurave të parapara dhe është miratuar nga Qeveria. Gjatë vitit 2020, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ka finalizuar projektligjin për konkurrencë, i cili pas konsultimeve publike do procedohet në Qeveri dhe Kuvend për miratim.

Legjislacioni dytësor për zbatimin e ligjit për mbrojtjen e konkurrencës përbëhet nga 13 akte legjislative dytësore. Legjislacioni dytësor që pjesërisht transponon legjislacion të BE përfshin:

- UA nr. 05/2012 për kriteret dhe kushtet për caktimin e marrëveshjeve me vlerë të vogël
- UA nr. 06/2012 për mënyrën e paraqitjes e konstatimit e përqendrimit të ndërmarrjeve
- UA nr. 07/2012 mbi kriteret për lirin ose uljen e masës administrative
- Rregullore nr. 01-2017 për procedurat hetimore të autoritetit kosovar të konkurrencës
- UA nr. 02/2017 për Përfashtimin Grupor të Marrëveshjeve Horizontale Ndërmjet Ndërmarrësve;
- UA nr. 03/2017 për Përfashtimet Grupore të Marrëveshjeve Vertikale të Ndërmarrësve;
- UA nr. 04/2017 për Përfashtimet Grupore të Marrëveshjeve në Sektorin e Transportit;
- UA nr. 05/2017 për Përfashtimet Grupore të Marrëveshjeve në Sektorin e Sigurimeve;
- UA nr. 06/2017 për Përfashtimin Grupor të Marrëveshjeve për Distribuimin dhe Servisimin e Automjeteve Motorike.
- UA nr. 01/2018 mbi kriteret për shqiptimin e masës së sanksioneve administrative;
- UA nr. 02/2018 për mënyrën e përcaktimit të tregut relevant.
- Rregullore nr. 01/2019 Per marrëveshjet ne kategori te caktuara te specializimit
- Rregullore nr. 02/2019 per marrëveshjet ne kategori te caktuara te kerkimit dhe zhvillimit

Aktet normative kanë transpozuar këto akte të acquis-së:

- Nenet 101-105 te TFBE;
- Njoftimin e Komisionit për marrëveshjet e rëndësisë së vogël (*de minimis*) që nuk kufizojnë konkurrencën sipas nenit 81 pika 1 (tani neni 101) i Traktatit që themelon Komunitetin Evropian (OJ/C 368/13, e 22 dhjetorit 2001);
- Disa elemente të kërkesës dhe kriterëve për bashkimin/përqendrimin të definuar në Rregulloren e Komisionit nr. 802/2004 që zbaton Rregulloren e Këshillit nr. 139/2004 për kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve;
- Rregulloren e Komisionit (KE) nr. 773/2004, e 7 prillit 2004, në lidhje me zhvillimin e procedurave nga Komisioni në përputhje me nenet 81 dhe 82 të Traktatit të KE-së e amendamentuar me Rregulloren nr. 2015/1348;
- Rregulloren e Komisionit (KE) nr. 1217/2010;
- Rregulloren e Komisionit (KE) nr. 1218/2010.

Ndihma shtetërore

Legjislacioni bazë që rregullon këtë fushë konsiston nga Ligji nr. 05/L-100 për Ndhmën Shtetërore i cili ka hyre në fuqi në janar 2017. Ky ligj vendosë bazën për zhvillimin e sistemit të ndihmës shtetërore, principet dhe procedurat për dhënien e ndihmës shtetërore. Për më tepër, ligji përmban definicionet bazë përfshirë atë të ndihmës shtetërore, si dhe vendosë mekanizmin dhe kornizën për kontrollin e ndihmës shtetërore. Ai gjithashtu krijon bazën për themelimin e inventarit gjithëpërfshirës të ndihmave shtetërore dhe sistemin e raportimit.

Sa i përket legjislacionit sekondar, procedurat detale dhe përmbajtja e formularëve notifikues, procedurat për ndihmat joligjore, ato të monitorimit dhe raportimit janë rregulluar me Rregulloren Procedurat dhe Formatin e Njoftimit për Ndhmën Shtetërore e cila është rishikuar dhe hartuar sipas Ligjit të ri për Ndhmën Shtetërore. Kjo Rregullore pjesërisht transponon Rregulloren e Komisionit (KE) nr. 794/2004 e 21 prillit 2004 që zbaton Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 659/1999 që definojnë rregullat detale për aplikimin e Nenit 93 të Traktatit të Komunitetit Evropian. Gjithashtu, Rregullorja për Komisionin e Ndhmës Shtetërore është miratuar në vitin 2019. Ndërsa rregullat e organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Ndhmës Shtetërore përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë janë të rregulluara me Rregulloren nr. 01/2013 të Ministrisë së Financave për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Ndhmës Shtetërore.

Korniza e politikave në këtë fushë përbëhet nga këto dokumente:

- AKK - Strategjia për zbatimin e Reformave Evropiane - Parasheh dy detyrat kryesore të Autoritetit të cilat janë pjesë e zbatimit të Agjendës për Reforma Evropiane (ERA-s) dhe MSA për fushëveprimin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës që janë si në vijim:
- Fuqizimi i procedurave dhe kapaciteteve të brendshme në AKK: Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, përveç identifikimit të monopoleve do të identifikoi edhe ndërmarrjet e tjera tregtare të cilat kanë fuqi të konsiderueshme të tregut përkatës, ku Autoriteti do t'i jap rekomandimet e duhura bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës. Nëse Autoriteti Kosovar i Konkurrencës gjatë këtij hulumtimi identifikon ndonjë sjellje anti-konkurrese nga ndërmarrjet në tregjet përkatëse atëherë Autoriteti do ti ushtrojë autorizimet e tij ligjore dhe do të veproje menjëherë konform dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.
- AKK ka bërë hulumtimin dhe identifikimin e monopoleve në Kosovë për 14 tregje. Raporti mbi gjendjen aktuale për monopole për 14 tregje (telekomunikacionit, transportit, lojërave të fatit, energjisë, mediave dhe produksioneve kinematografike, minierave, sigurimeve, prokurimit, mbeturinave, derivateve të naftës, bankave, furnizimit me ujë, produkteve farmaceutike, dhe pajisjeve fiskale), bashkë me rekomandimet përkatëse, është ndarë me Qeverinë, Kuvendin dhe Komisionin Evropian. Nga të gjeturat e raportit të Hulumtimit të Monopoleve në RKS, Autoriteti ka marr hapa konkrete në disa nga tregjet e hulumtuara:

Korniza institucionale

Konkurrenca

Bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës (AKK) është institucioni kryesor për parandalimin dhe ndalimin e praktikave kundër konkurrencës përfshirë marrëveshjet e ndaluara, abuzimin me pozitën dominuese, përqendrimet ose shitjen dhe blerjen e aksioneve në ndërmarrje, dhe aspektet e avokimit në fushën e konkurrencës. Autoriteti gjithashtu ka kompetenca më inicimin e procedurave hetimore, mbikëqyrjen e tregut dhe propozimin e masave për vendosjen e konkurrencës në rastet e pengimit, kufizimit ose çrregullimit të konkurrencës në treg.

Ndihma shtetërore

Korniza institucionale konsiston në Komisionin e ndihmës Shtetërore dhe Departamentin për Ndihmë Shtetërore. DNSh pas marrjes së informatave dhe analizimit harton raportin vlerësues dhe e dërgon në Komisionin e Ndihmës Shtetërore (KNSh) për vendim, harton raportin vjetor për Departament, kontrollon ndihmat në nivel vendi, harton regjistrin e ndihmës De minimis dhe Regjistrin e përgjithshëm, harton Inventarin e ndihmave dhe i harmonizon ato me rregullat e ndihmës shtetërore, krijon Harten rajonale dhe çdo vit e rifreskon me të dhëna, dhe harton legjislacionin dytësorë, Departamenti ka shtatë (7) zyrtarë të punësuar, Drejtorin, dy udhëheqës të Divizioneve dhe 4 zyrtarë. Deri më tani DNSh ka hartuar 15 raporte vlerësuese dhe i ka dorëzuar në KNSh.

Mbështetja e donatorëve

Institucionet e Kosovës mbështeten nga KE (përmes IPA-s) dhe nga donatorët të tjerë bilateral me projektet e përmbledhur në vijim.

Projektet aktuale dhe të planifikuara të donatorëve bilateralë:

- Projekti i BE-së në kuadër të IPA II 2014-2020 për "Asistencë Teknike për Mbështetje për Autoritetin e Konkurrencës dhe Komisionin e Ndihmës Shtetërore (Departamenti i Ndihmës Shtetërore) ka filluar në vitin 2019 dhe do të zgjasë deri me 2021, me mundësi vazhdimi;
- Projekti i Ambasadës së Britanisë së Madhe ka mbështetur me ekspertë Autoritetin e Konkurrencës për ngritjen e kapaciteteve profesionale.
- Mbështetje institucionale të Kosovës në procesin integruar, është program i qeverisë së Luksemburgut i cili ka si synim ngritjen e kapaciteteve institucionale të Republikës së Kosovës në zbatimin e prioritetëve që dalin nga MSA. Ky projekt që ka filluar më 2019, është duke ofruar mbështetje për Autoritetin Kosovar të Konkurrencës, dhe Departamentin për Ndihmën Shtetërore.

Objektivat prioritarë afatmesme:

Konkurrenca:

- Hartimi i legjislacionit sekondar që derivon nga Ligji i ri për Konkurrencë.
- Përafrimi i mëtejshëm me Acquis të BE,
- Arritja e Memorandumeve e Bashkëpunimit me institucionet relevante.
- Hartimi i strategjisë për ngritjen e ndërgjegjësimit për politikën e konkurrencës.
- Organizimi i Seminareve me Gjykatat, Asociacioneve biznesore, Avokatet dhe Shoqërinë Civile.
- Zhvillimi i kapaciteteve institucionale dhe njerëzore përfshirë kapacitetet për analizën ex-ante dhe vlerësimin ex post, programe të trajnimit profesional të stafit të Autoritetit të konkurrencës.

Ndihma shtetërore:

- Përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit me atë të BE-së gjegjësisht transpozimi i Rregullores së Komisionit (KE) nr. 794/2004 e 21 prillit 2004 që transponon Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 659/1999 që definojnë rregullat detale për aplikimin e Nenit 93 të Traktatit të Komunitetit Evropian.
- Plotësim-ndryshimi i ligjit nr. 05 /L-100 me qëllim të përafrimit me acquis të BE-së;
- Hartimi dhe miratimi i Projekt Rregullorja për ndihmën sektoriale.
- Hartimi dhe Rregullorja për Instrumente specifike të ndihmës Shtetërore.
- Mbajtja e aktiviteteve të vetëdijësimit për institucionet dhënëse të ndihmës shtetërore dhe trajnimet për stafin të DNSh-së.
- Finalizimi i Inventarizimit të skemave të Ndihmës Shtetërore dhe harmonizimi i skemave me kërkesat e MSA;
- Zhvillimi i sistemit informativ për monitorimin e ndihmës shtetërore;

3.9. Kapitulli 9 i acquis-së: Shërbimet financiare

Acquis në fushën e shërbimeve financiare përfshin rregullat për autorizimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare në fushën bankare, sigurimit, pensione, shërbimet e investimeve dhe tregjet e letrave me vlerë si dhe në lidhje me infrastrukturën e tregut financiar. Sistemi i ri Evropian i Mbikëqyrjes Financiare (ESFS) hyri në fuqi në janar 2011. Ky sistem përbëhet nga një rrjet i mbikëqyrësve financiarë kombëtarë duke punuar së bashku me tre Autoritetet e reja Mbikëqyrëse Evropiane - me Autoritetin Bankar Evropian (EBA), me Autoritetin e Letrave me Vlerë dhe Tregjeve Evropiane (ESMA) si dhe me Autoritetin e Sigurimeve Evropiane dhe Pensioneve të Punës (EIOPA). Përveç kësaj, Bordi i Rrezikut Sistemik Evropian (ESRB) është themeluar për të monitoruar dhe vlerësuar kërcënimet e mundshme ndaj stabilitetit financiar që lindin nga zhvillimet makro-ekonomike dhe nga zhvillimet në sistemin financiar në tërësi.

Në fushën e **bankave dhe konglomerateve financiare**, acquis përcakton kërkesat për autorizimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e kujdesshme të institucioneve kredituese si dhe kërkesat në lidhje me llogaritjen e kapitalit të institucioneve kredituese dhe firmave investuese. Direktivat e tanishme për kërkesat e kapitalit, të cilat përkthejnë standardet ndërkombëtare Bazel II në ligjin e BE-së, është zëvendësuar më 2014 me një pako të bazuar në marrëveshjen e Basel III. Acquis në këtë sektor gjithashtu parashtron rregullat në lidhje me mbikëqyrjen shtesë të konglomerateve financiare dhe me marrjen, ndjekjen dhe mbikëqyrjen e kujdesshme të biznesit të institucioneve të parasë elektronike. Acquis përcakton rregullat lidhur me llogari vjetore të konsoliduara të bankave dhe institucioneve të tjera financiare.

Në fushën e **sigurimeve dhe pensione të punës**, disa Direktiva përcaktojnë rregulla lidhur me autorizimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e sigurimit të jetës dhe të jo-jetës dhe risigurimi i ndërmarrjeve. Acquis përcakton rregullat për mbikëqyrjen e sigurimit plotësues të grupeve. Dispozita të veçanta ekzistojnë në sektorin e jo-jetës për bashkë-sigurimin, ndihmë turistike, sigurimit të kredisë dhe sigurimit të shpenzimeve ligjore. Kjo përfshin një kuadër rregullativ të kujdesshëm për aktivitetet e risigurimit në BE që synojnë heqjen e pengesave për të arritur risigurimin afarist.

Në fushën e **tregjeve të letrave me vlerë dhe shërbimeve rreth investimeve**, Direktiva 2004/ 39/KE mbi tregjet në instrumente financiare (MiFID) së bashku me ndryshimet e saj dhe Masat zbatuese, përcakton një regjim të plotë rregullator që mbulon autorizimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e firmave investuese dhe tregjeve të rregulluara. Në lidhje me **infrastrukturën e tregut financiar**, *acquis synon* të heq pengesat në zona tregtare, duke rritur efikasitetin e infrastrukturës së tregut dhe nxitjen e stabilitetit financiar.

Së fundi, *acquis* ka një kornizë gjithëpërfshirëse rregullative dhe mbikëqyrëse për investimet alternative, fondet kapitale dhe ato shoqërore, duke rritur transparencën ndaj investitorëve dhe autoriteteve publike.

Kërkesat e MSA-së

Në kuadër të MSA, nga Kapitulli 9 Shërbimet Financiare, rrjedhin detyrimet për Bankën Qendrore të Kosovës (BQK) në fushën e shërbimeve financiare, përkatësisht në lidhje me të drejtën e vendosjes dhe lirinë e ofrimit të shërbimeve bankare, të sigurimeve dhe shërbimeve tjera në fushën financiare, si dhe përafrimin dhe zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullator (përkatësisht nenet 50, 96 dhe aneksit 6 të MSA-së), me legjislacionin e Bashkimit Evropian, statutin e Bankës Qendrore Evropiane dhe Sistemin Evropian të Bankave Qendrore.

Kërkesat nga mekanizmat e tjerë të aderimit në BE

Bazuar në *Raportin e KE-së për Kosovën – 2020*, Kosova është mesatarisht e përgatitur në fushën e shërbimeve financiare. Progres është bërë pas hyrjes në fuqi të rregulloreve të Basel III të lidhura me kërkesat e kapitalit dhe menaxhimin e rrezikut të bankave dhe përafrimi i tatimit të sektorit të sigurimeve me sektorët tjerë financiarë. Pasi që rekomandimet nga raportin i mëparshëm nuk janë adresuar plotësisht, ky raport nënvizon që Kosova në veçanti duhet të:

- Të zbatojë plotësisht masat Solvency I
- Avancojë edhe më tej zbatimin e kornizës Basel III dhe rishikimin e kornizës ligjore të qeverisjes së institucioneve mikrofinanciare dhe atyre financiare jobankare në përputhje me praktikën më të mirë;
- Të ndërmarrë veprime të menjëhershme për të adresuar çështjen e automjeteve të pasiguruara, të paregjistruara.

Konkluzionet e dala nga Nënkomiteti i vitit 2021 kërkojnë që të zbatohen plotësisht masat Solvency I dhe të vazhdohet zbatimi i hartës për transpozimin e masave Solvency 2. Po ashtu kërkohet që të miratohet Ligji për Bankat dhe Projektligji për Mikrofinancat dhe Institucionet Financiare Jo-Bankare deri në fund të këtij viti. BQK duhet të vendosë një funksion të pavarur të zgjidhjes brenda saj si dhe të vazhdojë rritjen e rolit të saj mbikëqyrës në industrinë e sigurimeve.

Tek **bankat dhe konglomeratet financiare**, është bërë pak progres në zbatimin e mbikëqyrjes bankare, që *synon* të përforcojë qeverisjen korporative dhe menaxhimin e riskut kreditor. Banka Qendrore duhet të sigurojë mbrojtje adekuate të konsumatorëve dhe parandalim të praktikave të padrejta bankare. Kosova duhet të krijojë një autoritet të pavarur të rikuperimit dhe zgjidhjeve. Tek harmonizimi i kornizës rregullative me standardet Bazel II dhe të BE-së, Kapitulli për Shumat e Ekspozimit me Normim Risku ende nuk është miratuar. Në mars 2017 Banka Qendrore nënshkroi një memorandum mirëkuptimi me Autoritetin Bankar Evropian, duke vendosur kështu një kornizë bashkëpunimi dhe këmbimi informatash, si dhe për Mekanizmin e Përbashkët Mbikëqyrës Evropian. Legjislacioni për institucionet mikro-financiare dhe institucionet financiare jo-bankare është në proces të përputhjes me *acquis* të BE-së Ligji për kontabilitet, raportim financiar, e që varet nga miratimi i Ligjit për IMF dhe IFJB i cili është proceduar disa herë por që akoma nuk është miratuar.

Tek **sigurimet dhe pensionet e punës**, masat Solvency I duhet të zbatohen plotësisht dhe është përgatitur harta për zbatimin e masave Solvency II. Ligji i sigurimeve është i përafër me *acquis* të BE-së për ushtrimin dhe zbatimin e biznesit të sigurimeve, ri-sigurimeve dhe ndërmjetësimit në sigurime. Mbikëqyrja dhe kontrollimi i fondeve të pensioneve të punës duhen përmirësuar. Pak progres është bërë në rritjen e transparencës së shërbimeve të sigurimit, gjegjësisht duke publikuar në internet raportet vjetore të auditimit, por nevojiten përpjekje të mëtejshme për të rritur kushtet për dhënien e licencave për

kompani të reja të sigurimeve. Nevojitet edhe bashkërendimi më i mirë ndërinstitucional për të adresuar çështjen e veturave të pasiguruara e të paregjistruara. Për shkak të pamundësisë që Kosova të jetë pjesë e sistemit të “kartonit të gjelbër”, sigurimi i automjeteve vazhdon të kërkohet për veturat me regjistrime të huaja që hyjnë në Kosovë dhe për automjetet me tabela kosovare që dalin nga Kosova. Kjo nuk vlen për vendet me të cilat Kosova ka rregullime bilaterale të sigurimeve të automjeteve.

Tek **tregjet e letrave me vlerë dhe shërbimet investuese**, Banka Qendrore vë në ankand letrat me vlerë të qeverisë dhe mban dosjet, të cilat ruhen dhe përpunohen në mënyrë elektronike.

Gjendja aktuale

Korniza legjislative

Sa i përket **sektorit bankar**, korniza ligjore dhe rregullative për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e bankave në Republikën e Kosovës përfshin:

- Ligjin nr. 05/L-150 për amendamentimin e Ligjit nr. 03/1-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (me tutje Ligji për BQK-në);
- Ligjin nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jo bankare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/11 maj 2012) (me tutje Ligji për Bankat);
- Ligjin nr. 04/L-155 për Sistemin e Pagesave (me tutje Ligji për Sistemin e Pagesave).

Në kuadër të legjislacionit ekzistues, në vijim është paraqitur edhe legjislacioni sekondar (rregullat, rregulloret dhe udhëzimet) të nxjerrë nga BQK duke u bazuar dhe në zbatim të ligjeve të lartcekura (Ligji për BQK-në, Ligji për Bankat dhe Ligji për Sistemin e Pagesave) që adresojnë licencimin, organizimin, operimin, kërkesat për menaxhimin e rrezikut dhe kërkesat për mbikëqyrjen prudenciale të bankave, institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve financiare jobankare. Kjo kornizë rregullative për rregullimin dhe mbikëqyrjen e bankave është e bazuar në Parimet Bazike të Komitetit të Basel-it dhe Standardet e Basel II dhe III. Në vitin 2020 janë miratuar këto rregullore dhe udhëzime:

- Rregullore për huadhënie brenda ditore dhe njëditore
- Rregullore për licencimin e bankave dhe degëve të bankave të huaja
- Rregullore për raportimin e bankave
- Rregullore për teknologji të informacionit për banka
- Udhëzim metodologjik për raportim të bankave
- Udhëzim metodologjik për raportimin për treguesin e leverazhit
- Udhëzim metodologjik për adekuatshmërinë e kapitalit
- Udhëzues për ristrukturim të kredive për shkak të Covid-19

Gjithashtu gjatë vitit 2020 janë hartuar rregullorja për Treguesin e Mbulimit me Likuiditet (LCR) dhe Rregullorja për Treguesin e Financimit të Qëndrueshëm Neto (NSFR). Këto rregullore pasi të finalizohen pritet të miratohen nga organet vendimmarrëse të BQK-së. Hartimi i këtyre rregulloreve po bëhet në pajtim me Rregulloren e BE-së 2015/61 mbi kërkesën e mbulimit me likuiditet të dt. 10 tetor 2014, Rregulloren e BE-së 2018/1620 mbi plotësimin e rregullores 2015/61 mbi kërkesën e mbulimit me likuiditet dt. 13 korrik 2018, si dhe Rregulloren e BE-se 2019/876 për Treguesin e Financimit të Qëndrueshëm Neto.

Rregulloret e tjera në zbatim të Ligjit për Banka që janë në fuqi janë të listuara më poshtë:

- Rregullore për drejtorët dhe menaxherët e lartë të bankave;
- Rregullore për adekuatshmërinë e kapitalit të bankave;
- Rregullore për auditimin e jashtëm të bankave;
- Rregullore për bashkimet dhe përvetësimet e bankave;
- Rregullore për depozita ekuivalente me kapitalin për degët e bankave të huaja;
- Rregullore për ekspozimet e mëdha;
- Rregullore për hapjen dhe mbylljen brenda dhe jashtë Kosovës të degëve dhe subjekteve të varura të bankave;
- Rregullore për hapjen e zyrave përfaqësuese brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës;
- Rregullore për instrumentet dhe marrëveshjet e garantimit të FKGGK-së;

- Rregullore për kontrollet e brendshme dhe auditimin e brendshëm të bankave;
- Rregullore për kreditë hipotekare rezidenciale;
- Rregullore për kufizimet në mbajtjen e pasurisë së paluajtshme dhe të luajtshme;
- Rregullore për kërkesat minimale të sigurisë;
- Rregullore për letërkredinë dhe garancionin bankar;
- Rregullore për lëshimin e certifikatave të licencimit apo regjistrimit të institucioneve financiare;
- Rregullore për mbikëqyrjen e konsoliduar të grupeve bankare;
- Rregullore për mbështetjen emergjente për likuiditet;
- Rregullore për menaxhimin e rrezikut operacional;
- Rregullore për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit;
- Rregullore për menaxhimin e rrezikut të normës së interesit në librin e bankës;
- Rregullore për minimumin e rezervave të bankës;
- Rregullore për ndryshimet në llogaritë e kapitalit;
- Rregullore për normën efektive të interesit dhe kërkesat për shpalesje të bankave;
- Rregullore për publikimin e informacionit nga bankat;
- Rregullore për përdorimin e vlerësimeve të jashtme kreditore për qëllim të llogaritjes së kapitalit rregullativ;
- Rregullore për qeverisjen korporative të bankave;
- Rregullore për aplikimin e standardit ndërkombëtar të raportimit financiar 9;
- Rregullore për ekspozimet joperformuese dhe ristrukturimet;
- Rregullore për menaxhimin e rrezikut kreditor;
- Rregullore për procesin e vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit;
- Rregullore për riblerje të letrave me vlerë me Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës;
- Rregullore për transaksionet me personat e ndërlidhur me bankën dhe punëtorët e bankës;
- Rregullore për treguesin e leverazhit;
- Rregullore për rrezikun nga aktiviteti me valuta të huaja;
- Rregullore për shpërndarjen e mjeteve të kredisë për banka;
- Rregullore për sigurimin e kasafortës;
- Rregullore për operatorët e sistemit të pagesave;
- Rregullore për instrumentet e pagesave elektronike;
- Rregullore për pagesat ndërkombëtare;
- Rregullore për raportimin e statistikave të instrumenteve të pagesave;
- Rregullore për regjistrin e llogarive bankare;
- Rregullore për instrumentet e pagesave elektronike;
- Rregullore për sistemin e pagesave ndërbankare;
- Rregullore për sistemin e numrave standardë të llogarive bankare.

Ligji për bankat dhe rregulloret e lartcekura kanë vendosur bazën ligjore për adaptimin e kërkesave të Direktivës 2006/48/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të 14 qershorit 2006 për fillimin dhe vazhdimin e ushtrimit të veprimtarisë së Institucioneve Kreditore dhe Direktivës 2006/49/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 14 qershorit 2006 për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Shoqërive Investuese dhe Institucioneve Kreditore, të cilat janë zëvendësuar më 2013 me miratimin e Direktivës 2013/36/BE për Qasjen në Aktivitetin e Institucioneve Kreditore dhe Mbikëqyrjen Prudenciale të Institucioneve Kreditore dhe Firmave Investuese (CRD IV) dhe Rregullores (BE) nr. 575/2013 për Kërkesat Prudenciale për Institucionet Kreditore dhe Shoqëritë Investuese (CRR).

BQK-ja është në proces të rishikimit të Ligjit aktual për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare me qëllim të hartimit të një Ligji të ri që do të zbatohet vetëm për bankat. Me rishikimin e Ligjit ekzistues në veçanti është punuar në Kapitujt X dhe XI në mënyrë që të sigurohet që këta kapitujt të përputhen me Direktivën e Parlamentit Evropian dhe Këshillit 2014/59 / BE ose "BRRD".

Sa i përket **Fondit të Sigurimit të Depozitave**, që nga viti 2011 është themeluar me anë të Ligjit nr. 03/L-216 për Themelimin e Sistemit për Sigurimin e Depozitave për Institucionet Financiare në Kosovë i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-133 për amendamentimin e Ligjit nr. 03/L-216 për Themelimin e Sistemit për Sigurimin e Depozitave për Institucionet Financiare në Kosovë. Ky ligj rregullon sigurimin e depozitave të personave fizik dhe juridik, themelimin, qeverisjen, autoritetin e Fondit të Sigurimit të Depozitave në Kosovë.

Sistemi i Sigurimit të Depozitave ("SSD") është themeluar si projekt zhvillimor ne kuadër te bashkëpunimit bilateral Gjermano-Kosovar, ku më 2011 është nënshkruar Marrëveshja trepalëshe e Financimit dhe Projektit në mes të Qeverisë së Kosovës (përmes MF), Qeverisë Gjermane (përmes KfW-së) dhe FSDK-së (si Agjenci për Ekzekutimin e Projektit) për themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave në Kosovë përmes një kontributi në kapital si donacion për FSD-në në shumë totale prej 15.5 milionë, ku 11 milionë janë dhënë nga Qeveria e Kosovës (përmes MF) ndërsa Qeveria Gjermane (nëpërmjet KfW) ka siguruar 4.5 milionë kontribut në kapital, dhe 0.5 milionë në shërbime të shoqëruara këshillimore. Kësti i tretë i paguar nga Qeveria e Kosovës (përmes MF) në shumën prej euro 2.9 milionë është financuar nga kredia e IDA-së (nëpërmjet BB). Në mbështetje të rritjes së limitit të sigurimit në 5,000 nga 01.01.2018, FSDK ka pranuar një kontribut shtesë nga Qeveria Gjermane (përmes KfW) në vlerë prej euro 2 milionë më 2013. Ky projekt tre-vjeçar është përmbyllur në korrik 2015.

Karakteristikat kryesore të SSD-së në Kosovë janë: pavarësia e agjencisë së sigurimit të depozitave, anëtarësimi i detyrueshëm i të gjitha institucioneve që pranojnë depozita, financimi "paraprak" ("ex-ante"), sistemi i premiumit diferencues, mbulueshmëria e sigurimit që përfshin individët dhe personat juridik, shumica e kufizuar e sigurimit të depozitave, rregulli i sigurimit i depozitave: për depozitues, për çdo bankë, lartësia e synuar e FSD-së, politikë konservatore e investimeve.

Sa i përket Sistemit për Sigurimin e Depozitave, korniza ligjore përfshin:

- Ligjin nr. 03/L-216 mbi Themelimin e Sistemit për Sigurimin e Depozitave për Institucionet Financiare në Kosovë i ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-133 për Amendamentimin e Ligjit 03/L-216 që rregullon sigurimin e depozitave të personave fizikë dhe personave juridikë si dhe themelimin, qeverisja dhe autorizimet e Fondit për Sigurimin e Depozitave në Kosovës;
- Ligjin nr. 03-L-216 për themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave ne institucionet financiare në Kosovë;
- Ligjin nr. 04-L-133 për amendamentimin e ligjit nr. 03-L-216 mbi themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë.

Në kuadër të legjislacionit ekzistues, në vijim është paraqitur edhe legjislacioni sekondar (rregullat, rregulloret dhe udhëzimet) të nxjerrë nga FSDK, bazuar dhe në zbatim të ligjeve të lartcekura që adresojnë obligimet e bankave anëtare që ndërlidhën me sigurimin e depozitave të personave fizikë dhe personave juridikë, kërkesat për strukturës dhe formatit të të dhënave për tu dorëzuar nga bankat anëtare për përcaktim të saktë dhe të shpejtë të depozitave të siguruara, llogaritjen dhe arkëtimin e premieeve fillestare dhe të vazhdueshme informimin e klientëve të anëtare, etj. Kjo kornizë rregullative është plotësuar më 2013-2016:

- Rregulla për pjesëmarrje të bankave anëtare në testim të SKD-se dhe dorëzim të të dhënave me specifika dhe format për përcaktim të depozitave të siguruara;
- Rregulla mbi raportimin tremujor të anëtarëve mbi depozitat dhe detyrimet e vonuara të depozituesve në fondin e sigurimit të depozitave në Kosovë;
- Rregulla mbi llogaritjen dhe arkëtimin e premieeve fillestare dhe të vazhdueshme;
- Rregulla mbi sanksionet administrative për anëtarët e fondit për sigurimin e depozitave;
- Rregulla për informimin e klientëve të anëtarëve të FSDK-së – amendamentuar;
- Rregulla mbi procesin e përzgjedhjes dhe kriteret e përzgjedhjes për bankën agjente të pagesës;
- Rregulla mbi financimin emergjent;
- Rregulloret për procedurat e kompensimit të depozitave të siguruara;
- Rregulla për procedurën e përgjithshme për konsultim me palët e interesit;

- Udhëzuesi i investimeve nga fondi i sigurimit të depozitave në Kosovë;
- Politika e vetëdijesimit të publikut;
- Udhëzues për depozitorët mbi procesin e kompensimit të depozitave të siguruara.

Sa i përket fushës së **sigurimeve**, korniza ligjore dhe rregullative për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e sigurimeve në Republikën e Kosovës përfshin:

- Ligji nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës;
- Ligji nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia (me tutje Ligji për Sigurimin nga Autopërgjegjësia);
- Ligji nr. 05/L-045 për Sigurimet i cili ka shfuqizuar Rregulloren nr. 2001/25 mbi Licencimin, Mbikëqyrjen dhe Rregullimin e Kompanive të Sigurimit e të Ndërmjetësuesve të Sigurimit (me tutje Rregulloren nr. 2001/25).

Ligji nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia dhe rregulloret në zbatim të tij janë pjesërisht në harmoni me Direktivën Evropiane 2009/103/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të 16 shtatorit 2009, për sigurimin ndaj përgjegjësisë civile lidhur me përdorimin e mjeteve motorike, dhe zbatimin e obligimit për sigurim ndaj kësaj përgjegjësie.

Me qëllim të harmonizimit dhe përafrimit të legjislacionit në fushën e sigurimeve me Direktivat Evropiane, në fillim të vitit 2016 ka hyrë në fuqi Ligji nr. 05/L-045 për Sigurimet, i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës i cili ka shfuqizuar Rregulloren nr. 2001/25 mbi Licencimin, Mbikëqyrjen dhe Rregullimin e Kompanive të Sigurimit e të Ndërmjetësuesve të Sigurimit (më tutje Rregulloren nr. 2001/25) e cila ka qenë në fuqi. Ligji pjesërisht është i harmonizuar me Direktivën Evropiane 2009/138 EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të 25 nëntorit 2009, për themelimin dhe vazhdimin e veprimtarisë së biznesit të sigurimeve dhe ri-sigurimeve (Solvency II) dhe Direktivën Evropiane 2002/92/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 9 dhjetorit 2002 për ndërmjetësimin në sigurime. Përmes këtij Ligji janë vendosur bazat për përafrim të mëtejshme me acquis të BE-së. Ligji i lartcekur përcakton parimet dhe rregullat themelore për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e siguruesve, ri-siguruesve, ndërmjetësuesve të sigurimeve dhe subjekteve tjera relevante, në mënyrë që industria e sigurimeve në Republikën e Kosovës të operojë në mënyrë të sigurt, të qëndrueshme dhe transparente në mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të policëmbajtësve gra dhe burra. Të gjitha aktet juridike (rregullore) të nxjerra në bazë të Rregullores 2001/25 kanë mbetur në fuqi për aq sa nuk janë në kundërshtim me Ligjin për Sigurimet. Ka filluar procesi i rishikimit të të gjitha rregulloreve i cili ka për qëllim harmonizimin e plotë rregulloreve me kërkesat e Ligjit për Sigurimet, ku deri më tani janë nxjerrë disa rregullore.

Rregulloret e adaptuara të bazuara në zbatimin e Ligjit për BQK-në, Ligjit për sigurimin nga autopërgjegjësia, Ligjit për Sigurimet dhe Rregullores nr. 2001/25, të cilat janë cekur më lartë, janë si vijon:

- Rregullore për llogaritjen e kufirit minimal të aftësisë paguese, adekuatshmërisë së kapitalit dhe fondit garantues për siguruesit jo-jetë;
- Rregullore për aktuarët e sigurimeve;
- Rregullore për auditimin e jashtëm të siguruesve, ndërmjetësuesve të sigurimeve, trajtuesve të dëmeve dhe Byrosë Kosovare të Sigurimit;
- Rregullore për bashkimet dhe përvetësimet;
- Rregullore për delegimin e funksioneve të siguruesve;
- Rregullore për depozitim të aseteve si garancë, mjaftueshmërinë e kapitalit, raportimin financiar, etj.;
- Rregullore për hapjen dhe mbylljen brenda dhe jashtë Kosovës të degëve dhe subjekteve të varura të siguruesve;
- Rregullore për hapjen e zyrave përfaqësuese brenda Kosovës nga siguruesit e jashtëm;
- Rregullore për investimin e aseteve në mbulim të provizioneve teknike dhe matematike si dhe investimin e kapitalit themeltar të siguruesve;
- Rregullore për kontrollin e brendshme dhe auditimin e brendshëm të siguruesve;
- Rregullore për kushtet e përgjithshme të policës së sigurimit nga autopërgjegjësia;

- Rregullore për kërkesat e mbajtjes së rrezikut dhe mbulimit përmes risigurimit;
- Rregullore për procedurat e trajtimit të kërkesave për kompensimin e dëmeve nga autopërgjegjësia;
- Rregullore për procedurat e tribunalit të arbitrazhit;
- Rregullore për publikimin e informacionit nga siguruesit;
- Rregullore për përcaktimin e kriterëve për vlerësimin e dëmeve jomateriale nga autopërgjegjësia;
- Rregullore për raportimin e siguruesve në BQK;
- Rregullore për mbikëqyrjen e konsoliduar të grupeve të siguruesve;
- Rregullore për financimin dhe llogaritjen e fondit të kompensimit;
- Rregullore për licencimin e trajtuesve të dëmeve në sigurime;
- Rregullore për likuidimin e siguruesve;
- Rregullore për shitjen e sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia dhe menaxhimin e shpenzimeve të siguruesve;
- Rregullore për standardet e raportimit dhe të mbikëqyrjes së Byrosë Kosovare të Sigurimit;
- Rregullore për strukturat e primit për sigurime;
- Rregullore për vlerësimin dhe mbajtjen e provizioneve teknike dhe matematike për siguruesit jetë dhe jojetë.

Gjatë vitit 2020 janë miratuar këto rregullore:

- Rregullore për licencimin e ndërmjetësuesve në sigurime;
- Rregullore për dënimet me gjobë për siguruesit, ndërmjetësuesit në sigurime dhe trajtuesit e dëmeve në sigurime;
- Rregullore për licencimin e siguruesve dhe degëve të siguruesve të jashtëm;
- Rregullore për menaxhimin e komisioneve dhe shpenzimeve operative të siguruesve
- Rregullore për qeverisjen korporative të siguruesve;
- Rregullore për zbatimin e sistemit bonus-malus.

Këto rregullore dhe rregulla janë pjesërisht të harmonizuara me Direktiva të BE-së në fushën e sigurimeve, të cilat rregullojnë çështjet si: sigurimin jo-jetë, sigurimin jetë, ndërmjetësimin në sigurime, sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia, kërkesat prudenciale për menaxhimin e rrezikut, kërkesat minimale të kapitalit, si dhe çështje tjera me rëndësi për fushën e sigurimeve. Në përpjekje të vazhdueshme për të harmonizuar legjislacionin në fushën e sigurimeve me acquis të BE-së, siç është cekur edhe më lartë.

Sa i përket fushës së **pensioneve**, ligji për BQK i ka përcaktuar fondet pensionale si institucione financiare. Prandaj, ky ligj përcakton kompetencën ekskluzive të BQK-së për të licencuar, rregulluar dhe mbikëqyrur Fondet Pensionale të Kosovës.

Korniza ligjore dhe rregullative për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e fondeve pensionale në Republikën e Kosovës përfshin Ligjin nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës (Ligji për Fondet Pensionale) dhe rregulloret e BQK-së për Fondet Pensionale.

Ligji nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale dhe rregulloret në zbatim të tij janë pjesërisht në harmoni me Direktivën e BE-së 2003/41/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 3 qershor 2003 për aktivitetet dhe mbikëqyrjen e institucioneve e pensioneve të punësimit, me anë të cilit janë përcaktuar bazën për harmonizimin e plotë të kërkesave të kësaj direktive.

Në fund të vitit 2015, ka filluar të rishikohet Ligji nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës (Ligji për Fondet Pensionale), në shtator të vitit 2016 është bërë leximi i parë në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Miratimi i plotësim-ndryshimit të Ligjit në fjalë është miratuar dhe publikuar në janar 2017.

Rregulloret e miratuara sipas Ligjit për BQK-në dhe Ligjit për Fondet Pensionale: korniza rregullative për rregullimin dhe mbikëqyrjen e pensioneve pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Fondet Pensionale, janë:

- Rregullorja mbi themelimin e pensionit plotësues individual nga ofruesit e pensionit;
- Rregullorja mbi raportet dhe informatat që kërkohen nga fondi i kursimeve pensionale të Kosovës;

- Rregullorja mbi investimet e mjeteve pensionale;
- Rregullorja për kontrollet e brendshme dhe auditimin e brendshëm për fondet pensionale;
- Rregullorja për licencimin e menaxhuesve të mjeteve për mjetet e fondeve pensionale;
- Rregullorja për licencimin e ofruesve të pensioneve plotësuese individuale;
- Rregullorja mbi llogaritë individuale të pjesëmarrësve;
- Rregullorja për mbajtësin e mjeteve të pensioneve;
- Rregullorja mbi mjetet e pensioneve dhe vlerësimin e mjeteve pensionale;
- Rregullorja mbi pagesën e pensioneve individuale të kursyera;
- Rregullorja për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve për tërheqjen e mjeteve nga FKPK për pjesëmarrësit me emigrim të përhershëm;
- Rregullorja për raportimin e fondeve plotësuese pensionale;
- Rregullorja për raportim të fondit të kursimeve pensionale të Kosovës;
- Rregullorja për financimin dhe vlerësimin aktuarial të pensioneve me shuma të caktuara;
- Rregullorja për licencimin e fondeve plotësuese pensionale të punëdhënësve;
- Rregullorja për menaxhuesit e mjeteve pensionale;
- Rregullorja për përfitimet pensionale nga pensionet plotësuese individuale;
- Rregullorja për themelimin e fondit plotësues pensional të punëdhënësit;
- Rregullorja për vlerën e kontributeve të pensionit.

Gjatë vitit 2020 është miratuar Rregullorja për mbajtjen e shënimeve në fondet pensionale dhe ofruesit e pensioneve.

Në fushën e *tregut financiar*, deri tani është zhvilluar tregu i borxhit të brendshëm, përmes emetimit të letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës, përmes platformës elektronike të tregtimit të letrave me vlerë. Ky aktivitet realizohet përmes organizimit të ankandeve të shpallura nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe menaxhimit të tyre nga ana e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Organizimi i ankandeve të letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës është i bazuar në sistemin e akterëve primarë (bankave komerciale), me ç'rast personat fizikë dhe juridikë mund të marrin pjesë në treg përmes akterëve primarë të cekur më lartë.

Emetimi i parë i letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës është realizuar me 17 janar 2012 ku është emetuar një instrument me maturitet 3 muaj dhe është vazhduar me emetime 6 dhe 12 mujore. Përveç bonove të thesarit emetohen edhe obligacione me afate maturimi 2, 3, 5, 7 dhe 10-vjeçare.

Tregu i letrave me vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës është i rregulluar me Ligjin 04/L-175 mbi Borxhin Publik, në fuqi nga nëntor i vitit 2009 dhe me aktet nën ligjore, Rregullorja MF-BQK nr. 01/2014 për tregun primar dhe sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë së Republikës së Kosovës të nxjerra në vitin 2012 (amendamentuar në vitin 2014).

Më 25 prill 2019, Bordi Ekzekutiv ka miratuar Rregulloren për Riblerje të Letrave me Vlerë të Qeverisë me BQK-në. Kjo rregullore ka përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet të përmbushen lidhur me huadhënien e mbështetur me kolateral të letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës, përmes sistemit depozitar qendror të letrave me vlerë (CSD) duke ekzekutuar një marrëveshje riblerjeje me Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Qëllimi i kësaj huadhënie është të ndihmojë bankat anëtare në menaxhimin efikas të likuiditetit të tyre në periudhën afatshkurtër.

Ndër qëllimet strategjike është edhe **sigurimi i sistemeve ndërbankare efikase dhe cilësore për transferim të fondeve dhe të letrave me vlerë**, që nënkupton avancimin e mëtejshëm të sistemit depozitar qendror të letrave me vlerë (*Central Securities Depository - CSD*), platformës elektronike për tregtim (*ETP*), si dhe angazhimin në themelimin e një sistemi bashkëkohor të tregut ndërbankar të parasë dhe tregut të kapitalit.

Korniza institucionale dhe ajo e politikave

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) është subjekt juridik publik bazuar në nenet 11 dhe 140 të Kushtetutës dhe të dispozitave të ligjit përkatës. BQK-ja është institucioni kyç pjesëmarrës dhe rregullativ

në sistemin financiar të Republikës së Kosovës dhe ka pavarësi dhe autonomi administrative, financiare dhe menaxhuese. Veprimtaria e BQK-së sigurohet nga organet e saj vendimmarrëse dhe personeli i saj.

Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) është institucion publik i pavarur i themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Aktivitetin e përgjithshëm të FKPK-së e rregullon Kuvendi i Kosovës, ndërsa e mbikëqyrë Banka Qendrore e Kosovës (BQK). FKPK është institucion i themeluar në dhjetor të vitit 2001 dhe ka filluar aktivitetin në gusht 2002 për të administruar dhe menaxhuar kontributet e obligueshme pensionale (dhe vullnetare) të të punësuarve në Kosovë.

Ligji nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale në Kosovë ia jep FKPK-së, përmes Bordit Drejtues, kompetencat dhe të drejtat e administruarit të besuar për fondet pensionale (Neni 5.1), dhe i përcakton atij të drejtat lidhur me fondet pensionale (Neni 5.2). FKPK e ka zyrën e saj kryesore dhe të vetme në Prishtinë, kurse shërbime për kontribuuesit dhe përfituesit e kursimeve për pension kryhen edhe në gjashtë qendrat e tjera të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) në: Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Ferizaj dhe Gjilan.

Byroja Kosovare e Sigurimit është themeluar me 07.09.2011 nga 10 kompanitë e sigurimit të licencuara për të operuar në Republikën e Kosovës, bazuar në Ligjin nr. 04/L-018 mbi Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia. Byroja Kosovare e Sigurimit është organizatë profesionale me cilësinë e personit juridik e themeluar për qëllime jofitimprurëse. Qeveria e Republikës së Kosovës e njeh statusin e Byrosë Nacionale të Sigurimit me të drejta të pakufizuara, në cilësi të byrosë paguese dhe byrosë trajtuese, që garanton përmbushjen e të gjitha detyrimeve nga sistemi i kartonit ndërkombëtar të sigurimit. Byroja financohet nga anëtarët e saj dhe veprimtaria e së cilës mbikëqyret nga Banka Qendrore e Kosovës. Në kuadër të Byrosë Kosovare të Sigurimit funksionon Fondi i Kompensimit, Sigurimi Kufitar, Qendra Informativ e Sigurimit dhe Kartoni i Gjellbër.

Mbështetja e donatorëve

BQK është duke u përkrahur nga projekti i Qeverisë së Norvegjisë, i cili ka për qëllim të mbështesë administratën publike të Kosovës në zbatimin e MSA-së dhe rritjen e gatishmërisë për anëtarësim në BE në disa kapituj përfshirë statistikat. Ky projekt do të forcojë kapacitetet institucionale të administratës publike të Kosovës, specifikisht në kapitullin Shërbimet Financiare përmes ofrimit të trajnimeve të specializuara për përmbajtjen e kërkesave dhe kërkesave që rrjedhin nga BE, transpozimin e akteve të acquis në legjislacionin kombëtar, si dhe në reformat e politikave përkatëse.

Objektivat prioritarë afatmesme

Prioritetet legjislative

Spektori bankar:

- Adaptimi i standardeve të Shtyllës së II dhe Shtyllës së III të Kornizës së Basel-it për Kapital;
- Adaptimi i kërkesave për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit dhe raportit të leverazhit bazuar në standardet e reja të njohura si Basel III;
- Adaptimi i kornizës raportuese të bankave sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe adaptimi i kornizës ligjore lidhur me klasifikimin dhe provizionimin e aseteve;
- Udhëzimet mbi raportimin e kapitalit dhe kërkesave të kapitalit;
- Udhëzimet mbi raportimin e ekspozimeve të peshuara me rrezik për rrezikun kreditor;
- Udhëzimet mbi raportimin e kërkesave të kapitalit për rrezikun e tregut.

Këto standarde janë pjesë e Direktivës 2013/36/BE dhe Rregullores (BE) nr. 575/2013 të BE-së, të njohura si CRD IV dhe CRR, pra pjesë e acquis të BE-së dhe janë paraparë të adaptohen për përafrimin e plotë të legjislacionit sa i përket fushës së mbikëqyrjes së bankave në kuadër të përmbushjes së plotë të kërkesave të parapara me MSA, përkatësisht nenit 96 dhe aneksit 6 të saj, sa u përket shërbimeve financiare.

Spektori i sigurimeve

- Përafrimi i mëtejshëm i rregulloreve të sigurimeve në Kosovë me Direktivat përkatëse Evropiane. Rregulloret ekzistuese do të nënshtrohet ndryshimeve/plotësim-ndryshimeve për ta zbatuar Ligjin për Sigurime.

Sektori i pensioneve:

- Korniza rregullative e BQK-së në fushën e pensioneve do të amendamentohet konform kërkesave të Ligjit për Fondet Pensionale dhe acquis të BE-së për fushën e pensioneve. Në këtë proces duhet të sigurohet integrimi gjinor, në përputhje me Ligjin për Barazi Gjinore.

Prioritetet zbatuese

Sektori bankar

- Trajnimi dhe kualifikimi i stafit të mbikëqyrjes së bankave në aplikimin e standardeve të Kornizës së Basel-it për Kapital dhe Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (IFRS), përfshirë asistencën teknike, në bashkëpunim me FMN-në në kuadër të FSSR.
- Analizimi dhe adaptimi i praktikave të mira të vendeve të BE-së për mbrojtjen e konsumatorit;
- Ngritja e kapaciteteve për administrimin e situatave emergjente në rast të krizave dhe zgjidhja e bankave me probleme.

Fondi i sigurimit të depozitave

- Avancimi i bashkëveprimit me partnerët e rrjetit të sigurisë, anëtarët dhe përforcimi i bashkëpunimit me partnerët në sektorin financiar;
- Rritja e vetëdijes publike përmes komunikimit të vazhdueshëm dhe efektiv;
- Avancimi i sistemit diferencial të premive dhe të raportimit nga bankat anëtare.

Sektori i sigurimeve

- Trajnimi dhe kualifikimi i stafit të mbikëqyrjes së sigurimeve në aplikimin e standardeve të Solvencës II;
- Fillimi i zbatimit të aftësisë paguese (Solvencia II).

Sektori i pensioneve

- Trajnimi dhe kualifikimi i stafit të mbikëqyrjes së pensioneve në aplikimin e standardeve dhe parimeve bazë të IOPS;
- Trajnimi i stafit në fushën e mbikëqyrjes së konsoliduar të pensioneve;
- Analizimi dhe adaptimi i praktikave më të mira të vendeve të BE-së në fushën e mbrojtjes së pjesëmarrësve dhe përfituesve në/nga fondet pensionale.

3.10. Kapitulli 10 i acquis-së: Shoqëria e informacionit dhe mediat

Ky kapitull mbulon komunikimet elektronike, shërbimet e shoqërisë së informacionit dhe politikat audiovizuale, në të cilat rregulloret evropiane promovojnë dhe inkurajojnë konkurrencën, zhvillimin dhe qasjen më të gjerë në shërbimet bashkëkohore dhe teknologjitë e reja, me theks të veçantë në interesat e shfrytëzuesve të fundit. Acquis në fushën e komunikimeve elektronike synon zbatimin e objektivave të specifikuar në "*Ligjin për komunikimet elektronike*", politikat e këtij sektori (Agjendën Digjitalë të Kosovës), si dhe kornizën rregullatore të BE-së për ofrimin e shërbimeve brezgjere, sigurinë e rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike, duke nxitur dhe mbrojtur konkurrencën efikase përmes zbatimit të mekanizmave adekuat, të cilët garantojnë mbrojtjen e konkurrencës, si dhe garantimin e shërbimeve të duhura e të përshtatshme në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Çështjet kryesore të cilat mbulohen në fushën e komunikimeve elektronike janë: ofrimi i shërbimeve brezgjere me shpejtësi sa më të madhe, në një afat sa më të shpejtë kohor, me siguri të lartë dhe me çmime të arsyeshme për konsumatorët, ofrimi i shërbimeve universale, planifikimi dhe vlerësimi i brezave frekuencor me rëndësi të posaçme ekonomike, si dhe siguria së rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike. Çështjet kryesore në fushën e shërbimeve për shoqëri të informacionit janë: siguria e informacionit, e-qeverisja, e-shëndetësia, e-nënshkrimi, e-tregtia dhe sektori publik. Çështjet kryesore në politikat audiovizuale janë: shërbimet mediale audiovizuale, shërbimet publike për radio emetim, mbrojtja e të miturve, trashëgimia filmike, dhe diversiteti kulturor.

Kërkesat e MSA-së

Dispozitat relevante të MSA-së janë pjesë e Kreut VIII. Neni 110, mbi bashkëpunimin në fushën e shoqërisë së informacionit, mbështet kryesisht përafrimin gradual të politikave dhe legjisllacionit të Kosovës me atë të BE-së. Objektivat globale janë: përgatitja e shoqërisë në tërësi për epokën digjitale dhe identifikimi i masave për të siguruar interoperabilitetin e rrjeteve dhe shërbimeve. Neni 109 rregullon bashkëpunimin dhe nxitjen e industrisë audiovizuale dhe përkrahjen e bashkëprodhimit në fushën e kinemasë dhe mediave audiovizuale, përfshirë programet dhe lehtësirat për trajnimin e gazetarëve e profesionistëve të industrisë së mediave audiovizuale. Ky nen gjithashtu adreson asistencën teknike për mediat publike dhe private të Kosovës me qëllim të forcimit të pavarësisë së tyre, profesionalizmin dhe lidhjeve me median evropiane, përafrimin e politikave mbi rregullimin e përmbajtjes së transmetimeve ndërkufitare me ato të BE-së, harmonizimin e legjisllacionit dhe përvetësimit të së drejtës së autorit si dhe fuqizimin e pavarësisë së autoriteteve rregullative. Neni 111 ka të bëjë me forcimin e bashkëpunimit në fushat e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, me objektivin përfundimtar të miratimit nga Kosova të legjisllacionit të BE-së në sektor pesë vite pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, duke i kushtuar vëmendje të veçantë sigurimit dhe forcimit të pavarësisë së autoriteteve rregullative.

Kërkesat nga mekanizmat të tjerë të aderimit në BE

Në kontekst të kërkesave të përgjithshme të dala nga *Raporti i KE-së për Kosovën - 2020* në fushën e komunikimeve elektronike, shoqërisë së informacionit dhe politikave audiovizuale, kërkohet që Kosova të vazhdojë përpjekjet për të përafruar dhe kompletuar kornizën ligjore në drejtim të harmonizimit me acquis-në e BE-së. Për më tepër, në kontekst të ngritjes së kapaciteteve profesionale dhe institucionale, rekomandohet që të forcohet pavarësia financiare dhe kapaciteti profesional i rregullatorëve të komunikimeve elektronike (ARKEP-it) dhe të medias (KPM-së). Gjithashtu, raporti vlerëson se Kosova nuk ka ecur përpara me procesin e kalimit nga televizioni analog në atë digjital. Raporti gjithashtu rekomandon që të rishikohet "*Ligji për Komisionin e Pavarur të Mediave*" me qëllim që të rritet disponueshmëria e të dhënave në sektorin audiovizual dhe për të zgjeruar kompetencat rregullatore, monitoruese dhe zbatuese të rregullatorit.

Ndër të e tjera, në fushën e komunikimeve elektronike dhe shoqërisë së informacionit, raporti vlerëson që Kosova duhet të bëjë më shumë përpjekje në zbatimin e kornizave dhe shërbimeve të qeverisjes elektronike si dhe të zbatoj kodin +383 tërësisht. Gjithashtu rekomandohet që Ekipi Reagues për Incidentet e Sigurisë Kompjuterike të plotësohet me personel të mjaftueshëm dhe të trajnuar.

Në fushën e politikave audio-vizuale, raporti vlerëson që KPM ka dështuar të bëjë ndonjë progres në procesin e digjitalizimit, edhe pse afati nga ITU ka qenë qershor i 2015. Rrjedhimisht, raporti kërkon që Kosova të përshpejtojë përpjekjet e saj dhe të sigurojë që kalimi nga sistemi analog në platformën digjitale të kryhet në transparencë të plotë dhe në përputhje me standardet e BE. Nga Kosova gjithashtu kërkohet që të gjitha ndryshimet që përfshinë Kodin e Etikës, të propozuar nga Komisioni i Pavarur për Media, të bëhen në përputhje me standardet e Këshillit të Evropës dhe standardet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në lidhje me lirinë e shprehjes.

Bazuar në kërkesat e dala nga *Nënkomiteti për Inovacion, Shoqëri të Informacionit dhe Politikë Sociale (2020)* në fushën e komunikimeve elektronike, shoqërisë së informacionit dhe politikave audiovizuale, është paraparë plotësimi i kornizës ligjore dhe asaj strategjike. Për më tepër, Qeveria e Kosovës duhet të sigurojë resurse adekuate buxhetore në fushën e shërbimeve të shoqërisë së informacionit, në veçanti për zbatimin e Strategjisë së Qeverisjes Elektronike dhe Strategjisë së Sigurisë Kibernetike. Gjithashtu, qeveria duhet të ndërmarr hapa për të transpozuar Direktivën eIDAS (për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besueshme për transaksionet elektronike). Në anën tjetër, raporti i KE-së vlerëson se Kosova duhet të ndërmarr hapat e nevojshëm për ta lidhur Kosovën në Rrjetin GEANT, duke filluar me një studim fizibiliteti. Sa i përket asistencës, KE e fton Kosovën të shfrytëzojë fondet e BE-së (30 mil. euro) për ndihmë teknike për projektet me brez të gjerë në kuadër të WBIF. Po ashtu, kërkohet nga Kosova që të siguroj sinergji mes politikave digjitale dhe të gjelbërta.

Për më tepër në fushën e politikave audio-vizuale, institucionet e Kosovës duhet të ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshëm që të zbatojnë kalimin e transmetimit nga sistemi analog në sistemin *digjital si dhe te*

lirojnë frekuencën e dividendës së parë digjitale. Rrjedhimisht, Qeveria e Kosovës duhet të miratojë strategjinë e kalimit të transmetimit digjital sa më shpejtë të jetë e mundur në mënyrë që Komisioni i Pavarur për Media të zbatoj ligjin dhe strategjinë për çështjen përkatëse.

Ndër të tjera, institucionet e Kosovës duhet të sigurojnë një model që siguron financimin e qëndrueshëm të RTK-së. Ndërkaq, në kontekst të forcimit të kapaciteteve profesionale, institucionet e Kosovës duhet të sigurojnë kapacitete dhe resurse adekuate për funksionin e KPM-së dhe ARKEP-it. Institucionet e Kosovës gjithashtu duhet të sigurojnë kapacitetet minimale për CERT-in (*Computer Emergency Response Team*) nacional, në përputhje me rekomandimet e ENISA-s.

Në anën tjetër, Kosova duhet të ndërmerr hapa konkret në drejtim të zbatimit të suksesshëm të Memorandumeve të Mirëkuptimit për 5G dhe interoperabilitetit në përputhje me praktikatat e BE-së, të nënshkruara në Samitin Dixhital të Tiranës.

Gjendja aktuale

Korniza legjislative dhe ajo e politikave

Komunikimet elektronike

Korniza legjislative në këtë fushë përbëhet nga këto akte kryesore normative:

- Ligji për komunikimet elektronike;
- Rregullorja për ndërtimin, instalimin, dhe mbikëqyrjen e infrastrukturës së komunikimeve elektronike;
- Rregullorja për mbledhjen e të dhënave për infrastrukturën e komunikimeve elektronike;
- Rregullore për çështjet teknike dhe operacionale të qasjes së rrjetit të komunikimeve elektronike në bitstream nr. Prot. 034/B/20 datë 07.07.2020;
- Rregullorja për për oferten referente për qasjen e hapur në lakun lokal dhe bitstream” 032/B/20 datë 07.07.2020;
- Rregullorja për qasjen e hapur në lakun lokal ose pjesë të tij 030/B/20 datë 07.07.2020;
- Rregullorja për shërbimin e interkoneksionit në rrjetat e komunikimeve elektronike nr. Prot. 028/B/20 datë 07.07.2020;
- Rregullorja për pagesat për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe Shërbimeve Postare nr. Prot. 025/B/20 datë 07.07.2020;
- Rregullorja për përdorimin e përbashkët të faciliteteve shoqëruese 113/B/19, datë 18 tetor 2019;
- Rregullorja për analizat e tregut 110/B/19, datë 18 tetor 2019;
- Rregullorja për brezat frekuencore të radio-frekuencave për të cilat nuk kërkohet autorizim individual për radio frekuenca 046/B/18, datë 03 gusht 2018;
- Rregullorja për shërbimet universale në komunikimet elektronike, datë 4 korrik 2018;
- Rregullorja për kontratat, transparencën dhe publikimin e informatave dhe masave të tjera mbrojtëse për përdoruesit fundorë për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike 022/B/18, datë 19 prill 2018;
- Rregullorja për autorizimet e përgjithshme 019/B/18, datë 16 prill 2018;
- Rregullorja për kualitetin e shërbimeve të komunikimeve elektronike, datë 16 prill 2018;
- Rregullorja mbi pagesat për mbikëqyrje dhe të drejtën e përdorimit të radio frekuencave 005/B/18, datë 19 janar 2018;
- Rregullorja për bartjen e numrave për para-paguesit e shërbimeve publike të komunikimeve elektronike 043/B/17, datë 26 qershor 2017;
- Rregullorja për planin kombëtar të numeracionit për rrjetet e komunikimeve elektronike të Republikës së Kosovës 038/B/17, datë 16 qershor 2017;
- Rregullorja për radio pajisje 032/B/17, datë 31 dhjetor 2017;
- Rregullorja mbi standardet teknike dhe organizative për sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike 046/B/16, datë 22 nëntor 2016;
- Rregullorja për ndarjen e llogarive 012/B/14, datë 01 prill 2014;

- Rregullorja për dhënien dhe shfrytëzimin e radio frekuencave 054/B/13, datë 31 dhjetor 2013;
- Rregullorja për analizat e tregut 110/B/19, datë 18 tetor 2019;
- Rregullorja për llogaritje të kostos sipas metodës së shpërndarjes së plotë të kostos (FDC) 043/B/12, datë 22 qershor 2012;
- Rregullorja për përdorimin e përbashkët të faciliteteve shoqëruese 113/B/19, datë 18 tetor 2019;
- Rregullorja për interkoneksionin 033/B/11, datë 3 qershor 2011;
- Rregullorja për bashkë-shfrytëzimin e plotë dhe të përbashkët të lakut dhe nën-lakut lokal 024/B/11, datë 18 prill 2011;
- Rregullorja për sigurimin e qasjes 012/B/11, datë 11 shkurt 2011.

Këto akte normative kanë transpozuar këto akte të acquis-së:

- Rregulloren nr. 2015/2120;
- Direktivën 2002/21/KE e amendamentuar nga Direktiva 2009/140/KE;
- Direktivën 2002/19/KE e amendamentuar nga Direktiva 2009/140/KE;
- Direktivën 2002/20/KE e amendamentuar nga Direktiva 2009/140/KE;
- Direktivën 2002/22/KE e amendamentuar nga Direktiva 2009/136/KE;
- Direktivën e Komisionit 2002/77/KE;
- Direktivën 2002/58/KE e amendamentuar nga Direktiva 2009/136/KE mbi përpunimin e të dhënave personale dhe mbrojtjen e privatësisë;
- Direktivën 2009/136/KE;
- Direktivën 2009/140/KE;
- Direktivën 1999/5/KE;
- Rekomandimin e KE-së 2003/311/KE;
- Rekomandimin e KE-së 2007/879/KE;
- Vendimin e KE-së për klasifikimin e radio pajisjeve dhe pajisjeve terminale 200/299/KE;
- Direktivën 2014/53/BE;
- Vendimin nr. 376/2002/KE;
- Vendimin ECC Dec. (08) 04);
- Vendimin ECC Dec. (06) 04);
- Rekomandimin 2014/710/BE;
- Rekomandimin e KE-së 98/322/KE;
- Rekomandimin e Komisionit Evropian 2005/698/KE; mbi ndarjen e llogarive dhe Sistemet e Llogaritjes së kostos sipas Kornizës Rregulatore për Komunikime Elektronike;
- Udhërrëfyesit e nxjerrë nga Agjencia Evropiane për Siguri të Rrjetit dhe Informacionit (ENISA);
- Komunikatën e Komisionit, të datës 26/08/2010, "Agjenda Digjitale për Evropën".

Korniza e politikave në këtë fushë përbëhet nga këto dokumente:

- Politikat e sektorit të komunikimeve elektronike-agjenda digjitale për Kosovën 2013–2020; dhe
- Atlasi elektronik për infrastrukturën telekomunikuese brezgjërë në Kosovë.

Shoqëria e informacionit

Korniza legislative në këtë fushë përbëhet nga këto akte kryesore normative:

- Ligji për shërbimet e shoqërisë informatike;
- Ligji për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik;
- Ligji për procedurën e përgjithshme administrative;
- Ligjin për organet Qeveritare për shoqërinë e informacionit; dhe
- Korniza e interoperabilitetit të Republikës së Kosovës.

Këto akte normative kanë transpozuar këto akte të acquis-së:

- Direktivën 1999/93/KE;
- Direktivën 2000/31/KE;
- Direktivën 2007/64/KE;

- Direktivën 2006/123/KE.

Korniza e politikave në këtë fushë përbëhet nga këto dokumente:

- Strategjia e Kosovës për teknologji informative, përfshirë planin e veprimit për periudhën 2016-2019;
- Strategjia shtetërore për sigurinë kibernetike dhe plani i veprimit 2016-2019.

Politikat audio-vizuale

Korniza legislative në këtë fushë përbëhet nga këto akte kryesore normative:

- Ligji për Komisionin e Pavarur të Mediave;
- Rregullorja për mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audio-vizuale;
- Rregullorja për të drejtën e autorit;
- Rregullorja për vlerësimin e aplikacioneve për licencë, kushtet dhe termet e përgjithshme për licencë;
- Rregullorja për shpërndarjen e ofruesve të shërbimeve mediale audio dhe audio-vizuale, forma e aplikacionit;
- Rregullorja për komunikimet komerciale audio-vizuale;
- Kodi i etikës për ofruesit e shërbimeve mediale audio dhe audio-vizuale;
- Rregullorja për operatorët e multipleksit në nivel shtetëror;
- Rregullorja për ofruesit e shërbimeve mediale audio dhe audio-vizuale;
- Rregullorja për tarifën vjetore për licencë;
- Rregullorja për bartjen e detyrueshme të ofrueseve të shërbimeve mediale në operatorin e multipleksit;
- Rregullorja për renditjen logjike të kanaleve;
- Rregullorja për mbështetjen e ofruesve të shërbimeve mediale audio dhe audio-vizuale me mbulim tokësor lokal dhe rajonal.

Këto akte normative kanë transpozuar Direktivën AVMSD 2010/13/BE.

Korniza institucionale

Komunikimet elektronike:

- Ministria e Ekonomisë;
- Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

Shoqëria e informacionit:

- Ministria e Ekonomisë;
- Ministria e Punëve të Brendshme, përkatësisht Agjencia për Shoqërinë e Informacionit.

Politikat audio-vizuale

- Komisioni i Pavarur i Mediave.

Mbështetja e donatorëve

Sa i përket mbështetjes dhe fondeve të siguruara nga donatorët e jashtëm për zbatimin e aktiviteteve të ndryshme në fushën e komunikimeve elektronike, janë siguruar fonde nga Banka Botërore, IPA, etj. ME në bashkëpunim me Bankën Botërore (BB) janë duke zbatuar Projektin KODE (*Kosovo Digital Economy*). Komponentët e KODE bazohen në projektet që do të zhvillojnë infrastrukturën ndërlidhëse brezgjere në viset e pambuluara, kapitalin njerëzor dhe bizneset digjitale për të futur Kosovën në ekonominë digjitale të së ardhmes. Ky projekt do të siguroj infrastrukturë me shpejtësi të lartë (broadband) dhe do të mbështesë qasjen në tregje të punës, burime të reja të njohurive dhe në shërbime publike për familjet dhe institucionet në zonat e përzgjedhura rurale të pazhvilluara. Kosova po bën të gjitha punët përgatitore për t'u lidhur me rrjetin pan-evropian hulumtim dhe edukativ - GEANT.

Në kuadër të Projektit KODE gjatë viteve 2019-2020 ka përfunduar zbatimi i 50 nën-projekteve *Shtrirja e infrastrukturës brezgjere në zonat e pambuluara*, të cilat përfshijnë rreth 150 fshatrat e fundit, dhe gjatë vitit

2021 edhe lidhja me infrastrukturë fikse brezgjere e pargjeve të pa-lidhura të rrjetit mobil. Me qëllim të realizimit të objektivave strategjike për zhvillimin e shoqërisë së informacionit (dhe Strategjisë së Kosovës për Teknologji Informativë) janë siguruar mbështetje dhe fonde nga donatorë të ndryshëm, si BB dhe BE. Projekti IPA 2017 *Mbështetja e BE-së për sektorin e TIK-ut për konkurrencën e Kosovës* (3 mil. euro) ka filluar zbatimin. Janë nënshkruar kontratat për furnizim me pajisje kompjuterike për 8 salla trajnimesh dhe me ofruesin e trajnimeve, si dhe kanë filluar aktivitetet trajnuese, të cilat do të zbatohen për një periudhë trevjeçare. Përfituesi kryesor i këtij veprimi është ME.

Objektivi i përgjithshëm i projektit është rritja e konkurrueshmërisë së bizneseve digjitale dhe tradicionale të Kosovës duke mbështetur rritjen e sektorit të TIK-ut të Kosovës që çon në rritjen dhe krijimin e vendeve të reja të punës. Objektivat specifike të projektit janë tejkalimi i hendekut në mes të shkathtësive digjitale dhe nevojave të biznesit në mënyrë të qëndrueshme, që plotëson nevojat e tregut dhe rrit konkurrueshmërinë e tyre, si dhe rrit eksportet e bizneseve kosovare duke shfrytëzuar potencialin e plotë të teknologjive digjitale. Ndërsa në kuadër të IPA 2019 do të bëhet sistemi për identifikimin dhe autentifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara në transaksionet elektronike. Projekti ka vlerën 4 mil euro, ka filluar së zbatuari dhe do të finalizohet deri në vitin 2023. Objektivi i përgjithshëm i këtij projekti është rritja e efikasitetit dhe produktivitetit të sektorit privat përmes rritjes së shfrytëzimit të TIK, krijimi i sigurisë së e-biznes/ e-tregtisë ekosistemit, dhe përmirësimi i shërbimeve elektronike për qytetarët dhe bizneset.

Projekti për Ekonominë digjitale të Kosovës – KODE që ME në bashkëpunim me BB janë duke e zhvilluar, përkatësisht Komponenti i dytë i KODE bazohen në projektet që do të zhvillojnë kapitalin njerëzor dhe bizneset digjitale për të futur Kosovën në ekonominë digjitale të së ardhmes, do të mbështesë qasjen në tregje të punës, etj. Në nivel kombëtar, projekti do të trajtojë dhe ndërlihdë të rinjtë me mundësitë e punësimit në internet; dhe do të përmirësoj qasjen në burime të njohurive, përfshirë mundësitë më të mira dhe bashkëpunimin, për institucionet e arsimit të lartë.

Objektivat prioritarë afatmesme

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA dhe mekanizmat e të tjerë të aderimit në BE në kuadër të fushëveprimit të kapitullit 10, fokusi gjatë periudhës 2021-2025 do të jetë në këto objektiva prioritarë afatmesme:

Komunikimet elektronike:

- Hartimi dhe miratimi i legjislacionit primar dhe sekondar në fushën e komunikimeve elektronike;
- Miratimi dhe fillimi i zbatimit të Strategjisë së re digjitale të Kosovës 2022-2030;
- Lidhja me infrastrukturë fikse brezgjere e pargjeve të palidhura të rrjeteve telekomunikuese mobile për të ju përshtatur teknologjive të gjeneratave të reja (5G ready), gjatë viteve 2021-2023;
- Zbatimi i Memorandumit të mirëkuptimit të nënshkruar me Republikën e Shqipërisë për korridorin 5G, si dhe Memorandumit të Mirëkuptimit me WB6 për zbatimin e rrjetave 5G për transformim digjital në Ballkanin Perëndimor, (2021-2023);
- Hapja e brezave frekuencore me vlerë të posaçme ekonomike për ofrimin e shërbimeve IMT;
- Nxitja e konkurrencës në tregun e komunikimeve elektronike brezgjere, për të ngritur efikasitetin e rregullimit të tregut dhe për të bërë përpjekje që të gjithë banorëve të Kosovës të u sigurohet qasje në internet me shpejtësi më të lartë;
- Krijimi i rrjetit kombëtar të Radio Monitorimit me ndihmën e të cilit do të mundësohet monitorimi 24/7 përmes Stacioneve monitoruese Fikse/nomadike dhe mobile.

Shoqëria e informacionit:

- Hartimi dhe zbatimi i legjislacionit primar dhe sekondar që do të bëjë transpozimin e NIS Direktivës së BE-së dhe Rregullores së BE-së eIDAS;
- Zbatimi i strategjisë së Kosovës për teknologji informative dhe rikrijimi i saj;
- Avancimi i platformës së interoperabilitetit, si dhe ndërlihdja shumicës së sistemeve elektronike ekzistuese përmes kësaj platforme;

- Krijimi i Portalit të shërbimeve “e-Kosova”, me qëllim të rritjes së numrit të shërbimeve elektronike për qytetarët dhe institucionet;
- Krijimi i qendrës së rimëkëmbjes në rastet e fatkeqësive (*Disaster Recovery Centre*).

Politikat audiovizuale:

- Plotësim-ndryshimi i ligjit për komisionin e pavarur të mediave;
- Hartimi i rregulloreve dhe pakove për e multipleks në nivel shtetëror dhe rajonal.

Megjithatë hartimi i planifikuar i këtyre rregulloreve, dhe i gjithë procesi i kalimit në transmetimin digjital është i varur nga miratimi i strategjisë për kalim në transmetim digjital tokësor nga ana e Qeverisë.

3.11. Kapitulli 11 i *acquis*-së: Bujqësia dhe zhvillimi rural

Kapitulli për bujqësi përfshin një numër të madh të rregullave të detyrueshme, shumica prej të cilave janë të zbatueshme në këtë fazë të zhvillimit. Zbatimi i duhur dhe efektiv i këtyre rregullave si dhe përforsimi dhe kontrolli më efikas nga një administratë publike janë thelbësore për funksionimin e Politikave të Përbashkëta Bujqësore Evropiane (PPBE). Për funksionimin e PPBE-ve kërkohet ngritja e menaxhimit dhe cilësisë së sistemeve të tilla siç janë Agjencia e Pagesave, Sistemi i Integruar i Kontrollit të Bujqësisë (SIK) si dhe kapacitetet për të zbatuar masat e zhvillimit rural.

Kapitulli 11 kërkon që shtetet anëtare duhet të jenë në gjendje të zbatojnë legjislacionin e BE-së për skemat mbështetëse direkte të fermës dhe të zbatojnë organizmin e përbashkët të tregut për produktet e ndryshme bujqësore.

Kërkesat e MSA-së

Sa u përket kërkesave të MSA lidhur me kornizën ligjore (përafrimin me legjislacionin e BE-së) detyrimi për kapitullin e 11 është nga neni 74 dhe 102 i MSA-s. Sipas nenit 102 të MSA-së, bashkëpunimi mes palëve do të zhvillohet në të gjitha fushat prioritare që lidhen me *Acquis*-në e BE-së. Këto fusha përfshijnë fushën e bujqësisë, skemat e cilësisë për produktet bujqësore dhe produktet ushqimore, sigurinë ushqimore, fushën e veterinarisë dhe fitosanitarisë. Sipas MSA-së, bashkëpunimi synon modernizimin dhe ristrukturimin e bujqësisë dhe sektorit agro-industrial në Kosovë, në veçanti për të arritur kushtet sanitare të BE-së. Për më tepër, bashkëpunimi gjithashtu synon përmirësimin e menaxhimit të ujit dhe të zhvillimit rural, menaxhimin e sektorit të pylltarisë në Kosovë dhe mbështetjen graduale në përafrimin e legjislacionit dhe praktikave të Kosovës me ato të BE-së.

Kërkesat nga mekanizmat e tjerë të aderimit në BE

Në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural, në Raportin e KE-së për Kosovën – 2020, thuhet se Kosova në përgjithësi ka progres të kufizuar, veçanërisht në zbatimin e programeve vjetore të zhvillimit agro-rural dhe vlerësimin e tij, ndërsa progresi në konsolidimin e tokës dhe mbrojtjen e tokës ishte i pamjaftueshëm. Meqenëse nuk janë kryer të gjitha rekomandimet e vitit 2020, në vitin e ardhshëm, Kosova në veçanti duhet:

- Të kryejë një vlerësim cilësor të efektivitetit të masave mbështetëse të parashikuara në programin e bujqësisë dhe zhvillimit rural;
- Të miratojë ligjin për organizimin e përbashkët të tregut;
- Të marrë masa urgjente, efektive për të ndaluar humbjen e tokës bujqësore dhe të zbatojë legjislacionin për planifikimin hapësinor;
- Të adresojë nivelin e ulët të financimit për zhvillimin rural;
- Të përfshijë masat “cross compliance” në kuadër të programit të bujqësisë;
- Të zhvillojë kapacitetet profesionale për vlerësim, monitorim dhe kontabilitet në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë;
- Të hartojë baza ligjore për krijimin dhe sigurimin e funksionimit të organizatave të tregut të përbashkët.

Në raport thuhet së është rritë buxheti për grante dhe subvencione, ndërsa është krijuar edhe sistemi i integruar i administrimit dhe kontrollit si dhe azhurnimi i identifikimit të parcelave të tokës dhe Rrjeti i të

Dhënave të Kontabilitetit në Ferma. Gjithashtu, përmirësimi i Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, duke i mbështetur fermerët e vegjël dhe Plani për Bujqësi Organike 2018-2020 konsiderohet progres. Për më tepër, si progres u raportua edhe krijimi i një skeme të veçantë të masave me qëllim të mbështetjes së katër komunave në veri të Kosovës si dhe krijimi i legjislacionit për indikatorët gjeografik.

Në raport, përmenden edhe disa sfida me të cilat përballlet sektori i bujqësisë, ku ndër të tjera thuhet se ka progres të kufizuar në zbatimin i programeve vjetore të zhvillimit agro-rural dhe vlerësimi i tij. Konsolidimi i tokës dhe mbrojtja e tokës mbetet sfida dhe është në nivel të pamjaftueshëm. Edhe mbizotërimi i fermave të vogla dhe tokës së punueshme e cila është e fragmentuar mbetën sfida. Sa i përket kapaciteteve njerëzore, në Raportin për Vendin, theksohet mungesa e kapaciteteve administrative për vlerësimin, monitorimin dhe kontabilitetin brenda Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor. Gjithashtu, potencohet se masat 'cross compliance' duhet të futen në kuadër të programit të bujqësisë.

Sa i përket krijimit e organizimit të tregjeve, KE konstaton se nuk është bërë ndonjë progres në lidhje me krijimin e organizimit të përbashkët të tregut. Në lidhje me këtë, Kosova duhet të bëjë hapa për të krijuar bazën ligjore për themelimin dhe funksionimin e tyre. Për më tepër duhet të krijohet sistemi për monitorimin dhe vlerësimin e granteve dhe subvencioneve.

Në raport, kërkohet azhurnimi i Programit për bujqësi, për të përmirësuar efikasitetin e investimeve në sektor. Sa i përket përafrimit të legjislacionit, theksohet se duhet të jetë në përputhje me legjislacionin e BE-së, sidomos në politikat e cilësisë së ushqimit. Ndërsa konsolidimi dhe mbrojtja e tokës është e pamjaftueshme, sepse nuk ka një plan veprimi dhe task forcë për mbrojtjen e tokës.

Detyrimet e tjera të Kosovës në raport me kërkesat e KE-s të dala nga Nënkomiteti për "Bujqësi dhe Peshkatarin" në sektorin e bujqësisë janë: miratimi i koncept dokumentit për tokat bujqësore, rregullimin e tokës bujqësore, realizimin e vlerësimit ex-post të ligjit për bujqësi organike, hartimit të programit për bujqësi dhe zhvillim rural 2021-2027, për masat e ndërmarrja kundër ndërtimit të paligjshëm në tokë bujqësore, formimi i trupit certifikues nga MBPZhR për regjistrimin e djathit të Sharrit si tregues gjeografik.

Sa i përket çështjeve horizontale, KE kërkon që të vazhdohet më harmonizimin e mëtejshëm të kornizës ligjore me acquis e BE-së, si dhe të vazhdohet më paisjen me inventar dhe me staf të të gjitha organeve të përfshira në menaxhimin e bujqësisë, sigurinë ushqimore dhe peshkatarinë sipas acquis së BE-së, përfshirë laboratorin referent fitosanitar.

Gjendja aktual

Korniza legjislative, e politikave dhe ajo institucionale

Zhvillimi rural

Korniza legjislative në këtë fushë përbëhet nga ligji për bujqësi dhe zhvillim rural, i cili ka transpozuar pjesërisht rregulloren e Këshillit (KE) nr. 73/2009 dhe rregulloren e Këshillit (KE) nr. 1217/2009. Sa i përket legjislacionit sekondar në fushën e sektorit të zhvillimit rural janë miratuar 12 UA.

Korniza e politikave në këtë fushë përbëhet nga këto dokumente:

- Programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2014-2020;
- Programi për Zhvillim Rural.

Korniza institucionale në Sektorin e Zhvillimit rural përbëhet nga Departamenti i Politikave të Zhvillimit Rural/Autoriteti Menaxhues.

Bujqësia

Korniza legjislative në këtë fushë përbëhet nga këto akte normative relevante:

- Ligji për regjistrimin e bujqësisë;
- Ligji për tokën bujqësore;
- Ligji për rregullimin e tokës;

- Ligji për ujitjen e tokave bujqësore;
- Ligji për mbrojtjen e varieteteve të bimëve;
- Ligji për farërat;
- Ligji për plehtrat artificiale;
- Ligji për bujqësi organike;
- Ligji për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e duhanit;
- Ligji për kooperativat bujqësore;
- Ligji për blegtorinë;
- Ligji për peshkatari dhe akuakulturë.

Sa i përket legjislacionit sekondar në sektorin e bujqësisë janë miratuar 22 UA.

Këto akte normative kanë transponuar pjesërisht këto akte të *acquis*-së:

- Rregulloren nr. 1166/2008 e Parlamentit Evropian;
- Direktivën e Këshillit nr. 157/2009/KE;
- Direktivën e Këshillit nr. 87/328/KEE;
- Direktivën e Këshillit nr. 88/661/KEE;
- Direktivën e Këshillit nr. 90/118/KEE;
- Direktivën e Këshillit nr. 90/119/KEE;
- Direktivën e Këshillit nr. 89/361/KEE;
- Direktivën e Këshillit nr. 90/427/KEE;
- Direktivën e Këshillit nr. 91/174/KEE;
- Direktivën e Këshillit nr. 94/28/KE;
- Direktivën e Këshillit Evropian (KE) nr. 2100/94;
- Direktivën Zbatuese të Komisionit nr. 97/2014/KE;
- Direktivën Zbatuese e Këshillit nr. 90/2008/KE;
- Direktivën e Këshillit nr. 66/402/KEE;
- Rregulloren e BE-së nr. 2003/2003 e Parlamentit Evropian;
- Rregulloren e BE-së (KE) nr. 834/2007;
- Rregulloren e BE-së (KE) nr. 889/2008;
- Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 834/2007 e datës 28 qershor 2007 mbi prodhimin organik dhe etiketimin e produkteve organike; dhe
- Rregulloren e Komisionit nr. 889/2008 e datës 5 shtator 2008 që përcakton rregullat e detajuara për zbatimin e Rregullores së Këshillit (KE) nr. 834/2007 për prodhimin organik dhe etiketimin e produkteve organike në lidhje me prodhimin organik, etiketimin dhe kontrollin.

Korniza e politikave në këtë fushë përbëhet nga këto dokumente:

- Plani për bujqësi dhe zhvillim rural 2014-2021;
- Programi për pagesa direkte 2018;
- Strategjia për konsolidimin e tokës 2010-2020;
- Strategjia për sektorin e hortikulturës 2009-2013;
- Raporti i gjelbër 2017;
- Plani i veprimit 2010-2020 për zbatimin e strategjisë;
- Plani i veprimit për bujqësi organike 2018-2021.

Sektorin e tokave: korniza institucionale në këtë sektor përbëhet nga Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregjeve.

Vreshtaria

Korniza ligjore në fushën e vreshtarisë përbëhet nga këto akte kryesore normative:

- Ligjit për verëra i amendamentuar me Ligjin nr. 04/L-019;

- UA për regjistrimin e vreshtave, deklaratën detyruese, dokumentet dhe evidencën e bodrumeve të verës.

Këto akte normative kanë transponuar pjesërisht këto akte të acquis-së:

- Rregulloren e Komisionit (KE) nr. 436/2009;
- Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 479/2008;
- Rregulloren e Komisionit (KE) nr. 555/2008;
- Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 479/2008;
- Rregulloren e Komisionit (KE) nr. 606/2009;
- Rregulloren e Komisionit (KE) nr. 607/2009;
- Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 491/2009;
- Rregulloren e Komisionit dhe Këshillit Evropian (BE) nr. 1308/2013.

Korniza e politikave në këtë fushë përbëhet nga strategjia për sektorin e vreshtarisë dhe vertarisë 2018-2022.

Korniza institucionale në fushën e vreshtarisë përbëhet nga Departamenti për verëtari dhe vreshtari dhe sektori i shërbimeve këshillimore.

Korniza ligjore në sektorin e shërbimeve këshillimore përbëhet nga ligji për shërbime këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural, i cili pjesërisht ka transpozuar Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 73/2009.

Sa i përket legjislacionit sekondar, në sektorin e shërbimeve këshillimore janë miratuar 9 UA.

Korniza e politikave në këtë fushë përbëhet nga strategjia e shërbimeve këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural 2015-2020.

Korniza institucionale në fushën e shërbimeve këshillimore përbëhet nga Departamenti i Shërbimeve Këshilluese dhe Teknike.

Agjencitë ekzekutive në kuadër të MBPZHR-së janë: Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë dhe Agjencia e Pyjeve të Kosovës.

Mbështetja e donatorëve

Në bujqësi, projektet kryesore në vitet e fundit kanë në shënjestër Programin Bujqësor dhe Rural të Zhvillimit / skemat e granteve rurale për të rritur konkurrencën e sektorit në përgjithësi.

Projektet që kanë filluar të zbatohen gjatë vitit 2020 janë nga programimi IPA-2015, "Skema e Grantit për Mbështetjen e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural 2015" në vlerë prej 8.8 milion euro, i cili ka filluar implementimin në shkurt 2020 dhe projekti "Ndërtimi i kapaciteteve për Kosovën në lidhje me Organizatën e Tregut të Përbashkët të BE-së (CMO) dhe Statistikat Bujqësore", vlera e kontratës 1, 476, 866.00 Euro. Objektivi i përgjithshëm i kësaj kontrate është për të siguruar qasje të përmirësuar dhe konkurrencë në tregjet e produkteve bujqësore. Me qëllim që të mbështesë përafrimin e Kosovës me standardet dhe praktikën e BE-së në lidhje me organizimin e përbashkët të tregjeve në produktet bujqësore, duke mbështetur Kosovën në zbatimin e një sistemi gjithëpërfshirës dhe të integruar të informacionit bujqësor. Si rezultat pritet hartimi i legjislacionit kombëtar primar dhe sekondar për organizimin e tregut të produkteve bujqësore të Kosovës, që të jenë në përputhje me rregullorët dhe praktikën përkatëse të BE-së, ngritje të kapaciteteve për zbatim të legjislacionit për CMO-në si dhe menaxhimi i Sistemit të Integruar të Informacionit Bujqësor në Kosovë.

Donatorët të cilët janë aktualisht aktivë në bujqësi dhe kanë sinergji me MBPZHR-në dhe AZhB-në janë Banka Botërore, përmes Projektit për Bujqësi dhe Zhvillimit Rural.

Projekti i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (PZHRB) në Kosovë synon të përmirësojë produktivitetin dhe qasjen në treg nga përfituesit e projektit në nën-sektorët e hortikulturës dhe blegtorisë, si dhe ndërtimin e kapaciteteve institucionale në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR). Projekti është i ndarë në 4 komponentë:

- Komponenti 1: Transferimi i njohurive tek sektori rural:
 - Nënkomponenti 1 (a): Kontratat e Shërbimit Këshillimor Rural (RAS);
 - Nënkomponenti 1 (b): Shkëmbimi rajonal i njohurive;
 - Nënkomponenti 1 (c): Fuqizimi Institucional i Shërbimeve Këshillimore Rurale;
- Komponenti 2: Rritja e investimeve për të promovuar zhvillimin e qëndrueshëm rural:
 - Nënkomponenti 2 (a): Programi i Grantit për Zhvillim Rural 8, 80 milion €;
 - Nënkomponenti 2 (b) (Aktivitet i Ri): Nxitja e Zhvillimit të Nënsektorit të Hortikulturës (3.0 milion \$);
 - Nënkomponenti 2 (c): Fuqizimi i Kapacitetit Institucional (0.78 milion €);
- Komponenti 3: Mbështetja për Ujitjen (Komponenti i Ri):
 - Nënkomponenti 3 (a): Rehabilitimi i Skemës Radoniqi;
 - Nënkomponenti 3 (b): Strategjia dhe Korniza e Investimeve për Sektorin e Ujitjes;
- Komponenti 4: Menaxhimi, koordinimi, monitorimi dhe vlerësimi i Projektit.

Për periudhën 2014-2020, gjithsej 14.5 milion euro janë investuar brenda projektit, nga të cilat 10.1 milion në dy programet e granteve. Gjatë kësaj periudhe, ndërhyrjet e ARDP-së kanë kontribuar në një total prej 4,910 përfituesish, përfshirë 332 në Programin e Granteve për Zhvillim Rural dhe 13 në Programin e Granteve për Zhvillimin e Hortikulturës. 3,381 fermerë në Kosovë morën pjesë në Trajnimet për aplikantët e mundshëm RDGP, ndërsa 545 këshilltarë publikë dhe privatë morën trajnim në fushën e shërbimeve teknike dhe shtrirjes. Mbi 172 fermerë dhe agro-përpunues kanë marrë pjesë në vizitat studimore në rajon dhe Evropë. Sa i përket përbërësit të ujitjes, punimet e rehabilitimit kanë filluar gjatë vitit 2020, ndërsa Master Plani për ujitje në Kosovë është finalizuar.

Programi i USAID-it për Zhvillimin Bujqësor dhe Zhvillimin Rural (AGRO) përqendrohet në rritjen e produktivitetit bujqësor, tregtueshmërinë dhe reagimin ndaj tregjeve dhe rritjen e qëndrueshmërisë dhe konkurrencës së agrobizneseve të synuara të Kosovës në tregjet e brendshme dhe të eksporteve.

USAID ofron mbështetje shtesë në formën e granteve dhe nënkontratave për të filluar ose zgjeruar aktivitete agrobiznesi që mund të lidhen me kërkesat e tregut të partnerëve strategjikë. Rezultatet e këtij projekti deri më tani përfshijnë 5,175 vende të reja të punës të krijuara (28% gra), 4,004 hektarë nën teknologji të reja dhe 147.6 milion dollarë gjithsej në shitjet në vend dhe eksporte.

GIZ-i gjerman, përmes projektit “Krijimi i Punësimit përmes Nxitjes së Eksportit (CETEP)” ndihmon në sigurimin e informacionit përkatës për ofruesit dhe ndërmarrjet e zhvillimit të biznesit, përmes hulumtimeve të tregut mbi kërkesat e tregut të BE-së. Ky projekt, ofron trajnime për ndërtimin e kapaciteteve për partnerët e saj dhe krijon lidhje ndërmjet kompanive kosovare dhe gjermane, përmes aktiviteteve të promovimit të eksportit siç janë: B2B, panaire, misione shitjeje, vizita studimore. Për më tepër, projekti krijon lidhje biznesi ndër-sektoriale me bizneset vendore dhe ndërkombëtare. Projekti gjithashtu mbështet zinxhirin e vlerës së manave, frutave dhe perimeve dhe përmes shpërndarjes së granteve në natyrë për fermerët në shkallë të vogël (260 përfitues). Projekti është angazhuar në rritjen e kapaciteteve prodhuese kushtuar eksportit dhe inovacionit përmes "Fondit të Inovacionit". Për më tepër, mbështet edhe MBPZhR-në dhe AZhB-në për të thithur Fondet IPA III.

Zhvillimi i qëndrueshëm i pyjeve private dhe të decentralizuara në Kosovë (SSPDF). Ky është një projekt katër-vjeçar i cili ka filluar në vitin 2014 në Kosovë i zbatuar nga OJQ “SNRP” (Menaxhimi qëndrueshëm i burimeve natyrore) me mbështetjen financiare të Bashkëpunimit Suedez për Zhvillim përmes SIDA-s. Objektivi kryesor i projekteve është përfshirja e komunave, AKP-së dhe përfituesve nga komuniteti lokal në procesin e përbashkët të menaxhimit të pyjeve (apo menaxhimin e pyjeve të decentralizuara); Përmirësimi i shërbimeve të ofruara për shoqatat e pronarëve të pyjeve privatë dhe asociacionit kombëtar të pronarëve të pyjeve privatë në rritjen e anëtarësisë dhe në menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve private dhe rritja e aplikimeve të praktikave të mira dhe qasjeve inovative për prodhimin e biomasës së drurit. Rezultatet e arritura nga projekti janë: numër i madh i trajnimeve të familjeve nëpër fshatra për procesin e menaxhimit të përbashkët të pyjeve. Janë ofruar shërbime dhe trajnime për anëtarët e shoqatës së asociacionit për ngritje të kapaciteteve në matje pyjore, planet e menaxhimit të pyjeve, punime

silvikulturore (rrallime, pastrime, pyllëzime) mbrojtje nga zjarret, përdorimi i sharrës dhe masat mbrojtëse, edukimi në pylltari, kultivimi i arrorëve, drunjet me rritje të shpejtë, biomasa të drurit si dhe fushata ndërgjegjësuere dhe informuese për ndryshimet klimatike mbrojtjen e mjedisit dhe biodiversitetin. Rezultat tjetër është së gratë dhe të rinjtë janë informuar dhe trajnuar në zinxhirin e vlerave të produkteve pyjore jodrusore dhe bimëve mjekësore aromatike duke formuar grupe prodhuese të grave dhe të rinjve në kuadër të 12 shoqatave lokale.

Programi i FAO-s mbështet fuqizimin e menaxhimit të qëndrueshëm dhe shumëqëllimor të pyjeve për të përmirësuar jetesën në vendet rurale dhe adresuar ndryshimin klimatik në Kosovë 2019-2023. Ky program do të mbështesë agjendën zhvillimore të Kosovës siç përshkruhet në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021, dhe në veçanti përpjekjet e Kosovës për të përmirësuar menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve, si burim i rëndësishëm për territorin. Rezultatet dhe aktivitetet e programit përputhen me rregullat e reja ekzistuese dhe të propozuara të Kosovës që qeverisin me pylltarinë, strategjinë e Bashkimit Evropian për pyje, instrumentin e Para-anëtarësimit në BE, dokumentin e strategjisë dhe politikave 2010-2020 (DSP) për zhvillimin e sektorit të pyjeve, si dhe politikat pyjore të Kosovës në zhvillim e sipër. Buxheti i përgjithshëm është 5.3 dollarë amerikanë. Në planin afatgjatë programi sjell ligjshmërinë dhe praktikën e menaxhimit të qëndrueshëm, duke siguruar një gjendje që mundëson një menaxhim pyjor të qëndrueshëm dhe me pjesëmarrje i cili edhe shprijnë në zhvillimin e praktikave tjera gjithëpërfshirëse të zinxhirit të vlerave. Programi do të adresojë këto probleme përmes tri komponentëve të ndryshme, por të cilët plotësojnë njëri-tjetrin.

- Komponenti 1: Krijimi i kushteve që mundësojnë përmirësimin e ligjshmërisë, tregtisë dhe zbatimit të ligjit në sektorin pyjor;
- Komponenti 2: Rritja e transparencës dhe fuqizimi i kapacitetit institucional në qeverisje të mirë dhe zbatim të politikave, strategjive dhe programeve pyjore;
- Komponenti 3: Prezantimi i menaxhimit pyjor shumë-qëllimor dhe zinxhirëve gjithëpërfshirës të vlerave pyjore për zbutjen e varfërisë së burrave dhe grave nga zonat rurale.

Rezultati i programit është që pyjet kosovare në rajonet e synuara të menaxhohen në mënyrë më efektive me qasje shumë-qëllimore, pjesëmarrëse, të fuqizuara në përputhje me rregullat përkatëse që kanë të bëjnë me sektorin pyjor dhe që mbështeten me zinxhirë vlerash të përgjegjshëm klimatik dhe gjinor për zbutjen e varfërisë.

Objektivat prioritarë afatmesme

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA dhe dokumentet e mekanizmat e të tjerë të aderimit në BE, në kuadër të fushëveprimit të kapitullit 11, fokusi gjatë periudhës 2021-2025 do të jetë në këto objektiva prioritarë afatmesme:

- Rritja e zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit të bujqësisë dhe sigurimi i nivelit të duhur të të ardhurave të prodhuesve bujqësorë, si dhe prodhimi i qëndrueshëm i ushqimit cilësor dhe mbrojtja e mjedisit;
- Rritja e aftësisë konkurruese në bujqësi, veçanërisht në sektorin agro-ushqimor, promovimi i zhvillimit dhe mundësive të punësimit, si dhe përmirësimi i cilësisë së jetesës në zonat rurale;
- Rritja e potencialit prodhues të fermave që mundëson rritjen e prodhimit vendor dhe uljen e importit të produkteve bujqësore;
- Investime në modernizimin e sistemit të ujitjes dhe zgjerimin e sistemeve ekzistuese në nivel të fermës dhe aktivitete të tjera që parashihen në kornizën e zbatimit të PBZHR-së;
- Mbrojtja dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i tokës bujqësore;
- Hartimi dhe miratimi i politikave zhvillimore për bujqësi dhe zhvillim rural;
- Ngritja e kapaciteteve për zbatim të legjislacionit për Organizimin e Tregut të Përbashkët (CMO) si dhe menaxhimi i Sistemit të Integruar të Informacionit Bujqësor në Kosovë.

3.12. Kapitulli 12 i acquis-së: Politikat e sigurisë së ushqimit, veterinarisë dhe ato të fitosanitarisë

Qasja e integruar e BE-së në sigurinë e ushqimit ka për qëllim sigurimin e një niveli të lartë të sigurisë së ushqimit, shëndetit të kafshëve, mirëqenies së kafshëve dhe shëndetit të bimëve brenda BE-së nëpërmjet masave koherente fermë-deri-në-tryezë dhe monitorimit të duhur, duke siguruar funksionimin efektiv të tregut të brendshëm.

Kapitulli i 12-të mbulon rregullat e detajuara në fushën e sigurisë së ushqimit. Politikat e përgjithshme të gjërave ushqimore vendosin rregullat e higjienës për prodhimin e ushqimit. Për më tepër, acquis ofron rregulla të detajuara në fushën e veterinarisë, të cilat janë kyçe për mbrojtjen e shëndetit të kafshëve, mirëqenien e kafshëve dhe sigurinë e ushqimit me origjinë shtazore në tregun e brendshëm. Në fushën e fitosanitarisë, rregullat e BE-së mbulojnë çështje si cilësia e farës, materiali për mbrojtjen e bimëve, organizmat e dëmshëm dhe ushqyeshmëria e kafshëve.

Kërkesat e MSA-së

Detyrimi për të përafuar legjislacionin e Kosovës në Kapitullin 12 me atë të BE-së buron nga nenet 74 dhe 102 të MSA-së. Neni 102 i MSA-së parasheh këtë bashkëpunim i cili duhet të zhvillohet në mes të Palëve në të gjitha fushat prioritare që lidhen me legjislacionin e BE-së në fushën e bujqësisë, si dhe në skemat e cilësisë për produktet bujqësore dhe produkteve ushqimore, sigurinë ushqimore, fushën veterinarë dhe fitosanitare. Bashkëpunimi veçanërisht do të synojë modernizimin dhe ristrukturimin e bujqësisë dhe sektorit agro-industrial në Kosovë, në veçanti për të arritur kushtet sanitare të BE-së, për të përmirësuar menaxhimin e ujit dhe të zhvillimit rural, si dhe për të zhvilluar aspektet e lidhura të sektorit të pylltarisë në Kosovë dhe mbështetjen e përafritit gradual të legjislacionit dhe praktikave të Kosovës me acquis të BE.

Kërkesat nga mekanizmat e tjerë të aderimit në BE

Përveç detyrimeve të MSA-së, Kosova gjithashtu duhet të përmbushë kërkesat e dala nga *Raporti i KE-së për Kosovën – 2020* dhe nga *takimi i Nënkomitetit për Bujqësi dhe Peshkatari*, i 14 majit 2020 dhe 20 maj 2021. Këto dokumente vënë në pah disa nga fushat kryesore të Kosovës për përmirësim, siç janë: sigurimi i një sistemi të integruar të kontrollit të ushqimit, përfshirë transferimin e inspektorëve komunalë në AUV; vazhdimi i përafritit të bazës ligjore me Acquis të BE-së; përmirësimi i infrastrukturës në pikat e inspektimit veterinar kufitar e sigurimi i objekteve karantinore për kafshë të gjalla; sigurimi i fondeve e kapaciteteve të mjaftueshme për zbatimin e plotë të programit shumëvjeçar për kontrollin e mbikëqyrjen e sëmundjeve të kafshëve; ngritja e kapaciteteve të AUV-it për reagime emergjente gjatë shpërthimeve të sëmundjeve; sigurimi i një sistemi adekuat për grumbullimin e nënprodukteve shtazore; miratimi i masave për të zbatuar legjislacionin mbi identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve në nivel të tregjeve të kafshëve, thertoreve dhe transportit të kafshëve; intensifikimi i përpjekjeve drejt përfshirjes së masave 'cross-compliance' për fushën e sigurisë së ushqimit dhe shëndetit e mirëqenies së kafshëve në kuadër të programit të bujqësisë; përmirësimi i zbatimit dhe kapacitetet operative të institucioneve përgjegjëse për shëndetin e bimëve; miratimi i ligjit për pijet e forta alkoolike, miratimi i UA-ve për përcaktimin e rregullave shëndetësore për nën-produktet shtazore, që transponojnë Rregulloret e BE-së 1069/2009 dhe 142/2011, miratimi i një plani apo strategjisë për avancimin e ndërmarrjeve agro-ushqimore, fuqizimi i mekanizmave të bashkëpunimit me Serbinë në luftën kundër tregtisë ilegale me kafshë të gjalla dhe produkte bujqësore e ushqimore.

Gjendja aktuale

Korniza legjislative, e politikave dhe ajo institucionale

Siguria e ushqimit

Korniza legjislative në këtë fushë përbëhet nga këto akte kryesore normative:

- Ligji për ushqimin;
- Ligji për pasurimin e miellit;
- Ligji për inspektoratin sanitar të Kosovës;

- Ligji për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse;
- Ligji për kontrollin e duhanit;

Aktet normative në fushën e sigurisë ushqimore kanë transponuar këto akte të *acquis*-së:

- Rregulloren nr. 178/2002 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian;
- Rregulloren nr. 882/2004 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian;
- Rregulloren nr. 852/2004 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian;
- Rregulloren nr. 853/2004 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian;
- Rregulloren nr. 854/2004 të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit Evropian;
- Rregulloren nr. 2073/2005 të Komisionit Evropian;
- Rregulloren nr. 1169/2011 të Parlamentit dhe e Këshillit Evropian;
- Rregulloren nr. 1331/2008 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian;
- Rregulloren nr. 1332/2008 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian;
- Rregulloren nr. 1333/2008 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian;
- Rregulloren nr. 1334/2008 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian;
- Rregulloren nr. 1881/2006 të Komisionit Evropian;
- Rregulloren nr. 333/2007 të Komisionit Evropian;
- Rregulloren nr. 183/2005 të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian.

Korniza e politikave në këtë fushë përbëhet edhe nga Plani Vjetor Kombëtar i Kontrollleve dhe Mostrimit.

Korniza institucionale në këtë fushë përbëhet nga këto institucione:

- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
- Ministria e Shëndetësisë;
- Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë;
- Komunat (Inspektoratet komunale).

Veterinaria

Korniza legislative në këtë fushë përbëhet nga këto akte kryesore normative:

- Ligji për veterinarinë;
- Ligji për përkujdesjen ndaj kafshëve;
- Ligji për ushqimin;
- Ligji për bletari.

Korniza ligjore në fushën e veterinarisë ka transponuar pjesërisht këto akte të *acquis*-së:

- Rregulloren nr. 1760/2000 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit që shfuqizon Rregulloren e Këshillit nr. 820/97;
- Rregulloren nr. 494/98 që përcakton rregullat e detajuara për zbatimin e Rregullosës së Këshillit nr. 820/97;
- Rregulloren nr. 911/2004 që zbaton Rregulloren (KE) nr. 1760/2000 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit;
- Rregulloren nr. 21/2004 që ndryshon Rregulloren (KE) nr. 1782/2003 dhe Direktivën 92/102/KEE dhe 64/432/KEE; dhe Direktivën 2008/71/KE;
- Rregulloren e Komisionit (KE) nr. 1251/2008 që zbaton Direktivën e Këshillit 2006/88/KE;
- Direktivën e Këshillit 2003/85/KE që shfuqizon Direktivën 85/511/KEE dhe Vendimet 89/531/KEE dhe 91/665/KEE dhe ndryshimin e Direktivës 92/46/KE 2004/07;
- Direktivën e Këshillit 2005/94/KE që shfuqizon Direktivën 92/40/KEE;
- Rregulloren e Këshillit nr. 1/2005 dhe që ndryshon Direktivat 64/432/KEE dhe 93/119/KE dhe Rregulloren nr. 1255/97;
- Direktivën e Këshillit 93/119/KE;

- Direktivën e Këshillit 2008/119/KE;
- Direktivën e Këshillit 98/58/KE;
- Direktivën e Këshillit 2008/120/KE;
- Rregulloren nr. 1881/2006 të Komisionit, siç ndryshohet me Rregulloren e Komisionit nr. 1126/2007 dhe Rregulloren nr. 565/2008;
- Direktivën e Këshillit 96/23/KE që shfuqizon Direktivat 85/358/KEE dhe 86/469/KEE dhe Vendimet 89/187/KEE dhe 91/664/KEE, Vendimin e Komisionit 97/747/KE, i bazuar në Direktivën e Këshillit 96/23/KE dhe Vendimi i Komisionit 98/179/KE;
- Direktivën 91/496/KEE;
- Direktivën 97/78/KE;
- Rregulloren e Komisionit nr. 605/2010.

Korniza e politikave në këtë fushë përbëhet edhe nga “Plani vjetor kombëtar i kontrolleve zyrtare”.

Korniza institucionale në fushën e veterinarisë përbëhet nga këto institucione:

- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë;
- Komunat (Inspektoratet komunale);
- Oda Veterinare e Kosovës;
- Doganat;
- Policia e Kosovës.

Korniza legjislativë dhe e politikave në fushën e fitosanitarisë

Korniza ligjore në fushën e fitosanitarisë përbëhet nga këto akte kryesore normative:

- Ligji për inspektoratin bujqësor;
- Ligji për mbrojtjen e bimëve;
- Ligji për produktet për mbrojtjen e bimëve;
- Ligji për ushqimin;
- Ligji për materialin fidanor;
- Ligji për farërat e Kosovës;
- Ligji për plehurat;
- Ligji për plotësim-ndryshimin e ligjit për verërat;
- Ligji për mbrojtjen e varieteteve të bimëve.

Aktet normative në fushën e fitosanitarisë kanë transponuar pjesërisht këto akte të acquis-së:

- Direktivën 2000/29/KE;
- Direktivën e Këshillit 91/414/KEE;
- Rregulloren e Parlamentit dhe Këshillit Evropian nr. 1107/2009, e cila shfuqizon Direktivën e Këshillit nr. 79/117/KEE dhe Direktivën nr. 91/414/KEE;
- Rregulloren e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit nr. 1272/2008, e cila shfuqizon Direktivën nr. 67/548/KEE dhe 1999/45/KE;
- Rregulloren e KE nr. 1907/2006;
- Rregulloren e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit Evropian nr. 396/2005 për ndryshimin e Direktivës së Këshillit 91/414/KEE;
- Rregulloren nr. 178/2002 e Parlamentit Evropian;
- Direktivën nr. 2008/72/KE;
- Rregulloren e Komisionit (KE) nr. 436/2009 që përcakton rregulla të hollësishme për zbatimin e Rregullores së Këshillit (KE) nr. 479/2008;
- Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 479/2008;
- Rregulloren e Komisionit (KE) nr. 555/2008 që përcakton rregullat e hollësishme për zbatimin e Rregullores së Këshillit (KE) nr. 479/2008;

- Rregulloren e Komisionit (KE) nr. 606/2009 që përcakton rregulla të caktuara të detajuara për zbatimin e Rregullores së Këshillit (KE) nr. 479/2008;
- Rregulloren e Komisionit (KE) nr. 607/2009 që përcakton rregulla të detajuara specifike për zbatimin e Rregullores së Këshillit (KE) nr. 479/2008;
- Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 491/2009 për ndryshimin e Rregullores (KE) nr. 1234/2007;
- Rregulloren e Komisionit dhe Këshillit Evropian (BE) nr. 1308/2013 për themelimin e organizatës së përbashkët të tregjeve për produktet bujqësore dhe shfuqizimin e Rregulloreve të Këshillit nr. 922/72; nr. 234/79; nr. 1037/2001; Nr. 1234/2007;
- Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 2100/94; dhe
- Direktivën Zbatuese të Komisionit 2014/97/BE që zbaton Direktivën e Këshillit 2008/90/KE.

Korniza institucionale në fushën e fitosanitarisë përbëhet nga këto institucione:

- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë;
- Komunitat (Inspektoratet komunale);
- Doganat;
- Policia e Kosovës.

Mbështetja e donatorëve

Në kuadër të IPA 2015, AUV përfiton përmes projektit:

- Mbështetje për Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë në zhvillimin e kapaciteteve për të zbatuar sistemin e integruar të sigurisë së ushqimit, përfshirë përmirësimin dhe funksionalizimin e sistemit të teknologjisë informative.

Në kuadër të IPA 2017, projektet që mbështesin Agjencinë janë:

- Përmirësimi i infrastrukturës së laboratorit dhe zyrave rajonale;
- Krijimi dhe zbatimi i një sistemi transparent për mbikëqyrjen e sëmundjeve dhe programet e kontrollit;
- Përgatitja e një Dokumenti gjithëpërfshirës për transponimin dhe zbatimin e acquis të BE-së në kapitullin 12 - Siguria e Ushqimit, Politikat Veterinare dhe Fitosanitare.

Mbështetja pritet të vazhdojë edhe në kuadër të IPA 2021 me një projekt që synon të mbështesë laboratorët fitosanitarë të MBPZHR-së për të forcuar kapacitetet e tyre teknike dhe organizative.

Gjithashtu, nga projekti i financuar nga Qeveria e Luksemburgut së bashku me ambasadën Norvegjeze: "Fondi për zhvillimin e kapaciteteve njerëzore për MSA, " AUV është përfituese e një projekti me katër (4) objektiva në ngritjen e kapaciteteve njerëzore, ku gjatë vitit 2020 janë përmbushur dy (2) prej tyre, përkatësisht: mbajtja e Trajnimit mbi lëvizjen, shëndetin dhe tregjet e kafshëve dhe Asistenca Teknike në hartimin e UA-së për implementimin e UA-së mbi përcaktimin e rregullave shëndetësore për nënproduktet e kafshëve dhe derivatet e tyre, të cilat nuk janë të destinuar për konsum njerëzor, që transponon Rregulloren (KE) nr. 142/2011. Trajnimi i Trajnerëve për inspektorët veterinarë mbi grumbullimin dhe kategorizimin e nënprodukteve shtazore.

Objektivat prioritarë afatmesme

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA dhe dokumentet e mekanizmat tjerë të aderimit në BE në kuadër të fushëveprimit të kapitullit 12, fokusi gjatë periudhës 2022–2025 do të jetë në këto objektiva prioritarë afatmesme:

- Plotësimi i kornizës ligjore që rregullon sigurinë e ushqimit, shëndetin e kafshëve dhe bimëve, duke transponuar pjesërisht legjislationin e BE-së, si: Rregulloren 2016/429 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit; Direktivën e Këshillit 66/402/KEE; Direktivën e Këshillit 66/401/KEE; Direktivën e Këshillit 2002/53/KE; Direktivën e Këshillit 2002/54/KE; Direktivën e Këshillit 2002/55/KE; Direktivën e Këshillit 2002/56/KE; Direktivën e Këshillit 2002/57/KE; Direktivën e Këshillit 68/193/KEE; Direktivën e Këshillit 1998/56/KE; Rregulloren 2016/2031 të Parlamentit

dhe Këshillit Evropian; Rregulloren e Këshillit (KEE) 2075/92; Rregulloren e Këshillit 1636/98 për ndryshimin e Rregullores 2075/92; Direktivën (KE) 2001/37; Direktivën 2009/54/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit; Rregulloren nr. 998/2003 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit; Rregulloren e Komisionit nr. 1082/2003; Direktivën e Këshillit 88/166/KEE; Direktivën e Këshillit 98/58 EC; Direktivën 2002/46/KE; Direktivën e Këshillit 89/108/KEE; Direktivën 2009/54/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit; Rregulloren (KE) nr. 258/97; Rregulloren nr. 2003/2003 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit; Rregulloren e (KE) nr. 1107/2009 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit dhe shfuqizon Direktivat e Këshillit 79/117/KEE dhe 91/414/KEE; Direktivën e Këshillit 66/402/KEE; Rregulloren nr. 396/2005/KE; Rregulloren nr. 92/70/KEE; Direktivën 2000/29/KE; Direktivën 2100/94; Direktivën 2014/97/BE; Direktivën 2008/90/KE; Rregulloren e KE 1107/2009; Rregulloren e Këshillit 834/2007; Rregulloren e KE 889/2008.

- Hartimi i planit kombëtar shumëvjeçar për kontrolle;
- Transferimi i inspektorëve veterinarë dhe fitosanitarë nga niveli komunal në atë qendror;
- Avancimi i mëtejme i bazës së të dhënave për identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve;
- Përmirësimi i infrastrukturës në pikat inspektuese veterinarë kufitare dhe sigurimi i objekteve karantinore për kafshët e gjalla;
- Ngritja e mëtejme e kapaciteteve për reagime emergjente në raste të shpërthimit të sëmundjeve;
- Përfshirja e masave 'cross-compliance' për fushën e sigurisë së ushqimit dhe shëndetit e mirëqenies së kafshëve në kuadër të programit të bujqësisë;
- Ngritja e kapaciteteve operative të institucioneve përgjegjëse për shëndetin e bimëve drejt sigurimit të një sistemi efektiv të kontrollit dhe sëmundjeve të bimëve;
- Vazhdimi i fuqizimit të mekanizmave të bashkëpunimit me homologët serbë në luftën kundër tregtisë së paligjshme të kafshëve të gjalla dhe produkteve bujqësore e ushqimore.
- Plani për avancimin e ndërmarrjeve agro-ushqimore.

3.13. Kapitulli 13i acquis-së: Peshkataria

Kapitulli 13 i siguron rregulla për ruajtjen e burimeve ujore të gjalla dhe menaxhimin e kapacitetit të flotës; kontrollin dhe zbatimin; veprime strukturore për operatorët në këtë sektor; zbatimin e standardeve të përbashkëta të marketingut dhe organizimin e përbashkët të tregut në peshkimin dhe përfshirjen e organizatave të prodhuesve në zbatimin e këtyre rregullave. Përderisa është shumë e rëndësishme në identifikimin e këtyre rregullave, theksi i kushtohet vlerësimit të rezervave ekzistuese të peshkut dhe mbledhjes së të dhënave të besueshme për sektorin e peshkimit. Zbatimi i legjislacionit dhe politikave kërkon përfshirjen e masave për të përgatitur administratën dhe operatorët për pjesëmarrje në politikën e përbashkët të peshkimit dhe për të fituar përvojë në zbatimin legjislacionit dhe politikave të peshkatarisë.

Duhet të theksohet se ndryshimet e fundit legjislative në këtë kapitull vendosin rregulla të hollësishme dhe strikte që duhet të zbatohen në mënyrë efektive jo vetëm nga vendet anëtare, por edhe nga vendet e treta që eksportojnë në BE. Kjo nënkupton ndërmarrjen e veprimeve për të përgatitur administratën dhe operatorët për pjesëmarrje në politikën e peshkimit të përbashkët, e cila mbulon politika të tregut, të burimeve dhe menaxhimin e stokut kombëtar, inspektimin dhe kontrollin, veprimet strukturore dhe kontrollin e ndihmës shtetërore. Në disa raste, marrëveshjet ekzistuese të peshkimit dhe konventat me vendet e treta ose organizata ndërkombëtare duhet të përshtaten.

Sipas nenit 103 të MSA-së, palët do të shqyrtojnë mundësinë e identifikimit të fushave me përfitim të ndërsjellë dhe interes të përbashkët në akuakulturë dhe në sektorët e peshkatarisë. Bashkëpunimi do të marrë në konsideratë fushat prioritare që lidhen më acquis të BE-së në këto fusha, dhe parimet e menaxhimit dhe ruajtjen e burimeve të peshkatarisë bazuar në rregullat e zhvilluara nga organizatat relevante ndërkombëtare dhe rajonale të peshkatarisë.

Sa i përket sektorit të peshkatarisë, në Raportin e KE-së për Kosovën – 2020, thuhet se Kosova duhet të filloj zhvillimin e një koncepti të politikës dhe zhvillimit të peshkimit, gjë që KE ofron edhe mbështetje me ekspertizë në këtë drejtim. Sa i përket inventarizimit të peshkut në lumenjtë e Kosovës, KE kërkon që të

fillohet në pellgje të vogla, për shkak të mungesës së kapaciteteve për të krijuar një inventarizim të peshkut në nivelin kombëtar.

Në kuadër të konkluzioneve të dala nga takimet e Nënkomitetit për “Bujqësi dhe Peshkari” të mbajtura me 14 maj 2020 dhe 20 maj 2021, sa i përket sektorit të peshkatarisë, KE thekson se Kosova është ende në një fazë të hershme të përgatitjes në fushën e peshkimit dhe detyrohet të harmonizojë më tej politikën e saj të tregut me *acquis*, të krijoj një inventar të specieve të peshkut në një zonë pilot, si dhe të shfrytëzoj TAIEX për avancimin e legjislacionit dhe politikave të peshkimit.

Nga KE, kërkohet që të bëhet harmonizimi i politikave të këtij sektori me *acquis*, ngritja dhe përforsimi i kapaciteteve administrative për menaxhimin, inspektimin dhe kontrollin e politikave të peshkatarisë si dhe të bëhet inventarizimi i peshqve. Subvencionet për prodhuesit e regjistruar janë të kufizuara dhe nuk pasqyrojnë as potencialin për vende pune dhe eksport, e as vlerën e tregut të sektorit thekson KE.

Korniza legjislative në fushën e peshkatarisë përbëhet nga këto akte kryesore normative:

- Ligji për peshkari dhe akuakulturë (nuk është i përafuar me legjislacion të BE-së);
- UA për peshkim sportiv-rekreativ dhe pajisjet për peshkim sportiv-rekreativ;
- UA për licencimin e aktiviteteve në akuakulturë;
- UA për përcaktimin e rajoneve-zonave të peshkimit.

Sektori i peshkatarisë në Kosovë nuk është shumë i zhvilluar, megjithatë Kosova ka një potencial të konsideruar të ujërave të ëmbla, duke krijuar mundësi të mëdha punësimi, profiti dhe mundësi e tjera për zhvillimin e ekonomisë së vendit. Sektori i akuakulturës në Kosovë, krahasuar me vendet e rajonit dhe të Evropës, është i vogël dhe prodhohet sasi minimale e mishit të peshkut rreth 614 t/vit. Në Kosovë kultivohet peshku troftë e cila konsumohet në restorante kurse shumë pak ose fare gjendet në treg.

MBPZHR në bashkëpunim me Federatën e Peshkatarëve Sportivë të Kosovës (FPSRK) merr vendime për zonat e peshkimit, sasinë e peshkut për peshkim, pajisjet për peshkim etj. Ndërsa sa i përket akuakulturës vendimet merren vetëm nga MBPZHR dhe si të tilla ekzekutohen nga Inspektorati. Sipas legjislacionit në fuqi licencimi nga lëmi i akuakulturës në shkallë vendi është përgjegjësi e MBPZHR ndërsa licencimi i peshkatarëve për peshkim sportive-rekreativë është kompetence e deleguar në FPSRK. Federata raporton të MBPZHR për numrin e licencave të lëshuara, zhvillimet në peshkimin, ripeshkëzimin dhe sasinë e peshkut të peshkuar.

Objektivat prioritarë afatmesme:

- Inventarizimi i peshqve;
- Përafrimi i legjislacionit të akuakulturës me *acquis*.

3.14. Kapitulli 14 i *acquis*-së: Politikat e transportit

Ky kapitull mbulon pjesën e politikave të transportit nga MSA. Legjislacioni i transportit të BE-së synon të përmirësojë funksionimin e tregut të brendshëm duke promovuar shërbime të sigurta, efikase dhe ekologjikisht të qëndrueshme me një sistem të integruar të transportit sa më miqësor ndaj mjedisit. Për më tepër, *acquis* i transportit mbulon sektorët e transportit rrugor, hekurudhor, ujor, transportin e multimodal, aviacionin dhe transportin detar. Në këtë kontekst, legjislacioni i transportit ndërlidhet me standardet teknike; standardet e sigurisë; standardet sociale; përfshirë edhe kontrollin e ndihmës shtetërore si dhe liberalizimin e tregut në kontekst të tregut të brendshëm të transportit. Gjithashtu, politika e transportit është e mbuluar edhe nga Titulli VI, nenet 90-100 të TFEU.

Kërkesat e MSA-së

Transporti në MSA mbulohet nga Kapitullin II: Ofrimi i Shërbimeve. Nenet relevante janë nenet: 53, 60, 61, 62 dhe 113. Neni 53 parasheh obligimet që do të rrjedhin nga Traktati i Transportit si dhe obligimet e marra përsipër përmes Marrëveshjes së Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit (HPEA). Neni 60 përveç merr për bazë Traktatin e Komunitetit të Transportit dhe Marrëveshjen HPEA dhe parasheh një përafrim gradual të legjislacionit në fushën e transportit me qëllim të avancimit të liberalizimit të qasjes së ndërsjellë

të Palëve në tregje dhe lehtësimin e lëvizjes së udhëtareve dhe mallrave si dhe përfshirjen e çdo konvente ndërkombëtare që merret me sigurinë rrugore. Nenet 61 dhe 62 fokusohen kryesisht në transportin e mallrave transit nga Kosova përmes BE-së me destinacion në vend të tretë ose anasjelltas. Neni 113 parasheh bashkëpunimin e palëve në fushat prioritete që lidhen me acquis të BE-së në fushën e transportit.

Kërkesat nga mekanizmat e tjerë të aderimit në BE

Në kontekst të kërkesave të dala nga *Raporti i KE-së për Kosovën – 2020*, në fushën e transportit rrugor, Kosova duhet të përmirësojë në mënyrë urgjente sigurinë rrugore duke synuar zvogëlimin e fataliteteve në rrugë dhe lëndimeve serioze të trafikut rrugor dhe të krijohet një sistem për grumbullimin e vazhdueshëm të të dhënave mbi aksidentet rrugore.

Kosova gjithashtu duhet ta përafrojë më tej kornizën ligjore primare dhe sekondare me acquis-në e BE-së, respektivisht legjislacionin mbi sistemin inteligjent të transportit (SIT) zhvillimin e një kornize strategjike për zbatimin e SIT mbi rrjetet bazë, duke siguruar kapacitete dhe burime të mjaftueshme për zbatimin e tij. Gjithashtu, RV rekomandon që të bëhen përpjekje intensive për të përfunduar harmonizimin me acquis për detyrimet e shërbimeve publike (PSO), përfshirë transpozimin e acquis për procedurat dhe kriteret për dhënien e kontratave të shërbimeve publike në fushën e transportit rrugor.

Sa i përket masave të reformës së konektivitetit, RV kërkon që të ndërmerren përpjekje të mëtejshme për të zbatuar masat me një fokus të veçantë në masat lidhur me kalimet kufitare, sigurinë rrugore dhe planet e mirëmbajtjes (rrugore dhe hekurudhore).

Ndër kërkesat e tjera të dala nga raporti janë edhe zbatimi i rekomandimeve të raportit CONNECTA lidhur me krijimin e një sistemi të dhënash për aksidentet rrugore në të gjithë vendin si dhe transpozimin e legjislacionit të BE-së mbi të drejtat e pasagjerëve. Për të zvogëluar numrin e aksidenteve me fatalitet, raporti rekomandon që të zhvillohen politika edukative, të trajnohet stafi dhe të këtë zbatim efektiv të rregullave të trafikut. Ndër të tjera, gjithashtu kërkohet që të përafrohet më tej legjislacioni mbi automjetet e transportit rrugor për energji-efiçente dhe të pastër, si dhe vendosja e infrastrukturës për përdorimin e karburanteve alternative. Raporti gjithashtu vlerëson se Kosova duhet ta vendosë në prioritet rishikimin dhe zbatimin e strategjisë së transportit multimodal si dhe zhvillimin e transportit të kombinuar.

Ndërkaq në sektorin e hekurudhave, raporti vlerëson se Kosova duhet të shtojë përpjekjet në drejtim të harmonizimit të legjislacionit vendor me acquis në fushën e interoperabilitetit. Kosova gjithashtu të bëjë përpjekje për të harmonizuar legjislacionin e BE-së për të drejtat e pasagjerëve në të gjitha format e transportit. Gjithashtu duhet të forcohen kapacitetet profesionale të ARH-së si dhe të sigurohen fonde të mjaftueshme.

Në fushën e aviacionit civil, raporti vlerëson se Kosova ka bërë progres në përafrimin e acquis dhe ka zbatuar gati të gjitha kërkesat nga faza e parë kalimtare e Marrëveshjes për Hapësirën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit (HPEA), me përjashtim të disa dispozitave në fushën e rregullimit ekonomik që kanë të bëjnë kryesisht me ligjin e punës. Në anën tjetër, raporti vlerëson se Kosova ka mungesë të ardhurave nga menaxhimi i hapësirës së lartë ajrore e cila e kufizon aftësinë e Kosovës për të investuar në trajnime dhe zhvillimin e infrastrukturës. Ndër të tjera, raport kërkon që të rritet mbështetja financiare dhe të forcohen kapacitetet profesionale të Agjencisë së Shërbimit të Navigacionit Ajror dhe Autoriteti të Aviacionit Civil.

Ndërkaq, në kuadër të kërkesave të dala në kuadër të *Nënkomitetit "INFRA" 2020 dhe 2021*, janë që Kosova duhet vazhduar me përafrimin e mëtejshëm të kornizës ligjore të sektorit të transportit me legjislacionin e BE-së në përputhje me praktikën më të mira. Për më tepër, institucionet përgjegjëse duhet të zbatojnë masat reformuese që rrjedhin nga agjenda e konektivitetit në fushën e transportit rrugor dhe hekurudhor. Në këto drejtim, Kosova duhet të miratojë Udhëzimi Administrativ mbi kornizën për instalimin e sistemeve inteligjente të transportit.

Sa i përket transportit rrugor duhet shtuar përpjekjet institucionale në zbatimin e legjislacionit si dhe të përmirësohet cilësia e të dhënave të sigurisë rrugore si parakushte që të përmirësohet siguria në

komunikacionin rrugor, siç përmendet edhe në kontekstin e masave të buta të Vjenës. Në këtë drejtim kërkohet të miratohen udhëzimet e Inspektimit të Sigurisë Rrugore si dhe të hartohet plani tre vjeçar për inspektim. Për më tepër, kërkohet që të ndërmerren masa direkte për krijimin e bazës së të dhënave për Regjistrimin e Aksidenteve Rrugore. Po ashtu, kërkohet që të zbatohen plotësisht veprimet e përcaktuara në planin e veprimit rajonal të Sigurisë Rrugore të miratuar në muajin tetor të vitit 2020. Për më tepër, kërkohet të hartohet strategjia gjithëpërfshirëse kombëtare për sigurinë rrugore 2021-2030, duke përfshirë vendosjen e caqeve si dhe të reflektohet në strukturën institucionale të sigurisë rrugore për adresimin e sfidave.

Në anën tjetër, kërkohet që institucionet e Kosovës ta trajtojnë me prioritet zgjidhjen e çështjes së homologimit të automjeteve të vjetra, me ç'rast kërkohet që legjislacioni për homologimin e automjeteve (UA nr. 2/2018) të rishikohet në mënyrë që të përafrohet me praktikën më të mirë të BE-së dhe t'i eliminojë barrierat jo tarifore.

Gjithashtu, nga Nënkomitetit "INFRA" 2020 vlerësohet nevoja që të punohet së bashku me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor për t'i shkëmbyer njohuritë dhe praktikën më të mirë dhe për ta ulur numrin e madh të vdekjeve në rrugë dhe të lëndimeve serioze në trafikun rrugor në rajon. Duhet të shtohen përpjekjet institucionale për miratimin dhe zbatimin e legjislacionit të Sistemit Inteligent të Transportit (SIT) si dhe zbatimin e rekomandimeve të CONNECTA-s.

Ndërkaq, sa i përket transportit hekurudhor, kërkohet që të nënshkruhet marrëveshja financiare 2020-2024, e paraqitur nga INFRAKOS në tetor 2019, mes Menaxherit të Infrastrukturës dhe autoriteteve kompetente. Gjithashtu, kërkohet që të caktohet bordi i ri drejtues i Infrastrukturës Hekurudhore / INFRAKOS si dhe të miratohet masat me qëllim rritjen e numrit të udhëtarëve në transportin hekurudhor. Po ashtu, kërkohet që të vazhdohen përpjekjet për të transpozuar *acquis* e BE-së për të drejtat e pasagjerëve në të gjitha modelet e transportit.

Në fushën e aviacionit civil, duhet përmbushur disa kërkesa të mbetura nga faza e parë e marrëveshjes për Hapësirën e Përbashkët të Aviacionit Evropian (HPAE) mbi rregullimin e marrëdhënieve të punës në përputhje me *acquis*, si dhe të finalizohet dhe miratohet strategjia e aviacionit civil të Kosovës. Qeveria gjithashtu duhet të sigurojë që riorganizimi dhe reformat administrative të Autoritetit të Aviacionit Civil të bazohen mbi parimet e reformës së administratës publike dhe të ndërliqhen me rrethanat dhe kërkesat specifike të sektorit të aviacionit.

Po ashtu, nga Nënkomitetit "INFRA" 2020 dhe 2021 të miratohet Strategjia Sektoriale e Transportit Multimodal që përfshin strategjinë e aviacionit civil.

Gjendja aktuale

Korniza legjislative, e politikave dhe ajo institucionale

Transporti rrugor

Korniza legjislative në këtë fushë përbëhet nga këto akte kryesore normative:

- Ligji për themelimin e traktatit të transportit të komunitetit;
- Ligji mbi rrugët;
- Ligji mbi transportin rrugor;
- Ligji për hekurudha;
- Ligji për aviacionin civil;
- Ligji për patentë shofer;
- Ligji për automjete;
- Ligji për rregullat e trafikut rrugor;
- Ligji për transportin tokësor të mallrave të rrezikshme.

Në drejtim të plotësimit dhe harmonizimit të mëtejshëm të kornizës ligjore sekondare, MMPHI ka miratuar 23 UA.

Këto akte normative kanë transpozuar këto akte të *acquis*-së:

- Direktivën 2006/126/KE;
- Direktivën 2000/30/KE;
- Direktivën 96/96/KE;
- Direktivën 96/35/KE;
- Direktivën 2008/68;
- Direktivën 1071/2009;
- Direktivën 1072/2009;
- Direktivën 1073/2009;
- Direktivën 95/50;
- Direktivën 96/35/KE e ndryshuar me Direktivën 2008/68/KE;
- Marrëveshjen evropiane për transport ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme (ADR);
- Konventën ndërkombëtare për transportin e mallrave përmes hekurudhës (CIM) dhe konventën për transport ndërkombëtar (COTIF);
- Rregullat për transportin ndërkombëtar të mallrave të rrezikshme me hekurudhë (RID).

Korniza e politikave në fushën e transportit përbëhet këto dokumente:

- Strategjia sektoriale dhe e transportit multimodal 2015-2025 (SSTMM) dhe PV pesëvjeçar;
- Strategjia për siguri në komunikacionin rrugor 2016-2020 dhe programi për siguri në komunikacionin rrugor.

Korniza institucionale:

- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës;
- Departamenti i inspektoratit;
- Departamenti i infrastrukturës rrugore;
- Departamenti i transportit tokësor;
- Departamenti automjeteve;
- Departamenti për patentë shofer;
- Departamenti koordinues i këshillit për sigurinë e komunikacionit rrugor.

Aviacioni civil

Korniza legjislative në këtë fushë përbëhet nga këto akte kryesore normative:

- Ligji për Aviacionin Civil;
- Ligji për themelimin e Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror;
- Rregullorja për plotësimin e standardeve të përgjithshme themelore të aviacionit civil;
- Rregullorja për përcaktimin e masave të hollësishme për zbatimin e standardeve themelore të përbashkëta në fushën e sigurimit të aviacionit;
- Rregullorja për hetimin dhe parandalimin e aksidenteve dhe incidenteve në aviacionin civil, rregullore e cila transponon rregulloret e BE-së nr. : 996/2010 (26 tetor 2017).

Këto akte normative kanë transponuar këto akte të acquis-së:

- Institucionet e Kosovës (MI dhe AAC) kanë transpozuar të gjithë legjislacionin që rrjedh nga faza e I e Marrëveshjes së Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit (HPEA), përveç Direktivës 2003/88 e cila pritet të transpozohet përmes ndryshimit të Ligjit të Punës;
- Gjithashtu, AAC kanë transpozuar 71 rregullore që rrjedhin nga faza e II-të e Marrëveshjes së Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit (HPEA);
- Rregullorja e BE-së nr. : 1141/2011 për ndryshimin e Rregullores (KE) nr. 272/2009; Rregulloren e BE-së nr. 245/2013 për ndryshimin e Rregullores nr. 272/2009;
- Rregullorja e BE-së nr. 2015/1998 për ndryshimin e Rregullores së BE-së nr. 185/2010.

Korniza e politikave në këtë fushë përbëhet nga këto dokumente:

- Strategjia sektoriale dhe Transportit Multimodal 2015-25 (SSTMM) si dhe Plani i Veprimit (PV) pesëvjeçar;

- Programi kombëtar për siguri të aviacionit civil, është miratuar plotësisht/ndryshimi nga MPB më 4 tetor 2017 dhe ka qëllim mbrojtjen e udhëtarëve, ekuipazhit, personelit tokësor, dhe publikut të gjerë nga ndërhyrjet e paligjshme;
- Programi kombëtar të kontrollit të kualitetit të sigurimit të aviacionit civil që ka për qëllim përcaktimin e përputhshmërisë me vlerësimin e efektshmërisë së programit kombëtar të sigurimit të aviacionit civil përmes auditimeve, testeve dhe inspektimeve;
- Programi kombëtar të trajnimeve për sigurimin e aviacionit civil, duke ofruar mundësi dhe trajtim të barabartë për të dy gjinitë, i cili siguron krijimin e personelit të trajnuar për zbatimin e standardizuar të sigurisë parandaluese për funksionim të sigurt të fluturimeve ndërkombëtare;
- Programi kombëtar i sigurimit të aviacionit civil në Republikën e Kosovës.

Korniza institucionale:

- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës;
- Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës;
- Ministria e Punëve të Brendshme:
 - Divizioni i Sigurimit të Aviacionit Civil;
- Komisioni për Hetimin e Aksidenteve edhe Incidenteve Aeronautike (KHAIA).

Transport hekurudhor

Korniza legislative në këtë fushë përbëhet nga këto akte kryesore normative:

- Ligji për hekurudha;
- 28 rregullore që mbulojnë rregullimin e licencimit, sigurisë, interoperabilitetit dhe tregut;
- 4 UA që mbulojnë rregullimin e licencimit, sigurisë, interoperabilitetit dhe tregut.

Këto akte normative kanë transpozuar këto akte të acquis-së:

- Direktivën e BE-së 2004/49;
- Direktivën e BE-së 2001/14;
- Direktivën e BE-së 91/440 dhe 95/18;
- Direktivën e BE-së 2007/59;
- Direktivën e BE-së 2008/57;
- Direktivën e BE-së 2012/34.

Korniza e politikave në këtë fushë përbëhet nga Strategjia Sektoriale dhe Transportit Multimodal 2015-2025 (SSTMM) dhe Planin e veprimit pesëvjeçar.

Korniza institucionale:

- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës;
- Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave (ARH);
- Komisioni për Hetimin e Aksidenteve edhe Incidenteve Aeronautike (KHAIA);
- Infracosi.

Mbështetja e donatorëve

Buxheti për realizimin e prioriteteve afatmesme do të planifikohet në kuadër të KASH-it si dhe përfshirë vazhdimin e përkrahjes nga IFN, si dhe donatorët potencial. Në këtë kontekst, kostoja totale e rehabilitimit të linjës hekurudhore 10-të e llogaritur në vitin 2015 në 208,400,000 euro, tani është vlerësuar në 245,000,000.00 euro prej të cilave 40 milionë euro janë kredi nga BERZh-i, 80 milionë euro janë kredi nga BEI-ja, 89 milionë euro janë grante nga BE, ndërsa për 36 milion euro pritet të gjenden mjetet financiare. Kostoja për realizimin e projekt dizajnit preliminar për linjën e 7 hekurudhore kapë vlerën prej 1,250,000 euro dhe është grant i WBIF, ndërsa kostoja e studimit të fizibilitetit për linjën hekurudhore Prishtinë – Aeroport kap vlerën prej 1.1 milion euro që gjithashtu është grant i WBIF.

Objektivat prioritarë afatmesme

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA dhe dokumentet e mekanizmat e tjerë të aderimit në BE në kuadër të fushëveprimit të kapitullit 14, fokusi gjatë periudhës 2021-2025 do të jetë në këto objektiva prioritare afatmesme:

- Plotësim-ndryshimi i ligjit për hekurudhat e Kosovës;
- Fillimi i zbatimit të Paketës së 4-të hekurudhore, e cila përfshinë standardet dhe autorizimin për mjetet lëvizëse, aftësimin e fuqisë punëtore, menaxhimin e pavarur të infrastrukturës si dhe liberalizimin e tregut të brendshëm të udhëtarëve dhe mallrave;
- Rehabilitimi i përgjithshëm dhe modernizimi i Linjës së 10 hekurudhore (Kufiri me Serbinë – Leshak – Fushë Kosovë – Hani i Elezit – Kufiri me Maqedoninë e Veriut);
- Projekt dizajni preliminar për linjën e 7-të hekurudhore Fushë Kosovë – Podujevë – Kufiri me Serbinë;
- Studimi i fizibilitetit për linjën hekurudhore Prishtinë – Aeroporti i Prishtinës; dhe
- Projekt dizajni për linjën jug-perëndimore Klinë – Prizren.
- Studimi i fizibilitetit për ndërtimin e Linjës Hekurudhore Kosovë – Shqipëri
- Rehabilitimi i Linjës së 7-të Hekurudhore (Fushë Kosovë – Podujevë – Merdare).
- Zbatimi progresiv i obligimeve që dalin nga Faza II e Marrëveshjes HPEA;
- Zbatimi i Programit Shtetëror të Sigurisë dhe Planit Shtetëror të Sigurisë së Aviacionit që e përcjellë atë, në përputhje me Rregulloren (BE) nr. 2018/1139.

3.15. Kapitulli 15 i acquis-së: Energjia

Ky kapitulli përmban acquis e BE-së për energjinë, pra objektivat e politikës së BE-së në sektorin e energjisë janë: aftësia konkurruese, siguria e furnizimit dhe qëndrueshmëria. Legjislacioni i BE-së për energjinë përfshinë politikën dhe rregullat veçanërisht në lidhje me konkurrencën dhe ndihmën shtetërore, përfshirë sektorin e thëngjillit, kushtet për qasje të barabartë në resurset për eksplorim dhe kushtet e prodhimit në sektorin e hidrokarbureve. Ky kapitull gjithashtu përcakton kushtet e tregut të brendshëm të energjisë, promovimin e burimeve të ripërtërishme, eficiencën e energjisë dhe mbrojtjen nga rrezatimi dhe sigurinë bërthamore.

Kërkesat e MSA-së

Detyrimi për të përafuar legjislacionin e Kosovës në sektorin e energjisë me atë të BE-së buron nga neni 74 dhe neni 114 i MSA-së. Këto dispozita e detyrojnë Kosovën që teknikisht të harmonizojë legjislacionin e saj me atë të BE-së, por gjithashtu të sigurojë zbatimin e tij. Në nenin 114 theksohet se bashkëpunimi në mes palëve do të përqendrohet në fushat prioritare që lidhen me acquis e Komunitetit të Energjisë. Ky bashkëpunim do të pasqyrojë parimet e ekonomisë së tregut dhe bazohet në Traktatin e themelimit të Komunitetit të Energjisë, me qëllim integrimin gradual të Kosovës në tregjet evropiane të energjisë.

Ajo gjithashtu parasheh mundësinë e përfshirjes për ndihmë për përmirësimin dhe shumëllojshmërinë e furnizimit me energji dhe qasjes në tregun e energjisë, si dhe zbatimin e rregullave të BE-së për transit, transmetim, shpërndarje dhe restaurim të ndërlydhjeve energjetike me rëndësi rajonale me vendet fqinje. Parashihet edhe zbatimin e acquis së BE-së për eficiencën e energjisë, burimeve të ripërtërishme të energjisë dhe ndikimit mjedisor nga sektori i energjisë, duke nxitur kështu eficiencën e energjisë dhe energjinë e ripërtërishme.

Masat nga Këshilli i Ministrave të Komunitetit të Energjisë: Kosova është palë kontraktuese në Traktatin e Komunitetit të Energjisë dhe si e tillë ka edhe detyrimin që të përafrojë dhe zbatojë acquis e Bashkimit Evropian të listuar në nenin 10 të Traktatit për themelimin e Komunitetit të Energjisë¹³.

Eficienca e energjisë dhe burimet e ripërtërishme të energjisë-BRE

Sipas nenit 114 të MSA-së, Republika e Kosovës duhet të përafrojë dhe zbatojë acquis e BE-së për eficiencën e energjisë, burimet e ripërtërishme të energjisë si dhe mjedisit të ndikuar nga aktivitetet energjetike, për

¹³ <https://www.energy-community.org/legal/treaty.html>.

të nxitur kursimin e energjisë, eficiencën e energjisë, shfrytëzimin e energjinë nga burimet e ripërtëritshme, reduktimin e emisioneve mjedisore si dhe hulumtimin dhe zhvillimin në këto fusha.

Siguria e furnizimit dhe tregu i brendshëm i energjisë

Kërkesat nga mekanizmat e tjerë të aderimit në BE

Përveç detyrimeve të MSA-së, Kosova gjithashtu duhet të përmbushë kërkesat e dala nga *Raporti i KE-së për Kosovën dhe nga takimet e Nënkomitetit të MSA-së "Transport, Mjedis, Energji dhe Zhvillim Rajonal"*, të mbajtur në mars 2020 dhe 2021.

Raporti i KE-së për Kosovën 2020 thekson se Kosova deri diku ka arritur përgatitjet në sektorin e energjisë. Ka pasur njëfarë progresi në këtë sektor, veçanërisht në harmonizimin me *acqui-in* e BE-së dhe në rritjen e investimeve për burimet e ripërtëritshme të energjisë. Sidoqoftë, diversifikimi i sektorit të energjisë është i ngadaltë dhe Kosova mbetet shumë e varur nga qymyri, i cili përveç se është një burim dominues i emetimit të gazrave serë, shkakton rreziqe serioze për shëndetin dhe mjedisin. Kosova ka nevojë për një fokus strategjik në një agjendë gjithëpërfshirëse të gjelbër, në përputhje me qëllimet e BE-së, përfshirë një zhvendosje graduale nga qymyri në burimet e ripërtëritshme dhe rritjen e eficiencës së energjisë në të gjithë sektorët.

Sa i përket dokumenteve strategjike, strategjia e energjisë së Kosovës, duhet të përditësohet me fokusim kryesor në energjinë e ripërtëritshme, eficiencën e energjisë dhe caqet e dekarbonizimit. Kosova duhet ta hartoj dhe miratojë planin që përfshin rregullimin gradual të tarifave të energjisë që pasqyrojnë rritjen e pritit të çmimeve dhe masat lehtësuese për konsumatorët e cenueshëm. Rekomandohet në veçanti të fillojë zbatimin e *acquis* mbi sigurinë e furnizimit me energji, të përgatitet për dekomisionimin e TC Kosova A dhe avancimin mjedisor të TC Kosova B si dhe të sigurojë vendosjen e kapaciteteve të reja gjeneruese. Gjithashtu theksohet që nuk ka progres në përafrim të legjislacionit në fushën e rezervave obligative të naftës me *acquis*.

Sa i përket *tregut të brendshëm të energjisë*, për sa i përket projektit të termocentralit të ri TC "Kosova e Re" mbetet të sqarohen afatet kohore dhe opsionet e financimit. Kapaciteti dhe pavarësia e Zyrës së Rregullatorit për Energji janë dëmtuar nga ndërhyrjet politike.

Në kuadër të Nënkomitetit të MSA-së "Infrastruktura", të mbajtur në mars 2020 dhe 2021, theksohet që Kosova duhet të bëjë përpjekje urgjente për të hapur tregun e energjisë elektrike dhe zbatuar kërkesat e pakos së tretë të Energjisë. Konkluzionet potencojnë harmonizimin e kornizës rregullative dhe kontraktuale me kërkesat për krijimin e tregut "Day ahead" dhe tregut të përbashkët me Shqipërinë si dhe miratimin e rregullave të reja për balancim ndërkufitar. Gjithashtu prioritet mbetet miratimi i ligjit për rezervat e obligueshme të naftës dhe ligjit për tregtinë me produktet e naftës dhe karburante të ripërtëritshme në Kosovë si dhe UA-të për biolëngjet dhe biokarburantet. Në përputhje me parimet dhe përparësitë e Marrëveshjes së Gjelbër, rishikoni Strategjinë e Energjisë dhe Planin e Veprimit dhe gjithashtu siguroni koherencën e tyre me "Planin kombëtar të energjisë dhe klimës".

Në kuadër të projektit të dekomisionimit të TC Kosova A konkluzion mbetet që të vazhdohet më tutje me procesin si dhe të merret vendimi për lokalitetin që do të caktohet për ruajtjen e mbeturinave të rrezikshme dhe të përgatitet vlerësim i ndikimit në mjedis me qëllim që të merret vendim përfundimtar për lokacionin. Në përputhje me tranzicionin e gjelbër të qëndrueshëm në Evropë dhe zhvillimin e burimeve të reja të energjisë, Kosova do të marrë pjesë në studimin gjithëpërfshirës për të vlerësuar burimet alternative të energjisë së qëndrueshme. Mbetet sfidë edhe emërimi i kryesuesit të bordit të ZRR-e-së. Sa u përket kapaciteteve të reja nënvizohet si konkluzion se Kosova duhet të informojnë rregullisht Komisionin Evropian për hartimin e garancisë shtetërore ose ndonjë instrument tjetër të ndihmës shtetërore dhe do t'i ofrojnë KE-së përditësime të rregullta për gjendjen e diskutimeve mbi ndihmën që shteti do të sigurojë për investimet në ndërtimin e termocentralit *Kosova e Re*. Të merren masat e nevojshme për të funksionalizuar impiantin e biomasës në Gjakovë. Kosova duhet të miratojë planin që përfshin rregullimin gradual të tarifave të energjisë, duke reflektuar rritjen e pritit të kostove dhe masat zbutëse për konsumatorët e cenueshëm.

Gjendja aktuale

Korniza legislative dhe ajo e politikave

Më 25 tetor 2005 Republika e Kosovës ka nënshkruar Traktatin për themelimin e Komunitetit të Energjisë (TKE) dhe me këtë është palë kontraktuese në Komunitetin e Energjisë.

Hartimi i politikave, organizimi, rregullimi dhe menaxhimi i sektorit energjetik në Kosovë bëhet nëpërmjet një pakoje ligjesh që janë përgjithësisht në përputhje me *acquis* e BE-së për fushën e energjisë. Ndërsa, institucionet e sektorit përfshijnë ato qeveritare, rregullatorë dhe ndërmarrjet energjetike.

Korniza legislative në këtë fushë përbëhet nga këto akte kryesore normative:

- Ligji për energjinë;
- Ligji për energjinë elektrike;
- Ligjit për rregullatorin e energjisë;
- Ligji për energjinë termike;
- Ligji për gazin natyror;
- Ligji për efikasitet të energjisë.

Këto akte normative kanë transpozuar këto akte të *acquis*-së:

- Rregulloren nr. 715/2009/KE për kushtet e qasjes në rrjetet e bartjes të gazit natyror;
- Rregulloren nr. 714/2009/KE për kushtet për qasje në rrjetin për shërbimet ndërkufitare të energjisë elektrike;
- Direktivën nr. 2009/72/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike;
- Direktivën nr. 2009/28/KE lidhur me promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e ripërtërishme;
- Direktivën nr. 2009/73/KE për rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit natyror;
- Direktivën 2012/27/BE të datës 25 tetor 2012 për efikasitetin e energjisë, ndryshuar Direktivat 2009/125/KE dhe 2010/30/BE dhe duke shfuqizuar Direktivat 2004/8/KE dhe 2006/32/KE.

Korniza e politikave në këtë fushë përbëhet nga këto dokumente:

- Strategjia e energjisë e Republikës së Kosovës 2017-2026;
- Strategjia e ngrohjes e Kosovës 2011-2018;
- Programi i zbatimit të strategjisë 2018-2020.

Korniza institucionale në këtë fushë përbëhet nga këto institucione:

- Ministria e Ekonomisë;
- Ministria e Tregtisë, Ndërmarrësisë dhe Industrisë;
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve;
- Zyra e Rregullatorit për Energji;
- Korporata Energjetike e Kosovës;
- Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës;
- Kompania Distribucionit me Energji Elektrike;
- Kompania e Furnizimit me Energji Elektrike;
- Ngrohoret e Qyteteve (Termokos-Prishtinë, Gjakovë, Mitrovicë dhe Zveçan).

Në kuadër të sigurisë së furnizimit, sa i përket përafrimit të legjislacionit në fushën e naftës, ligji për rezervat e obligueshme të naftës nuk është miratuar që disa vite për shkak të implikimeve të mëdha buxhetor që shkaktohen me zbatimin e këtij ligji. Ndërsa, ligji tjetër për tregti me naftë dhe karburante të ripërtërishme, si dhe UA për biokarburante pritet të miratohen brenda vitit 2021.

Tek pjesa e hartimit të politikave është në hartim e sipër Plani Kombëtar për Energji dhe Klimë 2021-2030 ku marrin pjesë pesë grupe punuese tematike. Në këtë plan do të integrohen dhe vendosen caqet për BRE,

EE dhe për gazërat serrë. Ky plan pritet të miratohet në vitin 2021. Gjithashtu është duke u rishikuar strategjia e energjisë 2021-2030 e cila pritet të miratohet në vitin 2021.

Tregu i brendshëm i energjisë gjatë vitit 2020 ka pasur zhvillime pozitive në kuadër të integritimit në tregun rajonal të energjisë elektrike. Pas votimit të suksesshëm në muajin prill 2020 nga ana e Grupit Rajonal të Evropës Kontinentale (RGCE), më 30 qershor 2020, u nënshkrua Marrëveshja e re të Kycjes në mes të KOSTT dhe ENTSO-E. Marrëveshja e re e Kycjes KOSTT/ENTSO-E fillojë së zbatuari me 29 shtator 2020. Me fillimin e implementimit të marrëveshjes, KOSTT-i operon si zonë rregulluese e pavarur brenda bllokut AK (Albania-Kosovo) me Republikën e Shqipërisë, në kuadër të zonës sinkrone të Evropës Kontinentale. Alokimi i kapaciteteve të interkoneksionit dhe menaxhimi i kongjestionëve të rrjetit interkonektiv do të realizohet brenda strukturës së këtij blloku dhe jo më nga EMS (Serbi), ku edhe të hyrat nga këto aktivitete do të mblihdhen nga Blloku, përkatësisht nga KOSTT. Ky zhvillim tutje i hap rrugë KOSTT-it për integrimin në tregun rajonal të energjisë, pjesëmarrjes në bursën shqiptare të energjisë (APEX) si dhe vënies në operim të linjës 400 kV Kosovë-Shqipëri. Implementimi i plotë i Marrëveshjes së Bllokut Rregullues Kosovë – Shqipëri është nënshkruar në Tiranë, më 29.09.2020. Më tej me 05 tetor 2020 në Prishtinë, KOSTT dhe Operatori Shqiptar i Sistemit të Transmetimit (OST) nënshkruan Marrëveshjen e Aksionarëve për krijimin e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike (ALPEX) dhe miratuan Statutin e saj. Krijimi i Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike (ALPEX) shënon një standard të ri të funksionimit në sektorin e energjisë, i cili do të garantojë më shumë transparencë dhe konkurrencë në tregun e energjisë elektrike.

Për më tepër, më 30 tetor 2020, në Tiranë u nënshkrua marrëveshja për procesin e shkëmbimit të të dhënave për zgjidhjen përfundimtare të energjisë së shkëmbyer midis dy zonave rregullatore të Operatorëve të Sistemit të Transmetimit të Kosovës dhe Shqipërisë, si dhe memorandumit për kapacitetin metodologjia e llogaritjes rrjeti i transmetimit, ndërmjet dy zonave rregullatore KOSTT dhe OST. Me nënshkrimin e këtyre marrëveshjeve, KOSTT dhe OST bien dakord të zbatojnë rregullat dhe rekomandimet ENTSO-E për shkëmbimet ndërkufitare të energjisë, duke respektuar "Rregulloren nr. 714/2009 të Parlamentit Evropian mbi Kushtet për Hyrjen në Rrjetin për Shkëmbimet e Energjisë Elektrike Kufitare "Domethënë Rregullorja (KE) 714/2009 e Parlamentit Evropian. Këta hapa të rëndësishëm e afrojnë KOSTT-in drejt anëtarësimit në Rrjetin Evropian të Operatorëve të Sistemit të Transmetimi-ENTSO-E. Nga data 14 dhjetor 2020, KOSTT ka filluar funksionimin si Zonë e Pavarur Kontrolli brenda Bllokut të Kontrollit Shqipëri-Kosovë.

Në Kosovë nuk ekziston infrastrukturë funksionale dhe treg i gazit natyror, mirëpo ligjet e energjisë dhe strategjia e energjisë parashohin zhvillimin e infrastrukturës së gazit natyror, përmes lidhjes (kycjes) me projektet e infrastrukturës së gazit në rajonin e Evropës Juglindore, përmes projektit të gazsjellësit TAP ("Trans-Adriatik-Pipeline" – Gazsjellësi përtej Adriatikut) dhe projektit të interkoneksionit të gazit Maqedoni e Veriut - Kosovë. Gjithashtu me qëllim të hapjes së perspektivës së zhvillimit të sektorit të gazit natyror dhe përmbushjes së obligimeve që Kosova ka si anëtare ndaj Traktatit të Komunitetit të Energjisë, Kosova e ka të miratuar ligjin për gazin natyror, e i cili i ka të trajtuara elementet dhe kërkesat e pakos së tretë të legjislacionit të BE-së që lidhen me gazin natyror (Direktivën nr. 2009/73/KE dhe Rregulloren nr. 715/2009/KE). Përveç legjislacionit primar është i miratuar edhe UA për sigurinë e furnizimit me gazin natyror.

Rritja e diversiteti të burimeve energjetike konsiderohet si një komponentë mjaftë e rëndësishme për furnizim të qëndrueshëm dhe kualitativ me energji. Duke iu referuar Strategjisë së Energjisë së Republikës së Kosovës 2017-2026, dokumenti i cili i orienton politikat e sektorit të energjisë, në kuadër të objektivave të saj ka trajtuar edhe komponentin e zhvillimit të infrastrukturës së gazit natyror. Në këtë aspekt zhvillimi i sektorit të gazit natyror në Kosovë, përmes lidhjes me projektet e infrastrukturës së gazit në rajonin, vlerësohet si një mundësi reale për furnizim në të ardhmen me gaz natyror. Konektimi me linjat rajonale të furnizimit me gaz natyror është opsion kyç i Kosovës për diversifikim të burimeve të energjisë në funksion të rritjes së sigurisë së furnizimit.

Prodhimi i energjisë elektrike bazohet në thëngjill (94.5% e totalit të prodhimit vendor) përderisa pjesa tjetër e furnizimit prej 5.5% bazohet në BRE. Konsumi bruto i energjisë elektrike për 2019 ka qenë 6001 GWh (konsumi në amvisëri merr pjesë 41.9%, sektori komercial 17%, sektori e industrisë 16.3%). Humbjet

në rrjetin e shpërndarjes janë mjaft të larta: humbjet komerciale përbejnë 11.6%, humbjet teknike 11.4%, ndërsa humbjet në transmetim 1.7%).

Kapacitetet e reja gjeneruese nga BRE-të, për të adresuar problemin afatgjatë të sigurisë së furnizimit me energji, Strategjia për Energjinë 2017-2026 parashih kapacitetin prej 1, 436 MW në vitin 2025, 450 MW prej të cilit rrjedhin nga burimet ripërtëritëse. Me këtë kapacitet prodhues parashihet të prodhohet rreth 7, 703 KWh për një vit, ku 924 KWh apo 12.1% të tyre rrjedhin nga burimet ripërtëritëse.

Gjatë vitit 2020, kanë hy në operim katër (4) hidrocentrale me një kapaciteti prej 11.06 MW. Ndërsa, në proces të ndërtimit (Hidrocentrale) janë 10 projekte me kapacitet të instaluar 33.5 MË, të cilat priten të hyjnë në operim gjatë vitit 2021. Nga turbinat e erës janë katër (4) projekte me kapacitet të instaluar prej 114.4 MW, të cilat priten të hyjnë në operim gjatë viteve 2021-2022. Nga biomasa në proces të ndërtimit është një projekt me kapacitet të instaluar prej 1.2 MW, që pritet të hyn në operim në gjysmën e dytë të vitit 2021. Ndërsa, sa i përket projekteve të reja nga energjia solare nuk ka.

Gjithsej 21 gjeneratorë me BRE janë tanimë në operim, me një kapacitet total instalues prej 105 MW: 13 HC (61.1 MW); 6 PV-Solare (10MW) dhe dy (2) nga gjeneratorët prej erës (33.73 MW).

Mbështetja e donatorëve

Institucionet e Kosovës mbështeten nga KE (përmes IPA-së dhe WBIF) dhe nga donatorë tjerë bilateralë me projektet e përmbledhura në vijim.

Projektet aktuale dhe të planifikuara IPA

Përkrahja nga ana e donatorëve kryesisht është koncentruar në projektin lidhur me procesin e dekomisionimit të objekteve për rreth TC "Kosova A" që nuk kanë ndikim në operimin e TC "Kosova A", projektin për rehabilitimin e Ngrohtores së Gjakovës dhe zgjerimin e rrjetit të "Termokos" si dhe projektin për rehabilitimin e TC Kosova B pjesa ambientale.

Në kuadër të IPA 2014 i gjithë aktiviteti lidhur me procesin e dekomisionimit është zhvilluar në përputhje me Vendimin e Qeverisë për dekomisionimin dhe çmontimin e azotikut, gazifikimit, ngrohtores dhe objekteve të tjera përcjellëse të cilat nuk e pengojnë operimin normal të njërive aktive të TC Kosova A.

Faza e parë e projektit është mbështetur në kuadër të programit ka përfunduar në fillim të muajit nëntor 2020. Në këtë fazë është përgatitur plani i detajuar i çmontimit, studimi i vlerësimit të ndikimit mjedisor dhe social, tender dosja për punimet e çmontimit dhe dokumente të tjera të nevojshme. *Faza a dytë* përfshinë çmontimin fizik të objekteve të azotikut, gazifikimit, ngrohtores dhe objekteve të tjera përcjellëse të cilat nuk e pengojnë operimin normal të njërive aktive të TC Kosova A dhe pastrimin e terrenit. Realizimi i fazës së dytë planifikohet të mbështetet në kuadër të programit IPA 2021 dhe sipas planifikimeve paraprake kostoja e realizimit është rreth 50 milionë euro.

Në programin IPA 2018 për TC "Kosova B" është përkrahur projekti për instalimin e elektrofiltrave (ESP), reduktimin e shkarkimeve të pluhurit (thërrmijave) dhe reduktimin e oksideve të azotit (NO_x), Vendosja e elektrofiltrave dhe pajisjeve për NO_x-it në njësinë TC Kosova B1, pas situatës së krijuar nga COVID 19, është shtyrë për vitin 2021 ndërsa njësia B2 për vitin 2022. Kostoja e projektit është 76 milionë euro.

Pas dorëzimit të dokumentit të veprimt për projektin e dyfishimit të kapaciteteve gjeneruese dhe zgjerimit të rrjetit, zyra e BE-së ka shprehur gatishmërinë për të financuar projektin me 13 milion euro në kuadër të IPA 2020, ndërsa Banka Evropiane e Investimeve ka disponim të jap në formë të kredisë 12 milion euro, për dyfishimin e kapaciteteve gjeneruese. Gjithashtu, NP "Termokos" Sh.A për projektin e dyfishimit të kapaciteteve gjeneruese dhe zgjerimit të rrjetit në kuadër të IPA 2020 zotohet për bashkëfinancim të projektit prej viteve 2021-2025 me nga 500, 000 euro për vit në total 2.5 milion euro.

N.P. "Ngrohtorja e Qytetit" Sh.A. Gjakovë është përfituese e fondeve të ndara në kuadër të programit IPA II 2015, për ndërtimin e impiantit të ngrohjes me biomasë me teknologjinë e kogjenerimit. Kontrata për dizajnim dhe ndërtim është nënshkruar me kompaninë austriake URBAS në vlerë prej 13,978,180.63 euro, ndërsa për mbikëqyrje të punimeve është nënshkruar kontratë me kompaninë EGIS International në vlerë

850.000 euro. Sipas planit dinamik të punimeve pritet që pjesa më e madhe e projektit të kryhet gjatë vitit 2020 dhe fillimin e vitit 2021 me funksionalizimin e plotë të impianit të ngrohjes nga biomasa me teknologjinë e kogjenerimit.

Në kuadër të bashkëpunimit rajonal, Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit e Republikës së Kosovës dhe Ministri për Ekonomi i Maqedonisë së Veriut nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi me qëllim të intensifikimit të bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve duke përcaktuar fushat prioritare për bashkëpunim në lidhje me sektorin e energjisë. Në funksion të zbatimit të kësaj marrëveshje, në pjesën e parë të vitit 2019 përmes platformës WBIF është bërë një aplikim i përbashkët me palën Maqedonisë së Veriut, kjo e fundit në rolin e promotorit të projektit, për mbështetje financiare në formë granti për të realizuar një studim të fizibilitetit për gazsjellësin Maqedoni e Veriut – Kosovë. Sipas njoftimeve, Komiteti Drejtues i WBIF ka miratuar grantin në vlerën 0.650 milion euro. Ky studim do të realizohet përmes asistencës teknike e angazhuar nga platforma WBIF/BERZH i cili planifikohet të realizohet në periudhën 2020-2021.

Për më tepër, me iniciativën e Korporatës së Sfidave të Mijëvjeçarit (MCC), në fillim të pjesës së parë të vitit 2020 është realizuar edhe një studim i parafizibilitetit për gazifikimin e Kosovës nga konsulentët e angazhuar nga MCC. Këto rezultate të dala do të shërbejnë si mbështetje për përgatitjen e master-planit për gazin natyror për Kosovën dhe studimin e fizibilitetit për interkoneksionin me Maqedoninë e Veriut.

Ndërsa GIZ përmes asistencës teknike gjatë vitit 2020, ka angazhuar ekspert rajonal dhe vendor për të ndihmuar Grupin Punues për hartimin e Planit Kombëtar për Energji dhe Klimë 2021-2030. Gjithashtu, nga projekti i financuar nga ambasada Norvegjeze për vitin 2021, akterët në fushën e energjisë janë përfitues të këtij projekti me objektivat si: ngritjen e kapaciteteve në përfaftrimin e legjislacionit (trajtime për zyrtar/e brenda dhe jasht vendit) si dhe në kuadër të “gap analizave” për nën sektorët e këtij kapitulli.

Objektivat prioritare afatmesme

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA dhe dokumentet e mekanizmat e tjerë të aderimit në BE në kuadër të fushëveprimit të kapitullit 15, fokusi gjatë periudhës 2021-2025 do të jetë në këto objektiva prioritare afatmesme:

- Rishikimi i ligjit për energjinë;
- Rishikimi i ligjit për energjinë elektrike;
- Rishikimi i ligjit për rregullatorin e energjisë;
- Hartimi i programit për zbatimin e strategjisë së energjisë;
- Hartimi dhe miratimi i rregullave të reja të balancimit ndërkuftar;
- Zhvillimi i aktiviteteve të procesit të dekomisionimit të objekteve të gazifikimit, azotikut, ngrohtores dhe objekteve të tjera përcjellëse të cilat nuk e pengojnë operimin normal të njësieve aktive të “TC Kosova A”;
- Tregu i përbashkët i energjisë Kosovë-Shqipëri, i funksionalizuar;
- Anëtarësimi i KOSTT në ENTSO-E (Rrjetin Evropian të Operatorëve të Sistemit të Transmetimi);
- Anëtarësimi i ZRrE-së në ACER (Agjencia për kooperimin e rregullatorëve të energjisë);
- Përgatitja e Master planit për shpërndarjen e gazit natyror në Kosovë (2021-2022); dhe
- Studimi i fizibilitetit “Zhvillimi i sektorit të Gazit në Kosovë” (MCC Programi 1).

Efiçienca e energjisë dhe burimet e ripërtërishme të energjisë-BRE

Kërkesat e MSA-së

Sipas nenit 114 të MSA-së, Republika e Kosovës duhet të harmonizojë dhe zbatojë acquis e BE-së për efiçencën e energjisë, burimet e ripërtërishme të energjisë dhe mjedisin e prekur nga aktivitetet e energjisë, për të promovuar kursimin e energjisë, efikasitetin e energjisë, përdorimin e burimeve të ripërtërishme të energjisë, uljen të emisioneve mjedisore dhe kërkimit dhe zhvillimit në këto zona.

Kërkesat nga mekanizmat e tjerë të aderimit në BE

Përveç detyrimeve të MSA-së, Kosova gjithashtu duhet të përmbushë kërkesat e dala nga *Raporti i KE-së për Kosovën – 2020* dhe nga *takimet e Nën komitetit MSA-së “Transport, Mjedis, Energji dhe Zhvillim Rajonal”*,

të mbajtur në mars 2020 dhe 2021. Këto dokumente vënë në pah disa nga fushat kryesore të Kosovës për përmirësim, si në vijim:

Sfidat e identifikuara nga *Raporti i KE-së për Kosovën – 2020*, përfshijnë plotësimin e legjislacionit sekondar për ligjin për performancën energjetike të ndërtesave dhe zhvillimin e shërbimeve për auditimin e energjisë dhe auditorët e energjisë, të operacionalizohet Fondi i Eficiencës së Energjisë si dhe të filloj zbatimi i projekteve për eficiencë të energjisë në Komuna; incentiva për eficiencë të energjisë të përfshihen për sektorin privat dhe të amvisërisë; Kosova duhet të ndërmerr masa për të mundësuar kosto më efektive të energjisë së ripërtëritshme dhe futjen e ankandeve të energjisë së ripërtëritshme.

Projektet e reja për hidrocentralet e vogla duhet të jenë në përputhje me legjislacionin e BE-së për koncesionet dhe mjedisin dhe të marrin parasysh ndikimin në zonat e mbrojtura natyrore. Procedurat konkurruese të ofertave për projektet e energjisë së ripërtëritshme cenohen nga përdorimi i tarifave të tepruara fikse të furnizimit "feed-in" nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë.

Derisa legjislacioni është pjesërisht i përafruar me *acquis*, tregu i energjisë elektrike duhet të ristrukturohet për të mundësuar integrimin e gjenerimit të energjisë së ripërtëritshme. Duhet të paraqitet një skemë e bazuar në treg për mbështetjen e gjenerueseve të pavarur. Nuk ka pasur progres në përmbushjen kritereve për përdorimin e bio-karburanteve në transport. Kosova duhet të sigurojë funksionalitetin e Fondit për Eficiencë të Energjisë. Janë bërë investime në eficiencën e energjisë në ndërtesat publike, por nxitjet për sektorin privat dhe ekonominë familjare kanë mbetur prapa. Me tej thuhet se Agjencia e Kosovës për Eficiencë të Energjisë ka mungesë të stafit dhe ka kapacitete shumë të kufizuar për të monitoruar zbatimin e politikës së eficiencës së energjisë. Kosova duhet të funksionalizojë platformën e monitorimit dhe verifikimit për kursimin e energjisë. Kosova duhet t'i japë përparësi investimeve për eficiencën e energjisë në ndërtesat rezidenciale dhe sektorin privat (të cilat zënë 50% të konsumit përfundimtar të energjisë).

Ndërsa, sfidat të dala nga takimi i *Nënkomitetit të MSA 'Infrastruktura' 2020* përfshijnë funksionalizimin e Fondit për Eficiencë të Energjisë si dhe miratimin i incentivave për EE për sektorin privat dhe amvisëri. Gjithashtu theksohet përditësimi dhe miratimi i planit për burimet e ripërtëritshme, përfshirë masat e duhura për të siguruar që Kosova po arrin 25% të objektivave të energjisë së ripërtëritshme deri në vitin 2020 dhe funksionalizimi i "One stop shop" për BRE. Një ndër konkluzionet mbetet edhe miratimi i PV Kombëtar për Energji të Ripërtëritshme duke vendosur politika dhe masa për të arritur cakun prej 25% të energjisë së ripërtëritshme me kosto sa më të ulët. Rregullat ekzistuese për dhënien e ndihmës shtetërore për prodhuesit e energjisë së ripërtëritshme, për të qenë në përputhje me legjislacionin e ndihmës shtetërore, duhet të ndryshohen për të përfshirë edhe konkurrueshmërinë (ankandet konkurruese). Kosova duhet të vlerësojë si duhet projektet e propozuara të hidrocentraleve, përfshirë përmes Vlerësimeve të Ndikimit të Mjedisit, dhe lëshimit, transferimit e anulimit të garancive të origjinës për BRE, si dhe zbatimin e kriterit të qëndrueshmërisë për biokarburantet dhe biolëngje. Në raport theksohet nevoja që të shtohen përpjekjet për të monitoruar dhe verifikuar kursimet e energjisë, përfshirë operacionalizimin e platformës online për monitorimin dhe verifikimin e eficiencës së energjisë.

Gjendja aktuale

Korniza legislative në këtë fushë përbëhet nga këto akte kryesore normative:

- Ligji për eficiencë të energjisë;
- Ligji për performancën energjetike në ndërtesa;
- Rregullorja për inspektimin e sistemit të ngrohjes dhe pajisjeve të ajrit të kondicionuar;
- Rregullorja për metodologjinë e kalkulimit minimal për performacë të energjisë;
- Rregullorja për certifikatën e performancës së energjisë në ndërtesa;
- Rregullorja për 'One Stop Shop' për burimet e ripërtëritshme të energjisë;
- Rregullorja për sistemin e ofruesve të shërbimit energjetik dhe kriteret minimale për auditimin energjetik;
- Rregullorja për kriteret minimale për auditimet e energjisë përfshirë ato të kryera si pjesë e sistemeve të menaxhimit të energjisë;

- Rregullorja për kërkesat minimale për faturimin dhe informacionin e faturimit bazuar në konsumin aktual;
- UA për caqet e energjisë nga burimet e ripërtëritshme;
- UA për promovimin e shfrytëzimit të energjisë nga burimet e ripërtëritshme;
- UA për përmbajtjen e energjisë së lëndëve djegëse të përcaktuara për përdorim fundor;
- UA lidhur me kërkesat për efikasitetin e energjisë për blerjen e produkteve shërbimeve dhe ndërtesave nga institucionet e nivelit qendror;
- UA për potencialin e efikasitetit të energjisë në ngrohje dhe ftohje;
- UA për metodologjinë lidhur me përcaktimin e efikasitetit nga procesi i bashkë-prodhimit;
- UA për llogaritjen e energjisë elektrike nga bashkë-prodhimi;
- UA për kushtet e përgjithshme për analizën e kosto-përfitimit në lidhje me masat për promovimin e efikasitetit në ngrohje dhe ftohje;
- UA për certifikatë/garancinë e origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga bashkë-prodhimi me efikasitet të lartë.

Akte normative të lartcekura kanë transpozuar këto akte të acquis-së:

- Direktivën 2012/27/BE për efikasitetin e energjisë;
- Direktivën 2009/28/KE të Parlamentit Evropian dhe këshillit të datës 23 prill 2009 për promovimin e energjisë nga burimet e ripërtëritshme;
- Direktivën 2010/30/BE për treguesin përmes etiketimit dhe informacionit standard të produktit mbi konsumin e energjisë dhe burimet e tjera nga produktet e lidhura me energjinë.

Korniza e politikave në këtë fushë përbëhet nga këto dokumente:

- Strategjia e energjisë së Kosovës 2017-2026;
- Plani i tretë kombëtar për EE 2017-2019;
- Plani i katërt kombëtar për EE 2019-2021;
- Plani kombëtar i veprimit për BRE 2011-2020;
- Plani i veprimit i Kosovës për efikasitet të energjisë (PKVEE) 2010-2018;
- Planet komunale për efikasitet të energjisë.

Në kuadër zbatimit të ligjit për efikasitet të energjisë gjatë vitit 2020 janë miratuar nëntë UA dhe janë hartuar katër draft akte nënligjore që derivojnë nga ky ligj. Është miratuar në dhjetor 2020 plani i katërt për veprimin e efikasitetit të energjisë 2019-2021. Është hartuar rregullorja për organizimin e vendeve të punës në Agjencinë e Kosovës për Efikasitet të Energjisë. Gjithashtu është duke u hartuar strategjia për renovimin e ndërtesave, e cila pritet të miratohet në periudhën e parë të vitit 2021.

Ndërsa, në kuadër të burimeve të ripërtëritshme të energjisë, është duke u hartuar koncepti i dokumentit për BRE që do të përcaktojë politikën e kësaj fushe, e cila ka për qëllim promovimin e shfrytëzimit ekonomik e të qëndrueshëm të potencialeve vendore të BRE-ve, ndër të tjera do të udhëzojë për formën e skemës së re mbështetëse për BRE. Me tej, tarifa nxitëse për mbështetjen nga burimet e ripërtëritshme për projektet e reja është ndërprerë me 10 dhjetor 2020. Ndërsa, pritet kalimi gradual në tarifa premium dhe ankande për caqet 2021-2030.

Korniza institucionale në këtë fushë përbëhet nga këto institucione:

- Ministria e Ekonomisë;
- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve;
- Agjencia e Kosovës për Efikasitet të Energjisë;
- Fondi i Kosovës për Efikasitet të Energjisë;
- Zyra e Rregullatorit për Energji;
- Korporata Energjetike e Kosovës;
- Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës.

Mbështetja e donatorëve dhe nga institucionet financiare ndërkombëtare

Sa i përket projektit nga Banka Botërore për financimin e masave për eficiencën e energjisë në ndërtesat e institucioneve të nivelit qendror si dhe promovimin e energjisë nga BRE-të përmes një kredie të butë me vlerë prej USD 31 milion është në zbatim e sipër. Është bërë renovimi i 30 ndërtesave të pakos së 5-të, pritet të përfundojnë në kuartalin e 4-të vitit 2020. Lansimi i tenderit për renovimin e ndërtesave për pakon e 6-të pritet të përfundojë në kuartalin e 4-të vitit 2021, ndërsa përfundimi i renovimit planifikohet të ndodhë në fund vitit 2021. Në kuadër të këtij projekti gjithashtu është duke u realizuar studimi për "Planifikimi me kosto më të ulët për përzierjen optimale të energjisë së ripërtitshme" si dhe një studim tjetër për BRE "Planifikimi i gjenerimit të koston më të ulët dhe analiza e integritit të rrjetit të energjisë variable të ripërtitshme".

Në mbështetje të Bankës Botërore do të realizohet projekti, vlera e të cilit është 17,000 euro, ka për qëllim promovimin e rezultateve të KEEEP, dhe është në fazën e përzgjedhjes së kompanisë fituese. Lidhur me projektin e financuar nga KfW dhe WBIF, është nënshkruar kontrata me kompaninë që do ta bëjë Dizajnin dhe Auditimin Energjetikë të objekteve (masat e zbatuara në 15 ndërtesa publike në komunat Prishtinë, Gjiilan, Gjakovë dhe Ferizaj). Zbatimi i masave të EE në 52 ndërtesa publike për vitin 2020, (27 financohen nga BRK si dhe 25 ndërtesa nga Banka Botërore). Nga kjo shumë, nga BRK janë 4,950,000 euro ndërsa huamarrje prej 6 milion euro dhe nga donatorët 3,833,000 euro.

Në vitin 2020, zbatimi i katër projekteve të reja të HCV me kapacitet instalues prej 14.6 MW me kosto 17.52 milionë euro si dhe zbatimi i tri projekteve nga energjia e erës me kapacitet prej 105 MW dhe me kosto 147 milion euro investime private.

Sa i përket programimit të IPA 2021, janë duke u hartuar projektet të cilat përmbajnë edhe komponentin e eficiencës së energjisë dhe burimeve të ripërtitshme që ka për qëllim përmirësimin e eficiencës së energjisë dhe aplikimin e teknologjive të energjisë nga burimet e ripërtitshme në ndërtesat e banimit/infrastrukturën private, në përputhje me acquis të BE-së.

Objektivat prioritarë afatmesme

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA dhe dokumentet e mekanizmat e tjerë të aderimit në BE në kuadër të fushëveprimit të kapitullit 15, fokusi gjatë periudhës 2022–2025 do të jetë në këto objektiva prioritarë afatmesme:

- Hartimi dhe miratimi i aktit ligjor për BRE;
- Rishikimi i Ligji për eficiencën e energjisë;
- Zbatimi i masave për eficiencën e energjisë në amvisëritë përmes projektit "Reliable Energy Landscape" (RELPE) në 2, 600 shtëpi dhe në 25 ndërtesa shumëkatëshe dhe instalimi i njehsorëve për matjen e konsumit të nxehtësisë dhe valvulave termostatike për rreth 4, 500 familje në Prishtinë;
- Ndarjet e granteve për masat e eficiencës për bizneset e grave brenda projektit "Reliable Energy Landscape";
- Miratimi i politikës së stimujve dhe zbatimi i masave të eficiencës së energjisë në sektorin e amvisërisë dhe bizneseve;
- Miratimi i legjislacionit për mbështetjen e skemave konkurruese dhe shpallja e ankandëve për BRE;
- Zbatimi i planit të investimeve kapitale për forcimin, zgjerimin e rrjetit dhe projektet e tensionit të mesëm për të zvogëluar humbjet teknike dhe komerciale.

Mbrojtja nga rrezatimi dhe siguria bërthamore

Kërkesat e MSA-së

Një nga angazhimet e Kosovës që rrjedhin në kuadër të MSA-së, konkretisht nenit 114 të saj, është edhe përafrimi i legjislacionit në fushën e sigurisë bërthamore dhe mbrojtjes nga rrezatimi jonizues. Për më tepër, të gjitha dispozitat në fushën e gjenerimit të rrezatimit bërthamor, sigurisë bërthamore janë të bazuara në Traktatin EURATOM (Traktati i Krijimit të Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, 1957) i cili siguron që anëtarët e Komunitetit Evropian duhet të krijojnë dhe sigurojnë standarde uniforme të sigurisë nga teknologjia bërthamore për të mbrojtur popullsinë dhe shëndetin e punëtorëve.

Kërkesat nga mekanizmat e tjerë të aderimit në BE

Përveç detyrimeve të MSA-së, Kosova gjithashtu duhet të përmbushë kërkesat e dala nga *Raporti i KE-së për Kosovën – 2020* dhe nga *takimet e Nënkomitetit MSA-së "Transport, Mjedis, Energji dhe Zhvillim Rajonal"*, të mbajtur në mars 2020 dhe 2021.

Raporti i KE-së për Kosovën – 2020 në fushën e mbrojtjes nga rrezatimi dhe sigurinë bërthamore thekson se kapaciteti licencues dhe inspektues i Agjencisë për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore mbetet i dobët dhe financimi nuk është i mjaftueshëm për zbatimin e mandatit të saj. Nuk janë vërejtur zhvillime në monitorimin e rrezatimit (p.sh. uraniumit të varfëruar) dhe nuk kontrollohen mbeturinat radioaktive, e nuk ka as plan emergjent radiologjik. Ende mbetet të gjendet zgjidhja për depozitimin e përhershëm të mbeturinave radioaktive. Sa i përket bashkëpunimit ndërkombëtar në këtë fushë, Kosova ka finalizuar memorandumun e mirëkuptimit me Malin e Zi për menaxhimin e mbetjeve radioaktive.

Ndërsa, sfidë e dal nga takimi i Nënkomitetit të MSA 'Infrastruktura' 2021 përfshijn miratimin e Rregullores për Emergjencën dhe Monitorimin e Rrezatimit.

Gjendja aktuale

Korniza legislative dhe ajo e politikave

- Ligji për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguri bërthamore;
- Rregullorja për burimet dhe praktikën e rrezatimit jonizues;
- Rregullorja për autorizim;
- Rregullorja për kufijtë e dozave dhe mbrojtjen nga rrezatimi;
- Udhëzuesi për njohjen e ekspertëve të cilët ofrojnë shërbime profesionale dhe teknike për mbrojtje dhe siguri nga rrezatimi jonizues.

Këto akte normative kanë transponuar këto akte të *acquis-së*:

- Direktivën nr. 2013/59/EURATOM për standardet bazë të sigurisë;
- Direktivën nr. 2011/70/EURATOM për menaxhimin e përgjegjshëm dhe të sigurt të lëndës djegëse të shpenzuar dhe mbetjeve radioaktive;
- Direktivën nr. 2013/51/EURATOM për substancat radioaktive në ujë të destinuar për konsum njerëzor;
- Direktivën nr. 2006/117/EURATOM për mbikëqyrjen dhe kontrollin e transportit të mbetjeve radioaktive dhe lëndës djegëse të shpenzuar;
- Direktivën nr. 2014/87/EURATOM për sigurinë bërthamore të instalimeve bërthamore.

Korniza institucionale në këtë fushë përbëhet nga këto institucione:

- Ministria e Mbrojtjes;
- Ministria e Ekonomisë;
- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
- Ministria e Shëndetësisë;
- Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve;
- Agjencia e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore.

Në kuadër të miratimit të legjislacionit primar dhe sekondar është në fuqi ligji për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguri bërthamore, tri rregullore dhe një udhëzues. Gjatë vitit 2020 është miratuar rregullorja për kufijtë e dozave dhe mbrojtjen nga rrezatimi nga AKMRrSB. Gjithashtu me date 22.06.2020 është miratuar udhëzuesi për procedurat dhe kriteret për njohje të ekspertëve të cilët ofrojnë shërbime profesionale dhe teknike për mbrojtje dhe siguri nga rrezatimet jonizuese. Është në hartim rregullorja për emergjencat dhe monitorimin radiologjik e cila pritet të miratohet gjatë vitit 2021.

Sa i përket zbatimit të legjislacionit në fushën e mbrojtjes nga rrezatimi dhe sigurinë bërthamore, gjatë vitit 2020 janë ndërmarr aktiviteti si në vijim: janë realizuar 66 inspektime ndërsa sa i përket procesit të Autorizimit (Regjistrimi, Licencimi) të praktikave të rrezatimit jonizues dhe lejeve të importit dhe transportit të burimeve radioaktive, agjencia ka lëshuar: 48 Licenca, 2 regjistrime dhe 53 leje për import-transport te

burimeve radioaktive. Gjithashtu, agjencia ka bërë njohje të ekspertëve të fizikës mjekësore (6) dhe ekspertë të mbrojtjes nga rrezatimi (10) si dhe 23 autorizime për zhvillimin e praktikave radiologjike për ekspertë të mbrojtjes nga rrezatimi.

Për monitorimin e rrezatimit (specifikisht për lokacionet potenciale me uranium të varfëruar), agjencia nëpërmes marrëveshjes së bashkëpunimit me Institutin për Radioelemente IRE-ELiT realizon monitorimin radiologjik të ujit dhe të dheut në territorin e Kosovës me theks të veçantë në lokacionet potenciale me uranium të varfëruar). Deri në vitin 2019 janë mbledhur dhe analizuar 84 mostra të ujit dhe 13 mostra të dheut. Gjatë vitit 2020, janë mbledhur 16 mostra të ujit dhe 3 mostra të dheut të cilat janë dërguar për analiza në Institutin për radioelemente 'IRE' në Bruksel. Duhet cekur se gjatë këtyre viteve të monitorimit, analizat e mostrave të ujit dhe dheut tregojnë se nuk ka asnjë gjurmë të uraniumit të varfëruar në territorin e Republikës së Kosovës.

Sa i përket kontrollit të mbetjeve radioaktive, AKMRrSB bazuar në planin vjetor të inspektimit të mbetjeve radioaktive, kryen inspektime të rregullta të mbetjeve radioaktive së bashku me KFOR-in në territorin e Kosovës.

Objektivat prioritare afatmesme

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA dhe dokumentet e mekanizmat e tjerë të aderimit në BE në kuadër të fushëveprimit të kapitullit 15, fokusi gjatë periudhës 2022–2025 do të jetë në këto objektiva prioritare afatmesme:

- Rregullorja për Emergjencat dhe Monitorimin Radiologjik;
- Plani Kombëtar për emergjenca Radiologjike;
- Traktati mbi ndalimin e testeve bërthamore;

Si dhe nënshkrimi i:

- Konventës mbi mbrojtjen fizike të materialit bërthamor (CPPNM 2005);
- Konventës mbi njoftimin e hershëm të aksidenteve bërthamore;
- Konventës për ndihmë në rast aksidentit bërthamor ose emergjence radiologjike;
- Konventës ndërkombëtare për ndalimin e akteve të terrorizmit bërthamor;
- Marrëveshjes së masave mbrojtëse dhe protokollit shtesë;
- Kodit të sjelljes mbi sigurinë dhe sigurimin e burimeve radioaktive dhe udhëzimet shoqëruese për import dhe eksport.

3.16. Kapitulli 16 i acquis-së: Tatimet

Acquis në fushën e tatimeve konsiston në legjislacion të harmonizuar për fushën e tatimeve indirekte (domethënë tatimin mbi vlerën e shtuar) dhe akcizat. Acquis specifikon fushëveprimin, përkufizimet dhe parimet e TVSh-së. Legjislacioni për TVSh ofron trajtim të barabartë tatimor për transaksionet vendore dhe të huaja (import). TVSh-ja Gjithashtu është e bazuar në principin e neutralitetit ku tatimi i aplikuar është proporcional me çmimin pavarësisht numrit të transaksioneve të ndërmjetme.

Akciza për produktet e duhanit, pijeve alkoolike dhe produkteve të energjisë janë gjithashtu subjekt i legjislacionit të BE-së. Legjislacioni i BE-së vendos strukturën e akcizës që duhet ngarkuar si dhe sistemin e tarifave minimale për secilin grup të produkteve. Mallrat i nënshtrohen akcizës nëse prodhohen brenda BE-së apo nëse importohen nga vendet e treta. Sidoqoftë, akciza është e pagueshme vetëm në shtetin anëtar në të cilin malli lëshohet në qarkullim/konsum (me disa përjashtime) dhe me tarifën e akcizës së atij shteti anëtar. Legjislacioni i BE-së përcakton Dispozitat për prodhimin, mbajtjen, lëvizjen dhe monitorimin e produkteve me akcizë.

Sa u përket **tatimeve të drejtpërdrejta** (tatimet direkte), acquis mbulon disa aspekte të tatimeve të të ardhurave nga kursimet individuale dhe të tatimeve të korporatave. Qëllimi është të eliminojë çrregullimet e aktiviteteve ekonomike ndër-kufitare mes kompanive të vendeve anëtare. Për më tepër, të gjitha Shtetet Anëtare angazhohen të përputhin aktivitetet me parimet e Kodit të Mirësjelljes për Tatimin e Bizneseve, që kanë për qëllim eliminimin e masave të dëmshme tatimore.

Bashkëpunimi administrativ dhe ndihma e ndërsjellë ndërmjet shteteve anëtare synon të sigurojë funksionimin normal të tregut të brendshëm sa u përket tatimeve dhe mjeteve për parandalimin e evazionit fiskal dhe shmangies nga tatimet. Shtetet anëtare duhet të sigurojnë se ekzistojnë kapacitete të nevojshme për zbatim dhe fuqizim, duke përfshirë lidhjet me sistemet e kompjuterizuar të tatimeve përkatëse të BE-së. Në kuadër të **kapacitetit operativ dhe kompjuterizimit**, acquis për TVSH mbulon sistemin e shkëmbimit të informacionit që lejon shkëmbim direkt elektronik të të dhënave midis administratave të shteteve anëtare. Sisteme të ngjashme të IT-së kërkohen edhe në fushën e akcizave dhe tatimeve direkte për shkëmbim informacioni midis vendeve anëtare. Për më tepër, kërkohet sistem specifik i IT-së (VoeS) për shkëmbimin e informatave midis vendeve anëtare në lidhje me skemën e veçantë për e-shërbimet që ofrohen nga tregtarët jo-rezidentë të BE-së për qytetarët e BE-së.

Kërkesat e MSA-së

Fusha e tatimeve është një nga fushat e rëndësishme të cekura në MSA (neni 39, neni 40, neni 70 dhe neni 105). Neni 39 mbulon ndalimin e diskriminimit fiskal, neni 40 tarifat e natyrës fiskale, ndërsa neni 105 zhvillimin e Kosovës në fushën e tatimeve dhe masat me të cilat synohet reformimi i mëtejshëm i sistemit fiskal në Kosovë. Përveç kësaj neni i fundit mbulon edhe ristrukturimin e administratës tatimore me qëllim të sigurimit të efektivitetit të vjeljes së tatimeve dhe kundër mashtrimit fiskal.

Gjithashtu këtu merren parasysh edhe fushat prioritare që lidhen me acquis të BE-së, konkretisht ajo e luftimit kundër konkurrencës së dëmshme të tatimeve. Legjislacioni i aquis të BE mbi fushën e tatimeve, konkretisht luftën kundër konkurrencës së dëmshme të tatimeve bazohet në Kodin e Mirësjelljes për tatimin e biznesit, miratuar nga Këshilli dhe Përfaqësuesit e Qeverisë së Shteteve Anëtare.

Me qëllim të lehtësimit të zbatimit të masave për parandalimin e mashtrimit tatimor dhe shmangies tatimore, bashkëpunimi do të synojë promovimin e parimeve të qeverisjes së mirë në çështjet tatimore, transparencën, shkëmbimin e informatave dhe konkurrencës së ndershme të tatimeve në Kosovë.

Lidhur me themelimin e kompanive të BE në Kosovë, Kosova do të lehtësojë ngritjen e veprimtarive në territorin e saj nga kompanitë e BE-së. Me qëllim të lehtësimit të procesit të themelimit të kompanive, Kosova do të këtë trajtim të barabartë si për kompanitë e saja ose kompanitë e një vendi të tretë.

Kërkesat nga mekanizmat e tjerë të aderimit në BE

Bazuar në *Raportin e KE-së për Kosovën – 2020* për çështjet që lidhen me tatimet, Kosova duhet të vazhdojë të përforcojë masat e ndërmarra për luftën kundër ekonomisë jo formale, evazionit fiskal dhe të zvogëlojë lëndët e mbetura të ankesave të pazgjidhura kundër Administratës Tatimore në divizionin fiskal në Gjykatës Themelore në Prishtinë. Kosova në veçanti duhet të zbatojë sistematikisht strategjinë për luftimin e ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimin e terrorizmit dhe krimin financiar (2019-2023). Në raport gjithashtu kërkohet miratimi i ligjit për tatimin mbi të ardhurat personale dhe ligjit mbi TVSh për të harmonizuar legjislacionin në përputhje me acquis. Kapacitetet të administratës tatimore duhet të përforcohen më tej dhe të sigurohen procese të përzgjedhjes meritore dhe transparente.

Konkluzionet e dala nga Nënkomiteti i vitit 2020 kërkojnë që të miratohet Ligji për Administratën Tatimore dhe Procedurat dhe ligjet në fushën e tatimit (Tatimi mbi Vlerën e Shtuar, Tatimi në të Ardhurat e Korporatave dhe Tatimi në të Ardhurat Personale), për ta harmonizuar me legjislacionin dhe praktikën e BE-së. Konkluzionet nënvizojnë që të përmirësohet regjistri i pagesve të tatimeve duke përmirësuar statistikat sipas kodeve të industrisë. Të miratohet plani i auditimit për vitin 2020. Autoritetet duhet të përforcojnë qasjen e përzgjedhjes së rasteve për kontroll tatimor bazuar në vlerësimin e rrezikut të përmbushjes. Autoritetet gjithashtu duhet të rrisin përqindjen e borxhit të mbledhur si pjesë e shumës totale të borxhit të arkëtueshëm. Gjithashtu si konkluzion është edhe harmonizimi i sistemit tatimor i Kosovës me standardet minimale të kornizës inkluzive të BEPS/OECD.

Gjendja aktuale

Korniza legjislative

Në lidhje me legjislacionin tatimor, në Programin Legjislativ për 2021 përfshihen edhe tre ligjet kryesore tatimore: Projektligji për Administratën Tatimore dhe Procedurat, Projektligji për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar dhe Projektligji për Tatimin mbi të Ardhurat Personale. Nga ana tjetër, Ligji për Tatimin mbi të Ardhurat e Korporatave nuk është në Programin Legjislativ të këtij viti.

Procedurat për hartimin e këtyre tre projektligjeve tashmë kanë filluar dhe MFPT ka krijuar grupet punuese për hartimin e secilit ligj përkatës. Grupi punues për Projektligjin për Administratën Tatimore dhe Procedurat tashmë ka hartuar draftin e parë fillestar të Ligjit. Procesi i hartimit të këtyre projektligjeve do të jetë në përputhje me rekomandimet dhe praktikat më të mira nga BE.

Ligji për punën e lojërave të fatit është anuluar sepse Qeveria ka marrë një vendim për ndalimin e Lojërave të fatit në Kosovë. Kjo është përfshirë në Ligj dhe është miratuar nga kuvendi.

Sa u përket ndryshimeve tatimore, është miratuar UA për ndryshim/plotësimin e listës së produkteve që taten me normën 8% të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar, pra Kosova tani zbaton një normë standarde prej 18% dhe një normë të reduktuar prej 8% në përputhje me rregullat mbi normat e përcaktuara në Direktivën e BE-së për Sistemin e Përbashkët të TVSh-së.

Këto ndryshime dhe plotësime të ligjeve tatimore po bëhen për të siguruar harmonizimin e mëtejshëm me Direktivat e BE-së, veçanërisht me Direktivën e TVSh-së dhe me zhvillimet e fundit në lidhje me praktikat ndërkombëtare në fushën e tatimit të drejtpërdrejtë, si Njësinë e Përhershme, Transferimin e Çmimeve, tatimet e kompanive në sektorin financiar dhe të sigurimeve, si dhe harmonizimin e ligjit me kërkesa të ndryshme në fushën e politikës fiskale të shtetit.

Korniza e politikave

Në fushën e tatimeve janë miratuar dhe zbatohen disa dokumente me karakter strategjik.

- Plani Strategjik i ATK-së për periudhën 2015-2020 si dokument më i lartë në hierarkinë e dokumenteve të ATK-së; në këtë Plan Strategjik, ATK ka paraqitur vlerat, prioritetet dhe objektivat për periudhën 2015-2020. Administrata Tatimore e Kosovës, për të siguruar një nivel të lartë të përmbushjes tatimore, në vazhdimësi është e fokusuar në tri çështje kryesore: në përmbushjen vullnetare, ofrimin e shërbimeve profesionale dhe trajtimin e drejtë dhe të barabartë të të gjithë tatimpaguesve. Strategjia 2021-2025, përcakton prioritetet e ardhshme, gjegjësisht qëllimet strategjike dhe treguesit kyç të performancës, si: zvogëlimin e hendekut tatimor, mbledhjen dhe trajtimin e borxheve tatimore, si dhe zhvillimin e Organizatës në pajtim me standardet më të mira evropiane.
- Strategjia e Përmbushjes për periudhën 2021-2025. Qëllimi i Strategjisë së Përmbushjes është krijimi i një mjedisi përmbushës, duke lehtësuar procesin e përmbushjes përmes ngritjes së vazhdueshme të cilësisë së shërbimeve për të gjithë tatimpaguesit të cilët përmbushin vullnetarisht detyrimet e tyre ligjore. Ndërsa në anën tjetër zbatimi i forcës së ligjit bazuar në rrezik përmes identifikimit dhe trajtimit të të gjithë atyre tatimpaguesve të cilët hezitojnë apo kanë vendosur të mos përmbushin detyrime të tyre ligjore.

Plani Vjetor i Punës i ATK-së për vitin 2021 është miratuar nga menaxhmenti i lartë i ATK-së në shkurt 2021 i cili është përgatitur në bazë të objektivave të përcaktuara specifike për njësitë organizative përkatëse bazuar në Planin Strategjik të ATK-së 2021-2025.

Institucionet do të angazhohen për zbatimin e rekomandimeve të Komisionit Evropian në Raportin për Vendin për çështjet që lidhen me tatimet. Në këtë kontekst, Kosova duhet të vazhdojë të përforcojë masat e ndërmarra për luftën kundër ekonomisë jo formale dhe evazionit fiskal dhe t'i jap prioritet ngritjes së efikasitetit duke zbatuar Strategjinë për Parandalimin dhe Luftën kundër Ekonomisë Joformale, Pastrimin e Parave dhe Financimin e Terrorizmit dhe Planit të Veprimt. Sfidat e identifikuar janë adresuar në dokumentet strategjike (Plani Strategjik i ATK 2015-2020) dhe në planet operative vjetore. Gjithashtu, ATK do të vazhdojë në përmirësimin e kapaciteteve të organizatës me qëllim të luftimit kundër korrupsionit dhe të forcimit të kontrollit të brendshëm të performancës institucionale.

Korniza institucionale

Korniza institucionale në këtë fushë përbëhet nga **Administrata Tatimore e Kosovës**. ATK është institucioni kryesor tatimor në Republikën e Kosovës, që funksionon në kuadër të Ministrisë së Financave si autoriteti që ka të drejtën e zbatimit të ligjeve fiskale, administrimit të taksave dhe tarifave ndërkombëtare. Qëllimi kryesor i ATK-së është të ndihmojë tatimpaguesit të paguajnë detyrimet e tyre tatimore në përputhje me ligjet e zbatueshme tatimore dhe të sigurojë që të ardhurat nga taksat të shkojnë në llogaritë e buxhetit të shtetit, duke i ofruar Tatimpaguesve një sistem efektiv pagesash.

Është bërë funksional produkti i vërtetimit elektronik për persona fizik dhe për biznese. Përveç kësaj të gjitha deklaratimet e tatimeve bëhen në mënyrë elektronike përmes sistemit *Electronic Declaration of Incomes (EDI)* i cili u mundëson tatimpaguesve deklaratim të shpejt, të thjeshtë dhe të sigurt. Ky sistem është duke treguar rezultate mjaft të mira. Janë krijuar module të ndryshme në sistemin e TI të cilat kanë lehtësuar deklaratimet nga ana e tatimpaguesit dhe menaxhimin e proceseve të punës brenda institucionit.

Përmes Sistemit EDI, është mundësuar edhe ofrimi i shërbimeve të reja me rastin e pandemisë Covid-19, ku në mënyrë elektronike tatimpaguesit kanë parashtruar kërkesat e tyre për të përfituar nga Pakoja Fiskale Emergjente, si për kompensim të pagave të punëtorëve, kompensim të pagesë së qirasë, kërkesë për pagesë shtesë për të punësuarit e rrezikuar – në kontakt të drejtpërdrejtë me konsumatorin.

Gjithashtu, përmes Sistemit EDI është mundësuar edhe gjenerimi i Certifikatave për të punësuarit (liria e lëvizjes) bazuar në kodet (NACE) e lejuara për të punuar gjatë pandemisë Covid-19. Gjithashtu, përmes Sistemit Elektronik EDI është mundësuar edhe parashtrimi i kërkesës për Marrëveshje për pagesë me këste të borxheve të papaguara. Gjatë kësaj periudhe përmes sistemit EDI është mundësuar edhe përditësimi i të dhënave të tatimpaguesit, duke siguruar ATK informata të sakta me qëllim të komunikimit me tatimpagues. Gjithashtu, përmes sistemit EDI është mundësuar edhe menaxhimi i llogarive bankare të tatimpaguesit, i cili ka mundësi të menaxhoj vet llogaritë bankare nëse dëshiron se me cilën llogari bankare të pranoj mjetet nga ATK me rastin e rimbursimit të mjeteve, etj.

Administrata Tatimore, me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa më efikase, ka bërë plotësisht funksional sistemin e deklaratimit elektronik. Gjatë periudhës janar - dhjetor 2020, numri i deklaratave është 2,593,516 dhe numri i përgjithshëm i tatimpaguesve të regjistruar në sistemin e deklaratave online është 116,118. Për më tepër, gjatë periudhës raportuese, 77,561 Vërtetime Tatimore u shkarkuan online.

ATK, si institucion modern i orientuar drejt ofrimit të shërbimeve profesionale për tatimpaguesit, ka realizuar aktivitete të ndryshme për informimin e tatimpaguesve. Gjatë periudhës janar - dhjetor 2020 ATK mbajti 10 seminare dhe ofroi 5,141 përgjigje për tatimpaguesit. Gjithashtu, u realizuan 13 Prezantime për nxënësit e shkollave fillore/të mesme. Për më tepër, në mënyrë që tatimpaguesit të njihen në çdo hap për procedurat e kërkuara me legjislacionin tatimor, risitë dhe ndryshime të tjera, janë përgatitur/ofruar gjithsej 30 Njoftime për tatimpagues, përmes ueb-faqes së ATK-së, Facebook, përmes adresave elektronike të Tatimpaguesve, etj. Sa i përket aplikacionit "Verifiko punëdhënësin" ky është një shërbim elektronik që i mundëson çdo qytetari që të verifikoj se a është punëdhënësi i tij duke i paguar Kontributet Pensionale si dhe tatimin ashtu siç parashihet me legjislacion tatimor. Sa i përket modulit të "Menaxhimit të Rimbursimeve" ky është një shërbim elektronik që është në dispozicion për tatimpaguesit, të cilët bëjnë kërkesë për Rimbursim, si: për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, Tatimin në të Ardhura Personale dhe Tatimin në të Ardhura të Korporatave. Përmes këtij shërbimi, tatimpaguesi mund të informohet se deri ku ka arritur të shqyrtohet nga ATK, kërkesa e tij për Rimbursim e dërguar më parë.

Në fushën e Transferimit të Çmimit, është mbajtur dhe ka përfunduar misioni i "Tax Inspector Board", misioni i cili ka ndihmuar në ngritjen e kapaciteteve në divizionin e transferimit dhe inspektoret tatimor për evidentimin, trajtimin dhe kontrollimin e bizneseve që janë të obliguar të raportojnë transaksionet e tyre me palët e lidhura. Gjithashtu, është filluar nisma që transaksionet e kontrolluara me palët e lidhura të bëhen në formë elektronike. Po trajtohen njoftimet vjetore të dorëzuara nga tatimpaguesi, me qëllim që të vërtetohen transaksionet dhe në rast nevojë në bashkëpunim me inspektoret nga

departamenti i tatimpaguesve te mëdhenj te hapet kontrolle tatimore per verifikimin e saktësisë se transaksioneve te kontrolluara.

Administrata Tatimore e Kosovës përmes procedurave të brendshme ka reformuar procesin e shqyrtimit të kërkesave të riimbursimit të TVSh-së, duke lehtësuar procedurën e riimbursimit të mjeteve dhe shkurtuar kohën e shqyrtimit në maksimum 30 ditë. Ajo gjithashtu ka eliminuar plotësisht nevojën për kërkesë të veçantë për riimbursim të TVSh-së. Kërkesa për riimbursim bëhet njëkohësisht me deklaratën tatimore të TVSh-së. Është zhvilluar Moduli i riimbursimit i cili kërkesat i kategorizon në tri kategori, kategoria A, B dhe C. Përmes këtij moduli synohet që të përmirësohet koha e kthimit të rimursimeve.

ATK ka filluar zbatimin e projektit për Modernizimin e Teknologjisë Informative. Deri tani, ATK ka normalizuar një strukturë funksionale dhe menaxheriale të qeverisjes dhe mbikëqyrjes së projektit duke angazhuar ekspertë dhe përgjegjëse funksionale nga të gjitha fushat relevante në lidhje me proceset dhe zhvillimet në ATK. Ndërsa në kuadër të aktiviteteve të përbashkët me Operatorët Ekonomik gjatë kësaj periudhe është përfunduar faza fillestare e analizës së proceseve aktuale të punës, dizajni dhe arkitektura e sistemit, dokumentimi i kompetentëve për zhvillimin e Fazës së parë si dhe dorëzimi i licencave softuerike për komponentët funksionale dhe zhvillimor të Sistemit të Ri. Në fund të tetorit janë lëshuar në funksionet versionet testuese/provuese të funksioneve si janë planifikuar në fazën e parë të Projektit. Testimet e këtyre funksioneve janë duke u zhvilluar gjatë muajit nëntor , për tu përfunduar gjatë muajit dhjetor të viti 2020.

Divizioni i ankesave – Misioni i Divizionit t e Ankesave është t'i zgjidh kontestet tatimore, pa hedhje në gjyq, në baza të drejta dhe të paanshme për Qeverinë apo tatimpaguesin që do të nxisë pajtueshmëri vullnetare dhe besim publik në integritetin dhe efikasitetin e Administratës Tatimore. Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2020, numri i ankesave të pranuar është 496, ndërsa ankesa të shqyrtuara ishin 217 ankesa.

Mbështetja e donatorëve

Administrata Tatimore e Kosovës që nga themelimi i saj është mbështetur vazhdimisht nga organizata të ndryshme ndërkombëtare.

Nga FMN janë realizuar katër misione të asistencës teknike, për ngritjen e kapaciteteve për mbledhjen e borxheve tatimore; përcaktimin e indikatorëve kyçë të performancës bazuar në praktikën e mira ndërkombëtare, dhe për projektin e modernizimit të TI-së dhe për përmirësimin e menaxhimit të rrezikut të përmbushjes. Gjithashtu gjatë periudhës raportuese është realizuar misioni i ngritjes së kapaciteteve i përkrahur nga instrumenti TAIEEX, në fushën e rimbursimit të TVSh për turistë. Përveç kësaj, janë realizuar dy misione të asistencës teknike nga GIZ, Administrata Tatimore e Bavarisë lidhur me ri-shikimin e kriterëve të rrezikut të përmbushjes tatimore në veglën e analizës së rrezikut.

Për përmirësimin e regjistrimit tatimor janë realizuar disa aktivitete në bashkëpunim me Bankën Botërore e cila është duke e përkrahur ATK në këtë fushë. Në bashkëpunim me USAID është finalizuar Plani i Përmirësimit të Integritetit të ATK 2021-2023.

Objektivat prioritarë afatmesme

Në planin afatmesëm prioritetet kryesore **ligjore** që parashikohet të realizohen janë:

- Zbatimi i kornizës së fundit ligjore në ligjin e TVSH, TAK dhe TAP në harmoni me legjislacionin me të Drejtën e BE në veçanti me Kodin e Mirësjelljes për Tatimin e Biznesit dhe direktivat e Këshillit të Evropës;
- Hartimi dhe miratimi i legjislacionit dytësor për ligjin e TVSH, TAK, TAP dhe harmonizimi me legjislacionin me të Drejtën e BE në veçanti me Kodin e Mirësjelljes për Tatimin e Biznesit dhe direktivat e Këshillit të Evropës.

Në planin afatmesëm prioritetet kryesore **zbatuese** parashikohet të realizohen janë:

- Ngritja e inkasimit të borxheve tatimore;
- Digjitalizimi i shërbimeve të cilat aktualisht ofrohen fizikisht dhe manualisht;

- Vazhdimi i zbatimit të qasjes së përmirësimit të përmbushjes tatimore bazuar në vlerësimin e rreziqeve të identifikuar;
- Zbatimi i modernizimit të Teknologjisë Informative në Administratën Tatimore;
- Luftimi i evazionit tatimor, shmangies tatimore dhe zgjerimi i bazës tatimore;
- Negocimi i Marrëveshjeve për Eliminimin e Tatimit të Dyfishtë në të Ardhuara dhe Kapital, shmangies tatimore dhe evazionit tatimor.

3.17. Kapitulli 17 i *acquis*-së: Politikat ekonomike dhe monetare

Acquis në fushën e politikave ekonomike dhe monetare përmban rregulla specifike që kërkojnë pavarësinë e bankave qendrore në shtetet anëtare, duke ndaluar financimin direkt të sektorit publik nga to dhe qasje të privilegjuar të sektorit publik në institucionet financiare. Shtetet anëtare pritet që të bashkërendojnë politikat e tyre ekonomike dhe janë subjekt i Paktit të Stabilitetit dhe Rritjes mbi mbikëqyrjen fiskale. Edhe Shtetet e reja Anëtare duhet të zotohen në përputhje me kriteret e përcaktuara në Traktatin në mënyrë që të jenë në gjendje të pranojnë euron në kohën e duhur pas anëtarësimit. Deri atëherë, ato do të marrin pjesë në Bashkimin Ekonomik dhe Monetar si Shtet Anëtar i lejuar për mos-përdorimin e euros dhe do të trajtojnë normat e tyre të këmbimit si një çështje e interesit të përbashkët.

Acquis në fushën e politikës ekonomike dhe monetare përbëhet nga Titulli VIII (Art. 119 deri 144) të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFBE), dhe me legjislacionin përkatës zbatues.

Kërkesat e MSA-së

Detyrimet kryesore të Kosovës në kuadër të përafrimit të legjislacionit të saj me atë të BE-së rrjedhin nga neni 74 i MSA-së, gjithashtu neni 94 i MSA-së nënvizon se BE dhe Kosova do të lehtësojnë procesin e reformave ekonomike nëpërmjet bashkëpunimit për të përmirësuar të kuptuarit e bazave të ekonomive të tyre përkatëse si dhe formulimin dhe zbatimin e politikave ekonomike në ekonomitë e tregut.

Ky kapitull përshkruan zhvillimet e përgjithshme nga aspekti i politikës monetare dhe asaj ekonomike në kontekst të strategjisë dhe objektivave të caktuara nga Qeveria. Meqenëse Kosova përdor euron si valutë të vetën, të cilën që nga viti 2002 e ka adoptuar në mënyrë unilaterale, Kosova nuk ka politikë monetare, andaj fokusi i këtij kapitulli në rastin e Kosovës do të përqendrohet në seksionin mbi Politikën Ekonomike. Për më tepër, duke mos pasur mundësinë e shfrytëzimit të politikës monetare si alternativë zhvillimore, politikat ekonomike fitojnë një rëndësi edhe më të madhe. Kapitulli gjithashtu ndihmon në analizimin dhe arritjen e qëllimeve të institucioneve në kontekst të procesit të Stabilizim-Asociimit me BE-në, ku një ndër prioritetet është edhe sigurimi i stabilitetit makroekonomik.

Sipas *Raportit të KE-së për Kosovën – 2020*, rritja e pagave publike së bashku me remitancat thelbësore kontribuojnë në paga të larta rezervimi dhe ndalojnë zhvillimin e sektorit privat, i cili veqse po vuan nga konkurrenca e dobët në një kontekst ndërkombëtar. Pabarazitë mbeten të mëdha për shkak të një sektori të madh joformal dhe nivelit të lartë të pasivitetit, veçanërisht në mesin e grave. Kosova ka pasur stabilitet fiskal përgjatë vitit 2019, mirëpo rritja e shpenzimeve publike, sidomos për veteranët e luftës mbetet shqetësuese për qëndrueshmërinë fiskale dhe marrëdhëniet me institucionet financiare ndërkombëtare.

Politikat monetare

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK), pasardhëse e Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës, është subjekt juridik publik bazuar në nenet 11 dhe 140 të Kushtetutës dhe të dispozitave të këtij ligji, që ka autonomi administrative, financiare dhe menaxhuese.

Duke u bazuar në nenin 6 (pavarësia dhe autonomia) të Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, Banka Qendrore, anëtarët e organeve vendimmarrëse ose personeli i Bankës Qendrore, nuk do të marrin udhëzime nga ndonjë person apo subjekt tjetër, përfshirë subjektet qeveritare. Pavarësia dhe autonomia e Bankës Qendrore respektohet në çdo kohë dhe asnjë person apo subjekt nuk do të provojë të ndikojë anëtarët e organeve vendimmarrëse apo të personelit të Bankës Qendrore në realizimin e detyrave të tyre apo të ndërhyjë në aktivitetet e Bankës Qendrore. Për më tepër legjislacioni i Bankës Qendrore

parasheh që llogaritë, evidencat dhe pasqyrat financiare të Bankës Qendrore, të paktën një herë në vit, të auditohen në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit nga auditorë të jashtëm të pavarur ndërkombëtarë të cilët duhet të kenë reputacion të mirë dhe përvojë ndërkombëtare të njohur në auditimin e institucioneve të mëdha financiare ndërkombëtare.

Aktualisht Ligji për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës është pjesërisht në përputhje me *acquis*-në e Bashkimit Evropian. Megjithatë shumë dispozita janë të përafëruara, nevojiten përpjekje të tjera legjislative me qëllim përputhjen me parimet e përgjithshme të *acquis* së Bashkimit Evropian. Ligji nr. nr. -3/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, është hartuar me asistencën teknike nga FMN-ja në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare si dhe kornizën ligjore të Unionit Evropian.

Gjithashtu, me 10 mars 2017, Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin nr. 05/L -150 për Amendamentimin e Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, nëpërmjet të cilave ndryshime është bërë përmirësimi i mëtejshëm i kornizës qeverisëse dhe kontrolluese të BQK-së, dhe njëkohësisht është bërë harmonizimi i mëtejshëm i Ligjit për BQK-në me dispozitat që rregullojnë këtë çështje në kuadër të BE-së dhe praktikën ndërkombëtare.

Më 2002, Kosova në mënyrë të njëanshme ka adoptuar euron si valutë ligjore dhe që nga atëherë euro de facto u bë monedha e Kosovës, prandaj, politika monetare në Kosovë është shumë e kufizuar. Instrumenti i vetëm tradicional i politikës monetare i cili është plotësisht në dispozicion të Bankës Qendrore përbëhet nga kërkesat e rezervës bankare. Që nga fillimi i funksionimit të sektorit bankar të Kosovës, bankat kanë mbajtur vazhdimisht rezerva të tepërta; prandaj, gjatë kësaj periudhe nuk është konsideruar si e nevojshme të ndryshohet norma e rezervës së detyruar.

Përdorimi i euros e kufizon rolin e Bankës Qendrore në funksionin e saj si huadhënës i fundit (*LLR*) për të ofruar kredi afatshkurtra për bankat që potencialisht përballen me mungesa likuiditeti. Për këtë arsye, Qeveria e Kosovës dhe BQK-ja themeluan Asistencën e Likuiditetit Emergjent (*ELA*); një fond urgjence për të vepruar në rast të ndonjë mungese të likuiditetit në sektorin bankar. Përveç kësaj, Qeveria e Kosovës gjithashtu mban një nivel të duhur të bilanceve bankare si amortizues për të reaguar ndaj goditjeve të mundshme të ekonomisë me të cilat përballen.

Objektivat prioritarë afatmesme:

- Ngritja e kapaciteteve për administrimin e situatave emergjente në rast të krizave dhe zgjidhjen e bankave me probleme.

Politikat ekonomike

Në përgjithësi ekziston një konsensus mbi thelbin e politikave ekonomike me fokus të veçantë në orientimin e tyre drejt krijimit të kushteve për rritjen e qëndrueshme ekonomike dhe rrjedhimisht gjenerimin e vendeve të qëndrueshme të punës.

Qeveria e Kosovës ka si objektiv kryesor të politikës fiskale ruajtjen e stabilitetit makro-fiskal gjë që ndërlihet me obligimet që dalin nga MSA lidhur me ruajtjen e stabilitetit makro-fiskal dhe harmonizimin e politikave me ato të BE-së. Një tregues i përkushtimit të Qeverisë në këtë drejtim është adoptimi i rregullës fiskale e cila kufizon nivelin e deficitit të përgjithshëm në 2% të BPV-së. Qëllimi i krijimit të një mekanizmi të tillë fiskal ka qenë stabilizimi i nivelit të borxhit nën nivelin e kufizuar me ligj (40% e BPV-së). Mirëpo, për shkak të situatës së krijuar nga pandemia Covid-19, qeveria ka ndërruar rregullën fiskale duke e rritur deficitin si përqindje e BPV-së në 4.5%.

Ekziston një konsensus i gjerë për politika dhe reforma ekonomike të orientuara drejt tregut. Kjo reflektohet edhe në Programin e Qeverisë 2020-2023 ku nënvizohet se një nga parimet bazë të qeverisë është të promovojë zhvillim të hovshëm dhe qëndrueshëm ekonomik i mbështetur në potencialin njerëzor dhe pasuritë natyrore të Kosovës është boshti i programit qeverisëse. Vizioni i Qeverisë është rritja e mirëqenies, hapja e vendeve të reja të punës dhe zhdukja e varfërisë ekstreme në Kosovë. Për të arritur këto norma që tejkalojnë substancialisht mesataren e viteve të fundit, Qeveria do të fokusohet në zbatimin e reformave që kanë ndikim direkt në përmirësimin e ambientit ekonomik, fiskal dhe financiar.

Masat programore pritet të rezultojnë në rritje të aktivitetit ekonomik, sidomos në industrinë prodhuese, përpunuese dhe atë të shërbimeve, duke mbështetur zgjerimin e eksporteve, zvogëlimin e importeve dhe rrjedhimisht përmirësimin e bilancit tregtar të vendit. Paralelisht, Qeveria do të fokusojë resurset e veta në zbatimin e projekteve të mëdha zhvillimore, të cilat do të financohen përmes modaliteteve të ndryshme publiko-private. Zbatimi i këtyre projekteve përveç stimulimit afatmesëm, do të ndikojë në transformimin afatgjatë të strukturës ekonomike dhe në uljen e papunësisë.

Përgjatë mandatit, caqet programore të zhvillimit do të përkthehen në caqe vjetore të rritjes përmes Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve, planit vjetor të punës së Qeverisë, dhe buxheteve vjetore.

Korniza legjislative

Aktet ligjore/nënligjore në këtë nënkapitull janë:

- Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
- Ligji nr. 03/L-175 për borxhin publik;
- Ligji nr. 07/L-014 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit me nr 07/L-001 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020;
- Ligji nr. 04/L-008 Për Këshillin Ekonomiko-Social;
- Rregullorja nr. 01/2015 për punën e Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik të Kosovës.

Korniza e politikave

Programi i Qeverisë është dokumenti kryesor i cili përcakton orientimin dhe zhvillimin e politikave të Qeverisë dhe i cili paraqet bazën për vendosjen e politikave prioritare në KASh. Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës është dokument i natyrës politike dhe përfshin planet dhe zotimet e Qeverisë për periudhën afatmesme. Qeveria është e obliguar të nxjerrë një deklaratë të prioriteteve e cila shërben si bazë e politikave për përgatitjen e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve, Buxhetit dhe Planit Vjetor të Punës së Qeverisë. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve është mjeti përmes të cilit Qeveria përcakton kornizën e saj fiskale dhe shërben si dokument kryesor i planifikimit të politikave në Kosovë. Korniza fiskale përfshin planifikimet për të hyrat dhe shpenzimet për tri vitet e ardhshme; kufijtë e shpenzimit për të gjitha organizatat buxhetore që përcaktohen në bazë të prioriteteve të qeverisë, si dhe financimin e deficitit dhe nivelin e bilancit bankar.

Qeveria jonë mbetet e përkushtuar për ruajtjen e një mjedisi të qëndrueshëm makroekonomik dhe rritjen e mundshme dhe perspektivës afatgjatë të punësimit të Kosovës përmes; mbajtjes së deficitit fiskal dhe duke e bërë përbërjen e buxhetit me rritje të favorshme duke krijuar hapësirë për projekte të rëndësishme infrastrukturore (të kryera përmes mbështetjes nëpërmjet Marrëveshjes aktuale Stand By me FMN-në); rritjes së mëtejshme të kornizës rregullative dhe mbikëqyrëse bankare dhe reduktimit të pengesave të mbetura të huadhënies bankare për sektorin prodhues; dhe përmirësimin të mjedisit të biznesit të Kosovës duke përmirësuar sistemin e prokurimit publik.

Për të siguruar qëndrueshmëri të financave publike, si një ekonomi e vogël e hapur, Kosova ka arritur të përjetojë rritje ekonomike pozitive kryesisht nga konsumi dhe investimet, një buxhet i cili është financuar kryesisht nga remitencat dhe donacionet perëndimore. Niveli i borxhit të qeverisë mbetet më i ulëti në rajon dhe gjithashtu shumë më poshtë nivelit maksimal të lejuar sipas ligjit për "Menaxhimin e Financave Publike". Një nga faktorët kryesorë që kontribuojnë në nivel të tillë të borxhit të ulët është historia e tij e shkurtër e lëshimit të borxhit nga viti 2012.

Korniza institucionale

Korniza institucionale për politika ekonomike:

- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve: departamentet përkatëse për politika ekonomike, fiskale, thesari, buxheti etj.;
- Ministrinë e tjera që kanë në portofolin e tyre politika të caktuara ekonomike.

Korniza institucionale për koordinim të politikave:

- Zyra e Kryeministrit - Zyra për planifikim Strategjik dhe departamentet për integrim evropian;

- Ministritë e linjës – Departamentet për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave.

Përveç kësaj strukture ekzistuese për hartimin e politikave, Qeveria ka themeluar edhe këshillat të cilat kanë karakter konsultativ siç janë:

- Këshillin Kombëtar për Investime: i cili ka për qëllim shqyrtimin më të gjerë të prioriteteve, priorizimit më të mirë të investimeve në sektorët me aftësi konkurruese. Në këtë format Këshilli do të përcaktohen investimet afatgjate të cilat do të ndikojnë shkallën e zhvillimit të vendit.
- Këshilli ekonomik dhe social: i cili fokusohet në vendosjen dhe zhvillimin e dialogut social në Kosovë për të punësuarit dhe punëdhënësit, për çështje të rëndësishme të veçantë, të cilat kanë të bëjnë me realizimin e të drejtave të tyre ekonomike, sociale dhe profesionale, që realizohen, përmes zgjidhjeve të kontesteve me marrëveshje dypalëshe apo trepalëshe.
- Këshilli Kombëtar për Zhvillim Ekonomik të Kosovës: i cili në bashkëpunim me përfaqësuesit e sektorit të biznesit ka për qëllim shqyrtimin e politikave ekonomike për të adresuar sfidat zhvillimore të vendit.

Objektivat prioritarë afatmesme

Në planin afatmesëm prioritetet kryesore **zbatuese** parashikohet të realizohen janë:

- Politika fiskale të favorshme përfshirë, pushimet tatimore, dhe mbledhja e TVSH-së në brendi;
- Politika tregtare konkurruese dhe përmirësimi i mjedisit afarist përfshirë hapja e tregut, funksionalizimi i zonave të tregtisë së lirë, luftim i ekonomisë joformale, eliminimi i barrierave ligjore dhe zvogëlimi i burokracisë;
- Përkrahja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, përmes rritjes të fondit për garantimin e kredive dhe lehtësirave tjera administrative, përfshirë, ndër të tjera, ndërmarrjen e masave afirmative për ndërmarrjet e udhëhequra nga gratë.

3.18. Kapitulli 18 i acquis-së: Statistikat

Acquis në fushën e statistikave kërkon ekzistencën e një infrastrukture statistikore të bazuar në parimet si paanshmëria, besueshmëria, transparenca, konfidencialiteti i të dhënave individuale dhe shpërndarja e statistikave zyrtare. Institutet Kombëtare Statistikore veprojnë si pika referuese për metodologjinë, prodhimin dhe shpërndarjen e informacionit statistikor. Acquis përfshin metodologjinë, klasifikimet dhe procedurat për mbledhjen e të dhënave në fusha të ndryshme të tilla si statistikatat makro-ekonomike dhe të çmimeve, statistikatat demografike dhe sociale, statistikatat rajonale si dhe statistikatat e biznesit, transportit, tregtisë së jashtme, bujqësisë, mjedisit dhe të shkencës dhe teknologjisë. Nuk është i nevojshëm asnjë transpozim në legjislacionin kombëtar pasi që shumica e acquis merr formën e rregulloreve.

Kërkesat e MSA-së

Kapitulli i statistikave është i rregulluar me nenin 74 dhe 95 të marrëveshjes. MSA parasheh zhvillimin e një sistemi statistikor efikas dhe të qëndrueshëm në Kosovë të aftë për të siguruar të dhëna të besueshme, objektive dhe të sakta, të krahasueshme me statistikatat Evropiane, që nevojiten për të planifikuar dhe monitoruar procesin e tranzicionit dhe reformës në Kosovë. Ky sistem duhet gjithashtu t'i mundësojë Agjencisë së Statistikave të Kosovës të përmbush më mirë nevojat e shfrytëzuesve (përdoruesve) (si të administratës publike ashtu edhe të sektorit privat). Sistemi statistikor duhet të jetë në përputhje me parimet e Kodit Statistikor Evropian të Praktikës dhe parimeve themelore të statistikave nga OKB, citatet e drejtës Statistikore Evropiane, dhe duhet të zhvillohet në drejtim të zbatimit të acquis-së në këtë fushë.

Kërkesat nga mekanizmat e tjerë të aderimit në BE

Raporti i KE-së për Kosovën – 2020 konstaton se Kosova ka pak përgatitje në fushën e statistikave. Është arritur përparim i mirë në adresimin e disa prej rekomandimeve të vitit të kaluar, në veçanti me ndryshimin dhe miratimin e Ligjit për statistikatat zyrtare dhe përmirësimin e metodologjisë për mbledhjen e të dhënave. Komunikimi në mes institucioneve statistikore u përmirësua pak por koordinimi në nivelin teknik dhe përdorimi i burimeve të të dhënave administrative të disponueshme duhet të azhurnohen. Përafrimi i statistikave sektoriale me standardet evropiane pa shumë pak përmirësim gjatë periudhës raportuese. Pati

gjithashtu një rritje shumë modeste të produkteve statistikore. Raporti i KE-se, në pjesën mbi politikat sociale, thekson se përgatitjet për regjistrimin e ardhshëm të popullsisë në vitin 2021 janë penguar nga burimet e pamjaftueshme financiare dhe mbulimi territorial. Ende duhen përpjekje të konsiderueshme posaçërisht për të siguruar përafrimin e statistikave makro-ekonomike, afariste dhe mjedisore me standardet evropiane.

Konkluzionet e dala nga Nënkomiteti i vitit 2020 kërkojnë që të zbatohen ndryshimet e Ligjit për Statistika Zyrtare dhe të miratohen ndryshimet ligjore për regjistrimin e popullsisë. Gjithashtu, potencohet se duhet të vazhdojë zbatimi dhe zhvillimi i statistikave sektoriale. ASK të zbatojë planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Eurostat-it dhe të rritë rolin koordinues në sistemin kombëtar statistikor dhe të sigurohet që Agjencia të ketë një rol aktiv në krijimin dhe modifikimin e të dhënave administrative që përdoren për statistikat zyrtare. ASK duhet të vazhdojë harmonizimin me Rregulloren 223/2009 për Statistikat Evropiane.

Gjendja aktuale

Korniza legjislative dhe ajo e politikave

Korniza legjislative në fushën e statistikave zyrtare në Republikën e Kosovës përbëhet nga Ligji nr. 06/L-058 për amendamentimin e Ligjit nr. 04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës E Kosovës i cili qartëson parimet themelore për të qeverisur Statistikat Zyrtare, ky ligj ishte miratuar në janar të vitit 2019. Disa nga këto parime janë rëndësia, paanshmëria, besueshmëria, efektiviteti shpenzues, pavarësia profesionale, dhe transparenca. Veprimtaria në fushën e statistikave zyrtare në Republikën e Kosovës rregullohet në bazë të Ligjit për Statistikat Zyrtare.

Këto akte normative kanë transpozuar Rregulloren e Parlamentit Evropian nr. 223/2009 e cila trajton statistikat në nivel të BE, duke respektuar dispozitat e Ligjit e statistikave zyrtare mbi konfidencialitetin e të dhënave, parimet fundamentale të statistikave zyrtare (E/2013/24 (2013/21)).

Me qëllim të zbatimit të Ligjit të lartcekur, Qeveria e Kosovës ka nxjerre edhe akte nënligjore përkatëse:

- UA për ruajtjen e lëndës statistikore;
- UA për përpunime të veçanta statistikore;
- Rregullorja nr. 11/2013 për zbatimin e standardit për klasifikimin e veprimtarive ekonomike në versionin NACE-Rev. 2, e cila është në përputhje me Rregulloren nr. 1893/2006 të Parlamentit Evropian.

Për projektin e regjistrimit të popullsisë 2021, koncept dokumenti është përgatitur dhe miratuar në Qeveri. Është themeluar grupi punues për përgatitjen e Draft Ligjit për Regjistrimin e Popullsisë, të Ekonomive Familjare dhe të Banesave 2021 i cili do të jetë në harmoni me rekomandimet e Konferencës së Statisticienetëve Evropianë për regjistrimet e popullsisë dhe banesave 2021, përgatitur në bashkëpunim me Eurostatin.

Korniza legjislative që ndërlihet edhe me fushën e statistikave konsiston në këto akte ligjore:

- Ligji nr. 03/l-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (gazeta zyrtare e republikës së Kosovës/Prishtinë: viti v/nr. 77/16 gusht 2010);
- Rregullore mbi statistikat e bilancit të pagesave dhe pozicionit të investimeve ndërkombëtare;
- Rregullore mbi statistikat monetare-financiare dhe llogaritë financiare;
- Ligji nr. 03/l-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 03/l- 221, ligjin nr. 04/l-116 dhe me Ligjin nr. 04/l-194;
- Rregullore MF-nr. 01/2017 për pasqyrat financiare vjetore të organizatave buxhetore;
- Ligji nr. 05/L-020 mbi Barazinë Gjinore, i cili kërkon mbledhjen, mbajtjen, dhe procesimin e të gjitha të dhënave zyrtare të ndara në baza gjinore.

Korniza e politikave

Një nga instrumentet e nevojshme për koordinimin e sistemit statistikor është programi 5-vjeçar i statistikave zyrtare. ASK vazhdon të zbatoj programin e statistikave zyrtare për vitet 2018-2022. Për më

shumë, gjatë fazës përgatitore të programit janë konsultuar edhe përdoruesit kryesorë të statistikave zyrtare. Ky Program është miratuar nga Qeveria e Kosovës.

ASK është duke zbatuar planin vjetor për vitin 2020 dhe ka përgatitur planin vjetor për Statistikat Zyrtare për vitin 2021. Ky plan është miratuar nga Qeveria më 15 qershor 2020. Programi vjetor si një instrument planifikimi i jep përparësi aktiviteteve nga programi afatmesëm duke marrë parasysh burimet në dispozicion. Plani Vjetor 2020 synon të arrijë objektivat si shfrytëzimi më i mirë i burimeve nëpërmjet efikasitetit organizativ, shkurtimin e afateve kohore, me qëllim rritjen e numrit të produkteve statistikore. Vendosja e prioritetëve është bërë duke synuar arritjen e efikasitetit, produktivitetit, rritjen e cilësisë në sistemin statistikor dhe përmbushjen e kërkesave të përdoruesve dhe standardeve të BE-së.

Pas publikimit të raportit "Peer Review", ASK ka hartuar një plan për zbatimin e rekomandimeve nga raporti i bërë nga ekipi i ekspertëve. Ky plan është finalizuar në koordinim të plotë me Eurostat. Plani për zbatimin e rekomandimeve është publikuar në faqen zyrtare të ASK-së dhe Eurostat-it. Raporti i fundit për zbatimin e rekomandimeve nga Peer review është dërguar në vitin e kaluar (2019), ndërsa për vitin 2020, ASK është në pritje të kërkesës nga Eurostat-it për të freskuar raportin me të fundit për zbatimin e rekomandimeve për vitin 2020. Gjithashtu është bërë identifikimi i gjendjes së tanishme lidhur me indikatorët e SDG-ve 2030, për pjesën e ASK-së dhe procesi është në vazhdim.

Korniza institucionale

Zbatimi i angazhimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi në fushën e statistikave është nën përgjegjësinë e këtyre institucioneve, të cilat janë pjesë e sistemit Shtetëror Statistikor:

- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve/Agjencia e Statistikave të Kosovës;
- Banka Qendrore e Republikës së Kosovës;
- Organet e tjera të autorizuara nga ASK.

Agjencia e Statistikave të Kosovës, sipas Ligjit të Statistikave Zyrtare, koordinon sistemin shtetëror statistikor dhe është përgjegjës për harmonizimin e të dhënave zyrtare statistikore. ASK, Gjithashtu ka detyrë kryesore të identifikojë nevojat e përdoruesve dhe t'i filtrojë ata për nga rëndësia. Më pastaj, ata transformojnë nevojat përkatëse të përdoruesve në koncepte të matshme për të lehtësuar mbledhjen e të dhënave dhe shpërndarjen e tyre. ASK është koordinator kryesor në mes të prodhuesve statistikor dhe siguron koherencën dhe pajtueshmërinë e sistemit statistikor me standardet e miratuara. Momentalisht ASK është fokusuar kryesisht në mbledhjen e informacionit nga sektori real dhe zhvillimin e sa më shumë statistikave që janë të mundura në lidhje me të.

ASK është përgjegjëse për prodhimin e produkteve statistikore që japin informacione mbi aspektet ekonomike, sociale, popullsisë, bujqësisë, mjedisit, energjisë, etj. Produktet statistikore janë të prodhuara në intervale të ndryshme kohore. Produkti më i shpeshtë IÇK publikohet në bazë mujore. ASK është përgjegjëse për të siguruar informacione për Bruto Produktin Vendor, buxhetin e njëjësive ekonomike familjare, punësimin dhe strukturën e bujqësisë. Këto informata vihen në dispozicion të përdoruesve çdo vit. Në fund të çdo viti ASK para-shpall publikimin e kalendarit që informon për dorëzimin e produkteve statistikore gjatë vitit të ardhshëm.

ASK ka përgjegjësi të krijojë, menaxhojë, mirëmbajë dhe freskojë:

- Regjistrin e popullsisë;
- Regjistrin e ekonomive familjare;
- Regjistrin e shtëpive dhe banesave;
- Regjistrin statistikor të bizneseve;
- Regjistrin e njëjësive hapësinore; dhe
- Regjistrin ekonomik bujqësorë dhe Regjistrat të tjerë në pajtim me planet dhe vendimet.

ASK është përgjegjëse që metodologjitë statistikore të përdorura në Kosovë të jenë afër me ato të përdorura në vendet e tjera në rajon dhe Evropë. Që të jetë në gjendje të zbatojë këto objektiva ASK në mënyrë të

vazhdueshme përditëson procedurat në përdorimin e nomenklaturave, mbledhjen e të dhënave, përpunimin e të dhënave dhe shpërndarjen e të dhënave.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, në aspektin e përgjegjësive statistikore, vepron në bazë të Ligjit për Bankën Qendrore në Republikën e Kosovës dhe Ligjit për Statistikat Zyrtare në Republikën e Kosovës.

Përgjegjësitë statistikore të BQK-së janë të rregulluara edhe me Rregulloren mbi statistikave monetare-financiare dhe Llogaritë Financiare dhe Rregulloren mbi Statistikat e Bilancit të Pagesave dhe Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare.

Statistikat në përgjegjësinë e drejtpërdrejtë të BQK-së janë statistikave për sektorin monetarë e financiarë (SMF) dhe statistikave të jashtëm (SSJ). Këto statistika janë në përputhje me standarde të zhvilluara nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Qendrore Evropiane, Eurostat, etj. SMF përfshijnë të dhënat për bankën qendrore, bankat e nivelit të dytë, kompanitë e sigurimit, fondet e pensione, dhe institucionet ndihmese financiare. SSJ përfshijnë statistikave të bilancit të pagesave, statistikave në shërbime ndërkombëtare, pozicionit të investimeve ndërkombëtare (PIN), investimeve direkte, si dhe statistikave të borxhit të jashtëm. Në përgjithësi Kosova ka përmbushur detyrimet që rrjedhin nga *acquis* për SMF dhe SSJ. Megjithatë, BQK duhet të zhvilloi kornizën për përpilim të statistikave të Llogaritë Financiare.

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka për mision të bëjë parashikime dhe analiza për të mbështetur procesin e vendimmarrjes në lidhje me formulimin e politikave ekonomike. Përmbushja e këtij misioni të MFPT-së është i ndërlidhur me detyrat dhe përgjegjësitë e Thesarit dhe Departamentit të politikave ekonomike, publike dhe bashkëpunimi ndërkombëtar financiar (DPEPBNF). Statistikat për sektorin fiskal dhe ato të borxhit publik përpilohen dhe publikohen nga Thesari në kuadër të MFPT-së. MFPT është përgjegjëse për të ofruar informata për numrin e punëkërkuësve, numrin e shërbimeve që ofron, përfitime nga papunësia, subvencione për familjet në nevojë.

Organet e tjera të autorizuar nga ASK: Ekzistojnë edhe ofruet tjerë të informacionit dytësor që përdoren për përpilimin e statistikave zyrtare në Kosovë. Ministria e Arsimit dhe Shkencës është përgjegjëse për të regjistruar numrin e shkollave, nxënësve, studenteve dhe mësimdhënësve në çdo nivel arsimor. Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti i Shëndetit Publik janë përgjegjëse për regjistrimin e numrit të institucioneve shëndetësore, pacientëve, mjekëve dhe sëmundjeve.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është e ngarkuar për të siguruar të dhënat administrative siç janë: subvencionet për fermerët dhe të dhënat e tjera administrative. Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit është ngarkuar të hartojë Bilancin e Energjisë, sipas kërkesave të BE, si dhe të grumbullojë të dhëna mbi burimet natyrore në Kosovë dhe biodiversitetin, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, përkatësisht ARBK, ofron të dhëna administrative mbi bizneset e regjistruara. Të gjitha këto të dhëna përdoren nga ASK në periudha të caktuara për të informuar publikun për gjendjen në këto fusha përkatëse. Megjithatë, ASK përpillet për të kombinuar këto informacione me burime tjera që vijnë nga anketimet e kryera.

Kapacitetet administrative - për zhvillimin e kapaciteteve, ASK ka punësuar 10 zyrtarë gjatë vitit 2019, të cilat janë ndarë në statistikave të prodhimit me theks të veçantë në Statistikat Ekonomike dhe departamentet tjera prodhuese. Megjithatë deri në momentin e raportimit në ASK, 14 pozita janë të lira si rezultat i procesit natyror të stafit. (dalje në pension). Sfidë vazhdon të mbetet rekrutimi me staf të ri për shkak të kornizës ligjore në fuqi. Departamenti i Llogaritë Kombëtare tashmë është plotësisht funksional dhe ushtron përgjegjësitë konform planit dhe përshkrimin të detyrave të punës. Stafi i ASK-së ka marrë pjesë në një sërë trajnimesh brenda dhe jashtë vendit. Është rritur numri i trajnimeve dhe kurseve të ndryshme për stafin e ASK-së të siguruar nga KE dhe Eurostat (pjesëmarrja në forume të ndryshme trajnuese në afat të shkurtër dhe të gjatë).

Sa i përket zbatimit në praktikë në fushën e statistikave, janë realizuar aktivitete të cilat burojnë nga Ligji mbi statistikave zyrtare, programi 5 vjeçar i statistikave zyrtare, Plani vjetor i punës, procesi i integrimi të evropiane si dhe në bazë të kërkesave raporteve të ndryshme qoftë të brendshme apo ndërkombëtare.

Sa u përket *statistikave sektoriale*, ASK ka vazhduar të prodhojë dhe zhvillojë më tej statistikat ekonomike, statistikat bujqësore, statistikat sociale dhe aktivitetet metodologjike dhe IT.

Sa i përket teknologjisë për futjen e të dhënave, politikat e ASK kanë evoluar duke shkuar drejt modernizimit të mbledhjes së të dhënave, duke shkurtuar kohën në mbledhjen e të dhënave dhe me cilësi më të lartë, integrimin e këtyre metodave të reja për të forcuar programet statistikore të mbledhjes së të dhënave të ASK-së si dhe duke lehtësuar përpunimin më të shpejtë dhe të automatizuar të të dhënave, eliminimi i pyetësorë të letrës si dhe eliminimi i nevojës për staf të dedikuar për futjen e të dhënave, kosto më e lirë etj. Mbi 80% e të dhënave mblidhen përmes metodës CAPI dhe CAWI.

Sistemi i me metadatave SIMS (Single Integrated Metadata Structure) është në zhvillim e sipër sipas standardeve të Eurostat. Përmes këtij sistemi baza e njëjtë përdoret për shpërndarjen e metadatave në ueb faqe të ASK dhe të njëjtat mund të gjenerohen në formatin SDMX për transmetim në Eurostat përmes platformës së tyre Metadata Handler.

SIMS do të përdoren edhe për institucionet tjera si MFPT dhe BQK.

Në përputhje me rekomandimet e Eurostat-it vazhdon avancimi i mëtejme i platformës ASKdata, e krijuar për menaxhimin dhe shpërndarjen së të dhënave online për të gjithë shfrytëzuesit.

ASK prodhon llogaritë kombëtare çdo tre muaj dhe çdo vit (sipas qasjes së prodhimit dhe shpenzimeve, me çmime aktuale dhe konstante). Afatet kohore për publikimin e rezultateve të PBB-së janë shkurtuar, që do të thotë se për çdo tremujor të Produktit të Brendshëm Bruto, publikimi tremujor është arritur sipas standardit Eurostat (t+90 ditë), duke përdorur metodologjinë e re të Llogarive Evropiane të Sistemit (ESA 2010). ASK, në planin e saj operativ për vitin 2021 planifikon edhe përpilimin e llogarive kombëtare me qasjen e të ardhurave. ASK ka shkurtuar afatin vjetor të publikimit të PBB sipas ESA 2010. Gjithashtu, llogaritë qeveritare publikohen në baza vjetore dhe tremujore. Të dhënat në Eurostat transmetohen rregullisht (pas publikimit të rezultateve), duke përdorur formatin SDMX. Numri i tabelave rritet gradualisht.

Për *statistikat e tregtisë së jashtme*, të dhënat për eksportin dhe importin e mallrave publikohen në baza të rregullta mujore dhe vjetore. Botimet e rregullta mujore publikohen me T + 24 ditë. Publikimi vjetor bazohet në T + 168 ditë. Këto të dhëna dërgohen rregullisht në Eurostat përmes EDAMIS.

Për *Statistikat e Energjisë*, ASK ka shkurtuar afatin për publikimin e rezultateve të bilancit energjetik dhe ka rritur numrin e produkteve të dërguara në Eurostat. Publikimi tremujor i statistikave të energjisë sipas standardeve (T + 49 ditë). Gjithashtu, afati i fundit për publikimin e Bilancit Vjetor të Energjisë është zvogëluar dhe publikimi për vitin 2019 është bërë në qershor 2020, ndërsa bilianci i Energjisë për TM1 2021 është bërë në Maj 2021.

Sa u përket *statistikave e ndërmarrjeve*, afatet për botimet e rregullta janë shkurtuar dhe numri i produkteve të dërguara në EUROSTAT është rritur.

Sa u përket *statistikave hoteliere dhe turizmit*, statistikat e hotelerisë për TM2 2020 janë publikuar në shtator 2020. Modifikimet e pyetësorëve u harmonizuan sipas rekomandimeve dhe kërkesave të EUROSTAT për statistikat afatshkurtra të shitjes me pakicë, statistikat e industrisë dhe statistikat e transportit dhe telekomunikacionit. Një Memorandum Mirëkuptimi me Agjencinë e Regjistrimit Civil u nënshkrua në të kaluarën lidhur me qasjen në të dhënat për automjetet e regjistruara në Kosovë.

Në *statistikat sociale*, Agjencia e Statistikave të Kosovës, për herë të parë ka publikuar rezultatet e anketës mbi të ardhurat dhe kushtet e jetesës (EU-SILC) 2018, në gusht 2020. Deri në vitin 2017 informacioni për treguesit kryesorë të gjendjes së jetesës, mirëqenies, varfërisë dhe treguesve të tjerë është matur nga Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare. Anketa e SILC do t'i mundësojë ASK-së të përpilojë statistika mbi të ardhurat dhe kushtet e jetesës në familje dhe individë, të cilat janë të krahasueshme me statistikat e tjera të prodhuara në rajon dhe më gjerë. Ky hulumtim është një burim referimi për t'i ofruar Eurostat-it statistika krahasuese mbi shpërndarjen e të ardhurave dhe përfshirjen sociale në nivel evropian për Republikën e Kosovës. Gjithashtu, me rëndësi të veçantë, këto të dhëna do të përdoren për të monitoruar strategjinë e

Evropës 2020 me fokus në uljen e varfërisë si qëllimin parësor. Anketa e SILC do të vazhdojë të zhvillohet çdo vit si anketë e rregullt në ASK. Është në proces pastrimi i bazës së të dhënave të SILC 2019, ndërkohë që rezultatet pritet të publikohen gjatë muajit mars 2021. Poashtu ka përfunduar grumbullimi i të dhënave të SILC 2020.

ASK ka vazhduar me zhvillimin e Anketës mbi Përdorimin e TIK për vitin 2019. Anketa e TIK është integruar brenda programit statistikor të ASK-së, dhe ajo për 2020 është zhvilluar përmes metodës CAPI. Rezultatet e anketës TIK 2020 do të publikohen në dhjetor 2020. Rezultatet e anketës TIK 2021 do të publikohen në dhjetor 2021.

Publikimi tremujor i Anketës së Fuqisë Punëtore (AFP) vazhdon të publikohet sipas standardit Eurostat (T + 90 ditë), duke përdorur metodologjinë e re të Anketës Evropiane të Forcave të Punës dhe gjithashtu duke reduktuar afatin për publikimin tremujorë dhe vjetor të të dhënave të AFP-së. ASK gjithashtu ka përmirësuar mjetet për mbledhjen e të dhënave me qëllim të minimizimit të gabimeve gjatë grumbullimit të të dhënave në terren përmes monitorimit të vazhdueshëm dhe vlerësimit sistematik të cilësisë së punës në terren, përmirësimit të mekanizmave të auditimit të cilësisë gjatë dhe pas punës në terren, përgatitjen e një manuali për intervistuesit etj. ASK ka vazhduar dërgimin e mikro të dhënave të AFP-së në Eurostat.

ASK ka filluar të aplikojë ISCO 08 në AFP nga janar 2018 dhe në të ardhmen e afërt planifikon të aplikojë edhe ISCED 2011. ASK ka përgatitur modulën për aksidentet në punë i cili do t'i shtohet AFP-së në TM4 2020. ASK ka bërë rishikimin e të dhënave për "Nivelin e pagave në Kosovë 2012-2019 dhe ka publikuar Nivelin e Pagave për vitin 2020.

Sa u përket *statistikave të popullsisë*, janë duke u zhvilluar përgatitjet për Regjistrimin e Popullsisë Ekonomive familjare dhe banesave sipas rekomandimeve Ndërkombëtare për regjistrime dhe nevojave të vendit për nxjerrjen e indikatorëve socio-ekonomik.

Është përgatitur Harta rrugore për Regjistrimin e Popullsisë Ekonomive familjare dhe banesave 2021. Është duke u përgatitur Strategjia e regjistrimit që pritet të përfundojë së shpejti. Plani i punës dhe buxheti është ndarë sipas aktiviteteve dhe viteve.

Koncepti i dokumentit është miratuar nga Qeveria në muajin shtator 2020 dhe në fillim të muajit tetor 2020 është formuar Grupi punues për amendamentimin e Ligjit mbi Regjistrimin. Nga 15 shtator i deri me 14 tetor 2020 është realizuar Pilot Regjistrimi i popullsisë. Grupet punuese janë duke punuar në përgatitjen e aktiviteteve dhe dokumenteve të rëndësishme për Regjistrimin e Popullsisë.

Janë publikuar të dhënat Vlerësimi i popullsisë, Statistikat e lindjeve 2019, Statistikat e vdekjeve 2019, Statistikat e kurorëzimeve. Janë publikuar të dhënat finale nga MICS Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë e njohur si anketa MICS. Këto të dhëna janë të rëndësishme për plotësimin e indikatorëve të SDG-ve.

Në realizimin e këtij projekti (MICS6) kanë bashkëpunuar ASK dhe UNICEF në bazë të Memorandumit të nënshkruar në vitin 2019.

Sa i përket statistikave të bujqësisë janë publikuar të dhënat e anketës së ekonomive bujqësore 2019 (të dhënat për sipërfaqet, kulturat bujqësore, prodhimin, ujitjen, blegtorin sipas llojeve, prodhimin blegtoral etj.) Në statistikën agromonetare janë publikuar në baza të rregullta sipas metodologjisë së Eurostatit Indekset Tremujore dhe Vjetore të çmimeve të prodhimeve dhe inputeve në bujqësi. Gjithashtu janë publikuar të dhënat e vjetore të llogarive ekonomike në bujqësi 2019. Të gjitha këto të dhëna të publikuara janë dërguar në Eurostat.

Sa i përket statistikave të mjedisit nga burimet administrative dhe nga burimet tjera janë prodhuar dhe publikuar të statistikave të ujërave në Kosovë 2018 dhe 2019. Këto të dhëna janë dërguar në Eurostat. Janë publikuar gjithashtu rregullisht në baza vjetore rezultatet e Anketës së Mbeturinave Industriale 2019. Është në proces të punës përgatitja për publikim të rezultateve të Ankesës së Mbeturinave Industriale dhe rezultatet e anketës së mbeturinave Komunale.

Sa u përket statistikave të Bankës Qendrore të Kosovës, BQK ka vazhduar punën e saj të rregullt në mbledhjen e të dhënave, prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave monetare dhe financiare (MFS) dhe statistikave të sektorit të jashtëm (ESS). MFS dhe ESS publikohen rregullisht në ueb-faqe të BQK; dhe gjithashtu u shpërndahet organizatave ndërkombëtare (përfshirë Eurostat-in, Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN), Bankën Botërore). Sa i përket përmirësimit të sistemit të mbledhjes së të dhënave, BQK ka filluar procesin e zhvillimit të një platforme raportimi online për mbledhjen, përpunimin dhe shpërndarjen e informacionit statistikor nga korporatat jo-financiare. Përveç kësaj, janë bërë përpjekje për përmirësimin e cilësisë së të dhënave me optimizimin e sistemit të prodhimin dhe mbledhjen e informacionit të ri.

Statistikat e bilancit të pagesave, pozicionit të investimeve ndërkombëtare, të tregtisë ndërkombëtare në shërbime dhe ato të investimeve direkte i dërgohen rregullisht Eurostatit, dhe janë në harmoni me kërkesat e *acquis*.

Statistikave monetare financiare, përpilohen në përputhje me standardet e fundit ndërkombëtare. Përveç të dhënave për fondet pensionale, të gjitha statistikave të tjera financiare publikohen në baza mujore me një afat 25 ditë pas përfundimit të muajit referues. Të dhënat janë mjaft të detajuara dhe kualiteti i statistikave të publikuara është i mirë. SMF publikohen kryesisht në faqen e BQK-së dhe një pjesë e konsiderueshme e tyre dërgohen për publikim në Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Statistikat e sektorit të jashtëm janë në harmoni me *acquis* të BE-së. Pasqyra e bilancit të pagesave publikohet në baza mujore në faqen e BQK-së, kurse në Eurostat dërgohet në baza tremujore. Statistikat për pozicionin e investimeve ndërkombëtare (PIN) dërgohen në Eurostat në bazë tremujore, kurse statistikave të shërbimeve ndërkombëtare dhe ato për investimet direkte dërgohen në baza vjetore, konform kërkesave raportuese nga Eurostat.

Sa u përket statistikave të llogarive financiare, ato ende nuk janë duke u përpiluar në Kosovë. BQK ka ndërmarrë disa aktivitete për të filluar këtë vit me ndërtimin e kornizës për përpilimin e statistikave të llogarive financiare. Fillimisht, është duke u bërë rekrutimi i stafit. Gjithashtu, departamenti i statistikës BQK-së ka bërë një analizë të dhënave burimore që do të përdoren për përpilimin e statistikave të llogarive financiare. Në përgjithësi, të dhënat për sektorin financiar dhe sektorin qeveritarë janë adekuate; mirëpo mangësi ka për të dhënat e sektorit të korporatave jofinanciare dhe ekonomive familjare.

Mbështetja e donatorëve

Sistemi Statistikor i Kosovës është përkrahur dhe vazhdon të përkrahët në mënyrë nga donatorë të ndryshëm në ngritjen e kapaciteteve teknike dhe profesionale. Përveç projekteve me qasje shumë përfituese (në nivel rajonal) ASK dhe sistemi statistikor përkrahët edhe në formë kombëtare. Donatorët kryesor janë: KE, përkatësisht Eurostat, pasuar nga SIDA, BB, FMN, UNICEF, UNFPA, Norvegjia etj. Për periudhën 2019-2022 sistemi statistikor përkrahët nga KE. Projekti i regjistrimit të popullsisë 2021 është në konsultim me donatore por deri në momentin e raportimit nuk ka zotime nga donatorët me përjashtim të zyrës së BE-se prej 0.5 milionë euro, për proceset pas fazës së regjistrimit në terren, kryesisht me procesin e Anketës post regjistruese (koordinimi është në proces).

ASK është duke u përkrahur nga projekti i Qeverisë së Norvegjisë, qëllimi i këtij projekti është të mbështesë administratën publike të Kosovës në zbatimin e MSA-së dhe rritjen e gatishmërisë për anëtarësim në BE në disa kapituj përfshirë statistikave. Ky projekt do të forcojë kapacitetet institucionale të administratës publike të Kosovës, specifikisht në kapitullin Statistikat përmes ofrimit të trajnimeve të specializuara për përmbajtjen e kërkesave dhe kërkesave që rrjedhin nga BE, transpozimin e akteve të *acquis* në legjislacionin kombëtar, si dhe në reformat e politikave përkatëse.

Përveç projekteve në nivel kombëtar, ASK është duke u përkrahur nga Eurostat edhe përmes formave të pilot projekteve me fokus ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe teknike të ASK-së.

MB IPA 2015 (*Multi-beneficiary Statistical Cooperation Programme*) me këto projekte:

- Financat qeveritare;
- Metodologjia e llogarive kombëtare;

- Llogaritë sektoriale;
- Programi i transicionit, të llogarive kombëtare vjetore, llogarive kombëtare tremujore dhe raportimi kualitativ;
- Procedurat e mosbalancimeve makroekonomike (PIM).
- Llogarit rajonale
- Përpilimi dhe publikimi i tabelave ofruese-përdoruese (SUT)
- Statistikat e bujqësisë (Regjistrimi i bujqësisë apo Anketa strukturore e fermave); statistikat vjetore të kulturave bujqësore bimore dhe statistikat mbi kulturat e përhershme bimore (anketa e pemëtarisë, anketa vreshtarisë); statistikat e prodhimit të lektorale (statistikat mujore e vjetore të qumështit, mishit dhe vezëve);
- Llogaritjet mjedisore.

IPA 2017

- Menaxhimi Cilësisë Statistikore;
- Zhvillimi i Sistemit të Metadatave; Me përkrahjen e Bankës Botërore, ASK ka organizuar anketat e ekonomisë së pa-vrojtuar në katër aktivitete (biznese). Rezultatet e këtyre anketave do të përfshihen në llogari kombëtare për periudhën 2008-2020, në baza vjetore dhe tremujore, me çmime aktuale dhe çmime konstante.
- Ndërsa me përkrahjen e Eurostatit ka vazhduar me vlerësimin e ekonomisë joformale në fusha tjera, siç janë: shëndetësia, trafikimi i drogës, etj.
- Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK);
- Pariteti i Fuqisë Blerëse (PFB);
- Regjistri Statistikor i Bizneseve,
- Statistikat afatshkurtra të ndërmarrjeve: zbatimin e standardeve dhe udhëzuesve të sistemit evropian të statistikave,
- Statistikat e transporti: për udhëtarë dhe mallra,
- Teknologjia e informimit dhe komunikimit – përdorimi në biznese (e përealizuar në mungesë të resurseve njerëzore) dhe
- Statistikat e energjisë.

Ne bashkëpunim me Bankën Botërore jemi duke e zhvilluar anketën për produktivitetin në ndërmarrje.

- Përkrahja ka vazhduar edhe në fusha e tjera strategjike me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar si p. sh. strategjia, SDGs 2030, Competitiveness Outlook 2021etj

Objektivat prioritarë afatmesme:

- Përgatitjet dhe mbajtja e regjistrimit të bujqësisë 2022;
- Fuqizimi i resurseve njerëzore dhe kost-efektiviteti në ASK;
 - Sigurimi i resurseve të qëndrueshme;
 - Racionalizimi i vendeve të punës;
 - Zhvillimi i trajnimeve të brendshme dhe të jashtme;
 - Përpilimi dhe monitorimi i indikatorëve në kuadër të strategjisë 2030;
 - Zotimi në konfidencë, si përkrahje shtesë nga ana e Qeverisë së Kosovës për cilësinë e prodhimeve statistikore.
- Fuqizimi menaxhimit të cilësisë dhe metodologjisë;
 - Modernizimi i tërë sistemit për mbledhjen e të dhënave përmes implementimit të metodës CAPI, CAWI dhe CATI.
 - Fuqizimi i sistemit për menaxhim të Cilësisë dhe avansimin e GSBPM;
 - Zhvillimi dhe avancimi i metejme i Sistemit të Metadatave SIMS (Single Integrated Metadata Structure) si dhe ngritja e kualitetit të përshkrimit të metadatave për të gjitha hulumtimet statistikore dhe hulumtimeve tjera të parashtruara nga statistikatat prodhuese.
 - Azhurnimi i kornizës së mostrës e cila do të zhfrytëzohet për dizajnimin e mostrave (Korniza përmban ekonominë familjare që do të zgjedhen për intervistim.

- Krijimi i një infrastrukture të sigurt të TI-së si dhe zhvillimi i aplikacioneve dhe sigurimi i pajisjeve harduerike për regjistrimin e popullsisë 2021.
- Të forcoj përdorimin efektiv të teknologjive së informacionit hapësinor për prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave si dhe kontribuojë në përmirësimin e aftësive të menaxhimit të informacionit hartografik dhe qasjes në zyrat statistikore;
- Arkitektura e sistemit të TI-së, që bazohet në procese të përbashkëta dhe të dokumentuara
- Monitorimi dhe rritja e kontrollit të punës në teren;
- Vazhdimi i rritjes së përdorimit të pajisjeve elektronike në mbledhjen e të dhënave;
- Vazhdimi i përdorimit të mëtejshëm i nën fazave nga modelet statistikore GSBPM;
- Rritja dhe përmirësimi i statistikave zyrtare;
 - Zbatimi i plotë i Metodologjisë ESA 2010 në statistikat ekonomike në veçanti në llogaritë kombëtare;
 - Shtimin e numrit të tabelave të BPV-së për programin e transmissioinit, të cilat do të dërgohen në Eurostat;
 - Përmirësimin e mëtejshëm të Llogarive Kombëtare dhe Statistikave të Financave Qeveritare në përputhje me ESA 2010, manualin e FMN dhe të GFSM 2014;
 - Përpilimi dhe publikimi i tabelave ofruese-përdoruese (SUT), ku do të përdoren të gjitha burimet e të dhënave, duke balancuar SUT me çmime aktuale dhe konstante (duke përdorur të gjithë deflatorët);
 - Përgatiten tabelat input-output (I/O);
 - Vlerësimi i ekonomisë joformale për aktivitete të reja dhe integrimi i rezultateve në të dhënat e BPV-së; Krijimi i kornizës për të dhënat e ekonomisë së pa vrotuar - NOE (qasje tabelore për matjen e NOE);
 - Të vazhdojë publikimin e Statistikave të Financave Qeveritare (GFS) në baza tremujore bazuar në manualin e FMN dhe të GFSM 2014 dhe
 - Përpilimin e tabelave të EDP dhe dërgimi i tyre në Eurostat;
 - Përmirësimi i vazhdueshëm i të dhënave të llogarive qeveritare sipas COFOG-ut;
 - Zhvillimi i anketës së Shëndetësisë;
 - Zhvillimi i anketës për arsimimin e të rriturve (Adult Education Survey); Implementimin e Klasifikimit Ndërkombëtar të Krimit për qëllime statistikore (ICCS);
 - Implementimi i Klasifikimit Standard Ndërkombëtar të Arsimit ISCED 2011;
 - Zhvillimi i mëtejshëm i statistikave të tregut të punës, zhvillimi i ad-hoc moduleve të AFP-së, zhvillimi i anketës mbi koston e punës, zhvillimi i anketës për vendet e lira të punës, zhvillimi i anketës mbi strukturën e të ardhurave;
 - Implementimi i ESSPROS në statistikat e mbrojtjes sociale;
 - Zhvillimi dhe përmirësimi i statistikave të transportit, hotelërisë dhe turizmit, ndërtimitarisë dhe statistikave tjera afatshkurtra;
 - Zhvillimi i statistikave mbi investimet;
 - Zhvillimi i statistikave të përdorimit të teknologjisë informative dhe të komunikimit nga bizneset;
 - Parapërgatitjet për realizimin në Regjistrimin të bujqësisë apo anketës strukturore të fermave;
 - Zhvillimi i statistikave të kulturave bujqësore bimore vjetore (anketë e veçantë);
 - Zhvillimi i statistikave të kulturave të përhershme bimore (të dhënat strukturore për pemët dhe vreshtat si anketa të veçanta) ;
 - Zgjerimi i statistikave të blegtorisë dhe prodhimeve blegtorale (me indikator të ri (statistikat e prodhimit të mishit, qumështit, vezëve etj si anketa të veçanta).

BQK-ja do t'i pasurojë aktivitetet statistikore dhe kërkimore që kanë të bëjnë me ekonominë në përgjithësi dhe sistemin financiar në veçanti përmes këtyre veprimeve strategjike:

- Përpilimi dhe publikimi i statistikave për Llogaritë financiare për Kosovën, konform metodologjisë së paraparë me ESA 2010;
- Avancimi i mëtejshëm gjithëpërfshirës i statistikave monetare dhe financiare;
- Përpilimi i statistikave të bilancit të pagesave në baza mujore për raportim në Eurostat;
- Zhvillim i platformës online për raportim nga korporatat jofinanciare.

3.19. Kapitulli 19 i acquis-së: Politikat sociale dhe punësimi

Acquis në fushën sociale përfshinë standardet minimale në fushat e ligjit të punës, barazisë, shëndetit dhe sigurisë në punë dhe anti-diskriminimit. Shtetet Anëtare marrin pjesë në dialogun social në nivel evropian dhe në proceset e politikave të BE-së në fushat e politikave të punësimit, dhe përfshirjes e mbrojtjes sociale.

Shtetet Anëtare marrin pjesë në proceset e politikave të BE-së në fushat e politikës së punësimit, politikave sociale, gjithëpërfshirja dhe mbrojtja sociale. Partnerët socialë nga Shtetet Anëtare marrin pjesë në dialogun social në nivelin evropian.

Në fushën e aftësisë së kufizuar, BE ka miratuar një strategji që synon të harmonizojë çështjet e aftësisë së kufizuar në kuadër të politikave përkatëse të Unionit dhe në rritjen e integritit të personave me aftësi të kufizuara.

Marrëveshjet ndërkombëtare që lidhen me punësimin, punën dhe çështjet sociale, siç konventat relevante të ILO dhe Konventa e KB për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, duhet të merren në konsideratë.

Në lidhje me kapitullin 23 "Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore", duhet të theksohet se të drejtat e sindikatave të punëtorëve në thelb janë të përfshira në kapitullin 19. Sa i përket anti-diskriminimit dhe mundësive të barabarta, këto çështje në thelb janë të përfshira në Kapitullin 19 me fokus specifik në aspektet e punësimit, ndërsa kapitulli 23 përfshin të drejtat kulturore dhe pakicat si dhe dhunën kundër grave.

Kërkesat e MSA-së

Bashkëpunimi në këtë fushë sipas neneve 82 dhe 106 të MSA-së, do të synojë mbështetjen e Kosovës në reformimin e politikave të punësimit. Gjithashtu do të nxisë dialogun social si një forcë kyçe në shtytjen e reformës ekonomike dhe sociale si dhe përafrimin ligjor mbi punësimin, shëndetin dhe sigurinë në punë dhe mundësitë e barabarta për gratë dhe burrat, personat me aftësi të kufizuara, pjesëtarët e minoriteteve dhe grupeve të marginalizuara. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë përafrimin e legjislacionit të Kosovës me Acquis në fushën e Ligjit të Punës me theks në kushtet për punës për gratë si dhe për të nxitur përfshirjen e politikave sociale dhe anti-diskriminuese në Kosovë.

Kërkesat nga mekanizmat e tjerë të aderimit në BE

Në konkluzionet e Nënkomitetit për Inovacion, Shoqëri Informativ, Politika Sociale dhe Punësim 2020, kërkohet miratimi dhe implementimi i legjislacionit për Siguri dhe Shëndet në Punë, Ligji i Punës, Ligji për KES dhe të sigurohet funksionimi i Këshillit Ekonomik Social, sigurimi i mundësive për Inspektoratin e Punës për përmbushjen e mandatit të tij si dhe kërkohet që komunat të ofrojnë shërbime sociale, përfshirë edhe amendamentimin e Ligjit për Financa Lokale për të përfshirë grantin e kërkuar nga to.

Në Raportin e KE-së për Kosovën – 2020 kërkohet të bëhet amendamentimi i Ligjit të Punës në linjë me acquis të BE-së duke përfshirë rregullat e BE-së për mos-diskriminim në punësim dhe politika sociale dhe pushim të lehonisë/prindëror. Theksohet që Kosova e ka harmonizuar legjislacionin për Siguri dhe Shëndet në Punë me atë të BE-së, tani kërkohet fokusim në implementimin e këtij legjislacioni. Kërkohet gjithashtu përmirësim i kapaciteteve të Inspektoratit të Punës. Sipas këtij raporti, Kosova vazhdon të përballet me sfida strukturore të tregut të punës të cilat vijnë si rezultat i rritjes së shpejtë të popullsisë në moshë pune e cila nuk përputhet me krijimin e qëndrueshëm të vendeve të punës, pjesëmarrjen e ulët të grave në tregun e punës në mënyrë të vazhdueshme dhe mundësitë e pasigurta të punësimit.

Gjendja aktuale

Korniza legjislative dhe ajo e politikave

Korniza legislative në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, ka shënuar progres në përafrimin e legjislacionit vendor me acquis-në e BE-së. Deri më tani janë transpozuar gjithsejtë 25 direktiva (direktivat individuale sipas nenit 16 (1) të Direktivës Kornizë 89/391 dhe të e tjera) në 19 rregullore përkatëse të miratuara. Rregulloret e miratuara janë të listuara më poshtë. Direktivat e BE-së në fushën e kushteve të punës, janë identifikuar dhe analizuar. Shtatëmbëdhjetë (17) direktivat janë transpozuar në draftin e projektligjit të Punës dhe projektligjit për Pushimin e Lehonisë dhe Prindëror.

Korniza legislative në këtë fushë përbëhet nga këto akte kryesore normative:

- Ligji nr. 03/L-212 i Punës;
- Ligji nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë;
- Ligji nr. 04/L-205 për Agjencinë e Punësimit;
- Ligji nr. 04/L-008 për Këshillin Ekonomiko-Social;
- Ligji i ri nr. 05/L-077 për Regjistrimin dhe Ofrimin e Shërbimeve për të Papunët, Punëkërkuesit dhe Punëdhënësit;
- Ligji nr. 03/L-019 për Aftësim, Riaftësim Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuar, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-078;
- Ligji nr. 05/L-020, për Barazi Gjinore;
- Rregullore (MPMS) nr. 04/2014 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në përdorimin e pajisjeve të punës në vendin e punës e ndryshuar dhe plotësuar me Rregullores nr. 01/2020;
- Rregullore (MPMS) nr. 05/2014 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 02/2020;
- Rregullore (MPMS) nr. 02/2016 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për përdorimin e pajisjeve personale mbrojtëse në vendin e punës;
- Rregullore (MPMS) nr. 03/2016 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për mbrojtjen e punësuarve lidhur me punën e krahut me ngarkesa;
- Rregullore (MPMS) nr. 04/2016 për kërkesat minimale për sigurimin e shenjave të sigurisë dhe shëndetit në punë;
- Rregulloren (MPMS) nr. 05/2016 për kërkesat minimale për sigurinë dhe shëndetin në punë të punësuarave në risk nga ambientet shpërthyes;
- Rregulloren (MPMS) nr. 06/2016 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për punën me pajisje me ekran shfaqës;
- Rregullorja (MPMS) nr. 01/2017 për mbrojtjen e të punësuarave nga rreziqet lidhur me dridhjen në vendin e punës;
- Rregullorja (MPMS) nr. 02/2017 për mbrojtjen e të punësuarave nga risqet lidhur me zhurmën në vendin e punës;
- Rregullorja (MPMS) nr. 03/2017 për parandalimin e lëndimeve nga mjetet e mprehta në vendet e punës pranë sektorit të kujdesit shëndetësor dhe spitalor;
- Rregullorja (MPMS) nr. 04/2017 për mbrojtjen e të punësuarave nga risqet e lidhura me kancerogjenët dhe mutagenët në punë;
- Rregullorja (MPMS) nr. 05/2017 për mbrojtjen e të punësuarave nga risqet e lidhura me ekspozimin ndaj agjentëve biologjikë në punë;
- Rregullorja (MPMS) nr. 06/2017 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në punë në vendet e përkohshme ose mobile të ndërtimtarisë;
- Rregullorja (MPMS) nr. 07/2017 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në punë për mbrojtjen e punëtorëve nga rreziqet që lidhen me ekspozimin ndaj asbezt në punë;
- Rregullore (MPMS) nr. 08/2017 mbi kërkesat minimale të shëndetit dhe sigurisë në lidhje me ekspozimin e punëtorëve ndaj rreziqeve që lindin nga agjentët fizikë (fusha elektromagnetike);
- Rregulloren (MPMS) nr. 09/2017 për mbrojtjen e të punësuarave nga risqet e lidhura me rrezatimin optik në vendin e punës;
- Rregullorja (MPMS) nr. 10/2017 mbi mbrojtjen e shëndetit dhe sigurinë e punëtorëve nga rreziqet që lidhen me agjentët kimikë në vendin e punës;

- Rregullorja (QRK) nr. 22/2017 mbi kërkesat minimale për sigurinë dhe shëndetin në punë të punësuarve në veprimtari minerare sipërfaqësore nëntokësore me shpim si dhe aktivitete të caktuara minerare;
- Rregullorja për Masat Aktive të Tregut të Punës;
- UA nr. 03/2018 për mënyrën, procedurat dhe afatet e pagesës mujore për punëdhënësit të cilët nuk punësojnë persona me aftësi të kufizuara;
- UA nr. 04/2018 për fushëveprimin, kompetencat, përbërjen dhe mandatin e komisionit Mediko-Social për vlerësimin e aftësisë së mbetur për punë të personave me aftësi të kufizuara;
- UA nr. 05/2018 për mënyrën dhe procedurat e vlerësimit të aftësisë për punë të personave me aftësi të kufizuara;
- Rregullorja (QRK) nr. 16/2018 për lehtësirat doganore dhe tatimore për punëdhënësit që punësojnë persona me aftësi të kufizuara dhe personat me aftësi të kufizuara që ushtrojnë veprimtari të pavarur.

Në këto akte normative janë transpozuar 25 direktiva dhe 22 rregullore.

Korniza institucionale:

- Zyra e Kryeministrit;
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
- Ministria e Ekonomisë;
- Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
- Ministria e Shëndetësisë;
- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.

Mbështetja e donatorëve

Projekti i Asistencës Teknike “Mbështetje për Inspektoratin e Punës në luftë kundër joformalitetit” ka për qëllim të ofrojë asistencë prej euro 1 milion përgjatë periudhës korrik 2018 - korrik 2020 në ngritjen e kapaciteteve për Inspektoratin e Punës si dhe Asistencë Teknike për Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Projekti i Asistencës Teknike “Mbështetje për ngritjen e kapaciteteve për MFPT dhe APRK” ka për qëllim të ofrojë asistencë në vlerë prej euro 1 milion përgjatë periudhës maj 2018 – maj 2020. Objektivi i përgjithshëm i projektit është “të rrisë punësueshmërinë dhe perspektivat për punësim të qëndrueshëm për grupet e pafavorizuara, sidomos të rinjtë dhe gratë në Kosovë”. Qëllimi i projektit është zhvillimi i kapaciteteve të Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe Agjencisë për Punësim që të dizajnojnë, zbatojnë dhe monitorojnë masat aktive për tregun e punës me fokus tek grupet e pafavorizuara, sidomos të rinjtë dhe gratë, ndërsa projekti ka dy komponentë.

Projekti EYE, faza II “Rritja e punësimit të të rinjve”, financohet nga SDC. Qëllimi i fazës II (janar 2017-dhjetor 2020) është: “Një treg dinamik dhe social gjithëpërfshirës i punës që siguron gjithnjë e më shumë vende pune, përfshirë vetë-punësimin e të rinjve në Kosovë.”

Projekti Asistencë Teknike “Përkrahje për MFPT (ish Ministrinë e Punës dhe të Mirëqenies Sociale) për Zbatimin Efektiv dhe Efikas të Masave Aktive për Tregun e Punës” financohet nga fonde të BE-së (IPA) dhe zbatohet nga WYG savjetovanje d. o. o.

Projekti “Këshillim për Migrimin në Kosovë, Marrëveshje zbatimi ndërmjet MFPT (ish Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) data 1 prill 2016 deri më 31 tetor 2019 ka përfunduar mirëpo do vazhdojë faza e dyte 2020-2023 ku përmbajtja e projektit do zgjerohet dhe do shtohen shumë aktivitete.

Projekti PME/DIMAK që zbatohet dhe operon në Kosovë përmes GIZ-it Gjerman përkatësisht Projekti global „Programi - Migracioni për Zhvillim. Objektivi kryesor i programit është forcimi i kontributeve të migrantëve për zhvillimin e vendeve të tyre të origjinës dhe përmirësimin e kushteve për migracionin e ligjshëm në vendet e përzgjedhura partnere. Ky objektivi po ndiqet në mënyrë aktive fushat në vijim:

- Këshillim për politikën e migracionit;
- Këshillim për migracionin;
- Kthimi i migrantëve i orientuar nga zhvillimi;
- Bashkëpunimi me diasporën.

Ky kapitull është duke u përkrahur nga projekti i Qeverisë së Norvegjisë, qëllimi i këtij projekti është të mbështesë administratën publike të Kosovës në zbatimin e MSA-së dhe rritjen e gatishmërisë për anëtarësim në BE në disa kapituj përfshirë statistikat. Ky projekt do të forcojë kapacitetet institucionale të administratës publike të Kosovës, specifikisht në kapitullin Politikat Sociale dhe Punësimi përmes ofrimit të trajnimeve të specializuara për përmbajtjen e kërkesave dhe kërkesave që rrjedhin nga BE, transpozimin e akteve të acquis në legjislacionin kombëtar, si dhe në reformat e politikave përkatëse.

Objektivat prioritarë afatmesme

Objektivi kryesor i MFPT sa i përket legjislacionit është transpozimi i vazhdueshëm i acquis-së në fushën e punësimit dhe politikave sociale deri më 2022. Duhet të zhvillohet dhe krijohet një sistem i mbrojtjes sociale që e mbështetë punësimin dhe rrit gjithëpërfshirjen e grupeve të cenuara, përmes zhvillimit të politikave dhe hartimit të programeve që synojnë dhe sigurojnë ngritjen e cilësisë së skemave të mbrojtjes sociale, shërbimeve sociale dhe rritjen e mbulueshmërisë për kategoritë sociale dhe grupet e tjera të përjashtuara. Organizatat e shoqërisë civile kanë propozuar edhe hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore për zbatimin e dispozitave të Ligjit për Mbrojtje kundër Diskriminimit në fushën e punësimit.

Në këtë aspekt, në periudhën afatmesme planifikohet të miratohen dokumentet në vazhdim:

- Ligji i ri për sigurime sociale dhe pensionet e financuara nga shteti, për reformimin e sistemit të sigurimeve sociale në Kosovë. Kjo synon krijimin e një kornizë të përgjithshme të qëndrueshme të sistemit pensional dhe invalidor, përkatësisht të sistemit të plotë të sigurimeve sociale përmes harmonizimit të kornizës ligjore aktuale, krijimit të legjislacionit të ri, ngritjes së kapaciteteve institucionale, njerëzore e teknologjike. Reforma synon të ndikojë në rritjen e barazisë në mes të kategorive të ndryshme të përfituesve në aspektin e përfshirjes sociale dhe stabilitet financiar afatgjatë në vend.
- Ligji i ri për trajtimin e personave me aftësi të kufizuara, për të vendosur përkufizimin e duhur për PAK, përfshirë të gjitha llojet e aftësisë së kufizuar dhe ndarjen në kategori sipas nevojave të PAK;
- Hartimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin i Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, për transpozim të plotë të Direktivës 89/391/KEE e Këshillit Evropian e datës 12 qershor 1989 mbi paraqitjen e masave për të inkurajuar përmirësimet në sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve në punë (Direktiva Kornizë). Me këtë ligj, synohet të rregullohet më mirë dhe avancohet baza ligjore e sigurisë dhe shëndetit në punë;
- Hartimi i akteve nënligjore specifike që sigurojnë kërkesa dhe udhëzime të hollësishme për sigurinë dhe shëndetin në punë në sektorë të veçantë si bujqësi, pylltari, shëndetësi, hoteleri dhe të tjerë;
- Hartimi i kornizës ligjore për sistemin e mbikëqyrjes shëndetësore të punëtorëve: që përshkruajnë procedurën e mbikëqyrjes shëndetësore për ta bërë të qartë për të gjitha palët e interesit - punëdhënësit, të punësuarit, specialistët/ekspertët/shërbimet e SSHP-së, institucionet mjekësore që kryejnë ekzaminime mjekësore, si dhe përcaktimi i sanksioneve/gjobave për mosrespektimin e detyrimeve ligjore;
- Hartimin e kornizës ligjore që përshkruan procedurën e hetimit dhe regjistrimit të aksidenteve në punë, që përshkruan procedurën e diagnostikimit dhe raportimit të sëmundjeve profesionale përfshirë një listë të sëmundjeve profesionale;
- Ligji i ri për Shërbime Sociale dhe Familjare që do të mundësojë avancimin e shërbimeve sociale, fuqizojë Qendrat për Punë Sociale në nivel lokal, përcaktoj procedurat e licencimit dhe kornizën e operimit të ofruesëve të shërbimeve sociale nga sektori joqeveritar dhe privat.

- Ligji i ri për Skemën e Ndhmës Sociale, përmes së cilit do të eliminohet kriteret diskriminuese për pëfitimin e ndihmave sociale, krijohen mundësi për aktivizim në masat aktive të tregut të punës për përfituesit e skemës së ndihmës sociale dhe gjithpërfshirje të familjeve në nevojë.
- Hartimi dhe miratimi i kornizës ligjore sekondare për Ligjin e ri të Shërbimeve Sociale dhe Familjare, Ligjin për Mbrojtje të Fëmijëve dhe Ligjin e ri të Skemës së Ndhmës Sociale.
- Hartimi dhe miratimi i UA për formulën e financimit dhe Grantin e Veçantë për Shërbime Sociale;
- Mbështetja sektorit joqeveritar të licencuar dhe ndërmarrjeve sociale të regjistruara me subvencione dhe grante për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare dhe përfshirën në punësim të grupeve të cenueshme.

3.20. Kapitulli 20 i *acquis*-së: Politikat e ndërmarrjeve dhe ato të industrisë

Legjislacioni i BE-së për këtë kapitull kryesisht përbëhet nga parimet e politikës dhe instrumentet që konsistojnë nga komunikata, rekomandime dhe konkluzione të Këshillit. Në masë të madhe ato zbatohen përmes Programit për Konkurrueshmëri dhe Inovacion në nivel të gjithë BE-së. Ky kapitull gjithashtu përbëhet nga politikat sektoriale. në përgjithësi, politikat e ndërmarrjeve dhe industriale janë ngushtë të lidhura me Strategjinë 2020 të BE-së.

Përmes principeve të përgjithshme të politikave, BE synon të promovojë dhe forcojë konkurrueshmërinë dhe strategjinë industriale. Këto principe burojnë nga fryma e nenit 173 të TFBE për të shpejtuar ndryshimet strukturore, inkurajuar ambient të favorshëm për biznes dhe NVM, investime të huaja hyrëse dhe dalëse dhe për të inkurajuar dhe mbështetur inovacionin dhe ndërmarrësinë.

Instrumentet e politikave për ndërmarrjet dhe industrinë zhvillohen përmes programeve specifike që ofrojnë mbështetje (përfshirë atë financiare) për ndërmarrjet dhe politikë-bërësit. Këto programe fokusohen në promovimin e qasjes në financa, shërbime të biznesit, Rrjetin e ndërmarrjeve të Evropës, politikave kombëtare për inovacion dhe NVM. Aktualisht, kjo zbatohet përmes programit për konkurrueshmëri dhe inovacion 2014-2020. Direktiva 2011/7/BE është një nga instrumentet e rëndësishme të politikave dhe ka të bëjë me luftimin e pagesave të vonuara në transaksionet afariste.

BE promovon analiza specifike sektoriale të konkurrueshmërisë në kuadër të politikave sektoriale për ndërmarrjet dhe industrinë. Kjo konsiston në lansimin e iniciativave për sektorë të caktuar, studime të ndryshme, iniciativa të rrjetëzimit, forume të politikave etj.

Formulimi dhe zbatimi i politikave të ndërmarrjeve dhe industrisë kërkon kapacitete administrative në të gjitha nivelet, përfshirë mekanizmat e bashkëpunimit dhe konsultimit.

Kërkesat e MSA-së

Dispozitat e MSA që ndërlidhen me këtë kapitull konsistojnë në nenet 51, 74, 98, 99, 100, 101, dhe 102 të cilat kryesisht ofrojnë kornizën dhe synimet e bashkëpunimit dhe potencojnë kërkesat për harmonizim me *acquis*. Sipas nenit 51, Kosova obligohet që me hyrjen në fuqitë të MSA-se të sigurojë trajtim të barabartë kompanive të BE-së me ato vendore sa i përket kushteve të punës, pagesave dhe trajtimit të punëtorëve dhe subjekteve juridike të cilët themelohen juridikisht në territorin e Kosovës. Neni 74 definon obligimet për transpozim të legjislacionit në një fazë të mëhershme për fushat primare të tregut të brendshëm dhe tregtisë. Gjithashtu ky nen kërkon zbatim efektiv të këtij legjislacioni.

Neni 98 ofron kornizën për mbrojtje dhe promovim të investimeve të huaja direkte si dhe synon krijimin e klimës së favorshme për biznes. Bashkëpunimi në këtë fushë synon përmirësimin e kornizës ligjore për të favorizuar dhe mbrojtur investimet. Neni 99 jep kornizën e bashkëpunimit në fushën e politikave industriale. Ndër të tjera ky nen synon modernizimin dhe ristrukturimin e industrisë, inkurajimin dhe zhvillimin e konkurrueshmërisë dhe promovimin e bashkëpunimit ndërkufitar për zhvillimin e industrisë. Neni 100 ka të bëjë me bashkëpunimin në fushën e NVM-ve dhe ndërmarrjeve në përgjithësi në funksion të krijimit të një ambienti të favorshëm për bizneset. Bashkëpunimi duhet të jetë brenda kornizës së Aktit të Biznesit të Vogël dhe të marrë parasysh *acquis* në këtë fushë.

Neni 101 mbi turizmin, parasheh një zhvillim të balancuar dhe të qëndrueshëm të turizmit, duke studiuar mundësitë për operacione të përbashkëta dhe forcimin e bashkëpunimit në mes të ndërmarrjeve turistike, të ekspertëve, institucioneve dhe agjencive të tyre kompetente në fushën e turizmit gjithmonë duke marrë parasysh acquis-in e BE-së për këtë fushë.

Në dhjetor 2017 u nënshkrua marrëveshja për pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e BE-së për konkurrueshmëri të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (COSME). Kosova duhet të fillojë zhvillimin e masave për të rritur vetëdijen tek palët e biznesit dhe për të siguruar pjesëmarrjen e tyre aktive në program.

Kërkesat nga mekanizmat e tjerë të aderimit në BE

Raporti i KE-së për Kosovën – 2020 thekson se Kosova është mesatarisht e përgatitur në këtë fushë. Pak progres është arritur në përmirësimin e ambientit afarist. Ekziston nevoja për të zhvilluar më tutje kapacitetin administrativ dhe për të siguruar bashkërendim ndërministror më të fortë. Raporti nënvizon se Agjencia Kosovare e Investimeve dhe Ndërmarrjeve (KIESA) duhet të riorganizohet për të përmirësuar skemat e saj të mbështetjes dhe ofrimin e shërbimeve këshilluese për NVM-të si dhe të themelohet një njësi për përkujdesje të mëtejshme të investitorëve.

Nga Nënkomiteti për Tregti kërkohet nga autoritetet përgjegjëse që të miratohet dhe të fillojë zbatimin e një strategjie për të mbështetur mjedisin biznesor dhe zhvillimin industrial në Kosovë, duke marrë parasysh komentet e dhëna nga BE për draftin PSDS në vitin 2019. Gjithashtu theksohet se duhet të funksionalizohen grupet punuese të SBA-së për zbatimin e rekomandimeve të vlerësimit mbi SBA. Për më shumë, kërkohet përgatitja e një programi për zvogëlimin e barrës administrative që përqendrohet në masa konkrete për të përmirësuar mjedisin biznesor në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme, veçanërisht përmes rritjes së digjitalizimit dhe thjeshtimit, bashkimit dhe heqjes së licencave dhe lejeve.

Gjendja aktuale

Korniza legjislativë dhe ajo e politikave

Korniza legjislativë dhe ajo e politikave në fushën e politikave të ndërmarrësisë dhe industrisë

- Ligji nr. 04/L-220 për Investime të Huaja;
- Ligji për Turizmin nr. 04/L-176;
- Ligji nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit si dhe Ligji nr. 06/L-023 për amendamentimin e Ligjit nr. 04/L-034;

Këto akte normative kanë transpozuar Direktivën 90/314 të BE-së mbi paketat turistike (pjesërisht).

Korniza e politikave në këtë fushë përbëhet nga këto dokumente:

- Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021;
- Marrëveshja COSME;
- Programi për Reformave Ekonomike.

Korniza institucionale:

- Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (Departamenti i Industrisë, Divizioni i Politikës Industriale);
- Agjencia për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve (KIESA)
- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;
- Këshilli Kombëtar për Ekonomi dhe Investime.

Mbështetja e donatorëve

Projektet aktuale dhe të planifikuara të donatorëve bilateralë

Projekti i Konkurrueshmërisë dhe Gatishmërisë për Eksport (CERP) është projekt i mbështetur nga Banka Botërore qëllimi i së cilit është të forcojë kapacitetin e institucioneve të zgjedhura publike në Kosovë që të kontribuojnë në përmirësimin e eksportit dhe konkurrueshmërisë së sektorit privat.

Projekti Mbështetja për zhvillimin e sektorit privat për të lehtësuar ndikimin e krizës COVID-19 është projekt i mbështetur nga BE i cili do të mbështesë kompanitë start-up dhe NVMM-të ekzistuese në qasje në financa dhe njohuritë teknike për të mbështetur likuiditetin e tyre, rritjen e qëndrueshmërisë dhe konkurrencës që do të ndikon në rritjen e prodhimit dhe krijimin e vendeve të punës.

Projektet për përkrahje të NVM-ve:

- “Përkrahje për ndërmarrësit e rinj”;
- “Konkursi Triple Helix” – Konkursi i lansuar nga OECD-ja dhe partnerët e saj në Kosovë për idenë më të mirë inovative që vjen nga academia, biznesi dhe sektori publik;
- Fondi për Garantimin e Kredive i krijuar: Fondi do të rrisë qasjen në financa për NVM-të duke mbuluar 50% të kolateralit që kërkohet për NVM-të për të marrë një kredi në bankë. Ky kolateral i garantuar do të reduktojë rrezikun për bankat, duke iu mundësuar bankave të ulin normat e tyre të interesit dhe t’i bëjnë produktet e tyre kreditore më të përballueshme. USAID, KFW dhe SECO kontribuojnë me rreth 18 milionë euro dhe MINT kontribuon me 1 milion euro për të krijuar fondin.

Objektivat prioritarë afatmesme

Politikat e ndërmarrësisë dhe industrisë:

- Hartimi i strategjisë për politikat industriale;
- Përmirësimi i mjedisit të të bërit biznes dhe zhvillimi i turizmit;
- Promovimi dhe përkrahja e investimeve;
- Mbështetja e bizneseve në certifikimin e produkteve të tyre me standardet evropiane dhe ndërkombëtare duke ofruar grante të vogla për NVM-të, ofrimi i granteve dhe përkrahjes teknike për bizneset për standardet e cilësisë deri më 2020, duke siguruar, aty ku është e mundur, përfaqësimin e barabartë gjinor;
- Zhvillimi i industrisë përmes forcimit të kornizës së politikave, dhe mbështetjes së sektorëve kyç me qëllim të rritjes së produktivitetit dhe eksportit
- Promovimi i eksportit duke i përgatitur NVM-të për eksport dhe identifikuar/zhvilluar tregjet potenciale
- Pjesëmarrje aktive në COSME dhe Rrjetin Evropian të Ndërmarrjeve, përfshirë mbështetjen e bizneseve për t’i shfrytëzuar këto programe;

Politikat e inovacionit:

- Zhvillimi i inovacionit
- Zhvillimi dhe miratimi i legjislacionit sekondar të nevojshëm
- Krijimi i Fondit për Inovacion dhe Ndërmarrësi
- Shfrytëzimit efikas të Parkut të Inovacionit dhe Trajnimit në Prizren dhe Qendrës së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, të financuara nga buxheti qeveritar.

3.21. Kapitulli 21 i acquis-së: Rrjetet trans-evropiane

Ky kapitull mbulon rrjetin trans evropianë që njihet ndryshe si shtylla kryesore e zhvillimit të brendshëm të tregjeve Evropiane. Qëllimi i këtij kapitulli është të krijoj rrjetin e domosdoshëm rrugor, energjetik dhe të telekomunikimeve që lidh shtetet Evropiane me mundësi përfshirje edhe shtetet e treta. Mundëson krijimin e një infrastrukture moderne e cila lidh rrjetet rajonale dhe nacionale të cilat sigurojnë lëvizjen e lirë të mallrave, shërbimeve, kapitalit dhe fuqisë punëtore, që si rezultat të kenë efekt në krijimin dhe fuqizimin e një shoqërie të barabartë.

Qëllimi i politikave të Rrjeteve Trans-Evropiane (TEN) është të integrojnë një infrastrukturë evropiane ndërvepruese në fushat e transportit, energjisë dhe telekomunikacionit dhe në këtë kuadër të identifikojnë standarde teknike dhe projekte prioritarë me interes të përbashkët, si dhe të zhvillojnë instrumente financimi për zbatimin e tyre.

Qëllimi themelor i politikave TEN është të krijojnë një treg të vetëm për këta tre sektorë dhe kështu të lehtësohet funksionimi i Tregut të Vetëm Evropian dhe të shfrytëzohet plotësisht tregu i brendshëm, duke kontribuar në rritjen ekonomike dhe krijimin e punësimit në BE.

Politikat e BE-së në lidhje me rrjetet trans-evropiane për transportin (TEN-T) dhe energjinë (TEN-E) bazohet në tre pika: bazën ligjore për TEN; nenet 170-172 të Traktatit për Funksionimin e BE-së; Rregulloren (BE) nr. 1315/201350 mbi udhëzimet e Unionit për zhvillimin e rrjetit trans-evropian të transportit dhe energjisë si dhe Rregulloren e (BE) 1316/201351 për krijimin e fondit CEF, duke ndryshuar rregulloren (BE) 913/2010 dhe duke shfuqizuar Rregulloret (KE) 680/2007 dhe (KE) 67/2010.

Korniza dhe gjendja

Kjo kornizë përcakton objektivat e politikës së BE-së për politikën e rrjetit trans-evropian, e cila përfshin rrjetet e transportit dhe energjisë dhe synon adaptimin dhe zhvillimin e rrjeteve dhe sigurimin e ndërlydhjeve dhe ndërveprimit të tyre. Instrumenti i ri i financimit për rrjetet trans-evropiane-fondi "Connecting Europe Facility" (CEF) dhe udhëzimet e rishikuara TEN-T dhe TEN-E kanë hy në fuqi më 1 janar 2014. Qëllimi i krijimit dhe zhvillimit të Rrjeteve trans-evropiane (TEN) dhe promovimit të ndërlydhjeve dhe interoperabiliteti i rrjeteve nacionale janë që të shfrytëzohet plotësisht tregu i brendshëm dhe të kontribuojnë në rritjen ekonomike dhe krijimin e vendeve të punës në Bashkimin Evropian.

Kërkesat nga mekanizmat e tjerë të aderimit në BE

Lidhur me rrjetet e transportit, *Raporti i KE-së për Kosovën – 2020* thekson se kapacitetet institucionale për zbatimin e projekteve strategjike duhet të forcohen në nivelin qendror dhe lokal për prokurim publik, dhe për planifikimin, përgatitjen dhe menaxhimin e projekteve investuese. Projektet prioritare në rrjetet themelore dhe gjithëpërfshirëse mbetet të kryhen. Investimet e ardhshme në infrastrukturë duhet të zbatohen në përputhje me standardet e BE-së për prokurim publik, ndihmë shtetërore dhe vlerësimin e ndikimit në mjedis. Ato duhet të kanalizohen përmes *Listës së Përbashkët të Projekteve investuese*, duke konfirmuar orientimin strategjik drejt TEN-ve. Të zbatohet i projektit të linjës hekurudhore 10 dhe sigurohet financimi për vazhdimin e R7, Prishtinë – Merdare. Autoritetet duhet të ndër marrin masa të menjëhershme për të finalizuar protokollin e mbetura të kalimit kufitar hekurudhor me Maqedoninë e Veriut. Gjithashtu duhet siguruar hapjen e tregut hekurudhor me zgjatjen indikative të korridorit Orient/Lindje-Mesdhe. Ndonëse ka pasur progres në miratimin e planeve të mirëmbajtjes për të gjithë rrjetin themelor (rrugor dhe hekurudhor), Kosova ende mbetet prapa në këtë drejtim dhe nevojiten përpjekje të mëtejshme. Ndër të tjera, RV kërkon që investimet aktuale dhe të ardhshme infrastrukturore të jenë në përputhje me standardet e BE-së për prokurimin publik, ndihmën shtetërore dhe vlerësimin e ndikimit në mjedis, si dhe të bazohen në analizat e koston/përfitimit në përputhje me praktikën më të mira të BE-së.

Tek rrjetet e energjisë, *Raportit i Vendi 2020* thekson se në fushën e rrjeteve Trans-Evropiane TEN -E dhe TEN-T, Kosova është deri diku e përgatitur. Sidoqoftë, shumë nga rekomandimet e raportit të kaluar janë ende të pazbatuara, andaj rekomandimet e vitit 2019 janë ende të vlefshme. Në vitin e ardhshëm, Kosova duhet në veçanti:

- Të vazhdojë harmonizimin e kornizës ligjore me *acquis* të BE-së dhe me rregulloret TEN-T dhe TEN-E, si dhe të zbatojë masat reformuese të konektivitetit dhe të përforcojë kapacitetet administrative për zbatimin e projekteve strategjike infrastrukturore;
- Është shënuar progres në integrimin e tregut të energjisë elektrike. Por duhet të funksionalizohet linja e re e transmetimit 400kV dhe kontrolli i frekuencës së ngarkesës me Shqipërinë.

Në kuadër të *Nënkomitetit të MSA-së "Infrastruktura"*, të mbajtur në mars 2021, theksohet që Kosova duhet të adresoj urgjentisht mungesa e kapacitetit ndërkuftar midis KOSTT dhe EMS për t'i lehtësuar shkëmbimet tregtare në rajon si dhe të siguroj angazhimi me të gjithë Operatorët fqinjë të Sistemit të Transmisionit për ta koordinuar llogaritjen e kapacitetit ndërkuftar dhe të bëhet koordinimi mbi ndërprerjet e elementeve të rrjetit që ndikojnë në alokimin e tyre. Në raport theksohet edhe miratimi i planit

të veprimit për të rritur vlerat e Kapaciteteve Neto të Transferimit në të gjithë kufijtë në mënyrë që të arrihet caku prej 70% deri në vitin 2025.

Tek **rrjetet telekomunikuese**, nuk është shënuar progres në forcimin e kapaciteteve institucionale të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare në hartimin dhe zbatimin e rregulloreve.

Transporti

Kosova është anëtare e rregullt dhe pjesëmarrëse aktive e takimeve të niveleve Ministrore, komitetit drejtues dhe grupeve teknike të SEETO-së (Observatori i Transportit për Evropën Juglindore). Qëllimi i këtyre takimeve është krijimi i dokumenteve strategjike infrastrukturore dhe zhvillimi i rrjetit infrastrukturor bazik dhe gjithëpërfshirës në Evropën Juglindore, si pjesë përbërëse e Rrjetit Trans-Evropian. Me nënshkrimin e memorandumit të mirëkuptimit më 2004, të gjitha shtetet e Evropës Juglindore janë zotuar të zhvillojnë rrjetin bazik dhe gjithëpërfshirës i cili do të jetë edhe pjesë përbërëse e rrjetit bazik dhe gjithëpërfshirës trans-evropian.

Kosova tanimë e ka miratuar edhe Strategjinë e Transportit Multimodal, e cila përmban pesë qëllime kryesore të ndërlidhura me zhvillimin e rrjetit bazik dhe gjithëpërfshirës të SEETO-së. Qëllimi kyç i kësaj strategjie është: “Përmirësimi, zhvillimi, dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së transportit e cila është e integruar në korridoret Pan Evropiane dhe është konform standardeve Evropiane”. Rrjeti bazik dhe gjithëpërfshirës i SEETO-së përfshin edhe projektet infrastrukturore të Kosovës të cilat janë pjesë e rrjetit të Evropës Juglindore të përbëra nga projektet e infrastrukturës: rrugore, hekurudhore dhe ajrore. Kosova gjithashtu merr pjesë aktive në Komunitetin e Transportit i themeluar me Traktatin mbi Themelimin e Komunitetit të Transportit më 12.07.2017 në Trieste të Italisë dhe i ratifikuar nga të gjitha palët nënshkruese (Vendimi i Këshillit të BE-së 2019/392).

Projektet prioritare të paraqitura dhe të identifikuar në planin shumëvjeçar të Evropës Juglindore si dhe në rrjetin Trans Evropian janë: Route/Rruga 6 e cila lidhë Prishtinën me Maqedoninë e Veriut, Korridorin VIII, Route/Rruga 7 e cila lidhë Kosovën me Shqipërinë si dhe korridorin X në Serbi, R6a (Prishtinë - Mitrovicë) dhe R6b (Prishtinë- Pejë).

Sa i përket infrastrukturës hekurudhore, Kosova e ka të identifikuar projektin e Linjës Hekurudhore 10, e cila lidhë vendin tonë me Serbinë, Korridorin X dhe Maqedoninë e Veriut Korridorin VIII. Përveç Linjës së 10 hekurudhore e cila i përket rrjetit Bazik të SEETO-s, Kosova ka marrë vendim që të bënë edhe rehabilitimin e Linjës së 7 (shtatë) hekurudhore e cila i përket rrjetit Gjithëpërfshirës të SEETO-s dhe e lidhë Korridorin e X-të në Serbi me Linjën e 10 hekurudhore në Kosovë.

Projekti i autostradës Prishtinë-Merdare-Nish, është pjesë e rrjetit Bazik të Transportit në kuadër të Rrjetit Trans-European të Transportit. Kjo rrugë kalon përmes Kosovës nga Vermica në kufirin me Shqipërinë dhe në Merdare në kufirin me Serbinë me një gjatësi totale prej 128 km dhe siguron qasjen e vendit në Detin Adriatik dhe të Detit të Zi, duke përmirësuar lidhjet me vendet e tjera të Ballkanit dhe Korridoret Evropiane të Transportit IV dhe X. Projekti i Autostradës nga Morina në Prishtinë ka përfunduar në vitin 2012, ndërsa për segmentin e mbetur të Autostradës R7 Besi – Merdare (28 Km) financuar nga ana e WBIF- kanë përfunduar:

- Studimi i Fizibilitetit dhe ndikimit mjedisor;
- Projekti Preleminar për segmentin Besi – Merdare.

Kostoja e përafërt e ndërtimit të këtij segmenti është 210-230 mil. Euro (pa TVSH).

Nderkaq, segmenti i Autostradës R7 Kyçja Dulje – Lidhja me Autostradën R6 - kalon përmes Kosovës nga Kyçja në Duhël (autostrada R7) përmes Shtimes, Lipjanit dhe lidhet me Autostradën R6, në territorin e Komunës së Lipjanit. Ky segment i autostradës është pjesë e rrjetit Bazik të Transportit në kuadër të Rrjetit Trans-European të Transportit me një gjatësi totale prej 29 km dhe siguron shkurtime dhe kohës së udhëtimit dhe shpenzimeve të transportit për shfrytëzuesit e drejtimeve rrugore R6 dhe R7 dhe të korridoreve VIII dhe X, në kuadër të rrjetit bazik të Evropës Juglindore. Ndërtimi i këtij segmenti është i domosdoshëm për arsye se korridori ekzistues i rrugës nacionale N9, segmenti Prishtinë – Gjurgjicë është më i ngarkuari në

Kosovë, ku sipas studimit të fizibilitetit dhe ndikimit mjedisor të punuar në kuadër të asistencës teknike nga WBIF, ky korridor deri në vitin 2030, do të arrij kapacitetin e tij të plotë dhe nuk do të ketë mundësi për qarkullim sipas shpejtësisë projektuese të paraparë për këtë segment. Për këtë segment nevojiten që të hartohen:

- Plotësimi i studimit të fizibilitetit dhe ndikimit në mjedis;
- Hartimi i projektit preliminar.

Pas hartimit të projektit, pritet të definohet traseja e segmentit të Autostradës dhe kostoja e ndërtimit.

Pas lëshimit në qarkullim të segmenteve të Autostradës R7, Morinë – Gjurgjicë (Lidhja me N9) - Bresje - Besi, MI në bashkëpunim me WBIF-in dhe EIB-në, ka përfunduar Plotësimin e Studimit të Fizibilitetit dhe Ndikimit mjedisor për segmentin Besi - Merdarë (Kufiri me Serbinë). Për më tepër, janë definuar Termat e Referencës për hartimin e Projektit Preliminar për segmentin Besi – Merdarë, i cili do të financohet nga WBIF dhe është përzgjedhur Kompania Konsulente për hartimin e projektit, i cili pritet të fillojë së shpejti, dhe do të zgjasë 14 muaj. Pas përfundimit të projektit do të vazhdohet me definimin e hapave të mëtejme të financimit të këtij projekti. Në anën tjetër, në korrik 2015 është nënshkruar kontrata në mes të MI dhe Kompanisë fituese Bechtel Enka për ndërtimin e Autostradës Prishtinë - Hani i Elezit, në vlerë prej 599,944,263.55 euro (TVSh-ja e përfshirë). Projekti ka përfunduar dhe autostradës Prishtinë - Hani i Elezit është lëshuar në qarkullim.

MMPHI gjithashtu është duke vazhduar me zgjerimin e aksit rrugor R6a/N2 (Prishtinë – Mitrovicë). Për këtë projekt MMPHI ka arritur të sigurojë kredi në vlerë prej 60 milionë dollarë nga Banka Islamike për Zhvillim, Fondi Saudit për Zhvillim OFID-i.

Sa i përket segmentit Kijevë – Zahaq, MMPHI në bashkëpunim me WBIF dhe BERZh ka përfunduar plotësimin e studimit të fizibilitetit dhe ndikimit mjedisor (2016), i cili ka dhënë rezultate pozitive sa i përket arsyeshmërisë ekonomike të projektit. Janë definuar termat e referencës për hartimin e projektit preliminar nga Kijeva – Zahaq (32km) dhe është përzgjedhur kompania konsulente për hartimin e projektit. Gjithashtu, është duke vazhduar hartimin e projektit zbatues i cili pritet të zgjatë 12 muaj, dhe pas përfundimit të projektit zbatues pritet do të vazhdohet me definimin e hapave të mëtejme të financimit të këtij projekti.

Në sistemin hekurudhor, Kosova ka arritur progres në ndarjen e Hekurudhave të Kosovës në dy kompani, Infracos, përgjegjës për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e Infrastrukturës Hekurudhore dhe Trainkos i cili merret me transport të udhëtarëve dhe mallrave. Republika e Kosovës ka krijuar edhe Autoritetin Rregullativ të Hekurudhave i cili merret me rregullimin e tregut, licencimin, certifikimin, sigurinë dhe interoperabilitetin e sistemit hekurudhor në territorin e Kosovës, ndërsa si entitet i veçantë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit është krijuar edhe Departamenti mbi Hulumtimin e Aksidenteve Hekurudhore Sipas raporteve të dala nga SEETO, Kosova ka arritur progres në zbatimin e ligjeve dhe standardeve të kërkuara duke siguruar që tregu hekurudhor të hapet për operatorët të jashtëm.

Një ndër projektet me prioritet, të identifikuar edhe në SEETO është Linja Hekurudhore 10 dhe Linja Hekurudhore 7 të cilat janë edhe pjesë e rrjetit Trans Evropiane e që lidhin Republikën e Kosovës me Serbinë dhe Maqedoninë e Veriut, gjegjësisht me korridoret X dhe VIII.

Lidhur me zhvillimet e linjës hekurudhore 10 (Railway Route 10), më 06.02.2019 është nënshkruar kontrata me kompaninë Italiane Generale Costruzioni Ferroviarie e cila më 29.08.2019 i ka filluar punët ndërtimore për rehabilitimin e fazës së parë (Fushë Kosovë – Hani i Elezit). Ndërkaq, projekt Dizajni Detaj Teknik për fazën e dytë (Fushë Kosovë – Mitrovicë) është kryer dhe më 08.11.2019 është miratuar nga Infracosi, kështu që në kuartalin e katërt të këtij viti pritet të nënshkruhet kontrata me kompaninë fituese e cila do të bënë ekzekutimin e punëve ndërtimore për këtë fazë. Për më tepër, përfundimi i punëve për rehabilitimin gjeneral dhe modernizimin e Linjës 10 Hekurudhore pritet të realizohet deri më 2022-2023.

Rrjetet trans-evropiane të energjisë -TEN-E, mbulojnë objektet e transportit dhe magazinimit të gazit, si dhe transmetimin e energjisë elektrike dhe japin një kontribut të rëndësishëm në tregun e energjisë elektrike dhe gazit. TEN-E i përgjigjet rëndësisë në rritje të sigurimit dhe diversifikimit të furnizimit me energji të

BE-së, përfshirjen e rrjeteve energjetike të shteteve anëtare dhe vendeve candidate, dhe sigurimin e funksionimit të koordinuar të rrjeteve të energjisë në BE dhe vendet fqinje. Siguria e furnizimit me energji, përfundimi i izolimit të energjisë dhe funksionimi i energjisë së brendshme.

Kjo kornizë përcakton objektivat e politikës së Komunitetit për politikën trans-evropiane të rrjetit që përfshin rrjetet e transportit, energjisë dhe telekomunikacionit dhe synon të adaptojë dhe zhvillojë rrjete dhe të sigurojë ndërlidhjet dhe ndërveprimin e tyre.

Korniza institucionale në fushën TEN -E përbëhet nga këto institucione:

- Ministria e Ekonomisë;
- Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës;
- Kompania Distribucionit me Energji Elektrike;
- Zyra e Rregullatorit për Energji.

Korniza legjislativë në këtë fushë përbëhet nga këto akte kryesore normative:

- Ligji për energji elektrike;
- Ligjin për gazin natyror;
- UA për sigurinë e furnizimit me gazin natyror;
- UA për promovimin e investimeve të përbashkëta rajonale në sektorin e energjisë.

Këto akte normative kanë transpozuar këto akte të acquis-së:

- Direktivën nr. 2009/73/KE;
- Rregulloren nr. 715/2009/KE;
- Rregulloren (BE) 347/2013.

Korniza e politikave në këtë fushë përbëhet nga strategjia e energjisë e Republikës së Kosovës 2017-2026.

Energjia

Gjatë vitit 2020 është shënuar progres në drejtim të integritimit në tregun rajonal të energjisë elektrike. Pas votimit të suksesshëm në muajin prill 2020 nga ana e Grupit Rajonal të Evropës Kontinentale (RGCE), më 30 qershor 2020, u nënshkrua Marrëveshja e re e Kycjes në mes të KOSTT dhe ENTSO-E. Marrëveshja e re e Kycjes KOSTT/ENTSO-E filloi së zbatuari me 29 shtator 2020. Me fillimin e implementimit të marrëveshjes, KOSTT-i operon si zonë rregulluese e pavarur brenda bllokut AK (Albania-Kosovo) me Republikën e Shqipërisë, në kuadër të zonës sinkrone të Evropës Kontinentale. Alokimi i kapaciteteve të interkoneksionit dhe menaxhimi i kongjestionëve të rrjetit interkonektiv do të realizohet brenda strukturës së këtij blloku dhe jo më nga EMS (Serbi), ku edhe të hyrat nga këto aktivitete do të mblidhen nga Blloku, përkatësisht nga KOSTT.

Ky zhvillim i hap rrugë KOSTT-it për integrimin në tregun rajonal të energjisë, pjesëmarrjes në bursën shqiptare të energjisë (APEX) si dhe vënies në operim të linjës 400 kV Kosovë-Shqipëri. Implementimi i plotë i Marrëveshjes së Bllokut Rregullues Kosovë – Shqipëri është nënshkruar në Tiranë, më 29.09.2020. Më tej me 05 tetor 2020 në Prishtinë, KOSTT dhe Operatori Shqiptar i Sistemit të Transmetimit (OST) nënshkruan Marrëveshjen e Aksionarëve për krijimin e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike (ALPEX) dhe miratuan Statutin e saj. Krijimi i Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike (ALPEX) shënon një standard të ri të funksionimit në sektorin e energjisë, i cili do të garantojë më shumë transparencë dhe konkurrencë në tregun e energjisë elektrike.

Ky zhvillim i hap rrugë KOSTT-it për integrimin në tregun rajonal të energjisë, pjesëmarrjes në bursën shqiptare të energjisë (APEX) si dhe vënies në operim të linjës 400 kV Kosovë-Shqipëri. Ky është hapi i rëndësishëm i cili e afron KOSTT-in drejt anëtarësimit në Rrjetin Evropian të Operatorëve të Sistemit të Transmetimi-ENTSO-E. Ndërkaq përfitimet nga operacionalizimi i Marrëveshjes janë të mëdha:

- Inkasimi i të hyrave nga shfrytëzimi i rrjetit transmetues interkonektiv apo alokimi i kapaciteteve dhe menaxhimi i kongjestionëve, që perafersisht kap vlerën në mesatare vjetore 4-8 milionë euro dhe nga transiti rreth 0.5-1.0 milion euro;
- Lëshimi në operim të plotë i linjës interkonektive 400 kV, Kosovë-Shqipëri;

- Bashkimi i tregjeve elektroenergjetike me Shqipërinë;
- Pjesëmarrja me aksione në Bursën Shqiptare të energjisë elektrike (APEX).

Në Kosovë nuk ekziston infrastrukturë funksionale dhe treg i gazit natyror, mirëpo ligjet e energjisë dhe strategjia e energjisë parashohin zhvillimin e infrastrukturës së gazit natyror, përmes lidhjes (kycjes) me projektet e infrastrukturës së gazit në rajonin e Evropës Juglindore, përmes projektit të gazsjellësit TAP ("Trans-Adriatik-Pipeline" – Gazsjellësi përtej Adriatikut) dhe projektit të interkoneksionit të gazit Maqedoni e Veriut - Kosovë. Gjithashtu me qëllim të hapjes së perspektivës së zhvillimit të sektorit të gazit natyror dhe përmbushjes së obligimeve që Kosova ka si anëtare ndaj Traktatit të Komunitetit të Energjisë, Kosova e ka të miratuar ligjin për gazin natyror, e i cili i ka të trajtuara elementet dhe kërkesat e pakos së tretë të legjislacionit të BE-së që lidhen me gazin natyror (Direktivën nr. 2009/73/KE dhe Rregulloren nr. 715/2009/KE). Përveç legjislacionit primar është i miratuar edhe UA për sigurinë e furnizimit me gazin natyror.

Përmes platformës WBIF është realizuar studimi i parafizibilitetit për gazsjellësin Shqipëri-Kosovë (Projekti ALKOGAP). Ky studim ka pasur si objekt kryesor vlerësimin fillestarë të fizibilitetit për ndërtimin e gazsjellësit ALKOGAP – si një linjë furnizimi të gazit natyror nga rajoni i kaspikut përmes gazsjellësve rajonal TAP/IAP, që në fazën e parë do të lidhë Shqipërinë me Kosovën dhe potencialisht në të ardhmen të vazhdoj drejt vendeve tjera të rajonit.

Në kuadër të bashkëpunimit rajonal, Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit dhe Ministri për Ekonomi i Maqedonisë së Veriut nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi për intensifikimin e bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve duke përcaktuar fushat prioritare për bashkëpunim në lidhje me sektorin e energjisë. Në funksion të zbatimit të kësaj marrëveshjeje, në pjesën e parë të vitit 2019 përmes platformës WBIF është bërë një aplikim i përbashkët me palën Maqedonisë së Veriut, kjo e fundit në rolin e promotorit të projektit, për mbështetje financiare në formë granti për të realizuar një studim të fizibilitetit për gazsjellësin Maqedoni e Veriut – Kosovë. Sipas njoftimeve, Komiteti Drejtues i WBIF ka miratuar grantin në vlerën EUR 0.650 mil. Ky studim do të realizohet përmes asistencës teknike e angazhuar nga platforma WBIF/BERZH i cili planifikohet të realizohet në periudhën 2020-2021.

Më tej, me iniciativën e Korporatës së Sfidave të Mijëvjeçarit (MCC), në fillim të pjesës së parë të vitit 2020 është realizuar edhe një studim i parafizibilitetit për gazifikimin e Kosovës nga konsulentët e angazhuar nga MCC. Këto rezultate të dalura do të shërbejnë si mbështetje për përgaditjen e Master planit për gazin natyror për Kosovën dhe Studimin e fizibilitetit për interkoneksionin me Maqedoninë e Veriut.

Mbështetja e donatorëve

Sa i përket mbështetjes së donatorëve, Qeveria e Republikës së Kosovës është duke i përgatitur aplikacionet për rundin e V të investimeve në WBIF që ka për afat përfundimtar të aplikimit fundin nëntorit. Projektet të cilat janë duke u përgatitur për aplikim në WBIF janë:

- Rehabilitimi i Përgjithshëm i Hekurudhës 10 Faza 3, - Kufiri me Serbinë - Leshak-Fushe Kosove-Hani i Elezit – Kufiri me Seksionin Hekurudhor të Maqedonisë së Veriut, përfshirë sinjalizimin dhe Telekomin;
- Rehabilitimi i Përgjithshëm i linjës hekurudhore Lindore (Kufiri me Serbinë - Podujevë - Fushë Kosovë);
- Ndërtimi i Autostradës (Rruga 7 SEETO) Seksioni E nga Prishtina në Merdare.

Ndërsa, sa i përket mbështetjes së donatorëve tek TEN-E përmes programit Sfida të mijëvjeçarit (MCC) do të realizohet studimi i fizibilitetit "Zhvillimi i sektorit të Gazit në Kosovë" (MCC Programi 1).

Objektivat prioritare afatmesme

TEN T:

- Ndërtimi i Autostradës R7 Morinë-Prishtinë-Merdarë, segmenti Besi-Merdarë;
- Përfundimi i segmentit të zgjerimit të rrugës Nacionale N9, Zahaq – Pejë dhe ndërtimi i segmentit të Autostradës Kijevë – Zahaq;

- Ndërtimi i rrugës nacionale N2 Prishtinë – Mitrovicë;
- Rehabilitimi gjeneral dhe modernizimi i Linjës së 10-të hekurudhore (Kufiri me Serbinë – Leshak – Fushë Kosovë – Hani i Elezit – Kufiri me Maqedoninë e Veriut);
- Rehabilitimi gjeneral dhe modernizimi i Linjës së 7-të hekurudhore (Kufiri me Serbinë – Podujevë – Prishtinë – Fushë Kosovë).

TEN-E:

- Krijimi i tregut të përbashkët të energjisë elektrike me Shqipërinë;
- Anëtarësimi i KOSTT në ENTSO-E;
- Studimi i fizibilitetit dhe VNMS për Gazsjellësin Maqedoni e Veriut – Kosovë (2020-2021);
- Përgatitja e Master planit për shpërndarjen e gazit natyror në Kosovë (2021-2022);
- Studimi i fizibilitetit “Zhvillimi i sektorit të Gazit në Kosovë” (MCC Programi 1).

3.22. Kapitulli 22 i acquis-së: Politikat rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore

Ky kapitull mbulon të gjitha aspektet e fondeve strukturore dhe atyre të kohezionit të cilat BE u akordon shteteve në kuadër të paketës së zgjerimit me qëllim të harmonizimit të nivelit të zhvillimit të vendit përkatës në tërë territorin e tij dhe arritjes së konvergjencës zhvillimore të të gjitha rajoneve. Kjo është e domosdoshme në mënyrë që shteti i ardhshëm anëtar të jetë në gjendje të funksionojë në tërë territorin e tij në përputhje me kriteret e përcaktuara me acquis dhe me standardet relevante. Më konkretisht, substanca e asaj që mbulon ky kapitull përfshin përpilimin, miratimin dhe zbatimin e programeve të Fondeve Strukturore dhe Fondit të Kohezionit, në përputhje me organizimin e territorial të vendit përkatës. Më tej, pasi që këto programe negocohen me Komisionin Evropian, por zbatimi i tyre është përgjegjësi e vendit përkatës, dhe kjo ndodh pas anëtarësimit, gjatë procesit të anëtarësimit kërkohet ndërmarrja e masave parapërgatitore në drejtim të kësaj. Acquis në këtë kapitull konsiston kryesisht në rregullore kornizë dhe rregullore për zbatim, të cilat nuk kërkojnë ndryshime në legjislacionin kombëtar, por vetëm zbatim të dispozitave ligjore të BE-së nëpërmjet legjislacionit të Kosovës, me qëllim që të sigurohet zbatimi i instrumenteve financiare të BE-së në përputhje me rregullat e vendosura nga BE.

Në përputhje me këtë, në periudhën para se të bëhet shtet kandidat, Kosova duhet të vendosë strukturat ligjore, institucionale e administrative në mënyrë që kur të vijë koha të mund të zbatojë me sukses dhe në mënyrë të duhur këto programe. Prandaj ky kapitull ofron një përmbledhje të përgjithshme të nevojave të Kosovës për sa u përket masave të tilla, si dhe nevojave për t'u përgatitur për përfitim të mëtejshëm nga asistenca e BE-së që do të përfitojë gjatë procesit të anëtarësimit. Bazuar në këto nevoja, Kosova duhet të hartojë politikat konceptuale për fondet strukturore dhe për politikat rajonale dhe të planifikojë ngritjen e kapaciteteve të veta të qëndrueshme administrative për zbatimin e tyre.

Kërkesat e MSA-së

MSA, në nenet 121, 122, 123, 124 dhe 125, i mundëson Kosovës qasje në asistencën e ofruar nga BE si pjesë e procesit të integritimit evropian të vendit. Asistenca e BE-së kushtëzohet me përmbushjen e kriterëve politike për procesin e integritimit evropian dhe obligimeve nga procesi i stabilizim-asociimit dhe do të fokusohet në përafrimin e legjislacionit vendor me atë të BE-së, zhvillimin ekonomik të vendit dhe përmirësimin e qeverisjes. Ajo do të jetë e bazuar në programe vjetore apo shumëvjeçare të pajtuara në mes Kosovës dhe BE-së, brenda një kornize indikative shumëvjeçare. Asistenca e BE-së mund të jepet edhe në formë të ndihmës makro-financiare, në koordinim me institucionet ndërkombëtare financiare, në kuadër të realizimit të programeve në mes Kosovës dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Për të përmbushur obligimet e veta në kuadër të MSA-së, Kosova duhet të sigurohet që bashkëpunimi financiar do të vazhdojë të mbështesë reformat demokratike, ekonomike dhe institucionale, në përputhje me procesin e stabilizim-asociimit. Kosova duhet të fuqizojë koordinimin e donatorëve dhe asistenca financiare e BE-së duhet të koordinohet ngushtë me burimet e tjera nga shtetet anëtare dhe vendet e tjera jashtë BE-së si dhe institucionet financiare ndërkombëtare. Kosova obligohet që të ofrojë informata të rregullta për të gjitha burimet e asistencës.

Që nga viti 2007, BE ka ofruar ndihmë financiare për vendet kandidatë dhe kandidatë potenciale për anëtarësim në BE në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA), në përputhje me Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 1085/2006 e datës 17 korrik 2006 që themeloi Instrumentin për Asistencën e Para-Anëtarësimit (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja Kornizë), në përputhje me nenin 17 të Rregullores Kornizë dhe me nenin 7 të Rregullores (KE) nr. 718/2007 mbi zbatimin e Rregullores së Këshillit (KE) nr. 1085/2006. Çdo vend përfitues ka arritur një marrëveshje kornizë me Komisionin Evropian në mënyrë që të përcaktohen rregullat dhe parimet e bashkëpunimit të paraparë me Rregulloren Kornizë. Asistenca e dhënë nëpërmjet IPA-s është vazhduar për periudhën 2014-2020, me rregulloren 231/2014 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit që themelon një instrument të para-anëtarësimit (IPA 2), përkatësisht rregulloren për zbatimin e IPA 2. Qeveria e Republikës së Kosovës dhe KE (KE) kanë nënshkruar Marrëveshjen Kornizë e cila ka hyrë në fuqi më 16 prill 2015. Bazuar në Marrëveshjen Kornizë, për çdo program vjetor të IPA-s nënshkruhen marrëveshjet financiare.

Gjendja aktuale

Korniza legislative

Siç u tha, *acquis* në këtë kapitull konsiston kryesisht në rregullore kornizë dhe rregullore për zbatim, të cilat nuk kërkojnë ndryshime në legjislacionin kombëtar, por vetëm zbatimin e tyre nëpërmjet legjislacionit vendor, me qëllim që të sigurohet zbatimi i instrumenteve financiare të BE-së në përputhje me rregullat e BE-së. Megjithatë, zbatimi i duhur i këtyre fondeve kërkon transpozim të *acquis*-së në fushate ndërlidhura, sikurse ndihma shtetërore, mjedisi dhe prokurimi publik. Masat në këtë drejtim mbulohen nga kapitujt përkatës të këtij Programi.

Korniza institucionale

Korniza institucionale në këtë fushë përbëhet nga:

- Zyra e Kryeministrit;
- Ministria e Zhvillimit Rajonal.

Programimi

Programimi i asistencës së BE-së nëpërmjet IPA-s bazohet në Dokumentin Indikativ Strategjik 2014-2020, i cili përcakton sektorët dhe prioritetet afatgjate për periudhën 2014-2020. Asistenca e dhënë përmes IPA për periudhën 2014-2020 përfshin një shumë prej mbi 602 milionë eurosh. Programimi është sektorial, i bazuar në dokumentet planifikuese sektoriale, si dokumente të cilat përmbajnë informatat relevante për sektorët përkatës. Janë hartuar 7 dokumente për sektorët në vijim:

- Sundimin e ligjit;
- Energjinë;
- Bujqësinë;
- Reformën e administratës publike;
- Konkurrueshmërinë dhe inovacionin;
- Arsimin, punësimin dhe politikat sociale;
- Mjedisin.

Marrëveshja financiare për IPA 2016 pjesa e parë ka hyrë në fuqi, sikurse dhe marrëveshja financiare për IPA 2016, pjesa e dytë. Nga kjo e fundit Kosova do të përfitojë nga përkrahja e drejtpërdrejtë buxhetore në kuadër të sektorit të administratës publike shumë prej 25 milionë euro, e cila ka filluar të disbursohet duke filluar nga viti 2019. Gjithashtu ka hyrë në fuqi marrëveshja financiare për IPA 2017 pjesa e parë, si dhe IPA 2017, pjesa e dytë, e cila përkrah menaxhimin e financave publike me shumë të njëjtë, 25 milionë euro si përkrahje buxhetore sektoriale. Gjatë vitit 2018 dhe 2019 kanë filluar përgatitjet për programimin e IPA 2019 dhe 2020 dhe gjatë vitit 2019 ka hyrë në fuqi marrëveshja për IPA 2018 dhe për IPA 2019, pjesa e parë, ndërsa gjatë vitit 2020 janë përfunduar marrëveshjet financiare për programet në kuadër të IPA 2019, pjesa e dytë dhe marrëveshja financiare për IPA 2020.

Për të koordinuar të gjitha investimet infrastrukturore në Republikën e Kosovës, të financuara nga burimet e brendshme dhe ato të jashtme, me Vendim të Qeverisë më 8 korrik 2015 është themeluar Këshilli Kombëtar për Investime (KKI). Më 9 korrik 2020 vendimi është ndryshuar dhe është themeluar Komisioni për Planifikim Strategjik (KPS) që udhëhiqet nga Kryeministri dhe që luan rolin e Këshillit Kombëtar për Investime. Ndërsa, më datën 18 dhjetor 2017 Qeveria e Kosovës aprovoi Listën Prioritare të Projekteve Infrastrukturore ku përfshihen 63 projekte me vlerë prej 3, 4 miliardë euro në katër (4) sektorë: Transporti, Mjedisi, Energjia dhe sektori Social.

Në kontekst të bashkëpunimit me shtetet e tjera, janë miratuar programet shumëvjeçare (IPA 2014-2020) për bashkëpunimin ndërkufitar me shtetet e rajonit, sikurse Kosovë-Shqipëri, Kosovë-Mal i Zi dhe Kosovë-Maqedoni e Veriut. Janë nënshkruar marrëveshjet e partneritetit për menaxhimin e asistencës teknike për programin e bashkëpunimit ndërkufitar me secilin shtet partner për periudhën shumëvjeçare IPA II 2014-2020. Gjatë kësaj periudhe, për shkak të procesit të ndryshimeve ku Mali i Zi pritet të kalojë në sistem të decentralizuar të menaxhimit, më 10 shkurt 2017 është nënshkruar dhe ka hyrë në fuqi marrëveshja bilaterale në mes Kosovës dhe Malit të Zi për programin e bashkëpunimit ndërkufitar.

Për më tepër, janë nënshkruar marrëveshjet financiare trepalëshe vjetore për vitet 2019 dhe 2020 për programin e bashkëpunimit ndërkufitar në mes Komisionit Evropian, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut, dhe pritet të përfundohet edhe marrëveshjet në mes Komisionit Evropian, Kosovës dhe Shqipërisë, si dhe në mes Komisionit Evropian, Kosovës dhe Malit të Zi. Këto marrëveshje pritet të hyjnë në fuqi në momentin e njoftimit të palëve përmes kanaleve diplomatike.

Strukturat për zbatimin e programit të bashkëpunimit ndërkufitar me shtetet partnere përbëhen nga: Struktura Operative (SO) e udhëhequr nga MPL, ku sekretari i përgjithshëm i MAPL është udhëheqës i SO, deleguar nga NIPAC-u. Strukturat e tjera për zbatimin e këtij programi janë: Sekretariati Teknik i Përbashkët (JTS) dhe Komitetet e Përbashkëta Monitoruese (JMC) për secilin shtet bashkëpunues në këtë program. Në programin e bashkëpunimit ndërkufitar me Malin e Zi, rolin e auditorit në kuadër të shtetit të Kosovës e bartë Njësia Qendrore Harmonizuese e Auditimit të Brendshëm në kuadër të MFPT, ndërsa Trupi Kontrollues është në kuadër të MAPL-së.

Monitorimi

Komiteti i Përbashkët Monitorues i IPA-s siguron monitorimin e realizimit të programeve dhe projekteve të financuara nëpërmjet burimeve të IPA-s, i cili takohet mbi baza vjetore. Monitorimi i përgjithshëm i asistencës së donatorëve dhe në veçanti i asistencës së BE-së bëhet në dy mënyra: shfrytëzimi i raportimit të rregullt të donatorëve në kuadër të Platformës për Menaxhimin e Ndihmës (PMN) dhe pjesëmarrja e zyrtarëve në kuadër të takimeve të Komiteteve Drejtuese të projekteve.

Objektivat prioritarë afatmesme

Përderisa ka përfunduar programimi i IPA II dhe tani pritet të fillojë instrumenti i ri – IPA III, ende nuk janë përcaktuar obligimet e sakta të Kosovës për IPA III.

3.23. Kapitulli 23 i acquis-së: Gjyqësori dhe të drejtat themelore

Kapitulli 23 i acquis mbulon këto fusha: sistemin gjyqësor, politikat kundër korrupsionit dhe të drejtat themelore. Politikat e Bashkimit Evropian në fushën e gjyqësorit dhe të drejtave themelore synojnë të ruajnë dhe zhvillojnë më tej BE-në si një zonë të lirisë, sigurisë dhe drejtësisë. Krijimi i një gjyqësori të pavarur dhe efikas është i një rëndësie të madhe. Paanshmëria, integriteti dhe një standard i lartë i gjykimeve nga gjykatat është i një rëndësie thelbësore për ruajtjen e sundimit të ligjit. Kjo kërkon një angazhim të fortë për të eliminuar ndikimet e jashtme mbi gjyqësorin dhe për të kushtuar burime të mjaftueshme financiare si dhe trajnime në fushën e gjyqësorit. Gjithashtu, garancitë ligjore për procedurat e gjykimit të drejtë duhet të jetë në vend. Njëkohësisht, nga Shtetet Anëtare kërkohet luftimi i korrupsionit në mënyrë efektive, pasi që kjo përbën një kërcënim për stabilitetin e institucioneve demokratike dhe sundimin e ligjit. Një kornizë solide ligjore dhe institucionale e besueshme është e nevojshme për të mbështetur një politikë koherente për parandalimin dhe pengimin e korrupsionit. Për më tepër, shtetet anëtare duhet të sigurojnë respektimin

e të drejtave themelore dhe të drejtave të qytetarëve të BE-së, siç garantohet me legjislacionin e BE-së dhe me Kartën e të Drejtave Themelore.

Kërkesat e MSA-së

Sistemi gjyqësor

Në kuadër të fushëveprimit të sistemit gjyqësor, në përputhje me detyrimet dhe kërkesat e aderimit në Bashkimin Evropian që dalin nga MSA (Neni 83) kërkohet të intensifikohet bashkëpunimi me BE-në në fushën e gjyqësorit, me fokus në forcimin e institucioneve, me qëllim të konsolidimit të shtetit të së drejtës përmes forcimit të pavarësisë, paanshmërisë dhe llogaridhënies së sistemit gjyqësor. Bashkëpunimi do të fokusohet në veçanti në administrimin e drejtësisë, zhvillimin e strukturave adekuate të gjykatave e prokurorive, dhe të organeve të tjera gjyqësore, me qëllim të përgatitjes së tyre të duhur për bashkëpunim në çështjet civile, komerciale e penale, si dhe për parandalimin, hetimin, ndjekjen dhe gjykimin e krimit të organizuar, korrupsionit dhe terrorizmit.

Politikat kundër korrupsionit

Sipas obligimeve të dala nga MSA, neni 83 (Fuqizimi i institucioneve dhe shtetit të së drejtës) dhe 91 (Parandalimi dhe luftimi i krimit të organizuar dhe aktiviteteve të tjera të paligjshme), kërkohet zhvillimi i strukturave adekuate të policisë, prokurorëve dhe gjyqtarëve dhe organeve të tjera gjyqësore dhe të zbatimit të ligjit në mënyrë që të mundësohet parandalimi, hetimi, ndjekja penale dhe gjykimi i veprave korruptive në mënyrë efektive (Neni 83). Gjithashtu, sipas nenit 91, kërkohet që palët të bashkëpunojnë me qëllim të forcimit të strukturave të Kosovës për luftimin dhe parandalimin e veprimtarive kriminale në veçanti të korrupsionit dhe formave të tjera të krimeve të rënda me një shtrirje ndërkombëtare. Në këtë drejtim kërkohet që Kosova të respektoj konventat përkatëse ndërkombëtare dhe instrumenteve në këtë fushë. Në nivelin e parandalimit, Kosovës i kërkohet të synojë zbatimin e masave të cilat janë ekuivalente me ato të përcaktuara në legjislacionin përkatës të BE-së, dhe t'ju përmbahet konventave dhe instrumenteve përkatëse ndërkombëtare të lidhura me këtë fushë.

Të drejtat themelore, mbrojtja e minoriteteve dhe trashëgimia kulturore

Sa i përket mbrojtjes së të drejtave themelore dhe mbrojtjes së minoriteteve, në përputhje me kërkesat që dalin nga MSA, duhet të sigurohet respektimi i parimeve demokratike dhe të drejtave e njeriut, siç janë shpallur në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut të vitit 1948 dhe siç janë përkufizuar në Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut të vitit 1950, në aktin final të Helsinkit dhe në Kartën e Parisit për një Evropë të re (Neni 3). Gjithashtu institucionet e Kosovës duhet të sigurojnë respektimin të drejtës dhe instrumenteve ndërkombëtare, përfshirë ato që ndërlidhen me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të drejtave themelore, e deri tek mbrojtja e personave që u përkasin minoriteteve, pa diskriminim mbi çfarëdo baze (Neni 4).

Mbrojtja e të dhënave personale

Bazuar në obligimet që dalin nga neni 84 i MSA, institucionet e Republikës së Kosovës duhet të sigurohen që legjislacioni i mbrojtjes së të dhënave personale, të korrespondon me atë të *acquis-it* të BE-së. Mbrojtja e të dhënave personale, duhet të zhvillohet në atë mënyrë që t'i përshtatet kërkesave të legjislacionit të BE-së nga kjo fushë.

Kërkesat nga mekanizmat e tjerë të aderimit në BE

Sistemi gjyqësor

Sipas të gjeturave të *Raportit të KE-së për Kosovën – 2020*, janë identifikuar këto mangësi në funksionimin e gjyqësorit: zbatueshmëria e kufizuar e ligjeve të pakos së drejtësisë të vitit 2015, pamundësia e gjyqësorit për të mos iu nënshtruar ndikimit të tepruar politik, kapacitetet e kufizuara të institucioneve të sundimit të ligjit, dhe administrimi i drejtësisë në mënyrë efikase dhe të shpejtë. Kosova duhet që posaçërisht vëmendje t'i kushtojë rëndësi çështjeve në vijim:

- Miratimit të Ligjit për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve;

- Institucionet e sundimit të ligjit të bëjnë përpjekje të vazhdueshme për të ngritur kapacitetet e tyre. Pandemia COVID-19 kufizoi mbajtjen e seancave gjyqësore në Kosovë; megjithatë Kodi i Procedurës Penale të Kosovës parashikon që një gjykim duhet të fillojë rishtas pas 3 muajsh pa asnjë seancë dëgjimore. Një numër i konsiderueshëm i gjykimeve penale (përfshirë ato të profilit të lartë) mund të preken nga ky rregull. Institucionet e Kosovës duhet të ndjekin këtë çështje dhe të ndërmarrin masat e nevojshme për të siguruar zbatim efektiv dhe efikas të drejtësisë në Kosovë.
- Institucionet e vendit duhet të vazhdonjë të forcojnë kapacitetin e gjyqtarëve, prokurorëve dhe personelit ndihmës, si dhe të përmirësojnë administratën e gjykatës, në veçanti përmes lansimit të plotë të Sistemit Kombëtar të Centralizuar të Evidencës Penale si dhe Sistemit Informativ të Menaxhimit të Rasteve në të gjithë Kosovën;
- të finalizojë punën në Rishikimin Funksional të Sektorit të Sundimit të Ligjit dhe të hartojë një strategji gjithëpërfshirëse sektoriale që synon forcimin e pavarësisë, paanësisë, integritetit, llogaridhënies, si dhe kapacitetit të përgjithshëm të gjyqësorit dhe prokurorisë, me një fokus specifik në luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar;
- të shtojë përpjekjet për të zvogëluar grumbullin e rasteve të prapambetura, duke përfshirë përdorimin e mjeteve alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe në veçanti të ndërmjetësitimit, përdorimi i të cilave duhet të financohet dhe promovohet siç duhet.

Sipas kërkesave të dala nga takimi i Nënkomiteti për Drejtësi, Liri dhe Siguri, *për vitin 2020*, kërkohet që të finalizohet procesi i Rishikimit të Sektorit të Sundimit të Ligjit, sipas afateve të parapara nga Ministria e Drejtësisë dhe gradualisht të hyhet në fazën e zbatimit të strategjisë sektoriale. Gjithashtu është diskutuar që të vazhdohen përpjekje lidhur me krijimin mekanizmave në zgjidhjen e problemit në sistemin e drejtësisë, respektivisht ndikimin e pandemisë **COVID-19 në gjyqësor**, duke u fokusuar si në vijim:

- Të merren të gjitha veprimet për të minimizuar ndikimin e pandemisë COVID-19 në sistemin e drejtësisë, veçanërisht në hetimet penale dhe proceset gjyqësore që janë në vazhdim e sipër;
- Të sigurohet regjistrimi i saktë i të gjitha rasteve që kanë qenë të ndikuara dhe të cilat do të ndikohen nga rregulli 3-mujor i nenit 311 të KPP-së;
- Njësia e NCCR-së të themelohet zyrtarisht brenda Sekretariatit të KGJK-së;
- Njësia e NCCR-së e KGJK-së dhe Njësia e TI-së do të marrin përsipër plotësisht zbatimin dhe menaxhimin e funksionimit dhe mirëmbajtjen e bazës së të dhënave deri në fund të vitit 2020.

Gjithashtu, në kuadër të konkluzioneve të takimit të fundit të këtij Nënkomiteti, është kërkuar që:

- Sa i përket Sistemit Elektronik Informativ për Menaxhimin e Lëndëve, të sigurohet regjistrimi i të gjitha rasteve në mënyrë që të sigurohet përdorimi konsistent i tij për të gjitha rastet në të gjitha gjykatat dhe prokuroritë;
- Të sigurohet që sistemi e bën ndarjen e rastësishme të rasteve, si dhe caktimin automatik të gjyqtarëve në trupat gjyqësore në përputhje me Ligjin për Gjykatat;
- Të finalizohet procesi i përzgjedhjes së anëtarëve të mbetur të KGJK-së dhe KPK-së pa vonesë. Të sigurohet që procesi i përzgjedhjes të jetë transparent, i bazuar në merita dhe kandidatët e përzgjedhur i plotësojnë kërkesat ligjore për këto pozita
- Të kryhet vlerësimi gjithëpërfshirës i funksionimit të sistemit të masave disiplinore për gjyqtarët dhe prokurorët.

Politikat kundër korrupsionit

Sipas të gjeturave të *Raportit të KE-së për Kosovën – 2020* sa i përket luftimit të korrupsionit, sfidë mbetet krijimi i një regjistri të vazhdueshëm rastesh të hetimit dhe ndjekjes penale të rasteve të nivelit të lartë, përfshirë këtu edhe dënimet e plotfuqishme, konfiskimi përfundimtar mbetet i ulët edhe pse është arritur progres edhe në konfiskimin preliminar të pasurive.

Pasi që rekomandimet e raportit të fundit janë adresuar vetëm pjesërisht, ato mbeten të vlefshme më vijues, andaj Kosova duhet t'i kushtojë vëmendje posaçërisht:

- Ndryshimit të kornizës ligjore (për pezullimin dhe largimin e zyrtarëve publikë nën aktakuzë dhe të dënuar për korrupsion, për deklarimin e pasurive, si dhe për sinjalizuesit) për ta përafuar atë me standardet evropiane; konkretisht të miratohet Kodi i rishikuar i Procedurës Penale;
- Miratimit të legjislacionit përkatës, së bashku me ndryshimin e Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsion, me qëllim që Agjencisë t'i ofrohen më shumë kompetenca për të verifikuar deklaratimet e pasurisë dhe për të bërë sistemin e deklarimit më efektiv në trajtimin e rryshfeteve;
- Të sigurojë që raportet financiare dhe raportet e fushatave të partive politike të publikohen e të auditohen vazhdimisht, si dhe të aplikohen sanksionet ndaj shkeljeve të ligjeve përkatëse. Të ndryshojë kornizën ligjore që rregullon financimin e partive politike dhe financimin e fushatave në bazë të mendimit të Komisionit të Venecias për të siguruar zbatim efektiv, llogaridhënie e transparencë.

Institucionet e drejtësisë duhet të forcojnë efikasitetin e regjimit të konfiskimit duke promovuar përdorimin sistematik të konfiskimit të zgjeruar dhe 'të rregullt' nga prokuroria dhe policia, me krijimin e një fondi konfiskimi dhe me përmirësimin e procesit të shitjes së pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara të menaxhuara nga Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuara (AAPSK).

Gjithashtu, të prioritetizohet zbatimi i plotë i kornizës së rishikuar legjislative në fushën e sundimit të ligjit, përfshirë trajnimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit, për ta bërë atë një mjet efektiv për luftimin e korrupsionit.

Sipas obligimeve të dala nga Nën-komiteti për Drejtësi, Liri dhe Siguri, për vitin 2020, institucionet e Republikës së Kosovës duhet të përkushtohen fuqimisht në përfundimin e strukturave për luftimin, parandalimin, hetimin, ndjekjen penale, dhe gjykimin në mënyrë efektive të korrupsionit. Gjithashtu është e nevojshme monitorim i vazhdueshëm për të shqyrtuar përparimin e institucioneve në regjistrin e rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë dhe krimin të organizuar në lidhje me liberalizimin e vizave.

Për më tepër, autoritetet duhet të krijojnë Fondin e Konfiskimit dhe të fuqizojnë operacionet e Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK).

Të drejtat themelore, mbrojtja e minoriteteve dhe trashëgimia kulturore

Bazuar në të gjeturat e *Raportit të KE-së për Kosovën – 2020*, në fushën e të drejtave themelore, kadri ligjor garanton mbrojtjen e të drejtave themelore dhe është në përputhje me standardet evropiane. Mirëpo duhet bërë më shumë për të promovuar dhe siguruar zbatimin e plotë të legjislacionit dhe politikave të të drejtave të njeriut. Koordinimi i qeverisë për mekanizmat e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe atyre të pakicave, si në nivelin qendror dhe atë lokal, duhet të përmirësohet dhe çështjet e të drejtave themelore duhet të zënë vend më lart në agjendën politike. Ka mungesë të burimeve njerëzore dhe financiare dhe autoritetet përkatëse janë ende të varura nga mbështetja e donatorëve. Mekanizmat e koordinimit ndërministror shpesh trajtohen si formalitet dhe janë provuar të jenë joefektivë në avancimin e të drejtave të njeriut.

Më shumë përpjekje duhet të bëhen për të adresuar rekomandimet e raportit të vitit 2019, të cilat janë ende të zbatueshme. Kosova duhet në veçanti:

- Të rivlerësojë dhe forcojë efikasitetin dhe efektivitetin e mekanizmave për koordinimin dhe zbatimin e politikave dhe strategjive të të drejtave të njeriut. Të forcohet roli i zyrtarëve kundër diskriminimit në ministri dhe komuna;
- Të forcojë zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore dhe të ndërmarrë veprime konkrete për të siguruar funksionimin e strehimoreve për viktimat e dhunës me bazë gjinore;
- Të miratojë Strategjinë për Kthim dhe Komunitete dhe të sigurojë zbatimin e duhur të Strategjisë për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali¹⁴ në shoqërinë e Kosovës 2017-2021;
- Të miratojë Ligjin për Trashëgiminë Kulturore dhe Ligjin për Lirinë Fetare dhe të sigurojë funksionimin e qëndrueshëm të Këshillit për Zbatim dhe Monitorim. Të avancohet mbrojtja e

¹⁴ Të gjitha këto grupe konsiderohen në kuadër të termit më të gjerë gjithëpërfshirës 'romë', sipas Kornizës së BE-së për Strategjitë Kombëtare për Integrimin e Romëve.

trashëgimisë kulturore duke zbatuar plotësisht legjislacionin për zonat e veçanta të mbrojtura dhe ndërtimet e paligjshme.

Kurse, *sa i përket fushës së lirisë së shprehjes*, është bërë **përparim i kufizuar** në adresimin e rekomandimeve të raportit të mëparshëm. Mbeten shqetësuese fushatat e shpifjeve publike dhe kërcënimet ndaj gazetarëve. Ekzistojnë shqetësime të veçanta në lidhje me lirinë e shprehjes në veri të Kosovës, përfshirë vetëcensurën.

Iniciativat ligjore të Komisionit për Qeverisje Lokale, Administratë Publike dhe Media të Kuvendit të Kosovës (projektligjet për transmetuesin publik dhe Komisionin e Pavarur të Mediave) nuk kishin transparencë. Transmetuesi publik mbetet i cenueshëm nga presioni dhe ndikimi politik. Mungesa e vetëqëndrueshmërisë financiare i lë mediat të cenueshme ndaj interesave politike dhe të biznesit. Kjo përforcohet më tej nga mungesa e informacionit dhe të dhënave mbi përfituesin përfundimtar të pronësisë së mediave - dispozitatat për këtë ende nuk janë të përfshira në ligj.

Në vitin e ardhshëm, Kosova duhet të përmirësojë më tej përgjigjen e institucioneve përgjegjëse ndaj sulmeve fizike kundër gazetarëve dhe formave të tjera të presionit, përfshirë përmes bashkëpunimit më të mirë ndërinstitucional. Gjithashtu duhet të sigurojë financim të qëndrueshëm për transmetuesin publik në një mënyrë që ruan pavarësinë e tij. Nevojitet të rishikohet Ligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave për të përditësuar kompetencat e tij, përfshirë sa i përket mediave audio-vizuale në përputhje me Direktivën e Shërbimeve të Mediave Audio-Vizuale; si dhe të rritet disponueshmëria e të dhënave mbi tregun audio-vizual, veçanërisht kur bëhet fjalë për pronësinë e mediave.

Sipas obligimeve të dala nga Nënkomiteti për Drejtësi, Liri dhe Siguri, është i nevojshëm përkushtimi i institucioneve për zbatimin e pakos së ligjeve për të drejtat e njeriut, dhe t'i jepet prioritet më i lartë politik mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Institucionet e vendit duhet të ndër marrin hapa konkretë për të fuqizuar koordinimin e mekanizmave ekzistues për të drejtat e njeriut në nivel qendror dhe atë lokal, si dhe për të fuqizuar rolin e zyrtarëve për të drejtat e njeriut në ministri dhe komuna. Nevojitet të sigurohet monitorimi i duhur i aktiviteteve përcjellëse për raportet dhe rekomandimet nga Avokati i Popullit, në funksion të rritjes së mëtejshme të shkallës së zbatimit.

Institucionet e sundimit të ligjit duhet të vazhdojnë të hetojnë në mënyrë të plotë sulmet ndaj gazetarëve, rastet e dhunës seksuale dhe dhunës në familje, krimet e urrejtjes, gjuha e urrejtjes dhe diskriminimi dhe sulmet ndaj personave të komunitetit LGBTI, duke siguruar hetime në kohë dhe të plota dhe gjykim të rasteve të tilla.

Të miratohen aktet nënligjore për Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve. Si dhe të ndërmerren hapa më konkretë për zbatimin e Ligjit për Personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik dhe Ligjit për Personat e Verbër.

Duhet të miratohet Ligji i rishikuar kundër Dhunës në Familje me qëllim që të jetë në përputhje me Kodin Penal aktual i cili e përcakton dhunën në familje si vepër të ndarë penale, dhe të vazhdohet me trajnimin e gjyqtarëve, prokurorëve dhe policisë mbi legjislacionin penal në lidhje me dhunën në familje dhe format e tjera të dhunës me bazë gjinore. Qeveria duhet të ndajë buxhet të qëndrueshëm dhe të përhershëm për financimin e strehimoreve, në mënyrë që funksionimi i tyre të jetë i qëndrueshëm dhe efikas dhe të parandalohen mbylljet e tyre të përkohshme.

Në kuadër të fushës së lirisë së shprehjes, duhet të sigurohet pa vonesa të mëtejshme financimi i qëndrueshëm për RTK-në në një mënyrë që ruan pavarësinë e saj. Gjithashtu duhet të rishikohet Ligji mbi Komisionin e Pavarur për Media në mënyrë që të përditësohen kompetencat në lidhje me shërbimet e mediave audio-vizuale online që mbulohen nga Direktiva e vitit 2010 për shërbimet e mediave audio-vizuale.

Mbrojtja e të dhënave personale

Sipas të gjeturave të *Raportit të KE-së për Kosovën - 2020* për zbatimin e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale duhet emëruar Komisioneri i Agjencisë së re të Informacionit dhe Privatësisë. Gjithashtu duhet të miratohen aktet e nevojshme nënligjore esi dhe të sigurohet që buxheti i Agjencisë.

Gjendja aktuale

Korniza legislative dhe ajo e politikave

Sistemi gjyqësor

Korniza legislative në këtë fushë përbëhet nga këto akte kryesore normative:

- Ligji për Gjykatat;
- Ligji për Prokurorin e Shtetit;
- Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës;
- Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës;
- Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës;
- Ligji për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe Prokurorëve;
- Ligji për Akademinë e Drejtësisë;
- Ligji për Noterinë;
- Ligji për Ndërmjetësim;
- Ligji për Procedurën Përmbartimore;
- Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale;
- Kodi Penal i Republikës së Kosovës;
- Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës;
- Ligji për Përgjegjësinë Penale të Personave Juridik.

Korniza e politikave në këtë fushë përbëhet nga këto dokumente:

- Plani Strategjik 2019-2021 i sistemit prokurorial;
- Strategjia dhe Plani i Veprimit për reduktimin e Lëndëve të Vjetra;
- Strategjia Zhvillimore e Ministrisë së Drejtësisë 2018-2021;
- Korniza legislative dhe ajo e politikave në fushën e luftimit të korrupsionit.

Politikat kundër korrupsionit

Fushën e politikave kundër-korrupsion në Republikën e Kosovës e rregullojnë ligjet në vijim:

- Ligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të gjithë Zyrtarëve të Lartë Publik;
- Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik;
- Ligji për Agjencinë Kundër Korrupsionit;
- Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve;
- Ligji mbi Financimin e Subjekteve Politike;
- Ligji për Prokurimin Publik.

Korniza e politikave në këtë fushë përbëhet nga këto dokumente:

- Plani Strategjik 2019-2021 i sistemit prokurorial;
- Strategjia dhe Plani i Veprimit Kundër Korrupsionit;
- Plani i Veprimit kundër Korrupsionit.

Të drejtat themelore

Korniza legislative në këtë fushë përbëhet nga këto akte kryesore normative:

- Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi;
- Ligji për Avokatin e Popullit;
- Ligji për Barazi Gjinore, Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje;
- Kodi Penal i Republikës së Kosovës;
- Kodi i Drejtësisë për të Mitur;
- Ligji për Mbrojtjen e Fëmijës;
- Ligji për Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve;
- Ligji për Aftësim, Ri aftësim dhe Punësim të Personave me Aftësi të Kufizuar;

- Ligji për Personat e Verbër;
- Ligji për Përkrahjen Materiale Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar të Përhershme;
- Ligji për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetrapelgjik.

Korniza e politikave në këtë fushë përbëhet nga këto dokumente:

- Strategjia Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar 2013-2023;
- Strategjia kombëtare për të drejta pronësore;
- Procedurat Standarde të Veprimit Kundër Dhunës në Familje;
- Programi i Kosovës për Barazi Gjinore dhe plani i Veprimit 2020-2024
- Strategjia për të drejtat e fëmijëve 2019 – 2023.

Mbrojtja e minoriteteve dhe trashëgimia kulturore

Ligjet të cilat mbulojnë fushën e mbrojtjes së minoriteteve dhe trashëgimisë kulturore janë si në vijim:

- Ligji për Mbrojtjen dhe Promovimin e të drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës;
- Ligji për Përdorimin e Gjuhëve;
- Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura.

Korniza e politikave në këtë fushë përbëhet nga këto dokumente:

- Strategjia dhe plani i veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare 2017-2021;
- Strategjia për Komunitete dhe Kthim;
- Strategjia Kombëtare për Trashëgimi Kulturore 2017-2027.

Mbrojtja e të dhënave personale:

- Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale.

Korniza institucionale

Sistemi gjyqësor

Korniza institucionale në fushën e sistemit gjyqësor përbëhet nga institucionet në vijim:

- Ministria e Drejtësisë;
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës;
- Këshilli Prokurorial i Kosovës;
- Prokurori i Shtetit;
- Akademia e Drejtësisë;
- Gjykatat themelore;
- Gjykata e Apelit;
- Gjykata Supreme;
- Gjykata Kushtetuese.

Si institucione të tjera që mbulojnë fushën e sistemit të drejtësisë janë edhe Oda e Noterëve të Kosovës, Oda e Avokatëve të Kosovës, dhe Oda e Përmbartuesve Privat të Kosovës.

Politikat kundër korrupsionit

Korniza institucionale në fushën e politikave kundër korrupsionit përbëhet nga këto institucione:

- Agjencia Kundër Korrupsionit;
- Task Forca Speciale Anti-Korrupsion e PSRK-së;
- Koordinatorin Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik;
- Këshilli Kombëtar Kundër Korrupsionit;
- Prokuroritë Themelore;

- Mekanizmi përcjellës për ngritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional - Këshilli Prokurorial i Kosovës ka realizuar krijimin e bazës së të dhënave/Mekanizmin përcjellës me qëllim të harmonizimit të raporteve statistikore në mes të subjekteve parashtruese të kallëzimeve penale.

Të drejtat themelore

Korniza institucionale në fushën e të drejtave themelore përbëhet nga këto mekanizma:

- Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe kundër Diskriminimit (ZKM);
- Institucioni i Avokatit të Popullit;
- Agjencia për Barazi Gjinore;
- Zyrtarët/ët për Barazi gjinore në ministri dhe komuna;
- Zyrtarët për mbrojtje nga Diskriminimi në Ministri dhe Komuna;
- Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës;
- Koordinatori Nacional Kundër Dhunës në Familje;
- Komiteti Ndërminstros për të Drejtat e Fëmijëve;
- Grupi Koordinues Ndërminstros për të Drejtat e Njeriut
- Grupi Këshillëdhënës dhe Koordinues për të drejtat e personave nga komuniteti LGBTI;
- Shërbimi Korrektues i Kosovës;
- Shërbimi Sprovues i Kosovës;
- Inspektorati i MD-së për ShKK;
- Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e torturës dhe trajtimeve të e tjera mizore, jonjerëzore ose poshtëruese;
- Agjencia për Ndihmë Juridike Falas;
- Këshilli Nacional për Personat me Aftësi të Kufizuara.

Mbrojtja e minoriteteve dhe trashëgimia kulturore

Korniza institucionale në fushën e mbrojtjes së minoriteteve dhe trashëgimisë kulturore përbëhet nga:

- Ministria për Komunitete dhe Kthim;
- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- Këshilli Konsultativ për Komunitete;
- Këshilli Zbatues Monitorues;
- Zyra e Komisionarit për Gjuhët;
- Zyra për Çështje të Komuniteteve;
- Grupi Teknik i Punues për Koordinimin e zbatimit të rekomandimeve të Konventës Kornizë për Mbrojtje të Pakicave Kombëtare;
- Komitetet Lokale për Siguri Publike;
- Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi.
- Komiteti Komunal Veprues për Monitorimin e zbatimit të strategjisë dhe planit të veprimit për përfshirjen e komuniteteve Rom dhe Ashkali në shoqërinë kosovare.
- Grupi Teknik Punues për Mbrojtjen nga Diskriminimi të Komunitetit rom, ashkali dhe egjiptas.

Mbrojtja e të dhënave personale

- Agjencia e Informacionit dhe Privatësisë.

Mbështetja e donatorëve

Sistemi gjyqësor

Në vijim përmbledhen projektet e asistencës së BE-së dhe asaj bilaterale në fushën e gjyqësorit.

Sistemi i Menaxhimit Informativ të Lëndëve ka për qëllim mbështetjen e institucioneve të drejtësisë në Kosovë. Ky projekt, i mbështetur nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë, ka për qëllim të siguroj asistencë

teknike Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) ne automatizimin e funksionimit të punës në të gjitha gjykatat dhe prokuroritë e Kosovës.

Projekti Britanik: Fuqizimi i sistemit gjyqësor dhe prokurorial që ka për qëllim fuqizimin e kapaciteteve dhe rolit të Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK) duke ofruar mbështetje të drejtpërdrejt tek KPK për të identifikuar çështjet dhe sfidat më urgjente me të cilat ballafaqohet, dhe për të përgatitur planin e veprimit që të adresoj këto çështje dhe sfida në mënyrë efikase. Ky projekt financohet nga Qeveria e Britanisë, përfaqësuar nga Zyra e Jashtme dhe Federata e Pasurisë së Përbashkët (ZJFPP), nëpërmjet partnerit zbatues - Axiom International. Kohëzgjatja: tetor 2018-mars 2021.

- Objektivi i përgjithshëm i projektit është të kontribuojë në përmirësimin e efikasitetit të gjyqësorit dhe të drejtave themelore.
- Objektivi specifik që i përket sistemit gjyqësor dhe prokurorial është forcimi i kapaciteteve profesionale të organeve të menaxhimit gjyqësor dhe prokurorial me njohuritë e nevojshme në planifikimin strategjik.
- Asistenca për Zhvillimin e kapaciteteve njerezore - projekt i financuar nga Dukati i Madh i Luksemburgut dhe Mbretëria e Norvegjisë

Projekti “Mbështetje për sistem prokurorial të pavarur, profesional dhe të paanshëm” që do të zbatohet përmes avancimit të bashkëpunimit me media dhe rritjes së kapacitetit administrative dhe efikasitetit të KPK-së. Ky projekt zbatohet nga CILC dhe financohet nga ambasada e Holandës. Kohëzgjatja: shtator 2019-maj 2021.

Projekti i IPA-s, EUKOJUST mbështet sistemin e drejtësisë, financohet nga BE, dhe zbatohet nga konsorciumi mes IRZ, CILC dhe Ministria e Drejtësisë e Kroacisë. Përfitues të këtij projekti janë: KPK, KGJK, prokuroritë dhe gjykatat, Ministria e Drejtësisë dhe Akademia e Drejtësisë. Projekti ka filluar implementimin me 1 tetor 2020 dhe do të zgjasë 40 muaj. Qëllimi kryesor i projektit është *Reformimi i sistemit të drejtësisë në linjë me standardet evropiane dhe ndërkombëtare*

Programi i financuar nga USAID gjithashtu do të fillojë me programin “Drejtësia ka rëndësi”, me kohëzgjatje qershor 2018 - qershor 2021 dhe synon të përmirësojë qasjen në drejtësi për të gjithë dhe përfshirjen e grupeve të marginalizuara, duke forcuar institucionet, aktorët dhe proceset për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas dhe informacione ligjor.

Ne tetor të vitit 2020 ka filluar implementimi i projektit gjithëpërfshirës të IPA 2018 për mbështetjen e sistemit të drejtësisë në Kosovë me vlerë prej EUR 7.0 milion. Ky projekt zbatohet nga konsorciumi IRZ, Ministria e Drejtësisë Kroate dhe Qendra për Bashkëpunim Ligjor Ndërkombëtar - CILC. Projektisynon forcimin e sistemit gjyqësor në Kosovë dhe përafrimin e standardeve të tij me ato evropiane dhe acquis të BE-së. Kjo do të arrihet nëpërmjet forcimit të pavarësisë dhe paanshësisë, llogaridhënies, profesionalizmit, cilësisë, efikasitetit dhe transparencës së institucioneve në sektorin e drejtësisë. Programi do të mbështesë menaxhimin e përgjithshëm të sektorit të drejtësisë dhe do të zhvillohen aktivitete për të mbështetur institucionet, ngritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e kushteve të punës. Përveç kësaj, veprimi do të mbështesë luftën kundër dhunës në familje dhe do të rrisë qasjen në drejtësi për të gjithë qytetarët, me fokus të veçantë tek gratë, grupet e cenueshme dhe të marginalizuara. Ne qershor të vitit 2020 gjithashtu ka filluar implementimi i Projektit PECK III me vlerë prej EUR 2.25 milion i cili financohet nga IPA 2018 dhe bashkefinancohet dhe zbatohet nga Këshilli i Evropës. Projekti synon zbatimin e metodologjive të njohura ndërkombëtarisht GRECO dhe MONEYVAL për forcimin e institucioneve të Kosovës në luftën kundër korrupsionit, pastrimit të parave dhe terrorizmit.

Institucionet e drejtësisë do të mbështeten tutje edhe me programin IPA 2020 me vlerë prej EUR 3.5 milion, përkatësisht mbështetje me pajisje të teknologjive informative për funksionalizimin e mëtejshëm të Sistemit të Menaxhimit Informativ të Lëndëve në të gjithë gjykatat dhe prokurori si dhe ndërtimin e qendrës së rimëkëmbjes në rastet kur qendra kryesore e të dhënave ka probleme teknike dhe dështon. Projekti synon gjithashtu të mbështet tutje funksionalizimin dhe përmirësimin e kushteve të Akademisë të Drejtësisë. Pasi Qeveria e Kosovës ka marrur përsipër të ndërtojë objektin e ri, projekti do të plotësojë këtë investim me pajisje të nevojshme dhe furnizim shtesë.

Sistemi i drejtësisë në Kosovë mbështet tutje me projektin “Mbështetje për Profesionet Ligjore në Kosovë – LINK” me vlerë prej EUR 0.8 milion. Projekti i paraparë për IPA 2020 është shtyer për vitin programues IPA 2021 për shkak të situatës së krijuar me pandeminë globale COVID-19. Ky projekt do të zbatohet nga Këshilli i Evropës dhe synon të ngjitur kapacitetet e profesionistëve ligjorë (Akademia e Drejtësisë e Kosovës, Shoqata e Avokatëve të Kosovës, studente të universitetit, profesorë) lidhur me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut dhe metodologjisë HELP.

Ky projekt është në fazë të hershme të planifikimit dhe do të detajizohet tutje më 2021, ndërsa kontraktohet tentativisht më 2022.

BE gjithashtu parasheh vazhdimësinë e projektit EKOJUST në fazën e dytë për të mbështetur sistemin e Drejtësisë ndërmjet IPA 2022 me vlerë tentative EUR 9.0 milion. Projekt synon të rris më tej kapacitetet menaxheriale të KGJK-së dhe gjykatave, dhe të forcojë kapacitetet e tyre në trajtimin e rasteve të natyrës speciale të krimit kibernetik dhe dhunës në familje. Projekti gjithashtu do të mbështes administrimin e sistemit prokurorial dhe do të përmirësojë kapacitetet e administrimit të Akademisë së Drejtësisë për zhvillimin, menaxhimin dhe matjen e programeve të trajnimit. Në fundin e projektit do të vazhdojë mbështetjen për hartimin ligjor dhe të politikave dhe do të përmirësojë mekanizmat përgjegjës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Gjithashtu prej vitit 2019 e deri në maj të 2022 do të vazhdojë implementimi i projektit KOSEJ II, i financuar nga IPA me shumë perfitues dhe zbatuar nga Këshilli i Evropës me vlerë prej EUR 1.0 milion. Projekti do të vazhdojë të përmirësojë funksionimin dhe cilësinë e përditshme të sistemit të drejtësisë me mbështetje të vazhdueshme për gjykatat dhe autoritetet qendrore: njohjen dhe përdorimin më efektiv të metodologjisë dhe mjeteve të Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ) dhe zbatimin e rekomandimeve të bëra në fazën e parë të projektit.

Asistenca e BE-së në fushën e të drejtave themelore përfshin projektet e përshkruara në vijim.

Kthimi dhe Ri-integrimi në Kosovë V (EU-RRK V), Programi i financuar nga BE në kuadër të IPA 2016, i bashkë-financuar nga MKK dhe është duke u zbatuar nga Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM), ka për qëllim të kontribuojë në përpjekjet e Qeverisë së Kosovës për të promovuar një ambient tolerant dhe multi-etnik, të bazuar në respektimin e të drejtave universale të njeriut, të cilat janë të përshtatshme për kthim të qëndrueshëm dhe ri-integrimin e personave të zhvendosur dhe familjeve të refugjatëve nga radhët e minoriteteve. Projekti mbështet rreth 400 familje të kthyer në të gjitha fazat e aktiviteteve të saj në komunat e përzgjedhura. Aktivitetet e programit filluan më 2018, dhe pritet të përfundojë brenda 36-48 muajsh.

Programi i BE-së për Stabilizimin e Komuniteteve, faza e katërt (BE- CSP IV) në kuadër të IPA 2018, i cili ka filluar në muajin janar 2020 dhe në këtë periudhë kanë filluar takimet/aktivitetet për zbatim. Programi i financuar nga BE dhe Ministria për Komunitete dhe Kthim, synon të mbështesë krijimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse shumëetnike në Kosovë, krijimin e mundësive për krijimin e të ardhurave për komunitetet jo-shumicë, promovimin e ri-integrimit të qëndrueshëm të të kthyerve, përmes mbështetjes së stabilitetit socio-ekonomik dhe iniciativave të zhvillimit të komunitetit, duke rritur kështu perspektivat e integrimit dhe përfshirjen sociale. Së pari, përmes sjelljes së mbështetjes në krijimin dhe zhvillimin e bizneseve kolektive/të shoqëruara, do t'i ndihmojë ata në zhvillimin e operacioneve kolektive të biznesit, krijimin e një prodhimi të ri me vlerë të shtuar dhe përfitimin së bashku përmes rezultateve të tyre maksimale dhe pozicionit të forcuar. Së dyti, aksioni mbështet sipërmarrës të rinj ose operacionale jo-shumicë për të vendosur ose rritur prodhimin e tyre përmes ndihmës materiale dhe *know-how*, si dhe krijimin e lidhjeve të biznesit dhe qasjes së zgjeruar në treg. Së treti, përmes zbatimit të projekteve të nivelit të komunitetit, aksioni do të mbështesë drejtpërdrejt një gamë të gjerë të iniciativave për të adresuar shqetësimet, përparësitë dhe nevojat e komunitetit më të gjerë, duke nxitur mundësinë të integrimit social (ri) midis anëtarëve të komunitetit. Të gjitha aktivitetet bëhen në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet lokale të cilët luajnë një rol të rëndësishëm në secilin hap të procesit. Periudha e zbatimit të projektit është 24-30 muaj.

Projekti për mbështetje të mbylljes së qendrave kolektive faza e dytë, programi i financuar nga BE në kuadër të IPA 2018, i bashkë-financuar nga MKK, i cili projekt zyrtarisht ka filluar në muajin janar 2020 dhe në këtë periudhë kanë filluar takimet/aktivitetet për zbatimin e projektit. Projekti do të kontribuojë në zbatimin e mirë të strategjive për familjet e zhvendosura në qendra kolektive, duke mbështetur realizimin e zgjidhjeve të qëndrueshme për integrimin e tyre social dhe ekonomik. Aktiviteti do të zhvillohet përmes ndërhyrjeve shumëpalëshe që synojnë mbështetjen e një integrimi dinjitoz dhe të qëndrueshëm për deri në 70 familje përfituese direkte (142 individë) që banojnë në këto qendra kolektive. Si përfitues indirekt, komunat Leposaviq, Zveçan dhe Graçanicë do të përfitojnë nga kapaciteti i rritur për të ofruar zgjidhje të qëndrueshme për popullatën e tyre të zhvendosur. Priten tre rezultate kryesore: mbyllja e 14 qendrave / qendrave kolektive dhe zgjidhjeve të qëndrueshme të strehimit të ofruara deri në 70 familje të zhvendosura që lehtësojnë daljen e tyre nga qendrat kolektive drejt një jete dinjitoze; ofrimi i mbështetjes socio-ekonomike për deri në 70 familje të zhvendosura; dhe mbështetje për zhvillimin e komunitetit dhe infrastrukturë të përmirësuar në tre komuna. Aktivitetet në sektorë të ndryshëm (strehimi, ndihma humanitare, gjenerimi i të ardhurave, integrimi social) do të zbatohen paralelisht. Të gjitha aktivitetet bëhen në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet lokale të cilët luajnë një rol të rëndësishëm në secilin hap të procesit. Periudha e zbatimit të projektit është 24 - 30 muaj.

Me kornizën e planifikuar financiare të IPA III kryesisht IPA 2021 është parapare mbështetja e vazhdueshme e komuniteteve në Kosovë me projektin "Stabilizimin e Komuniteteve faza e V (BE-CSP V) me vlerë totale EUR 3.0 milion (2.5 nga BE dhe 0.5 bashkëfinancim nga MKK). Projekti ka për qëllim krijimin e mundësive për të gjeneruar të ardhura për komunitetet jo-shumicë (posaçërisht për gratë, të rinjtë dhe komunitetin RAE) në sektorët kyç ekonomikë në Kosovë duke rritur kështu perspektivat e tyre (ri) të integritit. Faza V e projektit gjithashtu synon përmirësimin e përfshirjes sociale dhe qëndrueshmërisë së komuniteteve të cilat janë në disavantazh (posaçërisht gratë, rinia dhe komunitetet romë, ashkali e egjiptas) përmes stimulimit të iniciativave të përshtatura të komunitetit ndëretnik që kontribuojnë në ndërtimin e besimit dhe pajtimin.

Gjithashtu me kornizën IPA 2022 është planifikuar projekti "Kthimi dhe Ri-integrimi në Kosovë faza e VI (RRK VI)" me vlerë totale EUR 8.0 milion (6.0 financuar nga BE ndërsa 2.0 bashkëfinancim nga MKR). Projekti do të zbatohet nga IOM dhe ka për qëllim që aktorët shtetërorë dhe jo-shtetërorë në Kosovë të zbatojnë kthimin dhe riintegrimin e qëndrueshëm të deri në 260 familjeve të zhvendosura, si dhe do të financoj shtese për ndërtimin e kapaciteteve.

Në 2020 gjithashtu është nënshkruar kontrata e Binjakezimit me Latvi dhe Gjermaninë për mbështetje të metutjeshme të Agjencisë për Informim dhe Privaci me vlerë EUR 2.0 milion. Projekti pritet të fillojë implementimin në 2021 dhe synon të përmirësojë performancën e Agjencisë për Informim dhe Privatësisë, duke forcuar kapacitetet institucionale, ligjore dhe kornizën rregullatore dhe ndërgjegjësimi e publikut për mbrojtjen e të dhënave dhe qasjen në informim publik.

Të drejtat e fëmijëve gjithashtu do të mbështetjet me projektin e planifikuar në kuadër të IPA 2020 i cili parasheh implementimin nga UNICEF në Kosovë me vlerë totale EUR 2.2 milion (bashkëfinancim nga UNICEF me 300,000). Qëllimi i këtij projekti është të rritet numri i djemve dhe vajzave që përfitojnë nga qasjet dhe shërbimet multi-disiplinore duke iu përgjigjur dobësive socio-ekonomike, dhunës, neglizhimit, abuzimit dhe aksesit të pabarabartë në drejtësi.

Të drejtat e njeriut gjithashtu janë duke u mbështetur nga projekti "Promovimi i diversitetit dhe barazisë në Kosovë" me vlerë EUR 0.3 milion i cili zbatohet në kuadër të programit Horizontal Facility II, i bashkë-financuar nga IPA me shume përfitues dhe Këshilli i Evropës. Projekti ka filluar në maj 2019 dhe përfundon në maj 2022. Projekti synon të forcojë kapacitetet dhe për të mbështetur autoritetet për të përmirësuar zbatimin e politikës / ligjore kornizë në lidhje me antidiskriminimin, luftimin e gjuhës së urrejtjes dhe mbrojtjen e të drejtave të personave LGBTI në përputhje me standardet dhe rekomandimet e vendosura nga Këshilli i Evropës - veçanërisht ato të Komisioni Evropian për Racizmin dhe Intolerancën (ECRI). Më konkretisht, veprimi do të kontribuojë në forcimin e kapaciteteve të Zyrës për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit dhe Institucionin e Avokatit të Popullit në lidhje me mekanizmat e mbrojtjes së të drejtave

të njeriut. Nëpërmjet dimensionit të tij rajonal, veprimi synon gjithashtu të forcojë bashkëpunimin dhe sinergjinë midis Kosovës dhe organet e barazisë së Ballkanit Perëndimor në luftimin e diskriminimit dhe gjuhës së urrejtjes në rajon.

Objektivat prioritare afatmesme

Sistemi gjyqësor

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA dhe nga dokumentet e mekanizmat e tjera të aderimit në BE në kuadër të fushëveprimit të kapitullit 23, gjatë periudhës 2021-2025 Qeveria e Kosovës do të fokusohet në këto objektiva prioritare afatmesme:

- Finalizimi, miratimi dhe zbatimi i politikave për procesin e vetingut në sistemin e drejtësisë duke përfshirë krijimin e mekanizmave të procesit të vetingut në gjykata dhe prokurori;
- Reforma e sistemit të drejtësisë përmes avancimit të mëtejshëm të kornizës ligjore dhe të politikave duke u bazuar në analizat e rishikimit funksional të sektorit të sundimit të Ligjit.
- Avancimi i kornizës ligjore dhe sistemit të administrimit të pasurisë së sekuestruar apo të konfiskuar.

Me qëllim që të identifikohen dhe përcaktohen objektivat strategjike dhe zhvillimore për fushën e sundimit të ligjit të rritet efektiviteti i institucioneve shtetërore në zbatimin e ligjit, do të rishikohet korniza ligjore e sundimit të ligjit, si dhe proceset e bashkëpunimit midis institucioneve që kanë përgjegjësi në fushën e sundimit të ligjit. Gjithashtu do të vlerësohen kapacitetet institucionale për sundimin e ligjit; nxjerrja e rekomandimeve për përmirësimin e kuadrit ligjor, si dhe të proceseve të bashkëpunimit. Ky proces do të udhëhiqet nga MD e cila për ecurinë, rezultatet dhe rekomandimet e rishikimit funksional i raporton Komitetit Drejtues, të përbërë nga përfaqësuesit e institucioneve si në vijim: MD, MPB, MFPT, KGJK, KPK, AKI, dhe përfaqësues të donatorëve ndërkombëtar që ofrojnë asistencë teknike në përkrahje të rishikimit funksional. Ky Komitet Drejtues ka për detyrë që të përcaktoj vijat e përgjithshme të ecurisë së rishikimit funksional në bazë të rekomandimeve të MD dhe ti paraqes Qeverisë së Kosovës propozimin për Strategjinë Kombëtare për Sundimin e Ligjit në Kosovë. Për këtë çështje MD do të lidh memorandume të bashkëpunimit me institucione të pavarura të fushës së Sundimit të Ligjit për bashkëpunim dhe bashkërendim të aktiviteteve në kuadër të këtij procesi;

- Rritja e numrit të noterëve konform ndryshimeve të reflektuara në Ligjin e ri të Noterisë;
- Rritja e numrit të përbaruesve privatë;
- Rritja e numrit të ndërmjetësuesve;
- Realizimi i trajnimeve për noterë, përbarues privatë dhe ndërmjetësues.

Në periudhën afatmesme, KGJK me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA do të fokusohet në këto objektiva prioritare afatmesme:

- Zhvillimin dhe zbatimin e procesit të plotësimit të pozitave për gjyqtarë si dhe monitorimin e politikave, strategjive dhe vendimeve të KGJK-së;
- Ngritjen e kapacitetit në gjykata në administrimin e drejtësisë përmes ngritjes së numrit të bashkëpunëtorëve profesionalë në pajtim me Ligjin për Gjykata;
- Organizimin e trajnimeve të vazhdueshme për gjyqtarë në të gjitha departamentet sipas fushave përkatëse e në veçanti trajnime të specializuara për Departamentin Special në kuadër të Gjykatës Themelore të Prishtinës dhe Gjykatës së Apelit, bazuar në programin e trajnimeve i cili del nga procesi i vlerësimit të nevojave për trajnim;
- Konsolidimin e Projektit të Sistemit të Centralizuar Nacional të Evidencës Penale në Kosovë, ky projekt ka për qëllim që të arrijë krijimin dhe funksionalizimin e një regjistri të centralizuar të kompjuterizuar të dënimeve penale që mbulojnë vendimet e gjykatës në të kaluarën dhe lëshimin e certifikatave, duke funksionuar në përputhje me kërkesat e ECRIS.
- Përditësimin dhe monitorimin në baza të vazhdueshme të bazës elektronike të të dhënave për të regjistruar të gjitha ankesat dhe kërkesat për fillimin e hetimeve disiplinore dhe informacionin e paraqitur nga autoritetet kompetente.
- Emërimin e anëtarëve të mbetur për të kompletuar perberjen e Këshillit Gjyqësor të Kosovës

- Zbatimin e Planit të Veprimit për lëndet të cilat mund të ndikohen nga neni 311 i KPPRK-se (2021-2023) për të minimizuar ndikimin e pandemisë COVID-19 në sistemin e drejtësisë, veçanërisht në hetimet penale dhe proceset gjyqësore që janë në vazhdim e sipër
- Vazhdimi i promovimit të përdorimit të ndërmjetësimit të gjyqtarët dhe publiku;
- Konsolidimin e Projektit NCCR, ky projekt ka për qëllim që të arrijë krijimin dhe funksionalizimin e një regjistri të centralizuar të kompjuterizuar të dënimeve penale që mbulojnë vendimet e gjykatës në të kaluarën dhe lëshimin e certifikatave, duke funksionuar në përputhje me kërkesat e ECRIS.

Në periudhën afatmesme, KPK me qëllim të ngritjes së efikasitetit dhe efektivitetit të sistemit prokurorial, konform mandatit dhe sfidave të identifikuar në Raportin e KE-së për Kosovën synon:

- Avancimin e sistemit të administrimit dhe llogaridhënies në sistemin prokurorial;
- Forcimi i kapaciteteve të KPK-së dhe komisioneve të KPK-së;
- Miratimin dhe mbikëqyrjen e politikave për zvogëlimin e numrit të rasteve me fokus në trajtimin e rasteve të korrupsionit, krimit ekonomik dhe krimit të organizuar;
- Zbatimin e Planit të Veprimit 2019 -2021 dhe Planit Strategjik në sistemin Prokurorial të Kosovës;
- Hartimi i Planit Strategjik të Sistemit Prokurorial pas skadimit të planit aktual;
- Avancimi i mëtejshëm i sistemit të arkivimit të dosjeve në sistemin prokurorial;
- Avancimi i procesit të mbledhjes, përpunimit dhe raportimit të statistikave;
- Ngritjen e kapaciteteve profesionale të prokurorëve dhe personelit administrativ;
- Avancimi i mëtejshëm i kapaciteteve profesionale të PSRK-së në zbatim të strukturës së re organizative në këtë prokurori;
- Kompletimi i akteve nënligjore konform ndryshimeve të fundit ligjore;
- Avancimi i mëtejshëm i sistemit elektronik të menaxhimit të lëndëve.
- Fuqizimi i kapaciteteve të komisioneve dhe stafit përgjegjës për zhvillimin e procedurave disiplinore dhe vlerësimin e performancës së prokurorëve dhe stafit.

Në periudhën afatmesme, *Akademia e Drejtësisë* do të ketë në fokus ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe ndërdisiplinore të gjyqtarëve, prokurorëve dhe stafit administrativ gjyqësor e prokurorial përmes zbatimit të programeve trajnuese fillestare dhe të vazhdueshme si dhe përmes ofrimit të burimeve dhe materialeve tjera ligjore në përputhje me Ligjin për Akademinë e Drejtësisë dhe aktet e tjera nënligjore.

Përveç zbatimit të programeve të cilat rezultojnë sipas nevojave të gjyqtarëve dhe prokurorëve, prioritet në periudhën afatmesme do të jenë:

- Trajnimet e detyrueshme me fokus në Etiken profesionale për gjyqtarë përkatësisht në Ligjin për Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve;
- Ndryshimet legislative qoftë në fushën penale ashtu edhe në atë civile.

Politikat kundër korrupsionit

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA-së dhe nga dokumentet e mekanizmat e tjera të aderimit në BE në kuadër të fushëveprimit të kapitullit 23, gjatë periudhës 2021-2025 Agjencia Kundër Korrupsionit do të fokusohet në këto objektiva prioritare afatmesme:

- Hartimi i Analizës për vlerësimin e mandatit të Agjencisë Kundër Korrupsionit. Kjo analizë parasheh nevojën e krijimit të mekanizmeve për vlerësimin e rrezikut të korrupsionit në sektorë të ndryshëm; vlerësimi i hapësirave në legjislacionin të cilat mundësojnë korrupsionin “corruption legislation proofing”, si dhe monitorimi i zbatimit të planeve të integritetit.
- Plotësimi i mandatit me masa shtesë për zbatimin e procedurës së hetimeve paraprake dhe kontrollit të prejardhjes së pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë;
- Krijimi i mekanizmit dhe ngritja e kapaciteteve institucionale të zyrtarëve të Agjencisë për zbatimin e ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve.
- Hartimin e Udhëzuesit për institucionet publike duke përfshirë edhe ndërmarrjet publike qendrore dhe lokale të veçanta për qëllime të parandalimit të konfliktit të interesit.

Në periudhën afatmesme, Akademia e Drejtësisë do të ketë në fokus në:

- Ngritjen e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve në luftimin e çfarëdo forme të korrupsionit duke pasur prioritet programet e specializuara të trajnimit në luftën kundër korrupsionit, krimit të organizuar, shpëlarjes së parave, hetimeve financiare dhe veprave tjera korruptive.

Të drejtat themelore

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA dhe nga dokumentet e mekanizmat e tjera të aderimit në BE në kuadër të fushëveprimit të kapitullit 23, prioritet i Qeverisë së Kosovës në fushën e të drejtave themelore gjatë periudhës 2021-2025 do të jetë, forcimi dhe fuqizimi i koordinimit ndërinstucional në fushën e të drejtave të njeriut, zbatimi i ligjeve aktuale dhe fokusimi në përditësimin dhe zbatimin e strategjive dhe programeve për të drejtat e njeriut, duke siguruar qasje afatgjatë në këtë drejtim. Më konkretisht:

- Të sigurohet monitorimin i duhur i përcjelljes së raporteve dhe rekomandimeve nga Avokati i Popullit për të rritur më tej shkallën e zbatimit;
- Krijimi dhe funksionalizimi i plotë i mekanizmave institucionalë për mbrojtjen nga diskriminimi në të gjitha ministrinë dhe komunat dhe vendosja e një sistemi të koordinimit ndërmjet tyre dhe Zyrës së Qeverisë së Mirë;
- Funksionalizimi i Grupit Koordinues Ndërminstros për të Drejtat e Njeriut
- Vendosja e sistemit për monitorimin e të drejtave të njeriut në nivel vendi;
- Fuqizimi i rolit të grave dhe vajzave në vendimmarrje, fuqizimit ekonomik të tyre dhe eliminimit të dhunës në baze gjinore dhe dhunës në familje;
- Të miratohen aktet nënligjore për zbatimin e Ligjit nr. 06/1-084 për mbrojtjen e fëmijës;
- Harmonizimi i Legjislacionit për reformën zgjedhore me Ligjin për Barazi Gjinore;
- Zbatimi i Programit të Kosovës për Barazi Gjinore dhe krijimi i sistemit të monitorimit për zbatimin e tij;
- Miratimi i Strategjisë së re kundër dhunës në familje;
- Zbatimi i Vlerësimit të Ndikimit Gjinnor për kornizën rregullative;
- Avancimin e sektorit të të drejtave pronësore, duke synuar në përkufizimin më të qartë me ligj të të drejtave pronësore dhe ofrimin e mekanizmave më efikas, të qasshëm dhe të përballueshëm përmes të cilëve qytetarët do të mund të fitojnë njohjen juridike të të drejtave të tyre;
- Përmirësimi i politikave për ekzekutimin e sanksioneve penale, si dhe sensibilizimi i gjykatave për rritjen e numrit të rasteve të shqiptimit të dënimeve alternative kundrejt shqiptimit të dënimeve me burg;
- Të hetohen në mënyrë të plotë sulmet ndaj gazetarëve, rastet e dhunës seksuale dhe dhunës në familje, krimet e urrejtjes, gjuha e urrejtjes dhe diskriminimi dhe sulmet ndaj personave të komunitetit LGBTI, duke siguruar hetime në kohë dhe të plota dhe gjykim të rasteve të tilla;
- Të sigurohet financim të qëndrueshëm për transmetuesin publik dhe të rishikohet korniza legjislative që rregullon funksionimin e Komisionit të Pavarur të Mediave.

Në periudhën afatmesme, Akademia e Drejtësisë do të ketë në fokus ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe interdisciplinare të gjyqtarëve, prokurorëve dhe stafit administrativ gjyqësor e prokurorial në fushën e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjen kundër diskriminimit në përputhje me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe ofrimin e burimeve ligjore për përfituesit, nëpërmjet bibliotekës si dhe materiale të ndryshme hulumtuese.

Mbrojtja e minoriteteve dhe trashëgimia kulturore

Në një periudhë afatmesme, do të ndërmerren masa për përfshirjen e grupeve të marginalizuara dhe të komuniteteve minoritare në arsimin e lartë. Në të njëjtën kohë duhet të vazhdohet me angazhimin për përmirësimin e qasjes së refugjatëve dhe personave të zhvendosur në pronat e tyre dhe shërbime publike, si dhe tu ofrohen mundësi më të mira ekonomike.

Rishikimi i kornizës ligjore, përfshirë,

- Ligjin për personat e zhvendosur;
- Ligjin për Rikthimin e Objekteve të Trashëgimisë Kulturore të Marra Ilegalisht;
- Ligjin mbi Eksportin e të Mirave Kulturore;
- Rritjen e fondeve për restaurimin e monumenteve të trashëgimisë kulturore: historike, kulturore dhe fetare.

Në funksion të mbrojtjes, ruajtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore vëmendje e veçantë do t'i kushtohet bashkëpunimit ndërkuftar dhe përfshirjes së zonave të trashëgimisë në Kosovë në agjendat rajonale të zhvillimit të turizmit kulturor.

3.24. Kapitulli 24 i acquis-së: Drejtësia, liria dhe siguria

Ky kapitull mbulon këto fusha: menaxhimin e kufirit, migrimin, parandalimin dhe kontrollimin e migracionit të parregullt, politikën e vizave, sigurinë e dokumenteve, luftën kundër krimit të organizuar dhe bashkëpunimin policor, luftimin e shpëlarjes së parasë dhe financimit të terrorizmit, luftën kundër terrorizmit, luftimin e narkotikëve dhe bashkëpunimi gjyqësor në çështjet penale dhe civile. Fusha e drejtësisë, lirisë dhe sigurisë është ndër fushat më dinamike të politikave në kuadër të BE-së dhe politikat e BE-së në këtë fushë synojnë të ruajnë dhe zhvillojnë më tej BE-në si një zonë të lirisë, sigurisë dhe drejtësisë dhe të garantojnë sigurinë, të drejtat dhe lëvizjen e lirë në BE. Legjislacioni i BE-së në këtë fushë bazohet mbi parimet e përgjithshme që rrjedhin nga Traktati i BE-së, Traktati i Funksionimit të BE-së, si dhe nga jurisprudenca e Gjykatës së Drejtësisë së BE-së.

Fushat e mbuluara përfshijnë harmonizimin e së drejtës private ndërkombëtare, marrëveshjet e ekstradimit ndërmjet shteteve anëtare, politikat e kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm të kufirit, vizave, migracionin, politikat e azilit, bashkëpunimin policor dhe gjyqësor si dhe luftimin e krimit (përfshirë luftimin e terrorizmit, krimit të organizuar, trafikimit të narkotikëve, trafikimit me njerëz, krimit kibernetik etj.). Kosova duhet të bëjë transpozimin gradual të acquis-së në këtë fushë, dhe të zhvillojë e zbatojë një kornizë adekuate të politikave e gjithashtu edhe ndërtojë e ngritë institucione me kapacitete për të zbatuar acquis-në e transpozuar. Njëkohësisht, nga Shtetet Anëtare kërkohet të kenë kapacitetet e nevojshme administrative brenda agjencive të zbatimit të ligjit dhe organeve të tjera relevante, të cilat duhet arritur standardet e nevojshme në këto fusha. Edhe pse pjesa më e detajuar e politikave të BE-së për drejtësinë, lirinë dhe sigurinë është e përfshirë në acquis-në e Schengenit, ku bëjnë pjesë heqja e kontrolleve të brendshme kufitare në BE, megjithatë, për vendet e reja anëtare pjesët thelbësore të Schengenit acquis zbatohen pas vendimit të veçantë të Këshillit të ndërmarrë pas anëtarësimit.

Kërkesat e MSA-së

MSA, në anën tjetër, në mënyrë eksplicite vendosë një sërë obligimesh për Kosovën, të përfshira në Titullin VII, përkatësisht nga nenet 83-93 të MSA-së.

Sipas MSA-së, në fushën e menaxhimit të kufirit, Kosova do të përkujdeset në përafrimin e legjislacionit përkatës në përputhje me acquis të BE-së, intensifikimin e bashkëpunimit rajonal, shkëmbimin e informatave, ngritjen e kapaciteteve institucionale dhe luftimin e krimit ndërkuftar. Sa i përket politikës së vizave, Kosova do të përkujdeset që të transpozojë në një periudhë afatshkurtër legjislacionin përkatës vendor në harmoni me acquis të BE-së. Në veçanti, Kosova do të përkujdeset që të zgjerojë dhe funksionalizojë rrjetin e sistemit të lëshimit vizave.

Sa i përket sundimit të ligjit, kërkesat e MSA-së dhe nga mekanizmat e tjerë të aderimit në BE konsistojnë në fuqizimin dhe konsolidimin e institucioneve të sundimit të ligjit. Kjo sidomos vihet në dukje nga neni 83 i MSA i cili thekson se, bashkëpunimi në këtë fushë do të fokusohet veçanërisht në fuqizimin e pavarësisë, paanshmërisë dhe llogaridhënies së gjyqësorit. Në lidhje me këtë, është veçanërisht i domosdoshëm zhvillimi i kapaciteteve profesionale nga radhët e pjesëtarëve të policisë, prokurorëve dhe gjyqtarëve për të parandaluar, hetuar, ndjekur dhe gjykuar veprat e krimit të organizuar, korrupsionit dhe terrorizmit.

Lidhur me migrimin përgjithësisht, Kosova do të harmonizojë legjislacionin vendor me *acquis* të BE-së, lidhur me kushtet e hyrjes dhe qëndrimin të ligjshëm të huajve në Kosovë, kushtet e punësimit të tyre, bashkimin familjar, qëndrimin afatgjatë, studimin, hulumtimin, punëtorët e kualifikuar, punëtorët sezonal, lëvizjen e punëtorëve brenda ndërmarrjeve dhe masat ndëshkuese ndaj punëdhënësve. Për menaxhimin e migrimit të rregullt, Kosova do të respektojë parimin e trajtimit të drejtë dhe të barabartë të grave dhe burrave të huaj, gjithashtu duke promovuar integrimin e tyre.

Sa i përket parandalimit dhe kontrollit të migrimit të parregullt, Kosova do të vazhdojë të ndërmarrë masat e nevojshme për parandalimin dhe kontrollin e migrimit të paligjshëm, përfshirë trafikimin dhe kontrabandimin me migrantë. Gjithashtu do të sigurojë mbrojtjen e të drejtave themelore të migrantëve dhe ofrimin e asistencës për migrantët në nevojë.

Kosova do të vazhdojë riatdhesimin dhe kthimin e shtetasve të Kosovës, shtetasve të vendeve të treta dhe personave pa shtetësi të cilët kanë hyrë në territorin e ndonjë shteti të BE-së përmes Kosovës ose që kanë hyrë në territorin e Kosovës përmes ndonjë shteti anëtarë të BE-së. Gjithashtu, Kosova do të fillojë negociatat për nënshkrimin e marrëveshjeve më qëllim të përcaktimit të procedurave specifike për riatdhesimin e këtyre personave. Gjithashtu, Kosova do t'i pajisë qytetarët e saj me dokumente përkatëse të identitetit dhe do të ofrojë lehtësira administrative për këtë qëllim. Kosova do të vazhdojë përpjekjet për nënshkrimin e marrëveshjeve për riatdhesim brenda mundësive, me shtetet që janë pjesë e procesit të Stabilizim-Asociimit, dhe do të merr masa të nevojshme për sigurimin e zbatimit të shpejtë dhe fleksibil të këtyre marrëveshjeve.

Në politikën e azilit Kosova do të garantojë standardet ndërkombëtare në përputhje me Konventën e Gjenevës lidhur me statusin e refugjatëve 1951, dhe Protokollin lidhur me statusin e refugjateve 1967. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet të drejtave të azilkërkuesve, duke respektuar parimin "non-refoulement". Kosova do të sigurojë harmonizimin e legjislacionit vendor me *acquis* të BE-se, veçanërisht rreth pranimit të azilkërkuesve, trajtimit të kërkesave për azil dhe në menaxhimin e kthimit të azilkërkuesve në vendin e origjinës.

Me qëllim të parandalimit dhe luftimit të krimit të organizuar dhe aktiviteteve tjera ilegale Kosova do të harmonizojë legjislacionin me *Acquis* të BE-se dhe do të forcojë mekanizmat për parandalimin dhe luftimin e të gjitha formave të krimit të organizuar. Kosova do të marrë pjesë dhe do të bashkëpunojë me mekanizmat rajonal dhe ndërkombëtarë në luftimin e krimit të organizuar dhe do t'u përmbahet konventave dhe instrumenteve ndërkombëtare në këtë fushë.

Sa i përket shpëlarjes së parasë dhe financimit të terrorizmit, Kosova do të ndërmarrë masat e nevojshme në mënyrë që të parandalojë përdorimin e sistemeve financiare me qëllim të shpëlarjes së të ardhurave nga aktivitetet kriminale dhe financimit të terrorizmit. Kosova do të harmonizojë legjislacionin vendor me *acquis* të BE-së dhe do të forcojë mekanizmat për luftimin e shpëlarjes së parasë, dhe financimit të terrorizmit, njëkohësisht duke adaptuar standardet ndërkombëtare në këtë fushë e veçanërisht standardet e rekomanduara nga FATF (Financial Action Task Force).

Sa i përket bashkëpunimit në luftimin e drogave të paligjshme, Kosova do të vazhdojë bashkëpunimin për të siguruar një qasje të balancuar dhe të integruar, duke harmonizuar legjislacionin me *acquis* të BE-së dhe duke forcuar strukturat për luftimin e drogave të paligjshme. Kosova do të fokusohet gjithashtu edhe në menaxhimin e pasojave shëndetësore dhe sociale të abuzimit të drogave dhe në menaxhimin efektiv të prekursorëve, në harmoni me parimet e përbashkëta të strategjisë së BE-së për droga dhe dokumentet e tjera përkatëse.

Në fushën e luftës kundër terrorizmit, Kosova do të vazhdojë me harmonizimin e legjislacionit me *acquis* të BE-së dhe do të fuqizojë mekanizmat institucional për parandalimin, luftimin dhe financimin e terrorizmit, duke siguruar sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut, liritë themelore, të drejtën ndërkombëtare për refugjatë dhe të drejtën ndërkombëtare humanitare.

Kërkesat nga mekanizmat e tjerë të aderimit në BE

Në fushën e menaxhimit të kufirit, *Raporti i KE-së për Kosovën – 2020* dhe të dalat nga Nënkomiteti për Drejtësi, Liri dhe Siguri theksojnë që nevojiten përpjekje të mëtutjeshme për të siguruar që QKMK të funksionojë me potencialin e saj të plotë, ndër të tjera, edhe duke zbatuar plotësisht planin e veprimit të QKMK-së të miratuar në shkurt 2019. Sa i përket bashkëpunimit ndërinstitucional në këtë fushë, raporti thekson se ky bashkëpunim mund të përmirësohet më tej në lidhje me shkëmbimin e informacionit dhe analizën e përbashkët të rrezikut, edhe nëse Kosova merr pjesë në Rrjetin e Analizës së Rrezikut në Ballkanin Perëndimor, të udhëhequr nga FRONTEX.

Në fushën e azilit, *Raporti i KE-së për Kosovën – 2020* thekson nevojën për vazhdimin e ngritjes së kapaciteteve për trajtimin e kërkesave për azil dhe ngritjes së numrit të stafit në Qendrën për Azil dhe Qendra për Mbjajtjen e të Huajve përballet me mungesa në lidhje me njësitë e strehimit të papërshtatshme, mungesën e zonave të sigurta, mungesën e pajisjeve mjekësore të brendshme dhe mungesën e personelit të duhur mbikëqyrës të specializuar për të siguruar të drejtat dhe nevojat themelore, veçanërisht mbështetjen psiko-sociale. Raporti thekson se sfidat mbeten në lidhje me komunikimin midis zyrtarëve dhe migrantëve të parregullt dhe njerëzve që kanë nevojë për mbrojtje, pavarësisht mundësisë për të ndarë përkthyes midis vendeve të rajonit përmes Iniciativës Rajonale të Migracionit, Azilit dhe Refugjatëve.

Në fushën e migrimit, *Raporti i KE-së për Kosovën – 2020* identifikon disa sfida, përfshirë nevojën për bashkëpunim dhe bashkërendim më të ngushtë ndërinstitucional. Gjithashtu, Raporti dhe nënkomiteti theksojnë se Strategjia e re pesëvjeçare për Migrim duhet të miratohet pas rishikimit për të reflektuar sfidat kryesore të Kosovës në këtë fushë bazuar në rekomandimet e ekspertëve, si dhe në vlerësimin e strategjisë së mëparshme. Për më tepër, raporti thekson se Autoritetit Qeveritar për Migrim (AQM) është në pozitë të mirë për të marrë rol më proaktiv në udhëheqjen e politikave në fushën e migrimit. Megjithatë, sipas Raportit duhet të miratohet rregullorja për AQM, e cila do të forcojë më tej rolin e AQM dhe të qartësojë përbërjen dhe funksionin e saj Vazhdon të mbetet sfida ofrimi i kujdesit të mirëfilltë për shumicën e grupeve të cënueshme të migrantëve. Gjithashtu, theksohet nevoja për të vazhduar përpjekjet për të parandaluar kontrabandimin e njerëzve. Në kuadër të konkluzioneve të dala nga takimi i Nënkomitetit për Drejtësi, Liri dhe Siguri 2020 theksohet se duhet të forcohet bashkëpunimi dhe koordinimi ndërinstitucional në fushën e migrimit dhe azilit, veçanërisht midis institucioneve të ndryshme të politikave dhe të sigurisë, përfshirë përmes ndërveprimit të sistemeve.

Në fushën e riintegrit, *Raporti i KE-së për Kosovën – 2020* thekson se ka nevojë për një koordinim më të mirë ndërinstitucional, përfshirë me komunat, si dhe monitorim dhe vlerësim të përmirësuar sistematik. Në këtë drejtim duhet të vendoset një sistem të ndjeshëm ndaj gjinisë që arrin të kthyerit më të rrezikuar dhe që përqendrohet më shumë në mbështetjen e qëndrueshme të komunitetit. Gjithashtu, raporti thekson se të kthyerit nuk marrin informacionin e mjaftueshëm, dhe se mungon një mjet shqyrtimi dhe referimi për të kthyerit, për të bërë identifikimin e njerëzve në nevojë, përfshirë viktimat e trafikimit.

Sa i përket fushës e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit, *Raporti i KE-së për Kosovën – 2020* thekson se Ligji për Luftimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit ende nuk është në linjë me acquis dhe standardet e tjera ndërkombëtare. Gjithashtu, raporti përmend se shpëlarja e parave nuk hetohet si vepër penale në vete, por gjithmonë në lidhje me vepra të tjera penale, dhe se hetimet paralele financiare nuk janë duke u zhvilluar në mënyre sistematike për rastet e krimit të organizuar. Raporti i KE-së, si dhe konkluzionet e takimit të Nënkomitetit për Drejtësi, Liri dhe Siguri- 2020, rekomandojnë që të zbatohen rekomandimet e raporteve të FATF/Moneyval dhe GRECO, të rritet bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve relevante, si dhe të fuqizohen kapacitetet e NJIF-it për ndjekjen e transaksioneve të dyshimta financiare.

Sa i përket bashkëpunimit në fushën e narkotikëve, *Raporti i KE-së për Kosovën – 2020* thekson zbatimin e dobët të legjislacionit. Raporti thekson se Observatori Nacional i Narkotikëve është operacional por me burime të kufizuara dhe pa udhëheqës. Gjithashtu, raporti dhe Nënkomiteti i DLS rekomandojnë zhvillimin e një sistemi të paralajmërimit të hershëm, duke përfshirë edhe procedurat e ndërlidhura për vlerësimin e rrezikut si dhe mekanizmin pasues për të shtuar substanca të reja psikoaktive në legjislacionin

e saj për kontroll të drogës, si dhe grumbullimin e të dhënave në mënyrë rutinore. Raporti dhe nënkomiteti gjithashtu rekomandojnë që të vazhdohet me hartimin e një protokolli apo PSO-je për ruajtjen, trajtimin dhe shkatërrimin e prekursorëve të drogës.

Lidhur me *luftimin e krimit të organizuar*, Raporti i KE-se 2020 thekson se Kosova është në një fazë të hershme: theksohet se ka përparime në reformave legjislative në sundim të ligjit, hetimin e rasteve të nivelit të lartë, dhe ngrirjen preliminare të aseteve, por numri i dënimeve përfundimtare, hetimeve financiare e konfiskimeve përfundimtare të aseteve mbetet i ulët. Nevojiten masa për të forcuar ndjekjen penale si dhe për të siguruar që nuk ka ndërhyrje politike në aktivitetet operacionale të të gjitha organeve të zbatimit të ligjit. Krimi i organizuar në veri të Kosovës vazhdon të mbetet sfidë për agjencitë e zbatimit të ligjit. Në përgjithësi, Kosova ka përmbushur pjesërisht rekomandimet e identifikuar vitin e kaluar, gjegjësisht ato rreth historikut të rasteve, policimit të udhëhequr nga inteligjenca dhe miratimit të reformave ligjore. Megjithatë, raporti ende rekomandon se Kosova duhet të priorizojë zbatimin e plotë të kornizës legjislative të rishikuar në fushën e sundimit të ligjit, përfshirë trajnimin dhe ngritjen e vetëdijes, për ta bërë atë një mjet efektiv për të luftuar krimin e organizuar; të rrisë edhe më tej numrin e prokurorëve në Prokurorinë Speciale për të hetuar dhe ndjekur penalisht rastet e krimit të organizuar të nivelit të lartë dhe të ofrojë trajnime për përforsimin e kapaciteteve të tyre për të kryer hetime financiare, konfiskuar pasuri dhe mbrojtur efektivisht dëshmitarët; të zbatojë në mënyrë konkrete qasjet e policimit të udhëhequr nga inteligjenca dhe policimit në komunitet, përfshirë raportimin më relevant të inteligjencës kriminale dhe përcaktimin e përmirësuar të detyrave brenda drejtorive të policisë, për të mundësuar policim më proaktiv. Për më tepër, Zyra për Rikthimin e Aseteve ka rekrutuar dy zyrtarë të rinj, duke ngritur kështu kapacitetet njerëzore; megjithatë duhet të rritet numri i kërkesave nga palët e përfshira. Raporti gjithashtu kërkon shkëmbim më të mirë të informacionit ndërmjet institucioneve për luftimin e krimit, përfshirë qasje në bazat e të dhënave dhe rritjen e bashkëpunimit institucional. Agjencia Kosovare e Forenzikës ka nënshkruar një marrëveshje me Komisionin Evropian për bashkëpunim të mëtejshëm në shkëmbim, ndihmë dhe trajnim për mbrojtjen e Euros nga falsifikimi. Raporti i KE 2020 vlerëson se ekzistojnë strategji dhe plane veprimi shtesë për kontrollin e armëve; ekonominë jo formale, pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit; terrorizmin; parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm; trafikimin e qenieve njerëzore; narkotikët; dhe sigurinë kibernetike. Megjithatë, ende ekziston një nevojë për bashkëpunim dhe koordinim më të mirë midis të gjitha institucioneve. Prokuroria Speciale mbetet hallka më e dobët në luftën kundër krimit të organizuar.

Sa i përket krimit kibernetik, në *Raportin e KE-së për Kosovën – 2020* theksohet se ka pasur progres në zbulimin, gjurmueshmërinë dhe ndjekjen penale të kriminelëve kibernetikë. Megjithatë, raporti thekson se duhet të adresohen sfida në lidhje me trajtimin e dëshmive elektronike nga persona me njohuri të pamjaftueshme si dhe numri i ulët i trajnimeve në fushën e krimeve kibernetike për gjykatësit dhe prokurorët e sapoemëruar. Raporti rekomandon që kërcënimet e identifikuar në SOCTA-të nga Policia e Kosovës, të përkthehen në prioritetet operacionale, të mbështetura nga resurse adekuate.

Sa i përket regjistrin të rasteve, Raporti i referohet konfirmimit nga KE rreth arritjes së caqeve për luftimin e krimit të organizuar, dhe potencon se ai do të vazhdojë të ndjekë zhvillimet nga afër dhe në mënyrë aktive. Procedurat operacionale për regjistrin e rasteve duhet të rishikohen, kurse rekomandohet të rriten përpjekjet e dënimeve finale për rastet e krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Përderisa vërehet se policia ka kapacitete të mira për luftimin e krimit të organizuar, Raporti thekson se ajo mbetet pre e korrupsionit dhe presionit politik. Si zgjidhje të mundshme për rritjen e integritetit në polici, raporti sugjeron që obligimi për deklarimin e pasurisë të zgjerohet përtej zyrtarëve të lartë dhe të bëhet i obligueshëm edhe për pozita më të ulëta por që janë të ekspozuara. Nën komiteti i DLS-së 2020 si dhe raporti, theksojnë se performanca e policisë ndikohet nga një numër detyrash që nuk janë detyra thelbësore të forcës policore, siç është sigurimi i ndërtesave qeveritare dhe infrastrukturës me rrezik të ulët dhe se duhet të ndërmerren hapa për ta korrigjuar këtë. Raporti dhe nënkomiteti konstatojnë se Policimi i udhëhequr nga inteligjenca po zbatohet dobët, dhe se kapacitetet përkatëse duhet të forcohen, duke përfshirë përdorimin e proceseve të Detyrave dhe Grupit të Koordinimit sugjeron që obligimi për deklarimin e pasurisë të zgjerohet përtej zyrtarëve të lartë dhe të bëhet i obligueshëm.

Sa i përket mbrojtjes së dëshmitarëve, thekson se në 2019 për herë të parë një dëshmitar është regjistruar në programin e dëshmitarëve të mbrojtur. Raporti sërish thekson se gjykatësit kanë nevojë për trajnime për mbrojtje të dëshmitarëve.

Raporti i KE 2020 thekson se konfiskimi i pasurisë vazhdon të shihet vetëm si një aspekt ndihmës i procedurave penale, me fokus të pamjaftueshëm dhe burime të pamjaftueshme të dedikuara për të. Edhe pse në përgjithësi korniza institucionale dhe ligjore është në fuqi dhe është përmirësuar ndjeshëm me hyrjen në fuqi të Ligjit të ri për Kompetencat e Zgjeruara të konfiskimit në janar 2019, kjo ende nuk ka dhënë rezultate. Koncepti i konfiskimit të pasurisë është kuptuar dobët midis prokurorëve dhe gjyqtarëve, duke përfshirë një interpretim kufizues të parimeve ligjore. Gatishmëria për të konfiskuar pasuritë është e ulët. Prokuroria mbetet hallka më e dobët në këtë drejtim. Duhet të përmirësojë mangësitë e saj teknike.

Raporti i KE 2020 dhe konkluzionet e Nënkomitetit theksojnë që duhet të forcohet efikasiteti i regjimit të konfiskimit duke promovuar përdorimin sistematik të konfiskimit të zgjeruar dhe 'të rregullt' nga prokuroria dhe policia, me krijimin e një fondi konfiskimi dhe me përmirësimin e procesit të shitjes së pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara të menaxhuara nga Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar (AAPSK).

Sa i përket luftës kundër terrorizmit, *Raporti i KE-së për Kosovën - 2020* thekson që Ligji për luftimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit nuk është plotësisht në përputhje me standardet e BE-së dhe ato ndërkombëtare. Strategjia kundër terrorizmit është në përputhje me strategjinë e BE-së kundër terrorizmit. Duhet të finalizohet dhe miratohet një strategji komunikimi për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të fituar mbështetje më të gjerë nga palët e interesuara në të gjithë shoqërinë. Në korrik 2020, Qeveria e Kosovës emëroi Ministrin e Punëve të Brendshme si Koordinatorin Kombëtar për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit. Koordinatorin i sapoemëruar duhet të luajë një rol më të fortë në koordinimin ndërinstitucional, me strukturë të qartësuar dhe linja raportimi.

Konkluzionet e Nënkomitetit për Drejtësi, Liri dhe Siguri rekomandojnë vazhdimin e zbatimit të qëndrueshëm të strategjisë kundër terrorizmit dhe strategjisë për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit. Institucionet duhet të sigurohen që të zbatohen programe gjithëpërfshirëse për parandalimin, de-radikalizimin, rehabilitimin dhe riintegrimin e luftëtarëve të kthyer, përfshirë ata në burgje dhe familjet e tyre, veçanërisht gratë dhe të miturit. Nënkomiteti rekomandon që të sigurohet që Divizioni për Riintegrim në MPB ka burimet e nevojshme financiare dhe njerëzore për të realizuar rehabilitimin dhe riintegrimin e luftëtarëve të huaj terroristë dhe anëtarëve të familjes së tyre. Gjithashtu duhet t'i jepet prioritet i mjaftueshëm parandalimit të përhapjes së radikalizimit dhe që praktikuesve vendorë u jepen burimet, mbështetja dhe njohuritë e nevojshme për të trajtuar në mënyrë efektive problemin; gjithashtu, vëmendje duhet t'i kushtohet rolit të mediave sociale dhe ndikimit të jashtëm në proceset e radikalizimit. Raporti i KE rekomandon që organizatat e shoqërisë civile duhet të përfshihen më shumë në proceset rehabilituese. Më tutje, theksohet se Kosova duhet të rrisë shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunimin operativ me fqinjët, Shtetet Anëtare të BE-së, Europolin dhe Interpolin. Gjithashtu duhet të ngritën kapacitetet për t'iu përgjigjur krizës dhe për të mbrojtur infrastrukturën kritike, duke siguruar zbatimin efektiv të ligjit të saj mbi infrastrukturën kritike.

Raporti për Vendin i vitit 2020 thekson që Kosova nuk është palë në shumicën e traktateve shumëpalëshe që rregullojnë bashkëpunimin e ndërsjellë gjyqësor, ajo zbaton në mënyrë të njëanshme standardet e traktateve të njohura ndërkombëtarisht. Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar i Kosovës në çështjet penale bazohet në ligjin përkatës të vitit 2013 si dhe në 28 traktate bilaterale. Katër traktate shtesë hynë në fuqi në periudhën e raportimit: një me Çekinë, dy me Francën dhe një traktat ekstradimi me SHBA-në. Bashkëpunimi me vendet me të cilat Kosova nuk ka marrëveshje bilaterale bazohet në parimin e reciprocitetit. Korniza ligjore për bashkëpunimin gjyqësor në çështjet civile ende nuk është e konsoliduar, pasi ligji është ende në fazën e hartimit. Puna për një rishikim të Ligjit për Bashkëpunim Ligjor në Çështjet Penale është duke vazhduar, dhe kjo do të sqarojë tekstin në një numër pikash.

Gjendja aktuale

Korniza legjislativë dhe ajo e politikave

Menaxhimi i kufirit

Korniza legjislativë në këtë fushë përbëhet nga këto akte kryesore normative relevante:

- Ligji nr. 04/L-214 mbi Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror;
- Ligji nr. 04/L-216 për Bashkëpunim ndërmjet Autoriteteve të Përfshira në Menaxhimin e Integruar të Kufirit;
- UA (QRK) nr. 09/2013 për Formën, Përmbajtjen dhe Mënyrën e Vendosjes së Shenjave Paralajmëruese dhe Shenjave të Shkruara në Pikat e Kalimit të Kufirit dhe në Zonën e Kalimit të Kufirit;
- UA (QRK) nr. 13/2013 për Shënjimin e Vijës Kufitare;
- UA (MPB) nr. 20/2013 për Rregullat e Trafikut Lokal Kufitar dhe Lejen e Trafikut Lokal Kufitar 23 Marrëveshje dhe Protokolle për Bashkëpunim Policor në fushën e Kufirit (me Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut, me Malin e Zi dhe me Serbinë);
- 12 marrëveshje për bashkëpunim doganor (me Shqipërinë, Malin e Zi, Finlandën, Hungarinë, Maqedoninë e Veriut, Slloveninë, Turqinë, Francën, Italinë, Poloninë, Austrinë dhe Britaninë e Madhe).

Këto akte normative kanë transpozuar këto akte të acquis-së:

- Rregulloren nr. 562/2006/KE (Kodi i Kufijve të Schengenit);
- Rregulloren (KE) 1931/2006 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit që vendos rregulla mbi Trafikun Lokal Kufitar;
- Rregulloren (BE) 610/2013 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit që ndryshon Rregulloren (KE) 526/2006 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit që themelon Kodin e Komunitetit mbi rregullat që drejtojnë lëvizjen e personave mes kufijve (Kodi Schengen i Kufijve);
- Konventën që zbaton Marrëveshjen e Schengen-it, Rregulloret e Këshillit (KE) 1693/2013 dhe (KE) 539/2001 dhe Rregulloret (KE) 767/2008 dhe (KE) 810/2009 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit;
- Rregulloren (BE) 1051/2013 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit që ndryshon Rregulloren (KE) 562/2006 me qëllim të sigurimit të Rregullave të Përbashkëta për Rivendosjen e Përkohshme të Kontrollit Kufitar në Kufijtë e Brendshëm në Rrethanat e Jashtëzakonshme;
- Udhëzimet për Menaxhimin e Integruar të Kufirit mbi bashkëpunimin e jashtëm të BE-së.

Politika e vizave

Që nga 1 korriku 2013 Qeveria e Republikës së Kosovës ka vendosur regjim vizash për shtetasit e 88 shteteve që planifikojnë të hyjnë në Republikën e Kosovës. Regjimi i vizave vazhdon të zbatohet me legjislacion të kompletuar dhe sistem funksional të KVIS në 15 misione diplomatike të Kosovës dhe 7 PKK.

Korniza legjislativë në fushën e vizave përbëhet nga këto akte kryesore normative relevante:

- Ligji nr. 04/L-219 për të Huajt;
- UA MPJ nr. 01/2014 për procedurat e lëshimit të vizave për të huajt nga misionet diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës.
- UA MPJ nr 03/2015 për Sistemin Informativ të Vizave (SIVK)
- UA MPJ nr 02/2015 për formën dhe përmbajtjen e afishes së vizës.
- UA MPB nr 08/2014 për procedurat e lëshimit të vizave në pikat e kalimit kufitar.
- UA MPB nr 22/2013 për kushtet dhe procedurat e vazhimit të vizave.

Këto akte normative kanë transponuar këto akte të acquis-së:

- Rregulloren (KE) nr. 810/2009 (Kodi i Vizave);
- Direktivën 2014/66/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 15 majit 2014 mbi kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta në kuadër të transfereve brenda korporatave;

- Direktivën 2014/36/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 26 shkurtit 2014 mbi kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta për qëllim të punësimit të punëtorëve sezonalë.

Migrimi

Korniza legislative në këtë fushë përbëhet nga këto akte kryesore normative relevante:

- Ligjin nr. 06/1-036 për të Huajt;
- Ligjin nr. 06/1-026 për Azilin;
- Ligji nr. 03/L-208 për Ripranim;
- 23 marrëveshje bilaterale për ripranim;
- Ligji nr. 04/1-215 për Shtetësinë;
- Ligji nr. 04/L-218 për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit.

Këto akte normative kanë transponuar këto akte të acquis-së:

- Direktivën 2014/66/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 15 majit 2014 mbi kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta në kuadër të transfereve brenda korporatave;
- Direktivën 2014/36/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 26 shkurtit 2014 mbi kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta për qëllim të punësimit të punëtorëve sezonal;
- Rregulloren (KE) nr. 810/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit "Mbi themelimin e Kodit të Komunitetit për vizat" – pjesërisht;
- Direktivën 2009/52/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit "Mbi parashikimin e standardeve minimale të sanksioneve dhe masave ndaj punëdhënësve për punonjës nga vendet e treta me qëndrim të paligjshëm" – plotësisht;
- Direktivën 2009/50/KE të Këshillit mbi kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta me qëllim pune – plotësisht;
- Direktivën 2008/115/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi standardet dhe procedurat e përbashkëta në vendet e anëtare për kthimin shtetasve të vendeve të treta me qëndrim të parregullt – plotësisht;
- Direktivën 2005/71/KE të Këshillit mbi procedurat specifike për pranimin e shtetasve të vendeve të treta për qëllime të kërkimeve shkencore – pjesërisht;
- Direktivën 2004/81/KE të Këshillit mi lejet e qëndrimit të lëshuara shtetasve të vendeve të treta që janë viktimat të trafikimit të qenieve njerëzore ose që kanë qenë subjekt i një veprimi për lehtësimin e imigracionit të paligjshëm, të cilët bashkëpunojnë me autoritetet kompetente – pjesërisht
- Direktivën 2004/114/KE të Këshillit mbi kushtet e pranimit të shtetasve të vendeve të treta për qëllim studimi, programe të shkëmbimit për nxënës, trajnim pa pagesë ose shërbim vullnetar – pjesërisht;
- Direktivën 2003/109/KE të Këshillit, në lidhje me statusin e shtetasve të vendeve të treta që janë rezidentë afatgjatë – pjesërisht;
- Direktivën 2003/86/KE të Këshillit mbi të drejtën e bashkimit familjar – plotësisht;
- Direktivën 96/71/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, në lidhje me transferimin e punëtorëve në kuadër të ofrimit të shërbimeve – plotësisht;
- Direktivën 2011/98/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi procedurën unike të aplikimit për leje unike për shtetasit e vendeve të treta për qëndrim dhe punë në territorin e një Shteti Anëtar dhe në një sërë të drejtash të përbashkëta – pjesërisht;
- Direktivën 2001/51/KE të Këshillit që plotëson dispozitat e nenit 26 të Konventës që zbaton Marrëveshjen e Schengenit të 14 qershorit 1985 – pjesërisht;
- Direktivën 2002/90/KE të Këshillit mbi definimin e lehtësimit të hyrjes, tranzitit dhe qëndrimit të paautorizuar – e transpozuar plotësisht;

- Direktivën 2008/115/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi standardet dhe procedurat e përbashkëta të Shteteve Anëtare për rikthimin e qytetarëve të vendeve të treta që qëndrojnë ilegalisht;
- Konventën Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut;
- Konventën e OKB-së mbi Statusin e Refugjatit (Konventën e Gjenevës, 1951) si dhe Protokollin Zbatues të saj (Protokollin e Nju Jorkut, 1967);
- Konventën e OKB-së mbi të Drejtat e Fëmijës;
- Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian.

Korniza e politikave në këtë fushë përbëhet nga këto dokumente:

- Strategjia Kombëtare për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar;
- Strategjia Kombëtare për Riintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar;
- Profilet e lehta të migrimit (si dokumente gjithëpërfshirëse me të dhëna standarde për migrimin dhe të dhëna lidhur me fushat e tjera të cilat potencialisht ndikojnë në fenomenin e migrimit, si situata ekonomike dhe sociale, tregu i punës, kapitali njerëzor, arsimimi, tregtia etj).

Korniza e politikave në këtë fushë bazohet edhe në këto akte ndërkombëtare:

- Deklaratën Universale mbi të Drejtat e Njeriut;
- Konventën e Gjenevës 1951 në lidhje me Statusin e Refugjatit dhe Protokollin e saj të vitit 1967;
- Konventën e Nju Jorkut për Personat pa Shtetësi;
- Konventën e OKB-së për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Gruas;
- Konventën e OKB-së, të vitit 1984, kundër Torturës dhe Trajtimit ose Ndëshkimit Tjetër Më të Dëmshëm dhe Poshtërues;
- Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollin e saj;
- Konventën e OKB-së mbi të Drejtat e Fëmijës;
- Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Protokollin e saj.

Azili

Korniza legislative në këtë fushë përbëhet nga Ligji nr. 06/L-026 për Azil (miratuar më 5 maj 2018), i cili ka transpozuar pjesërisht këto akte të acquis-së:

- Direktivën 2003/9/KE-të Këshillit mbi Kushtet e Pranimit për Azilkërkues;
- Direktivën 2004/83/KE të Këshillit mbi Standardet Minimale për Kualifikimin dhe Statusin e Shtetasve të Vendeve të Treta apo Personave pa Shtetësi si Refugjatë apo Persona që kanë Nevojë për Mbrojtje Ndërkombëtare (Direktiva mbi Kualifikimet);
- Direktivën 2011/95/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi Standardet dhe Kualifikimin e Shtetasve të Vendeve të Treta apo Personave pa Shtetësi si përfitues të Mbrojtjes Ndërkombëtare, për një Status Uniform të Refugjatit ose për Personat e Kualifikuar për Mbrojtje Shtesë (Recast);
- Direktivën 2005/85/KE të Këshillit mbi Procedurat e Azilit;
- Direktivën 2013/33/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 26 qershorit 2013 që përcakton standardet për pranimin e aplikantëve për mbrojtje ndërkombëtare;
- Direktivën 2013/32/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 26 qershor 2013 mbi procedurat e përbashkëta për dhënien dhe tërheqjen e mbrojtjes ndërkombëtare.

Luftimi i shpëlarjes së parasë dhe financimit të terrorizmit

Korniza legislative në këtë fushë përbëhet nga këto akte kryesore normative relevante:

- Kodi Penal i Republikës së Kosovës;
- Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit, i cili ka transpozuar
 - Direktivën e BE-së 2015/849 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 20 maj 2015, për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, që ndryshon Rregulloren e BE-së nr. 648/2012 e Parlamentit

Evropian dhe e Këshillit, dhe shfuqizon Direktivën 2005/60/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit dhe Direktivën e Komisionit 2006/70/KE dhe me standardet ndërkombëtare të përcaktuara nga Task Forca për Veprim Financiar (FATF);

- Ligji nr. 04/L-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë.

Lufta kundër narkotikëve

Korniza legislative në këtë fushë përbëhet nga këto akte kryesore normative relevante:

- Kodi Penal i Republikës së Kosovës;
- Kodi nr. 04/L-123 i Procedurës Penale;
- Ligji nr. 02/L-128 për Barnat Narkotike, Substancat Psikotrope dhe Prekursorë, i cili bazohet në Konventat në vijim:
 - Konventën e ndarë të Kombeve të Bashkuara për droga narkotike (Nju Jork, 30 mars 1961), siç është amendamentuar nga Protokollin e vitit 1972 (Gjenevë, 25 mars 1972);
 - Konventën e Kombeve të Bashkuara për substanca psikotrope (Vjenë, 21 shkurt 1971);
 - Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe substancave psikotrope (Vjenë, 20 dhjetor 1988), e cila vlen edhe për bashkëpunim gjyqësor në çështje penale;
- UA nr. 10/2010 për administrimin dhe përdorimin e metadonit për programe mbajtëse.

Korniza e politikave në këtë fushë përbëhet nga Strategjia e re Kombëtare dhe PV kundër Narkotikëve 2018-2022.

Lufta kundër rimit të organizuar dhe bashkëpunimi policor

Korniza legislative në këtë fushë përbëhet nga këto akte kryesore normative relevante:

- Kodi Penal, në të cilin janë transpozuar pjesërisht këto akte të acquis-së:
 - Vendimin Kornizë për luftimin e krimit të organizuar (Vendimi Kornizë 2008/841/JHA);
 - Vendimin Kornizë për vendosjen e sanksioneve penale kundër falsifikimit të euro-së (Vendimi Kornizë 2000/383/JHA, i ndryshuar me Vendimin Kornizë 2001/888/JHA);
 - Vendimi Kornizë për luftimin e mashtrimit dhe falsifikimit të mjeteve që nuk përfshijnë pagesa me para të gatshme (Vendimi Kornizë 2001/413. JHA);
 - Direktivën 2001/36 te BE-se për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me qenie njerëzore;
 - Direktivën 2011/93E BE-se për luftimin e abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve; dhe
 - Vendimin Kornizë të Këshillit 2004/757/JHA për dispozitat minimale për elementet përbërëse të veprave penale dhe dënimet në fushën e trafikut të paligjshëm të drogës.
- Kodi i Procedurës Penale, i cili ka transpozuar këto akte të acquis-së:
 - Direktivën 2010/64/BE për të Drejtën në Interpretim dhe Përkthim në Procedurën Penale;
 - Direktivën 2012/29/BE për të Drejtën në Informim në Procedurën Penale;
 - Direktivën 2012/29/BE që themelon standardet minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit dhe që zëvendëson Vendimin Kornizë të Këshillit 2001/220/JHA;
 - Direktivën 2013/48/BE, për të Drejtën e Qasjes në Mbrojtës/Avokat në procedurën penale dhe në procedurën e Urdhër Arrestit Evropian, dhe në të Drejtën e Informimit të një personi të tretë për kufizimin e lirisë dhe të komunikojë me personat e tretë dhe me autoritetet konsullore lidhur me kufizimin e lirisë;
 - Vendimin kornizë të Këshillit 2005/212/JHA dhe Vendimin kornizë të Këshillit nr. 2000/383/JHA.
- Ligji për Mbrojtjen e Dëshmitarëve;
- Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Krimit Kibernetik;
- Ligji nr. 05/L-049 për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, i cili ka transpozuar këto akte të acquis-së:

- Vendimin Kornizë të Këshillit 2005/212/JHA;
- Vendimin Kornizë të Këshillit 2007/845/JHA;
- Vendimin Kornizë të Këshillit 2006/783/JHA.
- Ligji për Bashkëpunimin Juridik Ndërkombëtar në çështjet Penale, i cili ka transpozuar këto akte të acquis-së:
 - Vendimin Kornizë të Këshillit 2003/577/JHA;
 - Vendimin Kornizë të Këshillit 2006/783/JHA për aplikimin e parimit të pranimit të përbashkët të urdhrave të konfiskimit;
 - Vendimin Kornizë të Këshillit 2007/845/JHA;
 - Vendimin Kornizë të Këshillit 2001/413/JHA; si dhe Vendimin Kornizë të Këshillit 2007/845/JHA.
- Ligji për Mbrojtjen e Informatorëve;
- Ligji nr. 04/L-076 për Policinë;
- Ligji për Barnat Narkotike, Substancat Psikotrope dhe Prekursorë, i cili ka transpozuar pjesërisht
 - Rregulloren (KE) nr. 1258/2013 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 20 nëntorit 2013 që e amendamenton Rregulloren (KE) e 273/2004 e 11 shkurt 2004 për prekursorë.
- Ligji nr. 04/L-218 për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit, i cili ka transpozuar pjesërisht
 - Direktivën 2011/36/BE mbi parandalimin dhe luftimin e trafikimit me qenie njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tyre.
- Ligji për Kompensimin e Viktimave të Krimit, i cili ka transpozuar pjesërisht
 - Direktivën e Këshillit 2004/80/KE lidhur me kompensimin e viktimave të krimit, ku ky ligj reflekton kërkesën e direktivës, lidhur me procedurat për kompensim të viktimave të krimit në rastet ndër-kufitare si dhe themelimin e autoriteteve vendimmarrëse dhe asistuese në rastet e kompensimit të viktimave.
- Ligji nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror;
- Ligji për Ekzekutimin e Sankcioneve Penale;
- Ligji për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë;
- Ligji për Prokurorin e Shtetit;
- Ligji për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë;
- Ligji për Gjykatat;
- Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- Ligji për Përgjimin e Komunikimeve Elektronike.

Korniza e politikave në këtë fushë përbëhet nga këto dokumente:

- Strategjia Kombëtare dhe PV i Republikës së Kosovës Kundër Krimit të Organizuar 2018-2022;
- Strategjia Kombëtare dhe PV i Republikës së Kosovës kundër Narkotikëve 2018-2022;
- Strategjia për kontrollimin dhe mbledhjen e armeve të vogla dhe të lehta 2017-2022.

Lufta kundër terrorizmit

Korniza legislative në këtë fushë përbëhet nga këto akte kryesore normative relevante:

- Kodi Penal i Republikës së Kosovës;
- Kodi nr. 04/L-123 i Procedurës Penale;
- Ligji nr 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit;
- Ligji nr. 05/1-002 për Ndalimin e Bashkimit në Konfliktet të Armatosura jashtë Territorit të Vendit;
- Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Parandalimin e Financimit të Terrorizmit; dhe
- Ligji për Ndalimin e Bashkimit në Konfliktet të Armatosura jashtë Territorit të Vendit.

Korniza e politikave në këtë fushë përbëhet nga këto dokumente:

- Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës kundër Terrorizmit 2018-2023;
- Strategjia Kombëtare për Parandalimin dhe Luftën kundër Ekonomisë Joformale, Shpëlarjes së Parasë, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2019 - 2023; dhe

- Strategjia për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit që Shpie në Terrorizëm 2018 - 2023.

Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështje penale dhe civile

Korniza legislative në këtë fushë përbëhet nga Ligji për Bashkëpunimin Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale, i cili ka transpozuar këto akte të acquis-së:

- Vendimin Kornizë të Këshillit 2003/577/JHA mbi ekzekutimin e urdhrave të ngrirjes së pronës ose dëshmimeve në Bashkimin Evropian;
- Vendimin Kornizë të Këshillit 2006/783/JHA mbi aplikimin e parimit të njohjes reciproke të urdhrave të konfiskimit;
- Vendimin Kornizë të Këshillit 2007/845/JHA i 6 dhjetorit 2007 lidhur me bashkëpunimin në mes të Zyrave të Konfiskimit të Aseteve të Shteteve Anëtare në fushën e gjurmimit dhe identifikimit të të ardhurave, ose pasurisë tjetër të lidhur, nga/ me krimin; dhe
- Vendimin Kornizë të Këshillit 2001/413/JHA i 28 majit të 2001 mbi luftimin e mashtrimit dhe falsifikimit të mënyrave të pagesave që nuk përfshijnë para të gatshme.

Korniza institucionale

Menaxhimi i kufirit

Korniza institucionale në këtë fushë përbëhet nga këto institucione:

- Policia e Kosovës (Departamenti për Kufij);
- Dogana e Kosovës; dhe
- Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë.

Përveç këtyre, gjithashtu funksionon edhe Bordi Ekzekutiv për MIK dhe Qendra Kombëtare për Menaxhimin e Kufirit (QKMK).

Politika e vizave

Korniza institucionale në këtë fushë përbëhet nga këto institucione:

- Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, përkatësisht Departamenti për Çështje Konsullore dhe misionet e Shërbimit të Jashtëm;
- Ministria e Punëve të Brendshme, përkatësisht Departamenti për Shtetësi Azil dhe Migracion;
- Policia e Kosovës, përkatësisht Policia Kufitare.

Migrimi

Korniza institucionale në këtë fushë përbëhet nga këto institucione:

- Ministria e Punëve të Brendshme, përkatësisht Departamenti për Shtetësi Azil dhe Migracion (i cili gjithashtu mbikëqyr Qendrën për Azil dhe Qendrën e Mbajtjes për të Huaj);
- Policia e Kosovës, përkatësisht Drejtoria për Migrim dhe të Huaj, Departamenti për Hetimin e Krimin të Organizuar, Policia Kufitare dhe Drejtoria për Hetimin e Trafikimit;
- Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar.
- Komunitat (të cilat kanë rol në zbatimin e politikave të riintegrimin).

Azili

Korniza institucionale në këtë fushë përbëhet nga Ministria e Punëve të Brendshme, përkatësisht Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion (në kuadër të të cilit funksionon edhe Qendra për Azilkërkues).

Luftimi i shpëlarjes së parasë dhe financimit të terrorizmit

Korniza institucionale në këtë fushë përbëhet nga këto institucione:

- Njësia e Inteligjencës Financiare;

- Ministria e Financave, Punës dhe Transfere, përkatësisht Dogana e Kosovës, dhe Administratës Tatimore e Kosovës;
- Policia e Kosovës, përkatësisht Drejtoria Kundër Krimeve Ekonomike;
- Prokurori i Shtetit; dhe
- Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës.

Lufta kundër narkotikëve

Korniza institucionale në këtë fushë përbëhet nga këto institucione:

- Policia e Kosovës, përkatësisht Drejtoria për Hetimin e Trafikimit të Drogave (me mbështetjen e departamenteve të tjera të PK-së);
- Dogana e Kosovës;
- Agjencia e Kosovës për Inteligjencë;
- Ministria e Shëndetësisë, përkatësisht Inspektorati Shëndetësor, Agjencia e Kosovës për Pajisje dhe Produkte Medicinale;
- Agjencia Kosovare për Forenzikë;
- Prokurori i Shtetit
- Ministria e Drejtësisë, përkatësisht Departamenti i Mjekësisë Ligjore; dhe
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Përveç këtyre, gjithashtu ekziston Koordinatori nacional dhe Sekretariati përgjegjës për këtë fushë, në kuadër të MPB-së.

Lufta kundër krimit të organizuar dhe bashkëpunimi policor

Korniza institucionale në këtë fushë përbëhet nga këto institucione:

- Ministria e Punëve të Brendshme, përkatësisht Policia e Kosovës:
 - Drejtoria Kundër Krimit të Organizuar,
 - Drejtoria Kundër Trafikimit me Narkotikë,
 - Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore,
 - Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit, përmes Divizionit të Hetimeve, e përbërë nga këta Sektorë: për Hetimin e Krimeve Ekonomike, për Hetimin e Korrupsionit dhe për Hetimin e Krimeve Financiare),
 - Drejtoria për Mbrojtjen e Dëshmitarëve,
 - Njësia kundër Terrorizmit, dhe
 - Sektori i Hetimit të Krimeve Kibernetike;
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, përkatësisht
 - Dogana e Kosovës,
 - Njësia për Inteligjencë Financiare dhe
 - Administrata Tatimore e Kosovës;
- Ministria e Drejtësisë;
- Agjencia Kosovare për Inteligjencë;
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës;
- Këshilli Prokurorial i Kosovës;
- Prokuroritë;
- Gjykatat.

Përveç këtyre, gjithashtu ekziston dhe Koordinatori Nacional dhe Sekretariati përgjegjës për këtë fushë, në kuadër të MPB-së.

Lufta kundër terrorizmit

Korniza institucionale në këtë fushë përbëhet nga këto institucione:

- Ministria e Punëve të Brendshme;
- Agjencia Kosovare për Inteligjencë;

- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, përkatësisht
 - Dogana e Kosovës,
 - Njësia për Inteligjencë Financiare dhe
 - Administrata Tatimore e Kosovës;
- Zyra e Kryeministrit.
- Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës

Përveç këtyre, gjithashtu ekziston dhe Sekretariati përgjegjës për këtë fushë, në kuadër të MPB-së.

Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështje penale dhe civile

Korniza institucionale në këtë fushë përbëhet nga Ministria e Drejtësisë, përkatësisht

- Departamenti për bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar, i cili përbëhet nga dy divizione:
 - Divizioni për Bashkëpunim në Çështje Penale, dhe
 - Divizioni për Hartim dhe Negocim të Marrëveshje.

Mbështetja e donatorëve

Institucionet e Kosovës mbështeten nga KE (përmes IPA-s) dhe nga donatorë të tjerë bilateralë me projektet e përmbledhur në vijim.

Projektet aktuale dhe të planifikuara IPA

Mbështetje për reforma në polici në harmoni me standardet e BE-së:

- Përshkrimi: Ndhimë në zbatimin e reformave në polici, përfshirë zbatimin e policimit të udhëhequr nga inteligjenca, luftimin e krimit kibernetik, ofrimin e trajnimeve dhe pajisjeve lidhur me teknika të avancuara të hetimit në fushën e trafikimit me narkotike, qenie njerëzore, etj; krijimin e një sistemi të paralajmërimit të hershem të drogave të reja; adresimin e çështjes së uljes së moshës mesatare në policinë e Kosovës;
- Përfituesi: Ministria e Punëve të Brendshme; (PK);
- Periudha e zbatimit: 2019-2022.

Digjitalizimi i Kopjeve të Certifikuara të Librave të Regjistrimit Civil - Faza III Ndërlidhja e Kopjeve të Certifikuara e-arkivi dhe Regjistrimit Qendror të Gjendjes Civile të Kosovës

- Periudha: mars 2020 – qershor 2022

Projekti Rajonal për Luftimin e Krimeve të Rënda në Ballkanin Perëndimor

- Periudha: 1 korrik 2020 – 30 qershor 2023

Projekti kundër Krimit Ekonomik në Kosovë (PECK III):

- Përshkrimi: ky projekt ka për qëllim të përmirësojë zbatimin e masave të Anti-Korrupsionit (AC), Pastrimit të Parave/Luftimit të Financimit të Terrorizmit (LPP/LFT) dhe masave të kundër-terrorizmit dhe përputhjes së tyre me standardet evropian;
- Përfitues: Zyra e Kryeministrit, Njësia e Inteligjencës Financiare, Agjencia Kundër Korrupsionit, dhe Ministria e Financave, Transfereve dhe Punës;
- Periudha e zbatimit: pas përfundimit të PECK II.

Gjithashtu institucionet e punëve të brendshme do të mbështeten me programin IPA 2020 duke forcuar luftën kundër krimit të organizuar, terrorizmit dhe korrupsionit në Kosovë.

Misioni i BE-së për Sundimin e Ligjit (EULEX) mbështet dhe ndihmon autoritetet e Kosovës në fushën e sundimit të ligjit, veçanërisht në fushën e policisë, gjyqësorit, dhe doganës. Si mision teknik, EULEX monitoron dhe këshillon autoritetet e Kosovës përderisa i mbetet një numër i kufizuar i përgjegjësive ekzekutive, si në rastin e Zyrës së Prokurorisë Speciale. Detyra e këtij institucioni është të merret me raste sensitive si rastet e krimeve të luftës, terrorizmit, krimit financiar dhe korrupsionit, si dhe krimit të organizuar.

Projektet aktuale dhe të planifikuara të donatorëve bilateralë

MPB, përveç mbështetjes nga Komisioni Evropian, është vazhdimisht përfituese e projekteve mbështetëse nga ICITAP, që ndihmon fuqizimin e sundimit të ligjit dhe ndërtimin e kapaciteteve të institucioneve të gjyqësorit, prokurorisë dhe të sundimit të ligjit për luftimin e krimit të organizuar, trafikimit me qenie njerëzore, korrupsionit, shpëlarjes së parasë dhe terrorizmit. Programi i ICITAP-it financohet nga Byroja e Çështjeve Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Zbatimit të Ligjit në kuadër të Departamentit të Shtetit të SHBA-se. ICITAP aktualisht mbështet Kosovën me programet e përshkruara në vijim.

Mbështetje për menaxhimin ekzekutiv të policisë së Kosovës: ky program ofron këshilla për Drejtorin e përgjithshëm të Policisë së Kosovës lidhur me bashkëpunimin me Policinë e Serbisë, shtrirjen e sundimit të ligjit në veri të Kosovës, ngritjen e nivelit të profesionalizmit, llogaridhënies dhe integritetit brenda nivelit ekzekutiv dhe të mesëm në polici.

Mbështetje për Ministrinë e Punëve të Brendshme për përmirësimin e praktikave të menaxhimin ekzekutiv, si dhe mbështetje për agjencitë e MPB-së si Inspektoratin policor të Kosovës, Agjencinë e Kosovës për Forenzikë, Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave, Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, në ngritjen e kapaciteteve.

Mbështetje në fushën e luftimit të krimeve të rënda dhe hetimeve komplekse kriminale: ka për qëllim të përmirësojë kapacitetet e MPB-së për të parandaluar dhe luftuar krimin e organizuar, korrupsionin, terrorizmin, trafikimin me narkotikë, trafikimin e qenieve njerëzore etj. dhe përmirësimin e kapaciteteve të departamentit për hetimin e krimit brenda PK-së për të kryer hetime të rasteve komplekse duke përdorur teknika moderne hetimore.

ICITAP gjithashtu mbështet fushën e menaxhimit të integruar të kufirit dhe atë të sigurisë në bashkësi.

Për më tepër, MPB përfiton nga mbështetja e ofruar nga UNDP

Programi Kosovo Safety & Security – KSSP (UNDP)

- Buxheti: ~3 mil euro;

2. CIAT – Combating Illicit Arms Trafficking/Luftimi i Trafikimit të Jashtëligjshëm të Armëve

- Periudha: korrik 2019 – dhjetor 2021

MPB gjithashtu përfiton nga projekti *Mbështetje në procesin e integritetit evropian*, i cili mbështet Departamentin për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave në ngritjen e kapaciteteve për koordinimin e procesit të liberalizimit të vizave. Projekti gjithashtu ofron mbështetje për departamentin për shtetësi, azil dhe migrim, si dhe departamentin për ri-integrim të personave të riatdhesuar.

MIMAK 2 – Mbështetje për Institucionet e Kosovës në Menaxhimin e Migrimit (Sekretariati Shtetëror për Migrim i Zvicrës, Agjencia Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim)

Periudha: janar 2020 – janar 2022; Buxheti: 1 milion euro.

Ministria e Punëve të Brendshme përfiton edhe nga projekti *Mbështetje për Autoritetin Qeveritar për Monitorimin e Lëvizjeve të Migrimit (AQM)*, financuar nga Agjencia zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim dhe i zbatuar nga Qendra ndërkombëtare për zhvillimin e politikave të migracionit. Projekti ka për qëllim ngritjen e kapaciteteve të Autoritetit Qeveritar për Migracion në hartimin dhe përgatitjen e politikave të migracionit përmes asistencës teknike dhe trajnimeve.

Objektivat prioritarë afatmesme

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA dhe dokumentet e mekanizmat e të tjerë të aderimit në BE në kuadër të fushëveprimit të kapitullit 24, fokusi gjatë periudhës 2021-2025 do të jetë në këto objektiva prioritarë afatmesme:

Menaxhimi i kufirit

- Avancimi i bashkëpunimit ndërkombëtar me autoritete si Frontex, Selec etj.;
- Hapja e pikë-kalimeve kufitare të reja me vendet fqinje;
- Avancimi i pajisjeve për mbikëqyrjen dhe kontrollin e kufirit.

Politika e vizave

- Shtrirja e SIVK-ut në misionet e tjera diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës.

Azili

- Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm të bashkëpunimit qendror dhe lokal për azilkërkues që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare.

Migrimi

- Avancimi i bashkëpunimit ndërkombëtar në luftimin e migrimit të parregullt;
- Promovimi i migrimit të rregullt dhe atij qarkor.

Luftimi i shpëlarjes së parasë dhe financimit të terrorizmit

- Përmirësimi i mëtejshëm i kornizës së politikave në fushën e luftës kundër shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit;
- Anëtarësimi i Kosovës në Moneyval;
- Fuqizimi i kapaciteteve të Njësisë së Inteligjencës Financiare (NjIF), në luftimin e financimit të terrorizmit dhe pastrimit të parave;
- Forcimi i bashkëpunimit ndër-institucional, përfshirë bashkëpunimin ndër-institucional me autoritetet për zbatimin e ligjit dhe subjektet raportuese, veçanërisht në fushën e trajtimit të transaksioneve të dyshimta financiare.

Lufta kundër narkotikëve

- Avancimi i bashkëpunimit me EMCDDA.

Lufta kundër krimit të organizuar dhe bashkëpunimi policor

- Krijimi i një bazë të të dhënave për regjistrat penal, përfshirë evidencën për personat e dënuar;
- Finalizimi, miratimi dhe zbatimi i politikave për procesin e vetingut në agjencitë vartëse të MPB-së, duke përfshirë krijimin e mekanizmave të procesit të vetingut;
- Rritja e numrit të gjyqtarëve dhe specializimi i prokurorëve e gjyqtarëve në fushën e krimit të organizuar;
- Ngritja e kapaciteteve teknike të laboratorëve të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë;
- Rritja e numrit të urdhrave për konfiskim të aseteve dhe në përgjithësi përmirësimi i rezultateve në konfiskimin e përhershëm të aseteve të përfituara në mënyrë të paligjshme;
- Zhvillimi i kornizës ligjore për vetingun në sistemin e drejtësisë, agjencitë vartëse të MPB-së dhe të sigurisë publike.

Lufta kundër terrorizmit

- Ngritja e kapaciteteve teknike, logjistike dhe teknologjike në fushën e terrorizmit dhe parandalimit të përhapjes së ekstremizmit përmes internetit dhe mediave sociale;
- Fuzionimi i strategjive kundër terrorizmit, radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm;
- Ngritja e kapaciteteve teknike, logjistike dhe teknologjike në fushën e terrorizmit;
- Ngritja e kapaciteteve kibernetike kundër terrorizmit;
- Fuqizimi i kapaciteteve dhe qasjes për de-radikalizim dhe ri-integrim;

Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështje penale dhe civile

- Avancimi i bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështje të ekstradimit dhe ndihmës së ndërsjellë juridike në çështjet penale dhe civile.

3.25. Kapitulli 25 i acquis-së: Shkenca dhe kërkimet shkencore

Acquis për këtë kapitull nuk kërkon transpozimin e rregullave të BE në rendin ligjor kombëtar por kërkon nga shtetet anëtare të sigurojnë kapacitetet e nevojshme zbatuese për të ndjekur objektivat dhe aktivitetet e BE-së në fushën e kërkimit dhe zhvillimit teknologjik. Kapacitetet e nevojshme zbatuese lidhen me ekzistencën e kushteve të nevojshme për pjesëmarrjen në programet e BE-së për hulumtim dhe inovacion për të lehtësuar integrimin në Zonën Evropiane të Kërkimit (ERA).

Kërkesat e MSA-së

Sipas nenit 118 të MSA-së, palët duhet të inkurajojnë bashkëpunimin në hulumtime shkencore dhe zhvillimin teknologjik mbi bazën e përfitimit të ndërsjellë duke marrë parasysh burimet e disponueshme, qasjen adekuate në programet përkatëse duke iu nënshtruar niveleve të përshtatshme të mbrojtjes efektive

të drejtave të pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare. Bashkëpunimi duhet të marrë në konsideratë fushat prioritare që lidhen me acquis e BE-së në fushën e kërkimit dhe zhvillimit teknik.

Kërkesat nga mekanizmat e tjerë të aderimit në BE

Sipas *Raportit të KE-së për Kosovën – 2020*, Kosova është në fazë të hershme të përgatitjeve për shkencë dhe hulumtime. Në fushën e inovacioneve është arritur progres i kufizuar.

Gjatë vitit vijues, Kosova duhet që posaçërisht: të sigurojë shpenzime më të larta qeveritare në hulumtime dhe të përpiqet të nxisë investimet nga sektori privat duke përfunduar Strategjinë e specializimit të mençur; të fokusojë përpjekjet për rritjen e pjesëmarrjes në Programin e BE-së Horizonti 2020; të sigurojë të dhëna statistikore për numrat e hulumtuesve, përqindjen e BPV-së së shpenzuar në hulumtime dhe inovacion, dhe performancën që lidhet me prioritetet e Zonës Evropiane të Kërkimeve.

Kosova ka bërë përpjekje që të zhvillojë politikën e saj të hulumtimit dhe inovacionit. Megjithatë, Ligji për Veprimtaritë Hulumtuese Shkencore nuk është duke u zbatuar siç duhet, për shkak të mungesës së fondeve. Shpenzimet qeveritare në hulumtim janë vetëm 0.1% të BPV-së. Kosova ka bërë ca përpjekje për të shpenzuar këtë shumë të kufizuar në mënyrë më efikase (p. sh. ndërtimi i sallave për ligjërata dhe laboratore që trajtojnë plagjiaturën). Më 2018, 1.1 milionë euro janë ndarë për laboratorë dhe pajisje specifike në dy qendra rajonale të inovacionit. Në arsimin e lartë, cilësia e programeve post-diplomike që përgatisin për karrierë hulumtimesh janë me cilësi të dobët, ku edhe institucionet private edhe ato publike të arsimit të lartë kanë kritere tejet të pabarazueshme për ngritje në detyrë në bazë të hulumtimeve dhe botimeve shkencore. Pasi që Strategjia e fundit për hulumtime ka skaduar më 2016, Kosova nuk ka zhvilluar synime të reja strategjike për të mbështetur zhvillimin e aktiviteteve të hulumtimit. Nuk ka pasur progres në integrimin në Zonën Evropiane të Hulumtimeve. Kosova duhet të dorëzojë statistika të besueshme për të monitoruar progresin në këtë fushë.

Tek programet kornizë, Kosova merr pjesë në programin e hulumtimit dhe inovacionit të Horizontit 2020 të BE-së (H2020) si palë e tretë. Deri më tani ka marrë pjesë në 11 projekte të Horizontit 2020 (10 më 2017 dhe 1 më 2018). Niveli i pjesëmarrjes në Horizont 2020 mbetet nën potencialin e Kosovës. Kosova tashmë ka marrë disa veprime fillestare për të përmirësuar performancën e saj në Horizont 2020 veçanërisht përmes lidhjes më të mirë të hulumtuesve, përmirësimit të rrjetet Pikës Kombëtare të Kontaktit, shkëmbimit të praktikave më të mira dhe mentorimit dhe vende të tjera. Kosova duhet të vazhdojë dhe t'i forcojë më tej këto përpjekje.

Sipas konkluzioneve të Nënkomitetit për Inovacion, Shoqëri Informativ, Politika sociale dhe Punësim 2021 për shkencën dhe inovacionin, Kosova duhet të: sigurojë të dhëna statistikore mbi shpenzimet për kërkime dhe inovacion në sasi ose si përqindje e BPV dhe për performancën lidhur me Prioritetet Evropiane të Zonës së Kërkimit (deri në tetor 2019), të përgatitet për pjesëmarrje në ushtrimin e tabelave të rezultateve (*scoreboard exercise*) evropiane të inovacionit, të angazhohet aktivisht në zhvillimin e një Strategjie të Specializimit të Mençur. Gjithashtu të vazhdohet me miratimin e akteve ligjore lidhur me Kërkimin dhe Inovacionin. Të perfundohet hartëzimi i infrastruktures së kërkimit dhe zhvillimit.

Gjendja aktuale

Korniza legjislative

Shkenca dhe hulumtimet në Kosovë rregullohen me Ligjin nr. 04/L-135 për Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore. Ky ligj ka përfshirë praktikën e mira evropiane të cilat e përkrahin hulumtimin shkencor me fokus në zhvillimin ekonomik dhe social. Gjithashtu, ligji posedon dispozita që rregullojnë lidhjen e hulumtimit shkencor me ekonominë dhe industrinë. Si strukturë përgjegjëse për administrimin e prioriteteve kombëtare të kërkimit është Këshilli Kombëtar i Shkencës, ndërsa Departamenti për arsim të lartë, Shkencë dhe Teknologji në MASHTI është institucioni kryesor për politike bërje në fushën e shkencës dhe hulumtimeve.

Ligji për Inovacion Shkencor, Transfer të Dijës dhe Teknologjisë është miratuar në nëntor 2018 në Kuvend. Në vitin 2019 është miratuar UA. si dhe rregullorja e për skemën voucher.

Kosova merr pjesë në Pogromin kornizë të BE për Kërkim dhe Inovacion *Horizon 2020* si vend partner ndërkombëtar i bashkëpunimit. Suksesi i aplikimit në të është 18, 6%, me 11 projekte të financuara. Për të funksionalizuar pikën kombëtare të kontaktit, MASHTI ka miratuar Rregulloren për funksionimin dhe funksionalizimin e pikave kontaktuese kombëtare të Kosovës për *Horizon 2020*. Janë ndërmarrë masa për të promovuar programin përmes ofrimit të trajnimeve për komunitetin shkencor dhe më gjerë për shkrim të projekt-propozimeve, përmes trajnimit të pikave kombëtare të kontaktit, mbështetjes për pjesëmarrje të PKK në sesionet qendrore tematike në vendet evropiane në kuadër të programit rrjetëzimit të tyre. Gjatë vitit 2018 Kosova ka avancuar statusin (vend fqinj i bashkëpunimit) e saj në Asociacionin COST. Janë ndërmarrë masat për promovimin e programit. Aktiviteti qendror për promovim të programit është realizuar në Prishtinë, në bashkëpunim me Asociacionin COST. Deri më tani 13 hulumtues nga Kosova janë pjesë e aksioneve të COST (krahasuar me vitin 2018 ku ishte vetëm një hulumtues).

Objektivat prioritarë afatmesme:

- Hartimi dhe miratimi i Ligjit për Financimin të Veprimtarisë Kërkimore Shkencore;
- Hartimi i legjislacionit sekondar bazuar në Ligjin për Inovacion Shkencor Transfer të Dijes dhe Teknologjisë nga i cili dalin gjithsej 5 akte nënligjore;
- Përmirësimi i kornizës së politikave dhe asaj strategjike dhe ngritja e kapaciteteve për hulumtim dhe inovacion, duke siguruar përfaqësimin e barabartë gjinor dhe reflektimin e aspekteve gjinore;
- Mbështetur në politikat e BE-se për zgjerim, synohet që Kosova të ketë status të avancuar në programin pasues të *Horizon 2020*, që është emëruar *Horizon EU* dhe që do të fillojë zbatimin më 2021-2022.

Për më shumë sa i përket prioritetëve të inovacionit, ju lutem t'i referoheni edhe kapitullit 20.

3.26. Kapitulli 26 i *acquis*-së: Arsimit dhe kultura

Fushat e arsimit dhe trajnimit, rinisë, sportit dhe kulturës janë kryesisht kompetencë e Shteteve Anëtare. Traktati mbi Funksionimin e BE-së (TFBE) parashikon që Bashkimi të inkurajojë bashkëpunimin ndërmjet Shteteve Anëtare dhe mbështetjen duke plotësuar veprimet e tyre, duke respektuar plotësisht përgjegjësinë e tyre për përmbajtjen e mësimin, organizimin e sistemeve të arsimit dhe trajnimit profesional, dhe diversitetin kulturor kombëtar dhe rajonal.

Acquis për arsim dhe kulturë përbëhet kryesisht nga një kornizë bashkëpunimi, duke përdorur programe dhe metodën e hapur të koordinimit (MHK) për të lëvizur drejt konvergencës së politikave kombëtare dhe arritjen e objektivave të përbashkëta. Në fushën e arsimit, trajnimit dhe të rinjve, Shtetet Anëtare duhet të kenë kornizën ligjore, administrative dhe financiare, si dhe kapacitetet e nevojshme zbatuese në vend për të siguruar menaxhim të shëndoshë, përfshirë menaxhimin financiar, të programeve të decentralizuara të BE-së. *Acquis* përmban gjithashtu një Direktivën për edukimin e fëmijëve të punëtorëve emigrantë dhe vendimeve të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë për rastet që lidhen me mos-diskriminimin ndërmjet shtetasve të një shteti anëtar të BE-së dhe një shtetasi tjetër të BE-së.

Objektivat e sistemeve të arsimit dhe trajnimit miratuar më 2001, si dhe procesi i Kopenhagës për trajnim profesional dhe të procesit të Bolonjës për arsimin e lartë, japin udhëzime për përmirësimin e cilësisë së sistemeve të arsimit dhe trajnimit. Programi i punës "Edukimi dhe Trajnimi 2010" dhe korniza strategjike "Edukimi dhe Trajnimi 2020" i integrojnë të gjitha veprimet në nivel Evropian, dhe kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së sistemeve të arsimit dhe trajnimit. Objektivat e përbashkëta për politikat rinore të BE-së janë përcaktuar në Strategjinë e BE-së Rinisë (2010-2018) e cila bazohet në një metodë të hapur të koordinimit. Në fushën e sportit, Komunikata e Komisionit e vitit 2011 "Zhvillimi i dimensionit evropian në sport" propozon veprime konkrete për të mbështetur dhe të koordinuar masat e politikave, me qëllim të miratimit të mundshëm të Planit shumëvjeçar të Punës së BE-së për sportin nga Këshilli.

Sa i përket politikës kulturore, Shtetet Anëtare duhet të mbështesin parimet e parashikuara në nenin 167 të TFEU dhe në veçanti, të sigurohen që angazhimet e tyre ndërkombëtare lejojnë zhvillimin dhe zbatimin e

politikave dhe instrumenteve që synojnë ruajtjen dhe promovimin e diversitetit kulturor. Në përputhje me këto parime, Konventa UNESCO-s për Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Larmisë së Shprehjeve Kulturore është një element kryesor i *acquis* në fushën e kulturës. Komunikimi Komisioni në Agjendën Evropiane për kulturë në një botë të globalizuar prezantuar një dialog të strukturuar me sektorin e kulturës dhe një metode të hapur të koordinimit, në mënyrë që të zbatohen tri grupe të përbashkëta të objektivave: diversitetit kulturor dhe dialogut ndërkulturor; kultura si një katalizator për kreativitet; dhe kultura si një komponentë kyçe në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Kërkesat e MSA-së

Sa i përket MSA-së neni 107 kërkon bashkëpunimin në mes të palëve me synim të ngritjes së nivelit të arsimit në përgjithësi, arsimit profesional, trajnimit si dhe zhvillimit të politikave për punën e të rinjve në Kosovë me qëllim të zhvillimit të shkathtësive, punësimit, gjithëpërfshirjes sociale dhe zhvillimit ekonomik në Kosovë. Një nga prioritetet për sistemin e arsimit të lartë duhet të jetë arritja e standardeve adekuate të cilësisë së institucioneve dhe programeve në përputhje me objektivat e procesit të Bolonjës dhe Deklaratën e saj. Palët duhet të bashkëpunojnë me qëllim të sigurimit që qasja në të gjitha nivelet e arsimit dhe trajnimit në Kosovë është bëhet pa diskriminim mbi bazën e gjinisë, prejardhjes racore apo etnike, fesë ose besimit, paaftësisë, moshës ose orientimit seksual. Gjithashtu nevojat e nxënësve me aftësi të kufizuara në Kosovë duhet të adresohen.

Neni 108 i MSA-së kërkon bashkëpunimin ndërmjet palëve me synim promovimin e bashkëpunimit kulturor për të rritur kapaciteteve të operatorëve dhe ngritjen e mirëkuptimit ndërmjet individëve dhe minoriteteve. Ky bashkëpunim duhet të mbështesë diversitetin kulturor në vend në bazë të parimeve të Konventës së UNESCO-s për mbrojtjen dhe promovimin e diversitetit të shprehjeve kulturore.

Kërkesat nga mekanizmat e tjerë të aderimit në BE

Sipas *Raportit të KE-së për Kosovën – 2020*, Kosova është në fazë të hershme të përgatitjes në fushën e arsimit dhe kulturës. Nuk ka pasur progres vitin e kaluar dhe cilësia e arsimit mbetet të përmirësohet dukshëm. Pasi që rekomandimet e raportit paraprak nuk janë adresuar, në veçanti duhet që: të miratohet ligji i ri i arsimit të lartë, me qëllim të zbatimit të një reforme të bazuar në standardet më të mira, përfshirë sigurimin e autonomisë dhe operimit të pavarur të institucioneve të arsimit të lartë dhe mekanizmave të sigurimit të cilësisë; të rriten përpjekjet për reformë në arsimin para-universitar (përfshirë programet e arsimit dhe aftësimin profesional), me fokus në mësimin e bazuar në kompetenca; të përmirësohet qasja në arsim cilësor për regjistrimin në parashkollor dhe grupet e marginalizuara.

Sipas konkluzioneve të Nënkomitetit për Inovacion, Shoqëri Informative, Politika sociale dhe Punësim 2021, Kosova duhet të përmirësojë kualitetin dhe mbulueshmërinë e trajnimeve online si dhe të vazhdohet me mësimin dhe trajnimet online për mësuesit. Sistemi për menagjimin e informative në Arsim të vazhdojë të zhvillohet me tutje në mënyrë që të plotësojë nevojat egzistuese dhe të në të ardhmen. Të publikohen të dhënat në fushën e edukimit dhe rinisë të cilat duhet të jenë të matshme dhe që mund të gjurmohen me lehtë. Komisioni rekomandoi që të njoftohet OECD për vendimin final lidhur me pjesëmarrjen e Kosovës në PISA 2022. Lidhur me Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë 2017-2021 të vazhdohet implementimi dhe në të njëjtën kohë të fillohet me përgaditjen e Strategjisë së re. Sa i përket legjislacionit primar të fillohet me draftimin dhe miratimin e ligjeve për: Ligjin për Fëmijerinë e Hershme, Ligjin për Tekset Shkollore, Ligjin për Arsimin e Lartë, si dhe Ligjin për Agjensinë e Akreditimit. Kosova do të shtojë përpjekjet për të rritur shkallën e regjistrimit të fëmijës së hershme për fëmijët 0-5 vjeç. Përmirësimi i cilësisë së arsimit në të gjitha nivelet duke aplikuar sistematikisht mekanizmat ekzistues të sigurimit të cilësisë, siç janë koordinatoret e cilësisë, inspektimet shkollore në arsimin bazë dhe të sigurohet monitorim me i rrepte i kushteve të Agjensisë së Kosovës për Akreditim të programeve të arsimit të lartë. Në kuadër të kësaj të vazhdohet me rritjen e regjistrimit të nxënësve me nevoja të veçanta. Të mbështeten institucionet e arsimit të lartë.

Në fushën e trashëgimisë kulturore, kërkohet që të hartohet ligji për trashëgiminë kulturore, të zbatohet vendimi i Gjykatës Kushtetuese për rastin e kontestit pronësor në Deçan, të rritet vetëdijesimi dhe ndarja e informatave për programin “Evropa kreative”, të vazhdohet me funksionimin e Këshillit Zbatues

Monitorues, dhe performancë në ndëshkimin në rastet e dëmtimit ose ndërtimeve ilegale në objektet e mbrojtura të trashëgimisë.

Gjendja aktuale

Korniza legjislative:

Arsimi

- Ligjin nr. 03/L-060 për kualifikime kombëtare dhe kornizën kombëtare për kualifikime.

Arsimi dhe aftësimi profesional

- Ligji nr. 04/L-138 për arsim dhe aftësim profesional;
- Ligji nr. 04/L-143 për arsimin dhe aftësimin për të rritur;
- Ligji nr. 03/L-060 për kualifikimet kombëtare.

Arsimi parashkollor

- Ligji nr. 02/L-52 për edukimin parashkollor;
- Ligji nr. 04/L-032 për arsimin para-universitar;
- Ligji nr. 06/L-046 për inspektoratin e arsimit në Republikën e Kosovës.

Braktisja shkollës

- UA nr. 08.2018 për themelimin dhe fuqizimin e ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mos-regjistrimit të nxënësve në arsimin parauniversitar.

Kultura

- Ligji nr. 02/L-57 për Institucionet e Kulturës;
- Ligji nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta;
- Ligji nr. 203/24 për Sport;
- Ligji nr. 04/L-056 për Ansamblin e Këngëve dhe Valleve Shota;
- Ligji nr. 04/L-59 për Filarmoninë, Operën dhe Baletin;
- Ligji nr. 2004/22 për Kinematografinë;
- Ligji nr. 02/L-88 Për Trashëgiminë Kulturore;
- Ligji nr. 04/L-106 për Teatrot.

Korniza institucionale dhe ajo e politikave

Pas vendimit të Rrjetit Evropian të Agjencive të Sigurimit të Cilësisë për Arsim të Lartë (ENQA) për ndryshimin e statusit të AKA-së në anëtar "nën rishikim", AKA i është nënshtruar procesit të rivlerësimit. Ekipi i ekspertëve nga ENQA arriti në përfundim se niveli i përgjithshëm i plotësimit të standardeve dhe udhëzuesve Evropian (ESG) nuk është i mjaftueshëm për përtëritjen e anëtarësimit të AKA-së në ENQA. Me këtë rast bordi i ENQA-s njofton se AKA ka të drejtë riaplikimi dy vite pas marrjes së këtij vendimi. Gjatë këtyre dy viteve, AKA do t'i nënshtrohet edhe një vlerësimi nga ekspertët e ENQA-s i cili ka për qëllim të ndihmojë dhe këshillojë AKA-në para aplikimit formal për rivlerësim.

Kosova, si rezultat i një marrëveshjeje midis Komisionit Evropian dhe MASHTI-it, merr pjesë në programin e BE-së për arsim Tempus që nga viti 2003. Programi Tempus, ka kontribuar në vazhdimësi drejtpërdrejtë në zhvillimin e kurrikulave, bashkëpunimin me shoqërinë, menaxhimin e universitetit, trajnimin e mësimitdhënësve si dhe projektet për sigurimin e cilësisë, të cilat mbulojnë pothuaj tërë sektorin e arsimit të lartë në Kosovë. Pasardhës i Tempusit tashmë është programi Erasmus+ i cili zbaton projektet përmes Zyrës Erasmus+ për Kosovën. Kjo zyrë është e përqendruar në fushën e arsimit të lartë dhe kontribuon në ngritjen e vetëdijes, dukshmërisë, përshtatshmërisë, qëndrueshmërisë, qasjes efektive në dimension ndërkombëtar të Programit Erasmus+. Institucionet e arsimit të lartë në Kosovë kanë rritur interesimin në pjesëmarrje në skemat në kuadër të programit ERASMUS + duke i rritur kapacitetet e tyre absorbuese. Lidhur me HORIZON 2020 tani që do të quhet Horizon Europe, MASHTI në mënyrë që t'u mundësojë IAL-ve mundësinë për të aplikuar në skemat Horizon Europe, ka filluar procedurën për avancimin e statusit tonë në këtë program si një vend i lidhur. Ky avancim do të mundësojë pjesëmarrjen në disa skema që nuk mund të aplikojmë më parë, ndërkohë ky proces është në fazën e negociatave që do të jenë pjesë e përfundimit të marrëveshjes. MASHTI do të ketë implikime buxhetore për pjesëmarrjet në shumën prej 1 milionë gjithë Trupat Këshillëdhënës (Bordet industriale) në Universitetet Publike i kanë hartuar dhe i

kanë nënshkruar rregulloret e punës për funksionimin e tyre. Universiteti i Prishtinës, në 10 njësi akademike, Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj ka themeluar 1 Trup Këshillëdhënës. Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani" ka themeluar 2 Trupa Këshillëdhënës. Universiteti "Haxhi Zeka" ka themeluar 3 trupa këshillëdhënës. Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini" është në fazën e hartimit të rregullores për trupat këshillëdhënës, ndërsa Universiteti i Gjilanit, e ka miratuar rregulloren.

Dokumenti bazë strategjik i cili përcakton objektivat zhvillimore në sistemin e Arsimit në Republikën e Kosovës është Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021, i miratuar nga Qeveria e Kosovës. Ky është një dokument strategjik gjithëpërfshirës, i cili përfshinë të gjitha nivelet e arsimit në Kosovë, duke filluar nga niveli para-fillor deri të niveli universitar. Dokumente tjera strategjike në funksion të zhvillimit të arsimit janë: Strategjia e Komunikimit; Strategjia Kundër Braktisjes së Shkollimit; Strategjia për Shkollat Promovuese të Shëndetit 2009-2018, Strategjia për Integrimin e Komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian 2017-2017 dhe Strategjia për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar 2007-2017.

Në kuadër të arsimit profesional ekzistojnë shkollat profesionale si dhe janë ngritur 4 qendra të Kompetencës. Sistemi i paraparë me legjislacionin në fuqi për Arsim dhe Aftësim Profesional është 3+1+1 bazuar edhe në kërkesat e tregut të punës. Ka përfunduar profilizimi i profileve ekzistuese të arsimit aftësimi profesional në bazë të fushave sektoriale bazuar në ISCED.

Sa i përket arsimit para universitar, zbatimi i Kurrikulës është duke u bërë në shkollat e Kosovës aty ku programet e reja mësimore/lëndore janë në zbatim për klasën përgatitore si dhe për klasat 1, 2, 3, 6, 7, 8, 10, 11, 12. Për vitin e ri shkollor 2020/2021 pritet të jenë të gatshme edhe programet mësimore/lëndore për klasat 4, 9, ndërsa në vitin 2021 me klasën e 5-të përfundon finalizimi dhe zbatimi i kurrikulës dhe programeve të reja mësimore.

Për të avancuar *menaxhimin e cilësisë në arsimin parauniversitar*, MASHTI ka vënë theksin tek udhëzimet e ngritjes së cilësisë së brendshme, zbatimin e mekanizmave për vlerësim të cilësisë së jashtme dhe ngritjen e kapaciteteve të Inspektoratit të Arsimit, gjithashtu ky inspektorat është anëtarësuar në SICI (*Standing International Conference of Inspectorates*).

Në prill 2017 është miratuar UA 4/2017 për vlerësimin e performancës së institucioneve arsimore të arsimit parauniversitar, Udhëzuesi për Vlerësimin e brendshëm të performancës së shkollës dhe Udhëzuesi për Vlerësimin e jashtëm të performancës së shkollës, të cilët kanë hyrë në zbatim në shkollat që janë duke zbatuar kornizën e kurrikulës së re. Pas miratimit të Ligjit 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës (gusht 2018), në tetor 2018 është miratuar UA 14/2018 për vlerësimin e performancës së mësimdhënësve. Bazuar në Ligjin 06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës, MASHTI është duke përgatitur UA për vlerësimin e performancës së drejtorit dhe zëvendësdrejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar. Pas miratimit të këtij akti nënligjor, Inspektorati i Arsimit do të fillojë me vlerësim të performancës së drejtorëve e zëvendësdrejtorëve.

Pra, për periudhën kohore 2021-2025, prioritet i Inspektoratit të Arsimit është sigurimi i cilësisë në arsimin parauniversitar nëpërmes inspektimeve të cilat kanë të bëjnë kryesisht me vlerësimin e performancës së mësimdhënësve, drejtorëve e zëvendësdrejtorëve, si dhe të institucioneve arsimore të arsimit parauniversitar. Ngritja e cilësisë në arsimin parauniversitar lidhet ngushtësisht me ngritjen e kapaciteteve të Inspektoratit të Arsimit.

Është hartuar dhe aprovuar programi për ndërtimin e kapaciteteve të ekipeve komunale të vlerësimit "si të përdoren instrumentet për vlerësimin pedagogjik të fëmijëve me nevoja të veçanta". Brenda këtij programi, njëqind e tetëdhjetë (180) anëtarë të ekipeve komunale të vlerësimit janë trajnuar në një trajnim tre-ditor, dhe paketa e dokumenteve për ekipet komunale të vlerësimit është hartuar për të dokumentuar procesin e vlerësimit të fëmijëve me nevoja të veçanta. Pakoja e hartuar përmban 12 dokumente të cilat ofrohen në mënyrë elektronike. Këto aktivitete mbështeten nga projekti i Këshillit të Evropës - "Ndërtimi i Kapaciteteve për Arsimin Përfshirës PCRFSHIR."

Në aspektin e fuqizimit të mekanizmave të jashtëm për matje të cilësisë, Kosova ka marr pjesë në Testin Ndërkombëtar PISA, dhe MASHTI ka organizuar Testin e Arritshmërisë për nxënësit e klasës së nëntë dhe

Testin e Maturës Shtetërore. MASHTI i ka dhënë gjithashtu prioritet zhvillimin profesional të mësimit dhe për modernizimin trajnimit të mësuesve në përputhje me kornizën e re kurikulare të Kosovës. Përveç raportit ndërkombëtar për provën PISA, është hartuar edhe raporti kombëtar që synon të identifikojë mundësitë për përmirësim sa i përket performancës së nxënësve në kuadër të testit PISA.

Sa i përket trashëgimisë kulturore, korniza institucionale përbëhet nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit si institucioni kryesor legjislativ për këtë fushë, Ministria e Ekonomisë si institucion zbatues dhe monitorues sa i përket planeve hapësinore të ndërtimit, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal si institucion monitorues i punës së komunave dhe institucionet e tjera ligj-zbatuese.

Mbështetja e donatorëve

Projektet për sektorin e arsimit:

- Në kuadër të IPA 2016, KE mbështet ngritjen e kapaciteteve për zhvillimin profesional të mësimit dhe për modernizimin trajnimit të mësimit dhe për nivelin parafillor dhe fillor në 10 komuna të Kosovës, në gjithsej 50 shkolla. Projekti pritet të përfundojë në vitin 2022;
- *Mbështetja e përmirësimit të infrastrukturës së arsimit* është një komponent tjetër në kuadër të IPA 2016. Ky aktivitet përfshin analizat e vlerësimit për subvencionimin e ndërtimit të infrastrukturës së arsimit parafillor dhe infrastrukturën publike komunale që kontribuon në zhvillimin e arsimit. Janë caktuar të gjitha lokacionet për ndërtimin e çerdheve të parapara me fondet e IPA 2016.
- IPA 2017 *Arsimi, punësimi dhe politikat sociale* (4.5 milionë total, kontributi i BE 3, 8 milionë), me qëllim kryesor përmirësimi i punësueshmërisë përmes arsimit dhe kualifikimit profesional të cilësisë që do të çonte në rritjen e pjesëmarrjes në tregun e punës sidomos të (të rinjve dhe grave).
- Në kuadër të IPA 2018, arsimit do të mbështetet nga BE me shumë prej 13 milionë euro. Në kuadër të kësaj asistence do të synohet që të arrihet rritja e qasjes në arsimin parafillor, fillor dhe të mesëm nxënësve që i përkasin grupeve të pafavorizuara. Forcimi i kapaciteteve për menaxhim të përgjithshëm dhe efektiv duke siguruar cilësi në mësimit dhe nivelin qendror dhe komunal.
- Projekti QAIN (Cilësia, llogaridhënia, integriteti dhe transparenca në arsimin e lartë) synon ofrimin e mbështetjes për zhvillim dhe zbatimin e rregulloreve, procedurave dhe praktikave më të mira për rritje të cilësisë në arsimin e lartë. Zhvillimin e dy skemave për promovimin e mësimit dhe mbështetur në punë hulumtuese;
- Projekti ALLED II – Përshtatja e edukimit me nevojat e tregut të punës do të fokusohet në forcimin e cilësisë dhe relevancës së programeve të arsimit dhe trajnimit për tregun e punës dhe do të mbështesë përshtatjen e kuadrit ligjor dhe mekanizmave si parakusht për rritjen e punësueshmërisë. Projekti ka filluar zbatimin më 2018 dhe pritet të përfundojë më 2021. Kostoja totale e projektit do të jetë 4,500,000 euro;
- Mbështetje për sektorin e arsimit parashikohet të vazhdohet edhe me IPA III. Në kuadër të IPA 2022 planifikohet vazhdimi i mbështetjes për përfshirjen e komunitetit RAE në arsim.

Objektivat prioritarë afatmesme:

- Harmonizimi i arsimit dhe aftësisë profesionale me kërkesat e tregut të punës përfshirë edhe zbatimin e kornizës së re kurikulare;
- Menaxhim efektiv i sistemit të arsimit në të gjitha nivelet;
- Arsim i lartë me cilësi dhe integritet, në harmoni me standardet ndërkombëtare.

Ngritja institucionale:

- Forcimi i kapaciteteve të Inspektoratit të arsimit, në përputhje me legjislacionin Evropian dhe standardet ndërkombëtare;
- Zhvillimi profesional i mësimit dhe për nivelin parafillor dhe fillor;
- Rritja e kapaciteteve të përfshirjes në arsimin para fillor.

3.27. Kapitulli 27 i acquis-së: Mjedis

Ky kapitull mbulon politikat mjedisore të BE-së të cilat kanë për qëllim të promovojnë zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm. Ato janë të bazuara në

veprimin preventiv sipas parimit 'ndotësi paguan', për të luftuar dëmin mjedisor në burim, ndarjen e përgjegjësisë dhe integrimin e mbrojtjes së mjedisit në politikat e tjera të BE-së. Acquis përfshin mbi 200 akte ligjore që mbulojnë legjislacionin horizontal dhe sekondar. Pajtueshmëria me acquis kërkon investime të konsiderueshme. Për aplikimin dhe zbatimin e acquis është e domosdoshme një administratë e fortë dhe e pajisur mirë - në nivel kombëtar dhe lokal.

Kërkesat e MSA-së

MSA, në nenet 115, 116 dhe 117 përcakton bashkëpunimin e Republikës së Kosovës me BE-në në fushën e Mjedisit, Ndryshimeve Klimatike dhe Mbrojtjes Civile. Neni 115 parasheh parandalimin e degradimit të mëtejshëm mjedisor dhe fillimin e përmirësimit të gjendjes mjedisore me qëllim të zhvillimit të qëndrueshëm në Kosovë. Ai gjithashtu parasheh dhe fuqizimin e strukturave dhe procedurave administrative të Kosovës, dhe përafrimin gradual të legjislacionit të Kosovës me acquis të BE-së dhe të përshtatur me acquis të Euratom. Neni 116 mbi ndryshimet klimatike, fokusohet në zhvillimin e politikave për ndryshime klimatike, përkatësisht për zbutje (zvogëlim të emetimeve të gazrave serrë) dhe përshtatje ndaj tyre (ndryshimeve klimatike), marrë parasysh politikat e tjera përkatëse, përfshirë sektorët si energjia, transporti, industria, bujqësia, shëndetësia, arsimiti, etj. Aty gjithashtu kërkohet përafrimi gradual të legjislacionit të Kosovës me acquis të BE-së mbi ndryshimet klimatike, në veçanti për monitorimin, raportimin dhe verifikimin efektiv të rezultateve, për emetimet e gazrave serrë, si dhe përfshirjen e Kosovës në mekanizmat ndërkombëtar. Neni 117, mbi mbrojtjen civile, parasheh përmirësimin dhe parandalimin, përgatitjen dhe reagimin ndaj katastrofave natyrore dhe atyre të shkaktuara nga faktori njeri. Ai gjithashtu kërkon ngritjen e kapaciteteve të mbrojtjes civile dhe përafrimin gradual të legjislacionit me acquis të BE-së në fushën e menaxhimit të katastrofave.

Kërkesat nga mekanizmat e tjerë të aderimit në BE

Raporti i KE-së për Kosovën – 2020, vlerëson se Kosova është në një fazë të hershme të përgatitjes në fushën e mjedisit dhe ndryshimeve klimatike. Është arritur progres i kufizuar. Ka përmirësime në raportimin mjedisor dhe monitorimin e cilësisë së ajrit. Nevojitet vullnet më i fortë politik për të adresuar degradimin e mjedisit dhe sfidat e ndryshimeve klimatike. Kosova inkurajohet të rritë në mënyrë të konsiderueshme ambiciet drejt një tranzicioni të gjelbër.

Ndërsa nga kërkesat e dala nga takimi i Nënkomitetit *INFRA 2020 dhe 2021*, për fushën e Mjedisit, në sektorin e Ajrit, Komuna e Prishtinës duhet të miratojë një plan të cilësisë së ajrit për Prishtinën, të identifikohen burimet e ndotjes së ajrit dhe të fillohet me zbatimin efektiv të masave të reduktimit.

Në sektorin e mbeturinave, operatori i magazinimit të mbetjeve të rrezikshme duhet të jetë funksional, përfshirë financimin, personelin, hapësirat dhe përgatitjen e planit të menaxhimit të mbeturinave, dhe duhet që të rishikohet strategjia kombëtare e mbeturinave dhe plani i veprimit për mbeturinat e ngurta. Po ashtu të vendoset për lokacioni për deponinë e re të Prishtinës.

Në sektorin e ujërave duhet që të vazhdohet me progresin në zbatimin e Direktivës së Ujërave Nëntokësore për "Drinin e Bardhë, të identifikohen dhe monitorohen zonat e tjera të rrezikut lidhur me ujërat nëntokësore dhe ujërat sipërfaqësore. Të fillohet me përgatitjen e planeve të menaxhimit të pellgut lumor për trupat e mbetura ujorë (Ibri, Morava e Binçës dhe Lepenci).

Tek Natyra, duhet që të finalizojnë hartimin e planeve rregulluese të hollësishme për Parkun Kombëtar "Sharri dhe për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna". Në sektorin e Pylltarisë, duhet të raportohet mbi përpjekjet për luftimin e prerjeve ilegale të drurëve, si dhe të miratohet ligji për pyjet duke transpozuar rregulloren për Lëndët Drusore 995/2010.

Tek Mbrojtja Civile, duhet të participohet më aktivisht në aktivitetet nën Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të Bashkimit Evropian, si trajnime, shkëmbim ekspertësh, projekte parandalimi dhe gatishmërie, etj. Sa i përket Ndotjes Industriale, duhet që urgjentisht të miratohet UA për kufizimet e emetimeve të ndotësve.

Tek fusha e Ndryshimeve Klimatike, duhet që të përmirësohet bashkëpunimi ndërinstitucional për të siguruar integrimin e ndryshimeve klimatike në sektorë të tjerë, veçanërisht në energji dhe transport, dhe

për ta forcuar rolin e Këshillit Kombëtar për Ndryshimet Klimatike. Në këtë kontekst, duhet të përgatitet një Plan i integruar Kombëtar të Klimës dhe Energjisë, si dhe të përgatitet një strategji afatgjate të dekarbonizimit.

Gjendja aktuale

Korniza legjislative, e politikave dhe ajo institucionale

Korniza legjislative në këtë fushë përbëhet nga këto akte kryesore normative:

- Ligji për vlerësim të ndikimit në mjedis (VNM);
- Ligji për vlerësimin strategjik mjedisor (VSM);
- Ligji për mbrojtjen e mjedisit.

Këto akte normative kanë transpozuar tërësisht këto akte të acquis-së:

- Direktivën nr. 2001/42/KE për Vlerësimin Strategjik Mjedisor;
- Direktivën nr. 85/337/KEE për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis;
- Direktivën nr. 2003/35/KE mbi Pjesëmarrjen e Publikut.

Direktiva mbi Themelimin e Infrastrukturës për Informim Hapësinor (INSPIRE Direktiva nr. 2007/2/KE) është duke u transpozuar në projektligjin për krijimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit hapësinor në Kosovë, i cili përcakton rregullat e përgjithshme për krijimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit hapësinor në Kosovë, për jetësim të politikave mjedisore dhe aktiviteteve të cilat mund të kenë ndikim në mjedis.

Autoriteti përgjegjës për zbatimin e legjislacionit horizontal mjedisor është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, përkatësisht Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ujërave/Divizioni për Mbrojtjen nga Ndotja Industriale.

Cilësia e ajrit

Korniza legjislative në këtë fushë përbëhet nga Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja, i cili ka transpozuar këto akte të acquis-së:

- Direktivën Kornizë nr. 2008/50/KE e cilësisë së Ajrit;
- Direktivën nr. 2004/70/KE për arsenin, kadmiumin, merkurin, nikelin dhe hidrokarburet aromatike policiklike në ajrin mjedisor;
- Direktivën nr. 70/220/KEE për masat që do të merren kundër ndotjes së ajrit nga emetimet e automjeteve;
- Direktivën nr. 1999/13/KE mbi kufizimin e emetimeve të komponimeve organike të paqëndrueshme për shkak të përdorimit të tretësve organikë në aktivitete të caktuara dhe instalimet;
- Direktivën nr. 2001/81/KE për kufijtë kombëtarë të emisioneve për disa ndotës atmosferik;
- Direktivën nr. 96/61/KE për parandalimin dhe kontrollimin e ndotjes industriale;
- Rregullorja nr. 1005/2009 për materiet të cilat e dëmtojnë shtresën e ozonit;
- Rregullorja nr. 842/2006 të Parlamentit dhe Këshilli Evropian për gazrat serë të fluoruara të caktuara.

Për transpozimin e mëtejshëm të Direktivës Kornizë të cilësisë së ajrit nr. 2008/50/KE, MMPHI është në proces të pregaditjes së projektligjit për mbrojtjen e ajrit nga ndotja. Në anën tjetër, plani i veprimit për cilësinë e ajrit 2018-2020, (i miratuar me 05.06.2018), siguron kornizën me të cilën do të arrihet mbrojtja dhe zvogëlimi i ndotjes së ajrit në vend, në pajtim me standardet e përcaktuara të BE-së dhe parimet e praktikave më të mira.

Gjithashtu, Plani kombëtar për zvogëlimin e emisioneve (PKZE) 2018-2027, (i miratuar me 29.05.2018), siguron kornizën me të cilën do të arrihet zvogëlimi i emetimeve në ajër nga Korporata Energetike e Kosovës (TC Kosova A dhe TC Kosova B), që do të reflektoj zvogëlimin e ndotjes së ajrit në rrethinën e

KEK-ut por edhe në tërë territorin e vendit në pajtim me standardet e përcaktuara të BE-së dhe obligimeve që dalin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë.

Autoriteti kompetent i përcaktuar për cilësinë e ajrit është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, përkatësisht Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ujërave/Divizioni për Mbrojtjen nga Ndotja Industriale; Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit/Instituti Hidrometeorologjik. Institucionet e tjera që ndërlidhen me këtë fushë janë kryesisht: Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal.

Menaxhimi i mbeturinave

Korniza legislative në këtë fushë përbëhet nga Ligji nr. 04/060 për Mbeturinat, i cili ka transpozuar këto akte të acquis-së:

- Direktivën nr. 2008/98/KE e mbeturinave;
- Direktivën nr. 86/278/KEE për lymin e ujërave të ndotura;
- Direktivën nr. 2000/53/KE për Automjetet Mbeturinë (ELV);
- Direktivën nr. 2011/65/KE mbi Kufizimet për Substancat e Rrezikshme;
- Direktivën nr. 2002/95/KE për Mbeturinat nga Pajisjet Elektrike dhe Elektronike (RoHS);
- Direktivën nr. 1999/31/KE për deponi;
- Rregullorja nr. 1013/2006/KE për transit të mbeturinave.
- Për më tepër, pritet të miratohet ligji për mbeturinat në K3 2021. Në anën tjetër, gjate kësaj periudhe është miratuar UA për menaxhimin e mbeturinave që përmbajnë azbest.

Gjatë vitit 2019, në përkrahje të GIZ, është hartuar Strategjia dhe Plani i veprimit për menaxhimin e integruar të mbeturinave 2020-2029, të cilat së fundi u miratuan (qershor 2021) dhe tanimë janë në fuqi. Sipas ligjit për mbeturina, neni 13, autoriteti kompetent i përcaktuar për administrimin e mbeturinave është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) dhe Komunitet e Republikës së Kosovës. Në kuadër të MMPHI-së funksionon Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ujërave, përkatësisht, Divizioni për kimikate dhe mbeturina, si dhe Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit. Institucionet e tjera që përfshihen në forma të ndryshme në sektorin e mbeturinave janë kryesisht: Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZhR), Ministria e Shëndetësisë (MSh), Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal (MAPL). Ndërsa komunitet sipas ligjit për mbeturina janë kompetente për menaxhimin e mbeturinave të ngurta, mbeturinat vëllimore, mbeturinat nga konstruktimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore.

Cilësia e ujërave

Korniza legislative në këtë fushë përbëhet nga ligji për ujërat e Kosovës, i cili ka transpozuar pjesërisht këto akte të acquis-së:

- Direktivën nr. 2000/60/KE kornizë e Ujërave;
- Direktivës nr. 91/271/KEE për trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane;
- Direktivën nr. 98/83/KE për Cilësinë e Ujit për përdorimin për Konsum Njerëzor.

Ligji për ujërat e Kosovës është në proces të plotësim ndryshimit, në anën tjetër, sa i përket zbatimit të Strategjisë shtetërore të ujërave të Kosovës 2017-2036 (e miratuar 30.05.2018), është nxjerrë vendimi me (më 15.10.2019) me të cilin autorizohet Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore si institucion përgjegjës sipas ligjit që në koordinim dhe konsultim me të gjitha palët relevante të hartoj dhe miratoj një plan për zbatimin e strategjisë shtetërore të ujërave të Kosovës. Plani i Veprimit 2020-2022 për zbatimin e strategjisë shtetërore të ujërave në Kosovë 2017-2036.

Autoriteti kompetent i përcaktuar për menaxhimin dhe mbrojtjen e ujërave është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, përkatësisht Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave, Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit, me gjithsej 30 zyrtarë. Institucionet e tjera që kanë të bëjnë me fushën e ujërave janë kryesisht: Ministria e Shëndetësisë (MSh),

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZhR), Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal (MAPL) si dhe Zyra e Rregullatorit për Ujë dhe Kanalizim (ZRRUK).

Mbrojtja e natyrës

Korniza legjislative në këtë fushë përbëhet nga këto akte kryesore normative:

- Ligjit për mbrojtjen e natyrës;
- Ligjit për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna";
- Ligjit për Parkun Kombëtar "Sharri";
- Ligjit për pyjet e Kosovës;
- Ligjit për gjuetinë.

Këto akte normative kanë transpozuar këto akte të acquis-së:

- Direktivën nr. 2009/147/KE për ruajtjen e zogjve të egër;
- Direktivën e Këshillit nr. 92/43/KEE e 21 majit 1992 "Për ruajtjen e vendbanimeve natyrore, florës dhe faunës së egër;
- Direktivën e Këshillit nr. 1999/22/KE lidhur me mbajtjen e kafshëve në kopshtet zoologjike;
- Direktivën nr. 83/129/KEE lidhur me importin në shtetet anëtare të lëkurës së disa llojeve të vegjlish të fokave dhe produkteve që dalin prej tyre;
- Rregulloren nr. 338/97 (KE) për mbrojtjen e llojeve të florës dhe faunës së egër duke rregulluar tregtinë e tyre, me amendamentet;
- Rregulloren nr. 3254/91 (KEE) që ndalon përdorimin e kurtheve në Komunitet dhe futjen në Komunitet të gëzofit dhe prodhimeve të disa llojeve të faunës së egër me origjinë nga vendet që i kapin ato duke përdorur metodat e kurtheve që nuk plotësojnë standardet humane ndërkombëtare të kapjes;
- Rregulloren nr. 995/2010 (BE) e Parlamentit Evropian dhe Këshillit që përcakton obligimet e operatorëve të cilët qesin drurin dhe prodhimet e drurit në treg;
- Rregulloren nr. 2173/2005 (KE) mbi krijimin e një skeme të licencimit FLEGT për importet e lëndës drusore në Komunitetin Evropian;
- Rregulloren nr. 348/81/KEE për rregullat e përbashkëta për importin e balenave dhe produkteve të tjera të cetaceve dhe amendamentet.

Kuadri strategjik për mbrojtjen e natyrës në Republikën e Kosovës përbëhet nga strategjia dhe plani i veprimit për biodiversitetin 2011-2020; Strategjia e pyjeve 2010-2020; Strategjia kombëtare për sektorin e produkteve pyjore jo drunore 2014-2020 dhe Strategjia e mbrojtjes së klimës në sektorin e pylltarisë në Kosovë.

Më tej, plani i veprimit për biodiversitetin 2016-2020 (i miratuar me 30. 05.2018) identifikon aktivitetet specifike, institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse, burimet e financimit të siguruara ose të mundshme dhe kornizën kohore.

Autoriteti kompetent i përcaktuar për mbrojtjen e natyrës është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, përkatësisht Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit, divizioni për mbrojtjen e natyrës, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit. Institucionet e tjera që kanë të bëjnë me fushën e natyrës janë kryesisht: Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal dhe Komunitat.

Kontrrolli i ndotjes industriale

Korniza legjislative në këtë fushë përbëhet nga Ligji nr. 03/L-043 për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes.

Ai ka transpozuar këto akte të acquis-së:

- Direktivën nr. 2012/18/BE SEVESO III për Kontrollin e Rreziqeve të Mëdha të Aksidenteve ku Përfshihen Substancat e Rrezikshme;

- Direktivës nr. 2004/42/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 21 prillit 2004 mbi kufizimin e emetimeve të komponimeve organike të paqëndrueshme për shkak të përdorimit të tretësve organikë në ngjyra të caktuara dhe llaqë dhe produkteve për përfundim të automjeteve.

Për me tepër, ligji për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes është në proces të plotësimit ndryshimit, dhe pritet të miratohet në K3 2021.

UA për pengimin e aksidenteve të mëdha ku përfshihen substancat e rrezikshme, (i miratuar me 06.09.2018), tranzpozoi më tutje Direktivën SEVESO III. Në anën tjetër, me qëllim të zbatimit të legjislacionit të transpozuar të BE-së, në fuqi janë strategjia për mbrojtjen e mjedisit 2013-2022 dhe plani i Kosovës për veprim në mjedis për vitin 2013-2017.

Autoriteti kompetent i përcaktuar për kontrollin e ndotjes industriale është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit (Divizioni për Mbrojtjen nga Ndotja Industriale), me asistencë të Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit, dhe Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal.

Kimikatat

Korniza legjislative në këtë fushë përbëhet nga këto akte kryesore normative:

- Ligji për kimikate;
- Ligji për produkte biocide.

Këto akte normative kanë transpozuar këto akte të acquis-së:

- Direktivën e Këshillit nr. 87/217/KEE e 19 mars 1987 mbi parandalimin dhe reduktimin e ndotjes së mjedisit nga asbesti;
- Rregullorja nr. 528/2012/KE, autorizimet e BE të produkteve biocide;
- Rregullorja nr. 1907/2006/KE REACH;
- Rregullorja nr. 1272/2008/KE (CLP) për klasifikimin, paketimin dhe etiketimin e substancave të rrezikshme;
- Rregullorja (KE) nr. 689/2008 për eksport import të kimikateve, përkatësisht Rregullorja nr. 649/2012/BE për eksport import –PIC procedure;
- Rregullorja nr. 648/2004/KE për detergjentet.

Gjate kësaj periudhe, ka përfunduar drafti i UA për klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e kimikateve të rrezikshme, dhe pritet të miratohet gjate 2021.

Autoriteti kompetent i përcaktuar për kontrollin e ndotjes nga kimikatat është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, përkatësisht Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit, Divizioni për Kimikate dhe Mbeturina, dhe Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit (me gjithsej 4 zyrtarë), dhe Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal.

Mbrojtja nga zhurma

Korniza legjislative në këtë fushë përbëhet nga Ligji për mbrojtjen nga zhurma, i cili ka transpozuar pjesërisht Direktivën nr. 2002/49/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 25 qershor 2002, në lidhje me vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës në mjedis.

Në funksion të përafritimit të mëtejshëm të legjislacionit vendor me acquis të BE-së në fushën e mbrojtjes nga zhurma, Kosova ka marrë vendim për amendamentimin e ligjit për mbrojtjen nga zhurma, pritet të miratohet gjatë 2021. Përmes këtij ligji do të bëhet transpozimi i mëtejshëm i Direktivës nr. 2002/49/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 25 qershor 2002, në lidhje me vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës në mjedis.

Autoriteti kompetent për mbrojtjen nga zhurma në mjedis është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës përkatësisht Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit/ Divizioni për Mbrojtjen nga Ndotja Industriale, dhe Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit/ Instituti Hidrometeorologjik. Institucionet

e tjera që ndërlidhen me këtë fushë janë kryesisht: Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal dhe Komunitet.

Pylltaria

Korniza legislative në këtë fushë përbëhet nga këto akte kryesore normative:

- Ligji për pyjet;
- Ligji për gjuetinë;
- Ligji për mbrojtjen nga zjarri;
- Ligji për tokën bujqësore.

Këto akte normative kanë transpozuar këto akte të *acquis*-së:

- Direktivën e BE-së nr. 92/43/KEE për ruajtjen e mjediseve natyrore dhe florës e faunës së egër;
- Direktivën e BE-së nr. 79/409/KEE për shpezët;
- Rregullorja BE-së nr. 691/2011 për Mjedisin Evropian dhe Llogaritë Ekonomike;
- Rregullorja BE-së nr. 995/2010 e cila përcakton obligimet e operatoreve të cilët plasojnë drurin dhe produktet drunore në treg, gjithashtu e ashtuquajtur "EU TR".

Më tutje, ligji për pyjet e Kosovës është miratuar nga Qeveria e Kosovës më 23.05.2019. Ky projektligj është përcjellë për miratim në Kuvend, por për shkak të shpërbërjes së Kuvendit i njëjti është kthyer për ri procedim për miratim. Pritet të miratohet në K4 2021.

Në anën tjetër, politikat, strategjitë dhe planet e veprimit për zhvillimin e sektorit pyjor në Kosovë të miratuara nga Qeveria e Kosovës janë të përmbledhura në dokumentin "Strategjia për Zhvillimin e Pylltarisë 2010/2020". Ndërsa për këtë vite pritet të miratohet Strategjia për Zhvillimin e Sektorit të Pylltarisë 2021-2030 deri me K4 2021.

Autoriteti kompetent i përcaktuar për pylltarinë është Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, si organi më i lartë i administrimit dhe menaxhimit të pyjeve në Kosovë, përkatësisht Departamenti i Pylltarisë dhe Agjencia Pyjore e Kosovës. Numri i të punësuarve në departament të Pylltarisë është 7 ndërsa, APK si autoritet ekzekutiv ka 140 të punësuar. Institucionet e tjera që kanë të bëjnë me fushën e pylltarisë janë kryesisht: Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal.

Ndryshimet klimatike

Korniza legislative në këtë fushë përbëhet nga këto akte kryesore normative:

- Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja;
- UA për mekanizmin e përcjelljes së emisioneve të gazrave serë;
- UA për përcjelljen e emisioneve të gazrave serë.

Këto akte normative kanë transpozuar këto akte të *acquis*-së:

- Direktivën nr. 2009/30/KE e cilësisë së benzinës dhe karburanteve të naftës;
- Direktivën nr. 2011/83/BE për informim të konsumatorit;
- Rregulloren e BE nr. 525/2013 të parlamentit dhe Këshillit Evropian për mekanizmin për monitorimin dhe raportimin e gazrave serrë;
- Rregulloren nr. 842/2006e F-Gazeve.

Sa i përket kornizës së politikave, në fuqi është strategjia dhe plani i veprimit për ndryshime klimatike 2019-2028/2019-2021 (e miratuar me 19 shkurt 2019). Gjithashtu ne hartim e sipër është koncepti dokumenti për ndryshime klimatike i cili pritet të miratohet gjatw 2021 dhe i cili i paraprinë procesit të hartimit të ligjit për ndryshime klimatike.

Për me tepër, plani kombëtar për energji dhe klime është duke u hartuar nga grupi ndërministrorë i udhëhequr nga MMPHI. Si rezultat janë krijuar 5 nëngrupe tematike si: gazrat serre, BRE, siguria e furnizimit, tregu i brendshëm i energjisë si dhe nëngrupi për inovacion dhe konkurrueshmëri. Ky plan pritet të përfundoj gjatë vitit 2021.

Autoriteti kompetent i përcaktuar për ndryshime klimatike është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) përkatësisht Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit/Divizioni për Mbrojtjen nga Ndotja Industriale, dhe Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit/ Instituti Hidrometeorologjik.

Mbrojtja civile

Korniza legislative në këtë fushë përbëhet nga këto akte kryesore normative:

- Ligji për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera;
- Ligji për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent;
- Ligji për mbrojtje nga zjarri;
- Ligji për zjarrfikje dhe shpëtim.

Këto akte normative kanë transpozuar pjesërisht Direktivën nr. 2012/18/BE- Seveso III.

Deri më tani Kosova ka hartuar planin e reagimit kombëtar, si dhe strategjinë për reduktimin e rrezikut të katastrofave dhe planin e veprimit 2016 - 2020. Ndërsa ne prioritetet afatmesme do të hyn edhe hartimi i Strategjisë së Vlerësimit dhe Rimëkëmbjes së Nevojave të Fatkeqësive i cili pritet të përfundojë në vitin 2022. Ndërsa, në Dhjetor 2020, është miratuar rregullorja (RKS Nr. 28/2020) mbi Metodologjinë e Vlerësimit të Rrezikut nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera. Kjo rregullore integron aspekte të Ligjit për Mbrojtjen e Infrastrukturës Kritike, si dhe akomodon standardet dhe udhëzimet e lëshuara nga programi IPA DRAM.

Autoriteti kompetent i përcaktuar për Mbrojtje Civile është: Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), Agjencia për Menaxhimin e Emergjencës, po ashtu dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), përkatësisht Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit përkatësisht Divizioni për Mbrojtjen nga Ndotja Industriale, AMMK- Instituti Hidrometeorologjik. Institucionet e tjera që kanë të bëjnë me fushën mbrojtjes civile janë kryesisht: Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD), Ministria e Financave Punës dhe Transfereve (MFPT), Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik (IKSHP); njësia e zjarrfikësve të Kosovës, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL).

Mbështetja e donatorëve

Legjislacioni horizontal

Sa i përket përkrahjes së donatorëve, në mbështetje të ME është duke u zhvilluar projekti “Programi Mjedisor i Kosovës 2016-2020” i financuar nga SIDA, me vlerë prej 6, 810, 000 euro, i cili përbëhet nga tetë (8) komponentë që përfshijnë fuqizimin e kapaciteteve institucionale për monitorim, konservimin e biodiversitetit përmes librit të kuq të specieve shtazore në Kosovë; fuqizimin e menaxhimit të parqeve natyrore ndërkufitare; vendosjen e sistemit të monitorimit të ujërave nëntokësore në Kosovë; fuqizimin e kapaciteteve për zbatimin e legjislacionit mjedisor në nivel lokal dhe qendror; studimin për ujërat nëntokësore të pellgut të lumit Drini i Bardhë; mbështetje në hartimin e planit të menaxhimit të pellgut të Drinit të Bardhë dhe mbështetje të Këshillit Ndërmjësor të Ujërave. Gjithashtu, në fushën e ujërave është duke u zhvilluar projekti i përkrahur nga WBIF “ Vlerësimi paraprak i rrezikut nga vërshimet në Pellgun e lumit Drini i Bardhe, Lepenc dhe Sitnica.

Cilësia e ajrit

Me përkrahje nga Zyra e Komisionit Evropian në Prishtinë është bërë instalimi i softuerit për mbledhjen dhe grumbullimin e të dhënave nga stacionet e monitorimit. Përmes këtij softueri është mundur raportimi në kohë reale për monitorimin e cilësisë së ajrit nga 8 stacionet e monitorimit. Investimet në përmirësimin e sistemit për monitorimin e cilësisë së ajrit do të vazhdojnë edhe me mbështetje shtesë nga Qeveria Amerikane përmes Programit të Korporatës së Sfidave të Mijëvjeçarit dhe nga Qeveria Japoneze përmes Agjencisë Ndërkombëtare Japoneze për Zhvillim.

Në kuadër të programit IPA 2018 dhe IPA 2019 do të përkrahët rehabilitimi i Kosovës B me një shumë prej 78 milion euro, 40 në kuadër të IPA 2018 dhe 38 në kuadër të IPA 2019, që do të reduktojë ndotjen e krijuar nga puna e termocentralit.

Në kuadër të programit IPA 2021 parashihet të zhvillohet projekti për dekomisionimin e Kosovës A me një vlerë indikativë prej 50,000,000 euro.

Menaxhimi i mbeturinave

Në kuadër të programit IPA 2018, BE ka ndarë 11 milion euro për fushën e mjedisit. Këto fonde do të shfrytëzohen për të ndihmuar sistemin e menaxhimit të mbeturinave të ngurta në komunat e Kosovës nëpërmjet investimeve në krijimin e deponive të reja, rehabilitimin e atyre ekzistuese dhe duke ndihmuar kapacitetet institucionale të ME-së dhe të komunave. Në kuadër të IPA 2020 gjithashtu parashihet një përkrahje e metutjeshme për fushën e mjedisit në shumën prej 16 milion euro për sistemin e menaxhimit të mbeturinave.

Në kuadër të programit IPA 2021 parashihet të zhvillohet projekti për ndërtimin e deponisë për mbetjet e rrezikshme me një vlerë indikativë prej 12,000,000 euro.

Cilësia e ujërave

Sa i përket mbështetjes së donatoreve në këtë sektor, është duke u zhvilluar projekti "Prishtina III", nga i cili projekt direkt përfiton komuna e Prishtinës, Fushë Kosovës dhe Gracanics, ndërsa indirekt 8 komunat ku operon KUR Prishtina. Vlera e këtij projekti është 35 milionë euro (20 milion euro kredi nga KfW, 5 milion euro me IPA 2010, 5 milion euro nga Qeveria e Kosovës dhe 5 milion euro nga Komuna e Prishtinës).

Projekti "Prishtina II", i cili përfshin rehabilitimin e rrjetave të ujësjellësit në 30% të qytetit të Prishtinës dhe 70% të qytetit të Fushë Kosovës, si dhe rehabilitimin e Fabrikës në Badovc i cili ka një rendësi të veçantë sepse ka qenë një prej fabrikave më të vjetra të ujit, është në zbatim e sipër. Vlera e këtij projekti është 17 milion euro (11 milion euro grant nga WBIF/BE dhe euro 6 milion kredi nga Qeveria Gjermane).

Gjithashtu, në përkrahje të Qeverisë Gjermane janë duke zbatuar dhe përgatitur 6 projekte në ujëra të zeza në gjashtë faza: Faza e parë dhe e dytë ndërtimi i fabrikës për trajtimin e ujërave të zeza në Prizren, me ME. Faza e tretë ndërtimi i fabrikës në Gjakovë në bashkëpunim me Qeverinë Zvicerane. Faza e katërt, ndërtimi i fabrikës në Pejë gjithashtu me Qeverinë Zvicerane. Faza e pestë rehabilitimi i rrjetit në Gjakovë, Pejë dhe Prizren. Faza e gjashtë mbetet për nevojë shtesë të intervenimit.

Mbrojtja e natyrës

Në kuadër të programit IPA 2021 parashihet të zhvillohet projekti për ndërtimin e impiantit për trajtimin e ujërave të ndotura në Kosovën B me një vlerë totale indikative prej 8,000,000 euro.

Kontrolli i ndotjes industriale

Sa i përket përkrahjes nga donatorët në këtë fushë ME përfiton nga projekti nga JICA 2017-2020 me vlerë rreth 4 milionë USD për zhvillimin e kapaciteteve për kontrollin e ndotjes së ajrit.

Objektivat prioritarë afatmesme

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA dhe dokumentet e mekanizmat të tjerë të aderimit në BE në kuadër të fushëveprimit të kapitullit 27, fokusi gjatë periudhës 2021-2025 do të jetë në këto objektiva prioritarë afatmesme:

- Transpozimi i Direktivës nr. 2004/35/KE mbi Përgjegjësitë Mjedisore, Direktivës nr. 2003/04/KE për Qasje në Informacion, Direktivës nr. 66/2010/KE për Eko-etiketë, Rregullores nr. 1221/2009/KE EMAS, si dhe Rregullores nr. 2011/832/BE EMAS Global;
- Hartimi i Strategjisë së Mjedisit 2021-2030;
- Revidimi i Planit Kombëtar për cilësinë e ajrit dhe hartimi i Planit të Veprimit për cilësinë e ajrit 2021-2023;
- Hartimi i Plani Kombëtar për Energji dhe Klime;
- Miratimi i UA për përgjegjësinë e zgjeruar të prodhuesit të mbeturinave bazuar në parimin "ndotësi paguan";
- Vazhdimi i hartimit të planit menaxhues për pellgun lumor Drini i Bardhë;

- Programi i monitorimit të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore;
- Planet e menaxhimit të pellgut të lumit të Ibrit, Moravës së Bincës dhe Lepencit;
- Pregatitja e Hartave për rreziqet nga përmbytjet;
- Rehabilitimi i deponisë sanitare në Pejë, ndërtimi i celulës së re, dhe mbyllja e deponisë ilegale në Istog;
- Strategjia për zhvillimin e Pylltarisë 2021-2030;
- Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin 2021-2030;
- Ngritja e kapaciteteve administrative/humane/profesionale për përcaktimin e vendeve të NATYRA 2000;
- Rritja e numrit të zonave të mbrojtura të natyrës edhe për 40 zona;
- Finalizimi i Planeve Detajuese rregulluese për parqet nacionale 'Sharri' dhe 'Bjeshket e Nemuna';
- Hartimi i 4 Planeve Rregulluese të hollësishme për parqet kombëtare;
- Programi nacional për menaxhimin e faunës së egër dhe gjuetinë;
- Inventarizimi nacional i pyjeve III.

3.28. Kapitulli 28 i acquis-së: Mbrojtja e konsumatorit dhe e shëndetit

Legjislacioni i BE-së në këtë kapitull konsiston në masa rregullatore, rekomandime, koordinim dhe mbështetje për aktivitetet e vendeve anëtare përfshirë mbështetjen financiare. Kapitulli ka të bëjë me interesat e qytetarëve Sa u përket politikave të sigurisë së konsumatorit, interesit ekonomik dhe shëndetit publik.

Acquis në fushën e **mbrojtjes së konsumatorit** përfshin mbrojtjen e konsumatorit, sigurinë e produkteve, shitjen e produkteve konsumuese dhe garancionet e tyre, kushtet e padrejta të kontratës, shitjen në distancë, shitjen derë më derë, marketingun keq informues, praktikatat e padrejta komerciale, kreditë e konsumatorit, dhe bashkëpunimin dhe zbatimin ndër-kufitar. Këtu bën pjesë edhe Sistemi i Alarmimit Rapid të BE-së (RAPEX).

Në fushën e **shëndetit publik**, legjislacioni i BE-së merret me çështjet që lidhen me kontrollin e duhanit, sëmundjeve të transmetueshme, gjakun, indet, qelizat dhe organet, sëmundjet mentale, parandalimin e abuzimit me drogën, dhe diagnostikimet për kancer. Acquis e kësaj fushe gjithashtu rregullon të drejtat e pacientëve në shërbimin shëndetësor ndërkufitar, promovimin e ambientit të shëndetshëm dhe parandalimin e lëndimeve.

Zbatimit i politikave për mbrojtjen e konsumatorit dhe shëndetit publik kërkon kapacitete adekuate administrative dhe infrastrukturë në të gjitha nivelet e organizimit administrativ. Për mbrojtjen e konsumatorit kjo nënkupton mbikëqyrje efektive të tregut dhe mekanizma gjyqësor dhe jo-gjyqësor adekuat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe ankesave. Politikatat e BE gjithashtu synojnë angazhimin e publikut në konsultimet e politikave dhe aktivitetet e vetëdijesimit në mbrojtjen e konsumatorit.

Kërkesat e MSA-së

Sa u përket **mbrojtjes së konsumatorit**, neni 81 i MSA-së obligon Kosovën të krijojë politika për mbrojtjen aktive të konsumatorëve, në përputhje me të drejtën e BE-së, duke përfshirë rritjen e informimit dhe zhvillimit të organizatave të pavarura në Kosovë, harmonizimin e legjislacionit të mbrojtjes së konsumatorit në Kosovë me atë ekzistues në BE, mbrojtjen efikase ligjore për konsumatorët në mënyrë që të përmirësohet cilësia e mallrave të konsumit dhe ruajtja e standardeve të duhura të sigurisë, monitorimi i rregullave nga autoritetet kompetente dhe sigurimi i qasjes së kompensimit përkatës ligjor në rastet e mosmarrëveshjeve si dhe shkëmbimi i informatave mbi produktet e rrezikshme.

Kërkesat nga mekanizmat e tjerë të aderimit në BE

Në fushën e mbrojtjes së konsumatorit, *Raporti i KE-së për Kosovën – 2020* dhe të dalat nga Nënkomiteti për Treg të Brendshëm, Konkurrencë dhe Mbrojtje të Konsumatorit dhe Shëndetit, theksojnë se legjislacioni në

fushën e mbrojtjes së konsumatorit duhet të harmonizohet me legjislacionin e BE-së, si dhe të vazhdohet me rritjen e ndërgjegjësimit për të drejtat e konsumatorëve dhe detyrimet e tregtarëve.

Sipas konkluzioneve të *Nënkomitetit të Tregut të Brendshëm, Konkurrencës, Shëndetit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit* të mbajtur në fillim të vitit 2021, në lidhje me *Mbrojtjen e Konsumatorit*, është rekomanduar nga Komisioni që të punohet në përafrimin e mëtutjeshëm të legjislacionit primar dhe sekondar me atë të BE-së. Sa i përket kornizës së politikave, Programi për Mbrojtje të Konsumatorit 2021-2025 theksohet të miratohet sa më parë. Është rekomanduar të ngritën kapacitetet humane të MINT, e në veçanti të inspektoreve, që të mbrohen më mirë konsumatorët. Dhe në fund, aktivitetet vetëdijësuese në lidhje me të drejtat e konsumatorëve dhe obligimet e tregtarëve është rekomanduar të vazhdojnë, posaçërisht për blerjet online.

Sa i përket shëndetit publik, *Raporti i KE-së për Kosovën – 2020* thekson se duhet të ndahen më shumë burime financiare për shëndetin, të mundësohet zbatimi i reformave të sektorit shëndetësor, duke përfshirë shtrirjen e mëtejshme të sistemit elektronik të informacionit në shëndetin publik, dhe të përmbushen rekomandimet e përgjithshme për financimin e sistemeve shëndetësore.

Sipas konkluzioneve të *Nënkomitetit 2021 te Tregut te Brendshëm ,Konkurrenca,Shendetit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit per Shendetin Publik* thekson qe korniza legjislative të miratohet dhe fillohet me implementimine tyre si; Ligji për Shëndetësi, Ligji për Sigurime Shëndetësore si dhe implementimi i legjislacionit ekzistues, Plani i Veprimit për kontrollin e duhanit . Vendosja e masave për të siguruar shërbime të përshtatshme të kujdesit shëndetësor parësor dhe sigurim të detyrueshëm shëndetësor dhe miratimi i masave të mëtejshme për të përmirësuar standardet e cilësisë në kujdesin shëndetësor, duke përfshirë investimet në aktivitete të promovimit të shëndetit dhe trajnimit si dhe te pergaditet pakoja e benefiteve dhe te vendoset ne platformen per konsultime publike para se te fillohet me mbledhjen e primeve.Sa i përket sëmundjeve ngjitëse Komisioni ka rekomanduar qe te miratohet plani i veprimit per sëmundjet ngjitëse duke u bazuar ne rekomandimet e ECDC. Të vazhdohet me përpjekjet për të përmirësuar nivelin e kapaciteteve për sistemin mikrobiologjik për shëndetin publik bazuar ne gjetjet e ENLabCap survey.

Gjendja aktuale

Korniza legjislative dhe ajo e politikave

Mbrojtja e konsumatorit

Korniza legjislative në këtë fushë përbëhet nga këto akte kryesore normative:

- Ligji nr. 06/L-034 për Mbrojtjen e Konsumatorit;

Ky akt normative transpozon këto akte të *acquis*-së:

- Direktivën 93/13/KKE mbi Kushtet e Padrejta në Kontrata, Direktivën 98/6/KE për Mbrojtjen e Konsumatorit në Tregues të Çmimeve të produkteve të ofruara për konsumatorët;
- Direktivën 1999/44/KE mbi aspekte të caktuara të shitjes së mallrave të konsumit dhe garancive ndërlidhëse;
- Direktivën 2002/65/KE në lidhje me marketingun në distancë të shërbimeve financiare;
- Direktivën 2005/29/KE në lidhje me praktikën e padrejta komerciale biznes-konsumator në tregun e brendshëm;
- Direktivën 2008/48/KE mbi marrëveshjet e kredisë për konsumatorët;
- Direktivën 2008/122/KE për mbrojtjen e konsumatorëve në lidhje me aspekte të caktuara të kontratave të shfrytëzimit me afat të paluajtshmërive me qëllim të pushimit, shfrytëzimit afatgjatë të produkteve të pushimit, të rishitjes dhe shkëmbimit;
- Direktivën 2009/22/KE mbi vendimet gjyqësore për mbrojtjen e interesave të konsumatorëve,
- Direktivën 2011/83/BE mbi të drejtat e konsumatorëve;
- Direktivën 1999/44/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit duke shfuqizuar Direktivën e Këshillit 85/577/KKE dhe Direktivën 97/7/KE.

Ligji për Mbrojtje të Konsumatorit mbeshetet nga legjislacioni sekondar si ne vijim:

- UA nr. 13/2018 për Procedurën e Trajtimin të Ankesave nga Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorit.
- UA nr. 18/2018 për formularin për informacionin, kohën dhe procedurat e zbatimit të tërheqjes nga Kontratat në Distançë dhe jashtë objektit afarist.
- UA nr. 01/2019 për caktimin e formës, përmbajtjes dhe përdorimit të flamurit mbi origjinen e produktit.
- UA nr. 05/2019 për Përcaktimin e Formulareve Standard të Informatave për Konsumatorët të Kontratave me Kohë-Ndarje dhe Kontratave të Ndërlidhura
- UA nr. 01/2020 për Mbrojtjen e regjistrimit elektronik të padive kolektive të finalizuara me aktgjykim të plotfuqishëm
- Vendimi i Qeverisë i datës 3 dhjetor 2018 për përberjen e Këshillit për Mbrojtje të konsumatorit.

Korniza e politikave në kete fushë perbehet nga Programi për Mbrojtje të Konsumatorit 2016-2020.

Korniza legjislative në fushën e *shërbimeve financiare*, nga përbëhet nga këto akte kryesore normative:

- Ligji nr. 04/L-155 mbi Sistemin e Pagesave për Shfrytëzuesit e Shërbimeve të Pagesave;
- Ligji nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia;
- Rregullorja për Normën Efektive dhe Kërkesat për Shpalosje;
- Rregullorja e Brendshme për Trajtimin e Ankesave;
- Rregullorja për Procesin e Brendshëm të Trajtimin të Ankesave;

Këto akte normative kanë transpozuar këto akte të acquis-së:

- Direktivën 2007/64/KE për Shërbimet e Pagesave në Tregun e Brendshëm – pjesërisht;
- Direktivën 2009/13/KE si dhe Rregulloren nr. 2001/25 mbi Licencimin, Mbikëqyrjen dhe Rregullimin e Kompanive të Sigurimit dhe Ndërmjetësuesit të Sigurimit – pjesërisht;
- Direktivën 2008/48/KE për Marrëveshjet e Kredive Konsumuese që ndër të tjera definojnë kalkulimin e normës efektive.

Mbrojtja e shëndetit

Legjislacioni në fushën e shëndetit publik përbëhet nga Ligji nr. 04/L-125 për shëndetësi. Ai ka për qëllim sigurimin e bazës ligjore për ruajtjen dhe përparimin e shëndetit të qytetarëve të Republikës së Kosovës nëpërmjet promovimit të shëndetit, aktiviteteve parandaluese, dhe ofrimit të shërbimeve gjithëpërfshirëse dhe kualitative të kujdesit shëndetësor.

Korniza legjislative në fushën e Mbrojtjes së Shëndetit përbëhet edhe nga ligjet në vijim:

- Ligji për Luftimin dhe Parandalimin e COVID-19
- Ligji nr. 04/L-192 për Transplantim të Indeve dhe Qelizave;
- Ligji nr. 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit;
- Ligji nr. 05/L-023 për mbrojtjen e te ushqyerit;
- Ligji nr. 02/L-78 për Shëndetësi Publike;
- Ligji nr. 02/L-76 për Shëndetin Riprodhues;
- Ligji nr. 02/L-109 për Sëmundjet Ngjitëse.
- Ligji nr. 02/L-128, Për barnat Narkotike, substancat psikotrope dhe prekusorë,
- Ligji nr. 05/L-025, Për Shëndetin Mendor
- Ligji nr. 2004/38, Për të drejtat dhe Përgjegjësitë e qytetarëve në kujdesin shëndetësorë,
- Ligji nr. 02/L-76, Për Shëndetin Riprodhues,
- Ligji nr. 03/L-110, Për ndërprerjen e shtatzënisë.
- UA nr. 06/2013 për Frytnimin e Asistuar Mjekësor;
- UA nr. 05/2011 për Parandalimin dhe Kontrollin e Infeksioneve brenda Spitalore dhe
- UA nr. 05/2010 për Vaksino profilaks, Seroprofilaks dhe Kimioprofilaks
- UA nr. 08/2015 për Udhërrëfyes dhe protokolle klinike;
- UA për veprimtarinë, strukturën dhe funksionet e shërbimeve shëndetësore për HIV/AIDS.

Këto akte normative kanë transponuar këto akte të acquis-së:

- Direktivën 2002/98/KE, me anë të së cilës përcaktohen standardet e cilësisë dhe sigurisë gjatë grumbullimit, testimit, përpunimit dhe shpërndarjes të gjakut dhe përbërësve të gjakut pavarësisht qëllimit;
- Direktivën 2004/33/KE, me anë të së cilës zbatohet direktiva 2002/98/KE në raport me kërkesat teknike për gjak dhe përbërës të gjakut;
- Direktivën 2005/61/KE, me anë të së cilës zbatohet direktiva 2002/98/KE në raport me gjurmimin dhe raportimin e ngjarjeve dhe reaksioneve anësore serioze
- Ky ligj transponon pjesërisht Direktivën 2004/23/KE për Vendosjen e Standardeve të Kualitetit dhe Sigurisë për Dhurimin, Prokurimin, Testimin, Procedimin, Ruajtjen, Magazinimin dhe Distribuimin e Qelizave dhe Indeve Njerëzore.
- Ligji në fjalë transponon pjesërisht Direktivën 2001/37/KE lidhur me Prodhimin, Prezantimin dhe Shitjen e Produkteve të Duhanit, Direktivën 2003/33/KE lidhur me Reklamimin dhe Sponsorizimin e Produkteve të Duhanit si dhe Rekomandimin e Këshillit të vitit 2002 për Parandalimin e Pirjes së Duhanit dhe Inicativat për Përmirësimin e Kontrollit të Duhanit.
- Ky ligj transponon pjesërisht Direktivën 2006/141/KE për Formula Qumështore dhe Formula Pasuese.

Sa i përket kornizës së politikave, institucioni kompetent për zhvillim të politikave për mbrojtje të shëndetit është Ministria e Shëndetësisë. Ky institucion për zbatim të legjislacionit posedon një numër strategjisë, programe dhe plan veprimi të përshkruar në vijim.

Strategjia Sektoriale Shëndetësore 2017-2021 përcakton tri objektiva strategjike për zhvillimin e sektorit të shëndetësisë: Ruajtja dhe përparimi i shëndetit, sigurimi i financimit të qëndrueshëm shëndetësor dhe riorganizimi i sektorit të shëndetësisë. Ministria e Shëndetësisë me qëllim të vazhdimit të përmirësimit të shëndetit të nënës, fëmijës, adoleshentit dhe shëndetin riprodhues ka finalizuar Planin Strategjik për shëndetin e nënës, fëmijës, adoleshentit dhe shëndetin riprodhues 2019-2021 (PSShNFSHR).

Plani Strategjik ofron një kornizë gjithëpërfshirëse në përpjekjet e arritjes së synimit për zvogëlimin e sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë së nënave dhe fëmijëve në Republikën e Kosovës.

Ky dokument promovon një qasje të integruar për zbatimin e aktiviteteve dhe rekomandimeve të cilat mbështesin politikën dhe programet e Ministrisë së Shëndetësisë si dhe synimet globale të kësaj fushe në përgjithësi.

Duke marrë parasysh gjendjen e shëndetit të nënës dhe fëmijës në vendin tonë, nevoja për adresimin e problemeve në këtë fushë konsiderohet si prioritet i Ministrisë së Shëndetësisë dhe për këtë qëllim Strategjia Sektoriale Shëndetësore 2017-2021 ka paraparë në kuadër të Objektivit Strategjik "Ruajtja dhe përparimi i Shëndetit", Objektiven Specifike 2: Përmirësimi i shëndetit të nënës dhe fëmijës.

Programi i zgjeruar i imunizimit paraqet dokumentin që përcakton vaksinat e obliguara me ligj me të cilat imunizohen fëmijët e moshës së caktuar në interval kohor të caktuar. Me qëllim të adresimit të pabarazive, Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me partneret relevant dhe mbështetur nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) ka filluar procesin e riorientimit të programit me qëllim të rritjes së nivelit të vaksinimit të fëmijëve Romë, Ashkali dhe Egjiptas. Për këtë qëllim janë duke u zhvilluar një varg aktivitete që do të ndikojnë në përfshirjen e këtyre fëmijëve në kuadër të vaksinimit të rregullt.

Korniza institucionale

Mbrojtja e konsumatorit

Korniza institucionale në këtë fushë përbëhet nga këto institucione:

- Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, përkatësisht Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorit si dhe Inspektorati i Tregut;
- Banka Qendrore e Kosovës, saktësisht Divizioni për Shqyrtimin e Ankesave të Shfrytëzuesve të Shërbimeve Financiare.

Organ tjetër i rëndësishëm në fushën e Mbrojtjes së Konsumatorit është Këshilli për Mbrojtjen e Konsumatorit i themeluar në bazë të Ligjit për Mbrojtje të Konsumatorit. Këshilli është zgjeruar nga 7 në 16 anëtarë me vendim të Qeverisë nr. 05/77, më 4 dhjetor 2018. Anëtarët e Këshillit janë përfaqësues të MINT-së, Agjencisë së Veterinës dhe Ushqimit (AVUK), Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Aleanca Kosovare e Biznesit (AKB), Banka Qendrore e Kosovës, Zyra e Rregullatorit të Energjisë, Komisioni i Pavarur për Media, Organizatat Joqeveritare “Konsumatori”, “LENS”, “FOL” dhe “Kallzo.Com”, si dhe instituti GAP. Përgjegjësitë e Këshillit për Mbrojtjen e Konsumatorit janë këshillëdhënëse në fushën e mbrojtjes së konsumatorit. Gjithashtu Këshilli është përgjegjës për hartimin e Programit për Mbrojtjen e Konsumatorit si dhe monitorimin e zbatimit të Programit për Mbrojtje të Konsumatorit.

Mbrojtja e shëndetit

Organi kryesor në fushën mbrojtjes së shëndetit është Ministria e Shëndetësisë. Organet kompetente për zbatimin dhe monitorimin e ligjit për kontrollin e duhanit janë: Inspektoratet qendrore të ministrive të linjës: Inspektorati Shëndetësor (MSh), Inspektorati Sanitar (AUV), Inspektorati i Tregut (MINT), Inspektorati i Punës, Inspektorati i Arsimit (MASH), Inspektorati i Transportit (MMPHI), Policia e Kosovës (MPB), Agjencia Kundër Korrupsionit dhe Inspektoratet komunale. Kapacitetet administrative aktuale për zbatimin e ligjit për kontrollin e duhanit janë aktualisht të pamjaftueshme.

Veprimtaria transfuzive në Republikën e Kosovës kryhet nga institucionet e autorizuar transfuzive të organizuara në dy nivele; Qendra Kombëtare e Kosovës për Transfuzionin e Gjakut dhe Qendrat e Transfuzionit të Gjakut të cilat funksionojnë në kuadër të spitaleve publike të përgjithshme.

Inspektorati Shëndetësor vepron në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë dhe ka të punësuar 25 inspektorë.

Këshilli Ndërmintor për Kontroll të Duhanit është themeluar nga Qeveria e Kosovës në bazë të Ligjit për Kontrollin e Duhanit dhe ka 15 anëtarë: përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit; Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve; Ministrisë së Drejtësisë; Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Ministrisë së Ekonomisë; Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve; si dhe profesionistë shëndetësorë, përfaqësues të mjeteve të informimit dhe shoqëria civile. Ky këshill është kompetent për propozimin e masave parandaluese, të vetëdijesimit, edukimit dhe njëkohësisht bënë monitorimin e zbatimit të tyre.

Institucionet e tjera për zbatim të legjislationit në fushën e shëndetësisë janë edhe Instituti Kombëtar për Shëndetësi Publike, Komunitat/Inspektoratet, Institucionet shëndetësore dhe Bordi Nacional për Kontrollin e Kancerit.

Mbështetja e donatorëve

Institucionet e Kosovës mbështeten nga Komisioni Evropian (përmes IPA-s) dhe nga donatorë tjerë bilateralë me projektet e përmbledhur në vijim.

Projektet aktuale dhe të planifikuara IPA

Mbrojtja e konsumatorit

- Përshkrimi: Lëvizja e Lirë e Mallrave 2 – Komponenti për mbrojtje të konsumatorit synon të mbështes aktivitetet për ngritje të vetëdijes, të përafroj më tej legjislationin me acquis-in e BE-së, të mbështes Departamentin e Mbrojtjes së Konsumatorit në pjesëmarrjen aktive në organizatat relevante evropiane dhe ndërkombëtare dhe të trajnoj stafin punues.;
- Përfituesi: Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë: Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorit;
- Periudha e zbatimit: 2018-2020.

Mbështetje institucioneve të Kosovës në procesin integruar, është programi i qeverisë së Luksemburgut i cili ka si synim ngritjen e kapaciteteve institucionale të Republikës së Kosovës në zbatimin e prioriteteve që dalin

nga MSA. Ky projekt ka filluar në vitin 2019 dhe do ofrojë mbështetje për institucionet kosovare në fushën e mbrojtjes së konsumatorit.

Mbrojtja e shëndetit

- Sektori i shëndetësisë mbështetet nga projekti “Kujdesi shëndetësor i qasshëm dhe cilësor” që financohet nga Qeveria Zvicerane/SDC. Projekti do të fokusohet në Kujdesin Parësor Shëndetësor dhe ka për qëllim përmirësimin e shëndetit të popullsisë së Kosovës duke përmirësuar qasjen në shërbime shëndetësore, cilësinë e shërbimeve, menaxhimin shëndetësorë duke të fuqizuar nevojat e pacientëve (veçanërisht të grupeve të cenushme). Ky projekt është duke u dizajnuar për fazën e dytë që pritet të filloj këtë vit;
- Qeveria e Luksemburgut përmes projektit Mbështetja e sistemit shëndetësor të Kosovës KOS 017 (faza e 2-të). Projekti do të vazhdoj të mbështesë sektorin e shëndetësisë në zhvillimin e reformave në sektorin e shëndetësisë. 6, 000.000. Faza e dytë e këtij projekti do të fillojë gjatë vitit 2020;
- Fondi Global do të vazhdoj të mbështesë aktivitetet në parandalimin e TB dhe financimin e vazhdimin të projektit “Parandalimi i HIV në Kosovë.”
- Emiratet e Bashkuara Arabe kanë filluar me Ndërtimin e spitalit të Kirurgjisë Pediatrike në QKUK në vlerë prej 22, 000, 000 eurosh. Projekti i ndërtimit të spitalit pediatrik do të përfundoj në vitin 2021;
- Sektori i shëndetësisë do të vazhdoj të mbështetet përmes projektit “Mbështetje e sistemit shëndetësor” që financohet nga Qeveria Italiane. Buxheti i mbetur i projektit do të jetë 628, 869 dhe do të fokusohet në zhvillimin e kardiokirurgjisë me qëllim të funksionalizimit të klinikës së kardiokirurgjisë përmes trajnimeve të stafit profesional, ofrimit të ekspertizës nga ekspertët italian dhe blerjes së pajisjeve;
- *Mbështetje institucioneve të Kosovës në procesin integruar* është programi i qeverisë së Luksemburgut i cili ka si synim ngritjen e kapaciteteve institucionale të Republikës së Kosovës në zbatimin e prioriteteve që dalin nga MSA. Ky projekt ka filluar në vitin 2019 dhe do ofrojë mbështetje për institucionet kosovare në fushën e mbrojtjes së shëndetit.

Objektivat prioritarë afatmesme

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA dhe dokumentet e mekanizma të tjerë të aderimit në BE në kuadër të fushëveprimit të kapitullit 28, fokusi gjatë periudhës 2021-2025 do të jetë në këto objektiva prioritarë afatmesme.

Mbrojtja e konsumatorit

- Zbatimi i Programit për Mbrojtje të Konsumatorit 2021-2025 ;
- Forcimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve administrative në Departamentin e Mbrojtjes së Konsumatorit;
- Rritja e vazhdueshme e nivelit të përfshirjes së shoqatave të konsumatorëve si dhe akterëve relevant në fushën e mbrojtjes së konsumatorit;
- Realizimi i vazhdueshëm i aktiviteteve vetëdijësuese dhe ndërgjegjësuese për mbrojtjen e konsumatorit.

Mbrojtja e shëndetit

- Në aspektin legjislativ, në planin afatmesëm, do të vazhdojë harmonizimi i legjislacionit primar dhe sekondar me Acquis në fushën e të drejtave të pacientëve në kujdesin shëndetësor ndër kufitar, shëndetin mendor, transplantimi i organeve, parandalimi i lëndimeve, duhani, ushqyeshmëria, aktiviteti fizik dhe psikik;
- Sa u përket kapaciteteve institucionale, në 2 vitet e ardhshme do të behet funksionalizimi i Autoritetit shtetëror përkatësisht Divizioni për Biomjekësi që përcaktohet në baze të Ligjit për Transplantimin e Indeve dhe Qelizave;
- Sa u përket masave zbatuese, do të fokusohet në zbatimin e strategjive ekzistuese me theks të veçantë strategjitë për: Kontrollin e kancerit, promovim dhe edukim shëndetësor, kujdesin parësor

shëndetësor, shëndetin mendor, rezistencën antimikrobike, programin e imunizimit shëndetin e nënës, fëmijës, adoleshentit dhe shëndetin riprodhues, vaksinimin, edhe HIV-AIDS;

- Funkcionalizimi i plotë i sistemit të sigurimeve shëndetësore përfshirë kornizën e nevojshme ligjore, mbledhjen e premieeve përmes Fondit të Sigurimeve dhe sistemin informativ shëndetësor, është një aspekt tjetër prioritar për periudhën afatmesme.

3.29. Kapitulli 29 i acquis-së: Unioni Doganor

Acquis në fushën e bashkimit doganor përbëhet thajse ekskluzivisht nga legjislacioni i cili është direkt detyrues për Shtetet Anëtare. Ai përfshin Kodin Doganor të BE-së dhe dispozitat e tij zbatuese, nomenklaturës së kombinuar, tarifës të përbashkët doganore dhe dispozitat për klasifikimin tarifor, lirim nga detyrimet doganore, pezullime doganore dhe kuota të caktuara tarifore dhe dispozita të tjera të tilla si ato në kontrollin doganor të mallrave të falsifikuara, prekursorëve të drogës, eksporti i mallrave kulturore si dhe mbi asistencën reciproke administrative në çështjet doganore dhe transitit. Shtetet anëtare duhet të sigurojnë se ekzistojnë kapacitetet e nevojshme të zbatimit dhe fuqizimit, përfshirë lidhjet me sistemet përkatëse të kompjuterizuara doganore të BE-së. Shërbimet doganore duhet gjithashtu të sigurojnë kapacitete të mjaftueshme për të zbatuar rregulla të veçanta të përcaktuara në fushat e lidhura me acquis të tilla si tregtia e jashtme.

Kërkesat e MSA-së

Angazhimet në fushën e doganave janë marrë në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga MSA, nenet 17, 18, 19, 39, 48, 75, 93 dhe 104. nenet 17, 18, 19, 39, 48 dhe 93 parashohin në veçanti forcimin e bashkëpunimit me vendet e rajonit që kanë nënshkruar MSA, ndërsa neni 49 dhe Protokoli 3 përcakton rregullat e origjinës për zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshje.

MSA, në veçanti neni 104, vendos detyrimet rreth doganave, përkatësisht që palët të bashkëpunojnë në këtë fushë me synim garantimin e përputhjes me dispozitat që do të miratohen në fushën e tregtisë, dhe për të arritur përafrimin e sistemit doganor të Kosovës me atë të BE-së, duke ndihmuar kështu në hapjen e rrugës për marrjen e masave liberalizuese të planifikuara në këtë Marrëveshje dhe për përafrimin gradual të legjislacionit të Kosovës për doganat me atë të acquis të BE-së. Bashkëpunimi do të marrë parasysh në mënyrën e duhur fushat prioritare që lidhen me acquis të BE-së në fushën e doganës. Në këtë fushë protokoli 4 vendos rregullat e asistencës të ndërsjellë administrative mes Palëve në fushën e doganës. Gjithashtu, me qëllim të sigurimit të tregtisë së lirë, Dogana do të zhvillojë kapacitetet administrative në fushën e luftimit të ekonomisë joformale, në fushën e mbrojtjes së pronësisë intelektuale (Kreu VI, neni 4.3).

Ndërsa në kuadër të protokollit 3 Kosova duhet që pas hyrjes në fuqi të MSA-së të nënshkruajë dhe ratifikojë Konventën Pan Euromed për Rregullat Preferenciale të Origjinës, si konventë që zbaton MSA-në për pjesën e tregtisë.

Fusha e Doganës karakterizohet si një ndër fushat kyçe në zbatimin e detyrimeve të dala nga MSA mbi lëvizjen e lirë të mallrave nga njëra anë zbatimin e masave lehtësuese tregtare si dhe luftimin e evazionit fiskal, kontrabandës dhe piraterisë për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Këtu mbulohet legjislacioni i harmonizuar/adoptuar me Acquis, dokumentet strategjike, strukturimi i Administratës doganore, kapacitetet administrative dhe sundimi i ligjit.

Kërkesat nga mekanizmat e tjerë të aderimit në BE

Bazuar në *Raportin e KE-së për Kosovën – 2020*, Kosova është e përgatitur mesatarisht në fushën e doganave. Ka pasur progres pasi strategjia dhe plani i veprimit për luftimin e ekonomisë joformale u miratuan dhe Kosova vazhdoi të performojë pozitivisht në zbatimin e masave doganore, veçanërisht për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale (IPR). Rekomandimet në raportin e vitit të kaluar nuk janë adresuar plotësisht dhe në të ardhmen, Kosova duhet në veçanti të harmonizojë më tej legjislacionin doganor, të forcojë koordinimin midis Doganave të Kosovës, agjencive të zbatimit të ligjit dhe institucioneve të tjera përkatëse për luftimin e ekonomisë joformale dhe mashtrimin doganor. Dogana duhet të fillojë të heq dorë

nga përdorimi i terminaleve doganore në pronësi private dhe të heqin tarifën përkatëse që u ngarkohen eksportuesve / importuesve, në përputhje me legjislacionin doganor të BE-së.

Konkluzionet e dala nga Nënkomiteti i MSA kërkojnë që të miratohet Kodi Doganor dhe Akcizës të Kosovës për të përafuar atë më tej me legjislacionin dhe praktikën e BE-së; të forcohet më tej koordinimi ndërmjet Doganave të Kosovës, agjencive të zbatimit të ligjit dhe institucioneve të tjera përkatëse për luftimin e ekonomisë joformale dhe mashtrimin doganor; të zbatohen parimet e administrimit dhe meritave të mira të burimeve njerëzore në politikën e rekrutimit dhe promovimit në Doganat e Kosovës. Gjithashtu, rekomandohet që Dogana duhet të aplikojë për programin Doganor 2020 që synon përmirësimin e mëtejshëm të kapaciteteve doganore në përafrimin me BE.

Kosova zbaton dispozitat e Konventës Rajonale mbi rregullat preferenciale Pan-Euro-Mesdhetare të origjinës, pa e ratifikuar atë. Protokollin III parashtron rregullat e origjinës për zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje. PROTOKOLLI III – Referohet në konceptin e “Origjinës së produkteve”. Me qëllim të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, do të aplikohen Shtojca I dhe dispozitat përkatëse të Shtojcës II të Konventës Rajonale mbi rregullat preferenciale pan-Euro-Mesdhetare të origjinës (këtu e tutje të referuara si “Konventa Rajonale”). Të gjitha referencat për “marrëveshjen përkatëse” në Shtojcën I të Konventës Rajonale dhe në dispozitat përkatëse të Shtojcës II të Konventës Rajonale do të interpretohen siç parashihet në këtë marrëveshjeje.

Konventa Rajonale mbi Rregullat Preferenciale Pan-Euro-Mesdhetare - përmban rregulla uniforme të origjinës të cilat janë të detyrueshme për të gjitha Palët Kontraktuese për aplikim sipas Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të cilën ata e kanë lidhur në mënyrë të ndërsjellët.

Shtojca I - i Konventës përmban dispozita të përgjithshme për përcaktimin e konceptit të produkteve origjinuese dhe metodave të bashkëpunimit administrativ.

Shtojca II – i Konventës përmban dispozita specifike të zbatueshme midis Palëve të caktuara Kontraktuese dhe përjashtimeve nga dispozitat e dhëna në Shtojcën I.

Gjendja aktuale

Korniza legjislative dhe ajo e politikave

Dogana në vitet e fundit ka bërë progres të dukshëm dhe ka ndërmarrë një numër hapash pozitiv në proceset e modernizimit dhe zhvillimit, që kanë për qëllim përafrimin e procedurave dhe sistemeve të administratës me ato të BE-së.

Dogana e Kosovës ka vazhduar të përmirësojë legjislacionin e saj. Më 8 maj 2018, Ligji nr. 06/L-015 për Masat Doganore për Mbrojtjen e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale është publikuar në gazetën zyrtare. Gjatë fund vitit 2017, 2018 dhe 2019 janë miratuar disa akte nënligjore të brendshme (përfshirë ato që vetëm janë ndryshuar) prej të cilave më të rëndësishmet janë listuar në vijim:

- UA nr. 43-2017 mbi procedurat për lejimin e autorizimit për procedurat e eksportuesit të miratuar. Qëllimi i këtij UA është zgjerimi i procedurave të thjeshtësuara, gjatë lëshimit dhe verifikimit të zvogëlimit të shpenzimeve administrative dhe kohës duke u autorizuar si eksportues i vërtetuar.
- UA nr. 44-2017 për amendamentimin e UA 86/2010 që përcakton detyrimin për vendosjen e kontrollit fiskal (banderolat) në pije alkoolike. Ky UA përcakton kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen për të lëshuar licencë për banderola, për subjektin që merret me importin, prodhimin e pijeve alkoolike dhe përcaktimin e masave sanksionuese.
- UA nr. 45/2017 për amendamentimin e UA 37/2016 për rregullimin e marrëdhënieve të punës për zyrtarët doganorë. Ky UA ka plotësuar dhe ndryshuar nenin 45 që kanë të bëjnë me promovimet, neni 94, të cilat merren me orarin e përdorimit të pushimit vjetor dhe nenin 98 që kanë të bëjnë me kompensimin e aktiviteteve edukative.
- UA nr. 46/2018 lidhur me zbatimin e kontrolleve selektive mbi operacionet doganore. Ky rregull i UA për zbatimin e kontrolleve selektive përcaktohet duke përdorur teknikat e menaxhimit të rrezikut.

- UA nr. 47-2018 për amendamentimin e UA 36/2016 mbi shpërblimet e pagave dhe shpërblimet e aplikueshme në doganë.
- UA nr. 48-2018 për amendamentimin e UA 92/2011 i cili përcakton vendet ku zyrat doganore do të vendosen orarin e punës, rrugët dhe afatin përfundimtar për mallrat e sjella në Kosovë.
- UA MF-DK nr. 471/2018 për amendamentimin e UA nr. 36/2016 për pagat, shtesat, dhe shpërblimet e zbatueshme në DK, datë 18.01.2018.
- UA nr. 48/2018 për amendamentimin e UA nr. 24/2016 i cili ka plotësuar dhe ka ndryshuar UA 92/2011 që përcakton vendet ku do të vendosen zyrat doganore, orari i punës, rrugët dhe afati kohor për paraqitjen e mallrave të sjella në Kosovë, datë 19.03.2018.
- UA nr. 49/2018 për amendamentimin e UA nr. 69/2009 që përcakton kushtet për bartjen e produkteve me akcizë dhe dokumentet që duhet ta shoqërojnë atë, datë 18.05.2018.
- UA nr. 50/2018 për amendamentimin e UA nr. 103/2012 për inventarizimin e pasurisë së Doganës së Kosovës, datë 07.06.2018
- UA nr. 51/2018 për amendamentimin e UA nr. 106/2012 për vlerësimin e pasurisë së Doganës së Kosovës, datë 07.06.2018.
- UA nr. 52/2018 për amendamentimin e UA nr. 33/2016 mbi trajtimi dhe administrimin e mallrave të ndaluara dhe të konfiskuara, datë 20.06.2018.
- UA (MF-DK) nr. 53/2018 për zbatimin e Ligjit nr. 06/L-015/2018 për masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale, datë 16.07.2018.
- UA nr. 57/2019 për amendamentimin e UA nr. 39/2017, për strukturën organizative të Doganave të Kosovës dhe anekset e tij.
- UA nr. 58/2019 për përcaktimin e rregullave speciale për rregullimin dhe funksionimin e doganës gjatë tranzicionit pas ndryshimit të statusit për personelin civil të punësuar në Doganë në zyrtarë publik.
- UA nr. 59/2019 për amendamentimin e UA nr. 39/2017 për strukturën organizative të Doganave të Kosovës dhe anekset e tij, të ndryshuar dhe plotësuar me UA nr. 57/2019.
- UA nr. 60/2019 për amendamentimin e UA nr. 37/2017, për rregullimin e marrëdhënies së punës për zyrtarët doganorë.
- UA (UA) 64/2020 i cili ndryshon UA 62/2019 të mëparshme, për regjistrimin e përfaqësuesve doganorë në procedurën doganore;
- UA 65/2020, i cili ndryshon UA 55/2019, për caktimin e vendit të zyrave doganore, itineraret dhe afatet e deklarimit të mallrave për zhdoganim.
- UA 66/2020, për Doganat e Kosovës për menaxhimin e pasurive jo financiare.

Në përgjithësi, legjislacioni i Kosovës në fushën e detyrimeve doganore është vlerësuar të jetë në masë të madhe në përputhje me *acquis* dhe kornizën doganore të BE-së.

Sa i përket *transpozimit të akteve të acquis-së* në këto akte normative, Dogana e Kosovës si legjislacion primar zbaton Kodin Doganor dhe të Akcizave të Kosovës Ligjit nr. 03/L-109 i datës 10 nëntor 2008 dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/L-099, i datës 3 maj 2012. Ky ligj është pjesërisht në harmoni me Kodin Doganor të BE-së, me konkretisht me Rregulloren e BE-së nr. 952/2013 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 9 dhjetorit 2013 për Kodin Doganor të Unionit.

Dispozitat zbatuese të Kodit të Doganës janë të përfshira në UA 11/2009 të vitit 2009, të nënshkruar nga MFPT.

Programi legjislativ për vitin 2021 është miratuar, projektligji për ndryshimin e Kodit Doganor dhe të Akcizës së Kosovës është përfshirë në programin legjislativ të vitit 2021, dhe është planifikuar të aprovohet gjatë TM4 2021.

Korniza institucionale dhe e politikave

Korniza institucionale në këtë fushë përbëhet nga këto institucione:

- Ministria e Financave, Punës dhe Transfere përfshirë Doganën e Kosovës, dhe

- Institucione të tjera për aspekte specifike në bashkëveprim me MFPT, si MINT, MPB, MBPZhR etj.

Dogana e Kosovës është autoriteti në kuadër të MFPT i cili është përgjegjës për zbatimin e politikave doganore në Republikën e Kosovës dhe për të siguruar aplikimin e drejtë e të njëtrajshëm konform rregullave doganore dhe dispozitave të tjera të aplikueshme për mallra, të cilat janë subjekt i mbikëqyrjes doganore. Kodi doganor dhe i akcizave është miratuar me 11 nëntor 2008 nga Kuvendi i Kosovës, ndërsa i njëjti është ndryshuar më 2012 dhe është në pajtim me standardet ligjore të BE-së dhe ndër të tjera ka si objektiv edhe zhvillimin ekonomik të Republikës së Kosovës. Kodi Doganor dhe të Akcizave të Kosovës pritet të rishikohet gjate vitit 2021.

Krahas përgjegjësisë për të grumbulluar detyrimet doganore, Dogana e Kosovës është institucion kyç edhe për vjelën e TVSh-së dhe Taksave mbi Akcizën të cilat vjelën nëpër kufij, dhe për më tepër është përgjegjëse për mbrojtjen e shoqërisë nga kontrabandimi i mallrave të tjera të ndaluara dhe me efekt të dëmshëm të krimit ekonomik, dhe evazionit fiskal.

Dogana e Kosovës operon në tërë territorin doganor të Kosovës, përfshirë edhe në pjesën veriore në dy pikat kufitare me Serbinë, në zbatim të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës (nr. 03/L-109) duke unifikuar procedurat doganore.

Dogana e Kosovës është zhvilluar në bazë të standardeve të BE-së dhe është e financuar tërësisht nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës dhe aktualisht i ka rreth 591 punëtorë. Dogana investon në stafin e saj ashtu që të mbajë hapin me zhvillimet e reja, gjithnjë në pajtim të Strategjisë Operative të Doganës dhe Blueprint Doganor (Dokumenti i BE-së).

Nga aspekti i dokumenteve strategjike Dogana e Kosovës operon bazuar në Strategjinë Operative. Në fund të vitit 2019 është finalizuar dhe miratuar Plani Strategjik 2020-2024. Më 31 mars, Dogana e Kosovës ka miratuar Planin e Veprimit për vitin 2020, i cili zbaton Planin Strategjik të DK-së 2019-2021. Kjo strategji përcakton qëllimet dhe objektivat e parapara nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Aplikacioni SEED mbetet një nga mjetet më të rëndësishme për shkëmbimin e informacionit parambërritjes me Malin e Zi, Shqipërinë, Serbinë dhe Maqedoninë e Veriut.

Dogana e Kosovës vjelë rreth 58% e të hyrave të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës. FMN ka lavdëruar vazhdimisht Shërbimin për performancën e saj, duke e krahasuar në një nivel me Shërbimet e Evropës Perëndimore.

Gjatë periudhës janar -10 nëntor 2020, Dogana e Kosovës ka mbledhur 880,891,293.42 €, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak, paraqet rënie prej 11.56%, si pasojë e ndikimit të shkaktuar nga pandemia COVID 19.

Dogana ka zhvilluar reforma të brendshme në mënyrë që ti përshtatet nevojave të biznesit, të zvogëlojë shpenzimet e tyre dhe të ulë numrin e procedurave burokratike të cilat reforma në mënyrë indirekte do kontribuojnë edhe si masa parandaluese të anti-korrupsionit.

Lidhur me lehtësimin e tregtisë, Dogana përpiqet vazhdimisht të ruajë ekuilibrin ndërmjet kontrollit dhe lehtësimit të tregtisë, duke krijuar kushte të përshtatshme për procedurat e zhdoganimit dhe përsheptimin e tyre. Kanali i gjelbër dhe kanali i kaltër u mundëson bizneseve legjitime të kryejnë procedurat doganore brenda 30 minutave nga momenti i hyrjes në kontroll doganor. Gjithashtu, së fundi është prezantuar konceptin Paperless për zhdoganimin e mallrave. Gjatë periudhës raportuese, 10.5% e ngarkesave procedohen në kanalin e kaltër dhe 42.99% në kanalin e gjelbër, ndërsa 14.29% në kanalin e verdhë. Me qëllim të ngritjes së mëtejshme të performancës dhe lehtësimit të tregtisë do të vazhdoj reformimi për gjithë administratën dhe do të rris numrin e bizneseve që do të përdorin kanalin Gjelbër. Dogana ka përgatitur infrastrukturën për eliminimin e regjistrimit të bizneseve për eksport-import, shitjen e mallrave online, si dhe është zbatuar projekti E-Payment.

Në kuadër të lehtësimit të tregtisë dogana aplikon sistemin e I-Informacionit Doganor si Informacionin detyrues të Origjinës (BOI), Informacionin detyrues të tarifës (BTI), Operatorët e Autorizuar Ekonomik (AEO), Statusi i Eksportuesit të Autorizuar, Procedurat Doganore me ndikim ekonomik etj.

Gjatë vitit 2019 janë autorizuar dy subjekte për AEO, ndërsa në vitin 2020 është autorizuar një subjekt për AEO, ku gjer më tani janë gjithsejtë tre subjekte të autorizuar. Tre subjekte tjera janë në procedure për vlerësim, pritet vendim me afat brenda vitit kalendarik. Gjatë vitit 2020, në mbështetje të GIZ-it, janë krijuar grupe validuese në kuadër të vendeve anëtare të CEFTA, për validim të programit AEO të vendeve anëtare të CEFTA-së, për njohje reciproke ashtu siç është paraparë në Protokollin Shtesë 5. Pjesëmarrës në këtë pilot projekt ka qenë edhe ekipi për validim të Doganës së Kosovës.

Një hap i rëndësishëm është edhe prezantimi i Linjës së Sigurt (thirrje telefonike falas) e cila ka rezultuar me rritjen e veprave dhe rritjen e informatave për vepra të korrupsionit. Mbi 95% e informacionit të marrë nga qytetarët ka rezultuar me saktësi.

Në përputhje me Strategjinë për luftimin e ekonomisë joformale dhe bazuar në vlerësimin e përparësisë së lartë, Drejtorët e Përgjithshëm të DK dhe ATK ranë dakord në gusht për krijimin e grupeve të përbashkëta për të luftuar ekonominë joformale. Kjo do të bëhet përmes krijimit të grupeve të analistëve për të targetuar zonat dhe subjektet me rrezik të lartë të evazionit fiskal, dhe përcaktimin e ekipeve të përbashkëta që do të kryejnë kontrollin në zonat e synuara nga grupi i përbashkët i analistëve.

Gjithashtu është rritur kontrolli nga brenda, kryesisht në vendet me rrezik të lartë të specifikuar nga inteligjenca Doganore e Kosovës dhe gjithashtu bazuar në informacionin e marrë nga publiku përmes Qendrës Kombëtare të Menaxhimit të Kufijve. Kontrollët u kryen me fokus të mallrave të kontrabanduar, mashtrimet e importit gjatë zhdoganimit, siç janë origjina, klasifikimi i tarifave, shkelja e të drejtave të pronësisë intelektuale, mashtrimi i konsumatorit, etj. Rëndësi e veçantë i është dhënë forcimit të bashkëpunimit dhe aktiviteteve të përbashkëta me zbatimin e ligjit të tjerë agjenci si Policia e Kosovës, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, Inspektorati Farmaceutik, Inspektorati i Tregut, etj.

Kosova ka nënshkruar 12 marrëveshje/memorandume dypalëshe me vendet e rajonit dhe të BE-së, për të avancuar bashkëpunimin ndërkombëtar doganor, ndërsa marrëveshjet e tjera janë në negociim e sipër. Kosova gjithashtu synon marrjen e statusit joformal të vëzhguesit në Konventën e Përbashkët të Transitit. Ndërsa, me qëllim të zbatimit të Protokollit 4 të MSA për asistencës administrative në çështje doganore, Dogana ka shkëmbyer pikën e kontaktit me OLAF, përmes së cilës do të shkëmbehen informata me qëllim të parandalimit, hetimit dhe luftimit të aktiviteteve ilegale ndërkufitare.

Kosova është anëtarësuar në Organizatën Botërore të Doganave më 25 janar 2017, duke u bërë shteti i 182. Përgjatë 3 viteve si anëtarë të OBD, Dogana e Kosovës është duke përfituar përmes adaptimit të të gjitha fushave doganore për të avancuar tutje sipas standardeve më profesionale botërore.

Për më tepër, në janar 2020 Kosova ka aderuar në dy (2) Konventa ndërkombëtare të cilat administrohen nga Organizata Botërore e Doganave. Dogana e Kosovës duke qenë maksimalisht e përkushtuar si anëtare në Organizatën Botërore të Doganave do të bëhet Palë kontraktuese e konventave kyçe ndërkombëtare, me qëllim të zhvillimit të mëtejshëm të Administratës Doganore dhe zhvillimit të procedurave për tregtinë ndërkombëtare.

Më 19 mars është nënshkruar Marrëveshja BE – Kosovë për pjesëmarrje në Programin e BE-së *Customs 2020*, ndërsa më 23 korrik Kuvendi i Kosovës ka ratifikuar marrëveshjen në fjalë.

Sa i përket mbrojtjes së të Drejtës së Pronësisë Intelektuale (DPI), Dogana e Kosovës zbaton Ligjin për Masat Doganore për Mbrojtjen e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale si pjesë e Këshillit Shtetëror për Pronësi Intelektuale, që synon të rris nivelin e bashkëpunimit dhe koordinimit ndër-institucional. Si tërësi, secili nga institucionet e lartpërmendura ngërthen në vete përgjegjësi të caktuara të cilat kontribuojnë në zhvillimin vital të sektorit të DPI-së.

Të gjitha këto sisteme të krijuara reflektojnë në transparencë, si dhe eliminojnë diskrecionin dhe vendimmarrjen e zyrtarit doganor. Dogana është duke punuar edhe në një numër të moduleve të reja, të

cilat do të avancojnë dhe modernizojnë më tutje organizatën tonë, përfshirë: sistemin për përzgjedhjen e lëndëve për auditim, sistemin për arkiv dhe menaxhim të kërkesave/ankesave (*case management*), portali tregtar i cili do të ofrojë qasje më transparente për subjektet gjatë procedurës së zhdoganimit të mallrave.

Dogana e Kosovës gjithashtu ka avancuar me sistemet dhe lehtësimin e procedurave. Nga aspekti i sistemeve është zbatuar versioni i fundit i sistemit doganor ASYCUDA Eorld 4.3.2 me të cilën është mundësuar që shumë module të shtohen disa veçori që në versionin paraprak kanë munguar. Tani me versionin e ri tek moduli i transiteve është bërë e mundur dhe është filluar menjëherë në bashkëngjithjen e faturave dhe dokumenteve tjera relevante të cilat lehtësojnë analizën e riskut në transit. Gjithashtu në proces janë edhe shumë ndryshime tjera të cilat do të ndikojnë drejtpërdrejt në thjeshtësimin e procedurave doganore.

Në kuadër të digjitalizimit të biznes proceseve në Doganën e Kosovës është duke u zhvilluar projekti *Enterprise Content Management (ECM)* e cila është pjesë e platformës së Zbatimit të Ligjit e cila mundëson që departamentet dhe sektorët brenda DK-se të komunikojnë përmes sistemit në zhvillimin e procedurave doganore, si: Krijimi i kërkesave për autorizime, licenca, raportime, krijimi i rasteve dhe ndërlihdja e rasteve bazuar në numër fiskal, protokollimi i kërkesave, postave dhe dokumenteve zyrtare në mënyrë elektronike të cilat marrin numër protokollit elektronik, miratimi i kërkesave, lëshimi i autorizimeve, etj, dhe të gjitha këto bëhen brenda një sistem të vetëm.

Është funksionalizuar gjithashtu platforma OPEN Data, kjo platformë ngrit nivelin e transparencës dhe siguron të gjithë që Dogana është një institucion transparent dhe kredibil. Platforma OPEN DATA përmban disa kategori si në vijim:

- Bilancin tregtar ndër vite, ku të gjithë të interesuarit mund të gjejnë shkëmbimet tregtare të Kosovës me të gjitha shtetet si në aspektin e importit gjithashtu edhe në aspektin e eksport.
- CEFTA, kjo kategori tregon qartazi shkëmbimet tregtare të Kosovës me të gjitha vendet anëtare të cilat janë pjesë e marrëveshjes ndërkombëtare të CEFTA-s.
- MSA, pasqyron aktivitetin e Doganës, përkatësisht të gjitha të dhënat lidhur me zbatimin e MSA-së në aspektin e tregtar që nga prilli 2016.
- Performanca mujore/vjetore, është kategori që mundëson qasje të gjithë të interesuarve në punën e Doganës dhe performacën tonë.
- Koha e zhdoganimit, tregon kohën që nevojitet për zhdoganimin e mallrave si në import gjithashtu edhe në eksport.

Krijimi i sistemeve lehtëson punën e oficerëve doganor, si dhe ofron kapacitete shtesë:

- Sistemi për **menaxhimin e depove doganore 'online'** mundëson mbikëqyrjen elektronike- online e të gjitha depove doganore të autorizuar. Ky sistem i mundëson Doganës, kontroll të saktë dhe azhur në të gjitha hyrje-daljeve nga depot dhe procedurat doganore, në këtë mënyrë Dogana ushtron kontroll 24 orë pranë depove pa prezencë fizike.
- Sistemi për **Lojërat e fatit** mundëson evidentimin dhe mbikëqyrjen e aktivitetit të subjekteve të autorizuar për veprimtari të lojërave të fatit. Sistemi i ofron Doganës fleksibilitet në gjetjet e të dhënave të kompanive dhe pagesave të tyre në kohë reale.
- Deklarimi **'online' i mjeteve monetare** është krijuar mundësia që deklarimi i mjeteve monetare, pritet ndërlihdja e këtij sistemi me BQK dhe njësinë e inteligjencës financiare. Sistemi ka mundësuar heqjen e formularëve klasik, të cilët plotësoheshin nga oficerët dhe tani sistemi mundëson përcjelljen dhe kalkulimet automatike të deklarimeve monetare.
- Sistemi për **evidentimin e kundërvajtjeve doganore** mundëson menaxhimin e tërë procesit të kundërvajtjeve doganore, duke filluar nga faza e inicimit e deri në përmbylljen e lëndës.
- Shitja **Online (e-auction)** - ky sistem mundëson shitjen online të mallrave të konfiskuara. Aktivizimi është bërë gjatë vitit 2017.
- Sistemi për **Autorizime dhe Normativa** evidenton dhe menaxhon të gjitha autorizimet për procedura me ndikim ekonomik (depo doganore, përpunim i brendshëm, etj.), në procedurë të përpunimit doganor.

- Sistemi për **evidentimin e garancioneve bankare** menaxhon të gjitha garancionet bankare në nivelin e gjithë institucionit.
- Sistemi për **menaxhimin e kthimit të akcizës për prodhues** mundëson menaxhimin e autorizimeve për subjektet prodhuese.
- Sistemi për **Sektorin e Rishqyrtimit të Vendimeve** mundëson evidentimin dhe menaxhimin e lëndëve (ankesave), të cilat paraqiten në sektorin e rishqyrtimit të vendimeve.
- Sistemi për **bashkëpunim ndërkombëtar** evidenton dhe menaxhon të gjitha kërkesat të cilat kanë të bëjnë me shkëmbimet ndërkombëtare.
- Sistemi për **përzgjedhje ASG** mundëson përzgjedhjen automatike të lëndëve për kontrole të dyta.
- Sistemi për **selektim të ngarkesave në procedurë të thjeshtëzuar** përzgjedh në mënyrë të rastësishme për kontrole detale një numër të ngarkesave, të cilat janë të autorizuar për procedurë të thjeshtëzuar.
- Ne mbështetje të UNICTAD është duke u zhvilluar moduli në sistemin automatik për të dhëna (Asycuda), që evidenton dhe menaxhon të gjitha autorizimet, normativat, stoqet e lëndëve të para, produktit final për Depot e Mallrave Akcizore dhe Tregtareve të Mallrave Akcizore.
- Sistemi për menaxhimin e pullave fiskale - banderolave - ECM/LESS mundëson menaxhimin e porosive dhe furnizimin e subjekteve importuese/prodhuese më banderolla për produktet e duhanit dhe pijeve alkoolike.

Objektivat prioritarë afatmesme

Në planin afatmesëm prioritetet kryesore **ligjore** parashikohet të realizohen janë:

- Përafrimi i vazhdueshëm i kornizës ligjore me Acquis përfshirë edhe legjislacionin sekondar për zbatim të Kodit Doganor.

Në planin afatmesëm prioritetet kryesore **zbatuese** parashikohet të realizohen janë:

- Modernizimi i Doganës së Kosovës sipas standardeve të Udhërrëfyesit Doganor të BE-së (EU Blueprint);
- Zbatimi i programit për autorizimin e Operatorëve Ekonomik (AEO);
- Zbatimi i programit të BE-së Customs 2020 (*Customs 2027*);
- Forcimi i mëtejshëm koordinimit ndërmjet Doganave të Kosovës, agjencive të zbatimit të ligjit dhe institucioneve të tjera përkatëse për luftimin e ekonomisë joformale dhe mashtrimin doganor;
- Finalizimi i shkëmbimit të informatave në nivel rajonal SEED+ të vendeve të CEFTA-së.

3.30. Kapitulli 30 i acquis-së: Marrëdhëniet me jashtë

Acquis në këtë fushë përbëhet kryesisht nga legjislacioni i zbatueshëm drejtpërsëdrejti dhe nuk kërkon transpozim në legjislacionin kombëtar. Ky legjislacion i BE-së rezulton nga angazhimet shumëpalëshe dhe dypalëshe të BE-së në fushën e tregtisë, si dhe nga një numër i masave tregtare autonome. Në fushën e kredive të eksportit dhe mallrave me përdorim të dyfishtë, disa direktiva kërkojnë ndryshime në legjislacionin kombëtar.

Në këtë kontekst, vendeve kandidatë u kërkohet që në mënyrë progresive të harmonizojnë politikën e tyre drejt vendeve të treta si dhe të harmonizojnë qëndrimet e tyre brenda organizatave ndërkombëtare (p. sh. OBT, OECD) me politikën dhe pozicionet e miratuara nga BE dhe shtetet anëtare.

Në fushën e politikës së zhvillimit dhe ndihmës humanitare, shtetet anëtare të BE-së duhet të përputhin me legjislacionin e BE-së dhe angazhimet ndërkombëtare dhe të sigurojnë kapacitetin për të marrë pjesë në zhvillimet dhe në politikën humanitare të BE-së.

Kërkesat e MSA-së

Detyrimi për përafrimin e legjislacionit me atë të BE-së buron nga neni 74 MSA-së, dispozitë nga cila Kosova ka jo vetëm detyrimin për të sjellë legjislacionin e saj kombëtar në përputhje me të drejtën e BE-së, por edhe të sigurohet se ajo të zbatohet.

MSA përfshin një pjesë kryesore të tregtisë së lirë midis Kosovës dhe BE-së. Ajo përfshin dispozita në disa fusha që kërkojnë se palët duhet të veprojnë në përputhje me rregullat ose detyrimet ndërkombëtare. Gjithashtu, MSA rregullon edhe bashkëpunimin ekonomik me BE dhe vendet e tjera që kanë MSA në fuqi, bashkëpunimin doganor (protokolli për bashkëpunim doganor), zbatimin e rregullave të OBT-së për tregti të lirë etj. Detyrimet e Kosovës sipas përcaktimeve të MSA-së për politikën tregtare dhe bashkëpunimin ekonomik në mënyrë të përmbledhur për këtë kapitull janë nenet si vijon: 20, 23, 24, 27, 31, 33, 38, 39, 45, 60, 64, 74, 75, 76, 94, 104. Këto obligime në këtë program adresohen nga kapitujt përkatës për lëvizjen e lire te mallrave, doganat, politikat ekonomike dhe monetare etj.

Gjendja aktuale dhe perspektiva

Në kuadër të marrëdhënieve ekonomike dhe kornizës së përgjithshme të perspektivës së integritimit në BE, Kosova aktualisht përfiton nga masat preferenciale tregtare të BE-së për eksportin e Kosovës. Për më shumë rreth bashkëpunimit ekonomik me BE-në ju lutem shihni kapitullin e kriterëve ekonomike dhe atë për politika ekonomike dhe monetare. Gjithashtu Republika e Kosovës tashmë është anëtare e Bankës Botërore, Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe disa institucioneve ndërkombëtare financiare. Kosova Gjithashtu përfiton nga sistemi tregtar preferencial unilateral për eksporte të disa produkteve në SHBA, Japonia, Zvicra dhe Norvegjia. Ndërsa brenda bashkëpunimit ekonomik me vendet e tjera, Kosova ka nënshkruar disa marrëveshje bilaterale për eliminimin e tatimit të dyfishtë. Marrëveshja për Eliminimin e Tatimit të Dyfishtë (METD) është marrëveshje/konventë në mes të dy shteteve për tatimin apo eliminimin e Tatimit të Dyfishtë. Pra, ka për qëllim të përcaktoj shtetin se cili ka të drejtën e tatimit për të njëjtat të ardhura ose kapital, në rastet kur një person është i tatueshëm në të dy shtetet.

Kosova ka në zbatim 11 marrëveshje për Eliminimin e Tatimit të Dyfishtë në të Ardhura dhe Kapital dhe luftimin e evazionit dhe shmangies tatimore, të cilat janë aktualisht në fuqi. 3 nga këto marrëveshje janë lidhur në kohën nga ish-Republika Socialiste Federative Jugosllave me shtetet e tjera. Vendet me të cilat për Eliminimin e Tatimit të Dyfishtë në të Ardhura dhe Kapital dhe luftimin e evazionit dhe shmangies tatimore janë: Belgjika në fuqi nga 13.04.2012, Britania e Madhe në fuqi nga SFR Jugosllavia 01.04.1982 ndërsa në fuqi në RKS nga 06.09.2010, Finlanda në fuqi nga SFR Jugosllavia 1987 ndërsa në fuqi në RKS nga 08.09.2011, Gjermania në fuqi nga SFR Jugosllavia 26.05.1983 ndërsa në fuqi në RKS nga 02.04.2010, Holanda në fuqi nga SFR Jugosllavia 06.02.1983, Hungaria në fuqi nga 12.03.2014, Maqedonia e Veriut, në fuqi nga 11.04.2013, Sllovenia në fuqi nga 18.06.2015, Shqipëria në fuqi nga 11.03.2015 dhe Turqia e ratifikuar nga Kosova 07.11.2012. Gjatë vitit 2017, është arritur që të nënshkruhet marrëveshja në mes të Kosovës dhe Zvicrës; Kosovës dhe Austrisë; Kosovës dhe Luksemburgut.

Gjatë vitit 2018 është negociuar Marrëveshja me Belgjikën, Lituanië, Letoninë, Maltën, ku teksti në nivelin teknik është përafshuar. Ndërsa janë filluar negociatat me Katarin dhe Kuvajtin.

Më 2018 Kosova ka nënshkruar Deklaratën e Përbashkët për Bashkëpunim me vendet e EFTA-s. Takimi i parë i Komitetit të Përbashkët në mes të Kosovës dhe EFTAs do të mbahet në muajin nëntor 2020 (takim virtual).

Kosova do të vazhdojë të jap kontributin e saj në kuadër të Procesit të Berlinit, respektivisht në kuadër të MAP/REA. Gjithashtu, Kosova do të vazhdojë avancimin e raporteve tregtare me vendet e EFTA-s deri në arritjen e qëllimit final, nënshkrimin e MTL me vendet e EFTA-s.

Marrëveshja e CEFTA-s

Marrëveshja CEFTA (*Central European Free Trade Area*) është marrëveshja e tregtisë së lire në të cilën marrin pjesë tetë vende të rajonit të Ballkanit Perëndimor: Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina dhe Moldavia. UNMIK në emër të Kosovës ka nënshkruar marrëveshjen e CEFTA-s më 2006 e cila ka hyrë në fuqi nga viti 2007.

Marrëveshja e parë e CEFTA-së u nënshkrua nga Polonia, Hungaria, Çekia dhe Sllovakia në dhjetor 1992 dhe hyri në fuqi në korrik 1994. Nëpërmjet CEFTA-së këto vende pjesëmarrëse u mobilizuan për t'iu qasur institucioneve politike, ligjore dhe ekonomike të BE-së, duke forcuar në këtë mënyrë demokracinë dhe

ekonomitë e tyre të tregut. Meqenëse në 2007 të gjitha palët e mëparshme të CEFTA-së kishin hyrë në Bashkimin Evropian dhe kishin dale nga CEFTA, u vendos që CEFTA të shtrihej në pjesën e Ballkanit të mbetur jashtë BE-së.

Vlen të ceket që deri tani janë negociuar tregtia e lirë e mallrave dhe e shërbimeve midis vendeve të CEFTA-së (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia e Veriut, Moldavia, Serbia, Mali i Zi dhe Kosova).

Negociatat e shërbimeve me vendet e CEFTA-s kanë përfunduar në dhjetor 2016 dhe gjithsej kanë qenë 9 raunde të negociatave. Në muajin dhjetor 2019 është miratuar nga vendet e CEFTAs Protokollin Shtesë 6 për Tregtinë në Shërbime.

Gjithashtu, gjatë vitit 2018 dhe 2019, negociatave në kuadër të CEFTA-s janë mbajtur takime të grupit punues për Njohjen e Kualifikimeve Profesionale në Vendet e Rajonit (Anëtarëve të CEFTA-së) ku janë caktuar pozicionet nga përfaqësuesit për profesionet përkatëse dhe është konstatuar se është e nevojshme të fillohen sa më parë negociatat në sektorët e zgjedhur si: mjekët e përgjithshëm, dentistët, inxhinierët e ndërtimtarisë dhe arkitektët. Negociatat janë zhvilluar më 2019 por janë pezulluar deri në një vendim të ri nga Kryeministrat e WB6.

Negociatat për Protokollin Shtesë 7 për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve Tregtare kanë filluar në muajin tetor 2020 dhe randa i radhës do të zhvillohet në muajin janar 2021.

Marrëveshjet e tjera

Kosova ka në zbatim 11 marrëveshje dypalëshe për Eliminimin e Tatimit të Dyfishtë të cilat janë aktualisht në fuqi. Disa nga këto konventa ishin lidhur edhe nga ish-Republika Socialiste Federative Jugosllave me shtetet e tjera. Vendet me të cilat Republika e Kosovës ka nënshkruar marrëveshje për Eliminimin e Tatimit të Dyfishtë janë: Konventa ndërmjet Republikës së Kosovës dhe dukës së madhe të Luksemburgut për eliminimin e tatimit të dyfishtë për tatimet në të hyra dhe në kapital dhe për parandalimin e evazionit dhe shmangies fiskale. Data e publikimit: 18.01.2018

- Marrëveshje ndërmjet qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Konfederatës Zvicerane për shmangien e tatimit të dyfishtë për tatimet në të ardhura dhe parandalimin e evazionit fiskal dhe shmangien tatimore. Data e publikimit: 17.08.2017
- Marrëveshje ndërmjet qeverisë së Republikës së Kosovës dhe qeverisë së Republikës së Kroacisë për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin. Data e publikimit: 08.06.2017
- Marrëveshje ndërmjet qeverisë së Republikës së Kosovës dhe qeverisë së Emirateve të bashkuara Arabe për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin. Data e publikimit: 21.10.2016
- Marrëveshja ndërmjet qeverisë së Republikës së Kosovës dhe qeverisë së Mbretërisë së bashkuar të Britanisë së madhe dhe Irlandës veriore për shmangien e tatimit të dyfishtë. Data e publikimit: 09.07.2015
- Marrëveshje ndërmjet qeverisë së Republikës së Kosovës dhe këshillit të ministrave të Republikës së Shqipërisë për shmangien e tatimit të dyfishtë lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin dhe për parandalimin e evazionit fiskal. Data e publikimit: 25.04.2014
- Marrëveshje ndërmjet republikës së Kosovës dhe Republikës së Sllovenisë për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin. Data e publikimit: 14.04.2014
- Marrëveshje ndërmjet qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Republikës Çeke për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat. Data e publikimit: 27.03.2014
- Marrëveshje ndërmjet republikës së Kosovës dhe Hungarisë për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin. Data e publikimit: 13.01.2014

- Marrëveshje ndërmjet republikës së Kosovës dhe Republikës së Turqisë mbi shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat. Data e publikimit: 08.11.2012
- Ratifikimi i marrëveshjes ndërkombëtare për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin, ndërmjet R. së Kosovës dhe R. së Maqedonisë së Veriut. Data e publikimit: 06.06.2011.

Republika e Kosovës ka nënshkruar një varg marrëveshjesh për bashkëpunim ekonomik me vendet e BE-së dhe vende tjera. Po i listojmë më poshtë vetëm ato që janë nënshkruar në periudhën 2018-2019 ndërsa lista e plotë e marrëveshjeve mund të gjendet në Gazetën Zyrtare:

- Marrëveshja për bashkëpunim ekonomik midis Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë së Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Industrisë dhe Tregtisë së Republikës Çeke (korrik , 2019);
- Marrëveshja bilaterale për bashkëpunim ekonomik dhe politik me Mbretërinë e Bashkuar është negociuar dhe pritet të miratohet. Kjo marrëveshje synon të mbulojë vakuumin e krijuar nga dalja e Britanisë nga BE dhe si rezultat edhe nga MSA me Republikën e Kosovës;
- Marrëveshje midis Republikës së Kosovës dhe të Shqipërisë për bashkëpunim, nxitjen e biznesit dhe informimin e diasporës;
- Marrëveshje midis Republikës së Kosovës dhe Kanadasë për promovimin dhe mbrojtjen e investimeve (Maj , 2018);
- Marrëveshje bashkëpunimi në mes të Republikës së Kosovës dhe Japonisë (Shkurt , 2018).

Sa u përket marrëdhënieve tregtare ndërkombëtare, në qershor 2019 është dekretuar nga Presidenti marrëveshja për tregti të lirë mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Turqisë dhe me 1 shtator 2019 ka hy në fuqi. Kosova ka negociuar me Britaninë e Madhe marrëveshjen e partneritetit, tregtisë dhe bashkëpunimit dhe kjo marrëveshje është nënshkruar në muajin dhjetor 2019. Gjithashtu Kosova ka nënshkruar edhe një varg marrëveshjesh bilaterale dhe multi-laterale për bashkëpunim financiar dhe grante të cilat kanë për objekt financimin e projekteve të ndryshme në Kosovë nga donacionet e shteteve dhe institucionet financiare ndërkombëtare.

3.31. Kapitulli 31 i *acquis*-së: Politika e jashtme, e sigurisë dhe ajo e mbrojtjes

Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë dhe Politika Evropiane për Siguri dhe Mbrojtje janë të bazuara në akte ligjore, përfshirë marrëveshjeve ligjrisht detyruese ndërkombëtare, dhe në dokumentet politike. *Acquis* përbëhet nga deklaratat politike, vendime dhe marrëveshje. Shtetet anëtare duhet të jenë në gjendje të kryejnë dialog politik në kuadrin e Politikës së Jashtme të Përbashkët dhe të Sigurisë (PPS), të lidhur me deklaratat e BE-së, për të marrë pjesë në veprimet e BE-së dhe për të aplikuar ne sanksione për masat kufizuese. Vendet aplikante janë të nevojshme në mënyrë progresive të harmonizohen me deklaratat e BE-së, dhe të aplikojnë për sanksione dhe masa kufizuese kur dhe ku kërkohen ato.

Dialogu politik zhvillohet intensivisht në disa nivele ndërmjet institucioneve të Republikës së Kosovës edhe atyre të BE-së për përmbushjen e kriterëve të përcaktuara në procesin e integritimit, fillimisht përmes nënshkrimit, ratifikimit dhe zbatimit të MSA-së.

Dialogu politik dhe dialogu për politika, sipas nevojës, kontribuojnë në procesin e normalizimit të marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë. Kosova zotohet për angazhim të vazhdueshëm drejt përmirësimit të dukshëm dhe të qëndrueshëm të marrëdhënieve me Serbinë. Ky proces do të sigurojë që të dyja vendet të mund të vazhdojnë rrugën e tyre përkatëse evropiane, duke shmangur bllokimin e njërës apo tjetrës palë në këto përpjekje dhe gradualisht të shpien në normalizimin gjithëpërfshirës të marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë, në formën e një marrëveshje ligjrisht të detyrueshme, ku të dy vendet do të jenë në gjendje të ushtrojnë plotësisht të drejtat e tyre dhe të përmbushin përgjegjësitë e tyre. Rrjedhimisht, Kosova vazhdon të zbatojë në mirëbesim të gjitha marrëveshjet e arritura në dialog me Serbinë dhe të respektoj plotësisht parimet e bashkëpunimit gjithëpërfshirës rajonal.

Gjithashtu, detyrimet që dalin nga dispozitat e MSA-së parashohin që Kosova të zgjidhë përmes dialogut konstruktiv çështjet e tjera të pazgjidhura, në bazë të zgjidhjeve praktike dhe të qëndrueshme dhe të

bashkëpunojë për çështjet me interes të përbashkët me Serbinë; të bashkëpunojë në mënyrë efektive me misionin e Politikës së Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes (Common Security and Defence Policy, CSDP) përgjatë mandatit të tij dhe do të kontribuojë në mënyrë aktive në përmbushjen e plotë dhe të papenguar të mandatit të tij në tërë Kosovën.

Këshilli i Stabilizim-Asociimit do të rishikojë rregullisht progresin në këtë proces dhe mund të marrë vendime dhe të lëshojë rekomandime në këtë drejtim. KSA mund të ndihmojë këtë proces në përputhje me nenin 129.

Republika e Kosovës ka marrë seriozisht përgjegjësinë e ofrimit të sigurisë për qytetarët dhe territorin të saj. Kosova e njëh rëndësinë e vazhdimit të ngritjes së aftësisë për institucionet e veta për të ofruar siguri të të gjithë qytetarëve të Kosovës. Prandaj, si pjesë e procesit të marrjes graduale të më shumë përgjegjësi për sigurinë e saj qysh nga fillimi i Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë (RSSS) të vitit 2012, si dhe më pas nga rekomandimet e dala nga analiza e RSSS e vitit 2014, është përcaktuar arkitektura e sektorit të sigurisë në Kosovë dhe janë definuar rolet dhe misionet e qarta në sektorin e sigurisë për t'i maksimalizuar kapacitetet institucionale; janë identifikuar kapacitetet e nevojshme për të ofruar mbrojtje dhe siguri qytetarëve të Kosovës të cilat janë proceduar me kalimin e pakos legjislativë në Kuvend.

Republika e Kosovës aspiron të jetë pjesë përbërëse e strukturave të sigurisë rajonale dhe globale, e në veçanti e BE-së, NATO-së, OSBE-ës dhe OKB-së. Në këtë kontekst, siguria kombëtare e Kosovës është e lidhur ngushtë me sigurinë rajonale dhe sigurinë më të gjerë Euro-Atlantike.

Kërkesat e MSA-së

Në kuadër të kriterëve për fushën e administratës publike që duhet plotësuar nga qeveria dhe institucionet relevante të Republikës së Kosovës në pajtim me nenet 5, 11 dhe 13 të MSA-së, Kosova do të vazhdojë të harmonizohet me masa të caktuara që derivojnë nga Politika e Jashtme, e Sigurisë dhe e Mbrojtjes. Pjesë e obligimeve të MSA-së gjithashtu është normalizimi i marrëdhënieve me Serbinë, përfshirë zbatimin e marrëveshjeve të nënshkruara, respektimi i parimeve të bashkëpunimit rajonal dhe bashkëpunimi efektiv me misionin e Politikës të Jashtme, Sigurisë dhe Mbrojtjes.

Gjendja aktuale

Integrimi evropian i Kosovës është objektiv strategjik nacional, dhe garanci për paqen, stabilitetin dhe prosperitetin e rajonit. Në këtë aspekt, qeveria e Republikës së Kosovës ka vullnet të plotë për të ndërmarrë të gjitha reformat e duhura në kuadër të procesit të integritit evropian. Më tej, Kosova mbështet fuqimisht politikën e jashtme të sigurisë dhe mbrojtjes së BE-së, e cila synon forcimin e rolit të BE-së si një entitet me influencë politike gjithnjë në rritje në politikën ndërkombëtare.

Korniza ligjore në fushën e politikës së jashtme, sigurisë dhe mbrojtjes është e vendosur dhe vazhdon të konsolidohet me ligjet e nevojshme me synim të trajtimit të të gjitha çështjeve që derivojnë nga kjo fushë. Korniza ligjore në fjalë është në përputhje me parimet dhe objektivat e BE-së dhe ndër të tjerë përbëhet nga Ligji për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit; Ligjit për Ndalimin e Bashkimit në Konfliktet të Armatosura Jashtë Territorit të Vendit; Strategjisë Kombëtare për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2018, Strategjisë Kundër Terrorizmit dhe Planit të Veprimit 2018-2022, Urdhrit Administrativ për parandalimin dhe zbulimin e shpëlarjes së parasë dhe Urdhrit Administrativ për parandalimin dhe zbulimin e financimit të terrorizmit.

Struktura institucionale përgjegjëse për politikë të jashtme, sigurisë dhe mbrojtjes përbëhet nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Punëve të Brendshme, dhe përfaqësitë diplomatike.

Ndër prioritetet kryesore të politikës së jashtme të Kosovës mbetet avancimi i partneritetit strategjik me Bashkimin Evropian dhe NATO-n, përfshirë vendosjen e marrëdhënieve kontraktuale me këto organizata, në rrugën drejt integritimeve euro-atlantike.

Kosova ka pikësypnim zhvillimin e bashkëpunimit rajonal, përkatësisht marrëdhënieve të mira me vendet fqinje, si dhe dhënien e ndihmës për realizimin e agjendës së Brukselit për një rajon stabil, demokratik dhe të integruar në BE e NATO. Republika e Kosovës konsideron se bashkëpunimi rajonal është jo vetëm parakusht i integritetit evropian por edhe domosdoshmëri për stabilitetin rajonal.

Ky orientim i politikës sonë të jashtme gjithashtu reflektohet në pjesëmarrjen tonë proaktive në nismat dhe organizatat multilaterale që veprojnë në rajonin e Evropës Juglindore e më gjerë. Kosova është anëtare e përtej 40 nismave rajonale, në mes e tjerash bashkëpunimit në fushën e tregtisë, sigurisë, edukimit, teknologjisë, ambientit.

Sa i përket gjendjes aktuale të sigurisë, është me rëndësi të theksohet se Kuvendi i Republikës së Kosovës më 14 dhjetor 2018 ka miratuar projektligjin për Ministrinë e Mbrojtjes, projektligjin për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe projektligjin për Shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës, të cilat ligje kanë hyrë në fuqi më 18 janar 2019 dhe me të cilat i është dhënë misioni ushtarak FSK-së. Neni 126 i Kushtetutës, ndër të e tjera, përcakton qartë FSK-në si një forcë kombëtare e sigurisë e cila pasqyron karakterin multi-etnik të vendit, që është nën kontrollin civil të institucioneve demokratike dhe ka për detyrë të mbrojë qytetarët dhe komunitetet e Kosovës. Meqenëse ndryshimet në misionin e FSK-së nuk ndikojnë në interesat vitale të komuniteteve pakicë, sipas përkufizimit me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, nuk ka kërkesa për ndryshime kushtetuese.

Dialogu politik me Serbinë

Sa i përket dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë, Kosova mbetet e përkushtuar me pjesëmarrjen e saj në dialogun e nivelit teknik, në mënyrë që të arrihet përparim në zbatimin e marrëveshjeve në mes të dyja palëve të përfshira.

Kosova vlerëson seriozisht rëndësinë e dialogut të Brukselit, jo vetëm në përmirësimin e jetës së qytetarëve dhe të marrëdhënieve bilaterale mes dy shteteve, por sepse ky dialog është aktualisht kontribuuesi më i rëndësishëm për paqen dhe stabilitetin në rajon.

Në këtë drejtim, Qeveria e Republikës së Kosovës, si palë konstruktive dhe serioze në Dialogun e Brukselit, i jep rëndësi të veçantë zbatimit të gjitha Marrëveshjeve të Brukselit dhe marrëveshjeve potenciale që priten të arrihen në periudhën në vijim.

Ka pasur progres të caktuar në arritjen e marrëveshjeve në mes Kosovës dhe Serbisë, megjithatë gjetjet e Raportit të fundit të Qeverisë së Republikës së Kosovës (2019) tregojnë për një progres të ulët në zbatimin e marrëveshjeve në përgjithësi nga ana e Serbisë. Duke parë marrëveshjet veç e veç, raporti identifikon nivele të ndryshme progresi në disa fusha dhe mungesë progresi në shumicën e fushave, edhe për këtë arsye dialogu pritet të hyj në një fazë të re.

Pjesa me dialogun me Serbinë ndërlihet me fushën e Bashkëpunimit Rajonal dhe Obligimeve Ndërkombëtare në kuadër të Kritereve Politike.

Objektivat prioritarë afatmesme:

- Miratimi i Strategjisë për Politikën e Jashtme;
- Do të vazhdojë trajnimi i shërbyesve civil në fushën e politikës së jashtme dhe të sigurisë. Prioritet do të kenë ata që kanë për detyrë zbatimin e masave kufizuese dhe kontrollit të armëve. Gjithashtu, përmes vizitave në shtetet anëtare, do të shkëmbehen përvojat mbi zbatimin sa më efektiv të masave kufizuese;
- MPJD do të hartojë një plan veprimi për zhvillimin sa më efikas të Dialogut Politik në mes të RKS dhe BE. Ky plan veprimi do të përfshijë aktivitete konkrete afatshkurtra dhe afatmesme për koordinimin ndër-institucional brenda RKS dhe koordinimin e institucioneve të BE-së/EEAS për zbatimin e këtij dialogu;
- Republika e Kosovës aspiron të jetë pjesë përbërëse e organizatave shumëpalëshe në nivel rajonal dhe global, e në veçanti e BE-së, NATO-së, OSBE-ës dhe OKB-së. Në këtë drejtim, MPJ do të intensifikojë lobimin si dhe bashkëpunimin me ministrinë dhe institucionet e Republikës së

Kosovës për realizimin e anëtarësimeve që konsiderohen të nevojshme për mirëqeverisje dhe përmirësimin e standardeve të jetesës për qytetarët e saj.

- Republika e Kosovës do të vazhdojë të zbatoj masat kufizuese të dakorduara nga Këshilli. Në këtë mënyrë, Kosova do të funksionalizojë tutje mekanizmin për zbatimin e masave kufizuese.

3.32. Kapitulli 32 i *acquis*-së: Kontrolli financiar

Ky kapitull mbulon dy fusha kryesore të politikave: (a) kontrollin e brendshëm të financave publike (KBFP) dhe auditimin e jashtëm (AJ) dhe (b) mbrojtjen interesave financiare të BE-së dhe mbrojtjen e Euros nga falsifikimi. Sa i përket fushës së KBFP-së dhe auditimit të jashtëm, nuk ka legjislacion specifik të BE-së që do të përdorej në përafrimin e ligjeve kombëtare. Në vend të kësaj, vendet angazhohen që të përvetësojnë standardet ndërkombëtare të kontrollit dhe auditimit të jashtëm të definuara nga Organizata Ndërkombëtare për Institucionet Supreme të Auditimit (INTOSAI) si dhe praktikatat e mira të BE-së.

Kontrolli i brendshëm i Financave Publike është pjesë e integruar e menaxhimit të financave publike dhe përfshinë gjithë buxhetin publik. Në veçanti, parimet e Kontrollit Financiar kërkojnë ekzistencën e i) sistemeve efektive dhe transparente të kontrollit dhe menaxhimit financiar (përfshi inspektimet dhe kontrollet financiare adekuate ex-ante, të vazhdueshme dhe ex-post); ii) sistemeve funksionale të pavarura të auditimit të brendshëm; iii) strukturave përkatëse organizative (përfshi koordinimin qendror); dhe iv) auditimit të jashtëm funksional dhe financiarisht të pavarur, ndër të tjerë, duke vlerësuar cilësinë e sistemeve të krijuara të KBFP-së.

Në fushën e **auditimit të jashtëm** vendet kandidatë pritet që të zbatojnë standardet INTOSAI, në veçanti Deklaratat e Limës dhe Meksikës për pavarësinë funksionale, financiare dhe institucionale si dhe zbatim të auditimeve të financiare (të rregullsisë) dhe performancës.

Sa i përket **mbrojtjes financiare të interesave të BE-së**, Traktati për Funksionimin e BE-së (neni 325) kërkon që vendet anëtare të ndërmarrin masa kundër mashtrimeve që ndikojnë në interesat financiare të BE-së. Vendet anëtare obligohen të koordinojnë veprimet dhe të bashkëpunojnë me Komisionin Evropian. Mbrojtja e interesave të BE-së përfshin përafrimin e legjislacionit kriminal vendor me Konventën për Mbrojtjen e Interesit Financiar të BE-së (PFI Convention) dhe tri protokollet e saj për bashkëpunim midis autoriteteve kombëtare dhe Komisionit. Vendet kandidatë kërkojnë të nominojnë një shërbim kombëtar kundër mashtrimit si pikë kontakti për të facilituar koordinimin me Komisionin dhe vendet anëtare.

Sa i përket **mbrojtjes së euros kundër falsifikimit**, ky kapitull adreson aspektet jo-penale, ndërsa aspektet penale adresohen në kapitullin 24. Principet kryesore kundër falsifikimit të parasë janë të definuara në Konventën e Gjenevës dhe detajuar më tutje në *acquis* relevante. Legjislacioni relevant përfshinë procedura për mbledhjen, ruajtjen dhe shkëmbimin e informatave për bankënotat e falsifikuara, ndalimin e metaleve të ngjashme me monedhat e euros, obligimin që institucionet financiare të kontrollojnë autenticitetin, tërheqjen nga qarkullimi të bankënotave false dhe bashkëpunimin në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Kërkesat e MSA-së

Detyrimet e Republikës së Kosovës për Kapitullin e Kontrollit Financiar rrjedhin nga neni 97 i MSA-së.

Neni 97 kërkon që bashkëpunimi mes palëve të përqendrohet në fushat prioritare që lidhen me *acquis* të BE-së në fushën e kontrollit të brendshëm financiar publik. Në veçanti Palët të bashkëpunojnë me qëllim të zhvillimit të mëtejshëm të zbatimit të kontrollit efikas të brendshëm dhe sistemit funksionalisht të pavarur të auditimit të brendshëm në sektorin publik në Kosovë, në përputhje me kornizën e pranuar ndërkombëtarisht dhe praktikatat e mira të BE-së. Gjithashtu, bashkëpunimi duhet të përqendrohet në krijimin dhe forcimin e njësive qendrore harmonizuese për menaxhimin financiar dhe kontroll.

Në fushën e Auditimit të Jashtëm, neni 97 kërkon që palët të bashkëpunojnë veçanërisht me qëllim të zhvillimit të mëtejshëm të auditimit të jashtëm të pavarur funksional në Kosovë në përputhje me Kornizën e INTOSAI-t për Standardet Profesionale dhe praktikatat dhe praktikatat e mira të BE-së. Bashkëpunimi gjithashtu të fokusohet në ngritjen e kapaciteteve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Kërkesat nga mekanizmat e tjerë të aderimit në BE

Raporti i KE-së për Kosovën – 2020 konstaton se Kosova ka disa përparime të përgatitjes në fushën e kontrollit financiar. Progres është arritur me miratimin e legjislacionit dytësor në fushën e kontrollit të brendshëm të financave publike (KBFP), si dhe miratimin e metodologjisë për raportimin mbi sistemet e kontrollit të brendshëm nga Njësia Qendrore e Harmonizimit. Sidoqoftë, nevojiten përpjekje të mëtutjeshme për të rritur përgjegjësinë menaxheriale, dhe për të forcuar funksionimin e kontrollit të brendshëm në institucionet publike dhe avancimin e auditimit të jashtëm karshi zhvillimeve të reja. Mbështetja politike e nivelit të lartë do të mbetet instrumenti kryesor për zbatimin e KBFP në të gjitha nivelet e administrimit. Zbatimi në kohë i rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm duhet të përmirësohet.

Konkluzionet e dala nga Nënkomiteti i vitit 2020 kërkojnë që të filloj përgatitja e një dokument të ri mbi kontrollin e brendshëm të financave publike sa më shpejt. Në hartimin e këtij dokumentit duhet të përfshihet studimi i SIGMA për përgjegjshmërinë Menaxheriale dhe Studimi për vlerësimin e cilësisë dhe konsultimi me Komisionin Evropian. Paralelisht, duhet të zhvillohet plani i veprimit për zbatim. Gjithashtu, të vlerësohet efektiviteti i raportit vjetor për zbatimin e KBFP-së, për të përmirësuar funksionimin e KBFP-së dhe për të zhvilluar rekomandime të bazuara në të dhëna. Në auditimin e jashtëm, të gjitha organizatat buxhetore duhet të përgatisin planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm siç kërkohet me Ligj dhe Rregulloren e Punës për Zbatimin e Auditimit dhe Planeve të Veprimit. Kërkohet ndryshimi i Ligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Kosovës, duke hequr detyrimin për të kryer auditime të rregullsisë çdo vit në të gjitha organizatat buxhetore dhe futja e qasjes së auditimit të bazuar në rrezik. Komisioni inkurajon rritjen e numrit të auditimeve të performancës nga ZKA.

Gjendja aktuale

Korniza legjislative

Në Kosovë, ekziston një kornizë gjithëpërfshirëse legjislative që rregullon fushën e Kontrollin të Brendshëm të Financave Publike, përfshirë: ligjet, udhëzimet, rregulloret, standardet e tjera ndërkombëtare, politikat e Qeverisë së Kosovës.

Baza ligjore **për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike** është përcaktuar nga Ligji nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike i publikuar në gazetën zyrtare më 19 prill 2018. Të gjitha aktet nënligjore për zbatimin e këtij Ligji janë përgatitur dhe miratuar gjatë vitit 2019. Ky Ligj rregullon sistemin e kontrollit të brendshëm të financave publike, që përfshin menaxhimin financiar dhe kontrollin, auditimin e brendshëm, si dhe harmonizimin e tyre, në pajtim me standardet ndërkombëtare për kontrollin e brendshëm dhe auditimin e brendshëm.

Legjislacioni sekondar për fushën e KBFP përfshin:

- Rregulloren nr. 01/2019 për menaxhimin financiar dhe kontrollin e miratuar (e miratuar);
- Rregulloren e Qeverisë së Kosovës për krijimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm në entitetet e sektorit publik (e miratuar);
- UA për krijimin dhe funksionimin e Komisioneve të Auditimit (e miratuar);
- Metodologjinë për monitorimin e cilësisë së kontrollit të brendshëm në PSE e përgatitur;
- Metodologjinë për monitorimin e cilësive të auditimit të brendshëm në NjAB e përgatitur;
- Manualin për auditimin e prokurimit publik i përgatitur;
- Manualin për auditimin e performancës i përgatitur.
- Doracaku për auditim të brendshëm i miratuar
- Rregullin financiar nr. 01/2013/MF për shpenzimin e fondeve publike trajton shpenzimet dhe kontrollin e brendshëm dhe decentralizimin e menaxhimit të shpenzimeve tek organizatat buxhetore.
- Doracakun e Procedurave të MFK-së, që është në fuqi nga viti 2011, përmban 14 procedura që synojnë mbulimin e të gjitha fushave të ciklit buxhetor. Doracaku i MFK-së do të mund të ishte përdorur nga organizatat buxhetore po të kishin sistem të duhura informative të menaxhimit, ku

kontrollat janë pjesë e proceseve me pak udhëzime të ofruara nga NjQH/MFK-ja dhe nëse do të kishte llogaridhënie të rreptë dhe mekanizma raportimi. Këto kushte nuk kanë qenë në zbatim në kohën e fuqizimit të Doracakut të MFK-së.

- Librin e përshkrimit të proceseve për shpenzimin e parave publike i nënshkruar nga ministri i financave.

Korniza legjislative në fuqi për kontrollin e brendshëm të financave publike përmban parimet e përgjithshme dhe i referohet standardeve të INTOSAI, Kornizës COSO, Standardeve të Institutit të Auditimit të Brendshëm (IIA).

Për përmasimin e sitemit të KBFP ka vazhdu monitorimi i SSP në menagjim financiar e kontroll dhe Auditim të brendshëm (deri me tani janë monitoruar 6 SSP) dhe 6 Njësive të Auditimit të Brendshëm Në Proces të monitorimit të MFK janë edhe dy SSP dhe 4 NJAB. Gjithashtu ka vazhduar trajnimi i zyrtarëve të MFK dhe AB (për shkak të pandemisë trajnimet kryesisht janë mbajtur në formën online).

Përveç legjislacionit të lartpërmendur, ka edhe ligje të tjera që kanë ndërlidhje me KBFP, përfshirë:

- Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi;
- Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal (Ligji nr. 03/L-049);
- Ligjet vjetore mbi Miratimin e Buxhetit të Kosovës
- Ligjin për Prokurimin Publik (Ligji nr. 04-L-042);
- Ligji për ndërmarrjet publike,
- Ligjin për Organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (ligji nr. 03/L-189)
- Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit (05/L-055);
- Ligjin Anti-Korrupsion (Ligji nr. 2004/34);
- Ligjin mbi Shërbimin Civil (Ligji nr. 2010/03-L-149);
- Ligjin për Pagat e Nëpunësve Civil (Ligji nr. 03-L-147); dhe
- Ligjin për Qasje në Dokumente Publike (Ligji nr. 06/L-081).

Sa i përket **Auditimit të Jashtëm**, Deklarata e Limës dhe Deklarata e Meksikës theksojnë se ruajtja e objektivitetit dhe pavarësisë janë primare për funksionimin e Auditorit të Përgjithshëm. Këto dy parime janë vendimtare për institucionin tonë. Objektiviteti dhe pavarësia duhet të sigurohen me anë të zbatimit të mirë të një mandati të gjerë, të qëndrueshëm dhe ligjor; në pajtim me standardet e pranuar ndërkombëtarisht të auditimit në sektorin publik dhe një kodi të brendshëm për mirësjelljen profesionale. Mandati dhe funksionimi rregullohet me anë të legjislacionit primar:

- Kushtetutës së Kosovës nenet 136, 137, 138;
- Ligjin nr. 05/L-55 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës të Kosovës.

Legjislacioni tjetër relevant për fushën e auditimit përfshin:

- Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi;
- Ligji për kontrollin e brendshëm të financave publike;
- Ligjin për prokurim publik;
- Ligjin për ndërmarrjet publike;
- Ligjin kundër korrupsionit;
- Ligji për shoqëritë tregtare.

Korniza e politikave

Zyra Kombëtare e Auditimit ka në zbatim Planin Strategjik 2018-2021. Për zbatimin e tij hartohen Plani Vjetor Operacional dhe Plani i Auditimit. ZKA në vazhdimësi kujdeset në zhvillimin profesional të auditorëve për të siguruar kualifikimet e duhura për të kryer punën tonë si auditor.

Sa i përket **mbrojtjes së Euros kundër falsifikimit**, Banka Qendrore e Kosovës në kuadër të kompetencave të saj më 14 mars 2007 ka nxjerrë UA mbi Shmangien e Kartëmonedhave dhe Monedhave Euro të

Falsifikuara nga Qarkullimi, udhëzim që vlen për të gjitha institucionet financiare që operojnë në Kosovë dhe të cilat janë të licencuara nga BQK-ja. Qëllimi i këtij Udhëzimi është vendosja e masave të nevojshme për arsye të shmangies së kartëmonedhave dhe monedhave të falsifikuara euro nga qarkullimi.

Institucionet financiare, konkretisht institucionet e kreditimit dhe çdo institucion tjetër i angazhuar me ndarjen dhe shpërndarjen e kartëmonedhave dhe monedhave publikut si një veprimtari profesionale, përfshirë institucionet, veprimtaria e së cilave konsiston në këmbimin e kartëmonedhave dhe monedhave të valutave të ndryshme, si p. sh. zyrat e këmbimit, do të jenë të detyruara të heqin nga qarkullimi të gjitha kartëmonedhat dhe monedhat euro të pranuar prej tyre, të cilat ata i dinë ose kanë arsye të mjaftueshme të besojnë që janë të falsifikuara. Kartëmonedhat dhe monedhat e dyshuara si të falsifikuara duhet menjëherë t'i dorëzohen autoritetit kompetent (në këtë rast Policia dhe Policia ia paraqet ato Agjencisë Kosovare për Forenzikë). BQK-ja gjithashtu ka lëshuar një dokument "Këshilla të vlefshme për operuesit me para të gatshme" që përcakton veprimet hap pas hapi se si t'i trajtoni paratë e dyshuara si të falsifikuara.

Korniza institucionale

Qeveria ka krijuar një kornizë institucionale të përbërë nga organizatat e sektorit publik duke punuar me drejtimin e Njësisë Qendrore Harmonizuese, përkatësisht për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) dhe Auditimin e Brendshëm (AB) si dhe nën mbikëqyrjen e auditorit të jashtëm për të krijuar një zinxhir të llogaridhënies.

Koncepti "Kontrolli i Brendshëm i Financave Publike" së pari është zyrtarizuar më 1999 nga KE. Ai i referohet "sistemeve të kontrollit të brendshëm të qeverisë të synuara në mbrojtjen e interesave financiare të qeverisë në tërësi". KBFP u krijua si strategji e mirë për të ndihmuar procesin e reformës në zhvillimin e sistemeve publike të kontrollit të brendshëm në vendet të cilat dëshirojnë të bëhen candidate për anëtarësim në BE. Sistemi i KBFP-së përkufizohet si sistem i cili përbëhet nga elementët funksionale të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) dhe Auditimit të Brendshëm (AB) bashkë me institucionet përgjegjëse për harmonizimin e këtyre funksioneve përgjatë qeverisë (NjQH (MFK + AB).

Subjektet e sektorit publik (organizatat buxhetore)

Llogaridhënia përbëhet nga një zinxhir akterësh ku secili është përgjegjës për arritjen e qëllimeve të caktuara dhe secili duhet t'i japë llogari një autoriteti të nivelit më të lartë për arritjen e këtyre qëllimeve. Niveli më i lartë i autoritetit në këtë zinxhir mbahet nga qytetarët të cilët përfaqësohen nga deputetët e zgjedhur në Kuvend dhe në qeveritë komunale. Subjektet në sektorin publik bartës të KBFP janë:

- Kuvendi: Në kuadër të Kuvendit të Kosovës është krijuar Komisioni për mbikëqyrjen e financave publike i cili ka autoritetin për mbikëqyrjen e shpenzimeve të parasë publike përmes raporteve nga ZAP, NjQH etj;
- Qeveria e Kosovës cakton kompetencat dhe përgjegjësit për Ministrat e saj për të zbatuar politikat e Qeverisë nëpërmjet rregulloreve, politikave dhe aranzhimeve administrative me menaxhmentin e lartë të organizatave buxhetore.
- Ministri i Financave është përgjegjës për zhvillimin e rregullave dhe procedurave të detajuara për KBFP (MFK dhe AB), për trajnimin dhe ofrimin e mbështetjes teknike për të gjitha palët në lidhje me zbatimin e rregullave të MFK-së dhe AB;
- Menaxhmenti i lartë i subjektit të sektorit publik mban përgjegjësinë e plotë për zbatimin e KBFP-së dhe është përgjegjës për performancën e tyre në përdorimin e resurseve publike për të arritur objektivat organizative.

Skema e trajnimit për fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit

NjQH ka krijuar skemën e trajnimit për fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit. Kjo skemë parasheh trajnimin e përgjegjësve për fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe është e fokusuar në këto fusha: menaxhimin e rrezikut, vet vlerësimit, përshkrimin e proceseve, planifikimin strategjik dhe buxhetor.

Skema e certifikimit të auditorëve të brendshëm

Programi kombëtar për trajnim dhe certifikim të auditorëve të brendshëm është krijuar. Ky program është akredituar edhe nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Zbatimi i programi ka filluar prej shtatorit 2016 dhe vazhdon edhe tani. Kjo skemë përbëhet prej pjesës teorike dhe praktike.

Arsimimi i vazhduar profesional për auditor të brendshëm

Përveç skemës së certifikimit për auditor të brendshëm NjQH ka krijuar edhe skemën e trajnimit për arsimimin e vazhduar profesional e cila është e fokusuar në planin strategjik dhe vjetor, sigurimin e cilësisë.

Në fushën e auditimit të jashtëm, Zyra Kombëtare e Auditimit luan një rol të rëndësishëm në mbikëqyrjen e shpenzimeve publike dhe përmirësimin e menaxhimit financiar dhe qeverisjes së mirë. Ruajtja e pavarësisë funksionale dhe financiare mbetet një prioritet në fushën e auditimit të jashtëm. Në periudhë afatshkurtër ZKA-ja synon të zbatoj planin e vet strategjik 2018 -2021 si dhe të zhvilloj dhe rris më tutje kapacitetet profesionale dhe njerëzore për të kryer më shumë auditime të performancës dhe të ndërmarrjeve publike. Në periudhë afatmesme zhvillimi i qëndrueshëm institucional, ruajtja e cilësisë dhe zhvillimi i procedurave dhe kapaciteteve administrative për të siguruar mbrojtje efektive të interesave financiare të BE-së do të jetë një prej prioriteteve kyçe.

Neni 136 i Kushtetutës së Kosovës definon Auditorin e Përgjithshëm si institucioni më i lartë për kontroll ekonomik dhe financiar. Auditori i Përgjithshëm është i përzgjedhur nga Kuvendi me votë të shumicës të gjithë deputetëve bazuar në propozimin e Presidentes/it. Kuvendi vendos në shkarkimin e Auditorit të Përgjithshëm me (2/3) e shumicës të të gjithë deputetëve nga propozimi i Presidentes/it ose në bazë të propozimit të një të tretës (1/3) të të gjithë deputetëve. Mandati i AP është pesë (5) vjeçar me mundësi vazhdimi për rizgjedhje edhe për një mandat.

Neni 137 i Kushtetutës mund të azhurnohet në pajtim me definicionet e tanishme të SNISA sa i përket rolit dhe mandatit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Aktualisht cek se Auditori i Përgjithshëm kontrollon: (1) veprimtarinë ekonomike të institucioneve publike dhe të personave të tjerë juridikë shtetërorë; (2) përdorimin dhe mbrojtjen e fondeve publike nga organet e pushtetit qendror dhe lokal; (3) veprimtarinë ekonomike të ndërmarrjeve publike dhe personave juridikë të tjerë, tek të cilët Shteti ka një pjesë të aksioneve, ose kur huat, kreditë dhe detyrimet e tyre garantohen nga Shteti.

Mënyra e tanishme e definimit në Kushtetutë nuk është ndonjë pengesë në zhvillimin e mëtejshëm të auditimit të jashtëm publik. Por, mund të konsiderohet për amendamentim kur është e përshtatshme.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit të ri nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, nga qershori i 2016, është konsoliduar pavarësia funksionale, financiare dhe operative. Auditori i Përgjithshëm dhe Zyra Kombëtare e Auditimit ka liri të plotë në kryerjen dhe ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave për të zbatuar mandatin e tij në pajtim me Kushtetutën, Ligjin dhe Standardet Ndërkombëtare për Institucionet Supreme të Auditimit në sektorin publik. Sipas legjislacionit në fuqi, Auditori i Përgjithshëm është i pavarur në organizimin dhe me menaxhimin e Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Mjetet e punës:

- Korniza e INTOSAI-t për Standardet Profesionale të Auditimit (INTOSAI frameëork);
- Doracaku për Auditimin e Rregullsisë;
- Udhëzuesi për Kontrollin e Cilësisë së Auditimeve të Rregullsisë;
- Doracaku për Auditimin e Performancës;
- Doracaku për Auditimin e Teknologjisë së Informacionit;
- Udhëzuesi për përcjelljen e rekomandimeve të performancës;
- Udhëzuesi i Auditimit për Mashtrim;
- Kodi i Etikës;
- Plani Strategjik i ZKA-së 2018 - 2021;
- Politikat dhe strategjitë e tjera sekondare.

Zhvillimi profesional i stafit

ZKA përkrah stafin auditues që të ndjek skemat e certifikimit për kontabilist dhe auditorë që ofrohen nga shoqatat profesionale vendore. Gjatë vitit 2020 janë mbajtur një sërë aktivitetesh që ndërlidhen me zhvillimin profesional dhe trajnimin. Edhe pse nën rrethanat e punës në distancë dhe në respektim të masave të përcaktuara nga Qeveria për tu mbrojtur nga pandemia me COVID-19, përmes platformave online ne kemi arritur të realizojmë planin vjetor të trajnimeve ndërsa vlen të theksohet se përveç trajnimeve të brendshme punonjësit e ZKA-së kanë përfituar edhe nga trajnimet e ofruara nga institucionet tjera vendore dhe ndërkombëtare.

I gjithë stafi auditues (rreth 140 sish) në periudhën shtator -tetor 2020, kanë ndjekur programin e trajnimeve për Manualin e azhurnuar të auditimit financiar dhe pajtueshmërisë si dhe trajnimin për përdorimin e Sistemit Elektronik të Auditimit (SITA). Këto dy trajnime ishin në fokus të veçantë në fazën e përgatitjeve për sezonin e re audituese 2020/2021. Gjithashtu, 80 auditor kanë ndjekur trajnimet e rregullta për edukimin e vazhdueshëm profesional të organizuara nga Shoqatat Profesionale të Auditimit SHKÇAK dhe IKAF; auditorët e TI-së kanë ndjekur dy trajnime profesionale në fushën TI-së, njëra e organizuara nga Iniciativa për Zhvillim e INTOSAI-t dhe tjetra nga Qendra për Ekselencë në Financa e Lbujanës; 15 auditorë janë trajnuar në auditimin e projekteve të financuara nga Banka Botërore rregullat e prokurimit publik sipas Bankës Botërore si dhe 31 auditor janë trajnuar në rregullat e komunikimit dhe paraqitjes publike i organizuar nga BIRN në kuadër të projektit trepalësh në mes të Zyrës Kombëtare të Auditimit, Qeverisë Holandeze dhe BIRN.

Në kuadër të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) dhe trupave të saj, gjatë vitit 2020, përmes platformave të komunikimit online janë organizuar një sërë trajnimesh, ëëbinare dhe takime konsultuese me tematikë në fushën e auditimit, menaxhimit dhe sigurimit të kontrollit dhe cilësisë sidomos në përballjen me pandeminë COVID-19. Stafi auditues i ZKA-së ka marrë pjesë dhe ka përfituar nga programet dhe aktivitetet profesionale varësisht nga interesi institucional dhe duke u kujdesur që mos të pengohen angazhimet në punën e tyre të përditshme.

Skema e Certifikimit për Auditorët e Rregullsisë

Një program i certifikimit për Auditim të Rregullsisë është i vendosur dhe zbatohet bazuar në standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit për sektor publik (SNISA). Programi është i ndarë në katër pjesë: Hyrja, Përgatitja, Pjesa Teknike dhe Zhvillim i Vazhdueshëm Profesional. Pjesa teknike kryhet nga një shoqatë vendore¹⁵ e certifikuar nga IFAC. Programi financohet nga buxheti i Kosovës. Koha që zakonisht është 3.5 vite për t'u certifikuar dhe ky vendim i certifikimit merret bazuar në rezultatet e provimeve, përvojën dhe rezultatet e vlerësimeve të stafit.

Skema e Certifikimit për Auditorët e Performancës

Programi i certifikimit për auditorët e performancës është zbatuar dhe certifikimet për 18 auditorë janë dhënë në shkurt 2020.

Lidhur me **mbrojtjen e parasë kundër falsifikimit në Republikën e Kosovës**, në vazhdimin e bashkëpunimit reciprok ndërmjet Policisë së Kosovës (PK-ja) dhe Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK-ja) me qëllim të sigurimit të mbrojtjes së parasë kundër falsifikimit në Republikën e Kosovës, më 11 shtator 2009 PK-ja dhe BQK-ja kanë nënshkruar marrëveshjen mbi themelimin e Komitetit Qendror të Analizave të Parave të Falsifikuara (Komiteti).

Komiteti është i përbërë nga tre përfaqësues të lartë të PK-së dhe tre përfaqësues të lartë të BQK-së. Përfaqësuesit e Komitetit takohen në suaza të rregullta me qëllim të shqyrtimit të çështjeve që dalin nga roli i këtij komiteti. Komiteti nuk ka fuqi vendimmarrëse.

Roli kryesor i komitetit është:

- Përforcimi i masave të nevojshme me qëllim të shmangies së kartëmonedhave dhe monedhave të falsifikuara nga qarkullimi;

¹⁵ Shoqata e Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës.

- Mbledhja, analizimi dhe publikimi i të dhënave teknike dhe statistikore lidhur me kartëmonedhat dhe monedhat e falsifikuara; dhe
- Sigurimi i informatave dhe udhëzime si dhe trajnimeve për institucionet financiare, institucionet e tjera relevante dhe publikun e gjerë në lidhje me kartëmonedhat dhe monedhat e falsifikuara.

Komiteti ka kompetenca të themelojë grupe punuese sipas nevojës për të studiuar më tutje çështjet e caktuara dhe për t'i bërë rekomandime mbi atë çështje Komitetit. Grupet punuese do të kenë statusin *ad hoc* me mandat dhe kornizë kohore të qartë.

Në Republikën e Kosovës, organi kompetent për analizën dhe ekspertizën e parave që dyshohet të jenë të falsifikuara është Agjencia Kosovare për Forenzikë - Laboratori për dokumente dhe dorëshkrime, i cili vepron në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme (më parë kishte operuar në kuadër të PK).

Mbështetja e donatorëve

MFPT është duke u përkrahur nga projekti i Qeverisë së Norvegjisë, qëllimi i këtij projekti është të mbështesë administratën publike të Kosovës në zbatimin e MSA-së dhe rritjen e gatishmërisë për anëtarësim në BE në disa kapituj përfshirë statistikat. Ky projekt do të forcojë kapacitetet institucionale të administratës publike të Kosovës, specifikisht në kapitullin Kontrolli Financiar përmes ofrimit të trajnimeve të specializuara për përmbajtjen e kërkesave dhe kërkesave që rrjedhin nga BE, transpozimin e akteve të *acquis* në legjislacionin kombëtar, si dhe në reformat e politikave përkatëse. Për pjesën e parë të vitit 2020 planifikohen tre aktivitete në këtë fushë si trajnimi mbi përmbledhjen e fushës në kapitullin 32 Kontrolli Financiar, pjesa e Kontrollit të Brendshëm e Financave Publike, trajnimi mbi sigurimin dhe cilësinë e informacionit nga OB përmes pyetësorëve vet-vlerësues ose përmes monitorimit direkt, si dhe një trajnim mbi parimet dhe kërkesat kryesore të kapitullit 32 Kontrolli Financiar.

MFPT është duke u përkrahur nga programi IPA i Bashkimit Evropian për Kosovën, përmes projektit “Ndihmë teknike për mbështetjen e zbatimit të Reformave për Menaxhimin e Financave Publike në Kosovë nr. i kontratës 2019/413-800”. Qëllimi i këtij projekti është të përmirësoj dhe fuqëzoj politikën, legjislacionin dhe kapacitetet e palëve kryesore të interesit (veçanërisht Grupit koordinues për menaxhimin e financave publike) të përfshirë në zbatimin e Reformës në Sektorin e Menaxhimit të Financave Publike duke ofruar asistencë teknike për të mbështetur zbatimin e reformave të menaxhimit të financave publike. Për ngritjen e kapaciteteve në fushën për KBFP gjatë viti 2020 NJQH është duke u përkrahur edhe nga USAID-i përmes projektit “ Komunitat transparente, efektive dhe llogaridhënëse (TEAM) aktiviteti në Kosovë.

Objektivat prioritare afatmesme

Në planin afatmesëm, prioritetet kryesore **zbatuese** që parashikohet të realizohen janë si në vijim:

Kontrolli i brendshëm i financave publike

- Hartimin i një dokumenti të ri të politikave për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike;
- Avancimi dhe integrimi i sistemeve të teknologjisë informative që përdoren në Ministrinë e Financave me qëllim të përmirësimit të cilësisë së informatave financiare;
- Përmirësimi i buxhetimit sipas programit dhe raportimit me objektiva dhe tregues të performancës (planifikimi strategjik lidhet me burimet buxhetore);
- Trajnimi për menaxherët e të gjitha institucioneve për zbatimin e llogaridhënies menaxheriale dhe trajnimi i auditorëve të brendshëm;
- Monitorimi i kontrollit të brendshëm në OB;
- Zbatimi i Librit të Përshkrimit të proceseve.
- Përmirësimi i cilësisë së auditimit të brendshëm përmes monitorimit të njësive të auditimit të brendshëm;

Auditimi i jashtëm

- Të krijohet baza për të hequr detyrimin për të kryer auditime të rregullsisë çdo vit në të gjitha organizatat buxhetore dhe futja e qasjes së auditimit të bazuar në rrezik përmes ndryshimeve të nevojshme në Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Kosovës.

- Zhvillimi i mëtejshëm i relevancës së auditimit duke kryer në mënyrë gradual më shumë auditime të performancës;
- Përcjellja më sistematike për zbatim në kohë të rekomandimeve të auditimit të jashtëm;
- Fillimi i zbatimit të udhëheqjes sipas sistemit të menaxhimit të buxhetit;
- Të vazhdohet me prodhimin e Raportit Vjetor të Auditimit në kohë, me cilësi më të mirë dhe rekomandime efektive, bazuar në relevancë më të madhe të auditimit;
- Zhvillimi i mëtejshëm i auditimeve të TI;
- Fokusim më i madh në fushat e interesit për menaxhim të decentralizuar të fondeve të IPA;
- Përmirësimi i cilësisë së auditimeve të obligueshme të Rregullsisë dhe auditimeve jo-statutore të Performancës përmes rritjes së kontrollit të cilësisë për fazat e planifikimit, ekzekutimit dhe raportimit;
- Të përmbushë misionin kushtetues e ligjor duke kryer auditime relevante, në përputhje me Kornizën e INTOSAI-t për Standardet Profesionale të Auditimit;
- Të zhvillojë dhe të forcojë kapacitetin institucional për të mbështetur auditimin dhe Qeverisjen korporative; dhe
- Të zhvillojë dhe të mirëmbajë marrëdhënie të mira me palët e jashtme, duke promovuar auditimin, rritur ndikimin dhe duke u integruar në organizatat globale dhe rajonale të ISA-ve.

3.33. Kapitulli 33 i acquis-së: Dispozitat financiare dhe buxhetore

Ky kapitull mbulon rregullat lidhur me burimet financiare të nevojshme për financimin e buxhetit të BE-së (burimet vetjake). Këto burime përbëhen kryesisht nga kontributet e shteteve anëtare, bazuar në burimet e veta tradicionale nga dogana dhe taksat bujqësore dhe të sheqerit; në burime të bazuara në tatimin mbi vlerën e shtuar dhe në burime të bazuara në nivelin e të ardhurave kombëtare bruto. Shtetet Anëtare duhet të kenë kapacitete të duhura administrative për të koordinuar në mënyrë adekuate dhe për të siguruar llogaritjen e saktë, mbledhjen, pagesën dhe kontrollin e burimeve të veta. Acquis në këtë fushë është drejtpërdrejt e detyrueshme dhe nuk kërkon transpozim në legjislacionin kombëtar.

Kërkesat MSA-së

Neni 74 i MSA-së kërkon përafrimin e legjislacionit të Kosovës me Acquis të BE-së, që përfshin edhe këtë kapitull.

Gjendja aktuale

Korniza legjislative

Aktet ligjore kryesore relevante për këtë Kapitull përfshijnë:

- Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë;
- Ligji nr. 07/L-014 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit me nr 07/L-001 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020;
- Ligji nr. 05/L-037 për Tatimin Mbi Vlerën e Shtuar;
- UA MF-nr. 03/2015 për zbatimin e ligjit nr. 05/L-037 për tatimin mbi vlerën e shtuar;
- Ligji nr. 04/L-099 për amendamentimin e Kodit nr. 03/L-109 Doganor dhe të Akcizave të Kosovës;
- UA MF-nr. 05/2014 për plotësimin dhe ndryshimin e Udhëzimit Administrativ nr. 11/2009 për zbatimin e kodit doganor dhe të akcizave, të plotësuar dhe ndryshuar me UA nr. 05/2010 dhe me UA nr. 06/2013.

Sistemi i Tatimit mbi Vlerën e Shtuar në territorin e Republikës së Kosovës rregullohet me Ligjin nr. 05/L-037 për Tatimin Mbi Vlerën e Shtuar. Tatimi mbi Vlerën e Shtuar përfshinë aplikimin e tatimit të përgjithshëm në konsum për mallra dhe shërbime, që është saktësisht proporcional me çmimin e mallrave dhe shërbimeve, dhe e cila llogaritet në këtë çmim sipas normës së aplikueshme, ngarkohet në fazat e ndryshme të prodhimit, shpërndarjes dhe ciklit jetësor të tregtisë së mallrave dhe shërbimeve, që në fund bartet nga konsumatori i fundit.

TVSh ngarkohet me normën standarde prej tetëmbëdhjetë për qind (18%), ndërsa norma e reduktuar në llogaritet dhe paguhet prej 8% për disa mallra dhe shërbime bazike, si dhe importit të tyre.

Procedurat e mbledhjes dhe të kontrollit për detyrimet doganore dhe taksat e importit kryhen nga Dogana e Kosovës. Dogana e Kosovës është nën autoritetin e funksioneve të Ministrisë së Financave, në bazë të Ligjit nr. 03/L-109 i datës 10 nëntor 2008 dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/L-099, i datës 3 maj 2012 Kodi Doganor dhe Akcizave të Kosovës. Ky ligj është pjesërisht në harmoni me Kodin Doganor të BE-se, me konkretisht me Rregulloren e Këshillit (KEE) 2913/92 për Themelimin e Kodit Doganor Komunitar.

Sa i përket Buxhetit, bazuar në nenin 5 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Departamenti i Buxhetit është i autorizuar dhe përgjegjës për:

- Përgatitjen e Propozim Buxhetit të Republikës së Kosovës,
- Përgatitjen e Kornizës *Afatmesme* të Shpenzimeve,
- Zbatimin e Buxhetit të Republikës së Kosovës,
- Vlerësimin e kërkesave për ndryshimin e ndarjeve buxhetore,
- Vlerësimin e ndikimit buxhetor të nismave të reja qeveritare dhe
- Ushtrimin e të gjitha përgjegjësiave të tjera të cilat i janë dhënë Departamentit të Buxhetit me ligj.

Korniza institucionale

Institucioni kryesor për këtë kapitull është Ministria e Financave. Në kuadër të MFPT-së strukturat kontribuuese janë Administrata Tatimore e Kosovës dhe Dogana e Kosovës. Në kuadër të MFPT-së funksionon Departamenti i Buxhetit, si dhe Departamenti për Politika Ekonomike, Publike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar.

Objektivat prioritarë afatmesme:

- Përgatitja e Kornizës *Afatmesme* të Shpenzimeve si bazë për zhvillimin e projeksioneve buxhetore vjetore.

3.34. Kapitulli 34 i acquis-së: Institucionet

Ky kapitull i acquis-së nuk mbulohet nga ky program në këtë fazë të aderimit në BE.

3.35. Kapitulli 35 i acquis-së: Çështjet e tjera

Ky kapitull i acquis-së nuk mbulohet nga ky program në këtë fazë të aderimit në BE.

MATRICA E MASAVE AFATSHKURTA

MASAT LEGJISLATIVE

Nr.	Dispozitat e MSA-së	Aktet kombëtarë që do të harmonizohen	Aktet e acquis-së së BE-së që do të transpozohen	Institucioni përgjegjës	Institucionet mbështetëse	Afatet kohore	Niveli i harmonizimit	Buxheti		
								BRK	Donatorët	Gjithsej
1. BLOKU I: KRITERET POLITIKE										
1.1. Demokracia dhe sundimi i ligjit										
1.1.1. Kushtetuta, Parlamenti dhe sistemi zgjedhor										
1.1.1.	<u>Legjislacioni kornizë</u>									
1.1.1.1	Neni 120	Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës (rregullore e re), e miratuar	Asnjë akt	Kuvendi		K4 2021		10,000	0	10,000
1.1.1.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>									
1.1.1.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
1.1.2. Administrata publike										
1.1.2.	<u>Legjislacioni kornizë</u>									
1.1.2.1	Neni 120	Projektligji për paga në sektorin publik, i miratuar	Asnjë akt	MPB	ZKM	K4 2021		5,000	0	5,000
1.1.2.2	Neni 120	Projektligji për zyrtarët publik, i miratuar	Asnjë akt	MPB	ZKM	K4 2021		5,000	0	5,000
1.1.2.3	Neni 120	Projektligji për valën e parë të racionalizimit të agjencive dhe institucioneve të pavarura (projektligj i ri), i miratuar	Asnjë akt	MPB		K3 2021		5,000	0	5,000
1.1.2.4	Neni 120	Projektligji për valën e dytë dhe të tretë të racionalizimit të agjencive dhe institucioneve të pavarura (projektligj i ri), i miratuar	Asnjë akt	MPB		K4 2021		5,000	0	5,000
1.1.2.5	Neni 120	Projektligji për inspektimin administrativ, i miratuar	Asnjë akt	MPB	ZKM	K4 2021		5,000	0	5,000
1.1.2.6	Neni 120	Projektligji për sistemin e menaxhimit të performancës dhe skemës së grantit për performancë komunale (projektligj i ri), i miratuar	Asnjë akt	MAPL		K4 2021		10,440	3,500	13,940
1.1.2.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>									
1.1.2.7	Neni 120	Gjashtë (6) rregullore për zbatimin e Ligjit për zyrtarët publik, të miratuara	Asnjë akt	MPB	ZKM	K4 2021		6,000	0	6,000
1.1.3. Avokati i Popullit										
1.1.3.	<u>Legjislacioni kornizë</u>									

1.1.3.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
1.1.3.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>									
1.1.3.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
1.1.4. Mbikëqyrja civile e forcave të sigurisë										
1.1.4.	<u>Legjislacioni kornizë</u>									
1.1.4.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
1.1.4.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>									
1.1.4.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
1.2. Bashkëpunimi rajonal dhe obligimet ndërkombëtare										
1.2.	<u>Legjislacioni kornizë</u>									
1.2.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
1.2.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>									
1.2.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
2. BLOKU II: KRITERET EKONOMIKE										
2.1. Ekzistenca e ekonomisë funksionale të tregut										
2.1.	<u>Legjislacioni kornizë</u>									
2.1.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
2.1.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>									
2.1.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
2.2. Kapaciteti për t'u përballur me presionin e konkurrencës dhe forcat e tregut brenda Unionit										
2.2.	<u>Legjislacioni kornizë</u>									
2.2.1	Neni 25, 43, 75, 93, 94, 96, 98, 106, 107, 121, 123	Projektligji për ndërmarrjet publike (plotësim-ndryshim), i miratuar	Asnjë akt	ME	AKP	K4 2021		7,200	0	7,200
2.2.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>									
2.2.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3. BLOKU III: STANDARDET EVROPIANE – PËRAFRIMI I LEGJISLACIONIT TË KOSOVËS ME ACQUIS-NË E BE-SË										
3.0. Korniza ligjore për përfrimin e legjislacionit të Kosovës me acquis-në e BE-së										
3.0.	<u>Legjislacioni kornizë</u>									
3.0.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.0.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>									
3.0.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.1. Kapitulli 1 i acquis-së: Lëvizja e lirë e mallrave										
3.1.	<u>Legjislacioni kornizë</u>									
3.1.1	Neni 20, 80 dhe 73, pika 3	Projektligji për inspektime (projektligj i ri), i miratuar	Asnjë akt	MINT		K4 2021		2,500	0	2,500
3.1.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>									
3.1.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.2. Kapitulli 2 i acquis-së: Liria e lëvizjes së punonjësve										
3.2.	<u>Legjislacioni kornizë</u>									
3.2.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.2.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>									

3.2.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.3. Kapitulli 3 i acquis-së: E drejta e themelimit dhe liria e ofrimit të shërbimeve										
3.3.	<u>Legjislacioni kornizë</u>									
3.3.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.3.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>									
3.3.1	Neni 51, 56, 57, 58, 59 dhe 74.	UA për organizimin dhe funksionimin e organit profesional, i miratuar	Direktiva 2005/36/BE	MAShTI		K4 2021	P	4,454	0	4,454
3.3.2	Neni 51, 56, 58 të MSA-së	Regullorja për ndarjen e llogarive dhe llogaritjen e kostos neto të ofrimit të shërbimit universal postar, e miratuar	Direktiva 97/67/BE	ARKEP	ME	K4 2021	T	2,025	0	2,025
3.4. Kapitulli 4 i acquis-së: Lëvizja e lirë e kapitalit										
3.4.	<u>Legjislacioni kornizë</u>									
3.4.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.4.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>									
3.4.1	Neni 89	UA për Pronarin Përfitues, i miratuar	Direktiva 2018/843	MFPT		K3 2021	P	3,285	0	3,285
3.5. Kapitulli 5 i acquis-së: Prokurimi publik										
3.5.	<u>Legjislacioni kornizë</u>									
3.5.1	Neni 79	Projektligji për partneritetin publiko-privat (plotësim-ndryshim), i miratuar	Direktiva 2014/23/BE	MFPT		K4 2021	P	2,300	0	2,300
3.5.2	Neni 79	Projektligji për prokurim publik (plotësim-ndryshim), i miratuar	Direktiva 2014/24/EU për Prokurimin ne Sektorin Klasik ; Direktiva 2014/25/EU për Shërbime/Utilitete ; Direktiva 2009/81/EC; Direktiva e Këshillit 89/665/EEC; Direktiva e Këshillit 92/13/EEC.	MFPT	KRPP AQP OSHP	K4 2021	P	14,470	0	14,470
3.5.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>									
3.5.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.6. Kapitulli 6 i acquis-së: E drejta e kompanive										
3.6.	<u>Legjislacioni kornizë</u>									
3.6.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.6.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>									
3.6.1	Neni 51, pika 1, 2, 4	UA për përfaqesuesit e huaj, i miratuar	Direktiva 2017/1132/KE,e amendamentuar	MINT		K3 2021	P	1,500	0	1,500
3.6.2	Neni 51, pika 1, 2, 4	UA për hetim dhe disiplinë, i miratuar	Direktiva 2006/43/KE e amendamentuar	MFPT		K3 2021	P	3,750	0	3,750
3.7. Kapitulli 7 i acquis-së: E drejta e pronësisë intelektuale										
3.7.	<u>Legjislacioni kornizë</u>									
3.7.1	Nenet 77 dhe 78	Projektligji për sekretet tregtare (projektligj i ri), i miratuar	Direktiva (BE) 2016/943 Direktiva (BE) 48/2004	MINT	MKRS	K4 2021	T	3,000	10,150	13,150

3.7.2	Nenet 77 dhe 78	Projektligji për patenta (plotësim-ndryshim), i miratuar	Direktiva (BE) 98/44 Rregulloja 469/2009 Rregulloja 1610/96 Rregulloja 816/2006 Rregulloja 2019/933 Direktiva (BE) 48/2004	MINT	MKRS	K3 2021	T	3,000	10,150	13,150
3.7.3	Nenet 77 dhe 78	Projektligji për markat tregtare (plotësim-ndryshim), i miratuar	Rregulloja 2017/1001 Direktiva (BE) 2015/2436 Direktiva (BE) 48/2004	MINT	MKRS	K3 2021	T	3,000	10,150	13,150
3.7.4	Nenet 77 dhe 78	Projektligji për përcaktimin e të drejtave dhe mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara (projektligji i ri), i miratuar	Direktiva (BE) 87/54 Direktiva (BE) 48/2004	MINT	MKRS	K4 2021	T	3,000	10,150	13,150
3.7.5	Nenet 77 dhe 78	Projektligji për dizajnin industrial (plotësim-ndryshim), i miratuar	Direktiva 98/71/KE Direktiva (BE) 48/2009	MINT	MKRS	K4 2021	T	3,000	10,150	13,150
3.7.6	Nenet 77 dhe 78	Projektligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta (plotësim-ndryshim), i miratuar	Direktiva BE 2019/790 Direktiva 2014/26/BE	MKRS		K4 2021	T	4,000	0	4,000
3.7.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>									
3.7.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.8. Kapitulli 8 i acquis-së: Politikat e konkurrencës										
3.8.	<u>Legjislacioni kornizë</u>									
3.8.	Konkurrenca									
3.8.1	Nenet 74 dhe 75	Projektligji për konkurrencë (plotësim-ndryshim), i miratuar	Rregulloja e Këshillit (KE) Nr. 1/2003; Rregulloja e Komisionit (KE) Nr. 773/2004; Rregulloja e Komisionit (BE) 330/2010	MINT	AKK	K3 2021	T	1,500	0	1,500
3.8	Ndihma shtetërore									
3.8.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.8.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>									
3.8.	Konkurrenca									
3.8.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.8.	Ndihma shtetërore									
3.8.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.9. Kapitulli 9 i acquis-së: Shërbimet financiare										
3.9.	<u>Legjislacioni kornizë</u>									
3.9.1	Neni 50, 96 dhe aneksit 6	Projektligji për mikrofinanca dhe për institucionet financiare jobankare (plotësim-ndryshim), i miratuar	Asnjë akt	MFPT	Kuvendi	K4 2021	P	7,000	0	7,000
3.9.2	Neni 50, 96 dhe aneksit 6	Projektligji për bankat (plotësim-ndryshim), i miratuar	Asnjë akt	MFPT	BQK	K4 2021	P	2,800	0	2,800

3.9	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>									
3.9.3	Neni 50, 96 dhe aneksit 6	Rregulla në fushën e pensioneve dhe siguruesit, e miratuar	Direktiva 2003/41/KE e parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 3 Qershorit 2003 "Mbi aktivitetin dhe mbikëqyrjen e institucioneve të pensioneve profesionale" (versioni i konsoliduar CELEX:02003L0041-20130620)	BQK		K4 2021	P	3,500	0	3,500
3.9.4	Neni 50, 96 dhe aneksit 7	Rregullorja për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit (plotësim-ndryshim), e miratuar	Rregullore e Deleguar nga Komisioni (BE) 2015/61	BQK		K3 2021	P	2,800	0	2,800
3.10. Kapitulli 10 i acquis-së: Shoqëria e informacionit dhe mediat										
3.10.	<u>Legjisllacioni kornizë</u>									
3.10.1	Neni 109, 110 dhe 111	Projektligji për masat e sigurisë së rrjeteve dhe sistemeve të informacionit (projektligj i ri), i miratuar	Direktiva e BE-së nr. 2016/61/BE Direktiva (BE) 2016/1148 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 6 korrikut 2016 në lidhje me masat për një nivel të lartë të përbashkët të sigurisë së rrjetit dhe sistemeve të informacionit në tërë Unionin	ME	ARKEP AKK MAPL	K4 2021	T	3,000	0	3,000
3.10.2	Neni 109, 110 dhe 111	Projektligji për masat për uljen e kostos së shtrirjes së rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartët (projektligj i ri), i miratuar	Direktiva e BE-së nr. 2016/61/BE Direktiva (BE) 2016/1148 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 6 korrikut 2016 në lidhje me masat për një nivel të lartë të përbashkët të sigurisë së rrjetit dhe sistemeve të informacionit në tërë Unionin	ME	ARKEP AKK MAPL	K3 2021	T	3,000	0	3,000
3.10.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>									
3.10.3	Neni 109, 110 dhe 111	Rregullorja për pronësi të mediave dhe parandalim të koncentrimit të mediave (akt nënligjor i ri), e miratuar	Direktiva për Shërbimet Mediale Audio-Vizuale - AVMSD	KPM		K4 2021	P	18,150	0	18,150
3.10.4	Neni 109, 110 dhe 111	Rregullorja për komunikimet komerciale audio-vizuale (plotësim-ndryshim), e miratuar	Direktiva për Shërbimet Mediale Audio-Vizuale - AVMSD	KPM		K4 2021	P	10,500	0	10,500
3.10.5	Neni 109, 110 dhe 111	Rregullorja për mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audio dhe audiovizuale (plotësim-ndryshim), e miratuar	Direktiva për Shërbimet Mediale Audio-Vizuale - AVMSD	KPM		K4 2021	P	6,000	0	6,000
3.10.6	Neni 109, 110 dhe 111	Rregullorja për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, e miratuar	Kodi për Komunikime elektronike Direktiva (BE) 2018/1972	ARKEP		K4 2021	P	3,308	0	3,308
3.10.7	Neni 109, 110 dhe 111	Rregullorja për kontratat e parapaguesve (plotësim-ndryshim), e miratuar	Kodi për Komunikime elektronike Direktiva (BE) 2018/1972	ARKEP		K4 2021	T	3,308	0	3,308
3.11. Kapitulli 11 i acquis-së: Bujqësia dhe zhvillimi rural										

3.11.	<u>Legjislacioni kornizë</u>									
3.11.1	Neni 102	Projektligji për bujqësi dhe zhvillim rural (projektligji i ri), i miratuar	<p>Rregullore (BE) nr. 1305/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 17 dhjetor 2013, për mbështetjen e zhvillimit rural nga Fondi Bujqësor Evropian për Zhvillim Rural (FBEZHR) dhe që shfuqizon Rregulloren e Këshillit (EC) nr. 1698/2005;</p> <p>Rregullore (BE) nr. 1306/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 17 dhjetor 2013, për financimin, menaxhimin dhe monitorimin e politikës së përbashkët bujqësore dhe që shfuqizon rregulloret e Këshillit (KEE) nr. 352/78, (EC) nr.165/94, (EC) nr. 2799/98, (EC); nr. 814/2000, (EC) nr. 1290/2005 dhe (EC) nr. 485/2008;</p> <p>Rregullore (BE) nr. 1307/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 17 dhjetor 2013, që përcakton rregullat për pagesat direkte për fermerët sipas skemave të mbështetjes në kuadër të politikës së përbashkët bujqësore dhe që shfuqizon Rregulloren e Këshillit (EC) nr. 637/2008 dhe Rregulloren e Këshillit (EC) nr. 73/2009;</p> <p>Rregullore (BE) nr. 1308/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 17 dhjetor 2013, që themelon organizatën e përbashkët të tregjeve në produktet bujqësore dhe që shfuqizon rregulloret e Këshillit (KEE) nr. 922/72, (KEE) nr. 234/79, (EC) nr.1037/2001 dhe (EC) nr. 1234/2007;</p> <p>Rregullore zbatuese të Komisionit (EE) nr. 447/2014, të datës 2 maj 2014, për rregullat specifike për zbatimin e Rregullores (BE) nr. 231/2014 Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për krijimin e Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II);</p> <p>Rregullore e Këshillit (EC) nr. 21/2004 të datës 17 dhjetor 2003 që krijon sistemin për identifikimin dhe regjistrimin e dhenve dhe dhive dhe që ndryshon Rregulloren (EC) nr. 1782/2003 si dhe Direktivën 92/102/KEE dhe Direktivën 64/432/KEE</p> <p>Rregullore (BE) nr. 1144/2014 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 22 tetor 2014, për masat e ofrimit dhe promovimit të</p>	MBPZhR	MFPT ZKM	K4 2021	P	150	0	150

			informacionit në lidhje me produktet bujqësore të zbatuara në tregun e brendshëm dhe në vendet e treta dhe që shfuqizon Rregulloren e Këshillit (EC) nr. 3/2008; Rregullore e Këshillit (EC) nr. 834/2007 të datës 28 qershor 2007 për prodhimin organik dhe etiketimin e produkteve organike dhe që shfuqizon Rregulloren (KEE) nr. 2092/91; Rregullore (BE) nr. 1151/2012 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 21 nëntor 2012, për skemat e cilësisë për produktet bujqësore dhe produktet ushqimore; Rregullore e Këshillit (EC) nr. 1217/2009 të datës 30 nëntor 2009 për krijimin e një rrjeti për mbledhjen e të dhënave të kontabilitetit mbi të ardhurat dhe operimin e biznesit të fermave bujqësore në Komunitetin Evropian.								
3.11.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>										
3.11.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.										
3.12. Kapitulli 12 i acquis-së: Politikat e sigurisë së ushqimit, fitosanitare dhe ato të veterines											
3.12.	<u>Legjislacioni kornizë</u>										
3.12.1	Neni 102	Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-016 për Ushqimin, i miratuar	Rregullorja nr. 178/2002 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian për përcaktimin e parimeve dhe kërkesave të përgjithshme të ligjit për ushqimin, krijimin e Autoritetit Evropian për Siguri Ushqimore dhe parashtrimin e procedurave që i përkasin sigurisë ushqimore;	MBPZHR	MFPT MINT MMPHI ZKM	K4 2021	P	2,400	0	2,400	
3.12.2	Neni 102	Projektligji për pijet e forta alkoolike (projektligji i ri), i miratuar	Rregullorja (BE) 2019/787 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 17 Prillit 2019 për përcaktimin, përshkrimin, prezantimin dhe etiketimin e pijeve të forta alkoolike, përdorimin e emrave të pijeve të forta alkoolike në prezantimin dhe etiketimin e produkteve të tjera ushqimore, mbrojtjen e indikatorëve gjeografik për pije alkoolike, përdorimin e alkoolit etilik dhe distilatet me origjinë bujqësore në pije alkoolike, e cila e shfuqizon Rregulloren (KE) Nr. 110/2008; Rregullorja implementuese (BE) Nr. 716/2013 që përcakton rregullat për aplikimin e Rregullores (EC) Nr. 110/2008 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian për përkufizimin, përshkrimin, paraqitjen, etiketimin dhe mbrojtjen e treguesve gjeografik të pijeve alkoolike;	MBPZHR	MFPT MMPHI ZKM	K4 2021	P	900	0	900	

			Rregullorja (EC) nr. 1334/2008 e Parlamentit dhe e Këshillit për aromatizues dhe përbërës të caktuar të ushqimit me veti aromatizuese për përdorim në/dhe ushqim dhe ndryshimin e Rregullores së Këshillit (EEC) nr. 1601/91, Rregulloreve nr.2232/96 dhe (EC) nr.110/2008 dhe Direktivës (EC) nr. 2000/13 (Gazeta Zyrtare L 354, 31.12.2008); Rregullorja (KE) nr. 1333/2008 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit 16 dhjetor 2008 për aditivët e ushqimit; Rregullorja e Komisionit (EU) 2015/210 të datës 10 Shkurt 2015 për ndryshimin e Aneksve II dhe III të Rregullores (EC) Nr. 110/2008 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian për përkufizimin, përshkrimin, paraqitjen, etiketimin dhe mbrojtjen e treguesve gjeografik të pijeve alokoolike; Direktiva e Këshillit nr. 98/83 mbi cilësinë e ujit të destinuar për konsum njerëzor (Gazeta Zyrtare L 330, 5.12.1998); Direktiva e Këshillit Nr.2001/110 në lidhje me mjaltën, (Gazeta Zyrtare L 010, 12/01/2002); Direktiva e Këshillit Nr. 2001/111 në lidhje me sheqernat e caktuara të destinuar për konsum njerëzor (Gazeta Zyrtare L 10 of 12.1.2002).								
3.12.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>										
3.12.3	Neni 102	UA mbi përcaktimin e rregullave shëndetësore për nënproduktet e kafshëve dhe derivatet e tyre, të cilat nuk janë të destinuar për konsum njerëzor (akt nënligjor i ri), i miratuar	Rregullorja nr. 1069/2009 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit që parashtron rregullat e shëndetit në lidhje me nënproduktet shtazore dhe produkteve që rrjedhin nga to jo të destinuar për konsum njerëzor qe shfuqizon Rregulloren (KE) nr. 1774/2002 (Rregullorja mbi nenproduktet shtazore).	AUV	MBPZHR ZKM MMPHI MAPL	K3 2021	P	1,200	0	1,200	
3.12.4	Neni 102	UA për implementimin e UA-së mbi përcaktimin e rregullave shëndetësore për nënproduktet e kafshëve dhe derivatet e tyre, të cilat nuk janë të destinuar për konsum njerëzor (akt nënligjor i ri), i miratuar	Rregullorja e Komisionit nr. 142/2011 që implementon Rregulloren nr. 1069/2009 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e cila parashtron rregullat e shëndetit në lidhje me nënproduktet shtazore dhe produkteve që rrjedhin nga to jo të destinuar për konsum njerëzor dhe zbatimin e Direktives se Këshilli 97/78/KE në lidhje me mostra të caktuara dhe artikuj të cilet përjashtohen nga kontrollet veterinare në kufi nën këtë direktivë.	AUV	MBPZHR ZKM MMPHI MAPL	K4 2021	P	3,600	0	3,600	
3.13. Kapitulli 13 i acquis-së: Peshkataria											

3.13.	<u>Legjislacioni kornizë</u>										
3.13.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.										
3.13.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>										
3.13.1	Neni 103	UA për mbrojtjen e peshkut në ujërat e peshkimit, i miratuar	Asnjë akt	MBPZHR	MMPHI	K4 2021	P	2,700	0	2,700	
3.14. Kapitulli 14 i acquis-së: Politikat e transportit											
3.14.	<u>Legjislacioni kornizë</u>										
3.14.1	Neni 113	Projektligji për rrugët (plotësim-ndryshim), i miratuar	Direktiva 2004/52 / EC mbi sistemet e taksave rrugore, ndërveprimin e sistemeve elektronike të taksave rrugore. Direktiva 2010/40 / EC mbi kornizën për vendosjen e sistemeve të transportit inteligjent në fushën e transportit rrugor dhe për ndërlidhjet me mënyrat e tjera të transportit. Direktiva 2004/54 / EC mbi kërkesat minimale të sigurisë për tunelet në rrjetin rrugor trans-evropian Direktiva 2008/96 / EC mbi menaxhimin e sigurisë së infrastrukturës rrugore Direktiva e Këshillit 96/53 / EC që përcakton për disa automjete rrugore dimensionet maksimale të autorizuara në trafikun kombëtar dhe ndërkombëtar dhe peshat maksimale të autorizuara në trafikun ndërkombëtar. Direktiva 1999/62 / EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit mbi ngarkimin e automjeteve të mallrave të rënda për shfrytëzimin e disa rrugëve të caktuara.	MMPHI	MPB	K4 2021	P	3,375	0	3,375	
3.14.2	Neni 113	Projektligji për transportin rrugor (plotësim-ndryshim), i miratuar	Direktiva nr.1071/2009/KE për qasje në profesion të operatorëve të transportit rrugor Direktiva nr.1072/2009/KE për rregullat e përbashkëta në qasje në transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave Direktiva nr.1073/2009/KE për rregullat e përbashkëta për qasje në tregun ndërkombëtar për ekuipazhin e automjetit dhe shërbimet e transportit të udhëtarëve Rregullorja 2016/68 mbi procedurat dhe specifikimet e përbashkëta të nevojshme për ndërlidhjen e regjistrave elektronikë të kartave të shoferëve Rregullorja 165/2014 e BE e cila rregullon kohën e ngasjes dhe pushimit	MMPHI	MPB	K4 2021	P	3,375	0	3,375	
3.14.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>										

3.14.3	Neni 113	UA për homologim të automjeteve (plotësim-ndryshim), i miratuar	Direktiva 2007/46/EC për krijimin e një kornize për miratimin e automjeteve dhe rimorkiove të tyre, të sistemeve komponentëve dhe pjesëve të veçanta teknike të destinuara për automjete të tilla	MMPHI	MPB	K3 2021	P	3,375	0	3,375
3.14.4	Neni113	UA për kontrollim teknik të automjeteve (plotësim-ndryshim), i miratuar	Direktiva 2014/45 për kontrollimin periodik të rregullt.	MMPHI		K3 2021	P	3,375	0	3,375
3.14.5	Neni 113	UA për kushtet teknike të pjesëmarrjes së automjeteve në rrugë, i miratuar	Direktiva 2014/45/EC e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 3 prill 2014, për kontrollin teknik periodik të automjeteve motorike dhe mjeteve të bashkëngjitura dhe shfuqizimin e Direktivës 2009/40EC (GZ 127. 29. 4. 2014) Direktiva e Parlamentit dhe Këshillit Evropian 2007/38/EC e datës 11 korrik 2007, për vendosjen e mëvonshme të pasqyrave në automjetet e rënda transportuese të regjistruara në Bashkësi (GZ 184, 14. 7. 2007) Direktiva e Këshillit 92/6/EEC e datës 10 shkurt 1992, për instalimin dhe përdorimin e pajisjeve për kufizimin e shpejtësisë për kategori të caktuara të automjeteve motorike në Bashkësi (GZ 57, 2. 3. 1992) Direktiva 2002/85/EC e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 5 nëntor 2002, për ndryshimin e Direktivës së Këshillit 92/6/EEC për instalimin dhe përdorimin e pajisjeve për kufizimin e shpejtësisë në automjete motorike të caktuara në Bashkësi (GZ 327, 4. 12. 2002) Direktiva e Këshillit 91/671/EEC e datës 16 dhjetor 1991, për përdorimin e obligueshëm të rripave të sigurisë dhe sistemeve për lidhje të sigurt të fëmijëve në automjete (GZ 59, 28. 2. 2014) Direktiva zbatuese e Komisionit 2014/37/BE e datës 27 shkurt 2014, për ndryshimin e Direktivës së Këshillit 91/671/EEC në aspektin e përdorimit të obligueshëm të rripave të sigurisë dhe sistemeve të lidhjes së sigurt të fëmijëve në automjete (GZ 59, 28. 2. 2014) Rregullorja (EU) nr. 167/2013 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 5 shkurt 2013, për homologimin dhe mbikëqyrjen e tregut të traktorëve për bujqësi dhe pylltari (GZ 60, 2. 3.	MMPHI		K4 2021	P	3,375	0	3,375

			2013) Rregullorja (EU) nr. 168/2013 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 15 janar 2013, për homologimin dhe mbikëqyrjen e tregut të automjeteve me dy ose tri rrota dhe katërçkuletave (GZ 60, 2. 3. 2013). Rregullorja e Komisionit (EU) nr. 458/2011 e datës 12 maj 2011, për kërkesat për homologim të tipit të automjeteve motorike dhe rimorkiove të tyre lidhur me montimin e gomave të tyre dhe zbatimin e Rregullores (BE) nr. 661/2009 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian për kërkesat për homologim të tipit për sigurinë e përgjithshme të automjeteve motorike, rimorkiove të tyre dhe sistemeve, pjesëve përbërëse dhe njësisë të posaçme teknike të dedikuara për automjete të tilla. (GZ 124, 13. 5. 2011).							
3.14.6	Neni 113	UA për kontrollimin teknik mobil, i miratuar	Direktiva 2014/47/EC për kontrollimin e rregullsis teknike te automjeteve komerciale ne rruge.	MMPHI		K4 2021	P	1,125	0	1,125
3.14.7	Neni 113	Rregullorja për përcaktimin e kërkesave për performancën dhe interoperabilitetin e mbikëqyrjes (survejimit) për qiellin e vetëm evropian (plotësim-ndryshim), e miratuar	Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2020/587 e 29 Prillit 2020 për ndryshimin e Rregullores Zbatuese (BE) Nr 1206/2011 që përcakton kërkesat për identifikimin e avionëve për mbikëqyrje për qiellin e vetëm Evropian dhe Rregulloren Zbatuese (BE) Nr 1207/2011 që përcakton kërkesat për performancë dhe interoperabilitet të mbikëqyrjes për qiellin e vetëm evropian	AAC		K3 2021		1,050	0	1,050
3.14.8	Neni 113	Rregullore për ndryshimin e Rregulloreve 01/2020 dhe 17/2017 sa u përket kërkesave për menaxhimin e trafikut ajror/shërbimet e navigacionit ajror, dizajnimin të strukturës së hapësirës ajrore, cilësisë së të dhënave, sigurisë në pistë dhe shfuqizimin e Rregullores 08/2015, e miratuar	Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2020/469 e 14 Shkurt 2020 për ndryshimin e Rregullores (BE) Nr. 923/2012, Rregullorës (BE) Nr. 139/2014 dhe Rregullores (BE) 2017/373 në lidhje me kërkesat për administrimin e trafikut ajror / shërbimet e navigimit ajror , dizajni i strukturave të hapësirës ajrore dhe cilësia e të dhënave, siguria e pistës dhe shfuqizimi i Rregullores (KE) Nr. 73/2010	AAC		K4 2021		6,000	0	6,000

3.14.9	Neni 113	Rregullore për ndryshimin e Rregullores 1/2020 dhe 17/2017 sa i përket lëvizjes së automjeteve në aerodrome, formatit global të raportimit dhe aktiviteteve tjera në aerodrom, e miratuar	Draft Rregullore e Deleguar e Komisionit (BE) / ... që ndryshon Rregulloren e Komisionit (BE) Nr. 139/2014, Rregulloren Zbatuese (BE) 2017/373 dhe Rregulloren Zbatuese (BE) Nr. 923/2012 (titulli i rregullores që transpozohet ende nuk është përcaktuar nga BE)	AAC		K3 2021		1,500	0	1,500
3.14.10	Neni 113	Rregullore për ndryshimin e Rregullores 17/2017 në lidhje me kushtet dhe procedurat për deklarim nga organizatat përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve të menaxhimit të platformës (akt nënligjor i ri), e miratuar	Rregullorja e Deleguar e Komisionit (BE) 2020/1234 e 9 Qershorit 2020 për ndryshimin e Rregullores (BE) Nr. 139/2014 në lidhje me kushtet dhe procedurat për deklarimin nga organizatat përgjegjëse për sigurimin e shërbimeve të menaxhimit të platformës	AAC		K4 2021		1,800	0	1,800
3.14.11	Neni 13	Rregullore për ndryshimin e Rregullores (AAC) Nr. 5/2015 në lidhje me kërkesat për kompetencën e ekuipazhit të fluturimit dhe metodat e trajnimit, dhe në lidhje me raportimin, analizën dhe ndjekjen e ngjarjeve në aviacionin civil	Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2020/2193 e 16 Dhjetorit 2020 për ndryshimin e Rregullores (BE) Nr. 1178/2011 në lidhje me kërkesat për kompetencën e ekuipazhit të fluturimit dhe metodat e trajnimit, dhe në lidhje me raportimin, analizën dhe ndjekjen e ngjarjeve në aviacionin civil	AAC		K3 2021		1,800	0	1,800
3.14.12	Neni 13	Rregullore për ndryshimin e Rregullores (AAC) Nr. 1/2019 në lidhje me kërkesat për kompetencën e ekuipazhit të fluturimit dhe metodat e trajnimit dhe shtyrjen e datave të zbatimit të masave të caktuara në kontekstin e pandemisë COVID-19	Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2020/2036 e 9 Dhjetorit 2020 për ndryshimin e Rregullores (BE) Nr. 965/2012 në lidhje me kërkesat për kompetencën e ekuipazhit të fluturimit dhe metodat e trajnimit dhe shtyrjen e datave të zbatimit të masave të caktuara në kontekstin e pandemisë COVID-19	AAC		K3 2021		780	0	780
3.14.13	Neni 13	Rregullorja për specifikacione teknike për interoperabilitet në lidhje me qasshmërinë për personat me aftësi të kufizuara dhe personat me lëvizshmëri të zvogëluar, e miratuar	Rregullorja e Komisionit (BE) Nr. 1300/2014 të datës 18 nëntor 2014 mbi specifikimet teknike për ndërveprimin në lidhje me qasjen në sistemit hekurudhor të personave me aftësi të kufizuara dhe personat me lëvizshmëri të zvogëluar.	ARH	MMPHI	K4 2021	P	2,360	0	2,360
3.14.14	Neni 113	Rregullorja për metodat e përbashkëta të sigurisë për	Rregullorja e Komisionit (BE) Nr. 1078/2012 e datës 16 nëntor 2012 mbi metodat e përbashkët	ARH	MMPHI	K3 2021		2,360	0	2,360

		monitorim, e cila aplikohet nga ndërmarrja hekurudhore, menaxheri i infrastrukturës pas marrjes së certifikatës apo autorizimit të sigurisë, e miratuar	sigurie për monitorimin, e cila aplikohet në ndërmarrjet hekurudhore, menaxherët e infrastrukturës pasi kanë marrë certifikatën e sigurie ose autorizim sigurie dhe nga subjektet e ngarkuara me mirëmbajtje.							
3.15. Kapitulli 15 i acquis-së: Energjia										
3.15.	<u>Legjislacioni kornizë</u>									
3.15.1	Neni 114	Projektligji për tregti me naftë dhe produkte të naftës në Kosovë, i miratuar	Direktiva nr. 2009/30/KE që amandamenton Direktivën 98/70/EC në lidhje me specifikimet e benzinës, naftës dhe gazit-vaj dhe futjen e një mekanizmi për të monitoruar dhe për të zvogëluar emetimet e gazit dhe amandamenton Direktivën e Këshillit 1999/32/EC në lidhje me specifikimet e karburantit të përdorur nga anijet e ujrave të brendshme dhe shfuqizimi i Direktivës 93/12/EEC Direktiva nr. 2009/28/KE mbi promovimin e shfrytëzimit të energjisë nga burimet e ripërtëritshme	MINT	ME MPB MFPT	K4 2021	P	5,400	0	5,400
3.15.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>									
3.15.2	Neni 114	UA për shërbimet e energjisë (ESCO) për sektorin privat dhe të amvisërisë, i miratuar	Direktiva nr. 2012/27/KE për efikasitet të energjisë e cila amendamenton direktivën nr. 2009/125/KE dhe direktivën nr. 2010/30/KE dhe shfuqizon direktivën nr. 2004/8/KE dhe direktivën nr. 2006/32/KE	ME	MFPT AKEE ZRrE	K4 2021	P	8,100	0	8,100
3.15.3	Neni 114	UA për kriteret e efikasitetit të energjisë për rregullimin e rrjetit të energjisë dhe për tarifën e rrjetit të energjisë elektrike, i miratuar	Direktiva nr. 2012/27/KE për efikasitet të energjisë e cila amendamenton direktivën nr. 2009/125/KE dhe direktivën nr. 2010/30/KE dhe shfuqizon direktivën nr. 2004/8/KE dhe direktivën nr. 2006/32/KE	ME	MFPT ZRrE KOSTT	K3 2021	P	8,100	0	8,100
3.15.4	Neni 114	UA për kërkesat e efikasitetit të energjisë për operatorët e sistemit të bartjes dhe operatorët e sistemit të shpërndarjes, i miratuar	Direktiva nr. 2012/27/KE për efikasitet të energjisë e cila amendamenton direktivën nr. 2009/125/KE dhe direktivën nr. 2010/30/KE dhe shfuqizon direktivën nr. 2004/8/KE dhe direktivën nr. 2006/32/KE	ME	MFPT ZRrE KOSTT	K3 2021	P	8,100	0	8,100
3.16. Kapitulli 16 i acquis-së: Tatimet										
3.16.	<u>Legjislacioni kornizë</u>									
3.16.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.16.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>									
3.16.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.17. Kapitulli 17 i acquis-së: Politikat ekonomike dhe monetare										
3.17.	<u>Legjislacioni kornizë</u>									
3.17.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.17.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>									

3.17.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.18. Kapitulli 18 i acquis-së: Statistikat										
3.18.	<u>Legjislacioni kornizë</u>									
3.18.1	Neni 95	Projektligji për regjistrimin e popullsisë dhe banesave 2021 (projektligji i ri), i miratuar	Rregullorja (KE) Nr. 763/2008 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit mbi regjistrimet e popullsisë dhe banesave Rregullorja (KE) Nr. 223/2009 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 11 Mars 2009 mbi statistikat Evropiane Rregullorja (BE) 2017/543 Rregullorja (BE) 2017/712 Rregullorja (BE) 2017/881 Rregullorja (BE) 2018/1799 Kodi i Praktikës i Statistikave Evropiane Konferenca Evropiane e Statistikave: Rekomandimet për Regjistrimin e Popullsisë	MFPT	ASK	K4 2021	P	10,000	0	10,000
3.18.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>									
3.18.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.19. Kapitulli 19 i acquis-së: Politikat sociale dhe punësimi										
3.19.	<u>Legjislacioni kornizë</u>									
3.19.1	Neni 82 dhe 106	Projektligji i punës (plotësim-ndryshim), i miratuar	Direktiva e Këshillit 91/533/KEE datë 14 Tetor 1991 mbi detyrimin e punëdhënësit për të njoftuar punonjësit mbi kushtet e zbatueshme në kontratë ose marrëdhënien e punës (OJ L 288, 18.10.1991); Direktiva e Këshillit 92/85/KEE datë 19 Tetor 1992, mbi masat që inkurajojnë përmirësimin e sigurisë dhe shëndetit në punë të punonjësve shtatzëna dhe punonjësve të cilët gjatë këtyre ditëve kanë lindur fëmijë ose i kanë në gjidhënie (Direktiva e dhjetë individuale brenda kuptimit të Nenit 16 (1) të Direktivës 89/391/KEE) (OJ L 348, 28.11.1992); Direktiva e Këshillit 94/33/KE të datës 22 qershor 1994 mbi mbrojtjen e të rinjve në punë (OJ L 216, 20.8.1994); Direktiva 96/71/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 16 Dhjetor 1996 për caktimin e punëtorëve në kuadër të ofrimit të shërbimeve (8 GZ L 18, 21.1.1997); Direktiva 2014/67/BE të dt.15 maj 2014 mbi zbatimin e Direktivës 96/71/KE për caktimin e punëtorëve në kuadër të ofrimit të shërbimeve dhe ndryshimin e Rregullores (BE) Nr. 1024/2012 mbi bashkëpunimin administrativ përmes Sistemit të Informacionit	MFPT	MSh ZKM MASHTI ME	K4 2021	P	10,000	0	10,000

		<p>të Tregut të Brendshëm ("Rregullorja IMI"); Direktiva e Këshillit 97/81/KE të datës 15 Dhjetor 1997 lidhur me Marrëveshjen Kornizë për punë me kohë të pjesshme e lidhur nga UNICE, CEEP UNICE dhe EUTC (OJ L 14, 20.1.1998) e ndryshuar nga Direktiva e Këshillit 98/23/KE të datës 7 prill 1998 (OJ L 131, 5.5.1998); Direktiva e Këshillit 98/59/KE të datës 20 Korrik 1998 mbi përafrimin e ligjeve të shteteve anëtare lidhur me tepricat kolektive (OJ L 225, 12.8.98); Direktiva e Këshillit 99/70/KE të datës 28 Qershor 1999 i përket marrëveshjes kornizë për punën me afat të caktuar" lidhur nga ETUC, UNICE dhe CEEP (OJ L 14, 20.01.1998); Direktiva e Këshillit 2000/43/KE të datës 29 Qershor 2000 për zbatimin e parimit të trajtimin të barabartë ndërmjet personave pavarësisht origjinës etnike ose racore (OJ L 180, 19.07.2000); Direktiva e Këshillit 2000/78/KE të datës 27 Nëntor 2000 që themelon një kuadër të përgjithshëm për trajtim të barabartë në punësim dhe profesion (OJ L 303, 2.12.2000); Direktivën e Këshillit 2001/23/KE të datës 12 mars 2001 për përafrimin e Ligjit të Shteteve Anëtare lidhur me mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve në rast të transferimit të ndërmarrjeve, biznese apo pjesëve të ndërmarrjeve ose të bizneseve (3 OJ L 82, 0.6.2001); 12. Direktiva 2002/14/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 mars 2002 për themelimin e kornizës për informimin dhe negocimin e punonjësve në Komunitetin Evropian (OJ L 80, 23.3.2002); Direktiva 2003/88/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 4 nëntor 2003 lidhur me aspekte të caktuara të organizimit të orarit të punës (OJ L 299, 18.11.2003); Direktiva 2006/54/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 5 korrik 2006 mbi zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimin të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe profesionit</p>							
--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

			(rifillimi) (OJ L204, 26.7.2006, fq.23); Direktiva 2008/94/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 22 tetor 2008 lidhur me mbrojtjen e punëtorëve në rast të falimentimit të punëdhënësit të tyre (verzion i kodifikuar) (OJ L 283, 28.10.2008); Direktiva 2008/104/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 19 nëntor 2008 lidhur me aspekte të caktuara të organizimit të orarit të punës (OJ L 327, 5.12.2008); Direktivën e Këshillit 2010/18/BE prej 8 Mars 2010 për zbatimin e marrëveshjes kornizë për të rishikuar lejen prindërorë të lidhur nga BUSINESSEUROPE, UEAPME, CEEP dhe ETUC dhe shfuqizimi i Direktivës 96/34/KE (OJ L BE 68, 18 Mars 2010)							
3.19.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>									
3.19.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.20. Kapitulli 20 i acquis-së: Ndërmarrjet dhe politikat e industrisë										
3.20.	<u>Legjislacioni kornizë</u>									
3.20.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.20.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>									
3.20.1	Neni 99 dhe 100	Rregullorja për organizimin e KIESA-së, e miratuar	Asnjë akt	MINT		K3 2021		1,500	0	1,500
3.21. Kapitulli 21 i acquis-së: Rrjetet trans-evropiane										
3.21.	<u>Legjislacioni kornizë</u>									
3.21.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.21.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>									
3.21.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.22. Kapitulli 22 i acquis-së: Politikat rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore										
3.22.	<u>Legjislacioni kornizë</u>									
2.22.1	Neni 25, 43, 75, 93, 94, 96, 98, 106, 107, 121, 123	Projektligji për zhvillim rajonal, i miratuar	Asnjë akt	MZhR		K4 2021		5,000	0	5,000
3.22.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>									
3.22.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.23. Kapitulli 23 i acquis-së: Gjyqësori dhe të drejtat themelore										
3.23.	<u>Legjislacioni kornizë</u>									
3.23.	Sistemi gjyqësor									
3.23.1	Neni 83 dhe 91	Projekt-kodi i procedurës penale (plotësim-ndryshim), i miratuar	Asnjë akt	MD		K3 2021		500	0	500

3.23.2	Neni 83 dhe 91	Projektligji Nr. 06/L- 056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës (plotësim-ndryshim), i miratuar	Asnjë akt	MD	KPK KGJK	K4 2021		500	0	500
3.23.3	Neni 83 dhe 91	Projektligji nr.06/L- 025 për Prokurorin e Shtetit (plotësim-ndryshim), i miratuar	Asnjë akt	MD	KPK KGJK	K4 2021		500	0	500
3.23.4	Neni 83 dhe 91	Projektligji për Sistemin qendror të evidences penale (projektligj i ri), i miratuar	Asnjë akt	MD	KGJK KPK MPB	K4 2021		500	0	500
3.23.5	Neni 83 dhe 91	Projektligji për kompensimin e viktimave të krimit, i miratuar	Asnjë akt	MD	KPK KGJK	K3 2021		500	0	500
3.23.	Politikat kundër korrupsionit									
3.23.6	Neni 83 dhe 91	Projektligji për konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme, i miratuar	Asnjë akt	MD	KGJK KPK	K4 2021		500	0	500
3.23.7	Neni 83 dhe 91	Projektligji për deklarimin prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë për zyrtarë publik (plotësim-ndryshim), i miratuar	Konventa evropiane për të drejtat e njeriut (neni 8) Konventa e Këshillit të Evropës për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale Konventa e të drejtës penale mbi korrupsionin (ets 173) Konventa e të drejtës civile mbi korrupsionin (ets 174) Rezoluta (97) 24 në lidhje me njëzet parimet mbi luftimin e korrupsionit	MD	AKK ZKM KPK KGJK	K3 2021		500	0	500
3.23.8	Neni 83 dhe 91	Projektligji për Agjencinë Kundër Korrupsionit (plotësim-ndryshim), i miratuar	Konventa evropiane për të drejtat e njeriut (neni 8) Konventa e Këshillit të Evropës për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale Konventa e të drejtës penale mbi korrupsionin (ets 173) Konventa e të drejtës civile mbi korrupsionin (ets 174) Rezoluta (97) 24 në lidhje me njëzet parimet mbi luftimin e korrupsionit	MD	AKK ZKM KPK KGJK	K3 2021	P	1,000	0	1,000
3.23.9	Neni 83 dhe 91	Projektligji për financimin e subjekteve politike (plotësim-ndryshim), i miratuar	Asnjë akt	ZKM	Kuvendi KQZ AKK	K4 2021		0	0	0

3.23.	Të drejtat themelore									
3.23.10	Neni 3 dhe 4	Projektligji për AKKVP-në (projektligj i ri), i miratuar	Asnjë akt	ZKM	AKKVP	K3 2021		500	0	500
3.23.11	Neni 3 dhe 4	Projektligji për liritë fetare në Kosovë (plotësim-ndryshim), i miratuar	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut – neni 9: Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë	ZKM		K3 2021	P	500	0	500
3.23.12	Neni 3 dhe 4	Projektligji për vlerësimin, njohjen e statusit, përfitimet dhe shërbimet për personat me aftësi të kufizuara, i miratuar	Asnjë akt	MFPT	ZKM	K4 2021		10,000	10,000	20,000
3.23.13	Neni 3 dhe 4	Projektligji për ekzekutimin e sanksioneve penale (plotësim-ndryshim), i miratuar		MD		K3 2021		1,000	0	1,000
3.23.14	Neni 3 dhe 4	Projektligji për ndihmë juridike falas (plotësim-ndryshim), i miratuar		MD		K3 2021		1,000	0	1,000
3.23.15	Neni 3 dhe 4	Projektligji për Komisionin e Pavarur për Media (plotësim-ndryshim), i miratuar	Asnjë akt	ZKM		K4 2021		2,000	0	2,000
3.23.	Mbrojtja e minoriteteve dhe trashëgimia kulturore									
3.23.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.23.	Mbrojtja e të dhënave personale									
3.23.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.23.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>									
3.23.	Sistemi gjyqësor									
3.23.16	Neni 83	UA për tarifën për ndërmjetësues, i miratuar	Asnjë akt	MD	KGJK MFPT	K4 2021		2,700	0	2,700
3.23.17	Neni 83	UA për shpërblimin për punën dhe kompensimin e shpenzimeve lidhur me punët e kryera nga noterët, i miratuar	Asnjë akt	MD	KGJK MFPT	K4 2021		2,700	0	2,700
3.23.18	Neni 83	UA për tarifën e përmbartimit, i miratuar	Asnjë akt	MD	KGJK MFPT	K4 2021		2,700	0	2,700
3.23.19	Neni 83	UA për vet-referimin e rasteve në ndërmjetësim, i miratuar	Asnjë akt	MD	KGJK MFPT	K4 2021		2,700	0	2,700
3.23.20	Neni 83	Rregullorja për bashkëpunëtorë profesionalë, e miratuar	Asnjë akt	KGJK		K4 2021		2,984	0	2,984
3.23.21	Neni 83	Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e	Asnjë akt	KGJK		K4 2021		2,984	0	2,984

		Sekretariatit të KGJK-së, e miratuar								
3.23.22	Neni 83	Rregullorja për normë standarde, e miratuar	Asnjë akt	KGJK		K4 2021		2,984	0	2,984
3.23.23	Neni 83	Rregullorja për dosje të prokurorëve, e miratuar	Asnjë akt	KPK		K4 2021		4,381	0	4,381
3.23.24	Neni 83	Rregullorja për menaxhimin e procesit të punës përmes sistemit elektronik SMIL në Prokurorin e Shtetit, e miratuar	Asnjë akt	KPK		K4 2021		4,381	0	4,381
3.23.	Politikat kundër korrupsionit									
3.23.25	Neni 83 dhe 91	UA për Ekipet e Përbashkëta të Hetimit, e miratuar		MPB		K3 2021		3,000	0	3,000
3.23.	Të drejtat themelore									
3.23.26	Neni 3 dhe 4	UA për përcaktimin e koordinimit dhe bashkëpunimit të punës të autoriteteve për të drejtat e fëmijës në nivel qendror dhe lokal, i miratuar		ZKM		K4 2021		6,000	6,000	12,000
3.23.27	Neni 3 dhe 4	UA për përcaktimin e rregullave të punës të Këshillit për të Drejtat e Fëmijës, i miratuar		ZKM		K4 2021		6,000	6,000	12,000
3.23	Mbrojtja e minoriteteve dhe trashëgimia kulturore									
3.23.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.23	Mbrojtja e të dhënave personale									
3.23.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.24. Kapitulli 24 i acquis-së: Drejtësia, liria dhe siguria										
3.24.	Legjislacioni kornizë									
3.24.	Menaxhimi i kufirit									
3.24.1	Neni 85	Projektligji për ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikqyrjen e Kufirit Shtetëror	Direktiva 2004/82/KE e Këshillit e 29 prillit 2004 mbi obligimet e transportuesve për të komunikuar të dhënat e udhëtarëve; Direktiva 2016/681/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 27 prillit 2016 mbi përdorimin e të dhënave të regjistrit të emrit të udhëtarëve (REU) për parandalimin, zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale të veprave terroriste dhe krimeve të rënda;	MPB		K4 2021	P	10,800	5,000	15,800
3.24.	Vizat									
3.24.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.24.	Siguria e dokumenteve									
3.24.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									

3.24.	Azili									
3.24.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.24.	Migracioni									
3.24.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.24.	Luftimi i shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizimit									
3.24.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.24.	Luftimi i narkotikëve									
3.24.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.24.	Luftimi i krimit të organizuar dhe bashkëpunimi policor									
3.24.2	Neni 91	Projektligji për sigurinë kibernetike, i miratuar	Direktiva e BE 2013/40/EU e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 12 gushtit 2013 mbi sulmet kundër sistemit informativ dhe zëvendesimit të vendimit kornizë 2005/222/JH të këshillit.	MPB		K4 2021	P	10,800	5,000	15,800
3.24.	Lufta kundër terrorizmit									
3.24.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.24.	Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështje penale dhe civile									
3.24.3	Neni 83	Projektligji për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale (plotësim-ndryshim), i miratuar	Direktiva 2014/41/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 3 prill 2014 për urdhrin evropian hetimor për çështje penale.	MD	KGJK KPK MPB MFPT	K3 2021	P	3,600	1,000	4,600
3.24.4	Neni 83	Projektligji për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet civile (plotësim-ndryshim), i miratuar	Konventa e Hagës për Zgjedhjen e Gjykatave; Rregullorja (BE) Nr. 1215/2012 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 12 dhjetor 2012 për juridiksionin dhe ekzekutimin e aktgjykimeve në çështjet civile dhe komerciale (ndryshim); Rregullorja (BE) Nr. 606/2013 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian, e datës 12 qershor 2013 për njohjen e dyanshme për masat mbrojtëse në çështjet civile; Rregullorja (KE) Nr. 4/2009 e datës 18 dhjetor 2008 për Juridiksionin, të drejtën e zbatueshme, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve dhe bashkëpunimin në çështjet që kanë të bëjnë me detyrimet e mbajtjes; Rregullorja (BE) Nr. 650/2012 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian, e datës 4 korrik 2012 për Juridiksionin, drejtën e zbatueshme, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve dhe njohjen dhe ekzekutimin e instrumenteve autentike në çështjet e trashëgimisë dhe krijimin e Certifikatës Evropiane për Trashëgiminë; Rregullorja (BE) 2015/848 e Parlamentit dhe	MD	KGJK KPK MPB MFPT	K3 2021	P	3,600	1,000	4,600

			<p>Këshillit Evropian e datës 20 maj 2015 për procedurat e falimentimit; Rregullorja (KE) Nr. 1896/2006 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 12 dhjetor 2006 për krijimin e rregullit evropian për procedurat e pagesës; Rregullorja (KE) Nr. 861/2007 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 11 korrik 2007 për Krijimin e procedurës evropiane për kërkesat e vogla; Rregullorja (KE) Nr. 805/2004 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 21 prill 2004 për Krijimin e rregullit evropian të zbatimit për kërkesat e pakontestuar; Rregullorja (BE) Nr. 655/2014 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 15 maj 2014 për Procedurën e krijimi të rregullit evropian për ruajtjen e llogarisë për lehtësimin e kthimit të borxhit ndërkuftar në çështjet civile dhe komerciale; Rregullorja (BE) Nr. 1215/2012 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 12 dhjetor 2012 për Juridiksionin dhe njohjen dhe ekzekutimin e aktgjykimeve në çështjet civile dhe komerciale; Rregullorja (KE) Nr. 1393/2007 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 13 nëntor 2007 për Shërbimin e Shteteve Anëtare me dokumente gjyqësore dhe jashtëgjyqësore në çështjet civile dhe komerciale (shërbimin e dokumenteve), dhe shfuqizimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr. 1348/2000.</p>						
3.24.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>								
3.24.	Menaxhimi i kufirit								
3.24.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.								
3.24.	Siguria e dokumenteve								
3.24.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.								
3.24.	Azili								
3.24.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.								
3.24.	Migracioni								
3.24.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.								
3.24.	Luftimi i shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizimit								
3.24.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.								
3.24.	Luftimi i narkotikëve								
3.24.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.								
3.24.	Luftimi i krimit të organizuar dhe bashkëpunimi policor								

3.24.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.24.	Lufta kundër terrorizmit									
3.24.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.24.	Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështje penale dhe civile									
3.24.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.25. Kapitulli 25 i acquis-së: Shkenca dhe kërkimet shkencore										
3.25.	<u>Legjislacioni kornizë</u>									
3.25.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.25.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>									
3.25.1	Neni 107	UA për transferin e teknologjisë dhe dijes, dhe format e transferit të teknologjisë, i miratuar	Asnjë akt	MASHTI		K4 2021		12,000	0	12,000
3.26. Kapitulli 26 i acquis-së: Arsimi dhe kultura										
3.26.	<u>Legjislacioni kornizë</u>									
3.26.1	Neni 118	Projektligji për arsimin e lartë (plotësim-ndryshim), i miratuar	NA	MASHTI		K4 2021		0	15,000	15,000
3.26.2	Neni 118	Projektligji për edukimin në fëmijërinë e hershme 0-6 vjeç në Republikën e Kosovës (projektligj i ri), i miratuar	NA	MASHTI		K4 2021		0	15,000	15,000
3.26.3	Neni 118	Projektligji për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (plotësim-ndryshim), i miratuar	NA	MASHTI		K4 2021		0	15,000	15,000
3.26.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>									
3.26.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.27. Kapitulli 27 i acquis-së: Mjedisi										
3.27.	<u>Legjislacioni kornizë</u>									
3.27.1	Neni 115, 116 dhe 117	Projektligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja, i miratuar	Direktiva 2004/70/KE për arsenin, kadmiumin, merkurin, nikelin dhe hidrokarburet aromatike policiklike në ajrin mjedisor Direktiva 2001/81/KE për kufijtë kombëtarë të emisioneve për disa ndotës atmosferik Direktiva 2003/87/KE krijimit të një skeme për tregtimin e kuotave të emisioneve të gazrave serë brenda komunitetit me të cilën amendamentohet Direktiva 96/61/KE për parandalimin dhe kontrollimin e ndotjes industriale Direktiva 2004/101/KE me të cilën amendamentohet Direktiva 2003/87/KE e krijimit të një skeme për tregimin e kuotave të	MMPHI	MSh MFPT	K3 2021	P	5,940	0	5,940

			<p>emisioneve të gazrave serë brenda komunitetit lidhur me mekanizmat e Protokollit të Kiotos Direktiva 2008/101/KE me të cilën amendamentohet Direktiva 2003/87/KE krijimit të një skeme për tregimin e kuotave të emisioneve të gazrave serë brenda komunitetit Direktiva 2009/29/KE me të cilën amendamentohet Direktiva 2003/87/KE për të përmirësuar dhe zgjeruar sistemin e tregimit të emisioneve brenda komunitetit Direktiva 2009/30/KE me të cilën amendamentohet Direktiva 98/70/KE e në lidhje me specifikimet e benzinës dhe naftës si dhe naftës së gazit si dhe prezantimin e një mekanizmi për monitorimin dhe reduktimin e emisioneve të gazrave serë si dhe amendamenti i Direktivës 199/32/KE për specifikimin e karburantit të përdorur nga anijet për lundrim të brendshëm si dhe shfuqizimin e Direktivës 93/12/KEE rreth përmbajtës së sulfurit në karburantet e lëngshme të caktuar;</p> <p>Vendimi 406/2009/KE për përpjekjet e shteteve anëtare në zvogëlimin e emetimeve e gazrave serë që ti plotësojnë obligimet e Komunitetit për zvogëlimin e gazrave serë deri më 2020</p> <p>Vendimi i Komisionit nr. 2011/278/BE për përcaktimin e rregullave kalimtare në nivel të Bashkësisë për shpërndarjen pa pagesë të kuotave të njësisive të emisioneve në përputhje me nenin 10, të Direktivës 2003/87/BE për krijimin e një skeme për tregimin emisioneve të gazrave serrë me kuota</p> <p>Rregullorja nr. 1005/2009 për materiet të cilat e dëmtojnë shtresën e ozonit</p> <p>Rregullorja nr. 842/2006 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian për gazrat serë të fluoruara të caktuara</p> <p>Vendimi i Këshillit nr. 97/101/BE me të cilën vendoset shkëmbimi reciprok i informatave dhe shënimeve të marra nga rrjetet dhe stacionet e veçanta të cilat matin papastërtinë e ajrit mes shteteve anëtare</p> <p>Vendimi i Këshillit nr. 2001/752/BE me të cilën ndërrohen shtojcat e Vendimit të Këshillit</p>						
--	--	--	---	--	--	--	--	--	--

			<p>97/101/BE për shkëmbim të informatave për të dhënat mbi ajrin</p> <p>Vendimi i Komisionit nr. 2004/224/BE me të cilën përcaktohet mënyra e dhënies së informatave për planet ose programet të cilat kërkojnë sipas Direktivës 96/62/BE për vlerat kufitare për materiet e veçanta ndotëse në ajrin mjedisor</p> <p>Vendimi i Këshillit nr. 2004/461/BE me të cilën përcaktohet pyetësi për paraqitjen e raportit vjetor për cilësinë e ajrit sipas Direktivës së Këshillit 96/62/BE dhe 1999/30/BE si dhe sipas Direktivave 2000/69/BE dhe 2002/3/BE të Parlamentit dhe Këshillit Evropian (ka zëvendësuar vendimin 2001/839/BE)</p> <p>Vendimi nr. 280/2004/BE të Parlamentit dhe Këshillit Evropian për mekanizmin e përcjelljes së gazrave serë në Bashkësi dhe për zbatimin e Protokollit të Kiotos</p> <p>Rregullorja e Komisionit (BE) nr. 031/2010 për ndarjen, udhëheqjen dhe aspektet tjera të ndarjes së kuotave të emisioneve të gazrave serë sipas Direktivës 2003/87/BE për vendosjen e sistemit të tregimit me kuota të emisioneve të gazrave serë brenda Bashkësisë</p> <p>Vendimi i Komisionit nr. 2007/589/BE me të cilën merren vendimet për përcjelljen dhe raportimin e emisioneve të gazrave serë sipas Direktivës 2003/87/BE, e cila është ndryshuar dhe plotësuar me Vendim të Komisionit 2011/540/BE</p>							
3.27.2	Neni 115, 116 dhe 117	Projektligji për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes, i miratuar	Direktiva nr. 2010/75/BE (IED) për Emisione Industriale	MMPHI	MFPT	K3 2021	P	8,910	0	8,910
3.27.3	Neni 115, 116 dhe 117	Projektligji për ujërat e Kosovës (plotësim-ndryshim), i miratuar	<p>Direktiva 2004/70/KE për arsenin, kadmiumin, merkurin, nikelin dhe hidrokarburet aromatike policiklike në ajrin mjedisor</p> <p>Direktiva 2001/81/KE për kufijtë kombëtarë të emisioneve për disa ndotës atmosferik</p> <p>Direktiva 2003/87/KE krijimit të një skeme për tregtimin e kuotave të emisioneve të gazrave serë brenda komunitetit me të cilën amendamentohet Direktiva 96/61/KE për</p>	MMPHI	ZKM MBZHR MFPT	K3 2021	P	8,910	0	8,910

			<p>parandalimin dhe kontrollimin e ndotjes industriale</p> <p>Direktiva 2004/101/KE me të cilën amendamentohet Direktiva 2003/87/KE e krijimit të një skeme për tregimin e kuotave të emisioneve të gazrave serë brenda komunitetit lidhur me mekanizmat e Protokollit të Kiotos</p> <p>Direktiva 2008/101/KE me të cilën amendamentohet Direktiva 2003/87/KE e krijimit të një skeme për tregimin e kuotave të emisioneve të gazrave serë brenda komunitetit</p> <p>Direktiva 2009/29/KE me të cilën amendamentohet Direktiva 2003/87/KE për të përmirësuar dhe zgjeruar sistemin e tregimit të emisioneve brenda komunitetit</p> <p>Direktiva 2009/30/KE me të cilën amendamentohet Direktiva 98/70/KE e në lidhje me specifikimet e benzinës dhe naftës si dhe naftës së gazit si dhe prezantimin e një mekanizmi për monitorimin dhe reduktimin e emisioneve të gazrave serë si dhe amendamenti i Direktivës 199/32/KE për specifikimin e karburantit të përdorur nga anijet për lundrim të brendshëm si dhe shfuqizimin e Direktivës 93/12/KEE rreth përmbajtës së sulfurit në karburantet e lëngshme të caktuara;</p> <p>Vendimi 406/2009/KE për përpjekjet e shteteve anëtare në zvogëlimin e emetimeve e gazrave serë që ti plotësojnë obligimet e Komunitetit për zvogëlimin e gazrave serë deri më 2020</p> <p>Vendimi i Komisionit nr. 2011/278/BE për përcaktimin e rregullave kalimtare në nivel të Bashkësisë për shpërndarjen pa pagesë të kuotave të njësisive të emisioneve në përputhje me nenin 10, të Direktivës 2003/87/BE për krijimin e një skeme për tregimin emisioneve të gazrave serrë me kuota</p> <p>Rregullorja nr. 1005/2009 për materiet të cilat e dëmtojnë shtresën e ozonit</p> <p>Rregullorja nr. 842/2006 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian për gazrat serë të fluoruara të caktuara</p> <p>Vendimi i Këshillit nr. 97/101/BE me të cilën vendoset shkëmbimi reciprok i informatave</p>							
--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

			<p>dhe shënimeve të marra nga rrytetet dhe stacionet e veçanta të cilat matin papastërtinë e ajrit mes shteteve anëtare</p> <p>Vendimi i Këshillit nr. 2001/752/BE me të cilën ndërrohen shtojcat e Vendimit të Këshillit 97/101/BE për shkëmbim të informatave për të dhënat mbi ajrin</p> <p>Vendimi i Komisionit nr. 2004/224/BE me të cilën përcaktohet mënyra e dhënies së informatave për planet ose programet të cilat kërkohen sipas Direktivës 96/62/BE për vlerat kufitare për materiet e veçanta ndotëse në ajrin mjedisor</p> <p>Vendimi i Këshillit nr. 2004/461/BE me të cilën përcaktohet pyetësori për paraqitjen e raportit vjetor për cilësinë e ajrit sipas Direktivës së Këshillit 96/62/BE dhe 1999/30/BE si dhe sipas Direktivave 2000/69/BE dhe 2002/3/BE të Parlamentit dhe Këshillit Evropian (ka zëvendësuar vendimin 2001/839/BE)</p> <p>Vendimi nr. 280/2004/BE të Parlamentit dhe Këshillit Evropian për mekanizmin e përcjelljes së gazrave serë në Bashkësi dhe për zbatimin e Protokollit të Kiotos</p> <p>Rregullorja e Komisionit (BE) nr. 031/2010 për ndarjen, udhëheqjen dhe aspektet tjera të ndarjes së kuotave të emisioneve të gazrave serë sipas Direktivës 2003/87/BE për vendosjen e sistemit të tregtimit me kuota të emisioneve të gazrave serë brenda Bashkësisë</p> <p>Vendimi i Komisionit nr. 2007/589/BE me të cilën merren vendimet për përcjelljen dhe raportimin e emisioneve të gazrave serë sipas Direktivës 2003/87/BE, e cila është ndryshuar dhe plotësuar me Vendim të Komisionit 2011/540/BE</p>							
3.27.4	Neni 115, 116 dhe 117	Projektligji për mbeturina (plotësim-ndryshim), i miratuar	Direktiva Kornize per Mbeturina 2008/98/EC	MMPHI	ZKM MBZhr MFPT	K3 2021	P	8,910	0	8,910
3.27.5	Neni 115, 116 dhe 117	Projektligji për kimikate (plotësim-ndryshim), i miratuar	Rregullorja REACH 1907/2006 EC Rregullorja CLP 1272/2008/ EC	MMPHI	MFPT MSh MBPZhr MPB	K3 2021	P	8,910	0	8,910

3.27.6	Neni 115, 116 dhe 117	Projektligji për pyjet (plotësim-ndryshim), i miratuar	Rregullorja (BE) nr. 691/2011 e Parlamentit dhe e Këshilli Evropian e datës 6 korrik 2011 mbi llogaritë ekonomike mjedisore evropiane; Rregullorja (BE) nr. 995/2010 e Parlamentit dhe e Këshilli Evropian e datës 20 tetor 2010 për detyrimet e operatorëve të cilët vendosin drurin dhe produktet e drurit në treg	MBPZhr	MFPT	K4 2021	P	2,025	0	2,025
3.27.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>									
3.27.7	Neni 115, 116 dhe 117	UA për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes (plotësim-ndryshim), i miratuar	Direktiva 2010/75/BE për emisionet industriale	MMPHI	MINT MSH MFPT	K3 2021	P	4,445	0	4,445
3.27.8	Neni 115, 116 dhe 117	UA për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujor (plotësim-ndryshim), i miratuar	Direktiva nr. 91/271/KEE për trajtimin e ujerave e ndotura urbane	MMPHI	MINT MSH	K3 2021	P	3,780	0	3,780
3.28. Kapitulli 28 i acquis-së: Mbrojtja e konsumatorit dhe e shëndetit publik										
3.28.	<u>Legjislacioni kornizë</u>									
3.28.	Mbrojtja e konsumatorit									
3.28.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.28.	Mbrojtja e shëndetit publik									
3.28.1	Neni 106	Projektligji për shëndetin riprodhues dhe fertilizimin e asistuar mjekësor, i miratuar	Direktiva 2004/23 / e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e 31 marsit 2004; Direktiva 2006/86 KE e 24 tetorit 2006 për zbatimin e Direktivës 2004/23 / KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit; Direktiva 98/79/EC e Parlamentit dhe Këshillit Evropian;	MSh	ZKM	K4 2021	P	7,500	0	7,500
3.28.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>									
3.28.	Mbrojtja e konsumatorit									
3.28.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.28.	Mbrojtja e shëndetit publik									
3.28.2	Neni 106	UA për vërejtjet e kombinuara në njësinë e paketimit të duhanit	Vendimin 2003/641/KE i KE Vendimi C (2006) 1502/BE i BE Vendimi C (2005) 1452 i KE	MSh	MINT	K4 2021	P	0	5,000	5,000
3.28.3	Neni 106	UA për vërejtjet e kombinuara në njësinë e paketimit	Directiva (EU) 2020/2184 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian për kualitetin e ujit të dedikuar për konsum njerëzor	MSh	MINT	K4 2021	P	0	5,000	5,000
3.29. Kapitulli 29 i acquis-së: Unioni Doganor										
3.29.	<u>Legjislacioni kornizë</u>									

3.29.1	Neni 77 dhe 104	Projekt-kodi doganor dhe i akcizave në Kosovë (plotësim-ndryshim), i miratuar	Rregullorja e BE-së nr. 952/2013 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 9 dhjetorit 2013 për Kodin Doganor të Unionit	MFPT		K4 2021	P	5,600	0	5,600
3.29.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>									
3.29.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.30. Kapitulli 30 i acquis-së: Marrëdhëniet me jashtë										
3.30.	<u>Legjislacioni kornizë</u>									
3.30.1	Nenet 11-16	Projektligji për tregtinë e jashtme (plotësim-ndryshim), i miratuar	Asnjë akt	MINT		K4 2021		1,500	0	1,500
3.30.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>									
3.30.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.31. Kapitulli 31 i acquis-së: Politika e jashtme, e sigurisë dhe e mbrojtjes										
3.31.	<u>Legjislacioni kornizë</u>									
3.31.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.31.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>									
3.31.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.32. Kapitulli 32 i acquis-së: Kontrolli financiar										
3.32.	<u>Legjislacioni kornizë</u>									
3.32.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.32.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>									
3.32.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.33. Kapitulli 33 i acquis-së: Dispozitat financiare dhe buxhetore										
3.33.	<u>Legjislacioni kornizë</u>									
3.33.1	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.33.	<u>Aktet nënligjore dhe aktet e tjera rregullative</u>									
3.33.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.34. Kapitulli 34 i acquis-së: Institucionet										
3.34.	Programi nuk mbulon këtë kapitull në këtë fazë të aderimit në BE.									
3.35. Kapitulli 35 i acquis-së: Çështjet e tjera										
3.35.	Programi nuk mbulon këtë kapitull në këtë fazë të aderimit në BE.									
MASAT ZBATUESE										
Nr.	Dispozitat e MSA-së	Objektivat	Treguesit	Institucioni përgjegjës	Institucionet mbështetëse	Afatet kohore	Dokumentet referuese	Buxheti		
								BRK	Donatorët	Gjithsej
1. BLOKU I: KRITERET POLITIKE										
1.1. Demokracia dhe sundimi i ligjit										
1.1.1. Kushtetuta, Parlamenti dhe sistemi zgjedhor										
1.1.1.	<u>Korniza e politikave</u>									
1.1.1.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
1.1.1.	<u>Reformat institucionale dhe ngritja e kapaciteteve institucionale</u>									
1.1.1.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
1.1.1.	<u>Zbatimi në praktikë</u>									
1.1.1.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
1.1.2. Administrata publike										

1.1.2.	<u>Korniza e politikave</u>									
1.1.2.8	Neni 120	Vazhdimi i reformave institucionale dhe ngritja e kapaciteteve institucionale në fushën e administratës publike, me qëllim të zbatimit të standardeve dhe parimeve të BE-së për AP	Plani kalimtar i Veprimit 2020-2021 për zbatimin e SMAP 2015-2020, i miratuar	MPB		K3 2021		5,000	0	5,000
1.1.2.9	Neni 120	Vazhdimi i reformave institucionale dhe ngritja e kapaciteteve institucionale në fushën e administratës publike, me qëllim të zbatimit të standardeve dhe parimeve të BE-së për AP	Strategjia e re kornizë për RAP, e miratuar	MPB		K4 2021		0	10,000	10,000
1.1.2.10	Neni 120	Vazhdimi i reformave institucionale dhe ngritja e kapaciteteve institucionale në fushën e administratës publike, me qëllim të zbatimit të standardeve dhe parimeve të BE-së për AP	Udhëzuesi për vlerësimin e performancës së agjencive ekzekutive për zbatimin e Ligjit për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura, i zhvilluar dhe miratuar	MPB		K3 2021		0	4,500	4,500
1.1.2.	<u>Reformat institucionale dhe ngritja e kapaciteteve institucionale</u>									
1.1.2.11	Neni 120	Vazhdimi i reformave institucionale dhe ngritja e kapaciteteve institucionale në fushën e administratës publike, me qëllim të zbatimit të standardeve dhe parimeve të BE-së për AP	Banka e pyetjeve për praninë në shërbim civil, e krijuar	MPB		K3 2021		0	18,000	18,000
1.1.2.12	Neni 120	Vazhdimi i reformave institucionale dhe ngritja e kapaciteteve institucionale në fushën e administratës publike, me qëllim të zbatimit të standardeve dhe parimeve të BE-së për AP	Modulet për të gjitha procedurat e rekrutimit, transferimit dhe avancimit në kuadër të SIMBNJ, të zhvilluara	MPB		K4 2021		0	20,000	20,000
1.1.2.13	Neni 120	Përzgjedhja transparente, meritore dhe jopolitike për të gjitha institucionet e pavarura, agjencitë, organet rregullative dhe kompanitë publike	MM në mes të Kuvendit, Qeverisë së Kosovës dhe Mbretërisë së Bashkuar, i zbatuar	ZKM	MPB ME Kuvendi MAPL	K4 2021		0	3,000	3,000

1.1.2.14	Neni 120	Përzgjedhja transparente, meritore dhe jopolitike për të gjitha institucionet e pavarura, agjencitë, organet rregullative dhe kompanitë publike	Udhëzuesi për zhvillimin e intervistës për pozita të larta drejtuese, përgatitur në bashkëpunim me projektin britanik dhe projektin e BE-së, i miratuar	MPB	ZKM	K4 2021		0	2,000	2,000
1.1.2.15	Neni 120	Vazhdimi i reformave institucionale dhe ngritja e kapaciteteve institucionale në fushën e administratës publike, me qëllim të zbatimit të standardeve dhe parimeve të BE-së për AP	Udhëzuesi për zhvillimin e intervistës në procesin e rekrutimit, i miratuar	MPB		K4 2021		0	2,000	2,000
1.1.2.	<u>Zbatimi në praktikë</u>									
1.1.2.16	Neni 120	Vazhdimi i reformave institucionale dhe ngritja e kapaciteteve institucionale në fushën e administratës publike, me qëllim të zbatimit të standardeve dhe parimeve të BE-së për AP	Të paktën 20% të projektligjeve ekzistuese, draft ligjeve, akteve nënligjore dhe udhëzimeve administrative që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe janë pjesë e programit legjislativ, të harmonizuara me LPPA	MPB	ZKM	K4 2021		0	26,000	26,000
1.1.2.17	Neni 120	Vazhdimi i reformave institucionale dhe ngritja e kapaciteteve institucionale në fushën e administratës publike, me qëllim të zbatimit të standardeve dhe parimeve të BE-së për AP	Të paktën 8% të lejeve dhe licencave për operatorët ekonomik, të thjeshtuara, bashkuara apo të shfuqizuara	ZKM	MPB	K4 2021		3,000	3,000	6,000
1.1.2.18	Neni 120	Vazhdimi i reformave institucionale dhe ngritja e kapaciteteve institucionale në fushën e administratës publike, me qëllim të zbatimit të standardeve dhe parimeve të BE-së për AP	Regjistri qendror për leje dhe licenca, i avancuar dhe përditësuar	ZKM		K4 2021		4,000	0	4,000
1.1.3.	Avokati i Popullit									
1.1.3.	<u>Korniza e politikave</u>									
1.1.3.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
1.1.3.	<u>Reformat institucionale dhe ngritja e kapaciteteve institucionale</u>									
1.1.3.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
1.1.3.	<u>Zbatimi në praktikë</u>									
1.1.3.1	Neni 3, 4 dhe 7	Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit	Numri i rekomandimeve të IAP të zbatuara nga autoritetet përgjegjëse, bazuar në indikatorin 7.3.2 të Kontratës Buxhetore Sektoriale për RAP	ZKM		K4 2021		30,000	20,000	50,000

1.1.3.2	Neni 3, 4 dhe 7	Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit	Numri i përgjigjeve të pranuar nga autoritetet përgjegjëse, bazuar në indikatorin 7.3.1 të Kontratës Buxhetore Sektoriale për RAP	ZKM		K4 2021		80,000	20,000	100,000
1.1.4. Mbikëqyrja civile e forcave të sigurisë										
1.1.4.	<u>Korniza e politikave</u>									
1.1.4.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
1.1.4.	<u>Reformat institucionale dhe ngritja e kapaciteteve institucionale</u>									
1.1.4.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
1.1.4.	<u>Zbatimi në praktikë</u>									
1.1.4.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
1.2. Bashkëpunimi rajonal dhe obligimet ndërkombëtare										
1.2.	<u>Korniza e politikave</u>									
1.2.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
1.2.	<u>Reformat institucionale dhe ngritja e kapaciteteve institucionale</u>									
1.2.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
1.2.	<u>Zbatimi në praktikë</u>									
1.2.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
2. BLOKU II: KRITERET EKONOMIKE										
2.1. Ekzistenca e ekonomisë funksionale të tregut										
2.1.	<u>Korniza e politikave</u>									
2.1.1	Neni 25, 43, 75, 93, 94, 96, 98, 106, 107, 121, 123	Hartimi i Strategjisë për Reforma të Menaxhimit të Financave Publike 2022-2026	Strategjia e SRMFPTP dhe Plani i Veprimt, të miratuara	MFPT	ZKM MPB ZKA KRPP	K4 2021	Programi i Qeverisë 2021-2025	24,000	54,900	78,900
2.1.	<u>Reformat institucionale dhe ngritja e kapaciteteve institucionale</u>									
2.1.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
2.1.	<u>Zbatimi në praktikë</u>									
2.1.2	Neni 25, 43, 75, 93, 94, 96, 98, 106, 107, 121, 123	Zhvillimi i kornizës strategjike fiskale për ndërmarrjet publike	Analiza e rrezikut fiskal të NP-ve, e përfshirë në dokumentet strategjike fiskale	MFPT	ME	K4 2021	Konkluzionet e NK për Ekonomi, Çështje Financiare dhe Statistika 2021	1,440	0	1,440
2.1.3	Neni 25, 43, 75, 93, 94, 96, 98, 106, 107, 121, 123	Sigurimi i transparencës dhe mbikëqyrjes së shpenzimeve publike	Raporti për zbatimin e Pakos Fiskale Emergjente të Qeverisë, i publikuar	MFPT	ZKM FKGK MBPZhr ME	K3 2021		20,000	0	20,000
2.2. Kapaciteti për t'u përballur me presionin e konkurrencës dhe forcat e tregut brenda Unionit										
2.2.	<u>Korniza e politikave</u>									
2.2.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
2.2.	<u>Reformat institucionale dhe ngritja e kapaciteteve institucionale</u>									
2.2.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
2.2.	<u>Zbatimi në praktikë</u>									
2.2.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									

3. BLOKU III: STANDARDET EVROPIANE – PËRAFRIMI I LEGJISLACIONIT TË KOSOVËS ME ACQUIS-NË E BE-SË										
3.0. Korniza ligjore për përafrimin e legjislacionit të Kosovës me acquis-në e BE-së										
3.0.	<u>Korniza e politikave</u>									
3.0.1	Neni 74	Koordinimi i përkthimit të acquis të BE-së në gjuhët zyrtare të Kosovës	Kalendari vjetor i përkthimit, i hartuar	ZKM		K4 2021	Programi i akteve nënligjore 2021	0	0	0
3.0.	<u>Reformat institucionale dhe ngritja e kapaciteteve institucionale</u>									
3.0.2	Neni 74	Ngritja e kapaciteteve për përafrimin e projekt akteve normative të legjislacionit të Kosovës me acquis të BE-së për zbatimin e MSA-së	Së paku 4 cikle të trajnimeve për përafrim të legjislacionit, të mbajtura	ZKM	MPB	K4 2021		5,000	0	5,000
3.0.3	Neni 74	Digjitalizimi i procesit për përafrimin e projekt akteve normative të legjislacionit të Kosovës me acquis të BE-së për zbatimin e MSA-së	Dizajnimi i platformës për përafrimin e legjislacionit vendor me acquis të BE-së	ZKM		K4 2021		20,000	30,000	50,000
3.0.	<u>Zbatimi në praktikë</u>									
3.0.4	Neni 74	Koordinimi i përkthimit të acquis të BE-së në gjuhët zyrtare të Kosovës	Numri i akteve të acquis-së të përkthyer, rishikuar dhe certifikuar që janë të përkthyer në gjuhë zyrtare të Kosovës	ZKM		K4 2021		100,000	0	100,000
3.0.5	Neni 74	Kontrolli i përafrimit të projekt akteve normative të legjislacionit të Kosovës me acquis të BE-së për zbatimin e MSA-së	Së paku 120 Opinione Ligjore të Përputhshmërisë (OLP) me acquis të BE-së, të lëshuara	ZKM		K4 2021		0	0	0
3.1. Kapitulli 1 i acquis-së: Lëvizja e lirë e mallrave										
3.1.	<u>Korniza e politikave</u>									
3.1.2	Neni 20, 80 dhe 73, pika 5	Përmirësimi i kornizës rregullative të sigurisë së përgjithshme të produkteve	Koncept-dokumenti për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve, i miratuar	MINT	AUV	K3 2021		10,500	6,600	17,100
3.1.3	Neni 20, 80 dhe 73, pika 5	Krijimi i politikave për fushën e pa-harmonizuar	Plani i Veprimit për fushën e pa-harmonizuar (34-36 TFEU), i miratuar	MINT	ME MSh MPB MBPZHR AUV ARKEP	K4 2021		1,500	0	1,500
3.1.	<u>Reformat institucionale dhe ngritja e kapaciteteve institucionale</u>									
3.1.4	Neni 20, 80 dhe 74 pika 3	Ngritja e kapaciteteve administrative në Agjencinë Kosovare për Metrologji, Akreditim dhe Standardizim	Së paku 6 module të trajnimeve të mbajtura për zyrtarët e AMK-së, DAK-ut dhe AKS-së	MINT		K4 2021		6,000	13,150	19,150
3.1.5	Neni 20, 80 dhe 74 pika 3	Ngritja e kapaciteteve administrative në inspektoratin e tregut	Së paku 3 module të trajnimeve të mbajtura për zyrtarët e Inspektoratit të Tregut	MINT		K4 2021		3,000	7,650	10,650

3.1.	<u>Zbatimi në praktikë</u>									
3.1.6	Neni 20, 80 dhe 74 pika 3	Përmirësimi i kapaciteteve teknike në fushën e metrologjisë	Laboratori i Vëllimit dhe Rrjedhjes i akredituar	MINT		K4 2021		1,500	4,650	6,150
3.2. Kapitulli 2 i acquis-së: Liria e lëvizjes së punonjësve										
3.2.	<u>Korniza e politikave</u>									
3.2.1	Neni 79, paragrafi 9	Inicimi/negocimi marreveshjeve bilaterale për sigurime sociale	Së paku një marrëveshje bilaterale e iniciuar	MFPT	ZKM MPJD	K4 2021		0	0	0
3.2.	<u>Reformat institucionale dhe ngritja e kapaciteteve institucionale</u>									
3.2.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.2.	<u>Zbatimi në praktikë</u>									
3.2.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.3. Kapitulli 3 i acquis-së: E drejta e themelimit dhe liria e ofrimit të shërbimeve										
3.3.	<u>Korniza e politikave</u>									
3.3.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.3.	<u>Reformat institucionale dhe ngritja e kapaciteteve institucionale</u>									
3.3.3	Neni 51, 56, 57, 58, 59 dhe 74.	Zbatimi i reformave institucionale në fushën e së drejtës së themelimit dhe lirisë së ofrimit të shërbimeve	Vendimi për Themelimin e Këshillit Shtetëror për Profesionet e Rregulluara, i miratuar	MASHTI		K4 2021	Ligji për profesionet e Rregulluara	1,000	0	1,000
3.3.4	Neni 51, 56, 57, 58, 59 dhe 74	Përgatitjet për themelimin e pikës së vetme të kontaktit Zbatimi i reformave institucionale në fushën e së drejtës së themelimit dhe lirisë së ofrimit të shërbimeve	Softueri për pikën e vetme të kontaktit i zhvilluar	MINT	MPB MASHTI ME	K4 2021	Ligji për Shërbime	2,600	0	2,600
3.3.	<u>Zbatimi në praktikë</u>									
3.3.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.4. Kapitulli 4 i acquis-së: Lëvizja e lirë e kapitalit										
3.4.	<u>Korniza e politikave</u>									
3.4.2	Neni i 64	Zhvillimi i mëtejshëm i politikave në fushën e sistemit të pagesave	Koncept-dokumenti për plotësim-ndryshimin e Ligjit për Sistemin e pagesave, i miratuar	MFPT	BQK	K3 2021	Plani vjetor i BQK-së.	5,600	0	5,600
3.4.3	Neni 89	Zhvillimi i legjislationit në fushën e luftimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit	Koncept dokumenti për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit, i aprovuar	MFPT	NjIF	K4 2021	Konkluzionet e NK për Treg të Brendshëm 2020	5,840	5,840	11,680
3.4.	<u>Reformat institucionale dhe ngritja e kapaciteteve institucionale</u>									
3.4.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.4.	<u>Zbatimi në praktikë</u>									

3.4.4	Neni i 64	Zbatimi i reformave në fushën lëvizjës së lirë të kapitalit	Metodologjia e rishikuar për vlerësime sektoriale të rrezikut, sipas listës së konsoliduar të rekomandimeve, e miratuar	MFPT		K4 2021		0	13,500	13,500
3.5. Kapitulli 5 i acquis-së: Prokurimi publik										
3.5.	<u>Korniza e politikave</u>									
3.5.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.5.	<u>Reformat institucionale dhe ngritja e kapaciteteve institucionale</u>									
3.5.3	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.5.	<u>Zbatimi në praktikë</u>									
3.5.3	Neni 79	Aplikimi i modulit për menaxhim të kontratave nëpërmes sistemit të e-prokurimit.	Numri i kontratave të nënshkuara në prokurimin publik që janë menaxhuar përmes sistemit të e-prokurimit.	KRPP	MFPT	K4 2021	Konkluzionet e NK për Treg të Brendshëm 2020	360,468	0	360,468
3.5.4	Neni 79	Themelimi i mekanizmave koordinues me Autoritetin e Konkurrencës në Kosovë në mënyrë që të promovohet një mjedis i favorshëm për praktikant konkurruese në prokurimin publik.	Memorandum Mirëkuptimi në mes të KRPP dhe Autoritetit të Konkurrencës në Kosovë, i nënshkuar.	KRPP	MFPT	K3 2021	Konkluzionet e NK për Treg të Brendshëm 2020	1,000	0	1,000
3.6. Kapitulli 6 i acquis-së: E drejta e kompanive										
3.6.	<u>Korniza e politikave</u>									
3.6.3	Neni 51, pikat 1, 2, 4	Përmirësimi i kornizës ligjore për shoqëri tregtare	Koncept-dokumenti për plotësim ndryshimin e Ligjit për Shoqëritë Tregtare, i miratuar	MINT	ARBK	K4 2021	Konkluzionet e NK për Treg të Brendshëm 2020	7,500	6,150	13,650
3.6.4	Neni 51, pikat 1, 2 dhe 3	Zhvillimi i politikave të qeverisjes korporative	Kodi i Qeverisjes Korporative, i miratuar	MINT	ARBK	K4 2021	Konkluzionet e NK për Treg të Brendshëm 2020	1,500	0	1,500
3.6.	<u>Reformat institucionale dhe ngritja e kapaciteteve institucionale</u>									
3.6.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.6.	<u>Zbatimi në praktikë</u>									
3.6.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.7. Kapitulli 7 i acquis-së: E drejta e pronësisë intelektuale										
3.7.	<u>Korniza e politikave</u>									
3.7.7	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.7.	<u>Reformat institucionale dhe ngritja e kapaciteteve institucionale</u>									
3.7.7	Neni 77 dhe 78	Ngritja e kapaciteteve të institucioneve relevante për zbatim të legjislationit	Së paku 1 trajnim i organizuar për gjyqtarët, prokurorët, policinë në fushën e Pronësisë Industriale	MINT		K4 2021		1,250	6,150	7,400
3.7.	<u>Zbatimi në praktikë</u>									
3.7.8	Neni 77 dhe 78	Forcimi i kapaciteteve për luftimin e piraterisë	Krijimi i pikave të kontaktit për 7 rajonet për luftimin e piraterisë dhe mallrave të falsifikuara	MKRS		K4 2021		0	0	0
3.8. Kapitulli 8 i acquis-së: Politikat e konkurrencës										
3.8.	<u>Korniza e politikave</u>									

3.8.	Konkurrenca									
3.8.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.8.	Ndihma shtetërore									
3.8.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.8.	<u>Reformat institucionale dhe ngritja e kapaciteteve institucionale</u>									
3.8.	Konkurrenca									
3.8.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.8.	Ndihma shtetërore									
3.8.2	Nenet 74 dhe 75	Ngritja e kapaciteteve të stafit të DNSh-së me qëllim të aplikimit të rregullave të Ndihmës Shtetërore në vend	50 sesione informuese për komunitet, Ministrinë e Linjës, institucionet rregullative dhe atyre të drejtësisë	MFPT	KNSh	K4 2021	Programi i Qeverisë 2021-2025 PSO të Qeverisë 2021-2025 SKZh	0	41,950	41,950
3.8.	<u>Zbatimi në praktikë</u>									
3.8.	Konkurrenca									
3.8.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.8.	Ndihma shtetërore									
3.8.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.9. Kapitulli 9 i acquis-së: Shërbimet financiare										
3.9.	<u>Korniza e politikave</u>									
3.9.5	Neni 50, 96 dhe aneksi 7	Hartimi i udhëzuesit metodologjik për zbatimin e Rregullores mbi raportin/proporcionin e mbulimit të likuiditetit (Liquidity Coverage Ratio)	Udhëzuesi metodologjik për zbatimin e rregullores për mbulueshmërinë e likuiditetit, i përgatitur	BQK		K4 2021	Plani vjetor i BQK-së	2,800	0	2,800
3.9.6	Neni 50, 96 dhe aneksi 7	Hartimi i udhëzuesit metodologjik për zbatimin e Rregullores mbi raportin/proporcionin financiar të qëndrueshëm neto (Net Stable Funding Ratio)	Udhëzuesi metodologjik për zbatimin e rregullores për financimin e qëndrueshëm neto, i përgatitur	BQK		K4 2021	Plani vjetor i BQK-së	2,800	0	2,800
3.9.	<u>Reformat institucionale dhe ngritja e kapaciteteve institucionale</u>									
3.9.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.9.	<u>Zbatimi në praktikë</u>									
3.9.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.10. Kapitulli 10 i acquis-së: Shoqëria e informacionit dhe mediat										
3.10.	<u>Korniza e politikave</u>									
3.10.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.10.	<u>Reformat institucionale dhe ngritja e kapaciteteve institucionale</u>									
3.10.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.10.	<u>Zbatimi në praktikë</u>									
3.10.8	Neni 109, 110 dhe 111	Nxiti e konkurrencës në tregjet e komunikimeve elektronike, krijimi i	Sistemi bartshmërisë së numrave, i krijuar dhe funksionalizuar	ARKEP		K4 2021	-	1,503,308	0	1,503,308

		mundësive për konsumatorët që të ndërrojnë operatorët duke ruajtur të njëjtin numër, si dhe përdorimi në mënyrë efikase dhe efektive i resurseve numerike								
3.11. Kapitulli 11 i acquis-së: Bujqësia dhe zhvillimi rural										
3.11.	<u>Korniza e politikave</u>									
3.11.2	Neni 102	Përmirësimi i politikave për rregullimin e tokës	Koncept dokumenti për rregullimin e tokës, i miratuar	MBPZHR	MMPHI AKK	K4 2021	Ligji për Rregullimin e Tokës Bujqësore Nr.04/L-040; Strategjia për Konsolidimin e Tokave Bujqësore	2,700	0	2,700
3.11.3	Neni 102	Përmirësimi i politikave për rregullimin e tokës	Koncept dokumenti për tokën bujqësore, i miratuar	MBPZHR	MMPHI AKK	K4 2021	Ligji për Tokën Bujqësore Nr.02/L-26 Strategjia për Konsolidimin e Tokave Bujqësore	2,700	0	2,700
3.11.4	Neni 102	Përmirësimi i politikave të bujqësisë dhe zhvillimit rural	Koncept dokumenti për verërat, i miratuar	MBPZHR	MAPL	K4 2021	Ligji për Verërat Nr.04/L-19	2,700	0	2,700
3.11.5	Neni 102	Përmirësimi i politikave të bujqësisë dhe zhvillimit rural	Programi për bujqësi dhe zhvillim rural 2021-2027, i finalizuar	MBPZHR	AUV MMPHI	K4 2021	Ligji për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Ligji Nr. 03/L-098 Strategjia për Konsolidimin e Tokave Bujqësore	3,600	0	3,600
3.11.6	Neni 102	Përmirësimi i politikave për organizimin e tregut të përbashkët	Koncept dokumenti për organizimin e tregut të përbashkët, i miratuar	MBPZHR	MINT AUV	K4 2021	Konkluzionet e NK për Bujqësi dhe Peshkatarin 2020 PSO i MBPZHR-së 2021	2,700	0	2,700
3.11.	<u>Reformat institucionale dhe ngritja e kapaciteteve institucionale</u>									
3.11.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.11.	<u>Zbatimi në praktikë</u>									
3.11.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.12. Kapitulli 12 i acquis-së: Politikat e sigurisë së ushqimit, fitosanitare dhe ato të veterinarëve										
3.12.	<u>Korniza e politikave</u>									
3.12.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.12.	<u>Reformat institucionale dhe ngritja e kapaciteteve institucionale</u>									
3.12.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.12.	<u>Zbatimi në praktikë</u>									

3.12.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.13. Kapitulli 13 i acquis-së: Peshkataria										
3.13.	<u>Korniza e politikave</u>									
3.13.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.13.	<u>Reformat institucionale dhe ngritja e kapaciteteve institucionale</u>									
3.13.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.13.	<u>Zbatimi në praktikë</u>									
3.13.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.14. Kapitulli 14 i acquis-së: Politikat e transportit										
3.14.	<u>Korniza e politikave</u>									
3.14.15	Neni 113	Hartimi i politikave të zhvillimit strategjik të sektorit të transportit	Strategjia sektoriale dhe e transportit multimodal 2015-2025 dhe plani i veprimit, e rishikuar dhe miratuar	MMPHI		K4 2021		25,200	0	25,200
3.14.16	Neni 113	Përmirësimi i sigurisë rrugore	Databaza e aksidenteve rrugore, e krijuar	MMPHI		K4 2021	Strategjia Sektoriale dhe e Transportit Multimodal 2015-2025 Plani i Vveprimit për Siguri Rrugore TCT	24,300	0	24,300
3.14.	<u>Reformat institucionale dhe ngritja e kapaciteteve institucionale</u>									
3.14.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.14.	<u>Zbatimi në praktikë</u>									
3.14.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.15. Kapitulli 15 i acquis-së: Energjia										
3.15.	<u>Korniza e politikave</u>									
3.15.5	Neni 114	Zhvillimi i mëtejshëm i politikave në fushën e e energjisë me qëllim të zbatimit të dispozitave të MSA-së dhe acquis-së së transpozuar	Strategjia e rishikuar e energjisë, e miratuar	ME	MFPT ZRrE KOSTT MMPHI	K4 2021	Strategjia e energjisë e Republikës së Kosovës 2017-2026	40,000	0	40,000
3.15.6	Neni 114	Zhvillimi i mëtejshëm i politikave në fushën e e energjisë dhe ndryshimeve klimatike me qëllim të zbatimit të dispozitave të MSA-së dhe acquis-së së transpozuar	Plani kombëtar për energji dhe klimë 2021-2030, i miratuar	ME	MMPHI MFPT ZRrE KOSTT	K4 2021	Traktati i Komunitetit të Energjisë: Rregullore për qeverisjen e unionit energjetik dhe veprimin për klimë	22,000	50,000	72,000
3.15.7	Neni 114	Zhvillimi i mëtejshëm i politikave në fushën e burimeve të ripërtëritshme të energjisë (BRE) me qëllim të zbatimit të dispozitave të MSA-së dhe acquis së transpozuar	Koncept dokumenti për burimet e ripërtëritshme të energjisë, i miratuar	ME	MFPT ZRrE KOSTT ZKM	K3 2021	Strategjia e energjisë e Republikës së Kosovës 2017-2026	2,700	0	2,700

3.15.	<u>Reformat institucionale dhe ngritja e kapaciteteve institucionale</u>									
3.15.8	Neni 114	Përmirësimi i të dhënave statistikore për eficiencën e energjisë	Platforma e monitorimit dhe verifikimit për kursimin e energjisë, raportet e gjeneruara	AKEE	ME FKEE	K4 2021	Ligji për Eficiencë të Energjisë L 06/079	2,400	0	2,400
3.15.	<u>Zbatimi në praktikë</u>									
3.15.9	Neni 114	Zhvillimi i mëtejshëm i politikave në fushën e energjisë elektrike së me qëllim të zbatimit të dispozitave të MSA-së dhe acquis-së së transpozuar	Plani për masat mbrojtëse për konsumatorët e cenueshëm (energji elektrike), i hartuar	MFPT	ME ZRrE	K4 2021		5,400	0	5,400
3.16. Kapitulli 16 i acquis-së: Tatimet										
3.16.	<u>Korniza e politikave</u>									
3.16.1	Neni 39, 40, 70 dhe 105	Rishikimi i politikave aktuale tatimore	Analiza për rishikimin e politikave aktuale tatimore, e hartuar	MFPT		K4 2021		0	0	0
3.16.	<u>Reformat institucionale dhe ngritja e kapaciteteve institucionale</u>									
3.16.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.16.	<u>Zbatimi në praktikë</u>									
3.16.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.17. Kapitulli 17 i acquis-së: Politikat ekonomike dhe monetare (referojuni Bllokut 2: Kriteret Ekonomike)										
3.17.	<u>Korniza e politikave</u>									
3.17.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.17.	<u>Reformat institucionale dhe ngritja e kapaciteteve institucionale</u>									
3.17.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.17.	<u>Zbatimi në praktikë</u>									
3.17.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.18. Kapitulli 18 i acquis-së: Statistikat										
3.18.	<u>Korniza e politikave</u>									
3.18.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.18.	<u>Reformat institucionale dhe ngritja e kapaciteteve institucionale</u>									
3.18.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.18.	<u>Zbatimi në praktikë</u>									
3.18.2	Neni 95	Përgatitjet për regjistrimin e popullsisë dhe banesave 2021	Burimet financiare dhe administrative adekuate (pyetësorët, udhëzuesit, dhe materiali tjetër statistikor), të siguruar	MFPT	Kuvendi ASK	K4 2021	Konkluzionet e NK për Çështje Ekonomike e Financiare dhe Statistika 2020	2,151,888	0	2,151,888
3.18.3	Neni 95	Fuqizimi i bashkëpunimit ndër-institucional	Shfrytëzimi (qasja) në të dhënat e ARC, ISCED 2011 në dispozicion në nivel vendi	MFPT	ARC ASK BQK	K4 2021	Konkluzionet e NK për Çështje Ekonomike e Financiare dhe Statistika 2020	13,500	1,600	15,100
3.19. Kapitulli 19 i acquis-së: Politikat sociale dhe punësimi										
3.19.	<u>Korniza e politikave</u>									

3.19.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.19.	<u>Reformat institucionale dhe ngritja e kapaciteteve institucionale</u>									
3.19.2	Neni 82 dhe 106	Fuqizimi i kapaciteteve institucionale në Inspektoratin e Punës	Numri i inspektorëve, i rritur	MFPT	IP	K4 2021	Strategjia Sektoriale e MFPT 2018-2022	246,310	0	246,310
3.19.	<u>Zbatimi në praktikë</u>									
3.19.3	Neni 82 dhe 106	Ndërmarrja e masave për rritjen e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës	Numri i grave të përfshira në masat aktive të tregut të punës, i rritur	MFPT		K4 2021		2,100,000	0	2,100,000
3.19.4	Neni 82 dhe 106	Ndërmarrja e masave për rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në tregun e punës	Numri i të rinjve të përfshirë në masat aktive të tregut të punës, i rritur	MFPT		K4 2021		1,800,000	0	1,800,000
3.19.5	Neni 82 dhe 106	Targetimi dhe ofrimi më i mirë i shërbimeve sociale në komuna dhe skemave të asistencës sociale	Shkalla e mbulushmërisë së familjeve të varfra, e rritur	MFPT		K4 2021	Strategjia Sektoriale e MPMS 2018-2022	32,000,000	0	32,000,000
3.20. Kapitulli 20 i acquis-së: Ndërmarrjet dhe politikat e industrisë										
3.20.	<u>Korniza e politikave</u>									
3.20.2	Neni 99 dhe 100	Përmirësimi i politikave sa i përket ambientit të biznesit dhe industrisë	Strategjia e Turizmit, e miratuar	MINT		K3 2021		0	0	0
3.20.	<u>Reformat institucionale dhe ngritja e kapaciteteve institucionale</u>									
3.20.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.20.	<u>Zbatimi në praktikë</u>									
3.20.3	Neni 99 dhe 100	Mbështetja e NVM-ve për certifikimin e produkteve	Së paku 10 NVM të subvencionuara në formë të granteve për certifikim të produkteve	MINT		K4 2021		7,500	0	7,500
3.21. Kapitulli 21 i acquis-së: Rrjetet trans-evropiane										
3.21.	<u>Korniza e politikave</u>									
3.21.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.21.	<u>Reformat institucionale dhe ngritja e kapaciteteve institucionale</u>									
3.21.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.21.	<u>Zbatimi në praktikë</u>									
3.21.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.22. Kapitulli 22 i acquis-së: Politikat rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore										
3.22.	<u>Korniza e politikave</u>									
3.22.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.22.	<u>Reformat institucionale dhe ngritja e kapaciteteve institucionale</u>									
3.22.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.22.	<u>Zbatimi në praktikë</u>									
3.22.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.23. Kapitulli 23 i acquis-së: Gjyqësori dhe të drejtat themelore										
3.23.	<u>Korniza e politikave</u>									
3.23.	Sistemi gjyqësor									

3.23.29	Neni 83	Finalizimi miratimi dhe zbatimi i politikave për procesin e vetingut në sistemin e drejtësisë	Koncept dokumentit për zhvillimin e procesit të vetingut, i miratuar	MD	KPK KGJK Kuvendi	K3 2021		5,000	0	5,000
3.23.30	Neni 83	Avancimi i kornizës ligjore dhe sistemit të administrimit të pasurisë së sekuestruar apo të konfiskuar	Koncept dokumentit për krijimin e fondit të konfiskimit, i miratuar	MD	MFFT ZKM	K4 2021		100	0	100
3.23.31	Neni 83	Rishikimi funksional i sektorit të sundimit të ligjit me qëllim të identifikimit dhe përcaktimit të objektivave strategjike dhe zhvillimore për fushën e sundimit të ligjit, të rritjes së efektivitetit të institucioneve në zbatimin e ligjit	Strategjia sektoriale e sundimit të ligjit, e miratuar	MD	KGJK KPK MPB ZKM MF AKK Kuvendi Presidenca	K3 2021		150,000	0	150,000
3.23.	Politikat kundër korrupsionit									
3.23.32	Neni 83 dhe 91	Avancimi i luftës kundër korrupsionit, si dhe zbatimi i reformave kyçe për drejtësi	Strategjia dhe Plani i Veprimit për Luftimin e Korrupsionit 2021 - 2023, e miratuar	AKKK	Kuvendi ZKM MD MFFT MPB KGJK KPK	K4 2021		3,000	0	3,000
3.23.	Të drejtat themelore									
3.23.33	Neni 3 dhe 4	Avancimi i kornizës ligjore dhe të politikave për mbrojtjen, promovimin dhe zbatimin e të drejtave të njeriut	Programi për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut (2021-2025), i miratuar	ZKM	ABGJ KGJK KPK IAP	K3 2021	Ligji për mbrojtjen nga Diskriminimi, Ligji për Barazi Gjinore Ligji për Avokatin e Popullit	6,000	13,000	19,000
3.23.34	Neni 3 dhe 4	Të drejtat e personave me aftësi të kufizuara janë prioritetuar në agjendën Qeverisë	Plani nacional për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, i hartuar	ZKM	OPAK	K3 2021	Konventa për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara; Strategjia për të drejtat e personave me Aftësi të kufizuara 2013-2023;	0	0	0
3.23.35	Neni 3 dhe 4	Zhvillimi i hulumtimeve për mbrojtje nga diskriminimi	Zhvillimi i hulumtimit mbi diversitetin dhe barazinë në Republikën e Kosovës	ZKM		K3 2021	Ligji nr. 05/L021 për Mbrojtje nga Diskriminimi	0	0	0
3.23.36	Neni 3 dhe 4	Të rregullohet mbrojtja e burimeve të gazetareve në	Koncept dokument për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë	ZKM		K4 2021	ERA II	0	4,050	4,050

		përputhje me standardet dhe praktikat evropiane								
3.23.	Mbrojtja e minoriteteve dhe trashëgimia kulturore									
3.23.37	Neni 3 dhe 4	Avancimi i kornizës ligjore dhe dokumenteve strategjike për komunitete, kthim dhe integrim	Koncept dokument për përkrahjen e projekteve për komunitete	MKK	ZKM	K4 2021	Plani i punës së MKK PVPQ	0	10,109	10,109
3.23.38	Neni 3 dhe 4	Avancimi i kornizës ligjore dhe dokumenteve strategjike për komunitete, kthim dhe integrim	Koncept dokument për persona të zhvendosur	MKK	ZKM	K4 2021	Plani i punës së MKK PVPQ	0	10,109	10,109
3.23.39	Neni 3 dhe 4	Avancimi i kornizës ligjore dhe dokumenteve strategjike për komunitete, kthim dhe integrim	Strategjia për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, e miratuar	MKK	ZKM	K4 2021	Plani i punës së MKK PVPQ	0	10,000	10,000
3.23.	Mbrojtja e të dhënave personale									
3.23.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.23.	Reformat institucionale dhe ngritja e kapaciteteve institucionale									
3.23.	Sistemi gjyqësor									
3.23.40	Neni 83	Të sigurohet që procesi i përzgjedhjes së anëtarëve të mbetur të KGJK-së dhe KPK-së të jetë transparent, i bazuar në merita duke siguruar që kandidatët e përzgjedhur ti plotësojnë kërkesat ligjore për këto pozita	Dy (2) anëtarë të KPK-së, të emëruar	Kuvendi		K3 2021		263	0	263
3.23.41	Neni 83	Të sigurohet që procesi i përzgjedhjes së anëtarëve të mbetur të KGJK-së dhe KPK-së të jetë transparent, i bazuar në merita duke siguruar që kandidatët e përzgjedhur ti plotësojnë kërkesat ligjore për këto pozita.	Një (1) anëtar i KGJK-së nga komuniteti pakicë i emëruar	Kuvendi		K3 2021		3,153	0	3,153
3.23.42	Neni 83	Avancimi i mëtutjeshëm i performancës në gjyqësor në veçanti në krijimin e mekanizmave në regjistrimin e dosjeve kriminale	Njësia Kombëtare për Regjistrimin e Lëndëve Penale brenda Sekretariatit të KGJK, e funksionalizuar	KGJK		K4 2021		35,640	0	35,640
3.23.	Politikat kundër korrupsionit									

3.23.43	Neni 83 dhe 91	Avancimi i mëtutjeshëm i njësisë për krime lufte në PSRK-së	Një (1) prokuror i transferuar	KPK		K4 2021		786	0	786
3.23.44	Neni 83 dhe 91	Avancimi i mëtutjeshëm i njësisë për krime lufte në PSRK-së	Dy (2) staf mbështetës, të rekrutuar	KPK		K4 2021		330	0	330
3.23.45	Neni 83 dhe 91	Hartimi dhe zbatim i politikave trajnuese të specializuara për të forcuar kapacitetin e sistemit prokurorial dhe gjyqësor për të kryer hetime financiare, ndjekjen penale, dënimet përfundimtare dhe konfiskimet përfundimtare	Dy (2) trajnime për pesëmbëdhjetë (15) prokurorë dhe dhjetë (10) gjyqtarë në hetimet dhe gjykimet e krimit financiar, i mbajtur	AD	KPK KGJK	K4 2021	Programi Trajnues për vitin 2021 Plani Strategjik i AD-së 2019-2021 Strategjia shtetërore në luftën kundër krimit të organizuar 2018-2022 Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Jo-formale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2019-2023	465	0	465
3.23.46	Neni 83 dhe 91	Hartimi dhe zbatim i politikave trajnuese të specializuara për të forcuar kapacitetin e sistemit prokurorial dhe gjyqësor për të kryer hetime financiare, ndjekjen penale, dënimet përfundimtare dhe konfiskimet përfundimtare	Një (1) trajnim për njëzetë (20) prokurorë dhe tridhjetë (30) gjyqtarë për sekuestrim, i mbajtur	AD	KPK KGJK	K4 2021	Programi Trajnues për vitin 2021 Plani Strategjik i AD-së 2019-2021 Strategjia shtetërore në luftën kundër krimit të organizuar 2018-2022 Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Jo-formale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2019-2023	930	0	930

3.23.	Të drejtat themelore									
3.23.47	Neni 3 dhe 4	Ngritja e kapaciteteve të mekanizmave institucional për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe mekanizmave institucional për barazi gjinore	Gjashtë (6) trajnime mbi avancimin e realizimit të të drejtave në vendimmarrje, paqe, siguri dhe drejtësi, të organizuara nga ABCj	ZKM		K4 2021		0	32,000	32,000
3.23.	Mbrojtja e minoriteteve dhe trashëgimia kulturore									
3.23.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.23.	Mbrojtja e të dhënave personale									
3.23.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.23.	<u>Zbatimi në praktikë</u>									
3.23.	Sistemi gjyqësor									
3.23.48	Neni 83	Administrimi më efikas i sistemit prokurorial dhe fuqizimi i administratës	Një-e-treta (1/3) e prokurorëve dhe prokurorëve të vlerësuar	KPK		K4 2021		5,173	0	5,173
3.23.49	Neni 83	Administrimi më efikas i sistemit gjyqësor dhe fuqizimi i administratës.	Një-e-treta (1/3) e gjyqtarëve të vlerësuar	KGjK		K4 2021		0	0	0
3.23.50	Neni 83	Avansimi i mëtejme i sistemit elektronik të menaxhimit të lëndëve	Konsolidimi i fazës së Sistemit (SMIL) në të gjitha regjionet e gjykatave duke përfshirë Lëndët Civile dhe Penale	KGjK		K4 2021		399,500	329,903	729,403
3.23.51	Neni 83	Adiministrimi efikas i procedurave dicitlinore në sistemin e drejtësisë	Baza elektronike e të dhënave, e cila do të regjistrojë të gjitha ankesat dhe kërkesat për fillimin e hetimeve disiplinore dhe informacionin e paraqitur nga autoriteti kompetent për prokurorë, e themeluar	KPK		K4 2021		3,683	36,000	39,683
3.23.52	Neni 83	Adiministrimi efikas i procedurave dicitlinore në sistemin e drejtësisë	Baza elektronike e të dhënave, e cila do të regjistrojë të gjitha ankesat dhe kërkesat për fillimin e hetimeve disiplinore dhe informacionin e paraqitur nga autoriteti kompetent për gjyqtarë, e themeluar	KGjK		K4 2021		20,000	0	20,000
3.23.53	Neni 83	Administrimi më efikas i sistemit gjyqësor dhe fuqizimi i administratës	Plani i Veprimit i sistemit prokurorial për menaxhimin e krizave, i zbatuar	KPK		K4 2021		36,786	0	36,786
3.23.	Politikat kundër korrupsionit									
3.23.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.23.	Të drejtat themelore									
3.23.54	Neni 3 dhe 4	Fuqizimi ekonomik i grave dhe vajzave përmes subvencionimit të projekteve që synojnë arritjen e barazisë gjinore OJQ dhe individëve fizike	Katërmbëdhjetë (14) projekte për fuqizimin ekonomik të grave dhe vajzave, të subvencionuara	ZKM		K4 2021		40,000	0	40,000

3.23.55	Neni 3 dhe 4	Ngritja e vetëdijes dhe senzibilizimi i opinionit mbi rëndësinë e parandalimit të dhunës në familje dhe luftimin e stereoptipeve gjinore dhe plotësimi i kornizës ligjore që garanton barazinë gjinore	Fushata vetëdijësuese, të realizuara	ZKM		K4 2021		25,000	0	25,000
3.23.56	Neni 3 dhe 4	Sensibilizimi i opinionit të gjërë për mbrojtjen e fëmijëve	Organizimi i fushatës për promovimin e ligjit për mbrojtjen e fëmijës	ZKM		K4 2021		3,000	17,000	20,000
3.23.	Mbrojtja e minoriteteve dhe trashëgimia kulturore									
3.23.57	Neni 3 dhe 4	Ofrimi i mundësive për kthim për personat e zhvendosur	Ngritja e sistemit të menaxhimit të informacionit për personat e zhvendosur	MKK		K4 2021	Rregullorja nr. 01/2018 për Kthimin e Personave të Zhvendosur dhe Zgjidhje të Qëndrueshme	0	54,000	54,000
3.23.58	Neni 3 dhe 4	Mbyllja e qendrave kolektive	Mbështetje për mbylljen e qendrave kolektive në komunat e Leposaviqit, Zveçanit dhe Graçanicës	MKK		K4 2021	Rregullorja nr. 01/2018 për Kthimin e Personave të Zhvendosur dhe Zgjidhje të Qëndrueshme,	2,150,000	0	2,150,000
3.23.59	Neni 3 dhe 4	Përfshirja në arsim dhe ofrimi i mundësive të barabarta për fëmijët nga grupet e marginalizuara	Ofrimi i mbështetjes financiare për fëmijët rom, ashkali dhe egjiptian	MASHTI		K4 2021	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë (PSAK) 2017-2021	60,000	0	60,000
3.23.	Mbrojtja e të dhënave personale									
3.23.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.24. Kapitulli 24 i acquis-së: Drejtësia, liria dhe siguria										
3.24.	<u>Korniza e politikave</u>									
3.24.	Menaxhimi i kufirit									
3.24.5	Neni 85	Përmirësimi i mëtejshëm i kornizës së politikave në fushën e menaxhimit të kufirit, me qëllim të zbatimit të dispozitave të MSA-së dhe të legjislacionit të përafëruar	Plani zhvillimor i QKMK-së, i rishikuar	MPB	MFPT ZKM	K4 2021	PSO të Qeverisë 2021-2025 Konkluzionet e NK për Drejtësi, Liri dhe Siguri 2020	5,000	5,000	10,000
3.24.	Vizat									
3.24.	Në këtë pjesë nuk është planifikuar ndonjë masë.									
3.24.	Siguria e dokumenteve									
3.24.	Në këtë pjesë nuk është planifikuar ndonjë masë.									
3.24.	Azili									
3.24.	Në këtë pjesë nuk është planifikuar ndonjë masë.									

3.24.	Migracioni									
3.24.6	Neni 85, 86, 87 dhe 88	Përmirësimi i mëtejshëm i kornizës së politikave në fushën e migracionit, me qëllim të zbatimit të dispozitave të MSA-së dhe të legjislacionit të përafëruar	Koncept-dokumenti për të Huajt, i miratuar	MPB	ZKM MPJD MFPT	K4 2021	PSO të Qeverisë 2021-2025 ERA II	5,000	1,000	6,000
3.24.7	Neni 85, 86, 87 dhe 88	Përmirësimi i mëtejshëm i kornizës së politikave në fushën e migracionit, me qëllim të zbatimit të dispozitave të MSA-së dhe të legjislacionit të përafëruar	Strategjia për migrim 2021-2025 dhe plani i punës, e miratuar	MPB	ZKM MPJD MFPT	K3 2021	PSO të Qeverisë 2021-2025 Konkluzionet e NK për Drejtësi, Liri dhe Siguri 2020	5,000	5,000	10,000
3.24.8	Neni 85, 86, 87 dhe 88	Përmirësimi i mëtejshëm i kornizës së politikave në fushën e migracionit, me qëllim të zbatimit të dispozitave të MSA-së dhe të legjislacionit të përafëruar	Profili i lehtë i migrimit 2020, i miratuar	MPB	ZKM MFPT MPJD AQM	K4 2021	PSO të Qeverisë 2021-2025 ERA II	8,100	15,000	23,100
3.24.9	Neni 85, 86, 87 dhe 88	Përmirësimi i mëtejshëm i kornizës së politikave në fushën e migracionit, me qëllim të zbatimit të dispozitave të MSA-së dhe të legjislacionit të përafëruar	Plani për reagim në rast të fluksit me migrantë dhe refugjatë, i përditësuar dhe miratuar.	MPB	MM MFPT MPJD AQM	K4 2021	PSO të Qeverisë 2021-2025	5,400	8,500	13,900
3.24.10	Neni 85, 86, 87 dhe 88	Përmirësimi i mëtejshëm i kornizës së politikave në fushën e migracionit, me qëllim të zbatimit të dispozitave të MSA-së dhe të legjislacionit të përafëruar	Sistemi i integritetit të të huajve, i zhvilluar	MPB		K4 2021	PSO të Qeverisë 2021-2025	0	5,000	5,000
3.24.	Luftimi i shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizimit									
3.24.	Në këtë pjesë nuk është planifikuar ndonjë masë.									
3.24.	Luftimi i narkotikëve									
3.24.	Në këtë pjesë nuk është planifikuar ndonjë masë.									
3.24.	Luftimi i krimit të organizuar dhe bashkëpunimi policor									
3.24.11	Neni 89, 90, 91 dhe 92	Përmirësimi i kornizës së politikave në fushën e reformës në polici	Koncepti i dokumentit për vettingun në MPB dhe agjencitë vartëse, i hartuar	MPB		K4 2021	PSO të Qeverisë 2021-2025 ERA II	0	0	0
3.24.12	Neni 89, 90, 91 dhe 92	Avancimi i mëtejshëm i konceptit të policisë së udhëhequr nga inteligjenca në luftimin e krimit të organizuar	Raporti i vlerësimit të kërcënimeve që vijnë nga krimi i organizuar dhe krimet e rënda (SOCTA), i hartuar	MPB		K4 2021	PSO të Qeverisë 2021-2025 ERA II	0	7,100	7,100

3.24.13	Neni 89, 90, 91 dhe 92	Ngritja e bashkëpunimit me EUROPOL	Marrëveshja për zyrtarin ndërlidhës me EUROPOL, i nënshkruar	MPB		K4 2021	PSO të Qeverisë 2021-2025 ERA II	0	3,000	3,000
3.24.14	Neni 89, 90, 91 dhe 92	Ngritja e bashkëpunimit me EUROPOL	Memorandumi i Mirëkuptimit për krijimin e linjës së sigurtë të komunikimit me EUROPOL, i nënshkruar	MPB		K4 2021	PSO të Qeverisë 2021-2025 ERA II	0	3,000	3,000
3.24.15	Neni 89, 90, 91 dhe 92	Ngritja e bashkëpunimit me Guardia di Finanza	Plani i përbashkët në mes të policisë së Kosovës dhe Guardia di Finanza, i hartuar	MPB		K4 2021	PSO të Qeverisë 2021-2025 ERA II	0	3,000	3,000
3.24.16	Nei 89, 90, 91 dhe 92	Përmirësimi i kornizës së politikave në luftën kundër trafikimit me qenie njerëzore	Strategjia kundës trafikimit me qenie njerëzore	MPB		K4 2021	PSO të Qeverisë 2021-2025	0	0	0
3.24.17	Neni 91	Përmirësimi i kornizës së politikave në fushën e sigurisë kibernetike	Strategjia shtetërore për sigurinë kibernetike 2020-2024, e miratuar nga Qeveria	MPB		K3 2021	PSO të Qeverisë 2021-2025	4,200	15,000	19,200
3.24.	Lufta kundër terrorizmit									
3.24.18	Neni 92	Përmirësimi i kornizës së politikave në fushën e luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit	Strategjia për parandalim të terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, e miratuar	MPB		K3 2021	PSO të Qeverisë 2021-2025 ERA II	0	5,000	5,000
3.24.19	Neni 92	Përmirësimi i kornizës së politikave në fushën e luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit	Raportet për zbatimin e Planit të Përbashkët të Veprimit BE - Ballkan Përendimor kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit	MPB		K3 2021	PSO të Qeverisë 2021-2025 ERA II	0	5,000	5,000
3.24.20	Neni 92	Përmirësimi i kornizës së politikave në fushën e luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit	Vlerësimi i përbashkët mbi rrezikun dhe kërcënimet nga terrorizmi, i hartuar	MPB		K4 2021	PSO të Qeverisë 2021-2025 ERA II	0	3,500	3,500
3.24.21	Neni 93	Hartimi i koncept dokumentit për armët	Koncept dokumenti për Armët, i hartuar	MPB		K4 2021	PSO të Qeverisë 2021-2025	0	0	0
3.24.22	Neni 92	Përmirësimi i kornizës së politikave në fushën e luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit	Programi i riintegritimit dhe deradikalizimit, i rishikuar	MPB		K3 2021	PSO të Qeverisë 2021-2025 ERA II	0	2,000	2,000
3.24.	Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështje penale dhe civile									
3.24.	Në këtë pjesë nuk është planifikuar ndonjë masë.									
3.24.	<u>Reformat institucionale dhe ngritja e kapaciteteve institucionale</u>									
3.24.	Menaxhimi i kufirit									
3.24.	Në këtë pjesë nuk është planifikuar ndonjë masë.									
3.24.	Vizat									
3.24.	Në këtë pjesë nuk është planifikuar ndonjë masë.									
3.24.	Siguria e dokumenteve									
3.24.23	Neni 85	Përmirësimi i shërbimeve që ofrohen nga ARC përmes digjitalizimit, automatizimit	Sistemi për menaxhimin e radhës dhe termineve online për shërbimet e ARC-së, i krijuar	MPB		K4 2021	PSO të Qeverisë 2021-2025	0	120,000	120,000

		dhe ofrimit të shërbimeve online dhe ndërlidhjes së sistemeve								
3.24.	Azili									
3.24.	Në këtë pjesë nuk është planifikuar ndonjë masë.									
3.24.	Migracioni									
3.24.24	Neni 85, 86, 87 dhe 88	Ngritja e kapaciteteve të pritjes dhe menaxhimit të flukseve me migrante	Qendra e Përkohshme e Pritjes, e funksionalizuar	MPB		K4 2021	PSO të Qeverisë 2021-2025 ERA II Konkluzionet e NK për Drejtësi, Liri dhe Siguri 2020	250,000	0	250,000
3.24.	Luftimi i shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizimit									
3.24.25	Neni 89	Fuqizimi i hetimeve të integruara financiare	PSO për të drejtuar hetimet financiare në përputhje me rekomandimet e FATF, e miratuar	MPB		K4 2021	PSO të Qeverisë 2021-2025 Konkluzionet e NK për Drejtësi, Liri dhe Siguri 2020	0	3,000	3,000
3.24.	Luftimi i narkotikëve									
3.24.	Në këtë pjesë nuk është planifikuar ndonjë masë.									
3.24.	Luftimi i krimit të organizuar dhe bashkëpunimi policor									
3.24.26	Neni 89, 90, 91 dhe 92	Avancimi i mëtejshëm i konceptit të policisë së udhëhequr nga inteligjenca në luftimin e krimit të organizuar	UA dhe POS për trajtimin e informatorëve, të hartuara/miratuar	MPB		K3 2021	PSO të Qeverisë 2021-2025 ERA II	0	3,000	3,000
3.24.27	Neni 89, 90, 91 dhe 92	Avancimi i mëtejshëm i konceptit të policisë së udhëhequr nga inteligjenca në luftimin e krimit të organizuar	Grupet punuese të koordinimit për ILP në nivelin qendror dhe lokal, të funksionalizuara	MPB		K3 2021	PSO të Qeverisë 2021-2025 ERA II	0	2,000	2,000
3.24.28	Neni 89, 90, 91 dhe 92	Avancimi i mëtejshëm i konceptit të policisë së udhëhequr nga inteligjenca në luftimin e krimit të organizuar	Gjashtëmbëdhjetë (16) zyrtarë të Policisë së Kosovës në tetë (8) drejtori regionale, të emëruar dhe trajnuar	MPB		K3 2021	PSO të Qeverisë 2021-2025 ERA II	0	1,056,000	1,056,000
3.24.29	Neni 89, 90, 91 dhe 92	Avancimi i mëtejshëm i konceptit të policisë së udhëhequr nga inteligjenca në luftimin e krimit të organizuar	Tridhjetegjashtë (36) kompjuterë të specializuar të lidhur me Databazën e Inteligjencës për dërgimin e raporteve të informacionit të inteligjencës për çdo stacion policor, të instaluar	MPB		K3 2021	PSO të Qeverisë 2021-2025 ERA II	0	280,000	280,000
3.24.	Lufta kundër terrorizmit									
3.24.	Në këtë pjesë nuk është planifikuar ndonjë masë.									
3.24.	Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështje penale dhe civile									
3.24.	Në këtë pjesë nuk është planifikuar ndonjë masë.									
3.24.	<u>Zbatimi në praktikë</u>									

3.24.	Menaxhimi i kufirit									
3.24.30	Neni 85, 86, 87 dhe 88	Avancimi i politikave në Menaxhimin e Integruar të Kufirit, kontrolli dhe mbikëqyrja e kufirit në përputhje me standardet e Schengenit	Përpilimi i analizës së riskut sipas modelit CIRAM 2.0	MPB		K4 2021		0	3,000	3,000
3.24.	Vizat									
3.24.	Në këtë pjesë nuk është planifikuar ndonjë masë.									
3.24.	Siguria e dokumenteve									
3.24.	Në këtë pjesë nuk është planifikuar ndonjë masë.									
3.24.	Azili									
3.24.	Në këtë pjesë nuk është planifikuar ndonjë masë.									
3.24.	Migracioni									
3.24.	Në këtë pjesë nuk është planifikuar ndonjë masë.									
3.24.	Luftimi i shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizimit									
3.24.	Në këtë pjesë nuk është planifikuar ndonjë masë.									
3.24.	Luftimi i narkotikëve									
3.24.	Në këtë pjesë nuk është planifikuar ndonjë masë.									
3.24.	Luftimi i krimit të organizuar dhe bashkëpunimi policor									
3.24.	Në këtë pjesë nuk është planifikuar ndonjë masë.									
3.24.	Lufta kundër terrorizmit									
3.24.	Në këtë pjesë nuk është planifikuar ndonjë masë.									
3.24.	Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështje penale dhe civile									
3.24.	Në këtë pjesë nuk është planifikuar ndonjë masë.									
3.25. Kapitulli 25 i acquis-së: Shkenca dhe kërkimet shkencore										
3.25.	<u>Korniza e politikave</u>									
3.23.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.25.	<u>Reformat institucionale dhe ngritja e kapaciteteve institucionale</u>									
3.23.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.25.	<u>Zbatimi në praktikë</u>									
3.25.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.26. Kapitulli 26 i acquis-së: Arsimi dhe kultura										
3.26.	<u>Korniza e politikave</u>									
3.26.4	Neni 118 i MSA-së	Përmirësimi i cilësisë në arsimin parauniversitar	Draft-kurrikulat e programeve mësimore të rishikuara për klasën e 5-të për të gjitha lëndët mësimore në gjuhën shqipe dhe për lëndët nacionale në gjuhën boshnjake dhe turke	MASHTI		K4 2021	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë (PSAK) 2017-2021 Korniza e Kuurikutit të Kosovës	49,700	0	49,700
3.26.	<u>Reformat institucionale dhe ngritja e kapaciteteve institucionale</u>									
3.26.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.26.	<u>Zbatimi në praktikë</u>									
3.26.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.27. Kapitulli 27 i acquis-së: Mjedisi										

3.27.	Korniza e politikave									
3.27.9	Neni 115, 116 dhe 117	Përmirësimi politikave për zhvillimin e sektorit të pylltarisë	Strategjia për zhvillimin e sektorit të pylltarisë 2021-2030, e miratuar	MPBZHR	ZKM MMPHI MFPT	K4 2021	Ligji për Pyjet	0	80,000	80,000
3.27.10	Neni 115, 116 dhe 117	Përmirësimi politikave për zhvillimin e sektorit të Pylltarisë	Plani i veprimit për luftën kundër prerjeve ilegale, i hartuar	MPBZHR	ZKM MMPHI MFPT	K4 2021	Ligji për Pyjet	480	0	480
3.27.11	Neni 115, 116 dhe 117	Përmirësimi i politikave strategjike mjedisore	Koncept dokumenti për vlerësimin strategjik mjedisor, i miratuar	MMPHI	ZKM	K3 2021	Ligji për vlerësimin strategjik mjedisor	540	0	540
3.27.12	Neni 115, 116 dhe 117	Përmirësimi i inspektimit mjedisor	Koncept dokumenti për inspektoratin e mjedisit, ujërave, natyrës, planifikimit hapësinor, ndërtimit dhe banimit, i miratuar	MMPHI	ZKM MBPZHR	K4 2021	Ligji për inspektimet e përgjithshme	4,455	0	4,455
3.27.	Reformat institucionale dhe ngritja e kapaciteteve institucionale									
3.27.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.27.	Zbatimi në praktikë									
3.27.13	Neni 115, 116 dhe 117	Përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave	Studimi i fizibilitetit për deponinë e Mirashit në Obiliq, i përfunduar	MMPHI	ZKM	K4 2021	Ligji për mbeturinat	2,430	0	2,430
3.27.14	Neni 115, 116 dhe 117	Përmirësimi i menaxhimit të ujërave	Studimi i vlerësimit të sigurisë së digave ekzistuese, i përfunduar	MMPHI	ZKM ME	K4 2021	Ligji për Ujërat e Kosovës	50,000	0	50,000
3.28. Kapitulli 28 i acquis-së: Mbrojtja e konsumatorit dhe e shëndetit publik										
3.28.	Korniza e politikave									
3.28.	Mbrojtja e konsumatorit									
3.28.4	Neni 81	Avancimi i politikave në fushën e mbrojtjes së konsumatorit	Koncept-dokumenti për plotësim-ndryshimin e Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit (06/L-34), i miratuar	MINT		K4 2021		7,500	10,150	17,650
3.28.5	Neni 81	Avancimi i politikave në fushën e mbrojtjes së konsumatorit	Programi për Mbrojtjen e Konsumatorit 2021-2025, i miratuar	MINT		K3 2021		4,100	11,150	15,250
3.28.	Mbrojtja e shëndetit publik									
3.28.6	Neni 106	Avancimi i politikave në fushën e mbrojtjes së shëndetit publik	Strategjia Sektoriale Shëndetësore 2022-2032, e miratuar	MSh	ZKM	K4 2021		10,000	0	10,000
3.28.7	Neni 106	Avancimi i politikave në fushën e mbrojtjes së shëndetit publik	Plani i Veprimit për parandalim dhe kontroll të sëmundjeve ngjitëse, i miratuar	MSh	ZKM	K4 2021		5,040	0	5,040
3.28.	Reformat institucionale dhe ngritja e kapaciteteve institucionale									
3.28.	Mbrojtja e konsumatorit									
3.28.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.28.	Mbrojtja e shëndetit publik									
3.28.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.28.	Zbatimi në praktikë									
3.28.	Mbrojtja e konsumatorit									

3.28.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.28.	Mbrojtja e shëndetit publik									
3.28.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.29. Kapitulli 29 i acquis-së: Unioni Doganor										
3.29.	<u>Korniza e politikave</u>									
3.29.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.29.	<u>Reformat institucionale dhe ngritja e kapaciteteve institucionale</u>									
3.29.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.29.	<u>Zbatimi në praktikë</u>									
3.29.2	Neni 17, 18, 19, 39, 48, 75, 93, 104 dhe Protokolli 3	Vazhdimi i luftimit të ekonomisë joformale	Numri i aktiviteteve (inspektimeve, ndalo&kërko dhe patrullë) kundër kontrabandës bazuar në analizën e rrezikut	MFPT		K4 2021	Konkluzionet e NK për Tregti Industri, Dogana dhe Tatime 2020	396,000	0	396,000
3.30. Kapitulli 30 i acquis-së: Marrëdhëniet me jashtë										
3.30.	<u>Korniza e politikave</u>									
3.30.2	Nenet 11-16	Avancimi i politikave tregtare	Dokumenti për politika tregtare, i aprovuar	MINT		K4 2021		1,000	0	1,000
3.30.	<u>Reformat institucionale dhe ngritja e kapaciteteve institucionale</u>									
3.30.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.30.	<u>Zbatimi në praktikë</u>									
3.30.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.31. Kapitulli 31 i acquis-së: Politika e jashtme, e sigurisë dhe e mbrojtjes										
3.31.	<u>Korniza e politikave</u>									
3.31.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.31.	<u>Reformat institucionale dhe ngritja e kapaciteteve institucionale</u>									
3.31.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.31.	<u>Zbatimi në praktikë</u>									
3.31.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.32. Kapitulli 32 i acquis-së: Kontrolli financiar										
3.32.	<u>Korniza e politikave</u>									
3.32.1	Neni 97	Zhvillimi i politikave në fushën e kontrollit të brendshëm të financave publike	Dokumenti i politikave për Kontrollin e Brendshëm e Financave Publike, duke përfshirë llogaridhënien menaxheriale dhe vlerësimin e cilësisë, i miratur	MFPT	ZKM	K4 2021	Konkluzionet e NK për Çështje Ekonomike e Financiare dhe Statistika 2020	9,604	71,160	80,764
3.32.	<u>Reformat institucionale dhe ngritja e kapaciteteve institucionale</u>									
3.32.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.									
3.32.	<u>Zbatimi në praktikë</u>									
3.32.2	Neni 97	Të sigurohet përcjellja sistematike e zbatimit të rekomandimeve të auditimit të jashtëm	Numri i rekomandimeve të zbatuara nga OB-të, i rritur në krahasim me vitin paraprak	ZKA	Kuvendi	K4 2021	Konkluzionet e NK për Çështje Ekonomike e Financiare dhe Statistika 2020	42,775	0	42,775

3.33. Kapitulli 33 i acquis-së: Dispozitat financiare dhe buxhetore					
3.33.	<u>Korniza e politikave</u>				
3.33.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.				
3.33.	<u>Reformat institucionale dhe ngritja e kapaciteteve institucionale</u>				
3.33.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.				
3.33.	<u>Zbatimi në praktikë</u>				
3.33.	Kjo pjesë nuk përmban ndonjë masë.				
3.34. Kapitulli 34 i acquis-së: Institucionet					
3.34.	Programi nuk mbulon këtë kapitull ne këtë fazë të aderimit në BE.				
3.35. Kapitulli 35 i acquis-së: Çështjet e tjera					
3.35.	Programi nuk mbulon këtë kapitull ne këtë fazë të aderimit në BE.				
		Gjithsej (buxheti)	44,931,171	2,745,621	47,676,792